INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ

INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM

INSTITUTE FOR SCIENTIVIC RESEARCH AND DEVELOPMENT

NAUČNI BILTEN

BULETINI SHKENCOR

Međunarodni naučni časopis

Revista Shkencore ndërkombëtare

International Scientific Journals

Procedings

X-TH INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

"Innovation, education, research and science in function of global developments"

II-nd INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

"Maintaining and advancing the language, literature, education,journalism and history of national minorities in the Republic of Montenegro"

Fusha gjuhë- letërsi

Br/Nr. 10-4

God- Viti IV / 2018

Ulcinj-Ulqin 06.04.2018

Montenegro

REDAKSIA

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)

Vait Nikaj (sekretar shkencor)

Prof.Asc Dr.Azeta Tartaraj

Prod.Asc.Dr.Jetmire Zeqiri

Ma.Yllka R.Imeri

DREJTOR I REVISTËS

Prof.Ass.dr. Elez Osmani

CIP – Каталогизација у публикацији

Централна народна бибиотека Црне Горе, Цетиње 330(905L)

NAUČNI bilten:ekonomska istraživanja

Buletin Shkencor:hulumtime ekonomike

E- ISSN 2337-0521
ISSN 1800-9794

COBISS.CG-ID 20586256

Shtëpia botuese Instituti përkërkime shkencore dhe zhvillim -Ulqin

Shtypëshkronja **IDEA Graf Vranje-Serbi**

Korrektoi dhe punoi në kompjutër

Besard Jakupi

E drejta e autorit :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin

Adresa e redaksisë :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin ++38269265707

web.: www.ekonomskiinstitut.com

SCIENTIFIC COMMITTEE

• Prof.Dr. Adem Bekteshi *(Albaniai)* - President,

• Prof.Dr. Predrag Goranović, *(Montenegro)* – Co.President

Academican Slobodan Nešković, *(Serbia)*

Academican Konstantin Pochivalov, *(Russia)*

AcademicanDragoljubMirjanić, *(Serbian Rep.)*

Prof.DrNevenkaŽarkić-Joksimović, *(Serbia)*

Prof.Dr. RamëVata*(Kosovo)*

Prof.Dr. SlađanaBenković FON *(Serbia)*

Prof.Dr. Armand Krasniqi*(Kosovo)*

Prof. Dr. DragoljubJankovic*(Montenegro)*

Prof.Dr. IbishMazreku*(Kosovo)*

Prof.Dr. ToninGjuraj*(Albania)*

Prof.Dr. Anatoly Avdenko*(Ukraina)*

Prof.Dr. Valentin Nedeff*(Romania)*

Prof.Dr. FahrushRexhepi *(Kosovo)*

Prof.Dr. RauchoIlarinov *(Bulgaria)*

Prof.Dr. Constantin Bungau*(Romania)*

Prof.Dr. Vladimir P. Sergienko*(Belorus)*

Prof.Dr. PredragDašić*(USA)*

Prof.Dr. HidajetShehu*(Albania)*

Prof.Asc.Dr. HalitShabani*(Kosovo)*

Prof.Asc. Dr. HusnijaBibiljica *(Kosovo)*

Prof.Dr. Laszlo Karpati*(Hungary)*

Prof.Ass. Dr. ShefketJakupi, *(Kosovo)*

Prof.Dr. Diana Shehu *(Albania)*

Prof.Dr. ShkëlqimFortuzi*(Albania)*

Prof.Dr. SeadinXhaferi*(Macedonia)*

Prof. Dr. Michael Minch *(USA)*

Prof.Dr. ArmendKadriu*(Macedonia)*

Prof.Asc.Dr. BlertaDragusha*(Albania)*

Prof.Dr. NikéWentholt*(Netherland)*

Prof.Dr. DritaKruja*(Albania)*

Prof.Dr. SuloHaderi*(Albania)*

Prof.Asc.Dr. BrilandaBushati*(Albania)*

Prof.Dr. BesaXhaferi*(Macedonia)*

Prof.Dr. Arta Bilalli*(Macedonia)*

Prof.Dr. Laszlo Karpati*(Hungary)*

Prof.Dr. MiodragBrzaković*(Serbia)*

Prof.Asc.Dr. DarkoLacmanović*(MNE)*

Prof.Dr. SalvatorBushati *(Albania)*

Prof.Dr. SofronijaMiladinoski *(Macedonia)*

Prof.Dr. Daniel Dobrev, *(Bulgaria)*

Prof.Dr. Andrej Raspor *(Slovenia)*

Prof. Dr. Zoran Mastilo*(B&H)*

Prof.Ass.Dr. HalilKukaj *(Kosovo)*

Prof.Dr. MirsadNuković *(Vojvodina-Serbia)*

Doc. Dr. NazmijeMerkoZabzun*(Maced.)*

Prof.Dr. Tibor Petres*(Hungary)*

Prof.Asc. Dr. MirijamDibra*(Albania)*

Prof.Dr. Heinrich Meister *(Switzerland)*

Prof.Ass. Dr. KamberKamberi*(Kosovo)*

Prof. Dr. KelesGulbahar*(Turkey)*

Prof.Dr. Naser Raimi *(Macedonia)*

Prof.Dr. Astrit Mehmeti *(USA)*

Prof.Dr. AzetaTartaraj *(Albania)*

Prof.Dr. Edmond Beqiri*(Kosovo)*

Prof.Dr. ArtanNimani*(Kosovo)*

Prof.Dr. Kerstin Bree Carlson *(Danska)*

Prof.Dr. Robert Dimitrejvski*(Macedonia)*

Prof.Dr. Michael Minch *(USA)*

Ph.Dr. FitimMaçani*(Kosovo)*

Phd (c) Rexhep Suma *(Kosovo)*

Prof. Ass. (c) Dr. ZemaidaMozali*(Albania)*

Prof.Ass.Dr.VehbiRamaj*(Kosovo)*

Prof.Dr. JusufMustafai*(Macedonia)*

Prof.Asc. Dr. FatosUkaj *(Kosovo)*

Prof.Asc Dr. ElidianaBashi*(Albania)*

Prof.Dr. Radovan Stojanović*(MNE)*

Prof. Dr. BiljanaCiglovska*(Macedonia)*

Prof.Dr. Zoran Todoorović*(MNE)*

Doc.dr. sc. Dean Sinkovic, *(Croatia)*

Prof.Dr. Sonja Vitanova*(Macedonia)*

Prof.Asc.Dr.IlirBerhani*(Albania)*

Prof.Asc.Dr. ShaipBytyqi*(Kosovo)*

Prof.Asc.Dr.Alba Robert Dumi*(Albania)*

Dr. YlvijeBorici*(Albania)*

Prof.Asc.Dr.JetmireZeqiri(Macedonia)

INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM - ULQIN, Mali i Zi, 6-7 Prill 2018

Konferenca e X-të:

"Novacioni, arsimi. Kërkimi dhe shkenca në funksion të zhvillimeve globale"

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

KONTRIBUTI I ULEMAVE NË PENGIMIN E MIGRIMIT TË SHQIPTARËVE

PHD (c)Rexhep Suma

Abstrakt:

Ky punim shkencor ka për synim që të ndriçojë dhe të nxjerr në pah, rolin dhe kontributin e ulemave dhe institucioneve islame në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet stërgjyshore dhe ruajtjen e ekzistencës kombëtare dhe në ngritjen e vetëdijes politike dhe fetare.
Shqiptarët gjatë historisë janë ballafaquar me situata tejet të rënda e sidomos kur kemi të bëjmë me projektet sllave për largimin e tyre me dhunë nga trojet tona etnike drejt vendeve tjera. Të shtyrë nga ndjenja dhe mësimet fetare kur vatani çmohet dhe vlerësohet, shumë ulema shqiptar vazhdimisht në ligjërata, predikimet e tyre, vaze, takime dhe komunikimet me xhemat e popull, kanë shprehur qëndrimin që të jetohet në këto toka dhe assesi mos të braktiset vendi. Qëndrimi i tyre ishte që të ruhet atdheu dhe feja.

Ulemat në mënyrë të hapur ju kundërvunë zbatimit të planit famëkeq "Naçertanie" të Ilija Garashaninit, të vitit 1844, i cili parashihte spastrimin e trojeve shqiptare. Ferhat Draga, në të cilin merrnin pjesë paria e atëhershme kombëtare e fetare shqiptare siç ishin: Mulla Idriz Gjilani, Shaban Efendiu, Rexhep ef. Abdullau, Bedri ef. Hamidi, Kadri Saliu, Azem Hoxha, Idriz Cërcëri, Akshi Sulejmani, Mulla Lutfi Ahmeti, Zenel Ibrahim Strazimiri etj. Sa për ilustrim, parulla kryesore e Mulla Hamidi i Dobërçanit kundër shpërnguljes ishte***:***
"Kush shkon në Turqi dhe e len vendin e tij, është pa imanë" .
"Ai që e lëshon vatanin është shkja (i pa fe)".

Më 1931 Mbretëria jugosllave shpall ligjin mbi kolonizimin e krahinave jugore, kurse më 1937 "Klubi kulturor serb i Beogradit vendos një projekt për shpërnguljen e detyruar të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë drejt Turqisë dhe Shqipërisë." Konform këtij projekti, qeveria jugosllave, më 29-30 shtator të vitit 1938, nënshkruan një Marrëveshje me qeverinë turke, që njihet si: "Marrëveshja turko-jugosllave për kalimin e shqiptarëve në Turqi.". Duhet theksuar se këto politika antishqiptare ishin projekte të Vasa Çubrilloviçi më 1936, kur këtë diskurs tre vjet më vonë e ndoqi Ivo Andriçi .

Autoritetet e Beogradit, bënin plane të fshehta për deportimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta,kur roli i hoxhallarëve ishte tepër efektiv në bindjen e familjeve që të mos lënë vatanin dhe që në vitet 1938-1941 ranë në minimum.

Fjalë kyçe: shpërngulje, ulema, komjet, racë e pathyeshme.

Ylematë shqiptarë kala e parë e pamposhtur në Kosovë
-Planet mafioze të Patrikanës së Stambollit-

Shtimi i dhunës në mas të madhe dhe represioni nga pushteti serbo-sllavë ndaj popullatës së pafajshme shqiptare myslimane në përgjithësi, prodhuan dhe nxitën shpërnguljen e detyrueshme të popullsisë së Kosovës dhe më gjerë drejt Turqisë dhe si pasojë kjo shpërngulje e detyruar ndikoi në dizajnimin e

strukturës së popullsisë në baza nacionale e fetare ku veçohet se u zvogëlua dukshëm numri i shqiptarëve myslimanë dhe u rrit dukshëm numri i popullatës së krishtere (serbe) e cila u vendos në vendbanimet dhe pronën e uzurpuar nga ana e kolonëve serb dhe malazez.
Pushteti përdori çfarëdo lloj mjeti për t'i diskredituar, nënçmuar ulematë dhe joshur me para, poste, privilegje të ndryshme ose edhe kërcënimeve që të përkrahnin procesin e shpërnguljes me dhunë.

Kundër shpërnguljes Ulema Mexhlisi i Shkupit në Mbretërinë e Serbo-kroato-sllovene, i cili përfshinte tërë viset shqiptare nën Jugosllavi, pati një rol të rëndësishëm në organizimin e popullsisë myslimane. Nisur nga ky fakt, pushteti i atëhershëm jugosllav, te kjo organizatë, shihte një "alete" (vegël) të fuqishme për realizimin e planeve të veta të errëta, siç ishin: asimilimi i popullsisë myslimane veçanërisht të asaj shqiptare e turke; dëbimi i dhunshëm i kësaj popullsie për në Turqi dhe kolonizimi i këtyre viseve me kolona sllave.[1]
Në shtator të 1924 Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", me udhëzimet e Hoxha Kadriut, dërgoi në Gjenevë një delegacion që të protestonte pranë Lidhjes së Kombeve kundër barbarizmave të qarqeve shoviniste serbe në Kosovë. Delegacionin e përbënin Hasan Prishtina, bajram Curri dhe Bedri Pejani, të cilët paraqitën protestën.
Në të përveç tjerash thuhej:"... *ky regjim hekuri, zjarri e grabitjeje përbën shkakun kryesor të një emigrimi në masë të popullsisë shqiptare drejt Turqisë, emigrim ky që bëhet në kushte të tmerrshme e që kushton jetën qindra familjeve dhe pjesa tjetër, që mbeten, dënohen me një mjerim të pashërueshëm... mjafton me dijtë se për mijëra krime të bëra në mes të ditës asnjë nuk është ndjek nga gjyqet... është vendi i vetëm në botë, ku mund të vriten njerëzit në prani të gjyqtarëve që heshtin*.[2]
Gjatë vitit 1950 të shekullit të kaluar në Kosovë vepruan disa misionarë politikë të kamufluar që për synonin pastrimin etnik të popullit shqiptarë të besimit islam, sidomos në Kosovë, duke përgatitur opinionin e gjerë që të gjithë të shpërnguleshin për në Anadoll (Turqi). Për këtë qëllim, nga fillimi i vitit 1950, me nismën e Patrikanës së Stambollit dhe Patrikanës Serbe, do të merrej një aksion i përqendruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë. Ky aksion udhëhiqej nga krimineli i njohur Aleksandar Rankoviç, për të dërguan në Kosovë një mision, të cilin e përbënin Moma Markoviçi, Mita Milkoviç dhe Dushan Mugosha, për krijimin e një "dege" të kombit shqiptarë, vetëm në baza fetare, "degë" që gjatë regjistrimit do të prononcohej për popullsi turke. Kështu cilësohej si aksion. Plani jugosllav ishte përgatitur nga MPB, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ushtria, për tu bërë shqiptarëve jetën sa më të vështirë dhe pa rrugëdalje. Vështirësitë nisnin që nga kushtet e shkollimit serbisht deri te detyrimi i kazanit të përbashkët në ushtri. Në këtë mënyrë shumica e të rinjve shqiptarë do të gjendje në pozitë shumë delikate shoqërore dhe kulturore-civilizuese.[3]

Që të realizohej plani sekret i spastrimit të Kosovës, fronti jugosllav ndërmori aksionin e ekstradimit të disa intelektualëve shqiptarë, dhe burgosën shumë mësues e myderriz (si Mulla Nuredin Xhinovci, dhëndër i Ramë Bllacës që vdiq në burgun e Nishit më 1953). Rrezikun më të madh për pushtetit e përbënin ulematë shqiptarë që atëherë vazhdimisht bënin thirrje popullit të mos shpërngulej. Për këtë arsye ishte bërë plani që "ulematë" të komprometoheshin në fillim, jo të gjithë por vetëm ata që ishin në shërbim.

Bazuar në dokumentin sekret nr.03/51 rrjetës së agjentëve të UDB-së i qe dhënë udhëzimi që imamët të quheshin "dërzhavni imami" (imam shtetërorë) që populli të krijonte version ndaj tyre ngase gjoja

---

[1]Dr. Shinazi Memedi, Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare,- Kontributi i Ulema-Mexhlisit të Shkupit në shpërnguljen e popullatës muslimane në Turqi (1930-1941), simpozium shkencor organizuar nga BFI e Maqedonisë, 17 nëntor 2012, Shkup.f.80.
[2] Mr. Qemajl Morina, "Kontributi i prijësve mysliman në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë-Kontributi i hoxhë Kadri Prishtinës në mbrojtje të tërësisë së tokave shqiptare,", KMSH, BIK dhe BFIM, Tiranë, 28-29 shtator 2012 f.198.
[3]Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Kryesia e BIK në Prishtinë, revista Dituria Islame, nr.85, viti 12, tetor – nëntor, 1996.Prishtinë, f.24.

“ata po i emëron dërzhava”-shteti, prandaj po punon për të. Në këtë grackë kishin rënë edhe shumë intelektualë të mirëfilltë sepse me ndonjë “dërzhavni imam” identifikonin të gjithë ulematë.

Prej të gjithë ulemave, si ideologu më i rrezikshëm , që me mësimet e tij nuk lejonte që shqiptarët të shpërnguleshin në Anadoll, ishte, ishte cilësuar Hasan Nahi (hoxhë xhehnemi), që për likuidimin e tij ishte angazhuar krimineli Voja Vojvodiç, që punonte në Pejë, por që agjentët e vet i kishte kudo. Po mençuria e Hasan Nahit do të triumfojë.[4]

Për fe e atdhe meriton të sakrifikohet çdo gjë

Përpos kësaj shumë imam u kërcënuan me burg e likuidim me familje nëse nuk do të pranon që vet ata të shpërnguleshin, sikur është rasti i Mulla Tahir Thaçit i cili përveç ndjenjave të pastra fetare, kishte ndjenja të zjarrta atdhetare. Në dokumentet sekrete të Beogradit, të publikuara nga historiani Dr. Hakif Bajrami, rreth shpërnguljes së shqiptarëve, emri i Mulla Tahirit është shënuar dy herë, ku shkruante: ”Dy herë i janë kërcënuar që të shpërngulej për në Turqi. Nëse nuk shpërngulej, do ta burgosnin me familje në Nish...”!

Gjatë viteve 1950-1960, Mulla Tahirin e burgosën dy herë dhe në burg kishte vuajtur shumë, por ai nuk fliste kurrë, më shumë fliste trupi i tij i dërrmuar, i shkretë, se ai vetë!.. Edhe mbas vuajtjes së burgut, Mulla Tahiri jetoi në Gjakovë në skamje, po nuk e lëshoi Kosovën, derisa i mbylli sytë, më 1984, në moshën 86 vjeçare.[5]

Për fe e atdhe ishte thënë në një mevlud në Llap më 1953-meriton të sakrifikohet çdo gjë. Ai që ua kthen shpinën varreve të stërgjyshave, ai ka tradhtuar kombin, ai e fyen Zotin e madhërishëm.

Prijësit fetarë fatin e tyre e kishin të lidhur shumë ngusht me fatin e popullit dhe për këtë gëzonin mbështetej dhe respekt të madh në mesin e popullatës. Mirëpo ulematë këtë respekt nga popullata e kishin fituar me vepra e me këshilla. Janë të njohura fjalët e Mulla Hajriz Bllacës së Dyzit, në xhaminë e Dumnicës, ku ishin mëse 10 mijë veta, publikisht pat deklaruar: “*Ai që lëshon vendin e vet, ai është short që mbetet pa iman. Zoti ka thënë: respektoni Allahun dhe Pejgamberin, mos u përçani mes vete e të dobësoheni e të humbni fuqinë (El enfalë,46). Vllazëni kjo tokë është tokë e mirë, atje ku po na detyrojnë me shkue, ajo tokë nuk është e jona, ajo tokë pasha kit Kur’an, neve nuk na sjell bereqet, neve atje mizat kanë me na u farue e lene ma uria dhe skamja. Këtu në Kosovë, qite farën si t’duesh dhe kur t’duesh, marë del, se kjo tokë e din gjuhën tonë*”

Ulematë edhe në rajonin e Drenicës gjithnjë e më tepër po e dëshmonin vetën si atdhetar të denjë sepse nuk ishin pajtuar të mbanin derse nëpër xhami për “jetën pa brenga në Turqi” si i kishin porositur misionarët e panjohur, që shtireshin si “njerëz që jetojnë dhe flenë me Kur’an në dorë”.

Jemi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit

Shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare e fetare - Mulla Idriz Gjilani (1901-1949) ishte atdhetar konsekuent; orator, mjeshtër i penës, besnik i fjalës, mësues fetar dhe mualim, ideolog dhe luftëtarë i lirisë . Ai pandërprerë propagandonte kundër shpërnguljes së shqiptarëve thoshte ***“pa nji atdhe të lirë feja nuk mbahet, nuk mund t’ushtrohet***”.

---

[4] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet secrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Ibid. f.26.

[5]Mexhid Yvejsi “Mulla Tahir ef. Thaçi”, revista “Dituria Islame”, nr.291, viti 28, BIRK, 2014, Prishtinë. f.53.

Ai ishte krah i djathtë i Ferat Dragës për Anamoravë. Kontributi i tij për pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera shqiptare të cilat i zbatonte qeveria jugosllave ishte i madh dhe me efekt kombëtar. Shkonte prej njërit katund në tjetër, prej një mexhlisi në tjetër, prej një xhamie në tjetër edhe në deka popullit i vinte në spikamë rrezikun e thërriste: ” J*emi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit. Nuk guxojmë të heqim dorë prej tyre, t'i lemë të shkreta për t'i lavruar derrat e naçalnikëve sllavë!. Jo vetëm në Turqi por as në Shqipëri nuk bën të shkojmë. Zoti në Kur'an na ka bërë përgjegjës për vatanin dhe kombin”*[6].

Më 1949 Mulla Idrizin e djegin në zjarr për të mbetur shembull te pasardhësit si luftëtarë dhe për të vdekur si fetar atdhetar dhe patriot.[7]

Roli i Ataullah efendi Kurtishit, në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare ishte shumë i madh, sidomos në viset e Shkupit, Kumanovës e të Preshevës. Ai, gjatë fushatës së tij kundër shpërnguljes, e demaskoi projektin sllav për pastrimin e myslimanëve nga trojet tona etnike, i sqaroi dëmet dhe pasojat e emigrimit, qëllimin e vërtetë të kësaj çmendurie serbe, me qëllim që ti largojë myslimanët e posaçërisht shqiptarët nga këto troje dhe t'i instalojë diku larg në Anadoll, ku do të shërbejnë si tampon zonë në mes turqve në njërën anë dhe armenëve dhe kurdëve në anën tjetër.[8]

Mulla Adem Emërllahu (1850-1921) nga Prapashtica ishte njëri ndër veprimtarët e theksuar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e sidomos në kryengritjen e vitit 1910 i krahut të djathtë të Idriz Seferit me Mulla Sinan Maxheren e Karadakut (Preshevë), i cili do të dënohet me varje nga xhonturqit në Kaçanik më 1910 (Ahmeti, 2011).
Ai veprimtarinë e vet do ta vazhdonte edhe pas pushtimit të Kosovës nga Serbia më 1912. Kurse familja e tij ishte gjithnjë nën trysninë e pushtuesve, por kjo trysni sikur nuk e lëkundi në bindjet e tij. Ai, edhe pse u lut nga të afërmit e tij që ta lëshonte vendin dhe të shkonte diku në brigjet e Anadollit, ku do të tretej përgjithmonë, sikurse bëri djali i tij Halimi, pati vendosmëri të patundur për të mos e lëshuar vendlindjen dhe ky fakt është tregues i qartë që flet për personalitetin e këtij njeriu, sepse sikur të merrte një hap të tillë dhe të shpërngulej prej vendit, sigurisht se me të do të shkonte edhe një pjesë e madhe e popullatës së asaj ane, e që natyrisht një gjë e tillë do t'iu konvenonte pushtuesve të asaj kohe.

Aktivitetin nuk e ndërpreu deri në fund jetës kur më 10 janar 1921, ushtarët dhe xhandarët serbë e vranë në prag të shtëpisë, bashkë me nëntë anëtarë të familjes.[9]

Me detyrimin e këtyre ulemave ishte planifikuar që të tundej tërë popullata shqiptare e rajonit të Ferizajt dhe Kaçanikut për Anadoll, për t'u realizuar marrëveshja famëkeqe Xhentellmene Tito- Kyprili, e vitit 1953, e përpiluar në Split si atentat kundër të gjithë muslimanëve të Jugosllavi dhe sidomos kundër shqiptarëve.[10]

Të gjithë këta ulema që ishin në listën e pushtetit serb për likuidim, ishin njerëz me autoritet të lartë dhe ishte paraparë që gjatë vitit 1954 të detyroheshin me familjen e tyre, të shpërnguleshin në Anadoll, në vilajetin Mysh për të çel rrugë masive të popullit shqiptarë, tek i cili kishin ndikim. Ndaj këtyre

---

[6]Dr. Muhamet Pirraku, Shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare-mulla Idriz Gjilani (1901-1949), Dituria Islame, nr.47, Prishtinë, viti 8, mars 1993, f.29-30.
[7] Dr. Fahrush Rexhepi, Periodiku shqiptar islam, gjysma e parë e shekullit XX, Dituria Islame, Prishtinë 2013, f.114.
[8]Mr. Taxhudin Bislimi, Medreseja e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, f. 80.
[9] Ahmeti, N.(2011), Krerët fetarë në lëvizjen kombëtare shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912), Instituti Albanologjikë, Prishtinë, p.137
[10] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (2), Dituria Islame nr. 87,1997.

ulemave ishte paraparë të bëheshin provokime të ndryshme, duke filluar me diskreditimin moral e deri te kërcënimi dhe rrahjet para anëtarëve të familjeve ose para xhematit në xhami, siç shprehet prof Hakif Bajrami.

Muhamedi a.s. nuk preferon arratisjen prej vendlindjes

Xhelatëve të UDB-së, myderriz Mulla Rashit Prugovci (Prishtinë) iu kishte thënë: *Mua nuk ka para që më blen dhe nuk ka çmim që më shet. Nderi i fesë sime, i të Madhit Zot që më ka falë asht ma i madh se çdo pasuni. Unë Turkinë e kam në respekt, por komjeti jem është shqiptarë. Islamizmi nuk ka atdhe. Ku është Zoti, aty është edhe emni i madhit Muhamed i cili nuk preferon arratisjen prej vendlindjes*.[11]

Ligjëratat dhe vaizet e hoxhallarëve nëpër xhami këshillonin xhematin që të mos e lëshonin trojet e veta. Porositë e tyre e forconin dinjitetin e popullit në çdo lëmi.

Ulemat nuk e donin të flisnin edhe "gjuhën e okupatorit" siç kishte thënë Mulla Shaban Arifi,- nuk e kam në zemër kurrë. Unë e di se çka i kanë ba *këta hoxhë Brezhnicës, por Zoti asht i madh, atij i kofshim falë dhe këtu me dy lug nuk ka.*

Por edhe ata ulema që me dhunë detyroheshin të shpërngulen prej Kosove në Turqi, vazhdonin të mbanin qëndrimin e palëkundur se pjesa tjetër e komjetit me asnjë kusht nuk duhet t'i lëshojë vatrat e stërgjyshërve. Kërkesën e tyre, ulematë e shpërngulur e përsëritën me këdo që e takonin", thuhet në një analizë të Tanjugut të marrë nga Konsullata jugosllave në Stamboll.

Shumica e ulemave ishte maltretuar në çdo mënyrë, por asnjëri nuk kishte thënë për askënd që "duhet të ndiqet " Është fenomen, thuhet në një raport të PKJ-së, se si këta njerëz të shkolluar në një sistem të vjetër në asnjë moment nuk janë labil. Në karakterin e tyre , thuhet aty, më tepër ka ndikuar rrethi kombëtar, dhe që të mbesin të pathyeshëm ka ndikuar shkollimi e mësimi kur'anor dhe bindja absolute e tyre në fatin e njeriut. Është në interes të shtetit, thuhet aty, që sa më parë këtë racë të pathyeshme ta përzëmë jashtë kufijve, sepse në të ardhmen këta do të ndikojnë në rininë e re, e cila kur të armatoset me dituri evropiane, (plus) fanatizmi oriental, do të bëhej nj NYE shumë i ngurtë që do të sjellë probleme.[12]

Kontribut determinues

Kontributi i ulemasë shqiptare ishte determinues si në marrjen pjesë aktive nëpër kryengritje të shumta, duke i udhëhequr ato, por edhe duke u dhënë kurajo luftëtarëve të lirisë me këshilla e vepra dhe me autoritetin të cilin e gëzonin në masë. Ulemaja shqiptare ishte e motivuar nga mësimet kur'anore dhe porosit e Muhamedit a.s. që të japin në vazhdimësi kontributin e tyre për liri e pavarësi. I madhi Zot në Kur'anin famëlartë thotë: "....Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ata të ndryshojnë gjendjen e tyre..."(**Rad, 11**).
Po ashtu, një kontribut të madh kanë dhënë edhe institucionet fetare islame, si xhamitë, meketebet, medresetë, teqetë etj., të cilat ishin çerdhe të përpjekjeve për mbijetesë dhe pavarësi të shqiptarëve, si Kompleksi i medresesë "Mehmed Pasha", xhamia "Sinan Pasha" në Prizren, medreseja "Pirinazir" e Prishtinës, Medreseja e Tiranës, medreseja e Isa begut dhe medreseja Meddah në Shkup, Medreseja e Madhe në Gjakovë etj. e deri tek kontributi që ka dhënë në dekadat e fundit medreseja "Alaudin" në

[11]Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (2), Ibid f.30.
[12] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (3), revista Dituria Islame, nr.88., shkurt 1997. f.28.

Prishtinë, ku gjatë viteve '89-'99 u mbajtën 1230 tubime të karakterit politiko shtet formues, nëpër të cilën kaluan kokat më të ngritura e të ditura, për ta bërë Kosovën shtet.[13]

Ekzodi po paralizon shtetin e ri të Kosovës

Në prag të shënimit të shtatëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, shumicën e të rinjve i gjejmë të zhgënjyer dhe të dëshpëruar me rrjedhat dhe zhvillimet në vend. Ata, por edhe popullata jonë, kanë pritur që pas shpalljes së pavarësisë të krijohen kushte më të mira dhe perspektivë. Skenat nga ikja masive e qytetarëve tanë nga vendi janë më tmerruese që po përjeton vendi ynë prej përfundimit të luftës së vitit 1999.
Foshnje, fëmijë, gra shtatzëna, të rinj e pleq, t'i shohësh çdo ditë që shtyhen për të hipur në autobus për Hungari, secilin nga ne duhet ta vrasë ndërgjegjja, nëse është prej atyre që ia dëshiron të mirën këtij vendi. Faktorët e këtij migrimi janë të shumtë, ndoshta dikush edhe me arsye, por prapëseprapë nuk është në rregull të veprohet kështu.

*Për çudi, ndoshta kjo nguti e qytetarëve tanë është edhe në esencën e krijimit të njeriut, e që Allahu e ka thënë edhe në Kuran: "**Insani (njeriu) u krijua i ngutshëm". (El Isra, 11**).*
Edhe pse shkaqet që i shtyjnë këta njerëz për t'u larguar nga vendi janë të disa llojësh, sikurse është gjendja sociale, pakënaqësia me punën e institucioneve etj., disa prej të cilave edhe nuk duhet të ndodhin në vendin tonë.

Duke iu referuar një të përditshmeje, e cila publikoi shifra vërtet rrënqethëse të braktisjes së shkollave nga ana e nxënësve dhe së këtejmi emigrimi në vendet e BE-së, alarmi për këtë çështje vetëm se është ndezur. Mediet evropiane filluan të na krahasojnë me popujt nomadë, madje edhe të na fyejnë rëndë. Kjo nuk përkon me traditën dhe të kaluarën tonë historike.
Edhe gjigantët mediatik i kushtuan rëndësi të theksuar eksodit që po ndodh në Kosovë. Kështu gazeta britanike "The Telegraph" në artikullin e saj të botuar shkruan se eksodi nga Kosova: Përse u larguan mijëra njerëz, shprehet se Kosova ka humbur rreth 50.000 njerëz gjatë dy muajve të fundit, shumica prej tyre janë larguar me autobusë në drejtim të Gjermanisë. Çfarë është duke ndodhur në këtë cep të vogël të Ballkanit. Kosova, shteti më i ri i Evropës, e fitoi pavarësinë më 2008, pas vendimit të Tony Blairit dhe Bill Clintonit për ta bombarduar Serbinë, duke e detyruar të tërhiqej, më 1999. Kosova poashtu është shteti më i varfër i Ballkanit, me një GDP vjetore për kokë banori prej 2.500 funtesh. Vende pune nuk ekzistojnë në shumë rajone, papunësia mesatare është 45%, derisa arrin në 60% tek ata të moshës deri në 24 vjet.
Por arsyeja pse po ndodh kjo tani mbetet mister- gjendja ekonomike nuk është asgjë e re. Dhe disa dyshojnë se autoritetet serbe, që panë konvojet me autobusë duke u larguar nga Kosova, nuk hezituan t'i mbyllnin sytë para rënies së një shteti, pavarësinë e të cilit refuzojnë ta njohin-dezertimi masiv nga Kosova u shkonte për shtat qëllimeve të tyre politike. Plus, derisa mijëra njerëz hipnin në autobusë për në Beograd, e më pas në kufirin me Hungarinë, biznesi po lulëzonte për ndërmarrësit serb- si të ligjshëm, ashtu edhe të paligjshëm .[14]

Edhe eksodi i fundit i ikjes masive nga Kosova ka alarmuar edhe institucionin e BIK-së. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, në mbledhjen e 12 shkurtit 2015 me kryetarët dhe sekretarët e Këshillave

---

[13] http://bislame.net/fjalimet/310-pvkfmyftiu, **fjala e myftiut të Kosovës, Mr. Naim Tërnava,në hapje të konferencës shkencore "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë", 28-29.09.2012, Tiranë,**

[14] **Exodus from Kosovo: Why thousands have left the Balkans,http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/kosovo/11426805/Exodus-from-Kosovo-Why-thousands-have-left-the-Balkans.html, By Harriet Alexander, Pristina 21 Feb 2015**

të BIK-së, ka kërkuar Këshillave, e përmes këtyre edhe të gjithë imamëve anekënd vendit, që të angazhohen e të kontribuojnë në ndaljen e fenomenit të migrimit të popullatës nga vendi.

Myftiu Tërnava tha se fenomeni i ikjes nga vendi është një përjetim i rëndë. "Pamjet e fëmijëve, të rinjve e grave tona nëpër male e kampe janë të rënda e brengosëse, prandaj duhet që ne si shoqëri e popull të jemi përgjegjës për këtë që po ndodh, dhe duhet të bëjmë më të mirën e mundshme që ky fenomen të ndërpritet dhe popullit t'i rikthejmë besimin dhe t'i hapim perspektivën në vendin tonë", ka thënë Myftiu Tërnava.
Tërnava gjithashtu tha se hoxhallarët, teologët e kanë për obligim-farz të bisedojmë me njerëzit tanë: "Pra të jemi pranë tyre dhe të ndikojmë tek ata aq sa është e munduar, që ata mos të marrin rrugën e migrimit ilegal. E bashkëndiejmë gjendjen dhe atmosferën që është krijuar në vendin tonë dhe në shoqërinë tonë, por duhet të japim maksimumin që tek populli ynë të rikthehet ndjenja e besimi në vendin tonë, në të ardhme tonë, në perspektivën tonë"[15].

.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

EDUCATIONAL SERVICES AND PRIORITIES IN ALBANIAN REFORMS, PERFORMANCE QUALITY AND LONG –TERM OBJECTIVES

Elona REXHO, Alba DUMI *"Ismail Qemali" University, Vlora, Albania*

As representative ofthe national educational service,this paper has the purposeto supply future Albanian citizen proper knowledge, adequate skills and capacities, in order to be educated and committed to the implementation of the economic and development national plan. This system aims to meet the domestic needs of the labour market and socio-cultural aspirations of the people with prerequisite forms in economic growth and sustainable development of the country.
The National Strategy on University Education stipulates short-term and mid-term objectives and goals for the system and introduced policies on strategic priorities for the following years. The concept of evaluation must be considered as a psycho-social and administrative process which has its own impacts on the motivation and performance of the public administration. The right relations are not only the success of the administration but also a guarantee of a qualitative management.

Key words**:** Educational services, individual performance, national strategy, develop the objectives

1. Introduction

At the beginning of the '90 Albanian state undertook deep changes, stimulating education with the objectives of economic improvement and social injustice. The new role of the state determined new obligations for the public, central and local administration. During this period the administration was nearly totally politicized and there were no clear divisions between the political and techno-professional function. During this period the model of the political control was inappropriate and out of logic and it was still in the development phase.

The laws were approved during this period.During 1996-1999 the politicization of the administration ended and the administration was based on merits; the division between the political and techno-professional was clear. The administration had the possibility to implement development system, in the human resources management, in the central and local institutions, especially ineducation. This reform goes beyond the institutional improvements up to radical changes in the vision, attitudes and conduct of all committed stakeholders.

Decentralization of the educational sector shall ensure the extension of participation and increase of the effectiveness of groups of interest in the outline of educational projects and their implementation. This process shall be carried out through a proper balance between the centralization and decentralization, being accompanied by the public awareness of potential risks and chances of success. Lectors, professors or lectors, members in auditorium, as human resources "discovered" in the 1930s with the human relations school.

The strategy is in line with the main trends of education in Europe and in the world, aiming to adopt the development of university education. The governmental vision for mid-term and long-term policies of the sector is in the focus of development of the human recourses. It incorporates the suggestions of the academic community and of the groups of interest within the country. The strategy represents the pillar of an Action Plan with tasks scheduled to be implemented until 2013.

Process1:Teaching methodology, this process of implementing this strategy, the leadership role is based on rules and extreme strict responsibilities toward the students, in order to handle the unexpected difficulties and obstacles the work of all the students to achieve their goals and purposes. (De Bruijn & Henglenn 2002: 12).

Process 2: The second definition of human recourses management (HRM) encompasses the management of people in organizations from a macro perspective i.e. managing people in the form of a collective relationship between management and employees. The successful completion of basic education is significantly influenced by the poverty level of families.The enrolment rates in basic education for the non-poor are 101.1 per cent (gross) and 94.1 per cent (net), for the poor are 97.15 per cent (gross) and 91.6 per cent (net), and for the extremely poor are 90.9 per cent (gross) and 88.6 per cent (net). (Guxholli Z, 2011:8)

The gross enrolment rate of children living in households unable to meet their basic food requirements is 5 per cent lower than that of children living in non-poor households. The extended period of poverty seems to have fostered a general lack of confidence and interest in education despite the traditionally high regard for education by Albanians in the early nineties as indicated by the high literacy rates at all levels of society at that time.

2. Literature review

This approach focuses on the objectives and outcomes of the HRM function. What this means is that the HR function in contemporary organizations is concerned with the notions of people enabling, people development and a focus on making the “employment relationship” full-filling for both the management and employees(Selznick 1957: 2). The definitions emphasize the difference between personnel managementand human resource management(Robbins1998: 6).To put it in one sentence, personnel management is essentially “work-force” centered, whereas human resource management is “resource” centered. The key difference is about fulfilling management objectives of providing and deploying people and a greater emphasis on planning, monitoring and control(De Bruijn 2002: 13)The hypothesis coming next: Learning process is difficult,but if someone(students themselves) is not given what is meant hard to resolve, human being never knows how far reaches.Often in everyday life student-teacher relationship is mutual and the leadership responsibility is high. Regardless to the specifics roles of HRM that takes the position of teacher relations, fundamental is to be perceived as work relationship, which are characterized by tolerant communications that runs through good will of understanding and bon-sense. *Tolerantia=Patience* (a Latin word).

Cultural differences between nations can be, to some extent, described using first four and now five, bipolar dimensions. The position of a country on these dimensions allows us to make some predictions on the way the society operates, including the management processes and the kind of theories applicable to the management.As the word “culture”plays such an important role in this paper research.Culture is a construct which is “not directly accessible to observation but inferable from verbal statements and other behaviors and useful in predicting still other observable and measurable verbal and nonverbal behavior” (Dhima A 2003:12).

The person who would lead must be able to transmit his ideas, convictions, purpose, methods, and approaches to the force that will carry them into action. Further, he must communicate quickly and accurately, so there will be no confusion or delay in the implementation of his planned actions. (Zaccaro, S.J, Foti, R.J & Kenny 1991: 23)Even more important, a leader must have ability to communicate to his staff the need for their personal dedication to whole organization. Only by communicating enthusiasm can a leader motivate his people to the level of achievement result in a successful operation. (Andrew B.M & Ross, J1980: 123)



Graph 1: The Maslow Hierarchy of needs and human roles, (Dumi, Alba, 2012, AIJS Journal)

The levels resonated and reminded me of another theory, Maslow's Hierarchy of Needs, which is used help explain personal motivations and needs in reaching ones full potential. This graphic 1: show the levels of some indicators (Management roles, leader intelligence, human roles, human intelligence), for each level of Maslow's hierarchy. The most basic "need" or skill is to be an effective and strong writer.Young professionals cannot expect to climb the professional ladder without mastering the technical skills.

Cultural differences between nations can be, to some extent, described using first four and now five, bipolar dimensions. The position of a country on these dimensions allows us to make some predictions on the way the society operates, including the management processes and the kind of theories applicable to the management.As the word "culture"plays such an important role in this paper research.Culture is a construct which is "not directly accessible to observation but inferable from verbal statements and other behaviors and useful in predicting still other observable and measurable verbal and nonverbal behavior" (Dhima A 2003:12). The graph 1: show the relation of Maslow Hierarch with human intelligence.

3. Methods andMaterials

The education sector reform has started its efforts to improve efficiency, such as overall sector finance reform with the introduction of per capita funding, which will result in freeing up funds for other priority needs. Additional consideration of whether the solutions proposed in the Strategy and Action Plan are the most cost effective means to reach goals is also critical to ensure sustainability of investments, while

ensuring equity and equality in access to quality education is simultaneously addressed in the reform process.

The analyzing data has to do with the performance evaluation is mainly characterized by qualitative indicators and there are only a few quantitative indicators. According to the data collected from the questionnaires on the employee asses with the importance of the performance evaluation in 100%, they concretize it with the objectivity in the evaluation. To the question "Is the performance evaluation objective in your institution?"- 30% answered positively, 44% avoided the answer and 26% of them think that it is dictated from the subjectivity of the leaders. According to the questionnaire the major part of the questioned employees think that the performance evaluation takes to conflicts between the subordinate and the superiors. This is also another factor that contests rewarding according to the performance.



Figure 1: In this figure we see the relations between labeled individualism, collectivism and relation in groups.[16]The indicators of individualism and members group actions. Bradler& Sediss

3.1 Assessment of results monitoring frameworkfrom Albanian educational sector

The second priority that emerges is to build the managerial capacity of key personnel in the Ministry of Education and Science, affiliated educational institutes and educational administration at decentralized levels. A variety of measures has been recommended in the plan for restructuring and increasing effectiveness of the Albanian educational ministry, including installation of various kinds of systems for efficient use of human and financial resources. As the country is undertaking the decentralization process, the education system is preparing itself to implement this strategy. The implementation platform is designed to achieve sharing of functional responsibilities and identifying the right and proper conditions to increase responsibilities on the function at decentralized levels.

During 2006, the Ministry of Education and Science approved the Preschool Strategy to be an integral part of the Pre-University Strategy requiring cross sect-oral consideration. This step among others is expected to increase the budget allocations for the 3 to 6 year old age group and influence the donor agenda for more funds for preschool. Using the estimation done by MOE for cost of the preschool child/year which is assumed to be 18,000lek/child it results that to implement the Strategy, a cost of

[2,3]Bradler& Sediss,Individualism and organizational behavior.The university text book: Kingston, Ontario, 1989.[16]The indicators of individualism and members group actions.

[4]The performance evaluation is mainly characterized by qualitative indicators and there are only a few quantitative indicators, Higgins, J. Theory for regression data analyze.

US$35 million is required in the next five years to provide preschool services to children 5 – 6 years of age. (Guxholli Z, 2011:13)The funding gap for each year to provide these is approximately US$7 million. This does not include the capital investment costs of building kindergartens as these will be provided by the local government. MOE will put in place a better system to plan the cost of preschool services.(Guxholli Z, 2011:7)

This is also another fact that contests rewarding according to the performance. (Higgins, J.1983:12:23). Autonomy might be described as freedom for higher education institutions (HEI) to run their own affairs, in particular in relation to staff, students, curricula (teaching and examining), governance, finance and administration. The following issues are relevant in the allocation of funding to higher education institutions: 1.Negotiation on the basis of an estimate from the institution, 2.Fixed on the basis of past costs, Performance indicators play a role in funding allocations. Research is funded separately.The scenarios designed were built to achieve primary education completion, based on high case, middle case and base case scenario. The three models take into consideration:

- Albania's specific demographic, economic and educational contexts;
- The economic forecast made by the Government of Albania and other international organization;
- Sensitivity analysis to assess the impact of changes in key parameters on financing requirements and other key output variables.

4. Conclusions

The governance in education, particularly in terms of the decentralization represents aviewto be developed in accordance with the current standards. In a general perspective, the application of a centralized management level in the national governanceand in the area of services in particular, leads to the reduction of effectiveness and efficiency of the public administration. Decentralization of the system of management and servicesis a key component of the broader decentralization process undertaken in Albania.While formal restructuring toward the decentralization has marked significant progress in several sectors, including the sector of education, the progress of the decentralization of responsibilities and of the decision making authority from central to local level for the pre-university education has not been satisfactory.

First, there is a lack of the full operational link of the school with the community as a democratic obligation to provide good education to everyone. There is a lack of encouragement of the power of the family for the social character of the community, to fully invest efforts in the area of education. This is based on the inadequate level of participation and the responsibility of all stakeholders.

The consequences are present in respect of the malfunctioning failing to meet the needs and requirements of the community of educational leadership, school management, contenting of curricula, financial planning and management, school maintenance, personnel management to offer a modern educational service and discharge the integrating function of schools.

Reform and strengthening of policy making, management and decision making capacity is one of the priorities in the framework of the European Partnership according to which: "The government is committed to realize the school autonomy through the educational reform in cooperation with the groups of interest"

At central level: Restructuring of the Ministry of Education and Science and subordinate institutions by building a clear management performance- based scheme. *At regional level*:

Restructuring of the Regional Educational Directorates and Educational Offices in view of further developing capacities in support of schools.

In the framework of decentralization: Decentralization and delegation of responsibilities and of decision making authority from central to local governance level.

At school level: Reaching school autonomy in the area of subject programs, in financial level, personnel and management at school level, in such case completing it with the legal basis. The respective implementing body Development of policies based on data oriented and on school decisionscan launch the research based on such results, functioning of the information management system in the area of education.

References:

Bodie, Zvi (Nobelist), 2002, "*Educational reforming strategy*" Finance Journal, USA, vol 3 nr 11.

Bishop, E. B. 1969, *Planning and Control", Long Range Planning*, 80-87, Oxford University.

Bradler & Sediss, 1989,*The report Company and HMR training*: Kingston, Ontario.

Dhima, Adrian, 2003, *The reform of public sector in Alban*ia, The Institute for Legal and Public Publications, Albania MOE.

Dumi, Alba, 2012,*The role of university in reform of public sector*, AIJS Journal, vol 2 Nr 3, pp 135, Spienzza, Roma, Italy.

Glueck, W.F. and Jauch, L. R. 1984, *Business Policy and Strategic Management*, 4th, McGraw-Hill, New York

Goffin Robert, 2001,*The assessment of the affects of certain public and private projects on the environment*", p 123-129 New York

Guxholli Z, 2011, *Albanian reforms and EU*, Albanian institute of sociology, Tirana, Albania

Higgins, J. M. 1983" *Organizational and Strategy" Management strategy" 2nd*Dryden New York, pp 145

Hofer, C, W Schendel, 1983, *Strategy Formulation: Analytical Concepts*,Oxford University, USA

Govern of Albania Project 2009" *Economy and identity*" pg 14, Tirana University,Albania

Nilufar, Egamberdi, "*Educational reforming strategy*,Center for Economic and Socialp 40-48 MJSS Roma Italy

Paul Samuelson, 2009 Nobelist Oxford: *Clarendon Plan and Economy* Oxford University Text book.New York

Progress Report 2013" *Economy reforming and development*", Republic of Albanian, Publish in www.econ.al

Progress Report 2011,National education strategy, EFA, Tirana University, Albania

Report" *Reform and strengthening of policy making*" 2012, publish in www.alb.gov.alAlbania

E- ISSN 2337-0521 *ISSN 1800-9794*

PËRMRAT E GJUHËS SHQIPE KUNDRUALL PËREMRAVE TË GJUHËS ANGLEZE

MA. Yllka R.Imeri - Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë

Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi është që të trajtojmë përdorimin e përemrit në gjuhën shqipe, dhe në gjuhën angleze. Gjithashtu do të shtjellojmë edhe për llojet dhe klasifikimet të përemrit.

Metoda *e* përdorur në këtë *punim* është metoda e analizës teorike. Analizimi teorik i bazuar në vepra dhe punime të ndryshme shkencore, profesionale, nga fusha e gjuhësisë, me theks të veçantë gjuha e shkruar, do të na mundësoj dhënien e përfundimeve të caktuara për problemet kyçe të hulumtimit.

Ne do japim një krahasim të përemrit midis gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze, do e vërejm se gjuha shqipe me gjuhën angleze kanë shumë dallime por kanë edhe disa ngjashmëri.

Fjalet kyçe: përemri, krahasim, gjuha shqipe & gjuha angleze

Krahasimi i përemrit midis gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze

Në gjuhën shqipe rendi i përemrave pyetës mund të lëviz leht pa e shkatërruar kuptimin e fjalisë, kurse në gjuhën angleze ky ndryshim nuk është i mundur; përemrat pyetës duhet gjithëmonë të vëndosën para foljes, kemi shembull: *What is this?* apo *What is that?*

Përemrat vetorë (Personal pronouns)

Përemrat vetorë në vetën e parë, dytë dhe të tretë, njëjes dhe shumës në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe kanë rolin e kryefjales (në fjali) dhe gjithmonë vendosen përpara trajtes foljore kurse në fjalitë pyetëse janë të vëndosura mbrapa trajtes foljore.[17]

Albanian	English
Unë po flas.	I am a student.
Ai po shkruan.	She's a daughter.
Çfarë po bën ti?	*Are you his son?*

[17]A student's grammar of the English language, Sidney Greenbaum & Randolph Quirk, Essex England 1990

E veçanta në këtë krahasim është se tek fjalitë pyetëse në gjuhën angleze përemri para vetes ka foljen "are you" kurse gjuha shqipe tek fjalitë pyetëse folja para ka përemrin pyetës "çfarë".

**Fjalitë pyetëse dhe veçoritë e interpretimit të tyre*

Përdorimi i gjuhës sipas sintaksës nënkupton një varg skemash, brenda të cilave ligjëruesi krijon fjali. Pra, gjuha përbën një rrjet fjalish të formuara drejt. Po e tregojmë me një shembull të shqipes. Gramatika jonë normative kërkon dallimin e prerë të Kush? si përemër për njerëzit nga Cili? për të gjitha rastet. Mirëpo mjaft shpesh ne e përdorim Kush? për të pyetur për sende. Arsyet e këtyre parregullsive janë të ndryshme, midis tyre ka dhe shkaqe jashtëgjuhësore. Nocioni qëndror i këtij diskutimi është kuptimi, i cili shumë shpesh shihej te rregullat e logjikës (filozofi) ose të sintaksës (gjuhësia gjenerative)[18] . Kjo u kundërshtua nga shumë studiues, të cilët kishin arritur në përfundimin se kuptimi i fjalisë del në përdorimin e saj. Dell Hymes[19] shpjegon se ' ka rregulla për përdorimin e gjuhës pa të cilat rregullat gramtikore s'do të kishin vlerë'. Të dish një gjuhë nuk do të thotë thjesht të dish gramatikën e një gjuhe pasi gjuha në vetvete i shërben një larmie funksionesh.[20] P.sh., të dish se Do you drink? (A pi?) është një pyetje në kohën e tashme është diçka, por të dish se po kjo pyetje mund të përdoret dhe si ofertë është diçka tjetër.

Father: Do you drink?

Young man: No, thanks, I'm cool.

Father: I'm not offering, I'm asking IF you drink. Do you think I'd offer alcohol to teenage drivers taking my daughter out?

Babai: Pi?

Djaloshi: Jo, faleminderit, nuk dua asgjë për të pirë.

Babai: Nuk po të ofroj, po të pyes nëse pi. Mendon ti se do t'i ofroja alkol adoleshentëve që ngasin makinën, e për më tepër atyre me të cilët shoqërohet vajza ime?

Fjalitë pyetëse kanë funksione të ndryshme. Edhe një fjali pyetëse e thjeshtë në kontekstin e dhënë, mund të jetë një akt i zhdrejtë, domethënë një akuzë, një fyerje, një urdhër, një kërkesë, një hetim si këshillë, një kërcënim i tërthortë, një përgjigje mohuese me ngjyrime stilistikore, etj[21]

Nga ky krahasimi, e kuptojmë se përemrat luajnë një rol të rëndësishëm ata do ti ngatërrojmë kur ne nuk dim kuptimin e fjalisë e sidomos kur përemrat e vetës së dytë njëjës dhe shumës në

[18] Lloshi, Xh., vep. cit, fq. 285.

[19] Hymes, D. "On communicative competence", in J.Pride and J.Holmes (eds) Sociolinguistics, Harmondsworth: Penguin, 1972, fq. 230.

[20] Lloshi, Xh., vep. cit, fq. 128.

[21] Lloshi, Xh., vep. cit, fq. 330.

gjuhën angleze janë të njejtë përemri *you* përdoret për të dy vetat i njejti,[22] kurse gjuha shqipe ka dy përemra për vetën e dytë njëjës dhe shumës *ti* dhe *ju.*

Përemrat pronorë (possessive pronouns),

Një përemer pronorë tregon që përemri vepron si një shej posedimi/pronësimi, përcakton se kush zotëron një objekt apo një person te caktuar.

Si në gjuhën shqipe po ashtu edhe në gjuhën angleze përemrat pronorë përdoren:

Ku në gjuhën shqipe pronsia vije e para, kurse në gjuhën angleze pronari vije para pronësisë.

Albanian	English
nipi im	*my umbrella*

- Përdoren vetem

Albanian	English
Miku im dhe i juaji.	*This is not mine*

Në gjuhën angleze në pyetje apo në fjali deklarative përemri pronor është vendosur përpara emrit; What's your new*Peremrat e pacaktuar (Indefinite pronouns)*

- Një përemer i pacaktuar është një përemër i cili ju referohet apo drejtohet një diçkaje të pacaktuar por jo një njeriu apo një gjëjeje specifike.
- Disa shembuj *dikush, askush, kushdo/ some, all, whole,* pra nuk po flasim për një gjë apo njeri specifike por për diçka të papërcaktuar.
- Gjuha angleze por edhe gjuha shqipe kanë përemra të pacaktuar që mohojnë formën negative (negative form).

Albanian	English
asnjë, asnjeri, asgjë	*any*

[22]Eastwood, J. (2006), Oxford Practice Grammar, Oxford University Press. (p.98)

Si përfundim, kemi marrë edhe disa shembuj të përemrave pyetës (interrogative pronouns). Përemrat pyetës janë përdorur për të bërë pyetje.

- Kemi një analogji ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze për përemrat pyetës; which / cili dhe what. E para është përdorur për të ndarë një qenie njerëzore apo një gjë nga grupi që i perket.

- Përemri *cili* zakonisht kërkon shpjegim apo saktësi të njeriut apo sendit.

Albanian	English
Cili nga ju e njeh djalin tim?	*What books have you read?*

Megjithatë, përemri përdoret edhe për të maskuar emërtimet e frymoreve apo sendeve, siç e ka theksuar edhe John Fowles në thënjen e tij, "Përemri është një nga maskat më të tmerrshme që njeriu e ka shpikur."[23]

Literatura

1. Akademia e shkencave, Gramatika e gjuhes shqipe 1, Tirane 1995.
2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë (2002), Fjalor i Gjuhës Shqipe. Tiranë: Toena
3. Agalliu, F. (2002), Gramatika e Gjuhes Shqipe 1. Morfologjia. Tiranë: Akademia e Shkencave
4. Çeliku, M. (2002), Gramatika e Gjuhës Shqipe II. Sintaksa. Tiranë: Akademia e Shkencave.
5. Erih Maria Remark "Një natë në Lisbonë",Shtëpia botuese "KONICA", Tiranë 2003.
6. A student's grammar of the English language, Sidney Greenbaum & Randolph Quirk, Essex England 1990.
7. Qesku. P (2002), Fjalor i gjuhës angleze, Tiranë: Toena.
8. Lakoff, R. . (1975), Language and Woman's Place. New York: Harper&Row.
9. Eastwood, J. (2006), Oxford Practice Grammar, Oxford University Press.
10. Schrampher, A. (1999), Understanding and using English Grammar, Longman (III edition).

[23] "The pronoun is one of the most terrifying masks man has invented". (John Fowles) https://www.goodreads.com/quotes/437670-i-say-her-but-the-pronoun-is-one-of-the

E- ISSN 2337-0521 *ISSN 1800-9794*

Dacia Maraini

Dr. Alva Dani Departamenti i Romanistikës Universiteti "Luigj Gurakuqi"Shkoder,

Në rrjedhat shekullore të historisë tonë e duke ardhur deri në ditët tona nuk kanë munguar asnjëherë shkrimet dhe emra të huaj që për arsye të ndryshme u gjenden në Shqipëri, përshkuan viset e saj, e njohën nga afër dhe kuptuan që është një komb evropian që mban në kurriz historinë sfilitëse të një populli në përpjekje të vazhdueshme për t'u ngritur në këmbë e për të rilindur.

Një emër shumë i njohur mes shkrimtareve të letërsisë bashkëkohore italiane, kandidate disa here për çmimin Nobel dhe dashamirëse e shqiptarëve është edhe Dacia Maraini. Me një prodhimtari të pasur letrare, romane, poezi, ese, vepra teatrale renditet mes shkrimtareve më të rëndësishme që trajtuan gjërësisht probleme sociale ende të pazgjidhura, duke vënë në qendër figurën e gruan dhe kushtet e ekzistencës së saj. Është shkrimtarja që kaloi njëzet vite ne krah të shkrimtarit të madh Alberto Moravia, në bashkëpunime teatrale e miqësi të ngushtë me Pier Paolo Pasolini-n, Leonardo Sciascia-n, Italo Calvino-n, Giorgio Bassani-n, duke u frymëzuar nga ironia e Svevo-s, nga lirizmi i Vergës, nga kritika e fortë e De Robertis, duke ndenjur netëve të gjatë duke lexuar pa u ndalur Dostojevskin e Balzakun.

Por edhe Shqipëria, fqinja e brigjeve përballë, nuk kishte si të ishte e panjohur për Marainin. Para se të vinte në Shqipëri, ajo pohon se ka lexuar shumë gjëra për të, se e njihte mirë Kadarenë, shkrimtarin e njohur në të gjithë botën, që jeton mes Parisit dhe Tiranës, se ka lexuar romanet e tij të përkthyera në italisht. Vizita e saj e parë në vendin tonë realizohet në vitin 2002, pas botimit të disa veprave të saj në gjuhën shqipe si *Jeta e gjatë e Mariana Ukrias*, *Pushimet*, *Bageria*. Lë pas një sërë intervistash, mendimesh e reflektimesh me vlerë për letërsinë tonë dhe artin shqiptar në përgjithësi.

Lexon në gjuhën italiane shumë vepra nga shkrimtarë bashkëkohorë shqiptar, si Fatos Kongolin, Aurel Plasarin, Elvira Dones, të sjella nga shtëpia botuese Besa në Leçe. Mes poeteve shqiptare, veçon Mimoza Ahmetin, Flutura Açkën e Luljeta Lleshanakun. Megjithë këtë Maraini shpreh keqardhje për një shpërndarje shumë të kufizuar të këtyre shkrimtarëve dhe për një kritikë letrare pothuajse zero nga kritika italiane[24].Në një intervistë për *Corriere della sera*, ajo ngre zërin për të vënë në vend prestigjin e shqiptarëve që nuk konsiderohen aq sa duhen nga opinioni dhe mediat italiane.

Në Shqipëri, thotë Maraini, nuk ka vetëm skafistë, por poetë, regjizorë e shkrimtarë. Rilindja e një populli që ka si model Italinë. E që italianët injorojnë…

[24]Dacia Maraini, *Corriere della sera*, 30/10/2002.

Me një dashamirësi të madhe për vendin tonë ajo vazhdon po aty: „Pak njerëz e dinë që në Tiranë jetojnë e punojnë kineastë të shkëlqyer të cilët përveç xhirimit të filmave të mirë, po hapin shkolla kinemaje për autorë e aktorë të rinj. Filmi Coloneli Bunker i Kujtim Çashkut u prit shumë mirë në një nga Festivalet e fundit të filmit në Venezia. Edhe filmi Slogans i regjizorit Gjergj Xhuvani pati sukses në sallat kinematografike të Parisit pasi fitoi çmimin e kritikës në Cannes 2001. Deri tash duket sikur janë vlerësuar vetëm nga francezët. Ne italianët i injorojmë me budallallëk.

Pak njerëz e dinë që midis Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës jetojnë e punojnë shrimtarë të shkëlqyer. Edhe librat e tyre janë publikuar kryesisht në Francë ndërsa në Itali janë nënvlerësuar apo janë shndërruar në të padukshëm, nga një heshtje e shtypit italian që i plagos rëndë".

Të bie në sy tek kjo shkrimtare forca dhe bindja e plotë për t'i dhënë vlerë dhe shpresë çdo sakrifice a mundi të shqiptarëve, për të thënë edhe atë të vërtetën e bukur që buron nga vitaliteti intelektual dhe dëshira e madhe për t'u njohur denjësisht si komb evropian. Maraini karakterizohet në letërsinë e saj nga një ndjenjë dhembushurie dhe mbrojtjeje ndaj shtresave më pak të mbrojtura siç janë gratë dhe fëmijët, rebele në të njejtën kohë për kërkuar me forcën e argumentit vëmendje dhe respekt ndaj tyre. Jeta e saj e detyroiqë të njohë dhe ta provojë në lëkurë dhunën e hipokrizinë, urinë dhe të ftohtin, përdhosjen e dinjitetit e diktaturën në kampet e përqëndrimit në Tokoi, në Japoni. Ajo u bë zëri i më të dobtëve, i grave dhe fëmijëve, përmes krijimeve të saj letrare në përmbledhjen Buio "Errësirë" (1999), duke sjellë të vërteta të errëta, ku tmerri shndërrohet në realitetit dhe frika merr formë dhe fytyrë.

Janë dymbëdhjetë tregime, me dymbëdhjetë protagonistë, fëmijë, gra dhe adoleshentë të keqtrajtuar që shohin rreth tyre gjithë indiferencën e botës. Njëra prej tyre është Vjollca, një vajzë e vogël dymbëdhjetë vjeçare, nga Shqipëria që hipën në një varkë, drejt Italisë për të fituar para. Por me të mbërritur në Itali atë e dërgojnë në një apartament, ku gjen një vajzë tjetër shqiptare, dhe dy trafikantë, të cilët i shfrytëzojnë pa u dhënë asnjë lekë në këmbim. Tmerri i shfrytëzimit të vajzave shqiptare nga burra të moshave të ndryshme përshkon gjithë atmosferën e ankthit që dominontregimin e Marainit.

"Con le gonne al sedere, le gambe velate da calze a rete, il reggicalze rosso che sbuca da sotto le mutande, i tacchi alti, il top scintillante e la giacchina di velluto su cui spiccano i riccioloni biondi, le due ragazzine appaiono sulla porta, sbalordite, come due personaggi di fumetti porno."[25] *(* Dy vajzat, me fundin poshtë vitheve, këmbët e veshura me geta rrjete, mbajtësen e getave të kuqe që i del nga poshtë të mbathurave, takat e larta, me kanatiere që shkëlqen dhe xhaketë të kadifenjtë ku bien në sy kaçurrelat e arta, shfaqen në derë, të tronditura, si dy personazhe filmash porno.)

Kjo ishte edhe një nga skenat më të dhimbshme që la gjurmë të thella në shoqërinë shqiptare të pas viteve ´90, duke u shndërruar në kronikë të vazhdueshme në mediat evropiane e sidomos ato italiane të kohës. Do të duhej shumë kohë, më pas, që ky makth njerëzor të kthehej në një të shkuar të pakthyeshme. Dacia Maraini, ishtë njëra ndër shkrimtaret femra, që besoi fort se shqiptarët duhet të ringriheshin, se kishin shumë gjëra të mira, për të cilat duhej të luftonin.

Në këndvështrimin e Marainit, Shqipëria ishte edhe një vend me "një vitalitet të lartë intelektual", ku ka shumë ngjyra, ka shumë shpresë, ka artistë shumë të mirë që i bëjnë nder këtij vendi. Shkruan "*I colori di Tirana*" (Ngjyrat e Tiranës) në "*La seduzione dell'altrove*", ku përshkruan udhëtimet e shumta të saj nëpër vendet dhe kulturat që ka njohur, duke sjellë refleksione të ndryshme për atë që quhet ndryshe "tjetri". Dhe pa diskutim Shqipëria ka vendin e saj në udhëtimet e Marainit. Si një grua me mendje të hapur dhe me një gjykim të mprehtë përshkruan me nota shumë kritike sjelljen e Italisë ndaj shqiptarëve, të cilët kishin pak vite që kishin dalë nga diktatura:

"Shqiptarët e duan Italinë në mënyrë prekëse por edhe e kritikojnë për distancën që ajo mban dhe për mendjemadhësinë e saj. Dhe ne italianët, me mekanizmin tipik të dashurisë që nuk këmbehet i lëpihemi Francës e Anglisë pa vënë re se kemi një fqinj që na do, që beson tek ne, që flet pa vështirësi

[25]Maraini, D., *Buio*, Rizzoli Editore, Milano, 1999, f.30

gjuhën tonë, që dëshiron të shkojë deri në fund të aftësive të tij të mëdha me bashkëpunimin tonë… - e pastaj vazhdon me nota besimi dhe optimizëm se, - …në ajër ndihet një vullnet i madh për të dalë nga këto kontradikta që dobësojnë shpirtin, dëshira për t'u çliruar nga katastrofat e komunizmit, nga tmerret e një diktature që zgjati shumë vite"[26]. Por jo vetëm kaq, Maraini e shohim në një shkrim tjetër letrar, në parathënien e librit të Fatos Lubonjës, i botuar në Bolonjë, në gjuhën italiane "Intervista sull'Albania. Dalle carceri di Enver Hoxha al liberismo selvaggio". Përmes një stili të thjeshtë përshkruan figurën e shkrimtarit shqiptar si edhe rindërton në shumë aspekte jetën e popullit shqiptar në vitet e gjata të diktaturës, se sa ndikuan në jetën e tyre këngët italiane dhe sidomos kinemaja e neoklasiçizmit italian, duke rrugëtuar deri në vitet '90, ku mbizotëronte tshmë varfëria që komunizmi kishte mbjedhë ngado, edhe në mendje, edhe në shpirt. Megjithëkëtë Dacia arrin në përfundimin se Shqipëria ka mendimtarë e artistë të zotëe madje edhe politikanë të vërtetë që luftojnë çdo ditë me egoizmin e me spekulimin. Në një nga intervistat e viteve 2002, Maraini lëshon një mesazh të fortë për gjithë shqiptarët, i cili edhe sot është mjaft aktual:

„Shqiptarë mos rrini duarkryq, por përvishjunipunës. Duhet shumë punë, shumë lodhje. Ky vend është i pasur me ndjenja, me ide...Është një vend që ka shumë krenari, dinjitet edhe pse është i varfër. Sipas meje është vend që mund të arrijënënivelet e vendeve të tjera evropiane, madje në një kohë shumë të shkurtër. Por për këtë duhet punuar me shumë qetësi dhe duhet patur besim në të ardhmen"[27]

Dacia Maraini meriton të vlerësohet për qëndrimin dashamiës, për imazhin e mirë që përçoi në mediat italiane, kur shumë prej tyre qëndronin indiferentë dhe mospërfillës, për evidentimin e aspekteve pozitive të shoqërisë shqiptare dhe për besimin e plotë që Shqipëria, vendi i brigjeve përballë, do të ringrihet.

Bibliografia

1. Prefazione di Dacia Maraini në, Fatos Lubonja, *Intervista sull'Albania. Dalle carceri di Enver Hoxha al liberismo selvaggio*, Il Ponte, Bologna, 2004
2. Dacia Maraini, "*I colori di Tirana*" në "*La seduzione dell'altrove*" BUR, 2010, Milano
3. Dacia Maraini, *Buio*, Rizzoli editore, 1999, Milano
4. Dacia Maraini, *Corriere della sera*, 30/10/2002.
5. Gazeta Shqiptare, 15 tetor 2002, *Shqipëria një vend me vitalitet intelektual*, Migena Hoxhalli.

[26]Maraini, D. Corriere della sera, 30/10/2002.

[27]Intervistë me Dacia Marainin, Gazeta Shqiptare, 15 tetor 2002, *Shqipëria një vend me vitalitet intelektual*, Migena Hoxhalli, f.20

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

VETËEFIKASITETI DHE SUKSESI AKADEMIK TEK ADOLESHENTËT

Artë Dulaj

Abstrakt

Suksesi akademik është çështje e rëndësishme dhe themelore mbi të cilën maten të gjitha veprimtaritë e nxënies duke u bazur në kritere të pritshmërisë së mirë akademike, të dobët ose dështimit akademik në përgjithësi. Vetëefikasiteti është një bindje në mesin e shumë faktorëve, që luan rol mjaft të rëndësishëm gjatë zhvillimit të fazave të ndryshme të fëmijëve dhe veçanërisht gjatë perdiudhës së adoleshencës. Qëllimi i këtij studimi është të paraqiten marrëdhënien midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe suksesit akademik të adoleshentëve në Kosovë. Të dhënat janë mbledhur nga 65 nxënës të klasave të 8 dhe të 9 të shkollave të mesme të ulëta. Për të matur vetëefikasitetin është përdorur pyetësori Self-Efficacy Questionnaire for Children (SEQ-C) *Brief Survey on Academic, Social and Emotional Self-Efficacy*, i cili kishte 24 pyetje. Dizajni i studimit është korrelacional. Dhe kishte tre variabla të cilat masin nënshkallët e vetëefikasitetit (akademik, social dhe emocional) dhe një variablën për suksesin akademik. Rezultatet kanë treguar korrelacion pozitiv dhe sinjifikant midis vetëefikasitetit akademik dhe suksesi akademik(r_s=.40, p=.001), midis vetëefikasitetit social dhe suksesi akademik poashtu ekziston korrelacion pozitiv (r_s=.33, p=.006) dhe midis vetëefikasitetit emocional dhe suksesi akademik ekziston korrelacion pozitiv (r_s =.30, p=.017). Këto të dhëna janë diskutuar në kuptimin e marrëdhënieve midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe suksesit akademik. Nga të gjeturat e këtij studimi është rekomanduar të bëhen studime me mostër më të sigurt për të vërtetuar marrëdhëniet midis variablave.

Fjalët kyçe: vetefikasitet, vetefikasitet akademik, vetefikasitet social, vetefikasitet emocional, sukses akademik.

Vetëefikasiteti dhe Suksesi Akademik tek Adoleshentët

Shpesh ndodh që individ të ndryshëm të dyshojnë në aftësitë e tyre për të filluar dhe përfunduar me sukses qëllime të ndryshme në jetë. Bindja e tillë e individit mund të ketë pasoja negative jo vetëm gjatë fazave të zhvillimit gjatë kohës së fëmijërisë por edhe më vonë. Vetëefikasiteti është një bindje në mesin e shumë faktorëve, që luan rol mjaft të rëndësishëmgjatë zhvillimittë fazave të ndryshme të fëmijëve dhe veçanërisht gjatë perdiudhës së adoleshencës. Qëllimi i këtij studimi është të paraqitenmarrëdhënien midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe suksesit akademiktë adoleshentëve në Kosovë. Prandaj, ky studim është i rëndësishëm për faktin që ofron një pasqyrë direkte të ndërlidhjes midis këtyre variablave.

Vetëefikasiteti sipas Banduras (1995), iu referohet besimeve në aftësitë për të organizuar dhe ekzekutuar kurse për veprim për të menaxhuar të ardhmen. Me fjalë të tjera vetëefikasiteti ka të bëjë me gjykimin e individit rreth aftësive të veta (Woolfolk, 2011). Sipas një studimi kualitativ të realizuar me mësimdhënës është vërtetuar se personat me vetefikasitet të lartë zakonisht janë ata të cilët janë më të gatshëm të marrin përsipër detyra më të vështira (Yost, 2006). Një studim tjetër kuantitativ kishte gjetur se ekziston korrelacion pozitiv midis vetëefikasitetit dhe motivimit akademik (Agbaria, 2013), i

cili mund të rezultoj poashtu me arritje me të larta akademike (Tella, 2007). Dullas (2010) me anë të një studimi ku kishte përdorur korrelacionin kishte ardhur në përfundim se kishte ndërlidhje sinjifikante mdis vetëefikasitetit dhe performancës akademike në lëndën e gjuhës angleze dhe atë të matematikës, tek nxënësit e shkollave të mesme në Nueva Ecija të Filipinës.

Nënshkallët eVetëefikasitetit

Vetëefikasiteti është i ndarë në tre nënshkallë të cilat ndikojnë në qëllimet e individit, si në atë *akademik, social* dhe *emocional* (Muris, 2001; 2002; Bandura, 1999). Vetëefikasiteti*akademik* është një proces komulativ i rolit të besimeve të përgjithëshme dhe fushave specifike të vetëefikasitetit në të nxënët vetërregullues dhe suksesin akademik, veçanërisht tek adoleshentët dhe të rriturit (Duncan, Dowsett, Claessent, Magnuson, Huston, Klebanov & Sexton, 2007). Pra, vetëefikasiteti akademik mund të jetë një objektiv i vlefshëm (Artino, 2012). Në një studim longitudinal të realizuar nga Liew, McTigue, Barrois dhe Hughes (2009) ka rezultuar se nxënësit mund të përfitojnë nga vlerësimet e besimeve të vetëefikasitetit akademik në mënyrë që të identifikohen nxënësit e tjerë që mund të jenë në rrezik për sfidat akademike. Vetëefikasiteti*social* është një dimension tjetër i vetëefikasitetit i cili iu referohet aftësive ndërpersonale (Gardner, 2011). Një person mund të jetë empatik ose i aftë për tu shoqëruar dhe përsëri nuk mban vetëperceptim në përputhje me këto aftësi (Di Giunta, Eisenberg, Kupfer, Steca, Tramontano & Caprara, 2015). Një studim kuantitativ ka treguar se adoleshentët me nivel më të lartë vetëefikasiteti social mund të përfshihen në sjellje të ndryshme të cilat vijnë si rrjedhojë e rrethit social (Veselska, Madarasova Greckova, Reijneveld, van Dijk, 2011). Vetëefikasiteti*emocional* kontribuon në rregullimin efektiv të emocioneve sepse është e drejtë e individit që të kontribuoj në mirëqenien psikologjike dhe rehatinë emocionale (Caprara, Di Giunta, Esenberg, Gerbino, Pastorelli & Tramontano, 2008). Pra, vetëefikasiteti emocional është koncept i cili është i lidhur me përdorimin efektiv të emocioneve nga një individ (Dogan, Totan & Sapmaz, 2013). Një studim tjetër kuantitativ kishte treguar se niveli i lartë i vetëefikasitetit emocional dhe nivelit të lartë të inteligjencës emocionale dhe vetëefikasitetit p.sh., tek mësimdhënësit do të ndikoj që të jenë më efektiv në mësimdhënie (Adilogullaria & Senelb, 2014).

Ashtu siç është theksuar më lartë vetëefikasiteti është besimi i individit në aftësitë e tij për të arritur me sukses një qëllim të caktuar. Sipas Brown, Malouff dhe Schutte (2005) vetëefikasiteti përveç që është një konstruk i teorisë sociokonjitive, poashtu njihet edhe si *teoria e vetëefikasitetit*, pra teori në vete. Bazuar në teorinë e sociokonjitivetë Banduras (1989) vetëefikasiteti aktivizon proceset knjitive që lidhen me qëllimet personale si zhvillimin e aftësive njohëse vetreflektuese, gjykimin për vetëefikasitetin dhe udhëzime të jashtme. Sipas Banduras (1995), vetëefikasiteti ndërlidhet me rrethin social i cili nxit njerëzit të provojnë shumëherë për të arritur sukses, poashtu qëndrimet emocionale mund të kenë ndikim në besimet e vetëefikasitetit, që mund të dërgojnë në arritje ose dështim të një qëllimi (p.sh. suksesin akademik). Më në detaje rezultatet e arritjeve (të nxënit) janë ndikuara nga një sërë faktorësh, duke përfshirë ndikimet shoqërore (udhëzimet p.sh. nga mësimdhënësit), besimi në vetefikasitet (ndikimet vetjake) tek fëmijët (Carroll, Houghton, Wood, Unsworth, Hattie, Gordon & Bower, 2009; Woolfolk, 2011).

Ndërlidhja e Vetëefikasitetit me Suksesin akademik

Vetëefikasiteti ishte i lidhur pozitivisht me angazhimin konjitiv dhe performancën akademike të nxënësve. Nxënësit të cilët kishin besuar se ishin në gjendje të ia dilnin, kanë pasur më shumë gjasa të raportojnë përdorimin e strategjive njohëse, ishin më vetërregullues në kuptimin e raportimit të përdorimit të strategjive metakonjitive dhe të vazhdonin më shpesh në detyra të vështira apo jointereasnte (Pintrich & De Groot, 1990). Duke u bazuar në teorinë e vetëefikasitetit Brown, Malouff dhe Schutte (2005, fq.13) kanë deklaruar se " Njerëzit do të provojnë vetëm atë që ata mendojnë se mund t'a bëjnë dhe nuk do të provojnë atë që ata mendojnë që nuk mund t'a bëjnë". Pra, lidhur me citimin e mësipërm nëse e marrim shembull suksesin atëherë mund të thuhet se nxënësit e dobët asnjëherë nuk synojnë vlerësimet maksimale, por vetëm ato kaluese. Një studim korrelacional i realizuar nga (Shkullaku, 2013) në Shqipëri me studentë të të gjitha viteve në dy universitete (Universitetin Europian të Tiranës dhe Universitetin Shtetëror të Tiranës) kishe gjetur një ndërlidhje të

fortë pozitive midis vetëefikasiteti dhe suksesit akademik. Në një studim deskriptiv korrelacional ka në ardhur në po të njëjtat rezultate duke konstatuar se se vetëefikasiteti ka ndërlidhje të fortë me suksesin akademik (Jahanian & Mahjoubi, 2013).

Kontributet në vetëefikasitetin e nxënësve, pritjen e rezultateve të vetëefikasitetit dhe motivimit janë trajtuar në një drejtim me synimet e nxënësve për të mbetur në kolegj (Landry, 2003). Një studim kuantitativt të realizuar në Malajzi me nxënës të kulturave të ndryshme (ndërkombëtare) ka treguar se socializimi i nxënësve të cilët janë nga kultura të ndryshme i ndihmon ata që të kenë motivacion më të lartë për të pasur shkallë më të lartë të aspiratës dhe arritje më të mira akademike (Khan, Hamdan, Ahmad & Mustaffa, 2015).Diçka të ngjashme ka vërtetuar edhe Chen (2014) sipas të cilit nxënësit e zinjë luan rol pozitiv dhe të rëndësishëm në shkallën e aspiratës tek nxënësit ndërkombëtarë, por kishte rol negativ tek nxënësit vendas, ku sipas tij një shpjegim mund të ofrohet identifikimit të etnicitetit gjë e cila mund të shkaktojë dyshime në definimin e suksesit akademik. Por, Preece (2011) ka deklaruar se në përgjithësi nuk ka dallime racore të cilat mund të ndikojnë suksesin akademik. Fëmijt të cilët ishin përfshirë në aktivitete pozitive, të tilla si sportet dhe puna ne grupe kishin përjetuar vetefikasitet më të lartë, kishin përjetuar më tepër ngjarje pozitive dhe poashtu kishin përjetuar rezultate akademike më pozitive (Tucker, 2009).

Adoleshentët me shëndet të mirë psikik, janë të ndikuar nga besimet e tyre për të menaxhuar me sukses eksperiencat e tyre emocionale qofshin ato pozitive apo negative në situata të ndryshme të jetës, përfshirë arritjet e tyre akademike në shkollë dhe ndryshimet në tranzicion (Ahmad, Yasien & Ahmad, 2014). Individët të cilët konsiderojnë se iu mungon burimi i energjisë mund të jenë të tëhequr, indiferentë dhe apatik ndaj përgjegjësive akademike (Duru, Duru & Balkis, 2014).Preece (2011), me anë të një studimi të realizuar me mësimdhënës dhe nxënës të klasës së pestë dhe të gjashtë ka treguar se mësimdhënësit dhe nxënësit e klasës së pestë (që kanë mbështetur njëri tjetrin) kanë kanë ndikuar në vetëefikasitetin akademik si dhe në mbështetje në situata stresuese. Një gjë e tillë nuk është vërtetuar tek nxënësit e klasës së gjashtë. Një studim tjetër eksperimental ka aprovuar se stresi dhe mbështetja sociale bazuar në mësime dhe këshillim janë të efektshme në reduktimin e stresit në mesin e nxënësve (Baqutayan, 2011).Për të arritur rezultate të mira, pavarësisht teknikave efektive të të nxënit dhe të planifikuara mirë, nxënësit duhet të jenë në gjendje të njohin veten e tyre në mënyrë të veçantë nga vetëefikasiteti emocional në mënyrë që ajo të mos bëhet një pengesë për suksesin akademik (Yahaya, Yahaya, Bonn, Hashim & Lee, 2012).

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës ku shumica e studimeve kanë tregua në mënyrë indirekte se ekziston ndërlidhje midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe arritjeve akademike. Atëher pyetja hulumtuese e këtij punimi është: A ekziston korrelacion midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe suksesi akademiktek adoleshentët?

Hipotezat:

1. Ekziston ndërlidhje midis vetëefikasitetit akademik dhe suksesi akademiktek adoleshentët.
2. Ekziston ndërlidhje midis vetëefikasitetit social dhe suksesi akademiktek adoleshentët.
3. Ekziston ndërlidhje midis vetëefikasitetit emocional dhe suksesi akademiktek adoleshentët.

Metodologjia

Mostra

Përzgjedhja e mostrës në këtë studim ka qenë konvencionale, joprobabile. Ky studim ka përfshirë 65 pjesëmarrës të moshë 13 deri 16 vjeç , ku 31% prej tyre kanë qenë të moshës 13 vjeçare, 37% të moshës 14 vjeçare, 24 % të moshës 15 dhe 8% prej tyre të moshës 16 vjeçare., nxënës të shkollave të mesme të ulëta nga regjione të ndryshme të Kosovës. Në këtë studim morën pjesë 30 femra (46.2 %) dhe 35 meshkuj (53.8%). Vlerësim në edukimin Kosovar bëhet nga 1 (dobët) deri tek 5 (shkëlqyeshëm). Mostra ishte e përbërë nga 43.1% me performancë të shkëlqyer akademike (5), 9.2% me performancë shumë të mirë akademike(4), 29.3% me performancë të mirë akademike (3) dhe 18.5% me sukses të mjaftueshëm (2) ndërsa nuk kishte asnjë me sukses të dobët. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ka qenë M=14.1 vjeç, SD= 1.1. Pyetësorët kanë qenë të tipit vetëraportues dhe janë administruar në fund të gjysëmvjetorit të parë.

Materialet

Pyetësori ishte i përbërë nga 2 pjesë. Pjesa e parë ishte me pyetjet demografike dhe pjesa e dytë me pyetjet për vetëefikasitetin. Për të matur vetëefikasitetin është përdorur pyetësori Self-Efficacy Questionnaire for Children (SEQ-C) *Brief Survey on Academic, Social and Emotional Self-Efficacy* nga Muris (2001; 2002), i cili kishte 24 pyetje, ku 3 prej tyre ishin marrë nga Bandura, Pastorelli, Barbaranelli & Caprara, 1999) dhe ishte i përbërë nga tre nënshkallë 1. *vetëefikasiteti akademik* (Alfa e Kronbahut .99), 2.*vetëefikasiteti social* (Alfa e Kronbahut .95) dhe 3. *vetëefikasiteti emocional* (Alfa e Kronbahut .97). Pyetësori është ndërtuar në bazë të 5 pikëve të shkallës së Likertit nga 1 (aspak nuk më përshkruan mua) deri tek 5 (shumë më përshkruan mua).Nuk kishte variabla të manipuluara, por ishte analizuar mardhënia ndërmjet variablave. Variablat ishin të determinuara dhe pozita e tyre është e definuar. Shpërndarja e të dhënave është jonormale dhe për analizë janë përdorur testet joparametrike, pra është përdorur korrelacioni i Spirmanit, për të parë ndërlidhjen ndërmjet variablave.

Procedura

Pjesëmarrësit janë informuarrreth qëllimit të studimit dhe se të dhënat e tyre do të jenë anonime dhe konfidenciale si dhe kanë të drejtë ta ndërprejnë plotësimin e pyetësorit në çdo kohë nëse nuk duan të vazhdojnë deri në fund. Në të njëjtën ditë nxënësve u janë shpërndarë fletëpëlqimet e prindërve. Pasi janë marrë fletëpëlqimet me nënshkrime të prindërve, është aplikuar pyetësori.

Rezulatet

Duke u bazuar në Shapiro-Wilk, rezultatet kanë treguar se mostra ka shpërndarje jonormale. Analizat janë bërë për të parë korrelacionin midis nënshkallëve të vetëefikasitetit (akademik, social dhe emociona) dhe suksesit akademiktë nxënësve të kasëve të teta dhe të nënta. Për të parë këtë ndërlidhje midis variablave është përdorur korrelacioni i Spirman Rho (r_s).

Tabela 1. Koeficienti i korrelacioni midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe arritjeve akademike.

	Vetëefikasiteti Akademik	Vetëefikasiteti Social	Vetëefikasiteti Emocional	Suksesi në gjysëmvjetorin e fundit
Vetëefikasiteti Akademik		.750**	.756**	.399**
Vetëefikasiteti Social			.772**	.335**
Vetëefikasiteti Emocional				.294*

Suksesi në gjysëmvjetorin e fundit	

*Korrelacioni sinjifikant në nivelin 0.02; **Korrelacioni sinjifikant në nivelin 0.05

Siç shihet në *Tabelën 1.0*, analizat tregojnë korrelacion pozitiv dhe sinjifikant midis vetëefikasitetit akademik dhe suksesi akademik(r_s=.40, p=.001), midis vetëefikasitetit social dhe suksesi akademikpoashtu ekziston korrelacion pozitiv dhe sinjifikant (r_s=.33, p=.005) dhe midis vetëefikasitetit emocional dhe suksesi akademikekziston korrelacion pozitiv dhe sinjifikant (r_s =.30, p=.01).Siç shihet të gjitha variablat kanë paraqitur korrelacion pozitiv dhe sinjifikant.

Diskutim

Të gjeturat e këtij studimi kanë ilustruar korrelacion pozitiv dhe sinjifikant midis variablava ashtu edhe siç është pritur. Pra, të gjeturat tregojnë se ekziston korrelacion pozitiv midis nënshkallëve të vetëefikasitetit dhe arritjeve akademike. Kjo është mbështetur nga literatura ekzistuese që vetëefikasiteti është i ndërlidhur me suksesin akademik të adoleshentëve (Tenaw, 2013; Ogunmakin & Akomolafe, 2013).

Në fund mund të konkludohet se hipotezat e këtij studimi janë mbështetur. Pra, vetëefikasiteti akademik, social dhe emocional ka ndërlidhje me suksesin akademik. Sa iu përketë limiteve, ky studim ka disa prej tyre, ku së pari përzgjedhja e mostrës ka qenë konvencionale. Së dyti, numri i pjesëmarrësve në studimin tonë ka qenë i vogël dhe së treti një nga limitet e këtij studimi mund të jetë administrimi i pyetësorëve në fund të gjysëmvjetorit të parë. Studimet e ardhshme mund të përdorin një mostër më të madhe për të vërtetuar edhe një herë rezultatet midis këtyre variablave. Do të rekomandohej që poashtu, studimet e ardhshme të drejtojnë fokusin e tyre në studime longitudinale në mënyrë që të gjenden raporte më të thella midis këtyre variablave.

Referencat

Adilogullaria, I., & Senelb, E. (2014). Examination of the Relationship between General Self-efficacy Beliefs, Emotional Intelligence Levels and Emotional Self-efficacy Levels of Students in School of Physical Education and Sport. *Anthropologist*, *18*(3), 893-902.

Ahmad, Z. R., Yasien, S., & Ahmad, R. (2014). Relationship between perceived social self-efficacy and depression in adolescents. *Iranian journal of psychiatry and behavioral sciences*, *8*(3), 65.

Artino Jr, A. R. (2012). Academic self-efficacy: from educational theory to instructional practice. *Perspectives on medical education*, *1*(2), 76-85.

Bandura, A. (1989). Social cognitive theory. In R. Vasta (Ed.), Annals of child development. Vol. 6. Six theories of child development (pp. 1-60). Greenwich, CT: JAI Press.

Bandura, A. (1995). *Self-efficacy in changing societies*. Cambridge university press.

Bandura, A., Pastorelli, C., Barbaranelli, C., & Caprara, G.V. (1999). Self-efficacy pathways to childhood depression. Journal of Personality and Social Psychology, 76, 258-269.

Baqutayan, S. (2011). Stress and social support. *Indian journal of psychological medicine*, *33*(1), 29.

Brown, L. J., Malouff, J. M., & Schutte, N. S. (2005). The effectiveness of a self-efficacy intervention for helping adolescents cope with sport-competition loss. *Journal of Sport Behavior*, *28*(2), 136.

Caprara, G. V., Di Giunta, L., Eisenberg, N., Gerbino, M., Pastorelli, C., & Tramontano, C. (2008). Assessing regulatory emotional self-efficacy in three countries. *Psychological assessment*, *20*(3), 227.

Carroll, A., Houghton, S., Wood, R., Unsworth, K., Hattie, J., Gordon, L., & Bower, J. (2009). Self-efficacy and academic achievement in Australian high school students: The mediating effects of academic aspirations and delinquency. *Journal of Adolescence*, *32*(4), 797-817.

Chen, Y. (2014). The influence of self-efficacy on degree aspiration among domestic and international community college students.

Di Giunta, L., Eisenberg, N., Kupfer, A., Steca, P., Tramontano, C., & Caprara, G. V. (2015). Assessing perceived empathic and social self-efficacy across countries. *European Journal of Psychological Assessment*.

Dogan, T., Totan, T., & Sapmaz, F. (2013). The role of self-esteem, psychological well-being, emotional self-efficacy, and affect balance on happiness: a path model. *European Scientific Journal*, *9*(20).

Dullas, A. R. (2010). Academic Performance and Self-Efficacy of Filipino Science High School Students on Mathematics and English Subjects.*Available at SSRN 2152791*.

Duncan, G. J., Dowsett, C. J., Claessens, A., Magnuson, K., Huston, A. C., Klebanov, P., & Sexton, H. (2007). School readiness and later achievement. *Developmental psychology*, *43*(6), 1428.

Duru, E., Duru, S., & Balkis, M. (2014). Analysis of Relationships among Burnout, Academic Achievement, and Self-regulation. *Educational Sciences: Theory & Practice*, *14*(4), 1274-1284.

Gardner, D. M. (2011). Parents' influence on child social self-efficacy and social cognition.

Jahanian, R., & Mahjoubi, S. (2013). A Study on the Rate of Self-efficacy's Effect of University Students' Academic Achievement. *Middle East Journal of Scientific Research*, *15*(7), 1021-1027.

Khan, A., Hamdan, A. R., Ahmad, R., & Mustaffa, M. S. (2015). International Student's Academic Achievement: Contribution of Gender, Self-efficacy and Socio-cultural Adjustment. *Asian Social Science*, *11*(10), 153.

School Students in Ondo State, Nigeria. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, *4*(11), 570.

Pintrich, P. R., & De Groot, E. V. (1990). Motivational and self-regulated learning components of classroom academic performance. *Journal of educational psychology*, *82*(1), 33.

Preece, K. K. (2011). Relations Among Classroom Support, Academic Self-Efficacy, and Perceived Stress During Early Adolescence.

Self- Efficacy and Participation in Choosing the Teaching Profession as Predictors of Academic Motivation among Arab Student's Girls

Shkullaku, R. (2013). The relationship between self-efficacy and academic performance in the context of gender among Albanian students. *European Academic Research*, *1*(4), 467-478.

Tenaw, Y. A. (2013). Relationship between self-efficacy, academic achievement and gender in analytical chemistry at Debre Markos College of teacher education. *African Journal of Chemical Education*, *3*(1), 3-28.

Tucker, L. (2009). Investigating the emotional intelligence of adolescents with and without disabilities.

The Impact of Motivation on Student's Academic Achievement and Learning Outcomes in Mathematics among Secondary School Students in Nigeria.

Veselska, Z., Madarasova Geckova, A., Reijneveld, S. A., & van Dijk, J. P. (2011). Self-efficacy, affectivity and smoking behavior in adolescence.*European addiction research*, *17*(4), 172-177.

Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi.* Tiranë: Centre for Democratic Education.

Yahaya, A., Yahaya, N., Boon, Y., Hashim, S., & Lee, G. M. (2012). The impact of emotional intelligence elements on academic achievement.*Archives Des Sciences*, *65*(4), 2-17.

Yost, D. S. (2006). Reflection and self-efficacy: Enhancing the retention of qualified teachers from a teacher education perspective. *Teacher Education Quarterly*, *33*(4), 59-76.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

CHALLENGES FOR SME DEVELOPMENT, INNOVATION AND TECHNOLOGY RELATIONSHIP, A CASE STUDY BY ALBANIA REGIO

Prof Dr Alba Robert DUMI[1]Florid DUMI[2]

Management Department" Economy Faculty University of Tirana, Albania

[2]Institute of Business Administration, Jean Moulun Lyon 3 University, France

ABSTRACT :*Although SME financing levels have been increasing in recent years, it is still considered inadequate to promote a rapid development of this sector. Also, SME, and especially new SME, face considerable difficulties in obtaining loans from the banking sector, where the cost of credit is relatively high. Banks' requirements are not conducive to business, especially for the high level of collateral of 120-150% and high interest rates on loans when required for investments in machinery and equipment. The Support policies to start-up businesses are still lacking. Lack of alternative financial resources for SME, such as venture capital, innovation vouchers, business angels, etc.*

Key words: Reform process, development economy, impact, law analyze, exchange rate

1.**Introduction**

1.1 Innovation and Technology SME Development .

The main factors influencing the capacity of firms to absorb new technology are: the investment climate in which they operate and the level of skills and technological capabilities in firms. In Albania, only 10% of all surveyed firms provide formal training to their employees, compared to 79% of Slovak firms involved in the 2005 study and 48% of firms in Serbia *(Source: World Bank, 2009, pg. 48).*

1.2 Challenges for SME Development

Based on the SWOT analysis, below, on the performance of SME development, it is ascertained that: *Internet and Electronic Commerce:* In recent years, in Albania, the number of SME using second-generation internet services has increased, especially from the young generation of entrepreneurs and managers. According to AKEP[5] in 2011 the coverage rate over the internet is over 50%, but still lower compared to 67.6% of EU countries.

2. The purpose of the study

Despite improvements in the legal framework, only 10,000 businesses have broadband internet from 100,687 active businesses. Currently, there are three operators offering 3G mobile broadband services.- *Creative economy:* it is necessary to intervene with concrete policies for this sector, such as: i) regulatory measures aimed at removing administrative and legal obstacles; ii) improving the system of vocational education and training (for all design / advertising activities, crafts and crafts); iii) legal and financial incentives to support this sector; and iv) improve the capacity of organizations presenting this sector.

- Inclusion of Social Responsibility in Growth of Business Competitiveness, CSR

Corporate social responsibility is a key part of the new Europe 2020 strategy, which requires an integrated approach to "a fast, sustainable, and inclusive growth" within the overall vision of a social market economy.[28]Inclusion of social responsibility in business poses a challenge to boosting business competitiveness, so it is a new policy for Albania, should be included in the sustainable business development agenda.

- *Development of Innovation and Technology for SME.*

Albania continues to stay behind other countries in terms of poor performance in innovation. Enterprises finance technological developments mainly from domestic resources, which are limited. There is a lack of business incubators and clusters; Albania is already part of the European SME Network, EEN. The implementation of proactive policies to support the growth of technology capacity for enterprises, especially for SME, remains a challenge for the next period 2014-2020.

- *Promote female entrepreneurship.*

Managed or owned enterprises by women are at a low level, in about 27% of all active businesses in 2011. Over 90% of women-run businesses are in service sectors (small trade, tourism, vacancies etc.). About 30% of self-employed are women. The percentage of disbursement of loans by women's businesses amounted to 25% in 2011. There are no policies for supporting women's entrepreneurship and according to the report "SME policy index 2012" Albania is rated 2.5 points (out of maximum 5 points).

2. Literature Review And Hypotheses

*SWOT analysis of SME:*This industry has had some particular aspects in its development over these years such as: ***The metallurgical industry,*** represented by metal scrap recycling and ferro-chromium production that has risen from year to year, and have used existing locations and industrial renewal of technology, which has enabled the emergence of domestic, regional and international markets further. Currently, about 600,000 tons of metal scrap are processed and about 23,000 tons of ferro-chromium per year are produced. There is a great potential for this industry in the metallurgical processes of copper and nickel ore handling.

Mechanical industry, represented by micro enterprises with 2-5 employees where mainly metal constructions, aluminum construction products, special spare parts for different industries etc. are produced. The total number of enterprises in this industry is around 700. This industry puts into use the professional experience of employees and the market demand for specific services. Its development is conditioned by the development of infrastructure and construction.

This industry has failed to develop the production of spare parts and technological equipment required by several branches of industry, particularly mining, food, focusing only on the service and maintenance sector. This is one of the directions of its development for the years 2014-2020.

i) ***The wood processing industry*** has a tradition and for the moment its development is normal. The products of this industry are increasingly meeting the requirements of customers with country wood products and their presence is becoming apparent even in regional markets. Today, the wood processing industry counts around 700 wood processing firms throughout the country, 200 of which produce scrap materials and 500 firms deal with furniture production in which around 4500-5000 employees are employed, with income which range from about 20 to 22 million Euros. Exports of these products amount to EUR 4 million for semi-fabricated wood materials.

[28]*The European Commission, Europe 2020, http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm*

3. Research Goal

i) ***The chemical industry*** set up after the 90's is characterized by many small, medium and large enterprises, which produce products in the field of chemical industry such as paints, detergents, polystyrene, oils, adhesives for building materials.

i) ***The textile and clothing industry*** is mainly represented by clothing production and a small production of textiles and woolen materials by utilizing part of the existing facilities, free labor costs and employee experience. It is noteworthy the phenomenon of companies with common assets, mainly Italian, Greek, German, which also use modern technology. In this branch, the value of exports for 2011 reached the figure of EUR 238.6 million. The number of employees at the end of 2010, according to INSTAT, has gone around **15 thousand employees.**

i) ***The leather and shoes industry is*** mainly represented by domestic processing companies working with buyers' materials. This industry has used the same opportunities as clothing. In this branch according to INSTAT there are employed 10,600 employees and the value of exports for 2011 amounted to **216 million EURO**

i) ***The glass and ceramics industry*** is represented by handicrafts as well as heavy pottery and sanitation tiles. These products, to a greater extent, have inherited and followed the earliest representations of the country's tradition, that of hard pottery. As a raw material for their products is used domestic raw material, the level of handicrafts and technology continues to be handmade which affects the increase in quantity and quality of production. Generally these lines are considered small where no more than two to four specialized employees work.

c- Internet and Electronic Commerce

Over the last few years, many Internet users in Albania have grown, especially from the younger generation, but there is still no talk of massive use of the Internet by small and medium-sized producers. Infrastructure in general is somewhat poorly valued, the use is limited to the main districts of the country, while it is less in the other districts of the country. It is worth mentioning that it is going very fast about the recognition of this field.

d- Technology

In Albania we are building some industrial or technological parks. To enhance the competitiveness of Albanian SME, a series of measures have been taken, starting with the preparation of the legal framework, institution building, drafting of action programs and implementation activities. These measures have affected the development of the SME sector in Albania.

e- Creative entrepreneurship and their contribution

The creative industry is based on individual talents and skills, capable of producing and employing people and is a component of intellectual property. This kind of industry in Albania in general has been based mainly on trades crafts. In recent years, some new sectors of the creative services industry have been emerging and developing in Albania: production of advertising, graphic studios, computer services, music and music shows, television and radio, architecture studios, design, publishing houses, cinematography etc. The contribution of these sectors to economic growth is still small.

4. Sample and Data Collections

Public policies for SME development in the period 2012-2020

SME development policies in the coming period have been compiled in accordance with all SAA and European Partnership acts and agreements and the European Charter of Small Enterprises. Albania as a Western Balkan country, aspiring to become part of the family and the European market, naturally follows the reform processes as well as the economic and structural development for reducing unemployment and increasing productivity and competitiveness in the European economy.

As a consequence of market liberalization reforms, privatization and institution building processes, a number of adaptive phenomena in the economic structure, labor market and social welfare were consequently brought to have a certain cost of this transition.

This liberalization process, which also brought a number of positive effects such as the growth of investment efficiency through economies of scale that led to higher investment growth, adaptation of new technologies and creation of new firms and industries, should not be accepted accompanied by a satisfactory level of investment in infrastructure, education and labor market. Small and medium-sized enterprises have been the most influential economies of the business and investment climate. While in the perspective of the effects, actors and institutions involved, the financial resources that need to be committed by the government and donors are worth emphasizing the strategic aspect.

Specifically, the following three levels are harmonized as follows:**a- Strategic Level**

1- The Creation of the Consultative Committee for SME Development. For the drafting of the strategic SME development program for the mid-term period 2009-2013, consultative groups have been set up with representatives of various institutions operating in the field of SME: representatives of the Regional Business Agencies, representatives of the banking system, representatives some of the major projects that support SME, donor representatives as well as Albinvest and the Business Promotion Directorate at METE. These working groups are respectively as below:

1. Enterprise Promotion Group.
2. Group of Growth Business with internationalization capacity.
3. Group for SME credit enhancement
4. Drafting a strategic program for SME development

The overall objective of this strategic program:

It is the sustainable economic development of the SME sector through the increase number of new enterprises as well as the continuous improvement of indicators of productivity, competitiveness and export of enterprises with potential internationalization.

Specific objectives:

1. To serve in achieving this general objective are as follows:
    - Encourage entrepreneurship culture
    - Development of growing businesses with internationalization capacity.
    - Improve SME financing
    - Of course, development in these directions will be preceded by measures to improve the business climate for the development of the private sector

b- Measures to be implemented to achieve specific objectives

1- Promote entrepreneurship culture One of the long-term priorities of the SME sector is the promotion of entrepreneurship culture. The aim is to develop a strategy of entrepreneurship

promotion with a concrete action plan that will focus on introducing entrepreneurial culture both in formal and informal education, in the training required for entrepreneurs

a-*Creation and improvement of management and training skills:*

The lack of managerial talent, prevalent in many countries in the region, has a major impact on SME. For this reason, another entrepreneurial behavior should be built up in the first steps of educating the younger generation. Such actions are very important in creating the right environment for entrepreneurs in the education system to ensure that young people are aware of entrepreneurial culture and consider it as part of their education and future employment opportunities. The strategies developed in the EU countries take into account that this process is a process of learning over a long period of time starting from primary education and further up to higher levels of education.

CONCLUSIONS AND RECOMMENDATIONS

These processes include not only curricular reform at all levels, but also a number of other programs aimed at promoting entrepreneurial culture such as business school partnership, student enterprise, school reform, and all institutions that provide education and training, in order to encourage universities to offer specialized courses on entrepreneurship in areas such as e-business, innovation technologies, etc. The aspirants states seeking to enter the EU should consider promoting and entrepreneurship projects outside school activities as part of education youth. Media should also play a role in promoting entrepreneurial culture.

To improve this situation, the following measures will be taken:

- 9-year compulsory education curriculum analysis, for general secondary education about entrepreneurship skills.
- Developing programs for introducing entrepreneurship into basic education programs at all levels.
- Drafting a curriculum for entrepreneurship and training programs for the development of entrepreneurial skills, in several monthly professional courses.
- Development of training programs for young people seeking to start a business, graduate, unemployed, retraining and ongoing information.
- Growth of internet users in the secondary and secondary education schools.

b- Increase the qualification of labor force through:

- Periodic analysis of training needs
- Developing training programs and relevant modules for entrepreneurship
- Expanding the Internet usage network,

c-Encouraging creative entrepreneurship through:

- Study on creative entrepreneurship in Albania
- Program for development of Albanian Handicrafts
- Entrepreneurship promotion programs with specific groups such as women, young people, etc.

The evelopmet of growing businesses with internationalization capacity

In the framework of regional and European integration, Albanian SME should be prepared to cope with the competition of other regional companies. For this it is required to increase the competitiveness of Albanian SME through the promotion of innovative SME and the transfer of contemporary technologies.

REFERENCES

Drucker, Peter F. *The Practice of Management*. New York: Harper & Row, 1954. Gantt, Henry. *Gantt on Management*. Edited by Alex W. Rathe. New York: American Management Association, 1961. Koontz, Harold, and O'Donnell, Cyril. *Principles of Management*. New York: McGraw-Hill, 1972. Merrill, Harwood, ed. *Classics in Management*. New York: American Management Association, 1960. Urwick, Lyndall F., and Brech, E.F.L. *The Making of Scientific Management.* London: Sir Isaac Pitman & Sonc, 1952. Urwick, Lyndall F., ed. *The Golden Book of Management. London: Newman Neame, 1956.*

III. *Management in Japan*

Abbeglen, James. *The Japanese Factory*. Glencoe, III.: Free Press, 1958. Hirschmeier, Johannes. *The Origins of Entrepreneurshipin Meiji Japan*. Cambridge: Mass.: Harvard University Press, 1964. Kobayashi, Shigeru. *Creative Management*. New York: American Management Association, 1971. Nakane, Chie. *Japanese Society*. Berkeley, Calif.: University of California Press, 1970. Tobata, Seiichi, ed. *The Modernization of Japan*. Tokyo: Institute of Asian Economic Affairs, 1966. *Yoshino, M. Japan's Management System: Tradition and Innovation.* Cambridge, Mass.: M.I.T. Press, 1968.

IV. Managing for Performance

Crozier, Michael. *The Bureaucratic Phenomenon*. Chicago: University of Chicago Press, 1964. Dean, Joel. *Managerial Economics*. Englewood Cliffs, N.J.: Prentice-Hall, 1951. Drucker, Peter F. *Managing for Results*. New York: Harper & Row, 1964. Penrose, Edith T. *The Theory of the Growth of the Firm*. Oxford University Press, 1959. Schumpeter, Joseph. *The Theory of Economic Development*. Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1934. Shackle, J.L.S. *Decision, Order and Time in Human Affairs.* Cambridge University Press, 1961.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-979

"NAÇERTANIJA" – PLATFORMË SHOVINISTE PËR KRIJIMIN E "SERBISË SË MADHE"

Astrit Sahitaj-Doktorant ASA Shqiperi

"Naçërtanija" (1944) e Ilia Garashaninit është platformë famëkeqe, që parasheh krijimin e "Serbisë së Madhe" mesjetare të car Dushanut në dëm të popujve fqinj. Para Garashaninit idenë për krijimin e Serbisë së Madhe e kishte shfaqur Vuk Karaxhiqi (1836), që i radhit territoret, ku banonin serbët. "Naçetanija" ka një rendësi të vacantë për Serbinë, sepse sherbeu si plkatformë zyrtare për krijimin e shtetit serb mbi themelet e shtetit mesjetar. Ky project është huazuar nga projekti i polakut Franjo Zahut. Në bazë **të këtij projekti.**"Naçertania" është dokumenti i parë politik, që pati paraparë krijimin e Serbisë së Madhe mbi rrënojat e shtetit mesjetar të mbretërisë së Stefan Dushanit. " Vetëm dinastia monarkiste serbe do të mund t'i bashkonte serbët (sllavët e jugut), "Naçertania" ka ushtruar ndikim në politikën e pushtetarëve serbë ndaj çështjes shqiptare.

Prandaj, bazuar në politikën ekspansioniste të pushtetarëve serbë ndaj shqiptarëve nëpër të gjitha etapat kohore, konkludojmë se "Naçertania" pati ndikim permanent në frymëzimin e pushtetarëve serbë për okupimin e trevave autoktone të shqiptarëve. Ajo i frymëzoi intelektualët serbë me frymën e ultranacionalizmit dhe mbolli dasi ndërmjet shqiptarëve e serbëve duke krijuar një hendek përçarës ndër këta dy popuj. Politika shoviniste e Serbisë për krijimin e Serbisë Madhe ushtroi dhunë gjenodiciale ndaj popullit shqiptar që nga çereku I shekullit XIX e deri në fund të shekullit XX.

Fjalëkyçe: Naçertania, platforma, Serbia e Madhe, shqiptarët, aneksimi.

"NAÇERTANIA" – PLATFORMË SHOVINISTE PËR KRIJIMIN E "SERBISË SË MADHE"

Kisha ortodokse me politikën e vete e ushqente popullin serb me frymën nacionale fe-komb. Kjo ide u shtjellua nga nacionalisti i njohur serb, Vuk Karaxhiq. Aimë 1836 e shkroi programin e njohur me titull "Serbët të gjithë dhe kudo". Në këtë shkrim "i radhiti territoret, ku banonin serbët: principatën e Serbisë, Bosnën, Hercegovinën, Malin e Zi, Metohinë e Banatit, Baçkën, Sremin, Sllavoninë, Kroacinë dhe Dalmacinë, por **nuk kishte njohuri** deri **ku kishte serbë në Shqipëri** dhe në Maqedoni"[29].

"Naçertania" (1844) e I. Garashaninit në historiografinë serbe mirret si programi i dytë i politikës nacionale të Serbisë[30].

Vitet e 30 e të 40 të shekullit XIX karakterizohen si vite përpjekjesh të popujve ballkanikë për t'u çliruar nga zgjedha turke. Popujt e Ballkanit edhe pse lypsej të vepronin bashkarisht kundër okupatorit të përbashkët, për shkak të lakmive aneksioniste, secila prej tyre thurrte plane për të përfituar në dëm të njëra tjetrës. Në këtë rrugë ishin edhe Serbia e Greqia të cilat kishin qëllime përfitimi në dëm të tokave shqiptare. Që të dyja këto vende i projektuan projektet e veta me të cilat parashihnin aneksimet e tokave jugore e veriore të Shqipërisë. Greqia kishte hartuar projektin "Megalo idea". Serbia do të dilte me "Naçertania".

[29] Dr. Momçillo Pavlloviq: "Savremena politiçka istorija", Beograd, 2016, fq. 49.
[30] Më gjërësisht: Dr. Momqillo Pavlloviq, "Savremena politiçka Istorija", Beograd, 2016, fq. 52, 53.

Politika serbe ndoqi vijën kundërshqiptare me rrugë institucionale. Por jo vetëm kundër shqiptarëve. Këtë e dëshmon projekti famkeq "Naçertania" (1844) i hartuar nga Ministri i Punëve të Brendshme, Ilia Garashaninit (1812 – 1874). "Naçertania" është quajtur platformë e parë politike e qarqeve drejtuese të Beogradit njëherësh edhe baza ideologjike e programit shovinist të "Serbisë së Madhe"…, "…ajo edhe sot mbetet themel i programit shovinist të fqinjit tone verior, nën zgjedhën e të cilit ndodhen mbi dy milion shqiptarë, banorë autoktonë në trevat e veta…"[31]

Niksha Stançiq në studimin e vet me titull "Problemi i "Naçertanisë" së Ilije Garashaninit në historiografinë tonë" vë në dukje se "Plani i fshehtë dhe politika nacionale e Principatës së Serbisë ka mbetur i panjohur për shkencëtarët dhe publikun e gjërë më tepër se gjashtëdhjetë vite".[32]Autori tregon se për herë të parë "Naçertaninë" e kishte publikuar M. Vukiçeviçi më 1906. Më vonë në Arkivin Shtetëror në Vjenë ishte gjetur "Naçertania" e përkthyer në gjermanisht dhe më 1886 u gjet në Arkivin Shtetëror në Budapest.[33]

Deri në vitin 1931 është menduar se "Naçertania" ishte krijim i Ilia Garashaninit. Atë vit D. Stranjakoviq, bazuar në publikimin e M. Handelsmanit lidhur me autorësinë e "Naçertanisë" e shpjegon origjinën e programit në fjalë. Të dhënat e reja lidhen me kushtetutëmbrojtësit dhe emigracionin polak, që pas shtypjes së kryengritjes në Poloni më 1831 ishin tubuar në Paris nën udhëheqjen e princit, Adam Czartoryskut. Emigracioni polak ka dasht të krijohej një shtet qendror, i cili do të mblidhte të gjithë sllavët e jugut, që ndodheshin nën okupimin turk. Qëllimi i Adam Czartoryskut ishte që me krijimin e bashkësisë së sllavëve të jugut, që ishin nën okupimin turk në Ballkan, të përkrahur nga Britania e Franca,- **Rusisë dhe Austrisë do t'u pamundësohej shtrirja në Ballkan.** Në studimin e vet D. Stranjkoviq e sqaron gjenezën e "Naçertanisë", ku decidivisht vjen në përfundim, që është hartuar nga Franjo Zahu.[34] Ndërsa Garashanini e ka marrë projektin në fjalë dhe në bazë të tij e ka hartuar "Naçertanien". "Gati 90 përqind e "Naçertanies"është kopjuar pothuajse fjalë për fjalë nga plani i F. Zahut".[35]Madje R. Peroviq ua sheh për të madhe të gjithë historianëve vendorë, "që kanë lënë pasdore ndikimin polak në formimin e mendimit politik të Serbisë".[36]

Qubriloviqi, i njohur me elaboratin e tij famkeq për qëndrim gjenocidial ndaj shqiptarëve, "Naçertaninë",- në raport me "Planin" e Zahut e sheh si të bazuar e të huazuar duke ia përshtatur konceptit të Vuk Karaxhiqit, që nuk duhet të hiqej dorë nga ajo që është serbe në vija të përgjithshme të kulturës politike të sllavëve të jugut[37].Ai e shef "Naçertaninë" si komponent të së drejtës historike të serbëve, të drejtës shtetërore, të traditës së perandorisë së Dushanit[38].

Garashanini në qendër të programit "Naçertania" vë Serbinë, politikën e saj, që duhej ndjekur për realizimin e idesë së krijimit të"Serbisë së Madhe".

Duke lexuar "Naçertaninë" që në fillim na bien në sy kërkesat e programit. Së pari që"Serbia duhet të zërë vend në radhët e shteteve të tjera evropiane". Kështu mendohej për një dominim të

---

[31] Marenglen Verli: "Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli", BOTIMPEX, Tiranë, 2007, fq. 21

[32] Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, str. 179.

[33]Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, str , fq. 180.

[34]Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, str. 183.

[35]Marenglen Verli: "Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli". "BOTIIMPEKS", Tiranë, 2997, fq. 21.

[36]Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, st .186.

[37]Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, str. 188.

[38]Niksha Stançiq: "Problem "Naçertanija" Ilije Garashanina u nashoj historiografiji". Tisak Stamparkog Zavoda "Ognjen Prica" u Zagrebu- 1971, str. 188-189.

politikës serbe në një të ardhme me kushte të përshtatshme. Ky realizim, sipas "Naçertanisë" mund të arrihej "vetëm në bashkimin me popujt tjerë, që e rrethojnë".[39]

"Naçertania" u përpilua nga Ilia Garashanini në vitin 1844 si program i politikës së jashtme të Serbisë. Synonte përtritjen e Perandorisë së dikurshme mesjetare serbe, prandaj pati karakter pushtues, sidomos ndaj territoreve shqiptare apo të banuara kryesisht prej shqiptarëve.

"Që në kohën e Garashaninit ekzistonte mendimi ndër politicientët konservativë borgjezë të Serbisë, se Serbia ishte zhvilluar mjaft dhe ishte mjaft e fuqishme t'i asimilonte vendet dhe popujt që do t'ia bashkonte vehtes pas shkatërrimit të Perandorisë turke.[40]"

"Naçertania" e Ilija Garashaninit është program, që parashikon dhe konstrukton rrugën, që duhej të ndiqej nga politika e Serbisë për krijimin e një"Serbie të Madhe" të periudhës së car Dushanit.

Rrethanat politike të krijuara në Ballkan në vitet e 40 kishin cytur interesimin e popujve ballkanas për të hequr qafet zgjedhën e robërisë shekullore. Në këtë periudhë politika serbe shfaqi pikëpamjet e veta për zgjërimin e Serbisë. Pra "Naçertania" ishte platformë afatgjate për krijimin e shtetit mesjetar të car Stefan Dushanit. "Në këtë mënyrë rikrijimi i Perandorisë Serbe arsyetohej si një e drejtë historike, prandaj sunduesve të Serbisë të shekullit XIX u takonte të plotësonin atë që kishin lënë pa bërë paraardhësit".[41]

Në projektin "Naçertania" i kushtohet vëmendje e posaçme çështjes së popujve, që e rrethojnë principatën serbe dhe politikës që duhej të ndiqej ndaj tyre. Garashanini pasi tregon për gjendjen politike të kohës dhe vijën politike, që duhej të ndiqej për arritjen e qëllimit të krijimit të një shteti serb me kufij të zgjëruar ai vijon tëparaqes koncepcionet për ndarjen e Perandorisë Osmane në të ardhëmen. Në këtë drejtim sheh si rival serioz Rusinë dhe Austrinë, që aspironin për zgjërim teritoresh.

Në nëntitullin "Vështrim mbi ndarjen e perandorisë"[42]Garashanini ka parashtruar koncepcionin për krijimin e "Serbisë së Madhe". Aty nder të tjera potencohet se "Shteti serb që tanimë ka nis të mbarën, por që patjetër duhet të zgjerohet e të forcohet, e ka bazën dhe themelin e vet të forte në Perandorinë Serbe të shekujve XIII e XIV dhe në historinë e pasur e të lavdishme serbe. Sipas kësaj historie dihet se perandorët serbë ia patën prerë hovin mbretërisë greke… Car Dushani, i fuqishmi tanimë e kishte pranuar stemën e mbretërisë greke..., pasi fuqia turke pothuajse është thyer e asgjësuar... duhet të fillojë të veprojë fryma e njëjtë, të drejtat e veta sërisht të kërkohen, dhe puna e ndërprerë rishtazi të vazhdojë…".[43]Kujton car Dushanin me qëllim ripushtimi.

"Naçertania" është marrë edhe me çështjen e politikës serbe ndaj shqiptarëve dhe mënyrën se si mund të vije deri në realizimin e pikëpamjeve për krijimin e "Serbisë së Madhe". Në fakt për këtë çështje nuk elaborohet gjerësisht, por megjithatë në mënyrë lakonike tregohet se si mund të arrihej deri në okupimin e tokave të Shqipërisë Verore. Dalja në bregdetin Adriatik është vënë në plan të parë nga Garashanini.

"Naçertania" është dokumenti i parë politik, që pati paraparë krijimin e Serbisë së Madhe mbi rrënojat e shtetit mesjetar të mbretërisë së Stefan Dushanit. " Vetëm dinastia monarkiste serbe do të mund t'i bashkonte serbët (sllavët e jugut), e kjo nënkupton se në një moment të caktuar në mënyrë të pashmangshme do të rrezikonte dinastinë dhe pavarësinë e Malit të Zi… Platforma e "Naçertanies" me synimet e saj pushtuese në Ballkan, nënkuptonte edhe shtrirjen në territoret shqiptare".[44]

"Naçertania" ka ushtruar ndikim në politikën e pushtetarëve serbë ndaj çështjes shqiptare. Ishte brumosur me ide shoviniste, që kishte pikësynim edhe aneksimin e territoreve shqiptare. Pikëpamje të ngjashme ndoqën edhe shumë intelektualë serbë të fushave të ndryshme e veçmas letrarë e historianë.

---

[39] Ilia Garashanin: "Naçertanija", Beograd, 1939, fq, 1

[40] Grgur Jakšiq-Vojislav J. Vuçkoviq: "Spolnja politika Srbije, za vlade knjeza Mihaila (Prvi Ballkanski Savez)", Beograd 1963, f,376, Reçencion i S.Brestovcit në "Gjurmime albanologjike", seri shkencave shoqerore, I/1972,f,337.

[41] Marenglen Verli: "Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli", BOTIMPEX, Tiranë 2007, fq. 21.

[42]Në original: "Primjeçanija o razdelenju carstva".

[43]Ilija Garasanin: "Nacertanija" marrë nga D. Stranjakoviq në studimin: "Si është krijuar "Naçertanija" e Garashaninit", Beograd 1939, fq. 76.

[44]shqipmedia.com, Xhelal Zejneli, Naçertaniae Garashaninit-kjo-murtajë-e-zeze-e-Ballkanit, 14 prill 2012

Nga ta po përmendi Dositej Obradoviqin, Vuk Karaxhiqin, Ivo Andriqin e Vaso Qubriloviqin, që paten ndikim në orientimin e politikës serbe për zgjerimin e kufijve në dëm të shqiptarëve. "Profesori serb Vasa Qubriloviqi, i njohur si shovinist, në librin e tij "Historia e ideve politike në Serbi në shekullin XIX është shprehur: "Garashanini duke pranuar si bazë për bashkimin …parimin e ekspansionit serb në krye të shtetit të ri dhe duke e përhapur administratën e Serbisë në këto vende, krijoi me 1844 bazën dhe programin e bashkimit politik serbomadh. Qarqet dhe personat politikë konservatorë në Serbi u bashkuan me këto qëllimederi në vitin 1941".[45]Natyrisht për Qubrilloviqin viti 1941 mund të mirrej si kufiri i pushimit të përpjekjeve serbomëdha, por faktikisht nuk ishte Lufta e Dytë Botërore ajo, që e pengoi ekspasionin serbë, sepse çetnikët e Drazho Mihajloviqit i vijuan përpjekjet për krijimin e Serbisë së Madhe duke ushtruar dhunë të paparë deri më atë kohë mbi popullatën autoktone shqiptare. Edhe pas triumfit të forcave partizane shqiptarët hoqën të zitë e ullirit nga regjimi serbosllav. "Kufiri nuk ishte viti 1941. Ai kufi nuk ka qenë as më pas, madje ai kufi nuk është as sot".[46]Duhet patur parasysh dy periudhat e pushtetit serbosllav: të Josip Broz Titos e të Sllobodan Millosheviqit. Gjatë periudhës së Titos nga regjimi serbosllav djallëzisht u aneksua Kosova. Kështu u shkel arbitrarisht marrëveshja e Bujanit. Ndërkohë filloi tortura e egër ndaj shqiptarëve, që kulmoi në dimrin e acart të viteve 1955/ 1956, kur me pretekstin e mbledhjes së armëve u rrahën për vdekje shumë shqiptarë, madje edhe gra. Për t'i shpëtuar vdekjes shumë djem e burra moren arratinë. Por sa më shumë që shtohej dhuna ndaj shqiptarit, aq më tepër shtohej urrejtja ndaj okupatorit serb. Popullit i kishte shkuar thika në asht. Rinia shqiptare e Kosovës më 1968 e 1981 i tregoi botës se nuk pranoni të jetonin në robëri. Më vonë shqiptarët iu kundërvurën me armë edhe politikës gjenocidiale të Sllobodan Millosheviqit. Edhe tani akoma nuk mund të dihet kufiri i ndaljes së politikës ekspansioniste të Serbisë, sepse presionet ndaj shqiptarëve, por në forma diplomatike, nuk kanë të ndalur.

Prandaj, bazuar në politikën ekspansioniste të pushtetarëve serbë ndaj shqiptarëve nëpër të gjitha etapat kohore, konkludojmë se "Naçertania" pati ndikim permanent në frymëzimin e pushtetarëve serbë për okupimin e trevave autoktone të shqiptarëve. Ajo i frymëzoi intelektualët serbë me frymën e ultranacionalizmit dhe mbolli dasi ndërmjet shqiptarëve e serbëve duke krijuar një hendek përçarës ndër këta dy popuj. E kam të qartë devizën se populli, cilidoqoftë ai, për ushtrimet ekspansioniste nga ana e pushtetarëve ndaj një populli tjetër, s'mund të jetë fajtorë, por fajtorë janë pushtetarët, sepse ata frymëzojnë dhe diktojnë që të ushtrohet dhunë.

[45]V.Çubriloviq, Istoria politikçke misli u Serbiji XIX veka, Beograd, 1958, pg. 175-176. Vep e cituar:shih Marenglen Verli: "Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli", Tiranë, 2007, fq. 28.

[46] Marenglen Verli: Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli". Tiranë, 2007, fq. 28.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

FORMAT E KOMUNIKIMIT MES MENAXHERËVE DHE STAFIT

DAFINA OLLONI

Abstrakti

Kemi dëgjuar shumë të flitet për format e komunikimit të cilat bëhen në mes të menaxherit të një kompanie me stafin e tij dhe rëndësin e këtij komunikimi. Në shoqërinë tonë ndihet nevoja për përmirsuar këto forma dhe për të analizuar më gjerësisht në mënyrë që të identifikohen se cilat forma përdoren. Nevojë për komunikim të mirë, kemi edhe në shtëpitë tona, në qendrat e punës ku punojmë, në marrëdhëniet me njerëzit, qofshin ato private apo publike etj. Këtë nevojë për komunikimin e qartë dhe të drejtëpërdrejtë ekemi sepse duam që ai të na prijë përpara drejt së ardhmes.

I konceptuar si një ndër elementet më të nevojshëm në punën e menaxherit, aq më tepër në ditën aktuale të ndryshimeve të vrullshme, komunikimi nëse trajtohet me kujdes dhe orientohet nga kriteret shkencore do të performojmë me vlera të pallogaritshme.

Megjithëse komunikimi është i rëndësishëm, mendoj se në vendin tonë pjesa dërrmuese e organizatave e anashkalojnë rëndësinë e tij duke lënë shkas në këtë mënyrë për keqkuptime dhe lindje konfilktesh.

Abstract

We have heard much talk about the forms of communication that are being made between a company manager and his staff and the importance of this communication. In our society, there is a need to improve these forms and to analyze them more widely in order to identify what forms are used. Needing good communication, we also have in our homes, in the work centers where we work, in relationships with people, whether private or public, etc. This need for clear and direct communication is ours because we want him to lead us forward to the future.

Perceived as one of the most necessary elements in the work of the manager, more so on the actual day of rapid changes, communication if carefully treated and oriented by the scientific criteria will perform with incalculable values.

Although communication is important, I think that in our country the vast majority of organizations overlook its importance, thus causing misunderstandings and births of confusions.

1. Kuptimi dhe rëndësia e komunikimit

Komunikimi nënkupton proçesin e kalimit të informacionit, ideve ose mendimeve tek përsonat e tjerë. (Andri Koxhaj, 2006) Komunikimi kërkon që të gjitha palët të kuptojnë një gjuhë të përbashkët që mund të shkëmbehet, paraqet procesin e kalimit të informatave nga burimi përmes rrugëve të mesme deri te pranuesi, si dhe kalimin e reagimit të pranuesit përmes rrugëve të mesme deri te burimi. Fjala komunikim rrjedh nga fjala latine „communico", nga „communis" ose nga fjala "common" (Carolyn

Mikanowicz, Shelda Shank, 2010) Komunikimi si i tillë në procesin e vet përfshin dy ose më shumë persona. (Wikipedia, 2017)

Komunikimi, është sistem i operacioneve të ndryshme të cilat përfshijnë:

- Gjuhë (fjalim),
- Gjeste,
- Simbole përmes të cilave përcillet qëllimet,
- Mendime ose shkëmbehet përvojë. (Carolyn Mikanowicz, 2010)

Komunikim! - Duket sikur është shumë e thjeshtë: thoni atë që mendoni dhe të tjerët do t'ju kuptojnë. Por në fakt, ajo që shpesh ndodh është shumë ndryshe, ajo që përpiqemi të komunikojmë, humbet në përkthim, pavarësisht qëllimeve tona më të mira. Ne themi një gjë, personi tjetër dëgjon diçka tjetër, dhe keqkuptimet, frustrimi, dhe konfliktet pasojnë. (Linked In, 2016)

Komunikimi është aktivitet i rëndësishëm për të gjitha funksionet e menaxhmentit. Rëndësia e komunikimit për menaxherin qëndron në faktin se pjesën me të madhe të kohës ia kushton komunikimit. Komunikimi paraqet mjetin metë cilin e bindim e informojmë e motivojmë dhe e udhëheqin individin kah qëllimi gruporë. (Mazreku, 2010)

Në një organizatë komunikimi ka dy qëllime parësore:

Së pari na jep mjetet me anën e të cilave do të mund të arrijmë objektivat e detyrës. Mënyrën se si planet që do të zbatohen dhe veprimet që do të kryhen u përcillen punonjësve dhe koordinohen për tu realizuar.

Së dyti komunikimi siguron mjetet me anën e të cilave individët nxiten të punojnë për përmbushjen e plaveve me vullnetin e tyre dhe me entusiazëm. (Kolegji AAB, n.d.)

Kjo, gjithashtu, i shpreh ndjenjat ose që është shumë më e rëndësishme sjellja e njerëzve. Zakonisht thuhet se çdo sjellje është komunikim, ndërsa çdo komunikim shkakton sjellje. (Carolyn Mikanowicz, 2010)

Elementet kyçe të komunikimit:

- Komunikuesi,
- Procesi i kodimit
- Mesazh
- Mjeti
- Procesi i dekodimit
- Marrësi
- Feedbacku
- Zhurma (Andri Koxhaj, 2006, pp. 14-18)

Rëndësia e komunikimit në një organizatë mund të përmblidhet si më poshtë:

Organizatat dhe komunikimi

-Një organizatë mund të udhëhiqet nga një mision i vetëm ose të mbështetet gamë arsyesh të ndyshme për ekzistencën e vet. (M.J.Papa, 2014)

Komunikimi nxit motivimin duke informuar dhe sqaruar punonjësit në lidhje me detyrën që kanë për të bërë, mënyrën se si ata do e kryejnë atë, dhe si mund të përmirësojnë performancën e tyre në qoftë se ajo nuk është në lartësinë e duhur.

Komunikimi është një burim informacioni për anëtarët e organizatës gjatë procesit të vendimmarrjes, ndërsa ndihmon identifikimin dhe vlerësimin alternativ të veprimeve.

Komunikimi gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në ndryshimin e qëndrimeve individuale, dmth, një individ i informuar mirë do të ketë qëndrim më të mirë se sa një individ i painformuar. Revistat organizative, artikujt, takime dhe forma të tjera të ndryshme komunikimi, të folur dhe të shkruar, ndihmojnë në dhënien formë të qëndrimeve të punonjësve.

Komunikimi gjithashtu ndihmon në shoqërizim. Në jetën e sotme, vetëm prania e një individi nxit komunikimin. Thuhet gjithashtu se njeriu nuk mund të mbijetojë pa komunikim.

Siç u diskutua më parë, komunikimi gjithashtu ndihmon në procesin e mbikqyrjes dhe kontrollit. Ai ndihmon për të mbikqyrur sjelljen e anëtarëve të organizatës, në mënyra të ndryshme. Ka nivele të ndryshme të hierarkisë dhe disa parime dhe udhëzime që punonjësit duhet të ndjekin në një organizatë. Ata duhet të jenë në përputhje me politikat organizative, të kryejnë rolin e tyre të punës, në mënyrë efikase, dhe të komunikojnë cdo problem pune dhe ankesë për eprorët e tyre. Kështu, komunikimi ndihmon në kontrollin e funksionit të menaxhimit.

Një sistem efektiv dhe efikas komunikimi kërkon aftësi menaxheriale në dërgimin dhe marrjen e mesazheve. Një menaxher duhet të zbulojë pengesat e ndryshme të komunikimit, të analizojë arsyet për ndodhjen e tyre dhe të marrë masa parandaluese për ti shmangur ato. Kështu, përgjegjësia kryesore e një menaxheri është të zhvillojë dhe të mbajë një sistem efektiv të komunikimit në organizatë. (Linked In, 2016)

1.3. Komunikimi Efektiv

1.3.1. Komunikimi efektiv është gurë themeli për organizatat e suksesshme

Komunikimi efektiv është i rëndësishëm për drejtuesit e organizatave në mënyrë që të kryejnë funksionet themelore të menaxhimit, si, planifikimin, organizimin, drejtimin dhe kontrollin.

Komunikimi i ndihmon menaxherët për të kryer punët dhe përgjegjësitë e tyre. Komunikimi shërben si bazë për planifikim. Të gjitha informacionet e domosdoshme duhet t'i komunikohen menaxherëve, të cilët për rrjedhojë, duhet të komunikojnë planet dhe mënyrën si duhen zbatuar ato punonjësve. Organizimi gjithashtu kërkon komunikim efektiv me të tjerët, në lidhje me detyrat e tyre në punë. Në mënyrë të ngjashme, liderat si menaxherët, duhet të komunikojnë në mënyrë e-fektive me vartësit e tyre, në mënyrë që të arrijnë objektivat e ekipit. Kontrolli nuk është i mundur pa komunikim me shkrim dhe me gojë.

Menaxherët i kushtojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre komunikimit. Atyre në përgjithësi u duhen rreth 6 orë në ditë për të komunikuar. Ata kalojnë një kohë të gjatë në komunikimin e ballë për ballë ose telefonik me eprorët, vartësit, kolegët, klientët ose furnitorët. Menaxherët përdorin edhe komunikimin me shkrim në formën e letrave, raporteve apo memorandumeve, kudo ku komunikimi me gojë nuk është i përshtatshëm.

Kështu, mund të themi se "komunikimi efektiv është një gur themeli për organizata të suksesshme". Me fjalë të tjera, komunikimi vepron si “gjaku organizativ”. (Linked In, 2016)

Komunikimi efektiv në organizatë është më shumë se aftësia e individëve, për të shkruar një raport, email apo prezentim. Përkundrazi është një mori aftësishë, individuale, grupore dhe organizative, që promovojnë ndërlidhjen e të punësuarve dhe grupeve të ndryshme në organizatë

Nga aspekti strategjik, përmirësimi I komunikimit në organizatë ndikon në performancën e organizatës në aspektin inovacioneve, vendimarrjes, vizionit.

Aftësit e komunikimit janë:

1. Teknike (njohja e teknologjisë së informacionit)
2. Linguistike (të folurit e mirë dhe të pasur, njohja e gjuhëve të huaja)
3. Kulturore (tiparet e ndryshme kulturore)

Të ndërtuarit e komunikimit efektiv në kuadër të organizatës:

- Identifikimi i kërkesave të brendshme dhe të jashtme për komunikim.
- Identifikimi i resurseve për komunikim.
- Identifikimi i barrierave (proceset, aftësitë personale, teknologjitë, standardet) (Dr. Mrika Kotorri, 2017)

Komunikimi efektiv midis menaxherëve dhe të punësuarve e zmadhon kënaqësinë dhe kryerjen e punëve, realizohet më me sukses, zvogëlohen mundësitë për oportunizëm, konfuzion dhe sjelljen e vendimeve të gabuara ose të kuptuarit gabim të vendimeve veç më të sjella.

Komunikimi efektiv midis menaxherëve dhe të punësuarve e zmadhon kënaqësinë e të punësuarve nga arsye që konsiderojnë ata:

- Marrin pjesë në krijimin e vizionit dhe vlerave të organizatës
- E dinë rolin e tyre, që duhet të arrihet dhe çfarë ajo do t'u sjell

ndjehen të informuar për të gjitha punët në organizatën dhe besojnë se mendimet e tyre dhe pamjet vlerësohen.

Barrierat më kryesore të komunikimit në biznes konsiderohet se janë këto:

- Barrierat gjuhësore
- Shpërqendrimet
- Informacioni i tepërt
- Kufizimet mjedisore
- Diferencat perceptuese dhe
- Taktikat dezinformuese

Në anën tjetër komunikimi efektiv nënkupton;

- Minimizim të shpërqendrimeve

- Marrja në konsideratë e audiencës
- Dhënia dhe pranimi i vlerësimeve apo komplimenteve
- Përmirësimi i aftësive dhe
- Aplikimi i etikës biznesore (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010)

1.4. Llojet e komunikimit dhe karakteristikat e tyre

1.4.1. Komunikimi verbal

Kjo formë e komunikimit realizohet përmes fjalëve të folura ose të shkruara. Kjo mund të jetë fytyrë në fytyrë (face to face), përmes telefonit, përmes sistemit video konferencë. Forma e shkruar e komunikimit mund të jetë në formë të letrës, memorandumit, raportit dhe ngjashëm. (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010) Është i rëndësishëm jo vetëm në komunikimin e përgjithshëm por edhe në komunikimet zyrtare. Suksesi i komunikimit verbal në shkallë të lartë nvarët në atë se sa ju jepet rëndësi elementeve të këtij komunikimi të cilët janë: shpejtësia e të folurit, zgjedhja e fjalëve, tempoja e të folurit etj.

Gjatë kominikimit verbal duhet të i jepet më shumë vëmendje mënyrës se si tingëllon ajo që e themi. Duhet pasur kujdesë për lartësinë e zërit. Folja e shpejtë mund të jetë pengesë e komunikimit ashtu që ai që e pranon porosinë mund që të lëshojë diqka nga porosia e pranuar, ndërsa nëse fjalimi është monoton atëherë paraqi.tet reziku që të paraqitet mosinteresim për temën. (Erhan Krasniqi, 2011)

Kur njerëzit meditojnë për komunikimin e fjalës, shpesh mendojnë për aktin e të folurit. Ne mbështetemi në komunikimin verbal për të shkëmbyer mesazhe me njëri-tjetrin dhe të zhvillohemi si individë. Termi komunikim verbal shpesh evokon idenë e komunikimit të folur, por komunikimi me shkrim gjithashtu është pjesë e komunikimit verbal. Duke lexuar këtë libër, po dekodon komunikimin verbal të shkruar të autorëve për të mësuar më shumë rreth komunikimit. Le të shqyrtojmë komponentët e ndryshëm të përkufizimit tonë të komunikimit verbal dhe të shqyrtojmë se si funksionon në jetën tonë.Komunikimi verbal ka të bëjë me gjuhën, të shkruar dhe të folur. Në përgjithësi, komunikimi verbal i referohet përdorimit të fjalëve tona.

1.4.2. Komunikimi joverbal

Kjo formë e komunikimit do të thotë përcjellje e porosive në atë mënyrë që nuk është me sprehura të folura ose të shkruara. Përcjellja e porosive realizohet më bërjen e shprehjeve të ndryshme të fytyrës, me lëvizjen e trupit, me sytë, me veshjen, të heshturit, etj. (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010) Komunikimi jo verbal e përmison komunikimin e përgjithshëm. Komunikimi jo verbal është posaqërisht i rëndësishëm gjatë bisedimeve, marveshjeve, prezentimeve etj.Përveq ndëgjimit të oponentit gjatë shprehjes së dëshirave dhe nevojave personale, me vëmendje duhet që të ndiqen gjestet të cilat i bën gjatë të folurit. Folësi duhet të ndëgjohet dhe të ndjekjet me vëmendje me anë të syve. (Erhan Krasniqi, 2011)

Shprehjet e fytyrës Disa shkencëtarë besojnë se shumë shprehje të fytyrës si buzëqeshja, të qeshurit dhe të qarët janë universale dhe të pranishëm në të gjitha kulturat dhe se kanë një bazë gjenetike. Për shembull përshëndetja e një personi të njouhur, nga ana jonë, me shumë mundësi mund të realizohet me ngritjen e vetullave. Eibl-Eibesfeltdt më 1972 zbuloi se ngritja e vetullave përpjetë ekziston si e tillë në shumë lloje kulturash. (Eibl-Eibesfeld, 1972)

Gjuha e trupit Janë domethënëse ato të duarve dhe të kokës p.sh lëvizjet që përdorim për të përforcuar atë që po them. P.sh. OK bëjmë me gisht. PO – JO lëvizim kokën GRUSHTI është shenjë zemërimi. BASHKIMI bashkimi i duarve etj. Kthimi i kokës nga ana tjetër përballë një personi lë të kuptojë se nuk dëshirojmë të komunikojmë me të, mund të lëvizim këmbët nga stresi kur përpiqemi të gënjejmë dikë, etj. Komunikimi joverbal përmes gjesteve dhe lëvizjeve të trupit është më i dukshëm në situata emocionale. (M. Franciska (Suzana) Lekaj, 2015)

Në varshmëri të strukturës organizative të komunikimit, komunikimi mund të paraqitet në llojet si më poshtë:

Komunikimi afarist:

• Formal,

• Jo formal.

-Komunikimi formal (formal communication): Komunikimi formal është strukturuar në bazë të hierarkisë, autoritetit dhe përgjegjësisë. Me këtë formë të komunikimit sigurohet unitet në dorëzimin e informatave dhe vërtetohet përgjegjësia. Ky komunikim mund të jetë komunikim teposhtë, komunikim përpjetë dhe anësor. (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010) Komunikimi formal zakonisht ndjek linjat zyrtare të autoritetit dhe është në formën e shkruar, me logo dhe nënshkrim (që mund të jetë në letër apo në ditët e sotme shumë e më shumë bëhet në mënyrë elektronike), dhe vendoset në dosje apo arkiv për qëllime të evidencave institucionale. (Prof.Dr. Ramë Buja, 2011)

- Komunikimi jo formal (informal communi-cation): Ky komunikim realizohet jashtë kornizave të përshkruara dhe planifikuara formale ose kanaleve. Në vend të komunikimit formal që është krijuar dhe dokumentuar, komunikimi jo formal realizohet spontanisht dhe si dhënie e shënimeve midis hierarkisë organizative. Kjo nuk ka rregulla e as drejtime praktike. (Eastern Mediterranean University, 2010) Komunikimi joformal është kryesisht gojor, "jo zyrtar", njihet gjithashtu edhe si "hardhi rrushi". Qëllimin e ka që ta përcjellë informatën – dhe të ndikojë tek personat,të cilëve u drejtohet porosia – pa e vënë në detyrim personin nga i cili buron ajo. Kjo shpesh ndodh në grupe të njerëzve të cilët kanë lidhje personale, zakonisht ndërlidhet me besimin. Komunikimi joformal është gojor, apo mund të shprehet madje edhe përmes një shikimi të thjeshtë, shenje apo qetësie. (Prof.Dr. Ramë Buja, 2011)

Në varshmëri të mënyrës së komunikimit, llojet e komunikimit mund të jenë:

• Intrapersonale,

• Ndërpersonale,

• Publike,

• Masive.

-Komunikimi intrapersonal (intra - personal communication): paraqet dialog interno i cili ndodh në kokën e një personi.

-Komunikimi ndërpersonal (interpersonal communication): është komunikim midis dy ose më shumë personave. (Eastern Mediterranean University, 2010)

1.5. Metodat e komunikimit

Ekzistojnë disa metoda të komunikimit biznesor të cilat e bëjnë më interesant mënyrën e komunikimit.Këto metoda që konsiderohen edhe metoda të avancuara të komunikimit biznesor janë:

Takimet ballë për ballë

Të cilat janë takime që lejojnë më shumë mundësi bashkëveprimi duke bër pyetje dhe përgjigje. Ky lloj kontakti sy me sy, mundëson që njerëzit e lidhur në biznes me njëri tejtrin, të mund të komunikojnë më afërsisht në mes veti, duke e parë njëri tjetrin në sy dhe dukei lexuar edhe mimikën edhe shprehjen e fytyrës dhe gjithë karakteristikat tjera emocionale. Takimet sy me sy, mundësojnë shprehjen e reagimeve të menjëhershme dhe zgjidhjen më të shpejtë të problemeve apo situatave.

Letrat

Dërgimi i letrave të mbylluar, mesazheve të shkruara, broshurave, kartolinave etj bën që marrëi të kutpj ndoshta më lehtë mesazhin tuaj, duke lexuar me kujdes atë dhe i jep mundësi atij/asj që të analizojë më gjatë shkrimin tuaj dhe mandej të ndërmarr hapa për kthimin e përgjigjes në mënyrë të njëjtë.

Komunikimit elektronike

E-mailat, sm-sat dhe format tjera të komunikimit elektronik, mundësojnë çasje të menjëhershme në shumë persona, subjekte apo ndërmarrje. Mandej videokeonferencat janë formë e mirë e komunikimit, sepse zvogëlon koston, eliminon udhëtimet, strehimin shujtën, dhe problemet e tjera me kohën.

Reklamat dhe marrëdhëniet me publikun

Janë një metodë mjaft e avancuar e komunikimit në biznese të ndryshme. Sot firma të ndryshme përdorin mediume të ndryshme të komunikimit, si gazetat, revistat, radion, stacionet televizive, billbordet, vebsajtet dhe së fundi edhe portalet për reklamimin e produkteve dhe bartjen e mesazheve për interesa të kompanive të tyre.

Mediat sociale

Sot kanë bërë bujë duke arritur një shtrirje të madhe në gjithë botën edhe atë për një këhë të shkurtër. Këto media kanë vënë një lidhje, në bazë interesi me shumë ndërmarrje, të vogla, të mesme dhe korporata, me të vetmin qëllim përfitimin e përbashkët material. Rrjetet sociale si; google plus, facebook, tweeter dhe sajtet e njohura alibaba, eBay etj, janë bërë rrjete mjaft të përdorshme sociale në shërbim ë bizneseve dhe ekonomisë. (Kujtim Baraliu, 2016)

1.6. Format e komunikimit

1.6.1. Komunikimi në organizatë

Një aspekt i rëndësishëm i komunikimit efekyiv person me person është besim.Në qoftë se punonjësit e ndiejnë që opinioni secilit vlerësohet, ata do të komunikojnë me lart më shpesh, me besim dhe me bindje.Komunikimi paraqet procesin në të cilin informatat dhe kuptimet barten nga një përson në përsonin tjetër.

Në organizata kemi këto lloje të komunikimit:

- Komunikimi nga lartë-poshtë.
- Komunikimi nga poshtë-larët.
- Komunikimi horzontal
- Komunikimi diagonal

Komunikimi nga larët-poshtë- nga niveli i laret tek i ulet te organizatat afariste komunikimi "lartë" bëhet kryesisht në këto fusha: raportet mbi afarizmin, ceshtjet rreth kuadrit (rekomandimet për ndërrime, gradime apo përparime, problemet rreth planeve dhe buxhetit, çështje të tjera financiare e të ngjashme). Komunikimi në nivel të organizatës, qoft si komunikim me "poshtë" apo me "lartë", është në njëfarë mënyre udhë dy drejtimeshe për organizatën kjo bën të mundshëm funksionimin informativ apo komunikues midis "majës" së piramidës (nievele të larta hierarkike) dhe bazese së piramidës (niveleve më të ulëta organizativo – hierarkike). (Slide Share, 2011)

Komunikimi nga lart-poshtë klasifikohet në këto forma:

a) Direktiva specifike për detyrat ku përfshihen instuksionet e punës.
b) Informacione në lidhje me kuptimin e detyrave specifike dhe rolit të tyre në organizatë (qëllimet e punës).
c) Informacione mbi proçedurat dhe praktikat e punës.
d) Feedbacku mbi performancën e vartësve.
e) Informacioni për misionin.

Komunikimi nga poshtë-larët -Nga niveli i ulët gjer te ato të lartë apo nga punëtoret e gjer te këshilli drejtues. Besimi është një element tjetër mjaft irëndësishëm që i lehtëson komunikimin nga poshtë-lartë.Kjo sepse vartësi priret të japë informacionin e duhur kur e di që shefi i tijë mund të marrë informacionin e saktë nga burimet të tjera alternative. (Andri Koxhaj, 2006)

Komunikimi horzontal - si fluks i informacionit ndërrnjet njerëzve të cilat ndodhen në të njëjtin nivel hierarkik në organizatë, është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për manaxherët por edhe për punonjësit e tjerë. Kanali horizontal mundeson rrjedhen laterale të porosive, u mundeson njesive organizative bashkepunim midis vete pa ndonje kushtëzim formal – mekanik te komunikimit menivele te larta apo te uleta. (Slide Share, 2011) Komunikimi horizontal është i nevojshëm për koordinimin e funksioneve të ndryshme organizative, p.sh. mes prodhimit dhe shitjes në një organizatë biznesi apo midis departamenteve të ndryshme të një spitali. (Andri Koxhaj, 2006)

Komunikimi diagonal - është koncepti më pak i përdorshëm në organizatë, ai është i rëndësishëme përdoret në ato situata kur nuk mund të përdoren me efektivitet kanalet e tjera të komunikimit. (Slide Share, 2011) Përshembull: drejtuesi i një departamenti në një organizatë të madhë, mund të kërkojë tërheqjen e një informacioni nga një sektor tjetër. Kështu fluksi i komunkimit do të ishte diagonal në vend që të ishte nga poshtë-lartë dhe më pas horizontal. Në këtë rast, përdorimi i një kanali diagonal do të minimizonte kohën dhe përpjekjet e tepërta që rezultojnë në organizatë. (Andri Koxhaj, 2006)

1.6.2. Shtatë "C-te" e Komunikimit

- ✓ Tërësia (**Completeness**) - sigurimi i të gjithë informacionit të domosdoshëm, përgjigja ndaj të gjitha pyetjeve të bëra, sqarime plotësuese kur ato dëshirohen.
- ✓ Koniciziteti (**Conciseness**)- të eleminohen shprehjet dhe fjalët e shumta, të përfshihen vetëm materialet që lidhjen me cështjen, të shmangen përsëritjet e panevjshme
- ✓ Konsiderata (**Consideration**) - fokusi tek "JU" dhe jo "TI", "NE" jo "UNË". Thkesimi i pëfitmit të audiencës, listimi i fakteve pozitive dhe të mira.
- ✓ Konkretësia (**Concreteness**) - përdorimi i fakteve dhe shifrave specifike, gjatë diskutimit foljet duhen vepruese dhe aktive, zgjedhja e falëve të gjalla.
- ✓ Qartësia (**Clarity**) - zgjedhja e fjalëve precize, konkrete dhe të njohura.
- ✓ Kortezia (**Courtesy**) - sjellja e matur dhe vlerësuese ndaj tjetrit, përdorimi i shprehjeve që tregojn respekt, zgjedhja e shprehjeve jo diskriminuese.
- ✓ Korrektësia (**Correctness**) - përdorimi i gjuhës së përshtatshme, kontrolli I saktësisë, fakteve dhe fjalëve, ruajtja e etikës. (Pranvera Rrapushi, 2015)

1.7. Procesi i dëgjimit

Figure 1 Listening and Nonverbal Communication, Chapter 8, Copyright © 2001 South-Western College Publishing Co

Çka do të thotë të dëgjohet në mënyrë aktive? Dëgjimi aktiv do të thotë përcjellje dhe respektim i procedurave në vijim: (Kellie Fowler, 2005)

1. Të njihet stili personal i komunikimit.

Stili i mirë i komunikimit kërkon nivel të lartë të ndërgjegjësimit. Të kuptuarit e stilit personal të komunikimit, krijon mundësi për ndërtim fotografi të mirë dhe impresiono se të tjerët munden lehtë të komunikojnë me dikë, e pranojnë për shkak se edhe ai i pranon dhe e përshtat stilin e tij të komunikimit, ashtu siç këtë e bëjnë edhe të tjerët. Adaptimi i stilit të komunikimit drejt të tjerëve nuk do të thotë se

ndonjë njeri është kameleon i cili ndryshon ne secilën situatë, respektivisht ndryshohet drejt secilit personalitet që do ta takojë. Në të kundërtën, me adaptimin e stilit të komunikimit, mundësohet secili njeri me të cilin komunikohet të ndjehet më i lirë, të zgjedh si do të sillet, dhe ai do të përshtatet në komunikimin e tillë. Sjellja e tillë do të thotë njeriu të jetë dëgjues aktiv.

2. Të jetë dëgjues aktiv.

Njerëzit flasin prej 100 deri 175 fjalë në minutë, por mund të dëgjojnë prej 600 deri 800 fjalë në minutë, por vetëm me një kusht të kushtohet vëmendje e plotë asaj që flitet. Por, duke pasur parasysh faktin që vetëm një pjesë e trurit kushton vëmendje dëgjimit kjo kryhet me vështirësi.

Thelbi i kësaj procedure është, jo vetëm të dëgjohen zëra, respektivisht fjalë, por duhet të dëgjohet me qëllim të caktuar. Kjo do të thotë të dëgjohet që të fitohen informata, të pranohen drejtime, të kuptohen të tjerët, të zgjidhen problemet, të ndahen interesat, të shikohet si të tjerët ndjehen, të jepet përkrahje dhe ngjashëm.

3. Të përdoret komunikimi jo verbal.

Sjellja jo verbale duhet të përdoret që të forcohet komunikimi ndër personal. Kjo përfshin shprehje të fytyrës siç janë: buzëqeshja, gjestet, kontakti me sytë dhe qëndrimet e trupit. Komunikimi joverbal tregon se dëgjohet në mënyrë aktive dhe se komunikimi do të realizohet me kohë dhe pa mos marrëveshje.

4. Të jepen informata kthyese.

Duhet të dihet se ajo që është thënë nga dikush është dëgjuar nga tjetri, mund të jetë e ndryshme në mënyrë befasuese. Dëgjimi selektiv, qasja, vlerësimi dhe besimet mund ta përdorin atë që është dëgjuar. Që të shmanget kjo, e nevojshme është të përsëritet ajo që është dëgjuar ose të bëhet rezyme që të fitohet besim se ajo që është dëgjuar është kuptuar. Nëse diçka nuk është kuptuar, mirë është të pyetet dhe të kërkohen më tepër informata. Informatat kthyese si mjet për komunikim verbal përdoren që të tregohet se dëgjuesi është aktiv dhe e vërteton komunikimin. (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010)

Sjelljet gjatë dëgjimit aktiv:

Figure 2 Robins Coulter: Managerial Communication and Information Technology, Prentice Hall, 2002

Shprehi të këqija të dëgjimit

Këto elemente e dëgjimit të keq quhet edhe shprehi të këqija dëgjuese të cilat klasifikohen si:

- Ndërprerje të folësit,
- Mos shikimi në folësin,
- Sulmimi i folësit dhe sjellja e tij në gjendje të ndjehet se e shpenzon kohën e dëgjuesit,
- Të treguarit e interesit për diçka tjetër, dhe jo për atë që flitet,
- Shkuarja para që folësi ta përfundojë fj alimin,
- Mos dhënia e përgjigjes pyetjeve të parashtruara nga folësi,
- Mos orientimi drejt porosisë,
- Dëgjimi pasiv. (D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski, 2010)

Hapa drejt dëgjimit më të mirë

Si të dëgjohet më aktiv është një nga çështjet kryesore në të cilën përgjigjja për atë si të dëgjohet shtrihet në sjelljen dhe të menduarit "dëgjo siç dëshiron edhe ty të të dëgjojnë". Që të realizohet dëgjim i mirë, ai që dëgjon duhet të kushtojë kujdes në rregulla të caktuara të cilat shprehen si rregulla të dëgjimit aktiv.

- Ballafaqimi me bashkëbiseduesin fytyrë në fytyrë,
- Mbajtja e kontakteve me sytë,
- Zvogëlimi i zhurmës së jashtme,
- Me përgjigje të tregohet se kuptohet ajo që flitet, (dremitje të kokës, ngritja e vetullave, të shprehurit me fj alët "kuptoj", "në të vërtetë", "interesant")
- Të drejtuarit drejt bashkëbiseduesit,
- Zvogëlimi i pengesave të brendshme gjatë të folurit,
- Të ketë lidhje aktive,
- Përsëritja me fjalë personale,
- Dhënia e përgjigjes kthyese.

Dëgjimi aktiv është drejtimi i kujdesit drejt asaj që nxjerrë personi që flet dhe dhënia përgjigjes kthyese me të cilën do të vërtetohet se është pranuar porosia. (Kellie Fowler, 2005)

Metodologjia

Metodologjia që do të ndiqet

Metodologjia e ndjekur për kryerjen e studimit duhet shprehur qartë, dhe të jepen të dhëna mbi kampionin, popullatën nga është nxjerrë, mënyrën e kampinonimit, teknikat e përdorura ne studim sasiore apo cilësore etj. Para së gjithash kandidati duhet të përkufizojë llojin e qasjes kërkimore për

problemin e zgjedhur. Në rastet kur tema e kërkimit është kryesisht teorike dhe nuk kërkon metodologji empirike, ky kapitull përfshin zakonisht këto elementë.

Unë në këtë hulumtim kam përdorur metodën kuantitative apo sasiore për mbledhjen e të dhënave. Metodat sasiore e mbledhjes së të dhënave mbështeten në marrjen e kampioneve të rastit dhe të strukturuara ne te dhënat që i përshtaten përvojave të ndryshme në kategori të paracaktuara. Kjo metodë mendoj që prodhon rezultate që janë me të lehtë për tu përmbledhur, krahasohen dhe përgjithësohen. Kerkimi sasior është i shoqeruar me hipoteza që rrjedhin nga teoria për të qene me në gjendje për të vlerësuar hipotezat e një fenomeni të caktuar.

Mostra, popullata dhe pjesëmarrësit

Për të pasur një mostër sa më përfaqësuese të popullsisë, me një mundësi përzgjedhjeje të njëjtë apo të llogaritshme për çdo punonjës në moshë madhore të ndërmarrjeve ku do kryej rastin e studimit, është hartuar një skemë e kujdesshme kampionimi.

Territori i ku jam fokusuar për të kryer rastin e studimit nuk ka qenë edhe shumë i madh ka përfshirë disa kompani hoteliere apo ndryshe të themi disa zona funksionale sipas variantit me më shumë zona të propozuar. Për secilën zonë është llogaritur numri i punonjësve të anketuar sipas numrit të punonjësve të regjistruar në vitin 2017. Kjo popullsi e këtyre zonave përfaqëson "popullatën" nga e cila do të përzgjidhet mostra për atë zonë specifike. Pra janë disa mostra përfaqësuese të zonave funksionale të propozuara.

Për këtë studim u realizuan 100 pyetsor me pyetje të mbyllura (opsionale) në disa kompani hoteliere në komunën e Gjakovës. Pjesëmarrësit në pyetësor u kërkasin grupmoshave dhe kulturave të ndryshme mirëpo që janë në qendër të këtij hulumtimi. Pyetsorët u shprendan tek punonjësit në kopje fizike, ku pas u analizuan. Nga pyetsorët u nxorën përgjigje të ndryshme ku kishte pohime dhe mohime varësisht nga mendimi i të anketuarve. Më pas u bë një analizë më e hollësishme për nxjerrjen e të dhënave duke i shprehur në grafike.

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave, variablat dhe materiali

Mbledhja e të dhënave është një aspekt i rëndësishëm i çdo lloj studimi kërkimor. Mbledhja e pasaktë e të dhënave mund të ndikojë në rezultatet e një studimi dhe përfundimisht të çojë në rezultate të pavlefshme. Mbledhja e të dhënave paraqet pothuajse pjesën me të rëndësishme të një hulumtimi. Të dhënat përfshijnë te gjithë informacionin që mblidhet gjate një studimi por qe ende nuk është analizuar dhe përpunuar. Do me thëne quhen të dhëna te gjitha informacionet qe merren dhe i nënshtrohen analizës se përpunimit metodologjik. Për të ekzaminuar te dhënat studiuesi përpiqet te gjej rrugën qe e ndihmon për te kuptuar problemin ose fenomenin që ka në shqyrtim. Mbledhja e të dhënave ose koleksionimi i të dhënave është procesi i mbledhjes dhe matjes të informacioneve në për variabla të caktuara nga modeli i një sistemi, të cilat pastaj mundësojnë përgjigjen për pyetjet përkatëse dhe të vlerësoj rezultatet. Komponenti i mbledhjes së të dhënave në hulumtim është i ngjashëm për të gjitha fushat e studimit duke përfshirë shkencat fizike dhe sociale, shkencat shoqërore dhe të biznesit. Përderisa metodat ndryshojnë sipas disiplinës, me theks të veçantë në sigurimin e saktë dhe të ndershëm, koleksionimi mbetet i njëjtë. Qëllimi për të gjithë mbledhjet e të dhënave është që të merret evidencë

kualitative të cilat më pas përkthehen për të pasur analizë të të dhënave dhe të lejojë ndërtimin e përgjigje bindëse dhe të besueshme për pyetjet që janë shtruar.

Në këtë hulumtim është përdorur metodat sasiore e mbledhjes së të dhënave për realizimin e kërkimit që kam synuar. Pyetsori është përdorur në tekniken e mbledhjes së të dhënave ku mbështetet në marrjen në pyetje të kompanis të cilën e përzgjedhim për kryerjen e rastit studimor. Në pjesën hyrëse të pyetësorit janë dhënë shpjegime të hollësishme për pjesëmarrësit në hulumtim, përmes së cilave është sqaruar lloji i hulumtimit dhe qëllimi i tij. Pyetësori është i përbërë nga gjithsej dhjetë [15] pyetje. Secili nga pyetjet, përmban informacione rreth formave të komunikimit dhe udhëzime se si të plotësohen përgjigjet në atë seksion. Përmes pyetjeve të sistemuara në seksionin e parë të pyetësorit, janë mbledhur të dhënat e përgjithshme nga pjesëmarrësit në hulumtim, dhe ato i referohen informacioneve për gjininë e punonësve, dhe grupmoshën të cilës i përkasin. Ku rezultatet e nxjerrura janë paraqitur në formë të grafikeve. Tek pjesa e shtojcës do ta gjeni të plotë pyetsorini i cili është zbatuar në disa ndërmarrje në komunën e Gjakovë.

Variablat:

Variablat njihen edhe si ndryshorë dhe paraqesin një koncept i matshëm, Variablat mund te mendohen si rregulla për klasifikimin e njerëzve, qëndrimeve, besimeve etj ne kategori te ndryshme.

Variablat e pavarura- *janë variabla që mendohet se influencojnë fenomenin që kemi objekt studimi.*	**Variablat e varura-** *janë ndryshorët të cilët studiuesi përpiqet t'i parashikoj, pikërisht reagimin e variablave të varur duam të shohim dhe të masim në një studim kërkimor.*
Komunikimi	Motivimi
Aftësitë dhe Mjeshtritë	Produktiviteti
Feedbacku	Kënaqësia në punë

Procedurat për analizimin e të dhënave

Për këtë punim kam përdorur metodën sasiore të mbledhjes së të dhënave, respektivisht është përdorur pyetësori për mbledhjen e të dhënave. Ndërsa për të analizuar këto të dhëna. Është përdorur teknika e kontaktimit të drejtëpërdrejtë, dhe kanë qenë të angazhuar personalisht për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Hulumtimi u bë në disa kompani hoteliere në komunën e Gjakovës. Pasi kam marrë pyetësorët e plotësuar nga kompanitë kam filluar me klasifkimin e përgjigjeve duke i radhitur në bazë të rëndesis dhe në fund kam ardh me konkluzione të përgjithshme për secilen pjesë të pyetësorit.

Bibliography

Kellie Fowler. (2005). *“Active Listening",“Hear What People are Really Saying”.*

AAB. (n.d.). Retrieved from https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/824/4e46ee62-bf21-4070-837d-c36bd1ddd42e.pdf?sequence=1&isAllowed=y

Alba Dumi. (2016). *Lidershipi dhe dallimet menaxhuese.* Vlore.

Andri Koxhaj, F. T. (2006). *Menaxhimi i komunikimit.* Tiranë.

Carolyn Mikanowicz, S. S. (2010). *„Communication Strategies”.*

Carolyn Mikanowicz, Shelda Shank. (2010). *„Communication Strategies".* National Center of Continuing Education.

D-R Aleksa Stamenkovski D-R Boshko Jaqovski. (2010). *"Komunikimi Afarist".* Shkup: Ministria e arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë.

Dr. Mrika Kotorri. (2017, November 15). *Slide Share*. Retrieved from Slide Share: https://www.slideshare.net/fatonbajrami1/komunikim-biznesi-dr-mrika-kotorri-sllajdet-e-ligjratave

Eastern Mediterranean University. (2010). Retrieved from Chapter 1: Achieving Success Th rough Eff ective Business Communication, sllajdet 5-10: business.emu.edu.tr/portal/iiles/lecturenotes/96jilIu.jWiao

Eibl-Eibesfeld. (1972). *Love and hate: The natural history of behaivior patterns.* New York.

Erhan Krasniqi. (2011, November 4). *Menaxherat*. Retrieved from Menaxherat: http://menaxherat.com/media/komunikimi/

Izet Zeqiri. (2016). *Albiz.* Retrieved from Albiz: http://albiz.org.mk/faqja/wp-content/uploads/2017/01/Bazat-e-menaxhimit-Bashk%C3%ABkohor-Izet-Zeqiri-2016.pdf

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

PARASHTRIMII PYETJEVE EFEKTIVE TË MËSIMDHËNËSVE DREJTUAR NXËNËSVE TË KLASAVE TË ULËTA NË SHKOLLAT

Ma. Digjle Namligji- Mësimdhënëse në SHFMU Fadil Hisari" Prizren

ABSTRAKTI

Në këtë studim do të trajtohen çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me rolin dhe funksionimin e zbatimit të pyetjeve efektive gjatë orës mësimore tek nxënësit e klasave të ulëta në shkollat fillore të qytetit të Prizrenit. Duke pasur parasysh se pyetjet ndihmojnë që nxënësit dhe mësimdhënësit të ndërveprojnë në mes vete nëpërmjet këtij punimi do të pasqyrojmë nivelin e përdorimit të pyetjeve efektive si dhe ndikimin e tyre në aktivizimin dhe motivimin e nxënësve gjatë orës mësimore në klasat e ulëta të shkollave fillore.Ky punim do të shërbejë për të kuptuar ndikimin e të pyeturit në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve si dhe nivelin e zbatimit të tyre nga mësimdhënësit e klasave të ulëta të shkollave fillore të Prizrenit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë llojet e përdorimit të pyetjeve si dhe qëllimin e zbatimit e të tyre si indikator i rritjes së suksesit të nxënësve te klasat e ulëta në shkollën fillore.

Pyetjet e hulumtimit janë; ,,Cilat lloje të pyetjeve parashtorohen nga mësimdhënësit e shkollave fillore?", ,,Cilat janë qëllimet e pyetjeve të parashturara në klasat e ulëta?", ,,Si qëndron raporti ndërmjet përdorimit të pytjeve të llojeve të ndryshme?

Hulumtimi do të realizohet gjithësej në 10 shkolla të qytetit të Prizrenit. Pesë prej tyre do të jenë shkolla urbane si, psh: SH.F.M.U ,,Fadil Hisari", ,,Mustafa Bakiu", ,, Mati Logoreci", ,,Abdyl Frashëri" dhe ,, Lekë Dukagjini" dhe pesë të tjera janë shkolla rurale, si, p.sh: ,,Dy Dëshmorët" në fshatin Piranë të Prizrenit, ,,Bajram Curri" në fshatin Romajë të Hasit, ,,Anadollu" në fshatin Mamushë të Prizrenit, ,, Dëshmorët e Kabashit " në fshatin Korishë të Prizrenit, ,,Zenel Hajdini" në fshatin Landovicë të Prizrenit. Grupi reprezentativ përfshin 500 nxënës të klasave të I –ra, II- ta, III-ta, IV-ta, V-ta, si dhe 50 mësimdhënës të klasave të ulëta, gjithësej 550 respondentë. Për mbledhjen e të dhënave të hulumtimit do të shfrytëzohen pyetësorë për mësimdhënës dhe protokol vëzhgimi për nxënës. Nga analiza e të dhënave pritet të vërtetohet se në këto dhjetë shkolla fillore të lartëpërmendura të Prizrenit të pyeturit e mësimdhënësve ndikojnë në zhvillimin e mendimit ktitik dhe krijues dhe rritjen e motivacionit gjatë orës mësimore.

Fjalët kyçe; Të nxënit aktiv, pyetjet efektive, të menduarit krititk dhe krijues, motivimi i nxënësve.

I. Hyrje

Të pyeturit është një ndër dukuritë e pandara të jetës së përditshme. Ato mund të hasim jo vetëm në jetën private, p.sh në familje, në rrugë, etj, por edhe në jetën profesionale. Në procesin mësimor të pyeturit janë elemente të cilat ndihmojnë në identifikimin e njohurive ekzistuese, analizën e

përfytyrimeve gjatë përvetësimit të nocioneve të reja si dhe konceptualizimin e informacioneve në memorien e fëmiut në klasat e ulëta të shkollave fillore.

Procesi mësimor është një proces mjaft kompleks i cili realizohet në formë të komunikimit me nxënës rreth çështjeve të ndryshme gjatë orës mësimore. Sistemet arsimore në vendet e zhvilluara i kanë kushtuar dhe po i kushtojnë rëndësi rreth kësaj kompetence si shprehi e domosdoshme të çdo individi. Kjo kompetencë tashmë është përcaktuar edhe me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, 69/2012. Një ndër aspektet më të rëndësishme që kontribojnë në formimin e kompetencës së komunikimit janë edhe të pyeturit. Pyetjet paraqesin një aspekt i rëndësishëm në ndërveprimin e mësuesit me nxënësin. Në klasë pyetjet mund të parashtrohen nga mësimdhënësi tek nxënësi si dhe nga nxënësit tek mësimdhënësi.

Një mësues i mirë duhet të posedojë aftësi për të bërë pyetje të mira duke mos i anashkaluar faktin se janë ndër veprimet më të vështira sa i përket këtij profesioni. Pa diskutim që pyetjet luajnë role të shumëfishta në njohje. Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësi paraprakisht duhet të bëj përgatitjen e pyetjeve bazuar në njohuritë dhe përmbajtjet mësimore të kaluara të cilat kontribojnë në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve, njëkohësisht ndihmojnë nxënësve që të përsërisin informacionin për të mbajtur mirë në mend atë. Përveç kësaj, pyetjet funksionojnë si mjet identifikimi rreth mangësive dhe për të përcaktuar bagazhin e njohurive të nxënësve, për të nxitur kureshtjen dhe interesin afatgjatë për të nxënit. Në jetën shkollore pyetjet përdoren edhe si mjet motivimi për të nxitur të nxënit aktiv dhe për të inkorporuar kureshtjen e nxënësve në lëndët përkatëse sepse vet suksesi i çdo veprimtarie është motivimi, po të mos jemi të motivuar nuk do të arrijmë suksese të larta.

II. Literatura

Procesi i të nxënit është mjaft i rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e personaliteti të njeirut. Ky proces fillon që nga lindja dhe në mënyrë sistematike vazhdon deri në vdekje. Sipas Fjalorit Pedagogjik „Të nxënit është proces nëpërmjet të cilit nxënësi ose çdo njeri fiton njohuri, shkathtësi, shprehi gjatë procesit mësimor, nëpërmjet fjalës së gjallë të mësuesi (Osmani.Sh 1983,fq 475). Një ndër parimet themelore të mësimdhënies bashkëkohore është nxitja e të nxënit aktiv dhe zhvillimi i mendimit kritik dhe krijues nëpërmjet parashtirmit të pyetjeve. Hulumtimet mbi funksionimin e trurit, dëshmojnë se mënyrat e të nxënit aktiv më së shumti ndihmojnë nxënësit të ruajnë për një kohë të gjatë atë çka kanë mësuar, në vend që ta ruajnë atë në kujtesë në formë pasive (Musai, B, 2003 fq. 51). Sipas Kornizës Kurrikulare të Republikës së Kosovës (2016) si dokument zyrtar pedagogjik është paraparë kompetenca për komunikim dhe të shprehurit sipas së cilës „Nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe në kontekste të reja, të identifikojnë dhe të zgjidhin probleme të ndryshme si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik" (KKK e Arsimit Parauniversitar, gusht 2011).

Në një studim të kryer nga revista shkencore „The Framework for Teaching Mathematics" të nxënit aktiv përkufizohet si një proces me dy drejtime, në të cilin nxënësit pritet të luajë një rol aktiv duke iu përgjigjur pyetjeve si dhe duke kontribuar në diskutime. Nxënësit nxisin të nxënit e njëri – tjetrit duke ndihmuar, duke ndarë dhe duke përkrahur përpjekjet e tyre në mësim (DfEE. 1999, fq,1:11). Mësuesi është faktori kryesor i cili luan rolin organizativ dhe udhëheqës në procesin mësimor. Puna e mësuesit është përcaktuar si një nga detyrat më të vështira dhe më me përgjegjësi. Në klasat bashkëkohore nxënësit inkurajohen që të parashtrojnë sa më shumë pyetje.

Në procesin e mësimdhënies nxënësit e të gjitha moshave kanë shumë pyetje të cilat e udhëheqin të nxënit e tyre. Mund të themi se si bazë e të mësuarit është shtruarja e pyetjeve për të cilat nxënësit kërkojnë të gjejnë përgjigje. Çdo mësimdhënës efektiv gjatë përgaditjes për mësim planifikon llojet e pyetjeve të cilat do të parashtojë në klasë. Gjatë planifikimt të përmbajtjeve programore, mësimdhënësit duhet të identifikojnë nivelin e përpunimit të njohurive dhe duhet të angazhohen në nxitjen e të nxënit aktiv (Lesley, Matczynski & Rowley, 2002). Gjatë përgatitjes së tyre mësimdhënësit duhet të kenë një bagazh të njohurive rreth koncepeteve kyçe rreth të cilave elaborohet përmbajtja mësimore. Pyetjet të

cilat përdoren në klasë mund të jenë të llojeve të ndryshme të cilat ndikojnë në atmosferën në klasë (Ismajli.H 2012, fq 267).

Adelon (2010) thekson se pyetetjet e mësuesve janë me vlera të rëndësishme të cilat përfaqësojnë shumë qëllime mësimore duke nxitur reflektimin dhe angazhimin e nxënësve në klasë, pyetjet e parashturara nga mësuesi është pjesë e domosdoshme e procesit mësimor në ç'rast mësuesit shpenzojnë diku 30 – 50% të kohës së mësimit në sesione të pyetjeve (Cotton. K, 1988). Formulimi i pyetjeve të mira nga mësuesi kërkon përgatitje dhe njohuri të nivelit të lartë pedagogjik (Bonne & Pritchard, 2007). Sipas studiuesit Yan (2006), i cili gjithashtu thekson se pyetejet e mësuesve mund të konsiderohen si pajisja më e fuqishme për të udhëhequr zgjerimin dhe kontrollin e komunikmit në klasë duke treguar rëndësinë e marrjes në pyetje në procesin e udhëheqjes dhe përmirësimit të bisedave në klasë. Vogler (2005, cituar nga Adedoyin 2010) thekson se pyetjet mund të monitorojnë të kuptuarit, ndihmojnë lidhjet me të mësuarit paraprak dhe mund të nxisin zhvillimin kognitiv. Planifikimi i mësimdhënies efektive i referohet njohjes së mësuesit me nevojat, interesat, mënyrën e të mësuarit si dhe nxitjen e të nxënit aktiv të nxënësve.

Një ndër objektivat universale të sistemit arsimor në mbarë botën është zhvillimi i aftësive e të menduarit. Psikologët e edukimit theksojnë se të menduarit e saktë mund dhe duhet të krijohet që në bankat e shkollës fillore. Në ditët e sotme krijueshmëria është aftësia më e kërkuara në të gjitha lëmitë e botës, prandaj ajo shpjegohet si aftësi e një individi, për të imagjinuar e ndërtuar, për të vënë në jetë një koncept, ide të re apo për të zgjidhur një problem në mënyrë sa më origjinale. Sipas Fjalorit pedagogjik (1967, fq 482) „Të menduarit kritik përcaktohet si veti e të menduarit i cili ka të bëjë me analizën e gjithanshme dhe me kontrollimin e fakteve, hipotezave, dhe të dhënave të tjera të cilat përvetësohen". Në procesin mësimor, mësuesi efektiv nëpërmjet pyetjeve të parashturara duhet të ndikoj në zhvillimn e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve.

Sipas një studimi të kryer në Universitetin Nebrashka – Lincoln(Blooser, 1975) llojet e pyetjeve të cilat përdoren nga mësimdhënësit klasifiohen në katër grupe; 1. Menaxherial: pyetje që mbajnë operimet e klasës në lëvizje, 2. Retorike: pyetje të përdorura për të theksuar një pikë ose për të përforcuar një ide apo deklaratë, 3. Të mbyllur: pyetje të përdorura për të kontrolluar mbajtjen ose për të përqëndruar të menduarit në një pikë të caktuar, dhe 4. Të hapur: pyetje të përdorura për të nxitur diskutimin ose ndërveprimin e nxënësve.

Jaka.B (2003, fq.59), thekson se mençuria e cila kulmon si cilësi më e lartë e dijes, po ashtu edhe mendimi kritik është cilësia më e lartë e të menduarit. Gjatë procesit mësimor pyetjet e parashtuara duhet të jenë në kronologji me përmbajtjen mësimore. Këto pyetje jo vetë që duhet të formulohen me shumë precizitet por gjithësesi duhe të ndikojnë në nxitjen e kureshtjes dhe motivacionit të nxënësve gjatë orës mësimore. Duke u nisur nga fakti se çdo veprimtari që arrin rrezultate të larta bazohet në motivacion mund të themi se „Motivimi është një gjendje e brendshme që gjallëron, drejton dhe e mbështet sjelljen" (Woolforl, 2011, fq. 376). Motivimi i nxënësve ushtron ndikim të drejtëpërdrejtë dhe të fuqishëm në ndërveprimet e tyre shoqërore dhe në rritjen e suksesit gjatë orës mësimore. Nxënësit me të njëjtat aftësi dhe të njëjtat njohuri paraprake mund të kenë ecuri krejt të ndryshme, në varësit të motivimit të secilit (Wigfield & Wentzel, 2007).

III. Metodologjia e hulumtimit

Për të hulumtuar problemin e ngritur në mënyrë të gjithanshme do të përdor disa metoda hulumtuese. Në mesin e tyre vlen të përmendim:

Metoda e analizës teorike nëpërmjet të cilës do të konsultohem me literaturën bazë në hulumtimin dhe studime pedagogjike në lidhje me temën.

Me metodën përshkruese do të përshkruhet gjendja aktuale e llojeve të parashtrimit të pyetjeve efektive nga mësimdhënësit në shkolla të lartëpërmendura.

Metoda statistiore ku rezultatet e hulumtimit do të përpunohen në bazë të parametrave statistikore.

Nga ato rezultate do të nxjerrim tabelat dhe grafikonët e të dhënave statistikore të fituara gjatë hulumtimit. Anketimi do të realizohet nëpërmjet pyetësorit të përpiluar për mësimdhënës dhe protokolit të vëzhgimit për nxënës. Pyetësori do të jetë i përpiluar nga pyetjet e tipit të mbyllur. Të dhënat e grumbulluara janë burime parësore që pasqyrojnë llojet e pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësit në shkollat fillore të lartëpërmendra. Të dhënat e përfituara do të përpunohen nga metodat e lartpërmendura dhe njëkohësisht do të nxirren konkluzionet dhe rekomandimet e nevojshme.Si mostër kam përcaktuar 10 shkolla fillore (nëntëvjeçare) të qytetit të Prizrenit, ku pesë prej tyre janë në zonën urbane si, p.sh:

(SHFMU „Fadil Hisari", „Mustafa Bakiu", „Mati Logoreci", „Abdyl Frashëri" dhe „Lekë Dukagjini") dhe pesë të tjera janë në zonën rurale si, p.sh: (SHFMU „Dy Dëshmorët" në fshatin Piranë të Prizrenit, „Bajram Curri" në fshatin Romajë të Hasit, „Anadollu" në fshatin Mamushë të Prizrenit, „Dëshmorët e Kabashit" në fshatin Korishë të Prizrenit, „Zenel Hajdini" në fshatin Landovicë të Prizrenit). Grupi reprezentativ përfshin 500 nxënës të klasave të I-ra, II- ta, III-ta, IV-ta, V-ta, si dhe 50 mësimdhënës të klasave të ulëta, gjithësej 550 respondentë. Për mbledhjen e të dhënave të hulumtimit do të shfrytëzohen pyetësorë për mësimdhënës dhe protokol vëzhgimi për nxënës.

III.1.HIPOTEZA E PËRGJITHSHME

Në mënyrë që ky punim të jetë i përsosur jam munduar ta përdor hipotezën themelore dhe atë ndihmëse.

Hipoteza themelore nga e cila jam nisur është; Parashtrimi i pyetjeve efektive ndikon në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve në shkollat fillore.

Hipoteza ndihmëse është; Të pyeturit efektiv ndikon në nxitjen e kureshtjes dhe motivimit të nxënësve gjatë procesit mësimor.

IV. Të dhënat e përgjithshme nga anketimi i mësimdhënësve në shkollat fillore të Prizrenit

Në këtë hulumtim kanë marë pjesë gjithësej 50 mësimdhënës respondentë. Mësimdhënësit të anketuar të cilët punojnë në shkollat urbane përfshijnë 65% të pjesëmarjes në këtë hulumtim, derisa 35% të anketuarve tjerë janë mësimdhënës të shkollave rurale. Në tabelën e mëposhtme ju kam pasqyruar përqindjen e pjesëmarjes së mësimdhënësve respondentë në bazë të vendit dhe emërtimit të shkollave ku punojnë.

Të dhënat e përgjithshme rreth mësimdhënësve pjesëmarës

Klasa		I – V
Vendi		
Shkollat urbane	„Mati Logoreci"	20%
SHFMU	„Fadil Hisari"	12%
	„Mustafa Bakiu"	10%
	„ Abdyl Frashëri"	15%
	„Lekë Dukagjini"	8%
Shkollat rurale	„Dy dëshmorët"	6%

SHFMU	,,Bajram Curri”	6%
	,,Anadollu”	3%
	,,Dëshmorët e Kabashit”	13%
	,,Zenel Hajdini”	7%
Gjithësej	**10 shkolla fillore**	**100%**

Tabela nr. 1. Të dhënat e mësimdhënësve në SHFMU- të urbane dhe rurale të komunës së Prizrenit

IV.1. Të dhënat e përgjithshme nga vëzhgimi i nxënësve në shollat fillore të Prizrenit

Nxënësit e shkollave të lartëpërmendura janë respondetë të tjerë sa i përket këtij hulumi. Sipas pjesëmarjes së tyre 71% të nxënësve mësimet vijojnë në shkollat urbane, dërsa 29% të nxënësve tjerë mësimet vijojnë në shollat rurale.

Të dhënat e përgjithshme nga vëzhgimi i nxënësve pjesëmarës

Klasa	I – V	
Vendi		
Shkollat urbane	**,,**Mati Logoreci”	15%
SHFMU	,,Fadil Hisari”	17%
	,,Mustafa Bakiu”	8%
	,,Abdyl Frashëri”	22%
	,,Lekë Dukagjini”	9%
Shkollat rurale	,,Dy dëshmorët”	8%
SHFMU	,,Bajram Curri”	4%
	,,Anadollu”	2%
	,,Dëshmorët e Kabashit”	7%
	,,Zenel Hajdini”	8%
Gjithësej	**10 shkolla fillore**	**100%**

Tabela nr.2. Të dhënat e nxënësve në SHFMU- të urbane dhe rurale të komunës së Prizrenit

V. Diskutimi i rezultateve të hulumtimit rreth pyetjeve efektive të mësimdhënësve

Në bazë të protokolit vëzhgues të realizuar në dhejtë shkolla urbane dhe rurale është konstatuar se nga pytejet të cilat parashtorhen nga mësimdhënësit nxënësve të klasave të ulëta, përdorim më të gjërë gjejnë **pyetjet e tipit kontrollues** me 57.94% me qëllim të identifikimit të njohurive të përfituara si dhe të zhvillimit të mendimit kritik dhe krijues të nxënësve gjatë një orës mësimore, ndërsa asnjëherë rreth 7.21%. **Pyetjet e rritjes së ndërgjegjësimit** gjejnë zbatim në nivel jo të kënaqur me një përqindje mjaft të lartë si69.84% në shkollat fillore. Përqëndrimi i nxënësve gjatë shtjellimit të njësisë mësimore ndikon dukshën në rritjen e suksesit të nxënësit në lëndën përkatëse prandaj pyetjet të cilat nxisin përqëndrimin e nxënësve parashtrohen gjithmonë me 16.24% gjatë orës mësimore ndërsa, 24.34% asnjëherë në disa shkolla të lartëpërmendura. Parashtrimi i **Pyetjeve të tipit nxitës** të cilat nxisin inkurajimin dhe aktivizimin e nxënësve gjatë orës mësimore kemi vërejtur se gjejnë zbatim në shkollat fillore me një përqindje shpeshëherë rreth 31.3%. **Pyetjet e tipit faktike** gjejnë zbatim shpeshëherë me një përqindje 43.67% ndërsa 4.07% asnjëherë nëpër disa shkolla fillore.**Pyetjet divergjente** janë ndër tipet e pyetjeve të cilat pothuajse tejet rrallë parashtrohen nga mësimdhënësit drejtuar nxënësve me një përqindje 4.02. Në grupin **e pyetjeve të nivelit të lartë**gjejnë zbatim pyetjet gjithmonë vetëm 45.62% ndërsa disa herë vetëm 8.25% gjatë orës mësimore. Në bazë të rezultateve të fituara nga vëzhgimet e mia në shkollat fillore të qytetit të Prizrenit,**pyetjet e tipit induktiv** gjejnë përdim dukshëm më rrallë nga mësimdhënësit drejtuar nxënësve me një përqindje 5.35% gjithmonë dhe asnjëherë 65.33%. Ndërsa **pyetjet e tipit deduktiv** gjithmonë gjejnë zbatim vetëm 2.85% dhe asnjëherë 78.25% në shkollat e lartëpërmendura. Krahasimi i dukurive dhe njohurive ndikon në identifikimin e nivelit të zhvillimit psikik si dhe zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve, gjatë vëzhgimeve kam arritur që të identifikoj se këto lloje të pyetjeve përdoren gjithmonë rreth 40.10% gjatë orës mësimore derisa vetëm 2.35% i mësimdhënësve nuk e praktiojnë pyetjet krahasuese. Aftësimi i nxënësve për të nxitur zgjidhjen e problemeve është objektivi kryesor i çdo mësimdhënësi dhe çdo institucioni nëpërgjithësi, prandaj ne si mësimdhënës bashkëkohor duhet t'i nxisim nxënësit në zgjidhjen e problemeve.Pra, në shkollat fillore gjejnë përdorim pyetjete të tilla shpeshëherë rreth 53.26% dhe asnjëherë 7.49%. Sa i përket **pyetjeve afektive** gjejnë përdorim në klasat e ulëta shpeshëherë 34.86% dhe asnjëherë 12.33% dhe **pyetjet e strukturimit** 58.24% gjithmonë dhe 3.02% asnjëherë në klasat e ulëta të shkollave fillore.

Protokoli i vëzhgimit të mësimdhënësve	**Asnjëherë**		**Disa herë**		**Shpeshëherë**		**Gjithmonë**		**Gjithësej**
1.Pyetjet e tipit kontrollues, p.sh;	**7.21%**		**22.07%**		**57.94%**		**12.78%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Çfarë keni kuptuar nga ky term?	**2.15 %**	**5.06 %**	**6.19 %**	**16.2 %**	**46.12 %**	**11.82%**	**8.78 %**	**3.99 %**	**100%**
b) A mund të përshkruani se çka mendoni?									
	15.24%		**69.84%**		**8.12%**		**6.65%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	

2. Rritja e ndërgjegjësimit, p.sh;	**4.20 %**	**11.22 %**	**27.24%**	**42.68%**	**6.42%**	**1.7 %**	**5.25 %**	**1.4 %**	**100%**
a)Çfarë mendoni në lidhje me këtë?									
b)Cila është arseja juaj për të menduar kështu?									
3. Pyetjet që e nxisin përqëndrimin e nxënësve,p.sh;	**24.34%**		**48.12%**		**11.27%**		**16.24%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Nëse kjo është e vërtetë cilat janë pasojat për të?	**5.11 %**	**19.23%**	**15.10 %**	**33.02%**	**7.65 %**	**3.62 %**	**10.72 %**	**5.52 %**	**100%**
b) Si lidhet përgjigjia e Ronit me…?									
c) A mund të lidhni këtë me?									
4.Pyetjet nxitëse, p.sh;	**26.03%**		**28.12%**		**31.3%**		**14.2%**		**100%**
	U	**R**	**U**	**R**	**U**	**R**	**U**	**R**	
Mësuesja; Roni, 25:5 sa bën?									
Roni; Nuk e di mësuese.	**7.2 %**	**18.82%**	**22.15 %**	**5.88 %**	**18.3 %**	**13.0 %**	**10.92 %**	**3.28 %**	**100%**
Mësuesja; Epo 8:4 sa bën?									
Roni; 2 mësuese.									
Mësuesja; Atëherë çfarë dime për nr. 2?									
II. Pyetjet faktike, p.sh;	**4.07%**		**16.33%**		**43.67%**		**35.93%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Kush ishte autori i këtij teksti?	**1.51 %**	**2.56 %**	**11.09%**	**5.24 %**	**22.69%**	**20.98%**	**19.38%**	**16.55%**	**100%**

b) Cila është kryefjala në këtë fjali?									
III.Pyetjet divergjente, p.sh:	**57.85%**		**31.14%**		**4.02%**		**6.98%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Çfarë mund të ndodh në organizmin tonë nëse nuk funksionon sistemi i tajitjes?	**22.47 %**	**35.38%**	**4.02%**	**27.12 %**	**3.89%**	**0.13 %**	**4.86%**	**2.12 %**	**100%**
IV.Pyetjet e nivelit të lartë, p.sh;	**12.33%**		**8.25%**		**45.62%**		**33.80%**		**100%**
	U	R	U	R	UR		UR		
1.Vlerësimi a)Si mendoni a kishte vepruar drejtë plaku me fshehjen e florinjëve nga i zoti i shtëpisë? Pse?	**4.07 %**	**8.26 %**	**3.74%**	**4.51 %**	**24.08 %**	**21.54 %**	**24.69 %**	**9.11 %**	**100%**
2.Pyetjet induktive, p.sh	**65.33%**		**20.12%**		**9.20%**		**5.35%**		**100%**
a) Kemi shqyrtuar cilësitë që duhet tëposedojë një	**U**	**R**	**U**	**R**	**U**	**R**	**U**	**R**	
udhëheqës shtetëror, a posedon këto veçori	**23.18%**	**42.15%**	**11.56%**	**8.56 %**	**5.1 %**	**4.10 %**	**3.28 %**	**2.07 %**	**100%**
kryetari i shtetit të Kosovës?									
3.Pyetjet deduktivie, p.sh;	**78.25%**		**12.66%**		**6.24%**		**2.85%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a)Nëse tepmeratura e gazit mbetet e njëjtë por gazi është	**22.96%**	**55.29%**	**4.24%**	**8.42 %**	**3.78 %**	**2.46 %**	**1.95 %**	**0.90 %**	**100%**

marrëprej 4.000m lartësi, çfarë ndodh me presionin e gazit?									
4. Pyetjet e tipit krahasues, p.sh:	**2.35%**		**24.08%**		**33.46%**		**40.10%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) A janë të njëjta burimet materiale me burimet e shkruara?	**1.12 %**	**1.23 %**	**5.0 2%**	**19.0 6%**	**21. 11 %**	**12.3 5%**	**33. 16 %**	**6.94 %**	**100%**
b) Cili është dallimi ndërmjet kërpudhave helmuese dhe johelmuese?									
5.Aplikimi, p.sh;	**14.12%**		**5.15%**		**47.3%**		**33.42%**		**100%**
a)Si reaguan nxënësit ndaj Zefit të vogël në tekstin ,,Një ndodhi në klasë" ?	U	R	U	R	U	R	U	R	
	5.26 %	**8.86 %**	**2.39 %**	**2.76 %**	**18.3 5%**	**28.6 8%**	**15.8 6%**	**17.5 6%**	**100%**
b) A mund të merni një shembull të tillë nga jeta juaj për të përshkruar këtë ngjarje?									
6.Pyetjet që nxisin zgjidhjen e problemeve, p.sh:	**7.49%**		**13.14%**		**53.26%**		**26.1%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Supozoni se jeni duke u rritur me idenë se kafshët shtëpiake janë të dëmshme për njeriun, si do të reagonit ndaj këtyre kafshëve kur do të rriteni?	**2.89 %**	**5.6 %**	**5.68 %**	**7.4 6%**	**28.8 7%**	**24.3 9%**	**17.3 %**	**8.71 %**	**100%**
	12.33%		**24.67%**		**34.86%**		**27.14%**		**100%**

V. Pyetjet afketive, p.sh:	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) Si mendoni për këtë?	**5.12 %**	**7.21 %**	**12.44%**	**12.23%**	**22.32%**	**12.54%**	**21.35 %**	**6.79 %**	**100%**
b) A është me rëndësi për ju?									
c) A keni dëshirë ta përshkruani këtë tekst?									
VI. Pyetjet e strukturimit, p.sh:	**3.02%**		**4.54%**		**34.20%**		**58.24%**		**100%**
	U	R	U	R	U	R	U	R	
a) A keni ndonjë pyetje lidhur me tekstin?	**0.82 %**	**2.20 %**	**2.22%**	**2.32 %**	**21.44 %**	**12.76%**	**42.13 %**	**16.18%**	**100%**
b) A do të përsërisësh këtë?									

Tabela nr.3. Paraqitja tabelare e nivelit të parashtirmit të pyetjeve nga mësimdhënësit e klasave të ulëta në shkollat fillore.

V.1. Krahasimi i rezultateve të fituara lidhur me nivelin e zbatimit të pyetjeve efektive varësisht prej zonave ku funksionojnë shkollat

Bazuar rezultateve të fituara nga ky hulumtim në dhejtë shkolla fillore të komunës së Prizrenit kemi konstatuar se në SHFMU „Fadil Hisari" si shkollë urbane rreth 55.21% aplikohet të pyeturit efektiv nga ana e mësimdhënësve, ndërsa në SHFMU „Mustafa Bakiu"rreth 25.12%. Sa i përket shkollave rurale SHFMU „Anadollu" në fshatin Mamushë të Prizrenit me një pëqindje 35.44% dhe pas saj vjen SHFMU „Dy Dëshmorët" në fshatin Piranë të Prizrenit.


Shkollat urbane
55.21%
25.12%
8%
5.33%
6.33%
SHFMU ,,Fadil Hisari"
SHFMU ,,Mustafa Bakiu"
SHFMU ,,Mati Logoreci"
SHFMU ,,Abdyl Frashëri"
SHFMU ,,Lekë Dukagjini"


Shkollat rurale
24.45%
12.03%
35.44%
14.78%
13.30%
SHFMU ,, Dy Dëshmorët"
SHFMU ,,Bajram Curri"
SHFMU ,, Anadollu"
SHFMU ,,Dëshmorët e Kabashit"
SHFMU ,,Zenel Hajdini"

VI. Konkluzionet

Përfundimet dhe Rekomandimet

Duke u bazuar në korelacionin e bërë ndërmjet hipotezës kryesore, variablave të hulumtimit, pjesës teorike të përshkruar dhe përvojës profesionale të mësimdhënësve të këtij hulumtmit konstatojmë se *në shkollat fillore të qytetit të Prizrenit aplikohet lloje të ndryshme të pyetjeve efektive në mësimdhënie të cilat ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues duke nxitur kureshtjen dhe motivimin e nxënësve gjatë përvetësimit të njohurivë në procesin mësimor.*Njëkohësisht nga krahasimi i bërënë mes të shkollave urbane dhe rurale kamkonstatuar se në shkollat urbane mësimdhënësit parashtrojnë një numër të madh të pyetjeve efektive që ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues në krahasim me shkollat rurale.

Në mbështetje të të dhënave nga analiza cilësore dhe sasiore, mund të japë disa rekomandime rreth temës së trajtuar në hulumtim.

Për drejtorët:

- Të realizohet mbikqyrje adekuate rreth nivelit të parashtrimit të pyetjeve efektive nga mësimdhënësit drejtuar nxënësve gjatë procesit mësimor.

Për mësimdhënësit:

- Të hartohen pyetjet adekuate që përputhen me përmbajtjen e njësisë mësimore nga ana e mësimdhënësve.
- Të merret parasysh nivelizimi i pyetjeve parase të parashtrohen gjatë orës mësimore.
- Të analizohen dhe të praktikohen lloje të ndryshme të pyetjeve varësisht prej strukturës së njohurive të nxënësve në klasë.
- Pjesëmarja në trajnime të realizuara ku mund të avancohen në aspektin e parashtirmit të pyetjeve efektive që ndikojnë në rritjen e suksesit të nxënësve në klasë.

Referencat

Literaturë teorikë

- Sadker.M dhe Sadker.M (1986). Manual mbi aftësitë mësimdhënëse në klasë" (Classroom Teaching Skills: A Handbook), bot. i 3- të, fq, 143 – 160, Boston.
- Woolfolk.A (2011). Psikologji Edukimi" botimi i 11 – të, fq. 469 – 472, Tiranë.
- Ismajli.V.H (2012). Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik. Prishtinë, Libri shkollor, fq 267.
- Korniza e Kurrikulës së Kosovës (2016) faqe, 15.
- Korniza e Kurrikulës së Kosovës (2011) faqe, 15 – 19
- Shefik Osmani (1983). Fjalori Pedagogjik, Tiranë, faqe 674.
- DfEE (1999). The Natinal Numeracy Strategy; Framework for Teaching Mathematics. London: DfEE Publications, fq.1:11
- Lasley, T, T. Matczynski & J. Rowley (2002). Instruction Models: Strategies for Teaching in a Diverse Society Belmont, CA: Wadsworth.
- Musai. B (2003). Metodologji e mësimdhënies, Tiranë, fq 51.
- Adedoyin, O. (2010). An Investigation of the effects of teachers' classroom questions on the achievements of students in mathematics: Case study of Botswana community junior secondary schools. European Journal of Educational Studies, 2(3).
- Cotton, K. (1988). Classroom Questioning. North West Regional Educational Laboratory

- Bonne, L., & Pritchard, R. (2007). Teacher researchers questioning their practice. Mathematics: Essential Research, Essential Practice — Volume 1.
- Yan, X. (2006). Teacher talk and EFL in university classrooms. Unpublished master of arts thesis, Chongqing Normal University & Yangtze Normal University, China.
- Pedagoŝki reĉnik 1 (1967). Beograd,fq. 482.
- Jaka, B (2001). Metodika e mësimit elementar të Matematikës. Prishtinë, fq.59.
- Wolfolk. A (2011). Psikologji Edukimi, Botimi i njëmbëdhjetë. Tiranë, fq. 376.
- Wigfield, A. and Wentzel, K. R. (2007). Introduction to Motivation at School: Interventions that Work. Educational Psychologist, 42(4), 191-196.
- P. E. Blosser. (1975). *How to Ask the Right Questions.* National Science Teachers Association)

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

EDUKIMI, PUNËSIMI DHE REDUKTIMI I VARFËRISË

ELIZABETA MURATI

ELZA QORRAJ

Abstrakt

"Intelegjenca plus karakteri janë qëllimi i edukimit të vërtetë" - Martin Lutherking

Përmes këtij studimi, do të hulumtojmë shkaqet praktike, teorike dhe shkencore, të cilat, si të tilla, janë të pranishme në Kosovë.

Edukimi, punësimi dhe varfëria, janë sfidë dhe pengesë për të gjithë botën. Edukimi nënkupton formim dhe ngritje të kapaciteteve humane. Sa më i lartë niveli i edukimit të qytetarëve të një vendi mundësia për punësim është më e madhe.Varfëria nënkupton të ardhura të pamjaftueshme dhe mohimin e nevojave themelore, të tilla si: arsimim, shërbim shëndetësor, ushqim, strehë, mirëqenie etj.

Objektivi kryesor i këtij studimi është të analizojë aspektet shumëdimensionale të edukimit të studentëve për rastin e Kosovës, të hulumtojë dhe të identifikojë faktorët ose karakteristikat individuale që përcaktojnë gjendjen e edukimit, me synimin për të sugjeruar politika të duhura sipas rajoneve dhe sipas karakteristikave të vendit.

Në kuadër të punimit do të analizojmë si të arrijmë që studentët si kategori shoqërore t'I aftësojmë në mënyrë që të rritet punësimi I të rinjëve.Të përgatiten më mirë për tregun e punës dhe të arrijnë të materializojnë punën, investimin dhe aftësitë e fituara gjatë edukimit.

Gjithashtu, ky studim ka për qëllim të analizojë modelet statistikore më të përshtatshme për të matur nivelin e edukimit, punësimit dhe varfërisë, duke evidentuar karakteristikat që ndikojnë në përcaktimin e faktorëve të saj.

Të gjeturat nga ky studim ofrojnë njohuri për studentët që synojnë të hyjnë në këtë treg dhe japin rekomandime për studime të mëtutjeshme.Për të realizuar qëllimet e këtij punimi janë përdorur të dhëna të mbledhura nga Agjensia e Statistikave të Kosovës dhe intervista me disa studentë.

Fjalët kyçe:

Edukimi, Punësimi, Varfëria, Kosovë, Student

HYRJE

Pyetja kryesore kërkimore i referohet asaj se si jetojnë studentët si kategori shoqërore?

Edhe pse vijmë nga vende të ndryshme, sfidat e të rinjëve janë të njejta. Gati gjysma e popullsisë rinore përballet me sfidën e gjetjes së punës për t'i ndërtuar jetët e tyre. Kjo situatë shihet në tërë Europën, përfshirë edhe Kosovën.

Studentët përbëjnë 13.63% të banorëve rezident në Republikën e Kosovës. Meqë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, popullësia në Kosovë për vitin 2015 është 1,771,604 banor, ndërsa nga ky numër rreth 130,000 janë student.

Paga mesatare neto në Kosovë është 457[47] euro, gjë e cila tregon edhe shportën e konsumatorit dhe aftësinë blerëse të tyre. Por sa do të mund të arrijnë këto të ardhura të mbulojnë shpenzimet që kanë në muaj studentët e familjeve?

Niveli i pagës mesatare në Kosovë Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë ishin 431 Euro, derisa në vitin 2016 ishte 519 Euro, një rritje prej 88 Eurosh ose 20.42%. Derisa, paga neto nga 384 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 457 Euro në vitin 2016, me 74 Euro më shumë, ose 19.17%.

Tabela 1: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto, sipas viteve 2012-2016

	Paga mesatare		**Sektori publik (BKK)**		**Sektori Privat**		**Ndërmarrjet publike**	
Viti	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2012	431	384	407	353	367	333	518	465
2013	444	393	415	356	367	333	549	491
2014	482	430	465	408	358	326	624	556
2015	510	451	511	441	367	333	651	578
2016	519	457	525	449	371	337	660	586

Burimi :ASK (Agjensia e Statistikave të Kosovës)

Pa përballueshmëria e një shpenzimi të papritur nga ekonomitë familjare prej 500 eurosh, (përgjigjja me vështirësi të mëdha 60%)[48] , ndërsa gjatë vitit 2015 bursat për studime nga 900 euro kanë rënë në vlerë prej 500 eurosh. Përderisa një familje ka deri në 3 studentë dhe të ardhurat për muaj janë rreth 500 eurosh, nëse vetëm një anëtar i familjes punon, dhe në rastin më të mirë me 2 paga prej 500 eurosh, që janë në afërsi rreth 1,000 eurosh. Por, në shumicën e rasteve pagat në sektorin privat janë rreth 250 euro në muaj.

Gjendja ekonomike e kategorisë shoqërore "Student"

- Kostot financiare të studimeve,
- Akomodimi, qiraja, ushqimi,
- Kostot financiare pas studimeve (kurset shtesë),
- Kostot e mospunësimit,

[47] http://askdata.rks gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__Wages/sal01.px/table/tableViewLayout1/?rxid=e2c1deba-265e-4fe2-b832-825259f0cc67

[48] http://ask.rks-gov.net/media/1514/rezultatet-e-anketes-se-buxhetit-te-ekonomive-familjare-2015.pdf

- Pritja për punë,
- Pagesa e ulët 2-3 vjet .

Investimet në edukim që i bënë një student mesatarisht në studime

Në Kosovë në studime të larta universitare gjatë periudhës 2015/2016 kanë qenë 120,429 studentë, prej tyre në universitetet publike janë 73,111 studentë, ose shprehur në përqindje ishin 60.7%, ndërsa në kolegjet private ishin 47,318 studentë ose 39.3%.

Gjatë studimeve një student në Prishtinë, ka shpenzime sidomos nëse nuk është banor i Prishtinës për:

- Banimi 50 euro në muaj
- Pagesat komunale 20 euro
- Ushqim të paktën 100 euro në muaj
- Shpenzime të fakultetit, libra dhe materiale tjera 50 euro.
- Për studentët e kolegjeve private plus 100 euro ekstra (kesti mujor pagesa e studimeve)

Nga kjo shohim se në total një studenti për shpenzimet bazë të studimeve i duhen rreth 220 euro për studentët e Universitetit publik, ndërsa rreth 320 euro janë shpenzimet bazë për studentët që janë në kolegje private. Në shumicën e rasteve vetëm njëri nga prindërit është mbajtës i familjes dhe të ardhurat mujore për tërë familjen janë të kufizuara, është shumë e vështirë që të financohen një apo më shumë student nga buxheti i konsoliduar i një familjeje kosovare.

Nëse një familje duhet të shkollojëdy studentë, në të njejtën kohë, janë shpenzime bazë 500 euro për një familje. Ndërsa në anën tjetër me punë me shkollim të mesëm siç edhe shihet në tabelën me të dhënat mbi papunësinë sipas edukimit të të rinjëve shihet që përqindja e të papunëve është 61.9% me edukim të mesëm profesional. Rrjedhimisht të gjithë studentët, të cilët kanë të regjistruar studimet e tyre, dhe nuk i kanë përfunduar ato, cilësohen me arsimim të mesëm. Zakonisht kësaj kategorie të të rinjëve deri në periudhën e studimeve ju ofrohen punë vullnetare, praktika pa pagesë nëpër Ministri dhe Institucione të tjera, ndërsa orari i punës është i plotë.

Njëkohësisht ata mbesin si kategoria më e shfyrtëzuar nga bizneset private, Institucionet publike, organizatat jo qeveritare, të cilët përfitojnë nga puna e tyre vullnetare apo nga puna praktike e cila paguhet pak. Por të paktën arrijnë të marrin njohuritë bazë mbi kulturën organizative, sjelljen që duhet të kenë në organizatë dhe mjedis të punës, si dhe të arrijnë të diferencojnë vetën nga kandidatët tjerë në të ardhmen.

Por, kjo vetëm sa shkon e thellon gjendjen e rëndë në të cilën gjenden kjo shtresë e shoqërisë. Meqë presim nga dikush për të cilin sakrifikohet shumë që nga një fshat apo qytezë e vogël, të sillet për studime në një qëndër më të madhe, të punoj në kushte të pafavorshme dhe të i pamundësohet mbarëvajtja e rregullt e atyre studimeve. Meqë për të përballuar kostot i vetëm duhet të punohet gjithësesi një punë shtesë, për të mos qenë barrë e madhe për familjen.

Sa të varfër janë studentët tanë?

Ata janë në minus (-220 deri në minus 320 euro) në muaj, me fillimin e datës 01 të çdo muaji. Sot në shumicën e konkurseve kërkohet përvojë pune të paktën prej 2 vitesh eksperiencë. Në Kosovë puna praktike nuk paguhet. Ndërsa në rastet në të cilat është me pagesë, paguhet rreth 100- 160 euro në muaj, gjë e cila nuk arrinë as të mbulojë shpenzimet bazë të të ushqyerit gjatë ditës në punë.

Lidhja në mes të Edukimit dhe Papunësisë në Kosovë

• Çka ofrojnë Institucionet tona të edukimit?

Institucionet tona të Arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë njohuri të përgjithshme teorike mbi çështjet e studimit, duke ofruar njohuri të cilat nuk janë aktuale për trendin dhe zhvillimet botërore. Ndërsa, shumë pak ka pjesë praktike të cilat në fakt do t'i përgatisnin të rinjët për të hyrë në tregun e punës.

• Sa i plotësojnë kërkesat e tregut të punës, sistemi i arsimimit në Kosovë?

Edhe pse ka shumë të diplomuar nga Universitetet tona, ka shumë pak forcë të punës në tregun e punës në Kosovë, shumica e studentëve nuk munden që të hyjnë në tregun e punës pa marrë kurse shtesë.

Papunësia ndër të rinjtë është një çështje shqetësuese pothuajse në të gjitha vendet në tranzicion.Norma e papunësisë për personat e moshës deri në 24 vjeç në vendet e Ballkanit është përafërsishtdy deri në tri herë më e lartë se sa norma e përgjithshme e papunësisë.

Në fillim të viteve të '90-ta (kur procesi i tranzicionit filloi), mendohej se norma e papunësisë përtë rinjtë ishtë një problem i përkohshëm sepse këta persona do të gjenin punë për shkak të aftësivetë tyre për tu përshtatur kushteve të reja dhe aftësive të tyre për të përvetësuar lehtë njohuritë dhe aftësitë e reja që kërkoheshin nga tregu i punës. Më vonë u pa se norma e papunësisë për këta persona lidhet me nivelin e tyre të edukimit, sistemin e trajnimit dhe ritrajnimit në nivel kombëtar.

Duke pasur parasysh natyrën e ngurtë (jofleksibile) të tregut të punës dhe kohën e nevojshme përreforma në sistemin e edukimit dhe trajnimit, papunësia për të rinjtë u bë një problem serioz dheshumë të rinj të papunë u bënë të papunë afatgjatë.Në Kosovë ky problem duket të jetë më i rendë se në vendet tjera duke pasur parasysh popullsinëshumë të re.

Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor

Tab. 2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (në mijëra)			
15-24	30.4	16.6	47.0
25-34	39.4	17.7	57.0
35-44	21.2	7.4	28.5
45-54	15.9	3.6	19.5
55-64	5.3	0.6	5.9
15-64	**112.1**	**45.8**	**158.0**
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-24	48.6	64.8	53.3
25-34	36.3	50.6	39.8
35-44	21.1	26.9	22.4
45-54	18.8	16.3	18.3
55-64	11.2	5.6	10.2
15-64	**27.8**	**38.0**	**30.2**

Burimi: ASK

Nga Tabela 2. Shohim se 53.3 % e popullsisë së re në Kosovë ishin të papunë. Shkalla më e ulët e papunësisë 10.2% është hasur në mesin e personave të moshës 55-64 vjeç.

Tabela 3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (në mijëra)			
Pa shkollë	0.8	0.1	0.9
Fillor	27.4	4.5	32.0
Arsim profesional i mesëm	47.8	14.1	61.9
Shkollë e mesme gjimnaz	20.7	8.6	29.3
Terciar	15.5	18.4	33.9
Totali	**112.1**	**45.8**	**158.0**
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
Pa shkollë	57.5	17.5	46.3
Fillor	35.3	28.1	34.1
Arsim profesional i mesëm	30.9	44.1	33.2
Shkollë e mesme gjimnaz	22.0	43.1	25.7
Terciar	20.5	35.6	26.7
Totali	**27.8**	**38.0**	**30.2**

Burimi: ASK

Shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (46.3% e këtij grupi ishintë papunë) dhe më e ulta për personat që kishin përfunduar arsimin e lartë (26.7%).

Shkollimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi57.5 % e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 20.5 % të atyreqë kishin përfunduar arsimin terciar.

Papunësia sipas nivelit të edukimit

Studimet ekonometrike të kryera në disa vende në tranzicion kanë treguar se personat me edukim të ulët kanë gjasa më të mëdha që të bëhen të papunë. Megjithatë ka diferenca në mes vendeve dhebrenda një vendi, por në përgjithësi kjo tendecë duket të jetë karakteristikë për të gjitha vendet dheregjionet. Afërsisht dy të tretat e personave të papunë në vendet në tranzicion posedojnë edukim të mesëm dhe një e treta edukim fillor, derisa në vendet e industrializuara egziston një shpërndarjemë e barabartë e personave të papunë sipas niveleve të edukimit.(Hoti, Avdullah (2002): Transformimi i Tregut të Punës dhe Implikimet për Papunësinë në Ekonomitë në Tranzicion: Eksperiencat nga Vendet e Evropës Juglindore dhe Përvojat përKosovën; Universiteti i Staffordshirit, Shkolla e Biznesit, Departamenti i Ekonomiksit, Britani e Madhe (Disertacion i Magjistraturës).

Kosova nuk përbën një përjashtim, ku 58% e të papunëve posedojnë edukim të mesëm dhe 33% me edukim fillor.Sektorët ekonomik si tregtia, arsimi dhe shëndetësia, ndërtimtaria, transporti dhe komunikimetjanë sektore në të cilat është koncentruar nivel më i lartë i punësimit. Në anën tjetër, të dhënat tregojnë se femrat bëjnë 12 % të punësimit total; kështu që pozicioni i tyre është tejët i pafavorshëm.

Implikimet e ekonomisë jo-formale mund të vërehen në shumë aspekte të ekonomisë së një vendi.

Një vend tipik i tillë është edhe Kosova. Në bazë të matjeve të ndryshme sektori jo-formal I ekonomisë në Kosovë është tejët i lartë dhe kjo si pasojë e moskompletimit të infrastrukturës ligjore, shtrirjes dhe nivelit të tatimeve dhe faktorëve tjerë

Tregu i punës në Kosovë ka disa karakteristika të veçanta krahasuar me vendet e tjera në tranzicion. Pothuaj të gjitha të dhënat që janë në diponim tregojnë se një e treta e popullsisë është nën moshën 16 vjeçare dhe mbi 50% e popullsisë është deri në 24 vjeç. Për shkak të kësaj, ka hyjre të konsiderueshme të individëve në tregun e punës. Duke marrë parasysh normën e lartë të papunësisë, mund të thuhet se shumica e individëve që hyjnë në tregun e punës hyjnë në grupin e të papunëve. Përveç kësaj, për shkak të mundësive të vogla për të gjetur punë, ka shumë persona që tërhiqen nga tregu i punës. Kështu, sa i përket lëvizjeve në forcën e punës Kosova karakterizohet me hyrje të konsiderueshme të individëve në tregun e punës (shumica hyjnë në grupin e të papunëve) dhe dalje të konsiderueshme nga tregu i punës.

Në bazë të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP),të realizuar në tremujorin e tretë (TM3) 2017 papunësia është 30.4%.Punësimi me i lartë është te meshkujt (48.1%), ndërsa punësimi te femrat është 12.5%. Femrat janë të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, kujdesit shëndetësor dhe tregtisë, me 47.9% të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimtarisë, prodhimit dhe tregtisë, me 47.0%.

Sa u përket të punësuarve me kontrata, del se 28.1% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 71.9% kanë kontratë të përkohshme. Kjo tregon edhe pasigurinë që kanë të gjithë të të punësuait të cilët janë në sektorë privat por edhe publik. Duke bërë kështu edhe me të papërballueshme stresin që kanë edhe pas punësimit të rinjët. Vështirësitë më të mëdha edhe në krijimin e jetës së re dhe mundësisë për planifikim familjar.

Papunësia në Kosovë është më e theksuar te femrat me 38.0 %, krahasuar me meshkujt, 27.8%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 53.3%.

Sipas rezultateve të AFP-së, në TM3 2017, fuqia joaktive është mjaft e lartë me 56.5%, me fokus të veçantë te femrat me 79.8%, krahasuar me meshkujt, 33.4%.

Tab. 4: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhegrupmoshës.

Kosovë	**Meshkuj**	**Femra**	**Gjithsej**
Fuqia Punëtore (në mijëra)			
15-19	11.2	4.8	16.0
20-24	51.4	20.8	72.2
25-29	59.1	20.2	79.3
30-34	49.2	14.8	63.9
35-39	48.1	12.7	60.9
40-44	51.9	14.7	66.6

45-49	42.7	13.2	56.0
50-54	41.9	8.6	50.5
55-59	30.4	6.6	37.0
60-64	16.9	4.0	20.9
Totali 15-64	**402.8**	**120.4**	**523.2**
Shkalla e pjesëmarrjes së Fuqisë Punëtore (%)			
15-19	12.0	5.4	8.8
20-24	57.6	27.4	43.8
25-29	83.7	32.2	59.5
30-34	90.5	27.8	59.6
35-39	86.7	21.8	53.4
40-44	88.2	23.0	54.3
45-49	85.6	20.7	49.0
50-54	80.3	15.8	47.4
55-59	65.1	15.1	41.0
60-64	49.2	12.1	31.1
Totali 15-64	**66.6**	**20.2**	**43.5**

Burimi: ASK

Të rinjët joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)

Të rinjtë e këtij grupi (NEET) përfshijnë të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekinshkollën, as nuk trajnohen, d.m.th. janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhenuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë etë rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregonshkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar nëvendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen efitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemevesociale.

Në tremujorin e tretë të vitit 2017, rreth 94,999 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 27.4 % të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET është 31.8% krahasuar me 23.4% të meshkujve

Tab. 5: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë

Kosovë	Mashkuj	Femra	Gjithsej
Të rinj NEET (në mijëra)	42.6	52.4	95.0
Përqindja e të rinjëve NEET në popullësinë e re (%)	23.4	31.8	27.4

Burimi: ASK

Lidhja në mes të Varfërisë dhe Edukimit

Duke marrë parasyshë që rreth 50% e përbëjnë të rinjët nën moshën 35 vjeçare, punësimi i tyre nënkupton që Kosova të përmirësoj gjendjen ekonomike të një shtrese të madhe shoqërore. Njëkohësisht do të ndikoj në rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore, të familjeve dhe të studentëve vet në Kosovë. Kjo nënkupton që potenciali i rinisë të shfyrtëzohet mbrenda vendit, në të mirë të Kosovës dhe të mos "nxisim" të rinjët të dalin jasht vendit për të gjetur vende pune në mënyrë që të sigurojnë mbijetesën e tyre.

Kjo është edhe një shënjë alarmante për të rinjët tjerë, që ndërsa i shohin të afërmit e tyre të cilët kanë sakrifikuar shumë për sukses e studime, nuk kanë arritur që të punësohen, thjeshtë dekurajojnë secilin të vazhdoj me studimet më tutje.

Konkluzionet

- Varfëria e studentëve është në nivel të lartë në Kosovë.
- Familjet kosovare e kanë shumë të vështirë që të përballojnë shpenzimet për studimet e fëmijeve të tyre.
- Të rinjët kosovar për aplikim në punësim duhet të kenë eksperiencë pune.
- Për të marrë eksperiencë, duhet filluar nga praktika, që janë papagesë ose me pagesë të ulët, e cila nuk mjafton as për mbulimin e shpenzimeve bazë.
- Nëse nuk ndërmirren masa për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë dhe për ta përshtatur atë me tregun e punës, atëherë papunësia tek të rinjët do të thellohet edhe më tej, ndërsa dalja nga vendi e rinisë së kualifikuar do të vazhdoj.

Rekomandimet

- Studentët janë 13% e tërë popullësisë së përgjithshme të Kosovës, andaj duhet të ju kushtohet më shumë kujdes dhe qasje proaktive për zgjedhjen e problemeve ekonomike me të cilat ballafaqohen studentët tanë.
- Ofrimi i mundësive më të mira për punësimin e të rinjëve.
- Qeveria duhet të krijoj kushte dhe mundësi për të gjithë të rinjët, në veçanti studentëve, të cilët kanë treguar sukses të lartë në studime, duke krijuar marrëveshje bashkëpunimi me biznese për të ofruar praktika për studentët dhe punësim.
- Universiteti duhet që të ju ofroj mundësi studentëve për të marrë pjesë në aktivitete shkencore në kuadër të lëmisë së studimeve, dhe të ju ndihmoj në punën e tyre shkencore.

Përfundimi

Faktikisht, menaxhimi i performancës përfshin tipe të ndryshme ose sisteme. Mbikëqyrësit dhe menaxherët janë përgjegjës për menaxhimin e performancës së punonjësve të tyre. Çdo politikë organizacionale duhet të përcaktojë se si do të zbatohet sistemi i menaxhimit të performancës. Organizatat duhet të përshtatin praktika të menaxhimit të performancës, të cilat janë në përputhje me kërkesat e këtyre politikave dhe që përshtaten më mirë me natyrën e punës dhe misionin e organizatës. Nëse punonjësit nuk janë të kënaqur ose nuk janë dakord me sistemin e menaxhimit të performancës, ka të ngjarë që ata të mos kenë dëshirë që të jenë pjesë aktive e këtij procesi, pasi ata e shohin këtë si të pavlerë. Si rezultat, performanca dhe produktiviteti i organizatës do të bien për shkak të inefiçiencës së performancës së dobët të punonjësit. Si përfundim, kjo pikë do të ishte shumë interesante dhe kuptimplotë për çdo organizatë, pasi performanca e punonjësve ka një lidhje të ngushtë me performancën e organizatës. Gjithashtu, të kuptosh se si praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore ndikon performancën e punonjësit, do ta ndihmonte organizatën që të ngrinte një sistem menaxhimi më të mirë dhe si pasojë të ngrinte performancën e punonjësve dhe të organizatës.

Rishikimi i Literaturës

Secila nga organizatat aplikojnë një vendosje efektive të burimeve njerëzore. Përcaktimi i objektivave behët nga ana e organizatës, ndërsa realizimi i objektivave bëhet nga burimet njerëzore. Pra një konkluzion i cili mund të arrihet nga e gjithë kjo është se performanca e një kompanie varet kryekëput nga performanca e punonjësve të sajë. Këtë mund të argumentojmë edhe nga një autorë i cili thotë se: Performanca e një organizate varet nga totali i performancës së anëtarëve të tij. Suksesi i një organizate do të varet nga aftësia e saj për të matur me saktësi performancën e anëtarëve të saj dhe për ta përdorur atë objektivisht për t'i optimizuar ato si një burim jetik. (Biswajeet, 2009).

Një numër i ndryshëm i autorëve argumentojnë se vlerësimi i performancës zhvillohet ne një kontekst social dhe ky kontekst luan një rol të rëndësishëm në efektivitetin e procesit të vlerësimit dhe pjesëmarrësit reagojnë për këtë proces. (Murphy & Cleveland, 1991) publikuan librin e tyre të parë për vlerësimin e performancës, të cilët duke parë nevojën për një model apo qasje të re të vlerësimit të performancës ofruan një rast të mirë studimi. Ata ofrojnë argumente se modelet e mëparshme të autorëve të tjerë si p.sh (Landy & Farr, 1980), ishin shumë të dobishme por (1) i kushtoj vëmendje të pamjaftueshme kontekstit organizativ në të cilin ndodhin vlerësimet, dhe (2) nuk kanë demonstruar lidhje midis hulumtimit të vlerësimit dhe praktikës së vlerësimit (Murphy & Cleveland, 1991).

(Levy & Williams, 2004) argumentojnë se identifikimi, matja dhe përcaktimi i kontekstit organizativ në të cilin bëhet vlerësimi është thelbësor për të kuptuar dhe për të zhvilluar vlerësime efektive të performancës. Më tej, ata besojnë se kjo ka qenë kuadri që ngre hulumtimin e vlerësimit të performancës që nga viti 1990 dhe në fillim të shekullit të 21-të. Gjatë rishikimit të literaturës të vlerësimit të performancës të 7-10 viteve të fundit nuk janë identifikuar mjaftueshëm variablat të cilët e kanë identifikuar procesin e vlerësimit të performancës përveç çështjeve të kulturës, teknologjisë dhe klimës organizative (Hebert & Vorauer, 2003)(Miller, 2003). Ndërsa gjetjet e fundit te autorit (Digh, 1998) tregojnë se ka pasur një thirrje nga praktikuesit që të përdorin llogaridhënien si një mjet për të përmirësuar saktësinë e vlerësimeve të vlerësimit, duke rritur pranimin e sistemit të vlerësimit dhe duke bërë sistemet e burimeve njerëzore më efikase. Për shembull, shumë kompani kanë aplikuar presionet e llogaridhënies ndaj menaxherëve për të përmirësuar stërvitje, si dhe nisma të diversitetit. Kompanitë

si Motorola, Proctor & Gamble, Sara Lee, Texaco dhe Steelcase kanë paraqitur presionet e llogaridhënies për të çuar më tej iniciativat e tyre të diversitetit.
Reaksionet e vlerësimit kanë të bëjnë me qëndrimet e punës (Pettijohn, Pettijohn, & d'Amico, 2001), dhe ndryshimet në perfromancën e punës. Kjo sigurisht është në përputhje me qëllimin parësorë të vlerësimit të performancës, i cili ka të bëjë me diagnostifikimin dhe korrigjimin e problemeve të lidhura me performancën dhe për të lidhur në këtë mënyrë punën individuale të punës dhe produktivitetin organizativ (DeNisi & Gonzalez, 2000).
Modele relativisht të fundit të procesit të vlerësimit të performancës kanë propozuar që konteksti social i vlerësimit të performancës të jetë një fushë e rëndësishme e hulumtimi (Erdogan, 2002), (Ferris, Munyon, Basik, & Buckley, 2008), (Levy & Williams, 2004), (Murphy & Cleveland, 1995). Modeli konceptual i zhvilluar nga (Erdogan, 2002), përfshinte konstruksione të orientuara nga marrëdhëniet shoqërore ose si shkëmbimi i anëtarëve udhëheqëse, si një faktor kontekstual në vlerësimin e performancës, ndërsa modeli i zhvilluar nga (Levy & Williams, 2004) përfshinë cilësia e marrëdhënieve lider-anëtarë besimi i mbikëqyrësit dhe menaxhimi i përshtypjeve. Në organizatat e suksesshme vërehet se proceset e vlerësimit janë të strukturuara dhe formalisht zbatohen në mënyrë sistematike dhe të planifikuar. Organizatat të cilat nuk i ndjekin masat sistematike dhe të planifikuara të vlerësimit të performancës së fuqisë punëtore të tyre, ato duhet të jenë të pasuksesshme në shumë pika. Në kohët e fundit, sistemi i vlerësimit të punonjësve ka një rëndësi të madhe dhe entuziazëm midis punonjësve dhe menaxhmentit. Sistemi i vlerësimit të performancës së punonjësve të duhur ka ndikim jetik në vlerësimin e rritjes, shpërblimit / njohjes, për punë e mirë për zhvillimin e promovimit të punonjësve.

Përkufizimi i menaxhimit të performancës

Menaxhimi i performancës në punë mund të përkufizohet si një proces sistematik për përmirësimin e performancës së një kompanie, përmes një organizimi më të mirë të punës me individët dhe grupet e punës. Është një mënyrë me anë të së cilës kompanitë, grupet e punës dhe individët arrijnë rezultate më të larta në punë, duke i kuptuar dhe menaxhuar ato brenda një platforme të qartë qëllimesh, standardesh dhe kompetencash. Proceset që ai përfshin kërkojnë një mirëkuptim të plotë mbi atë që duhet arrijë kompania; gjithashtu, kërkojnë angazhim dhe motivim të punonjësve, më qëllim që këta të arrijnë si objektivat afatshkurtra dhe ato afatgjata. Menaxhimi i performancës zbatohet dhe drejtohet nga menaxherët e linjës së produktit. Qëllimi kryesor i menaxhimit të performancës është kultivimi i një kulture të lartë në punë, në mënyrë që individët dhe grupet e veçanta të punës të marrin përgjegjësitë përkatëse për të përmirësuar proceset e biznesit, si dhe për të zhvilluar aftësitë dhe kontributin e gjithsecilit brenda platformës së përcaktuar qartë nga grupi drejtues. Kjo do të thotë se qëllimi kryesor i këtij menaxhimi është t'i përqendrojë punonjësit në kryerjen e veprimeve të duhura për arritjen e objektivave (Armstrong, 1994). Në lidhje me menaxhimin e performancës janë dhënë përkufizime të ndryshme nga autor të ndryshëm. Sipas (Lockett, 1992) menaxhimi i performancës nënkupton ''Shndërrimin e individëve në punonjës të aftë dhe të angazhuar për arritjen e objektivave të përbashkëta brenda një kompanie, e cila i mbështet dhe i inkurajon këto arritje''. Të administrosh performancën do të thotë të menaxhosh biznesin (Mohrman & Mohrman, 1995). (Walters, 1995)thotë se menaxhimi i performancës është procesi i ''drejtimit dhe mbështetjes së punonjësve, që të angazhohen sa më shumë për t'i përmbushur nevojat e kompanisë''. Ndërkaq (Armstrong & Baron, 1998) e kanë përkufizuar menaxhimin e performancës si një ndërhyrje strategjike dhe gjithëpërfshirëse, që sjell arritje për kompanitë, përmirëson rezultatet e punonjësve dhe zhvillon aftësitë e grupeve të punës apo të individëve.

Qëllimet e vlerësimit të performancës

Si një pikë nisjeje, është e rëndësishme të theksohet se pjesa më e madhe e provave nga hulumtimet e publikuara deri më tani tregon një ndërlidhje në mes të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të performancës.Megjithatë, këto prova janë të hapura për kritika dhe për këtë arsye ka mundësi për të sfiduar për një numër arsyesh (Jacobs, 1992).

Shumë njerëz kanë një sasi mjaft të madhe të parehatisë / shqetësimit kur mendojnë të bëjnë një vlerësim të performancës. Arsyeja është se shumica e menaxherëve dhe punonjësve nuk e kuptojnë drejt qëllimin e vlerësimit të performancës, e cila është bisedë për gjetjen e zgjidhjeve e jo për gjykim të veprimeve dhe raporteve të parregullta në mes të menaxherit të linjës dhe të një punonjësi. Por, qëllimi kryesor është që të dy palët të nxjerrin qëndrimin e kërkuar, të ndryshojnë sjelljen e tyre , dhënien e informative kthyese konstruktive për të dy palët dhe të gjinden mënyra që punonjësit të përmirësojnë performance e tyre me dëshirë dhe të koordinojnë dëshirat individuale me ato të organizatës.(Dion & Walster, 1986). Vlerësimi i performancës është pjesë e zhvillimit të karrierës. Përsëritja e fundite përcjellë nga organizatat më të mëdha nëpër botë është " paguaju varësisht nga ajo se çka kontribuon". Pra është e qartë se përqendrimi i organizatave është te monitoroi dhe të kthejnë aktivitetet e organizatës në drejtim të menaxhimit të kryerjes së detyrave dhe posaçërisht të performancës individuale.(Carrol & Schneier, 1982). Vlerësimi i performancës ndihmon në notimin e performancës së punonjësit dhe vlerëson kontributin e tyre ndaj qëllimeve të organizatës .Vlerësimi i performancës si zhvillim i karrierës shpie në pranimin e punës të bërë nga punonjësit, shumë herë me qëllim të shpërblimit dhe mirënjohjes dhe të vlerësimit të tij.

Vlerësimi I performancës luan rolin e lidhjes në mes të organizatës dhe qëllimeve të karrierës personale të punonjësit.Vlerësimi potencial është, pjesë e vlerësimit të performance, e cila ndihmon në identifikimin e talenteve të fshehur dhe potencialet e individëve. Me identifikimin e talenteve potencialmunde te ndihmon në përgatitjen e individëve për përgjegjësi më të lartadhe pozita në të ardhmen e afërt. Procesi I vlerësimit të performancës është zhvillues për nga vet natyra(Kujawski & Young , 1979).Vlerësimi I performancës është gjithashtu ngushtë I lidhur me proceset tjera të burimeve njerëzore, sepse ndihmon në identifikimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim, promovim, ulje në pozitë, ndryshime në kompensime etj.Një informatë kthyese e komunikuar në mënyrë pozitive shtonë në mënyrë të konsiderueshme mundësin e motivimit të punonjësit dhe ndihmon në identifikimin individual të planeve të zhvillimit të karrierës. Bazuar në vlerësimin e performancës, punonjësit munde të zhvillojnë qëllimet e karrierës, arrijnë nivele të reja të kompetencave dhe të arrijnë progres në karrierën e tyre.

Sipas gjetjeve të autorëve(Tyler & Lind, 1992) pjesë e vlerësimit social të performancës është edhe teoria e drejtësisë procedurale e cila parashtron problemin që përfshirja në proceset e vendimmarrjes duhet me doemos të rrisë cilësinë e marrëdhënies së punonjësit me figurën e autoritetit, si dhe reagimet e përgjithshme të punonjësit ndaj procesin e vendimit të veçantë. Teoria e drejtësisë ka propozuar gjithashtu që kur cilësia e marrëdhënieve është e ulët, efektet ndreqësuese të zërit po zbuten.Punonjësi dhe menaxheri i linjës diskutojnë në lidhje me detyrat e punës së periudhës së mëparshme dhe në veçanti të vlerësojnë se deri ku kanë mbërri qëllimet e shtruara në bisedat e mëparshme vlerësuese dhe deri në çfarë mase këto janë arritur . Për bisedën e parë vlerësuese duhet të përdoret përshkrimi i punës si pikë nisje. Në të njëjtën kohë, kënaqësinë e një të punësuari, me punën dhe cilësinë e punës dhe bashkëpunimit do të diskutohet midis (punëmarrësit dhe menaxherit të linjës si dhe midis kolegëve) . Duke marrë parasysh fazën e diskutimit dhe qëllimet e organizatës ose të departamentit, synimet e reja për periudhën e ardhshme duhet të bien dakord me të punësuarit. Përkufizimi në vijim në lidhje me qëllimin duhet të merret parasysh: si diçka të pritshme, specifike, të matshme, në kohë të planifikuara, realiste dhe sfiduese.

Pra, nëse cilësia e marrëdhënies(duke përfshirë besimin dhe mbështetjen) është i lartë, atëherë ndoshta gjykimet në lidhje me drejtësinë bëhen më pak të rëndësishme. Kjo do të sugjeronte që pjesëmarrja në vlerësim ka një efekt për cilësinë e marrëdhënieve si të lidhurapër reagimet e vlerësimit. Duke pasur parasysh këto perspektiva pritet që pjesëmarrja në vlerësim të moderojë marrëdhënien ndërmjet cilësisë së marrëdhënieve me ritëm të shpejtë dhe reagimeve të vlerësimit(Gjaku - Murturi , 2012).
Procesi i vlerësimit të performancës është interesant, sepse përfshin dy dinamika instrumentale dhe relacionale ose, me fjalë të tjera, dy lloje të mundshme shkëmbimi: Është e para dhe ndoshta më kryesorja ku konsiderohet si një proces administrativ që përdoret për shpërndarjen e burimeve dhe në këtëajo ka disa elemente të një shkëmbimi ekonomik. Megjithatë, është një proces i ngulitur në një kontekst social - më e rëndësishmja nga të cilat ndoshta është marrëdhënia midis vlerësuesit dhe ati që vlerësohet. Në këtë mënyrë, ajo gjithashtu përfshin elementë të një shkëmbimi shoqëror. Reagimet e punonjësve ndaj vlerësimeve të performancës, rrjedhimisht, lidhen me shpërndarjen e burimeve në proces, si dhe me aspektet relacionale të procesit(Pichler, 2012).Për këto arsye, shkëmbimet sociale janë të dobishme për të kuptuar procesin e vlerësimit të performancës.
Vlerësimi modern i performancës mund të përkufizohet si një ndërveprim i strukturuar dhe formal midis vartësit dhe mbikëqyrësit, që zakonisht merr formën e një interviste periodike (vjetore ose gjysmëvjetore, në të cilin është shqyrtuar dhe diskutuar kryerja e punëve nga vartësit(Woodland, Reilly, & Dix, 1999) , me një paramendim që të identifikohen dobësitë dhe anët e forta, si dhe mundësit për përmirësimin dhe zhvillimin e aftësive profesionale.
Organizatat duhet të jenë të vetëdijshme dhe t'i përcjellin ligjet në vendet e tyre që të munde t'i kufizojnë aftësitë e tyre për shkarkimin e punonjësve ose uljen e pagës. Nëse ky është një përdorim i duhur i vlerësimit të performancës – caktimi dhe arsyetimi i shpërblimeve dhe gjobave është një çështje shumë e pasigurt dhe e diskutueshme.

Trajnimi mbi vlerësimin e performancës

Gati të gjitha organizatat bëjnë vlerësim të performancës për vlerësim të performancës së punëtorëve dhe organizatës. Por, nëse nuk është mbajtur në mënyrën e duhur, ata mund të japin përshtypje jo të vërtet lidhur me performancën e punëtoreve e që do të ndikoj në performancën e përgjithshme të organizatës : megjithatë ekziston nevoja për trajnim të vlerësuesve që të sigurohen për maksimumin e efektivitetit të procesit. Studimet kanë zbuluar se në të shumtën e rasteve mbahen nga ana e menaxherëve dhe mbikëqyrësve, të cilët në disa raste nuk janë të vetëdijshëm për procedurat që duhet t'i ndjekin. Atyre duhet të ju sqarohet rëndësia dhe ndikimi i vlerësimit të performancës për organizatën, metodat që duhet të ndiqen dhe principet dhe procesin e vlerësimit(Bagchi, 1999). Të gjithë menaxherët dhe mbikëqyrësit të cilët i referohen vlerësimit të performancës duhet të trajnohen për pikat në vazhdim.
Metodat, teknikat dhe udhëzimet për vendosjen e qëllimeve objektivave
Si të vlerësohet performanca dhe norma e punëtorëve
Standardet për dokumentim të performancës
Si të kompletohet një formë e vlerësimit të performancës
Si të pohojmë në mënyrë objektive në vlerësim
Teknikat e të pyeturit për vlerësim
Përgjigjja ndaj reagimeve të punëtorëve
Përmirësimi i raporteve dhe komunikimit
Ndërtimi i moralit dhe motivimi i punëtorëve
Vëzhgimi dhe matja e performancës
Kufijtë e rezultateve
Strukturimi i intervistimit, duke u fokusuar në përmirësimin e performancës
Teknikat e informatës kthyese /feedback

Si të merren me jo performues dhe njerëz të cilët refuzojnë të bashkëpunojnë
Veprimet pas rishikimit(Gjaku - Murturi , 2012)
Andaj kjo na lë të kuptojmë se për një organizatë që ajo të jetë efektive deh t'i arrij qëllimet e veta, është shumë e rëndësishme që të monitoroj dhe masë performancën e saj dhe të punëtorëve të sah në baza të rregullta. Monitorimi dhe matja efektive, përfshinë dhënien në kohë të informatës kthyese dhe rishikimeve të punëtorëve lidhur me punën e tyre dhe performancën e bazuar dhe qëllimeve paraprakisht të determinuar, standardeve dhe zgjedhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen. Njohja me kohë e të arriturave gjithashtu motivon punëtorët dhe ndihmon në përforcimin e performancës. Prandaj detyrë kryesore e Menaxhmenti janë detyrat për stafin e duhur, duke përfshirë vlerësimin e performancës profesionale dhe moderne dhe sistemimin e promovimit.

6. Përfundime

Studimi I menaxhimit të performancës, si një fushë studimi, është një çështje e njohur në fushën e burimeve njerëzore.Organizata duhet të krijojë strategji për identifikimin, inkurajimin, vlerësimin, përmirësimin dhe shpërblimin e performancës së punonjësve në punë.Si rrjedhoje përmirësimi I performaces së punonjësve munde të ndikojë në performance e organizates. Për këtë arsye ky studim si për qëllim ka sistemin e menaxhimit të performancës mbi performancën. Objekt tjeter studimi ishte edhe analizimi I treguesve të sistemit të menaxhimit të performancës dhe marrëdhënia e tyre në raport me performancën e punonjësit.Organizata duhet të promovojë punonjësit, nëse ata kanë performancë të mire, në këtë mënyrë punonjësi munde të motivohet për të bërë një punë të mire dhe të ndikojë në performancën e organizatës.

Rekomandime

- Duhet që çdo organizatë zviloj kritere dhe instrumente sa më cilësore për vlerësimin e performancës (p.sh qendra vlerësimi) për të ngritur në detyrë anëtaret e stafit në bazë të aftësive të tyre menaxhuese dhe udhëheqëse.
- Duhet që të zhvillohen një grup testimesh, rezultatet e të cilave munde të udhëheqin zgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm për vendet e reja të punës.
- Fuqizimi i delegimit , me monitorimin e duhur të performancës, si dhe rritja e antonimisë në tërë nivelet.

Bibliografia

[1.]Armstrong, M. (1994). *Performance Managment.*

[2.] Armstrong, M., & Baron, A. (1998). *Performance Management: The new realities.* London: Institute of Personnel and Development.

[3.] Bagchi, A. K. (1999). *Recognition of complecsity leads to human solutions* . Fronline.

[4.] Biswajeet, P. (2009). *Human Resource Management,*. I Learning Private Limited.

[5.] Carrol, S. J., & Schneier, C. E. (1982). Performance Appraisal and Review Systems . 40.

[6.] DeNisi, A., & Gonzalez, J. A. (2000). *Performance appraisal.* London: Blackwell.

[7.] Digh, B. (1998). The next challenge: Holding people accountable. *HR Magazine, 43.63*.

[8.] Dion, B. K., & Walster, E. (1986). What is beatiful is good . *Journal of Personality and Social Psychology* , 285-290.

[9.] Erdogan, B. (2002). Antecedents and consequences of justice perceptions in performance appraisals. *Human Resource Management Review* , 555–578.

[10.]Ferris, G. R., Munyon, T. P., Basik, K., & Buckley, M. R. (2008). The performance evaluation context: Social, emotional, cognitive, political, and relationship components. *Human Resource Management Review* , 146–116.

[11.] Gjaku - Murturi , F. (2012). *Menaxhimi i burimeve njerëzore.* Prishtinë: 249-250.

[12.] Hebert, B. G., & Vorauer, J. D. (2003). Seeing through the screen: Is evaluative feedback communicated more effectively in face-to-face or computer-mediated exchanges? *Computers in Human Behavior* , 25-38.

[13.] Jacobs, R. L. (1992). *Structured on the job training in H.D. Stolovich & E.J. & Keeps (Est) Handbook of human performance technology.*

[14.] Kujawski, C. J., & Young , D. M. (1979). Appraisals of 'People'Resorces.". *Handbook of Personnel and Indsutrial Relations* .

[15.] Landy, J. F., & Farr, J. (1980). Performance rating. *Psychological Bulletin* , 72–107.

[16.] Levy, P. E., & Williams, J. R. (2004). The Social Context of Performance Appraisal: A Review and Framework for the Future. *Journal of Management* , 881–905.

[17.] Lockett, J. (1992). *Effective Performance Managment.* London: Kogan Page.

[18.]Miller, J. S. (2003). High tech and high performance: Managing appraisal in the information age. *Journal of Labor Research* , 409.

[19.]Mohrman, A. M., & Mohrman, S. A. (1995). Performance managment is 'running the business'. *Compensation and Benefits Review* , 69-75.

[20.]Murphy, K. R., & Cleveland, J. N. (1991). *Performance appraisal: An organizational perspective.* Boston: Allyn & Bacon.

[21.]Murphy, K. R., & Cleveland, J. N. (1995). *Understanding performance appraisal: Social, organizational,and goal-based perspectives.* Thousand Oaks: CA: Sage.

[22.] Pettijohn, C. E., Pettijohn, L. S., & d'Amico, M. (2001). Characteristics of performance appraisals and their impact on sales force satisfaction. *Human Resource Development Quarterly* , 127–146.

[23.]Pichler, S. (2012). THE SOCIAL CONTEXT OF PERFORMANCE APPRAISAL AND APPRAISAL REACTIONS A META-ANALYSIS . 4-9.

[24.]Tyler, T. R., & Lind, E. A. (1992). A relational model of authority in groups. Advances in Experimental Social Psychology, . 115-19

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

AFTËSITË GJUHËSORE TË NXËNËSVE MINORITARË.

VËZHGIM DHE ANALIZË E PËRVETËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE NJOHURIVE LETRARE PREJ NXËNËSVE MINORITARË ROM DHE MAQEDONAS

Ilir Shyta-Departamenti i Gjuhë-letërsisëUniversiteti i "Fan S. Noli" Korçë, Shqipëri

Abstrakt

Kjo temë synon të trajtojë nivelin arsimor të nxënësve të minoritetit maqedonas dhe atij rom, në Rajonin e Korçës. Këto minoritete ruajnë brenda komunitetit të tyre gjuhën, zakonet dhe traditat e vendeve të origjinës.Në programet e ciklit 9-vjeçar, në shkollat e Komunës Liqenas, ku është i pranishëm minoriteti maqedonas, përfshihet mësimi i gjuhës maqedonase, si gjuhë amtare, i historisë dhe i gjeografisë së Maqedonisë. Prania e këtyre programeve mësimore të arsimit parauniversitar tregon politkën arsimore gjithëpërfshirëse të shtetit shqiptar për të siguruar të drejtat e këtij minoriteti në vendin tonë. Ndërkohë, minoriteti rom duke qenë gjeografikisht i vendosur në qytetin e Korçës dhe në rrethinat e saj, paraqet një përfshirje më të madhe në jetën shoqërore. Në programet shkollore të cilkit nëntëvjeçar, në shkollat ku ata mësojnë, mungon programi i gjuhës së tyre amtare. Nisur nga prania e dy minoriteteve në shkollat nëntëvjeçare të Rajonit të Korçës, do të trajtojmë nivelin e këtyre nxënësve në programet e gjuhës shqipe dhe të leximit letrar; do të analizojmë aftësitë gjuhësore dhe letrare, si shprehësia dhe përvetsimi i gjuhës standarde shqipe, krahas gjuhës së tyre amtare. Kërkimi ynë analizues do të jetë empirik duke u realizuar në bazë të disa testimevetë kryera në programin e ciklit 9-vjeçar në shkollat përkatëse.Në këtë temë do të trajtohen gjithashtu tiparet dhe veçoritë e tyre sociale, përfshirja në shoqërinë shqiptare si dhe dallimet e tyre si pasojë e identitetit të ndryshëm nga ai i bashkëmoshatarëve të tjerë.Integrimi i nxënësve minoritarë në programet shkollore të unifikuara, do të bëjë që ky brez i ri të përfshihet denjësisht në sfidat shoqërore të së ardhmes.

Keywords: arsim, minoritet, maqedonas, rom, program, gjuhë, letërsi,

Vëzhgim dhe analizë e përvetësimit të gjuhës shqipe dhe njohurive letrare prej nxënësve minoritarë rom dhe maqedonas

Arsimimi përbën të drejtën themelore për të gjithë njerëzit, pa dallim feje, përkatësie shoqërore dhe etnike. Qëllimi i arsimimit është të përgatisë fëmijët dhe të rinjtë për t'u bërë qytetarë të denjë dhe aktivë. Për ta bërë këtë, arsimi duhet të zhvillojë inteligjencën e fëmijëve, duhet t'i nxitë ata të mendojnë dhe reflektojnë në mënyrë që të jenë të aftë të përballin sfidat e së ardhmes.Shkolla si vendi ku bëjnë pjesë qytetarët më të rinj të komunitetit, të cilët përfshihen në botën jashtë mjedisit të tyre familjar, ndikon mjaft në formimin e brezit të ri, përvijon figurën e tyre si qytetarë të së nesërmes; rrënjos tek ata dijet bazë të disiplinave të ndryshme; i pajis ata me një "pasaportë" e cila u hap dyert e jetës. Për këtë arsye sistemet arsimore janë mjetet më të rëndësishme dhe më ndikuese, sepse ato sigurojnë respekt për qytetarët me prejardhje të ndryshme kulturore dhe etnike. Në ditët tona arsimi është kthyer në qëllimin kryesor të prindërve, por edhe të të rinjve. Kudo në vendin tonë vihet re dëshira për t'u arsimuar në të gjitha ciklet e sistemit arsimor si në atë parauniversitar dhe në atë universitar.

Mes të rinjve që dëshirojnë të shkollohen bëjnë pjesë edhe nxënësit minoritarë të përkatësisë etnike rome dhe maqedonase që jetojnë në rrethin e Korçës. Të ardhmen e zgjidhjes së problemeve arsimore, ata e shohin përgjithësisht tek shkollat publike dhe jopublike, duke nënkuptuar pjesëmarrjen e shtetit dhe shoqërisë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë dhe disiplinojnë zgjidhjen e problemeve arsimore në komunitetet etnike në Shqipëri. Përveç dëshirës dhe përkushtimit të tyre për t'u arsimuar, statistikat e bëra në rrethin e Korçës tregojnë se dukuria e braktisjes së shkollës spikat tek nxënësit me etni rome, ndërsa te nxënësit me etni maqedonase kjo dukuri nuk shfaqet. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që e kanë braktisur shkollën në rrethin e Korçës, 65 % e tyre janë nxënës rom dhe egjiptianë. Sipas studimeve të kryera nga DAR-ja Korçë, shkaqet e braktisjes së shkollës nga fëmijët rom dhe egjiptianë janë: për arsye sociale dhe ekonomike.

Minoriteti rom ka ardhur në Shqipëri rreth 800 vjet më parë. Ata kanë ardhur nga Turqia dhe Greqia nëpërmjet Follorinës dhe janë vendosur në zonën e Korçës, Pogradecit dhe Bilishtit, mandej me jetën e tyre boheme, janë shpërndarë nëpër Shqipëri. Megjithatë romët nuk janë as pakicë, ata quhen vetëm formalisht të tillë, sepse nuk kanë një shtet referent të saktë për origjinë. Dhe pse ata kanë ardhur në Shqipëri prej shekujsh, nuk jetojnë në mënyrë të barabartë si pjesa tjetër e qytetarëve, sepse shpesh ata bien pre e diskriminimit të pjesës tjetër të shoqërisë. Komuniteti rom është i dallueshëm prej pjesës tjetër të popullsisë. Ata shfaqin tipare fizike të dallueshme si ngjyra e lëkurës dhe e flokëve, po kështu ata ruajnë me fanatizëm traditat dhe zakonet e etnisë së tyre, jetojnë dhe zbatojnë normat e vendosura brenda grupit të tyre etnik rom.

Ndërkaq, në brigjet perëndimore të liqenit të Prespës së Madhe (pjesa e Shqipërisë) përtej Qafës së Zvezdës, jeton mironiteti maqedonas i shtrirë në nëntë fashatra (Komuna Liqenas), me popullsi 4.548 banorë.

Në planet mësimore të arsimit bazë, të hartuara posaçërisht për programet shkollore të këtij minoriteti nga MASH-i, vihet re prania e mësimit të gjuhës amtare maqedonase, si edhe ajo e gjuhës shqipe. Përveç gjuhës maqedonase, në këto programe vihet re edhe mësimi i historisë dhe gjeografisë amtare maqedonase. Mbingarkesa e nxënësve me programe paralele në gjuhën shqipe dhe në atë maqedonase është një problem i dukshëm në orientimin e tyre gjuhësor.

Objekti i kumtesës sonë përfshin vëzhgime dhe analiza mbi aftësitë gjuhësore dhe letrare të nxënësve të minoritetit maqedonas dhe atij rom, të cilat janë të dallueshme nga aftësitë e nxënësve shqiptarë, për shkak të përkatësisë së tyre në një bashkësi tjetër gjuhësore.

**** Përvetësimi i aftësive gjuhësore***

Hapësira në të cilën shtrihet komuna e Liqenasit, me nëntë fshatrat ku banon minoriteti maqedonas përbën një hapësirë dygjuhësore. Hapësira dygjuhësore është ajo hapësirë e kufizuar në të cilën dëgjohen më shumë se një gjuhë, por që shumica e folësve janë njëgjuhësorë, të cilët kanë pak kontakt me folës nga grupe entike fqinje, kjo zonë ose hapësirë quhet "hapësirë dygjuhësore" (bipart lingual). Kjo është një hapësirë e gjuhëve në kontakt, ku gjuha maqedonase është në kontakt me gjuhën shqipe. Kontakti mes gjuhëve ka sjellë ndikime të ndërsjella tek këto gjuhë, duke përvijuar kështu dukurinë e interferencës gjuhësore. Ballkani është shembull tipik i kësaj dukurie.

Bashkësia gjuhësore e folësve në këtë zonë përbëhet nga folës amtarë të gjuhës maqedonase, ndërsa gjuha shqipe ka statusin e gjuhës së dytë të mësuar në shkollë.

Ndërsa bashkësia gjuhësore rome nuk përbën një hapësirë dygjuhësore, sepse romët nuk jetojnë në një zonë të veçuar kufitare, por jetojnë në brendësi të rrethit të Korçës. Bashkësia gjuhësore e tyre përbëhet nga folës të cilët krahas gjuhës shqipe, të cilën e mësojnë në kushte të barabarta me folës të tjerë amtarë të shqipes, flasin edhe gjuhën e tyre amtare, gjuhën rome.

Në këtë kontekst kemi të bëjmë me një situatë dygjuhësore, në të cilën gjëllon dukuria e bilinguizmit. Bilinguizmi është studiuar gjerësisht nga:

- Gjuhëtarë, që janë interesuar për mënyrën sesi folës të një gjuhe strehojnë impaktin ose ndikimin e një gjuhe tjetër në veten e tyre;
- Sociologë dhe sociolinguistë të cilët gjurmojnë ndryshimin në zakonet shoqërore si një funskion i ndryshimit në gjuhë;
- Mësues, të interesuar të zvogëlojnë efektet ndërhyrëse të një gjuhe kur mësohet gjuha tjetër;
- Psikologë, që janë të intersuar për bilinguizmin si një laborator natyror për studimin e mënyrës sesi mendja paraqet njohurinë e saj. Dhe sigurisht nga shumë të tjerë.[65]

Bilinguizmi është një term i cili i referohet aftësisë së një folësi për të komunikuar në dy ose më shumë gjuhë[66]. Dukuria shfaqet zakonisht në zonat kufitare, sidomos në ato ku kufijtë gjeografikë ndryshojnë herë pas here. Dygjuhësia në planin e përdorimit të gjuhës është manifestim i kontaktit në mes të kulturave. Për disa bilinguizmi nënkupton një aftësi të barabartë, të njëjtë komunikimi në të dy gjuhët. Për të tjerë bilinguizmi nënkupton aftësinë e komunikimit në të dy gjuhët por me aftësi më të mëdha në njërën prej tyre.

Përveç termit bilinguilizëm, në literaturën përkatëse haset edhe termi "diglosi". Fergusoni (1959) saktëson se një situatë e qëndrueshme e kontaktit ndërmjet gjuhëve është quajtur diglosi, term me të cilin ai mëton bashkekzistencën e dy gjuhëve, një varietet i të cilave përdoret në mënyrë komplementare ndaj tjetrës, sipas sferave të ndryshme të veprimtarisë[67].

Në bashkësitë gjuhësore të minoriteteteve përkatës vihet re një situatë diglosie me elemente të dygjuhësisë. Është e domosdoshme të bëhet një dallim ndërmjet dy bashkësive gjuhësore. Në bashkësinë gjuhësore të minoritetit maqedonas, gjuha maqedonase është gjuhë amtare me përdorim të gjerë në jetën shoqërore dhe familjare të tyre. Anëtarët e këtij minoriteti parapëlqejnë të flasin gjuhën e tyre amtare në mjaft sfera të jetës së tyre, kundrejt gjuhës shqipe. Varianti i tyre i maqedonishtes

[65]Paul A. Kolers, Wolrd of Mind, pg.10
[66]Britannica Concise Encyclopedia, pg. 215

[67]GJ. Shkurtaj, Sociolinguistika, fq. 85.

përbën për ta varietetin e lartë, gjuhën eprore, e cila përdoret si jashtë familjes, ashtu dhe brenda saj. Gjuha shqipe, në raport me variantin e tyre të maqedonishtes shihet si varietet i ulet, nuk parapëlqehet për t'u folur, edhe pse është në statusin e gjuhës zyrtare. Sjellja e këtyre folësve ndaj gjuhës së tyre përcaktohet nga fakti se ata gjuhën e vet amtare e ndiejnë si tipar themelor të shprehjes së etnicitetit të tyre. Kjo varet në radhë të parë nga faktorët politikë dhe sociokulturorë.

Ndërsa në bashkësinë gjuhësore të minoritetit rom vihet re një situatë diglosie e pastër. Gjuha e tyre amtare ka një përdorim shumë të ngushtë, është në nivelin e varietetit të pakodifikuar, që përdoret në familje dhe me miqtë, në problemet e punëve shtëpiake dhe të sferës së ndjenjave. Vihet re se gjuhën e tyre amtare romët po e përdorin gjithnjë e më pak edhe mes tyre ata po përdorin gjithnjë e më tepër gjuhën shqipe. Gjuha rome ka karakteristikat e një gjuhe që nuk zotëron prestigj të mjaftueshëm, si e tillë kjo gjuhë nuk ushtron kontroll shoqëror mjaft të fortë në bashkësinë përkatëse.

Në këtë kumtesë jemi ndalur në studimin e përvetësimit të gjuhës shqipe nga nxënës minoritarë maqedonas dhe rom. Përvetësimi i gjuhës është procesi i të mësuarit të një gjuhe amtare ose i një gjuhe të dytë. Përvetësimi i gjuhës amtare është studiuar fillimisht nga psikologë dhe psikolinguistë. Përvetësimi i gjuhëve të dyta ose të huaja është studiuar fillimisht nga gjuhësia e aplikuar. Ata që mësojnë një gjuhë të dytë kalojnë të njëjtat faza siç bëjnë fëmijët që mësojnë gjuhën e tyre amtare. Megjithatë, njerëzit rrallë bëhen aq të rrjedhshëm në një gjuhë të dytë siç janë në gjuhën amtare.Nuk ka të dhëna të sugjerojnë se është më e vështirë për një fëmijë të përvetësojë dy gjuhë sesa është për të të përvetësojë një gjuhë. Për sa kohë që njerëzit flasin rregullisht me fëmijën në të dy gjuhët, fëmija do t'i përvetësojë ato të dyja lehtësisht. Një fëmijë nuk ka pse të jetë i jashtëzakonshëm (ose rast përjashtimi) apo të ketë ndonjë aftësi gjuhësore të veçantë për t'u bërë biling: për sa kohë që fëmija është i ekspozuar ndaj të dy gjuhëve përgjatë fëmijërisë së hershme, ai do t'i përvetësojë ato të dyja[68]. Fëmijët nuk mund të jenë njëlloj të aftësuar në të dy gjuhët. Është më e zakonshme në këtë rast që ata të jenë dëgjues më të mirë sesa përdorues aktualë të një gjuhe. Probleme të gjuhës së folur shfaqen më të pakta ku të dy gjuhët prezantohen apo paraqiten herët dhe njëheresh ose në një kohë.

Në përvetësimin e një gjuhe të caktuar nga fëmijët dihet se rol të rëndësishëm luan mjedisi ku ai rritet, si dhe trashëgimia familjare. Inputi i përvetësimit të gjuhës është gjuha ose e folura e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Përvetësimi i gjuhës varet nga një modul specific, i lindur, i cili është i ndryshëm nga inteligjenca e përgjithshme. Në fakt përvetësimi i gjuhës duhet të ndihmojë në gjetjen se si trashëgimia dhe mjedisi ndërveprojnë.Në këtë kontekst, në të dy bashkësitë e nxënësve të marrë në studim, të dy këto elemente, mjedisi dhe trashëgimia familjare luajnë një rol vendimtar në përvetësimin e gjuhës amtare si dhe të gjuhës shqipe nga këta nxënës. Nxënësit e minoritetit rom e zotërojnë gjuhën shqipe në të njëjtin nivel si dhe nxënësit e tjerë, folës amtarë të saj. Mjedisi ku ata rriten, të rrethuar nga folës amtarë të shqipes me të cilët ndajnë përvojën e tyre të jetës së përditshme; mësimi i gjuhës shqipe që në klasën e parë, si dhe zhvillimi i të gjitha lëndëve shkollore në këtë gjuhë, ndërveprojnë së bashku në marrjen e njohurive të plotë të gjuhës shqipe dhe në përdorimin pa asnjë dallim nga folësit amtarë të shqipes. Ndërkaq për këta nxënës nuk është e mundur të mësojnë të shkruajnë edhe gjuhën e tyre amtare, atë rome, duke qenë se kjo gjuhë nuk dëshmohet me variantin e vet të shkruar.

Veçoritë që u vunë re nga studimi i punëve të tyre me shkrim, si dhe i testeve të gjuhës shqipe janë këto:

[68]Britannica Concise Encyclopedia, pg. 200

- zotërim shumë i mirë i strukturave gramatikore të shqipes,

- gabime në drejtshkrimin e shqipes, të ndikuara edhe nga tipare dialektore*: e mer; ka qenë lojtarë; ai nuk lotë më; kthev; pëlqevi;*

- ndikime nga e folura dialektore e zonës së Korçës: *odhi një sy; ay është më i miri; i kishte yrë frika; çeljen e atyre luleve aq të mbrekullueshme,*

- tipare të gjuhës së folur, të gjendura a të përdorura brenda grupit të tyre etnik si: *pas stinës së pranverës vin stina e verës, pas stinës së verës vin stina e vjeshtës;ka qenë një ga lojtarët; unë ndjek një tenelovelë,*

- nga vëzhgimi i testeve vumë re se normat gramatikore të mësuara janë të kënaqshme, nxënësit rom arrijnë të dallojnë grupin emëror nga ai foljor; ndarja e gjymtyrëve të fjalisë përgjithësisht është e drejtë, por përzihet me elemente të analizës morfologjike. Dallojnë qartë kryefjalën dhe përcaktorin kallëzuesor, por për kallëzuesin pothuajse të gjithë përdorin termin "folje".Shihen vështirësi në përdorimin e parafjalëve në togfjalëshat: *gjumë me ëndrra; burrë e (rreth) të pesëdhjetave; dashuria e (për) prindërit* etj.

Gjatë vëzhgimit të punëve të nxënësve minoritarë maqedonas u vu re se njohuritë gjuhësore të shqipes nuk janë përvetësuar në një nivel të kënaqshëm. Në gjuhën e shkruar të këtyre nxënësve vihet re se struktura e gjuhës shqipe karakterizohet nga veçori fonetikore, gramatikore e leksikore të mbartura nga gjuha maqedonase.

Veçori fonetikore:

Në shqipen e shkruar dhe të folur të nxënësve minoritarë maqedonas vihen re veçori fonetikore të sistemit fonologjik të gjuhës maqedonase. Këto veçori vijnë e formojnë një nënsistem fonologjik në gjuhën e shkruar dhe të folur shqipe. Të gjithë minoritarët maqedonas dallohen në shqiptimin e fonemave të veçanta të shqipes. Ndërsa në gjuhën e shkruar vihen re:

-përdorimi i bashkëtingëllores l në vend të ll-së:

e gëltiti (l për ll); balena është një gjalesë që jeton në ujë;

-përdorimi i bashkëtingëllores s në vend të sh-së:

lule shumëngjyrëse; do që të largohes;

-përdorimi i bashkëtingëllores v në vend të f-së:

çvarë mendon;

Veçori gramatikore:

- përdorimi i formave joveprore të foljeve të cilat në gjuhën shqipe përdoren në formën veprore:

u shëtitëm disa herë me varkë;liqeni që u shëtisëm ishte;jam lindur në;ishte një djaë ishte hipur asnjëherë në anije;shëtitemi përgjatatë bregut; të gjithë njerëzve u është interesante për të dëgjuar një prallë;ishte hera e parë që hipej në anije; ai shikohej si i çuditshëm në të gjitha anët; sepse njerëzit mësohen ndonjë gjë nga përallat; edhe pse nuk kam japur gjithçka që kam; është lindur në tetor; ne ndihmohemi njëra-tjetra; është lindur ndonjëherë ideja; m'u falenderua;

- mospërputhje në kategorinë e numrit mes kryefjalës dhe kallëzuesit:

në zgjidhjen e problemeve nuk më ndihmon asnjeri por unë e zgjidh vetë; aty gjendet hotele, resturante të ndryshme; rrugës flasin për ushëtimin; kur mbërritëm në shtëpi ishim shumë e gëzuar; në të ardhmen duhet të ndryshojë shumë gjëra;

Gabime në vendosjen e emrave në rasat përkatëse:

- emërorja në vend të kallëzores:

fshatari e kapi pula; ajo rinë në banga e parë, kurse unë në të dyta; ne ndihmohemi njëra-tjetra; kur zbritëm aty e pamë vendi të bukur;për të të dhënë kjo perlë;ky udhëtim do ta mbaj menëd për të gjith jetën time;

-kallëzorja në vend të emërores:

e hoqi mendjen nga atë gjë; sa e rëndësishme është për ty mbështetjen nga njerëzit e afërt;kur djali shkoi te kolombrenë; këtë dashuri të madhe për futbollin ka ardhur nga babi im;

-kallëzore në vend të rrjedhores:

të luftonte kundër kolombrenë;

-emërorja në vend të rrjedhores:

mes ato fusha të bukura me një liqen i madhe me ujë të pastër; që të luftonte kundër kolombreja; ndaj të tjerët; midis njerëzit;

- emërores: rrjedhore në vend të

këto dy vende të përshtatura për jetës tonë të përbashkëta;

- rrjedhore në vend të kallëzores:

që ta merrte me vetes;

- emërorja në vend të dhanores:

përallat i duhen njerëzit;

- gjinore e parregullt:

kallëzore në vend të gjinores:

e hetoi sipërfaqen e detin; nuk ia kishte zënë në gojë punën e peshkaqenin misterioz;

- emërore në vend të gjinores:

lumuria e familja ime;të mbushësh mendjen e nënës jote;

- gabime në përdorimin e vetës tek foljet dhe nyja me vlerë pronori:

në të ardhmen duhet të ndryshojë shumë gjëra;nqse do të jen të lumtur edhe unë do të jam i lumtur;rrugës flasin për ushëtimin; më pëlqen kur unë i kërkoj ndonjë gjëtë atit;

- gabime në numër:

rrëfejnë në mënyrat gjithnjë të re; të mos punoj puna të rënda;

- gabime në kohë:

qeni shikua një krimb; kur e shikua fshatari pula të e haj krimbin dhe gjahtari fillua me vrap të kap pula për gjah;donim që ajo ditë të mos mbaron kurë;

- gabime në nyjat e përparme të mbiemrave:

të jesh të gatshëm të rrezikosh;mes ato fusha të bukura me një liqen i madhe;nëse do të isha një peshk të madhe dhe të notoja;të krijoj një familje e lumtur;ajo me gojën të saj të madhe katapen peshq të tjerë të vegjël; nëse do të isha një peshk të madhe dhe të notoja;që të bëhet sa më të bukur; kam njohurë një vajzë shumë e mirë në shkollën; kur mbërritëm në shtëpi ishim shumë e gëzuar;

- përdorimi i dy kundrinave, edhe trajtë e shkurtër e rasës kallëzore, edhe emër në kallëzore:

fillimisht <u>e</u> vizituam <u>portin</u> e Durrsit; pastaj shkuam <u>e</u> vizituam <u>kalan</u> e Durrësit;<u>e</u> vizitova <u>sheshin</u> Skënderbej;

Veçori leksikore:

Gjatë vëzhgimit të shqipes së shkruar nuk u vunë re leksema nga gjuha maqedonase. Nxënësit e minoritetit maqedonas nuk përdorin në shqipe fjalë të gjuhës së tyre amtare. Një përdorim i veçuar i fjalës "*babo*" për *baba.*Si duket këta nxënës arrijnë të bëjnë shumë mirë dallimin në fushën e lëksikut ndërmjet të dy gjuhëve.

Përveç këtyre veçorive, në gjuhën shqipe të shkruar të këtyre nxënësve, si në punët me shkrim, edhe në testimet e lëndës së gjuhës shqipe u vunë re edhe gabime drejtshkrimore. Gabimet në

drejtshkrim mendohet se janë pjesë e gabimeve të përgjithshme drejtshkrimore të të gjithë nxënësve bashkëmoshatarë, minoritarë ose jominoritarë. Kështu vihen re:

- gabime në përdorimin e zanores *ë:*

prallat; fëmijria; të vështir; kryesishtë;e vetë; kuvendin e Shqipris;si të realizojm; çfarë të frikson; brënda; fjal; kamë frikë;fëmijria ime; si e vlerson lojën time; një lum; brënda;

- gabime në përdorimin e bashkëtingëlloreve:
- bashkëtingëllorja *j* në vend të zanores *i:emocjonet; ndjen;*
- përdorimi i gabuar i bashkëtingëllores *rr:*

erësira; e marin me mend se përallat; të riturit;një regull; kur aritëm;

- gabime në përdorimin e apostrofit: *për ti gëzuar; për ti lexuar;*

***Përvetësimi i aftësive letrare**

Ajo që vihet re në punët me shkrim të nxënësve minoritarë rom e maqedonas, përveç aftësive të tyre gjuhësore, është edhe aftësimi i tyre letrar në punët me shkrim që ata kanë realizuar në shkollat përkatëse.

Në përdorimin e figurave letrare këta nxënës, vështirësitë e tyre i hasnin tek përdorimi i tropeve, i pakuptimtë ndonjëherë dhe jofunksional në punët e tyre krijuese. Ky vështrim të jep mundësinë, të arrish në përfundimin, se punët krijuese lënë shumë për të dëshiruar te nxënësit pjesëtarë të komunitetit maqedonas dhe mospërdorim të kurrëfartë te nxënësit rom.

Për shembull, nëse përrallat janë pasqyrim i jetës sonë, ato, në punimet e nxënësve të klasave të teta, nuk interpretohen si pjesë e figurshme, por si pjesë enumerative jo e figurshme e përditshmërisë sonë. Me një fjalë mungon trajtesa e figurës së tropit si figurë mirëfilli gjuhësore.Ndërkaq bota e tyre e brendshme, tek tema me shkrim "Bota ime e brendshme" sërish nuk realizohet si pjesë e tropeve, më saktë ngatërrohet ngushtësisht lidhja metonimi-sinekdotë, për të paraqitur më pak ose më shumë elemente dalluese të cilësive të botës së brendshme të fëmijëve.

Veç kësaj, një përfundim tjetër nxirret nga shkaqet kryesore që vijnë si pjesë e të metave nga përvetësimi i plotë i anës teoriko-letrare te vetë nxënësit e kësaj zone, të cilët nuk arrijnë të kthejnë në proces krijues, dijet e fituara, gjë që çon në zbehjen e shijeve artistike të tyre.

Komuniteti rom, përdorimin e figurave trop, e injorojnë fare, duke prezantuar elemente të zhargonit të përditshëm jo letrar.

Idetë e nxënësve të shprehura në punët e tyre me shkrim, shpesh janë të cekëta te të dy minoritet. Kur idetë e tyre, vishen me lëndën letrare, menjëherë motivojnë përpjekjet e botës së tyre shpirtërore për një shprehësi letrare jo të cunguar. Mendimi letrar i aplikuar në punët krijuese depërton thellë në imtësi artistike për t'i kthyer ato, në emocione, në dëshira apo për t'i konkretizuar në jetë.

Aftësimi letrar, nxënësve u zhvillon atyre fantazinë, i bën të gjykojnë, të vlerësojnë dhe të mendojnë si një pjesë e integruar në shoqërinë tonë, për të qenë të vendosur dhe të qendrushëm në bindjet e tyre.Përdorimi i saktë letrar i fjalëve, i bën ato mjet të inteligjencës dhe përçuese të mendimit të gjithkujt. Në këtë kuadër ato bëhen një mjet i fortë shprehësie në komunikimin gojor dhe shkrimor. Sa më i fortë të jetë ky formim, aq më i fortë është formimi i personalitetit njerëzor te ata. Forcën e gjuhës letrare nuk ka gjë që e zëvendëson.

Parë në këtë këndvështrim një nxënës shkruan:

"*Kjo poezi, e Lasgushit* (Poradeci është poezia të cilës ai i referohet) *është vërtet më e bukura, midis më të bukura të Lasgushi".* Ky mendim është tepër i thatë dhe mbetet një stereotip i përgjithshëm që duket se nuk thotë asgjë, kur edhe argumentimi sqarues është sërish tepër i thatë. Më tej nxënësi në punën krijuese të cituar, zbërthen brendinë e poezisë po me një zhargon fjalish të gjata, por këtë radhë duke u ndalur te bukuritë që ai mendon se janë të tilla në Pogradec, duke pasur parasysh edhe ato që ka dëgjuar nga të tjerët.

Përsa i përket fundit të punëve me shkrim ndërtuar mbi të njëjtën poezi të Lasushit, hasim këtu një mbyllje sintetike te të dy minoritetet, që mund të jetë një pohim i stërnjohur ose shumë dëgjuar:

"Kjo është me të vërtetë një poezi e bukur, mbasi nduket sikur e shikojmë atë që poeti na përshkruan..."

Kështu, me këtë mënyrë të shprehuri kemi shpëtuar, më saktë u mbush plot edhe një gjysmë faqe dhe në këtë mënyrë puna me shkrim merr fund. Gjithsesi një punim i tillë mendoj, që është një përpjekje integruese, nga vetë nxënësit. Fëmijët rom, veçanërisht ata, duhet t'u shmangen situatave joletrare, të përgjithshme dhe boshe. Ndërkaq, nxënësit minoritarë maqedonas dhe rom, për ta kuptuar këtë poezi ose ndonjë tjetër të programit mësimor të gjuhës shqipe, është e domosdoshme që të krijojë fantazinë dhe ndjenjat e tyre sintezë, për të kuptuar më mirë poezinë apo u bërë pjesë e koherencës, forcës dhe bukurisë së aftësisë letrare, që rrjedhin veçanërisht nga zbërthimi gjuhësor dhe letrar i saj... Për të qenë e realizuar drejt një punë e tillë, duhet kulturë dhe shije individuale...

Si përfundim, mund të pranohet se bashkësitë gjuhësore ku folësit zotërojnë më tepër se një gjuhë përbëjnë bashkësi me vlera të mëdha jo vetëm gjuhësore, por edhe shoqërore e kulturore në përgjithësi. Përveç kësaj, njohja e dy gjuhëve përbën disa përparësi:

Së pari, shumë gjuhëtarë pohojnë se njohja e një gjuhe të dytë ndikon në përmirësmin e zhvillimit njohës të fëmijës.

Së dyti, fëmijët që janë të aftë të flasin gjuhën e etnisë së tyre mund të jetë me rëndësi për ndjenjën e identitetit kuturor të fëmijës.

E kundërta, do ta bënte fëmijën të ndihej i huaj brenda familjes së tij; të folurit e gjuhës së familjes i jep fëmijës një ndjenjë identiteti dhe përkatësie.

Së treti, në një shoqëri globale përbën përparësi për çdonjeri të njohë më shumë se një gjuhë.

Së katërti, të dhënat tregojnë se edukimi i fëmijës në një gjuhë ndikon me aftësinë e saj ose të dhënat e saj të kalojë provimin në të dytën dhe, ndikimi është më i madh, sa më e vogël njëra gjuhë dhe sa më e përpunuar e dyta.

Së fundi, për njerëz të çdo moshe ose profesioni, njohja e një gjuhe të dytë kurajon ose nxit mirëkuptimin dhe njohjen e kulturave që kryqëzohen ose takohen.Shquarja e gabimeve gjuhësore dhe letrare në shqip, përmirësimi i tyre gradual, tregon dukurinë gjithëpërfshirëse të integrimit të vetë minoriteteve në vendin tonë, edhe pse me hapa të ngadalshëm. Gjithsesi ky fakt duhet admiruar.

BIBLIOGRAFI:

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

LIFELONG LEARNING

Prof. d-r. Jusuf MUSTAFAI-FACULTY OF ISLAMIC SCIENCES – SKOPJE,e

Abstract:

The fast pace of the labor market and its rapid changes, the aging of the population and the more pronounced global competition point to the need that all available knowledge, skills and competences should be fully used, regardless of where and how they are acquired. Experts point out that lifelong learning is a prerequisite for employing individuals and increasing their competitiveness in the labor market, but also a basis for realizing one's personal potential and an important element of active citizenship.

Technological changes and economic factors encourage young people to actively work on their self-development. The modern age in which we all live requires that we turn to new ways of learning and acquiring certain competences. Younger generations are already engrossed in a new wave of learning. Today, teamwork is very popular, even in the earliest stages of education, as well as creative work, which is an essential part of all institutions that want to provide higher values to their students. In the end, it is very important to mention e-learning, due to which learning has become available to absolutely anyone who wants to know and learn, in spite of where they reside in the world. That being the case, we can state that education is a process directly related to the needs of production of material goods, the stage of development of science and technology, the ideology that involves various goals, and the organization of society itself.

All of the above indicates that the concept of lifelong learning has come to life and is of significant value to all people, regardless of age.

Keywords: development, system, process, work, potential

1. INTRODUCTION:

Education is always an important determinant for both the individual and the people as a whole. During a conversation, the possession of education is always an important determinant both in the educational and social circles. Knowledge, skills, creativity, upbringing, communication, the acquisition of identities and professional competence that are developed through the educational process are the main factors that reflect the personality, success, employment and ultimately the prosperity of society.

2. BUILDING THE EDUCATIONAL PROCESS

Throughout history, there were three ways to build education:

- Developing the capabilities of individuals,
- Training for empowering the life and preservation function,
- Transfer and use of spiritual, cultural, scientific and empirical knowledge and experiences of man.

Education is usually a process. In 1919, E. Durkheim defined the term education as a guide to young people by the old generations in order to develop the physical, intellectual and moral properties that they should possess, and that the society and the environment for which it is prepared requires them[69].Benefit from education for individuals (and society) is long-term. All efforts to improve the quality of that same education move the boundaries of human knowledge and the basis of human progress. It educates and empowers the nation for the times dominated by knowledge. Because of this, the syntagm of "cognitive society" is often used, which points to the role of knowledge as the most important contemporary resource. The users of educational services give a feeling of special and intellectual achievement. Availability and quality of education is an indicator of the company's inclusion rate, its progress, positioning, competitiveness, prosperity, etc. In the world, there is an overall competition in which it is changing rapidly, the role of education and the empowerment of the workforce (in all categories) is achieved by encouraging innovation, which implies increased

[69]Vidulin-Orbanić, S., Learning Society, Historical-Social Aspects of Education, Methodological Horizons, pp. 65 (2007)

competitiveness and enriching the quality of life. The values that come from quality education are long-term. If we analyze the reasons for success in the highly developed countries, we can conclude that in most of them economic development is based on the quality of education, the adaptation of the educational needs and demands of the modern market.

The educational process is primarily an activity in which students acquire knowledge, skills and abilities. Practice and scientific research, show that the knowledge is best adopted by the younger generation, but with the help of those who have already adopted this knowledge. Precisely in this fact is the reason for the emergence of education as an institution in which the cognitive activity is assisted by the lecturer. Therefore, the question naturally arises as to how to achieve greater effectiveness in the joint work of the educational system and the knowledge of knowledge. A number of human qualities have been acquired by learning. All but the biological heritage is the result of learning, say several psychologists. We would add: also those properties that are predominantly hereditary, especially their expression when it is not independent of learning. The development of a human person's preparation of life in the environment is also to a significant extent a product of the environment. The learning process is a process of humanization of the human psyche, because children learn to be careful, diligent, sociable, sacrificed, honest, as they learn not to be lazy, selfish, asocial and aggressive. Accordingly, learning is upgrading the innate abilities, perfecting the adaptation in the environment and enabling that environment to change according to the needs of individuals and society. Learning is not just a change of behavior it is also the empowerment of a more complete experience and understanding of yourself, other people and the world around us. So potentially, human development can go in many different directions. Which one of them will be adopted, depends on the fact that the environment in which we live stimulates and rewards, and what prevents and punishes. It should always be borne in mind that it is possible to learn only what is the disposition based on the potential possibility of the nervous system and other organic systems that are an organic basis for performing a particular activity[70].

[70]S.L.Kagan, PiaRebelloBritto, *Going globalwith Early Learning and Development standards*, ColumbiaUniversity,pp.36,(2005)

3. CONSIDERATION OF THE CONCEPT LIFELONG LEARNING AND ITS MEANING

The term "lifelong education", i.e. lifelong learning, appeared in England in the 90s of the last century. The concept of lifelong education, that is, learning is encouraged by the development of ideas and practice of adult education in industrialized Western countries such as England, Germany and the Scandinavian countries. The concept of lifelong education is not created in the countries of North America (USA and Canada), but in the countries of western and northern Europe. The ideas of lifelong education were acquired right after the Second World War. The name lifelong education has become accepted at international conferences on adult education that were organized by UNESCO in 1960 and 1965[71].

The development of the concept of adult education has significantly contributed to the formation of the concept of lifelong education[72]. The most successful description of the importance of lifelong education is: Lifelong education is perceived in its totality. It covers the formal, informal and informal form of education and seeks to integrate and articulate all structures and phases of education along vertical and horizontal dimensions. It is also characteristic of its flexibility as it relates to time, space, content, method of learning, and therefore requires self-governing learning, sharing knowledge with others and accepting different styles and learning strategies[73].

Lifelong learning has become one of the very commonly used syntagms not only in expert debates but also in everyday speech. It is closely related to adult education, so it makes sense that it is the same thing, although it is not. As lifelong learning is associated with some other concepts, it would be good to clarify the notion of lifelong learning by presenting the history of the emergence of the concept and its

[71]UNESCO Education for All – The Quality Imperative.(2004) http://unesdoc.unesco.org/images/0013/001373/137334e.pdf

[72]Jarvis, P. *Adult and Continuing Education.* New York: Croom Helm. Key Competencies: A developing concept in general compulsory education (2002). Brussels: Eurydice. pp.65, (1983)

[73]Dave, R. H. (ed.) *Foundations of Lifelong Education*. New York: Pergamon Press, str. 35-36,(1976

use in an international context[74].Lifelong learning is a concept that promotes gradual transformation into an educational community for satisfying individuals, and thus a competitive organization and a society based on the uninterrupted creation, renewal and application of new knowledge, skills and attitudes. The joy of learning something new, the motivation and the uninterrupted learning habits are created in the young age. Therefore, cultivation is thought out, learning approaches and learning experiences acquired in the family and pre-school institutions are the basis for continuous and self-initiated learning and education throughout the whole life. More important goals of lifelong learning are: raising the general level of education among all citizens - involving all citizens in the process, recognizing, realizing personal potentials and abilities, shaping socially active, responsible individuals involved, empowering adaptable individuals to navigate in a changing work and social environment, a higher level of employment. These guidelines are especially important for the working organization and the public administration, but also the entire social community, where the harsh economic and technological changes, as well as the unfavorable demographic processes, imposed lifelong learning and education as the need for educational and economic policies.The acquisition of quality from lifelong education is a measurable category and each country should develop its own systems for measuring the outcomes of the educational process. Of course, the best mechanism for measuring the quality of educational services is the labor market. Apart from the labor market, which as a category is beyond the influence of the state, special instruments should be developed to ensure quality in education. In that sense, the most important are the inspection supervision, the external assessment and the self-evaluation.

4. TYPES AND FORMS OF LIFELONG LEARNING

The forms of lifelong learning are:

1) The formal education,
2) Non-formal education
3) Informational education

Inadvertent learning is experiential learning, and it is neither organized nor structured. Formal education is education. It is the highest form of learning. Formal education is an official

[74]Pastuović, N., Lifelong Learning and Changes in Education, Educational Sciences, Vol. 10 No. 2, p. 253-267, (2008)

(regular) structured learning, organized by educational institutions and results in a recognized certificate, i.e. a degree that recognizes a degree of education. According to the International Standard Classification of Education, non-formal education is the education of a systemically organized educational activity that can be implemented in schools and non-school organizations and includes persons from all age groups, from children to persons in the third age. Completion of this form of non-formal education can result in confirmation of a successfully completed form of non-formal education, but it also does not acquire some degree of professional training. There are various organizational forms of informal education such as: seminar, counseling, symposium, conference, etc. For every informal education, the external educational support of the person who learns is characteristic. Informal education is a deliberate learning without external support. The name: self - education. It is a form of deliberate learning that is less organized than non-formal education. Non-formal education is organized by institutions and persons for the needs of other people who will be assisted with their help. Informal education is started and organized by the person who learns without the help of others.

Self-education can be completely autonomous (the individual independently determines the purpose of his / her learning, plans, organizes and valued the results of his / her own learning), and can ask for some help from other individuals and institutions. Inferior or experiential learning occurs in different life roles; role of a student, working, family / parental, political, recreational, military etc. Experiential, learning is most often unconscious. It is learned and works by passing through various life situations. In doing so, the activities that are acquired are usually not motivated by learning, but by satisfying the various economic, social and self-sustaining motives. Work is gaining and improving different skills, but that does not mean that employees work to practice, work here to earn money, work out, and so on. In experiential learning, a person does not have to be aware that he has learned something, that is, by inadvertent learning has changed. Lifelong learning does not replace traditional schooling, which was initially considered possible because of the lack of education and desired, rather than with the flexible system of learning environments that allowed lifelong acquisition and development of the competencies that people needed for life in the adult age[75].

5. COMPETENCIES OF PROFESSORS AS DETERMINANTS FOR RELIABILITY AND ACCEPTANCE FOR LIFELONG LEARNING

[75]Šundalić, A., Pavić, Ž, Between the Value of Education and the Negative Socio-Cultural Heritage, Social Research, Vol 20 No 4 (114) p.36-39 (2011)

The quality of teacher education is one of the main factors affecting the level of achievement of student learning. Therefore, the education and professional development of professors is a key issue in every country that seeks to improve the education system and make it more accessible, more streamlined and more flexible. The model determinants of the educational achievement demonstrate how the personal functions of students communicate with a variety of factors in the educational context, and they influence the achievements of students, attitudes and the image for themselves. Within this model, the personal characteristics of the professors and their approaches to learning and teaching contribute significantly to the achievement of learning outcomes. But this influence is indirectly manifested through the action of cognitive and affective components: the perception of task requirements and the preferred personal style of learning at the level and type of motivation. These components are responsible for learning approaches that are recognized as[76]:

a). superficial - aimed at achieving mechanical reproduction of the material without its integration into the root of knowledge and the value composition;

b). deep - focused on recognizing the basic and elaboration of materials in order to achieve meaningful understanding and to create a critical attitude towards the content.

The learning approach is directly related to learning outcomes. In general, it can be said that due to changing environmental conditions in contemporary societies that are focused on knowledge, they significantly change and expand the role of teaching / learning. In a changing social environment, more and more (as before) different actors (international community, home public, direct service providers and users) in the discussion of the goals of the education system express their expectations and needs in terms of educational outcomes. The role of professors, like any other professional, can be seen as a system of interconnected expectations from individual participants. These expectations at the manifested level are most often recognized through the basic professional tasks[77]:

- Transfer of cultural values and knowledge;

[76]Marentić-Požarnik, B.; ValenčićZuljan, M. The winding path between universalisation and teacher education: a
case of Slovenia. Metodika, 3 (5): pp. 195-210. (2002)

[77]Korthagen, F. A. J. In search of the essence of a good teacher: towards a more holistic approach to teacher education. Teaching and teacher education, 20 (1): pp.77-97. (2004)

- Encouraging the acquisition of more competences and self-regulated learning among students;
- Modeling communication and social skills needed for effective involvement in civil society and life in a multicultural environment;
- Supporting children and parents in solving developmental and life crises.

Awareness of the increased complexity of the role of teaching / learning has led to numerous analyzes of the current situation and the recognition of new needs in the education system of teachers and teachers. The existence of a new paradigm for teacher education, which proposes the most important documents in which this educational policy is formulated, includes the assumption of the responsibility of employers to enable continuous professional development, but also the commitment and right of employees to life-long learning.

From the perspective of the Lifelong Learning Concept, ensuring the quality of professors' work is not exhausted only by analyzing and improving their primary education, it also includes strategic responses to several interrelated issues, and they are part of the policies for national education (OECD, 2004[78])

1) How to attract capable individuals to choose a profession;

2) How to organize initial education and vocational training to provide the professorsthat will be successful in encouraging students to complete higher education;

4) What measures will ensure quality professors and how to maintain and develop them in the educational profession?

It is very easy to answer that the model of teacher education should have a focus in an experiential approach based on good practice and tradition that are not organically related to theoretical knowledge and empirically validated concepts in the field of learning and teaching. The teacher education model is based on understanding the importance of the rule of "academic disciplines" as a necessary and sufficient condition for quality teaching in combination with the "talent of teachers" as a database.

CONCLUSION:

People represent the core capital of companies, and not just a means of completing certain things. Today they represent an investment that is worth developing and in which it is

[78]OECD, Schooling for tomorrow. 2004, http://www.oecd.org/dataoecd/11/56/2498958.pdf

necessary to invest in order to deliver better results and be cost-effective. In today's fast-moving and turbulent world, man is forced to learn lifelong to be able to follow the changes, to satisfy his needs and interests, and to be an active member of society. The motivation and diversity of the possibilities of education are the basic condition for successful learning. We will all discover the value of education at one point in our lives. Knowledge and education is something that no one can take away from us, and therefore with every two new hands we need to accept every novelty in that direction, we should strive for greater interest in the different learning outcomes. Lifelong learning is needed for all generations to ensure equal rules of quality and active life. It is never difficult to include further education in order to gain some specific knowledge, to complement the permanent "holes" given that today's labor market has a shortage of unemployed people, who could with some certain competence that they possess long-term careers. Given that 90% of the employees would participate in various forms of additional education, even partially at their own expense, means that the value for the same is quite high, which means that lifelong learning has high appreciation among the employers, which should be an indicator of highly motivated workforce.

USED LITERATURE:

- Vidulin-Orbanić, S., Learning Society, Historical-Social Aspects of Education, Methodological Horizons, 2007
- S.L.Kagan, PiaRebelloBritto, Going globalwith Early Learning and Development standards, ColumbiaUniversity,, 2005
- Jarvis, P .. Adult and Continuing Education. New York: Croom Helm. Key Competences: A development concept in general compulsory education (2002). Brussels: Eurydice. 1983
- Dave, R. H. (ed.) Foundations of Lifelong Education. New York: Pergamon Press, 1976
- Pastuović, N., Lifelong Learning and Changes in Education, Educational Sciences, Vol. 10 No 2, 2008
- Šundalić, A., Pavić, Ž, Between the value of education and the negative socio-cultural heritage, Social Research, Vol 20 No 4 (114), 2011

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

PIKËPAMJET ESTETIKE TË NDRE MJEDJES

Prof. Ass. Dr. Labinot Berisha-Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"Fakulteti i Filologjisë

Ndre Mjedja na ka lënë një punim për shumëçka të veçantë "Përmbi poezi përgjithësisht", ku shtron disa dukuri të qenësisë së letërsisë, të estetikës, sidomos të poezisë dhe të mundësisë së ndikimit të saj në marrësin.

Mjedja thekson ndërliqësinë e përkufizimit të poezisë si mënyrë – formë e shqiptimit poetik të dukurive, të përfytyrimeve dhe vë në dukje se nëse kjo (dukuri) u përgjigjet më shumë disa gjinive apo llojeve letrare poetike, ajo nuk mund të zbatohet mirëfilli në disa të tjera.

Ai veçon tre përbërës të qenësishëm të poezisë: së pari ajo duhet të shprehë të bukurën, të bukurën e krijuar përmes gjuhës poetike, përmes të shprehurit, së dyti: ky i shprehur duhet të jetë përfytyrues, pra rrjedhojë e imagjinatës së poetit e jo e imitimit të natyrës ose të një dukurie tjetër, po e përftuar në bazë të përfytyrimit dhe e përshkruar nga bota e brendshme, nga shpirti i poetit. Së treti: poezia duhet të ketë ose rimën, ose ritmin, tingëllimën, me një fjalë ato elemente të vargut që i cilëson muzikaliteti dhe të cilat janë të rëndësishme për ndikimin në marrësin.

Mjedja thekson faktin se një poezi është e rëndësishme para së gjithash për vlerën artistike, që përligjet nga mënyra e të shprehurit e nga formësimi që i jep poeti e jo nga ajo që shqipton. Pra, poezia (pra dhe vepra letrare në përgjithësi) është përftim i ndërliqshëm i mendjes dhe i përfytyrimit, i përvojës dhe i shijes së atij që e krijon.

Sipas Mjedjes poeti në poezi e shfaq bukurinë në dy mënyra: me anë të gjuhës, të shprehurit poetik që dëshmohet nga përshkrimi i bukurisë në natyrë ose me anë të fuqisë së përfytyrimit dhe të ndjenjësimit.

Disa nga këto mendime të tij ruajnë aktualitetin e tyre edhe sot e gjithë ditën.

Fjalët kyçe: gjuha, teksti, poezia, vepra, estetika, arti etj.

Pikëpamjet estetike të ndre mjedjes

Poeti ynë i shquar, Ndre Mjedja, na ka lënë një punim për shumëçka të veçantë "Përmbi poezi përgjithësisht[79]", ku shtron disa dukuri të qenësisë së letërsisë, të estetikës, sidomos të poezisë dhe të mundësisë së ndikimit të saj në marrësin. Disa nga këto mendime të tij ruajnë aktualitetin e tyre edhe

[79] Punimi i Ndre Mjedjes *Përmí Poezi përgjithësisht*u botua (mbas vdekjes së autorit) në "Shkëndija", Tiranë 1941, n. 8 – 9; u ribotua në vëllimin Ibrahim Rugova – Sabri Hamiti, *Kritika letrare*. "Rilindja", Prishtinë 1979, f. 117 – 124; në Nasho Jorgaqi, *Antologji e mendimit estetik*. Tiranë 1979, f. 285 – 290. Shih dhe Ndje Mjedja, *Juvenilia. Poema dhe vjersha të tjera*. Faik Konica, Prishtinë 2016, f. 5 – 12.

sot e gjithë ditën, ndihmojnë ta kuptojmë më mirë natyrën e poezisë dhe mënyrat e komunikimit të saj si art, pra dhe poezinë e tij.

Në fillim Mjedja thekson ndërliqësinë e përkufizimit të poezisë si mënyrë – formë e shqiptimit poetik të dukurive dhe të përfytyrimeve: disa theksojnë se poezia është të shprehurit e ndjesive të zemrës dhe të përfytyrimit, ndërsa disa të tjerë se ajo është ngjasimi (ngjashmëri) me natyrën, çështje që e përmend edhe Aristoteli.

Mjedja vë në dukje se nëse kjo dukuri u përgjigjet më shumë disa gjinive apo llojeve letrare poetike, ajo nuk mund të zbatohet mirëfilli në disa të tjera: "Mirë se në poezi dramatike e epike shifet giasimi me natyrë, por në poezi lirike ku gjindet ky giasim? Ata që thonë se poezija asht nji hartim, nji sendergjim, nuk janë nji fjalë mbi se shka asht hartimi e sendergjimi. Mbas mendes së tyne, hartim e sendergjim do me thâne herë nji prrallë, nji gjâ e trillueme prei mendes, herë shenjon trajtimin e poemit[80]".

Përkundër faktit se Mjedja thekson së përkufizimi i poezisë është i vështirë dhe se këtë e kanë dëshmuar mendimet e shumë studiuesve paraprakë, ai e përcakton atë në këtë mënyrë: "Prandej ma mirë caktohet poezia tue thanë se asht *të shfaqunit e bukurisë me nji të shëprehun të përfëtyrimit (fantazis), ma të shumën e herës me masë[81] " (Filozofi i lashtë grek,* Platoni, thoshte se "Poezia âsht nji tregim i sendeve t'kalueme, t'qetashme e t'pertardhshme[82]").

Sipas Mjedjes metrika është përbërës i rëndësishëm, po jo i domosdoshëm. Natyra e poezisë është më komplekse: rima, rrokjet, theksat ritmikë etj., nuk e përligjin mirëfilli poezinë: "Disá tjerë, tuj folë për poezi, kujtojnë se mâsa (metri) âsht nji gjâ e domosdoshme për poezi. Por ka shprehje të lidhuna me masë, me rrokje, theksa e rrima qi s'mund të thohen përnjimend poezi; auktorët e tyne munden me u thânë vjershatarë, por jo poetë. E thomi edhe na se mâsa e plotëson poezín por nuk âsht nji gjâ e domosdoshme e natyrës së sai[83]".

Për ta konkretizuar këtë mendim Mjedja përmend Aristotelin, i cili thoshte se një prozë filozofike ose historike e vënë në vargje nuk është poezi. Kjo ngjet nga fakti se këtyre krijesave u mungon gjuha poetike dhe përfytyrimi poetik: "Pse megjithë qi asht vu në vjerrsha, i mungon perftimi poetik. Filozofi e historiku nuk thomi se s'janë poetë, pse nuk shkruejnë në vjersha, por pse sillen mbi nji landë që nuk perkon me atë të poezisë, mbasi seicilli nder këta të dy ka për shëllim me kallxue e shtjellë të vertetën e sëndevet, kurse poeti ka për shëllim me shëmbëllye bukurinë, atë shprehë[84]".

Rreth natyrës së poezisë Mjedja thotë:"[...] poeti në punë të vet do t'u përngjajnë sendeve e jo t'i përshkruejë. Ngjasimi lyp që sendja t'i përngjajë sendes, por jo që të jetë njinji me të[85]".

Ai veçon tre përbërës të qenësishëm të poezisë: së pari ajo duhet të shprehë të bukurën, të bukurën e krijuar përmes gjuhës poetike, përmes të shprehurit, së dyti: ky i shprehur duhet të jetë përfytyrues, pra rrjedhojë e imagjinatës së poetit e jo e imitimit të natyrës ose të një dukurie tjetër, po e përftuar në bazë të përfytyrimit dhe e përshkruar nga shpirti i poetit. Së treti: poezia duhet të ketë ose rimën, ose ritmin, tingëllimën, me një fjalë ato elemente të vargut që i cilëson muzikaliteti dhe të cilat janë të

[80]Ndre Mjedja, *Përmí Poezi përgjithësisht.* Në Ndje Mjedja, "Juvenilia. Poema dhe vjersha të tjera". Faik Konica, Prishtinë 2016, f. 5.
[81] Ndre Mjedja,po aty, f. 6.
[82] P. Gj. Fishta, O. F. M, *A janë t'zott Shqyptarët me u majtë shtet n'vedi?* Në "Hylli i Dritës", n. 3, Shkodër 1913, f. 77.
[83]Ndre Mjedja, *Përmí Poezi përgjithësisht,* vep e përm., f. 5.
[84] Ndre Mjedja,po aty, f. 6.
[85] Ndre Mjedja,po aty, f. 7.

qenësishme për ndikimin në marrësin.

Mjedja thekson se një poezi është e rëndësishme para së gjithash për vlerën artistike, që përligjet nga mënyra e të shprehurit e nga formësimi që i jep poeti e jo nga ajo që shqipton. Pra, poezia (pra dhe vepra letrare në përgjithësi) është përftim i ndërliqshëm i mendjes dhe i përfytyrimit, i përvojës dhe i shijes së atij që e krijon: "Edhe mënyra e të shprehurit në ketë pikë ka randsi. Qishtu Virgjili me nji mjeshtri e hollësi të pa shoqe të shprehunit ka mbërri me përshkrue fortunen e detit (Aen. I, 83). Nji tjetrë mënyrë fort mâ e çmueshme asht nji hartim a krijimi i mëndes, ku të shëndrisi drita e nji formës së naltë të idealit. Në ketë krijim danë faqija e mjeshtrija e poetve. Në mënyrë të pare qi thamë sypri, nuk shifet nji poet i vërtetë, por nji vjershtar; në të dytën gjejmë shka lypë Horati per nji poet: Ingenium cui sit divinior, alque os Magna sonatarum, des nominis huius honorem (Satyr. L. I .4. *vs.* 43)[86]. *Ashtu edhe Qiqeroni thotë se poeti e ka zotësinë prej natyre, zgjohet prej fuqisë së mëndes e asht frymëzuem prej fryme gadi hyjnore[87]".*

Sipas Mjedjes në poezi poeti e shfaq bukurinë në dy mënyra: me anë të gjuhës, të shprehurit poetik që dëshmohet nga përshkrimi i bukurisë në natyrë ose nga fuqia e përfytyrimit dhe nga ndjenjësimi: "Në dy mënyrë poeti mundet me shprehë bukurinë, d.m.th. a tuj përshkrue sêndet e bukura të natyrës, a tuj krijue me mend të vet nji send përnjimend të bukur[88]".

Në përcaktimin më të përafërt të bukurisë Mjedja thotë: *"Pulchra sunt quae risu placent (Të bukura janë ato që të pëlqejnë)*, për bukuri këtu merret vesht çdo sênd qi, sa të kuptohet siell kënaqje. Prandej s'do me thânë vetem nji sênd t'âmbël, të hieshëm, të shëndritshëm, por edhe të naltueshëm, të rândsishëm e qi bindë [...] Bukurija mundet me kênë lânda edhe e tjera arteve të bukura, si e pikturës e e skulpturës, por gjithë e cila e punon me mjete e vegla të veta; poezia e shfaqë me të shprehun, e jo sido por me njatë të shprehun që i del prej tugës së zëmrës e prej fuqisë së perfëtyrimit[89]". Po ashtu Mjedja thekson ndjeshmërinë e poetit përballë sidomos gjuhës poetike, formës, të bukurës që përftohet përmes shtjellimit gjuhësor shprehës ("poezia e shfaqë me të shprehun"), mënyrës si funksionon ajo brenda strukturës gjuhësore përkatëse për arsye se ajo duhet të jetë e lartësuar dhe bindëse për atë që e dëgjon ose e lexon. Me fjalë të tjera, me krijimin e vet artistik poeti duhet ta ketë parasysh marrësin dhe nëpërmjet veprës së vet të ndikojë estetikisht në të. Poeti i madh gjakon lartësimin dhe pasurimin e shpirtit të marrësit dhe e drejton atë tek idealet e larta: "Nji tjetrë mënyrë fort mâ e çmueshme âsht nji hartim a krijimi i mêndes, ku të shëndrisi drita e nji formës së naltë të idealit".

Duke krahasuar të bukurën që e krijon poeti përmes fjalës me atë që krijohet në artet e tjera, Mjedja thekson "[...] përkundrazi poeti shfaq një send nën shumë pikëpamje" dhe shqipton çka "[...] nuk shef syni, e mundet me përshkrue njênën mbas tjetrës pikëpamjet e atij sendi[90]".

Mjedja veçon, siç thamë, dy mënyra të të shqiptimit dhe të krijimit të së bukurës në artin e fjalës: 1) *përshkrimin e bukurisë së një dukurie të natyrës* (për këtë merr shembull Virgjilin që me një mjeshtri e hollësi të pashoqe të të shprehurit mbërriti të përshkruajë furtunën e detit) dhe 2) *të bukurën që e krijon poeti me anën e imagjinatës së vet.* Sipas tij e bukura në natyrë dhe e bukura në art janë të ndryshme (këtë ndryshim e kishte thënë qysh Platoni), pa mohuar faktin se poeti mund të nxitet apo të frymëzohet nga dukuritë dhe bukuritë e natyrës, po ky është vetëm një akt nxitës: struktura gjuhësore shprehëse dhe kuptimore është diçka tjetër me atë që shihet ose preket në natyrë.

---

[86] "Ai që ka imagjinatë, është më i hyjnueshëm dhe gojë e madhe e tingujve, nderi i këtij emri".

[87]Ndre Mjedja, *Përmí Poezi përgjithësisht,* po aty, f. 7.
[88]Ndre Mjedja,po aty, f. 6 – 7.
[89] Ndre Mjedja,po aty, f. 6.
[90] Ndre Mjedja,po aty, f. 7.

Në vijim të ndriçimit të natyrës së poezisë përballë dukurive konkrete të natyrës dhe procesit të ndërliqshëm që i cilëson këto marrëdhënie, Mjedja shkruan: "Edhe për këtë arrësye nuk merret vesht si mundet m'u thanë se poezia âsht nji giasim i natyrës. 1] Pse poezia, ma të shumën e herës, merret me sênde vërtetë – giasë, që u përshtaten sêndeve të natyrës, sit hotë Horati. 2] Pse vepra poetike asht përftimi i nji mêndes së mësueme me sênde të bukura; por mêndja s'mund të begatet pa shqyrtue sêndet e natyrës. 3] Pse vepra poetike ju shtrohet shi niatyne ligjëvet, sidomos kah shestimi e njisija, qi ju shtrohen sêndet e natyrës[91]".

Sipas Mjedjes e rëndësishme për një poezi, pra edhe për çdo vepër të artit të fjalës, është dukuria ose çështja që bëhet objekt artistik i trajtimi (krahas formës, bukurisë që përftohet përmes shtjellimit dhe të shprehurit gjuhësor dhe të kuptimeve që dalin nga teksti poetik përkatës). Poeti nuk duhet të vështrojë gjëra të përçudshme, të shëmtuara, po "sênde të nalta[92]", ato që janë të qenësishme dhe kanë kuptim për jetën e njeriut. Poeti duhet të jetë si bleta që kërkon nektarin e vet te lulet dhe bimët erëkëndshme dhe të përftojë krijimin e vet, për t'i dhënë cilësinë e shpirtit të tij: "Sikurse bleta prej epshi së vet tui i hjedhë andej e këndej nuk ndalet në pleh e në baltë, por kerkon lulishtet, nuk ulet mbi çdo bar, por kërkon lulet: lismen, sherbelën e tjera bimë erëkandshme e prei gjithë kësosh mbëledh atë mjaltë aq të shieshme, ashtu poeti, tuj injirue me sy ketë lulishten e botës nuk do të nguli në sênde të perçudshme as s'do të shëmëllejë zgaqin e Shoqënís, por do të zgjedhi sëndet ma të bukra, ma të ndershme, ma të shieshme, por edhe qi ma fort të perkojnë me arrësye e këto do të shfaqi në vjerrshi të vet; ashtu edhe me shpejti të mendes me u hjedhë në të tana anët, me rrnu e gjithëshka, me mbëledhë, me gjetë shka mund të vëlej në çdo rasë (nënvizimi ynë), e, prej gjithë aso sëndesh me përftue në mende të vet ndonji hartim të ri: kjo asht puna e poetit[93]".

Natyrisht brenda këtij përcaktimi, Mjedja këmbëngul që poeti në secilën krijesë duhet të dëshmojë mëvetësinë (origjinalitetin) e vet: "[...] me përftue në mende të vet ndonji hartim të ri: kjo asht puna e poetit". Kjo arsyetohet me faktin se secila individ i sheh, pra i percepton dhe i shpreh dukuritë e botës së jashtme dhe të botës së vet të brendshme në mënyrë të ndryshme: secili është një qenie që sa i përngjet tjetrit po aq ndryshon dhe prej tij; kjo shprehet edhe në poezitë që i krijojnë poetët për arsye se krijesat e tyre, siç u tha dhe më lart, janë fryt (rrjedhojë) e mendjes dhe e përfytyrimeve të tyre: "Pra, poeti e çdo mjeshtër i arteve të bukura për me perftue në mênd punën qi do të bajë, vepron në nji mënyrë të vetme. Populli imë shef sêndet që e rrethojnë e e ndal synin në të gjitha, pa dallue njânën prej tjetrës; e nd'i bâftë përshtypje ndonji aso sêndesh, kjo âsht nji pershtypje qi mund ta ketë gjithëkushi e nuk kalon dobin e jetesës. I dieshmi a filozofi sodit sêndet e ndodhitë e prei sosh xir ligjë të përgjithta, naltohet në parime të shkoquna, e ju paraqet edhe tjerëvet per mësim. Poeti prei sêndesh qi shef naltohet edhe ai në parime të shkoquna e i parason me atë shembull bukurije qi ka vetë në mênd, e me ndihmë të hollësisë së mêndes e së fantazis përban nji perftesë teknike; por mbasandej e shfaqë si gjâ me korp, d.m.th. të veshun me ndo'j sênd të hartuem, o me ndoj shembull, o me ndoj perfëtyrim qi të kënaqin e të argtojnë ata që e shofin e e këndojnë[94]".

Pikërisht ky ndryshim që ekziston dhe shprehet në poezitë e poetëve ("Pra, poeti e çdo mjeshtër i arteve të bukura për me perftue në mênd punën qi do të bajë, vepron në nji mënyrë të vetme") kushtëzon dhe ndikimin estetik të ndryshëm te secili marrës dhe se në rrethana të caktuara perceptohen dhe ndikojnë ndryshe, madje edhe tek i njëjti marrës (receptues), siç e kemi thënë edhe më parë. Pra, Mjedja e ndërlidh rëndësinë dhe vlerën e poezisë me marrësin, me estetikën e tij. Në qoftë se poeti nuk

[91] Ndre Mjedja,po aty, f. 9 – 10.
[92] Ndre Mjedja,po aty, f. 8.
[93] Ndre Mjedja,po aty, f. 8 – 9.
[94] Ndre Mjedja,po aty, f. 9.

e ka parasysh që përmes poezisë së vetë të ndikojë drejt dhe mbarësisht (me qëllim të mirë) në marrësin, atëherë nuk e ka kryer detyrën e vet si duhet. Së këndejmi, ai nuk duhet ta përftojë një poezi që do të ndikojë për të keq, ta dhunojë artin dhe marrësin: "Kurrgja qi lypë poezija nuk asht shtazore, por si e lypë nierzija e arrësyeja; nuk asht nji kënaqje qi ta poshtnojë njerin, por qi ta naltojë. Shkon, pra, kundra rregullash së artit kush ban nji poezi të fëlliqtë, përse me veprë të vet stolisë nji kënaqje qi nuk asht e nierit, por e shtazëve, e qi ash murtaja ma e rrebtë e helmi ma rrënues i shpirtit. Por mire e me vend foli per ketë punë At Famjan Strada i Shoqënis së Jezuit në ligjiratë poetike të vet[95]".

Poeti i mirëfilltë, thotë Mjedja duke u mbështetur në mendimin e atë Famjan Strada, është ai që synon që vepra e tij të pranohet dhe të bëjë ndikimin estetik te lexuesi: "Perse me ba nji poezi pa dhunue artin, të kënaqi përnjiheri e të sjelli dobi asht nji fatbardhësi mendje aq e madhe, sa (si me i këndellë nd'at send vetë Zotynë fuqit e nierit pat me thane dikur Sokrati se nd' atë punë nieriu e difton vendin latë të vërtetë të Tinë zot), tue ba nji veprë të dejë per nji qi i thonë poet: Tui kujtue pra, ata gjind qi thamë, ketë punë, e në tjetrë anë tui pa pazotësín e mëndes së vet m'u kapë me sênde aq fisnike qi të bâjnë ndo'j veprë e cila të joshi kah e mira e e mbara e tue e pelqye të mëdhejvet e të vogjelvet, marrin rrugën tjetrë e tui mbëledhë punë jo fort të vështira, dokrra të tinglluesshme të ndraguna nder flligshti t'armëvet e të dashtënis, aq e terhjekin e e perkëndellin atë pjesë njeri qi ma udobtë terhiqet e aq hinë në shpirt zgaqit të nierzis së gjindës që janë mbas mendes së ti, sa i rrên uzdaja se kanë me pasë prei asi zgaqi qi thamë, së ndragun prei këso gicilimesh plehnore, atë lavd e nam, qi s mund të presin prei zotësis së mendes së vet[96]".

Duke e krahasuar muzikën me poezinë Mjedja thotë se ato i njëson arti dhe mesazhi artistik që i kushtohet marrësit, që ka bazën te mendimi i Horacit i cili theksonte se "Ut pictura poesis" (Piktura është poezi, Ars. Poet. 361). Megjithatë, Mjedja thekson se ekziston ndryshimi midis tyre: piktori nuk mund të shfaqë fytyrën "[...] si me thane të njij sêndes, e pikën e kahës së njij veprimi; perkundra poeti shfaqë nji sênd nën shumë pikëpamje, me xjerrë shka shef sŷni, e mundet me përshkrue njânën mbas tjetrës pikëpamjet e atij sêndit[97]".

I. Rugova dhe të S. Hamiti për këtë punim të Mjedjes thonë: "Mirëpo teoria që e shtron dhe përpiqet ta argumentojë autori në këtë artikull, i detyrohet formimit të tij letrar klasicist, që argumentimet i mbështet kryesisht te teorikët e antikës: Aristoteli dhe Horaci. Po nga ana tjetër teoria e këtij artikulli del edhe si përvojë nga shkrimi, pra edhe leximi i veprës poetike të Ndre Mjedës, sidomos nga shkrimet e tij më të vonshme [...] Mjeda kërkon të përkufizojë natyrën e pastër të poezisë, duke u përpjekur ta diferencojë këtë lloj arti, nga gojëtaria, nga shkrimi shkencor dhe nga veprimtari të tjera të njeriut. Këtë diferencim e kërkon duke kapur për diskutim të gjitha elementet e poezisë, që nga problemi i ***'giasimit'***me natyrën, nëpër problemin e të shprehurit, pra stilit dhe masës (metrit) e deri te mënyra e hartimit dhe ***„sendërgjimit"*** të saj. Po këto elemente veç e veç nuk e përbëjnë ***'kenën'*** (qenësinë) e poezisë, e vetëm janë mjete të saj. Mjeda thotë se [...] ***kena e poezis nuk pështetet mbë të shprehun, por ma fort në send[98] [...]***pra, kategoritë e para estetike, që i përkasin poezisë dhe dalin nga ajo, (Mjedja) i sheh të bukurën dhe të naltën, të madhërishmen, duke përjashtuar komiken dhe të shëmtuarën, pra duke përjashtuar ***'zgaqin'*** e shoqërisë. E edhe këto të fundit janë një krah i të vërtetës në jetën e njeriut dhe në shoqëri. Ky puritanizëm poetik i Ndre Mjedës, sikur na përkujton idetë e De Radës për këto probleme dhe i detyrohet, më tutje, qëllimit të poezisë, pra funksionit të saj shoqëror, që t'i naltësojë, t'i pastrojë shpirtrat e mendjet[99]".

---

[95] Ndre Mjedja,po aty, f. 11.
[96] Ndre Mjedja,po aty, f. 11 – 12.
[97] Ndre Mjedja,po aty, f. 7.
[98]Ibrahim Rugova – Sabri Hamiti, *Kritika letrare*. "Rilindja", Prishtinë 1979, f. 125.
[99] Ibrahim Rugova – Sabri Hamiti, *Kritika letrare*, vep. e përm., f. 126.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

MJETET E PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË

Lendita Daci Universiteti,,HaxhiZeka,,Pejë

NatyraMavraj Universiteti,,HaxhiZeka,,Pejë

LauretaDaciUniversiteti,,HaxhiZeka,,Pejë

Abstrakt

Gjatë dekadave të fundit, cilësia është parë dhe trajtuar si faktori kryesor për suksesin. Tanimë bota bashkëkohore organizative gjithnjë e më shumë po largohet nga konceptet tradicionale të "cilësisë" duke lënë anash funksionet e tilla si të inspektimit, kontrollit dhe rishikimit duke i parë gjitha këto si jo dhe aq të vlefshme dhe duke i zëvendësuar me një punë të vazhdueshme që nga planifikimi e deri tek përmirësimet e nevojshme të cilësisë. Përtëplanifikuardhepërmirësuarcilësinë, ekzistojnëmjetetëposacmeqëaplikohennëpraktikë, kunatyra e punëssë tyre paraqetlehtësinëpërdorim, kuptimtëplotënëqartësim, dherrjedhimishtndikimpozitivnëperfeksionimin e tëdyjave. Parimet dhe mjetet e cilësisë mund të përmirësojnë proceset e përgjithshme të biznesit e vecanarisht kanë ndikim madhor tek procesi i prodhimit. Si qëllim parësor është tejkalimi i pritjeve të konsumatorëve dhe arritja e kënaqësisë së tyre e cila në mënryre direkte reflekton dhe ndihmon arritjen e strategjisë e biznesit.

Abstract

Over the last decades, quality is seen and treated as the main factor for success. The contemporary organizational world is increasingly fleeing from the traditional "quality" concepts by taking over functions such as inspection, control and review by looking at them all these are not so valuable and they are replaced by a continuous work from planning to the necessary improvements.In order to plan and improve the quality, there are special tools that apply in practice, where the nature of their work presents ease of use, complete understanding in clarification, and consequently a positive impact on the perfection of both. Quality features and tools can improve the overall business processes and especially have a major impact on the production process. The overriding goal is to overcome customer expectations and to achieve their satisfaction, which directly reflects and helps achieve the business strategy.

Cilësia nuk është një akt, është një zakon.

Aristoteli

Kohëve të fundit qasjet dhe teknikat e biznesit kanë synuar në përgjithësi përmirësimin e performancës të cilës i shërben rritja e fitimeve dhe më e rëndësishmja kënaqësia e konsumatorit i cili është bërë më i arsimuar dhe më i kërkuar se kurrë. Filozofia kyqe e menaxhimit të cilësisë totale ofron konceptet e përgjithshme që nxisin përmirësimin e vazhdueshëm në një organizate. Kjo filozofi thekson një perspektivë sistematike, konsistente, më të integruar dhe më të gjerë të organizatës që përfshin të gjithë brenda dhe jashtë sistemit dhe gjithçka përrreth. Menaxhimi i cilësië totale dhe filozofitë e tij

konsistojnë në përdorimin e njerëzve, zakonisht në krijimin e skuadrave multifunksionale përmes të cilave arrihen përmirësime brenda organizatës. Përdorimi i mjeteve për të përmirësuar cilësinë e procesit dhe produktit është aktualisht një praktikë e zakonshme dhe theksi vendoset tek parandalimi i defekteve. Menaxhimi i cilësisë totale çon një organizatë drejt përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë, rritjes së produktivitetit dhe uljes së kostove për të lehtësuar presionet ekonomike dhe për të parandaluar humbjet në treg. MTC fokusohet në kënaqësinë totale të konsumatorëve përmes cilësisë më të lartë të produktit dhe shërbimit me kosto më të ulët për të konkurruar në këtë mënyrë dhe në mjedisin global. Parimet dhe mjetet e cilësisë mund të përmirësojnë si procesin e prodhimit ashtu edhe ato të përgjithshme të biznesit, qëllimi është të kalojë pritjet e konsumatorëve për të arritur strategjinë e biznesit.

1.1 Pesha e problemit që hulumtohet për audiencën

Ky punim do të jetë nga punimet e para dhe të vetme në gjuhën shqipe që trajton këtë temë, si i tillë gjetjet e tij mund të jenë të dobishme për menaxherë, për hartues të politikave biznesore, institucione qeveritare dhe akademike si dhe studentë gjatë hulumtimeve dhe zgjerimit të njohurive të tyre.

1.2 Qëllimi i projektit:

Qëllimi i këtij punimi është të identifikojë, të prezantoj dhe të shqyrtoj më gjërësisht mjetet e përmirësimit të cilësisë përmes analizimit dhe strukturimit të tyre në formë grafikore. Në hulumtimin e problemit do të drejtohemi si në vijim: konsultimin në literaturë, punime dhe publikime shkencore relevante me temën, si dhe nga literatura elektronike.

2.Çfarë është cilësia?

Kjo është një pyetje e thjeshtë, por me një përgjigje jo aq të thjeshtë. Në fakt cilësia është provuar të jetë një koncept i vështirë për tu përcaktuar. Ajo që është edhe më e habitshme është se pavarësisht nga vëllimi i shkrimit në menaxhimin e cilësisë, ka pasur vëmendje të kufizuar për të përcaktuar saktësisht se çfarë nënkuptohet me termin "cilësi". Fjalor Amerikan Oxford përcakton cilësinë si : "Një shkallë ose nivel të përsoshmërisë". Përkufizimi i cilësisë nga Instituti Kombëtar i Standardeve Amerikane (ANSI) dhe Shoqëria Amerikane për Kontrollin e Cilësisë (ASQC) është : "Tërësia e vetive dhe karakteristikave të një produkti ose shërbimi që përmban aftësinë e tij për të përmbushur nevojat e dhëna." Një shumëllojshmëri e gjerë e qasjeve për përcaktimin e cilësisë janë të dukshme:

i) Cilësiaështëdefinuarsivlerë[100]

ii) Cilësiaështëpërputhshmëria me standardet, specifikimetosekërkesat[101]

iii) Cilësiaështëpërshtatshmëriapërpërdorim[102]

iv) Cilësiasipërsosmëri[103]

2.1 MenaxhimiiCilësisëtotale (MTC)

MTC kërkonqëkompaniatëmbajë standard cilësornëtëgjithaaspektet e biznesittësaj. Qëllimiështëpërfshirja e cilësisëqënëproceset e para, ngadizajnimiiproduktit/shërbimitpërtusiguruarqëproduktitërealizohetashtu sic duhetqënëprovën e

[100]Feigenbaum, A.V. (1983). Total Quality Control, 3rd edn, McGraw-Hill, New York.
[101] Crosby, Philip B. Quality Is Free. New York,New American Library, 1979
[102]Juran, Joseph M. Juran on Leadershipfor Quality. An Executive Handbook,Free Press, 1989.
[103] Peters, Tom and Waterman, Robert (1982) In Search of Excellence, Harper & Row, New York.

parënë vend qëtëmbështeteminëinspektimet, kontrrollin e cilësisëdhepërpjekjetpërtëkorigjuargabimetpasiatokanëndodhë, praparandalimin e tyre.[104]

MTC (TQM) përbëhetngatreparadigma:

- Totali: Organizata e gjerë, kucdopunonjësështëiangazhuarpërproduktin/shërbimin final
- Cilësia: Mbitëgjithacilësianuk do tëthotëluksporkonform me kërkesat
- Menaxhimi: Sistemiimenaxhimit me hapasiPlanifikimi, Organizimi, UdhëheqjadheKontrolli. MTC nukndodhrastësishtporështëprocesdinamik. Ajokaevoluarsepsekërkesat e klientevejanëtëndryshmedhenërritje.[105]

3. Mjetet e cilësisëtotale

Sipas Ahmed dhe Hassan zgjedhja e mjetevetëcilësisëmundtëlidhet me funksionetdheaktivitetet e njëorganizate. [106] Bunneydhe Dale (1997) kanëthënëmëtej se përdorimiimjetevedheteknikaveështënjëkomponentjetiknëçdopërmirësimtësuksesshëmtënjëprocesi. Mjetëtqëpërshkruajnëcilësinëtotalemundtëndahennëdygrupetëmëdha:

- Mjetet për planifikimin e cilësisë

dhe

- Mjetet për përmirësimin e vazhdueshëm

3.1 Mjetet për përmirësimin e vazhdueshëm

Me kalimin e kohës shumë mjete janë krijuar ose përshtatur nga disiplina të tjera për të ndihmuar procesin e përmirësimit të vazhdueshëm. Disa nga mjetet më të zakonshme të përdorura në aplikimet e përmirësimit të cilësisë janë: [107]

- Mjetet për koleksionimin e të dhënave dhe analizat
- Cikli i Demingut dhe
- Gabim–Dëshmim

3.1.1 Mjetet për koleksionimin e të dhënave dhe analizat

Për zgjidhjen e problemeve të cilësisë janë përdorur shtatë mjete të planfikimit dhe menaxhimit që shpesh janë të njohura si shtatë mjetet e QC (Quality control), këto mjete janë Flowcharts- Grafikët e rrjedhës teknologjike, Pareto Diagrami, Diagrami i Kauzës dhe Efektit apo ndryshe i njohur si Diagrami

[104]AndriKoxhaj, Aftësitëmenaxheriale,Tiranë, 2006, fq 110.
[105]QamilTalka, Menaxhimiiprodhimitdheoperacioneve,Tiranë, 2008, fq. 353.
[106] Ahmed, S., & Hassan, M. (2003). Survey and case investigations on application of quality management tools and techniques in SMIs. International Journal of Quality &Management, 20(7), 795-826.
[107]VenetikeNakuci, Menaxhimiicilësisë,Tiranë 2009,fq 97.

shkak-pasojë, Histogrami, Diagramet e Kontrollit, Diagramet e Shpërndarjes, Grafikët dhe Listat e Kontrollit.

1.**Flowcharts - Grafikët e rrjedhës teknologjike**

Grafikët e rrjedhës teknologjike ndihmojnë njerëzit që janë të përfshirë në proces të kuptojnë atë më mirë, i bënë të ndjejnë një sens zotrimi dhe më të gatshëm për përmirësimin e procesve. Përdorimi i këtyre grafikëve rezulton në përformancë më të qëndrueshme nga ana e punonjësve.



Fig 1. Një rast praktik i diagramit Flowcharts

I. Pareto Diagrami

Diagrami Pareto është një mjet që rregullon gjërat sipas rendit të madhësisë së kontributit të tyre, duke identifikuar kështu disa faktorë që ushtrojnë ndikim maksimal. Kjo analizë mundëson ndarjen/përzgjedhjen e pakices vitale nga shumica e parëndësishme.



Fig 2. Diagrami Pareto

II. Diagrami shkak – pasojë

Ky diagram ilustron grafikisht marrëdhënien midis një rezultati të dhënë dhe të gjithë faktorëve që ndikojnë në të. Ky lloj diagrami nganjëherë quhet "Diagram Ishikawa", sepse u shpik nga Kaoru Ishikawa, ose edhe si "Diagrami skelet peshku" për shkak të mënyrës se si ai duket.[108]



Fig 3. Diagrami shkak-pasojë

III. Histogrami

Një histogram është një lloj liste që na lejon të zbulojm dhe të tregojm shpërndarjen themelore të frekuencës (formës) të një grupi të të dhënave të vazhdueshme. Histogramet janë të dobishme në studimin e modeleve të shpërndarjes dhe në nxjerrjen e konkluzioneve rreth procesit të bazuar në model.



Fig 4. Paraqitja e histogramit normal shkëmbinjësh



[109]

Fig 5 . Paraqitja e histogramit në formë

IV. Fletët e verifikimit

Janë forma koleksionuese të dhënash që lehtësojnë interpretimin e të dhënave. Të dhënat që lidhen me cilësinë janë të dy tipeve të përgjithshëm: atribute dhe variabël. Të dhënat atribute llogariten përmes

[108]Burimteknologjik: http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/navy/bpi_manual/mod5-c-ediag.pdf
[109]Burimteknologjik:http://www.ijergs.org/files/documents/APPLICATION-45.pdf

inspektimit vizual psh numri i faturave që përmbajnë gabime, numri i pjesëve që përputhen me specifikimet etj. Ndërsa të dhënat variabël koleksionohen nga matësit numerik në mënyrë të vazhdueshme, të tilla si distanca, pesha, volumi, koha etj.[110]

Tipi	Java 1	Java 2	Java 3
Humbja e bagazheve	I		ll
Vonesat	lll l	lll	lll ll
Gabimet e biletave	I		I

Fig 6. L.Kontrrolli per tedhenat e atributeve



Fig 7. L.Kontrrolli per tedhenate variablave

V. Grafiku i kontrrollit

Grafiku i kontrollit është një grafik që përdoret për të studiuar se si një proces ndryshon me kalimin e kohës. Një tabelë kontrolli gjithmonë ka një vijë qendrore për mesataren, një vijë e sipërme për kufirin e kontrollit të sipërm dhe një vijë më të ulët për kufirin e kontrollit më të ulët. Duke krahasuar të dhënat aktuale me këto rreshta, mund të nxirrni përfundime nëse ndryshimi i procesit është i qëndrueshëm (në kontroll) ose është i paparashikueshëm (jashtë kontrollit, i prekur nga shkaqe të veçanta të variacionit).[111]



Fig 8. Paraqitja e listes së kontrollit

VI. Diagramet e shpërndarjes

Diagrami i Shpërdarjes njihet si mjet që studion marrëdhënien ndërmjet dy variablave. Ai përbëhet nga sërë pikësh që përfaqësojnë disa vrojtime në një grafik në të cilin një variabël është në boshtin X dhe variabla tjetër në boshtin Y. Mënyra se si pikat shtrihen dhe shpërndahen në kuadrant jep një tregues të mirë të marrëdhënies mes të dy variablave.

[110]VenetikeNakuci, Menaxhimiicilësisë, Tiranë 2009, fq 99/100.
[111]Burimteknologjik: http://asq.org/learn-about-quality/data-collection-analysis-tools/overvieë/control-chart.html



[112]

Fig 9. Paraqitja e formave të diagramit të shpërndarjeve

3.1.2 CikliiDemingut

Është njëmetodologjipërpërmirësim e cilabazohetnëpremisënqëpërmirësimivjenngaaplikimiinjohurisë. Deming kadhënëdhenjëpërkufizimtëmëherëshëmpërmenaxhimin e perfomancësicilijureferohejkatërhapave: Plan, Veprim, MbikqyrjedheRishikim.[113] Kjometodologji e njohursiCikli Deming është e kompozuarnëkatërfazatëngjashmedhetekmjetetpërpërmirësimin e cilësisë, mësaktësishtsi: Planifiko, Bëj, Studio dheVepro. Prejngakycikëlnjihetedhesicikli PBSV (PDSA).

[112]Burimteknologjik:http://www.ijergs.org/files/documents/APPLICATION-45.pdf
[113]Miachel Armstrong, Management of performance, 2006, fq. 24-25.

Fig 10. Paraqitja e ciklit Deming

3.1.3 Poka –Yoke (Gabim – Dëshmim)

Poka-Yoke është njëqasjegabim-dëshmimpërëliminimin e gabimeveqë u zhvilluanga Dr.Shingo nëvitet 1960, i quajtur më parë 'vërtetim i plotë', për të arritur zero defekte dhe përfundimisht eliminimin e inspektimit të kontrollit të cilësisë. Poka përdor mjete të thjeshta por efektive dhe sinjale për të parandaluar që gabimet të ndodhin.[114] Gabimet njerëzore janë të pashmangshme në çdo proces, por për çdo gabim ekzistojnë shkaqet që mund të korrigjohen. Defektet ndodhin kur gabimet lejohen të arrijnë konsumatorin prandaj qëllimi i Poka-Yoke është të dizajnojë procese në mënyrë që gabimet të parandalohen ose korrigjohen menjëherë, duke eliminuar kështu defektet në burim[115]. Si funksione themelore të kësaj teknike që përdoren kundër defekteve janë tri sosh: paralajmërimi, kontrolli dhe mbyllja.

Poka Yoke thënë ndryshe Gabim – Dëshmimi është i fokusuar në dy aspekte kryesore: Kur një defekt është gati të ndodh dhe kur defekti ka ndodhur tashmë. Duke njohur se një defekt është gati për të ndodhur quhet 'parashikim'. Duke njohur se një defekt tashmë ka ndodhur quhet 'zbulim'.[116]

Gjashtë Teknika të Përcaktimit të Gabimeve:

Eleminimi (A mund të eleminohet aktiviteti?)

Ndërrimi (A mund të automatizohet aktiviteti?)

Parandalimi (A mund të pengohet fizikisht gabimi?)

*Lehtësimi (*A mund të shfrytëzohen kontrrollet vizuale?)

Zbulimi (Si mund të zbulohet gabimi menjëherë?) dhe

Zbutja (Si mund të ndikojë që gabimi të zvogëlohet?) [117]

Poka Yoke

Parandalonga himet

[114]Burimteknologjik: h oka-yoke-part-1/
[115]Burimteknologjik: ht es/1130/newsletter_201311.pdf
[116]Burimteknologjik: http.// content/Uploads/19%20Best%20Manufacturing%20Practices.pdf
[117]Burimteknologjik: http://asq.org/sec mini-sites/1130/newsletter_201311.pdf



Fig 11. Paraqitje e thjeshtë e rolit të Poka Yoke-s

Konkluzione

Përmes këtij projekti kemi identifikuar se është shumë thelbësore që të zbatohen të gjitha mjetet e cilësisë totale brenda proceseve të prodhimit në organizata. Pa dyshim, të gjitha mjetet e lartpërmendura të cilësisë duhet të konsiderohen dhe përdoren nga menaxhmenti për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të cilësisë gjatë prodhimit të produkteve dhe shërbimeve. Mjetet e cilësisë kanë rol të rëndësishëm për të monitoruar,trajtuar, për të analizuar të dhënat dhe për zgjidhjen e problemeve të proceseve të prodhimit, në mënyrë që të lehtësojë arritjen e përsosmërisë së performancës në organizata.

Cilësia luan rol të rëndësishëm në një strategji të përgjithshme të organizatës. Shumica e kompanive zgjedhin të aplikojnë disa mjete cilësore për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre. Ka disa kuptime të ndryshme për cilësinë dhe për shkak të këtyre kuptimeve të sistemeve të cilësisë, ka dhe strategji të ndryshme për mjetet e cilësisë.

Vlen të theksohet, që gjetja dhe analizimi i diagramëve të vendosur në punim, na ka lehtësuar dhe qartësuar kuptimin e plotë të tyre, të cilët medoemos duhet të aplikohen në organizata gjatë planifikimit dhe përmirësimit të cilësisë, kjo rrjedhimisht ndikon në funksionet dhee aktivitetet tjera të biznesit, ashtu sic shprehet dhe Ruskin : Cilësia nuk është kurrë një aksident. Është gjithmonë rezultat i përpjekjeve inteligjente.

Është e qartë se ne duhet të kemi një perspektivë të sistemit për të parë mjetet dhe metodat e cilësisë në procesin e përmirësimit të cilësisë.Pavarësisht mendimeve të ndryshme që autorët e shumtë kanë për

menaxhimin e cilësisë, ne ende mund të zgjedhim mjetet e cilësisë duke u bazuar në rëndësinë e rolit të atyre mjeteve dhe identifikimin e situatës apo mjedisit ku do të gjejnë zbatim.

Para se të aplikojmë mjetet e cilësisë në procesin tonë,duhet të identifikojmë problemet dhe vështirësitë në zbatimin e tyre. Njëkohësisht duhet të zhvillojmë zgjidhje për të parashikuar problemin dhe të krijojmë qasjen e duhur për zbatimin e këtyre mjeteve dhe mbi të gjitha duhet të hedhim tutje paragjykimin e mjeteve të cilësisë,të studiojmë më shumë dhe të kombinojmë teoritë me praktikën në biznesin tonë.

Literatura

- Armstrong, M., Management of performance, 2006, fq. 24-25.
- Koxhaj. A., Aftësitëmenaxheriale, Tiranë, 2006, fq. 110.
- Nakuci V., Menaxhimiicilësisë, Tiranë 2000, fq 88.
- Nakuci V., Menaxhimiicilësisë, Koncepte, modele, strategji, mjete, Tiranë 2009(Botimmëimodifikuar).
- Panariti, S., Menaxhimiioperacioneve, Koncepte, Metoda, Strategji, Botimiitretë, Tiranë, fq. 292.
- Talka, Q., Menaxhimiiprodhimitdheoperacioneve, Tiranë, 2008, fq. 353.
- Uruci, E., Mikroekonomia, Tiranë, 2004, fq. 59.
- Ahmed, S., & Hassan, M. Survey and case investigations on application of quality management tools and techniques in SMIs. International Journal of Quality &Management, 20(7), 2003.
- Crosby, Philip B. Quality Is Free. New York, New American Library, 1979.
- Feigenbaum, A.V. Total Quality Control, 3rd edn, McGraw-Hill, New York, 1983.
- Garvin, David A. Managing Quality. New York: Free Press, 1988.
- Juran, Joseph M. Juran on Leadership for Quality. An Executive Handbook: Free Press, 1989.
- Peters, Tom and Waterman, Robert, In Search of Excellence, Harper & Row, New York, 1982.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE TEK STUDENTET

PhD Nevila Mehmetaj,-Faculty of Economics, University of Shkodra Luigj Gurakuqi[118]

ABSTRAKT

Rrjetet sociale kanë ndryshuar mënyren se si njerezit ndërveprojnë dhe komunikojnë me njëri tjetrin. Ky punim ka për qëllim të studiojë ndikimin e kohës së shpenzuar në rrjetet sociale tek jeta studentore e të rinjve në universitetin e Shkodrës. Analiza e përdorur është ajo e regresionit të thjeshtë, e regresionit të shumëfishte, korrelacionit, testi i Studentit dhe multikolinaritetit. Koha e shpenzuar në rrjete ndikon në reduktimin e kohës dedikuar studimit e për pasoje dhe mesataren e notave të studenteve. Analiza tregon se koha shpenzuar në rrjete sociale ndikon ne reduktimin e komunikimit balle për balle. Gjithashtu rezultatet sugjerojnë se femrat janë ato që shpenzojnë më shume kohe në rrjete sociale në krahasim me meshkujt. Gjatë analizes së multikolinaritetit vërehet një lidhje midis variablave shpjegues te marrë në studim.

Fjalët kyçe: Rrjete sociale, studente, koha, ndikimi, mesatare e notave.

ABSTRAKT
Rrjetet sociale kanë ndryshuar mënyren se si njerezit ndërveprojnë dhe komunikojnë me njëri tjetrin. Ky punim ka për qëllim të studiojë ndikimin e kohës së shpenzuar në rrjetet sociale tek jeta studentore e të rinjve në universitetin e Shkodrës. Analiza e përdorur është ajo e regresionit të thjeshtë, e regresionit të shumëfishte, korrelacionit, testi i Studentit dhe multikolinaritetit. Koha e shpenzuar në rrjete ndikon në reduktimin e kohës dedikuar studimit e për pasoje dhe mesataren e notave të studenteve. Analiza tregon se koha shpenzuar në rrjete sociale ndikon ne reduktimin e komunikimit balle për balle. Gjithashtu rezultatet sugjerojnë se femrat janë ato që shpenzojnë më shume kohe në rrjete sociale në krahasim me meshkujt. Gjatë analizes së multikolinaritetit vërehet një lidhje midis variablave shpjegues te marrë në studim.

Fjalët kyçe: Rrjete sociale, studente, koha, ndikimi, mesatare e notave.

1.HYRJE

Shpejtësia e përdorimit të internetit ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit marrin informacion. Interneti ka bëre të mundur prezantimin dhe zgjerimin e rrjeteve sociale për komunikim dhe shkëmbim informacioni. Me rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe përhapjes së përdorimit të internetit "rrjetet sociale" si Facebook, Twitter, Instagram, Linkedin, etj. janë kthyer në një aktivitet intensiv kryesisht për brezat e rinj me faqet (Coyle, 2008). Qëllimi i rrjeteve sociale është krijimi i komuniteteve online ku njerëzit kanë mundësi të ndajnë informacione të ndryshme me pjesëtarët e tjerë të të njëjtit

[118]nmehmetaj@unishk.edu.al or nevilamehmeaj@gmail.com

komunitetit (Oberst, 2010). Vitet e fundit rrjetet sociale në Shqiperi, janë përhapur gjerësisht në përdorimin e tyre veçanërisht nga të rinjtë. Në Shqipëri përdorimi i Facebook ka arritur shifrën e 1.097.800 banorë në vitin 2015 *(Internet World Status).* Kjo formë online komunikimi mundëson që transferimi i tekstit, fotografive, audiove, videove, etj., të bëhet me lehtësi, shpejtësi brënda një numri të madh përdoruesish të rrjeteve.

"Faqet e Rrjeteve Sociale ofrojnë një platformë për të rinjtë që marrin pjesë në komunitete që i ndihmojnë ata të mësojnë dhe të praktikojnë aftësitë brënda një fushe të caktuar të njohurive".(Ahn, 2011, p. 1435).

Rrjetet sociale përveç përparësive të shkëmbimit të informacionit rrisin kohën e shpenzuar në përdorimin e tyre; distancon komunikimet fizike mes individëve; gjithashtu i bën të jenë më pak produktiv në punë apo studime (Banquil, Chuna, Leano, Rivero, & Burce, 2009). Përdorimi i rrjeteve sociale nga studentët sjell një rënie të vazhdueshme të notave të tyre. Kjo u mbështet nga Kirschner dhe Karpinski, të cilët gjetën një marrëdhënie të rëndësishme negative midis përdorimit të Facebook dhe performancës në studime (Kirschner & Karpinski, 2010). Ata arritën në përfundimin se studentët që përdorin Facebook shpenzojnë më pak orë në javë duke studiuar mesatarisht sesa përdoruesit jo të Facebook dhe kjo ka rezultuar në mesatare më të ulët të notave. Duke qenë se literatura në shqip nuk përmban studime të mirefillta për këtë tëmë studimi, u pa me interes studimi në këtë fushë duke u fokusuar në studentët e universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

2. RISHIKIM LITERATURE

Faqja e parë e cituar si rrjet social është "SixDegrees" e shfaqur në fund të viteve 1990 dhe nuk ishte e zbatueshme në drejtimin komercial (Boyd & Ellison, 2007). Faqja e parë që arriti popullaritet masiv ishte "Friendster" prezantuar në vitin 2002 (Boyd, 2006). Pas epërsisë së "Friendster" shumë rrjete sociale filluan të shfaqeshin të suksesshme dhe të vazhdonin si të tilla. Facebook nisi në shkurt të vitit 2004 nga Mark Zuckerberg si një rrjet social kolegji dhe ka arritur të jetë faqja më popullore ndër të gjitha rrjetet sociale.

Rrjetet sociale përcaktohen si: shërbime bazë të internetit që lejojnë individët:

1. të ndërtojnë një profil publik ose gjysmë publik brënda një sistemi të lejuar;
2. të krijojnë një listë të përdoruesve të tjerë me të cilët ndajnë një lidhje;
3. të shohë dhe të zhvendosë listën e lidhjeve me ato të bëra nga të tjerët brënda(Boyd & Ellison, 2008)

Rrjetet sociale përkufizohen si "marrëdhënie që ekzistojnë midis një rrjeti dhe njerëzve (Wang, Chen, & Liang, 2011). Rrjetet sociale u japin njerëzve aftësinë për të komunikuar online dhe ndarë interesat e tyre me të tjerët në distanca të gjata (Barkhuus & Tashiro, 2010). Gjithashtu ndihmojnë në forcimin e komunikimit dhe ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore (Dwyer, Passerini, & Hiltz, 2007). Rrjetet sociale janë përdorur kryesisht për krijimin dhe mbajtjen e kontakteve personale ose profesionale; për të mbajtur kontakt me miqtë e vjetër; për të gjetur kontaktet e humbura; për të komunikuar me njerëzit; për t'u bashkuar me grupe me interesa të përbashkëta; për të organizuar ose për t'u bashkuar në ngjarje të ndryshme; për të gjetur informacione të ndryshme apo thjesht për të postuar një fotografi (Joinson, Looking at 'Looking up' or 'Keeping up with' People? Motives and uses of Facebook., 2008), (Lampe, Ellison, & Steinfield, 2007). Sipas një studimi thuhet se rrjetet sociale lehtësojnë shpërndarjen e fotove dhe videove me miqtë virtual duke u lejuar atyre të krijojnë identitete unike në internet duke personalizuar profilet e tyre personale me një sërë elementësh multimedialë që janë të hapura për leximin nga të tjerët (McLoughlin & Lee, 2007). Kërkimet kanë treguar se shumë

njerëz lidhen në faqet e rrjeteve sociale të paktën një herë në ditë ose për të kontrolluar profilet e tyre ose për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në internet (Joinson, 2008), (Lenhart, 2009).

Rrjetet sociale janë bërë pjesë integrale e jetës shoqërore më së shumti e brezave të rinj si studentët (Tavares, 2013). Studentët kalojnë pjesën më të madhe të kohës së lirë në internet dhe rrjetet sociale në ndryshim me brezat e vjetë që përdorin më shumë burime si televizionin apo gazeta (Lewis, 2008). Rreth më shumë se 90% e studentëve përdorin rrjetet sociale (Wiley & Sisson, 2006). Rrjetet sociale përdoren nga studentët për kalimin e kohës, për të mësuar rreth njerëzve të tjerë, për të ruajtur marrëdhëniet shoqërore, për të ndjekur bashkëmoshatarët në klasë dhe ndryshimet në universitet (Stutzman, 2006). Marrëdhënia midis studentëve dhe përfshirjes së tyre në rrjetet sociale ka tërhequr shumë kërkime që u përqëndruan në në lidhje me shqetësimet dhe pasojat që krijon përdorimi i rrjeteve sociale (Lenhart & Madden, 2007).

Studime të ndryshme kanë zbuluar një lidhje pozitive mes arsimimit të studentëve dhe kohës së shpenzuar në rrjete sociale (Yunus, Nordin, Salehi, Embi, & Salehi, 2013). Studentët përballen me sfida në ruajtjen e lidhjeve të mëparshme, ndërkohë që janë të hapur ndaj miqësive të reja në universitet (Steinfield, Ellison, & Lampe, 2008). Tiene në një studim tregon se "komunikimi me shkrim në hapësirën kibernetike u mundëson studentëve të marrin pjesë në diskutime në një kohë të përshtatshme për ta dhe të artikulojnë idetë e tyre në mënyra më të kujdesshme dhe të strukturuara (Tiene, 2000), (Deng & Tavares, 2013). Në mbështetje të gjetjeve u konkludua se diskutimet në rrjete sociale mund të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive reflektuese të studentëve dhe aftësive të të menduarit kritik.

Përveç aspekteve pozitive studime të tjera nga autorë të ndryshëm kanë zbuluar aspekte negative që pasojnë tek studentët nga koha e tepërt që shpenzojnë në rrjete sociale. Studime mbi "ndikimin e facebook në ecurinë universitare akademike" pohojnë se mediat sociale kanë ndikim negativ tek studentët (Malaney, 2005), (Moon, 2011). Mediat sociale kanë ndikim tek studentët, sa më shumë studentë i përdorin ato, aq më shumë reduktohet koha dedikuar studimit. Si pasojë notat e studentëve pësojnë rënie si rezultat e kohës së tepërt të shpenzuar në internet si dhe në rrjetet sociale të ndryshme (Asemah, Okpanachi, & Edegoh, 2013). Sipas (Akhtar, 2013) përdorimi i tepruar i internetit mund të bëhet një varësi sidomos në mesin e studentëve dhe mund të shkaktojë probleme akademike. Autori sugjeroi që varësia në internet mund të shkaktojë një rënie në kohën e shpenzuar për studime, rënie të madhe në nota, interes të ulët në aktivitetet jashtëshkollore dhe mungese të interesit në klase. Faqet e rrjeteve sociale rrëmbejnë vëmendjen e studentëve dhe pastaj e largojnë atë drejt veprimeve jo-edukative dhe të papërshtatshme (Kuppuswamy & Shankar, 2010).

Studentët në ditët e sotme preferojnë të hyjnë në mediat sociale kryesisht duke përdorur smartphone, prandaj studentët mund të hyjnë në mediat sociale në çdo kohë, kudo dhe kurdo, edhe pse janë në një klasë (Iorliam & Ode, 2014). Paul et al., në hulumtimin e tyre mbi efektin e rrjeteve sociale në ecurinë akademike të studentëve zbuluan se ka marrëdhënie statistikisht domethënësenegative midis kohës së shpenzuar nga studentët në rrjetet sociale në internet dhe rezultateve të tyre (Paul, Baker, & Cochran, 2012). Studentët që ishin përdorues të facebook kishin mesatare të notave më të ulët se sa ata studentë që nuk ishin përdorues (Karpinski, 2009).

Nisur nga fakti i kohës së kufizuar në dispozicion, përdorimi i tepruar i kohës së kaluar në internet shoqërohet me reduktim të komunikimit në familje si dhe zvogëlim të rrethit shoqëror lokal dhe me rritje të vetmisë dhe depresionit (Nie, Hillygus, & Erbring, 2002), (Kraut, Patterson, Lundmark, Kiesler, & Kiesler, 1998). Kjo çon në kufizimin e ndërveprimit me bashkëmoshatarët, ndërveprimit me familjarët, të aktiviteteve sportive, të komunikimit ballë-për-ballë që përfshin shikimin, gjestet, gjuhën e trupit etj. (Nie, Hillygus, & Erbring, 2002).Bazuar në të dhënat e kohës ata gjetën se përdorimi i tepruar i internetit është i lidhur me kufizimin e kohës kushtuar familjes dhe shoqërisë.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e të studimit bazohet në të dhëna primare siguruar nga pyetësorë. Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave është pyetsori me pyetje të mbyllura (me alternativa të përcaktuara). Hartimi i një pyetësori të mbyllur ka avantazh sepse është më e lehtë për të analizuar rezultatet, përgjigjet mund të krahasohen me njëra-tjetrën dhe tek përgjigjet me alternativa mund të bëjë pyetjet më të qarta (Bryman & Bell, 2007). Disavantazh është se pyetjet e mbyllura mund të jenë irrituese për të anketuarit nëse ata nuk i kanë përgjigjet e tyre personale të mbuluara nga alternativat (Bryman & Bell, 2007).

Popullimi i synuar ose targeti i studimit janë "studentët" në qytetin e Shkodrës. Një popullsi është një grup individësh ose objektesh që kanë të njëjtën formë karakteristikash (Mugenda & Mugenda, 2003). Popullata është e madhe e cila është e pamundur të survejohet e gjitha nga ky studim. Për këtë arsye është zgjedhur një mostër për të nxjerrë përfundime në lidhje me të gjithë popullsinë. Mostra e zgjedhur përbëhej nga 150 studentë shpërndarë në mënyrë proporcionale me nga 30 studentë në pesë fakultete, që mostra të jetë përfaqësuese për popullaten. Janë shpërndarë 150 pyetësorë në formë elektronike studentëve të nivelit bachelor dhe master. Shkallët e përdorura për të matur qëndrimet dhe si rezultat përgjigjet e studentëve janë shkallët e Likertit me një shkallë vlerësimi nga 1 (Aspak) -5 (Jashtzakonisht shume), pa përfshirë një përgjigje neutrale "nuk e di/ pa përgjigje". Këto lloj pyetjesh në përgjithsi gjenerojnë variabla të tipit intervalor dhe/ose nominal/ordinal të cilët më pas i kodojmë në formë sasiore në mënyre që të mund të kryhen analiza të mëtjeshme statistikore me këto të dhëna. Metodat sasiore janë përdorur për analizën e të dhënave të mbledhura.

Pas rishikimit të literatures në lidhje me përdorimin e rrjeteve dhe shqyrtimit të një numri të konsiderueshëm të studimeve në lidhje me faktorët që influencojnë në performancën apo në rezultatet e studentëve, është bërë një grupim i faktorëve të cilët do përbëjnë dhe bazën e modelit të studimit.



H1- Karakteristikat personale të studentit ndikojnë në kohën e shpenzuar në rrjete.
H2-Përdorimi i rrjeteve të ndryshme sociale ndikon në kohën dedikuar studimit.

H3- Koha e shpenzuar në rrjete sociale ndikon në mesataren e notave të studentëve.

H4- Koha e shpenzuar në rrjete sociale ndikon në reduktimin e komunikimit ballë-për-ballë.

H5- Ekzistojne diferenca në kohën e shpenzuar në rrjete sociale mes dy gjinive.

4.REZULTATET E ANALIZËSSËTË DHËNAVE

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave nga pyetësorët, ato u analizuan duke përdorur paketën statistikore SPSS versioni 20. Përpunimi statistikor ka konsistuar në analizën e variablave influencues për të konkluduar rezultate që u japin përgjigje pyetjeve kërkimore dhe vlerësimit të hipotezave të ngritura. Nga 150 pyetësorë të shpërndarë, këtij studimi i janë përgjigjur vetë 115 studentë që kanë plotësuar pyetësorin.Metoda stepwise përfshin vetëm ata variabla që janë të rëndësishëm statistikisht dhe eleminon variablat që nuk janë të rëndësishëm për modelin tonë. Më poshtë janë të paraqitura vlera e R square, adjusted R square, vlera e testit Fisher, etj.

Tabela 1: Regresioni shumefishtë

Model	R	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	F	Sig.
1 Mesatarja vjetore	.579[a]	.66	106.321	38.142	.000
2 Gjinia	.631[b]	.652	104.221	33.112	.000
3 Programi studimit	.618[c]	.655	103.957	30.101	.000
4 Gjendja civile	.631[d]	.659	103.846	27.132	.000
5 Mosha	.640[e]	.393	103.481	20.211	.000
6 Abonimi në rrjete	.645[f]	.454	103.263	25.122	.000
7 Punesimi	.646[g]	.657	103.199	28.123	.000
8 Viti studimit	.647[h]	.663	103.136	39.167	.000

Testi Fisher (F) teston modelin nëse është i rëndësishëm statistikisht. Me nivel rëndësie 0.05 ose edhe 0.01. rezulton se rezultatet e testit F jane statistkuisht signifikative, hipoteza baze qe koha e harxhuar në rrjete sociale nuk ndikon ne variablat e mësipërm bie poshtë..

H 1: Karakteristikat personale të studentit ndikojnë në kohën e shpenzuar në rrjete sociale.

Duke referuar tabelës ”model summary”, variabli që ka adjusted R-square më të lartë cilësohet si modeli më i mire dhe niveli i sigurisë është më i vogel se 0.005. Shumica e variablat të pavarur të përfshirë në model si mesatarja vjetore, gjinia, program i studimit, gjendja civile, punësimi e viti i studimit arrijnë ta shpjegojnë nga 65.2% deri në 66.3% variablin e varur kohën e harxhuar në rrjete. Por këto vlera nuk janë të larta për t’u konsideruar lidhje të forta. Ndërsa variablat si mosha apo numri i abonimeve në rrjete nuk kanë ndikim të madh tek koha e harxhuar në rrjete sociale.

H 2: Përdorimi i rrjeteve të ndryshme sociale ndikon në kohën dedikuar studimit.

Në këte rast është përdorur korrelacioni i cili tregon lidhjen midis dy variablave, ai merr vlerat nga -1 në .

Tabela 2: Correlations

		Koha shpenzuar ne rrjete	Ndikon ne kohen dedikuar studimit
Koha shpenzuar ne rrjete	Pearson Correlation	1	.765
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	115	115
Ndikon në kohen dedikuar studimit	Pearson Correlation	.765	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	115	115

******Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Nga të rezultatet e lidhjes shikojmë se lidhja korrelative midis këtyre dy variablave kohës së shpenzuar në rrjete sociale dhe kohës dedikuar studimit, R=0.765, tregon lidhje positive relativisht të

fortë. Sa më shumë kohë te shpenzohet në rrjetet sociale aq më shumë do të ndikojë ne kohen dedikuar studimeve.

H 3:Koha e shpenzuar në rrjete sociale ndikon në mesataren e notave të studentëve.

Tabela 3: Model Summary

Model	R	Adjusted R.Square	Std. Error of the estimate
1	0.579	0.66	0.27156

Tabela 4: Anova

Referuar tabelës së "Model summary" nga interpretimi i koeficentit të determinacionit R^2= 0.66

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	10.622	1	1.949	38.142	.000[b]
	Residual	10.997	113	.198		
	Total	21.619	114			

rezulton se koha e shpenzuar në rrjetet sociale ndikon 66% në variacionin e mesatares së notave të studentit. Tabela ANOVA tregon që regresioni është statistikisht domethënës, me nivel significance 0.000..

H 4:Përdorimi i rrjeteve ndikon në komunikimin balle për balle.

Tabela 5: Correlations

		Koha shpenzuar ne rrjete	Redukton komunikimin balle per balle
Koha shpenzuar ne rrjete	Pearson Correlation	1	.652
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	115	115
Redukton komunikimin balle per balle	Pearson Correlation	.652	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	115	115

**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Në tabelën 2 vërehet një lidhje positive mes kohës së shpenzuar në rrjete dhe reduktimit të komunikimit balle për balle me një nivel rendësie 0.01. Me fjalë të tjera sa më shume kohë të shpenzohet ne rrjete sociale aq më shumë do të reduktohet komunikimi ballë për balle.

H 5: Ekzistojne diferenca në mesataren e kohës së shpenzuar mes dy gjinive.

Tabela 6: Group Statistics

	Gjinia	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Koha shpenzuar ne rrjete	femer	67	185.328	.78602	.09603
	mashkull	48	146.208	.74258	.10718

Nga të dhënat e tabelës kemi që femrat shpenzojnë mesatarisht 185 minuta në ditë duke përdorur rrjetet sociale ndërsa meshkujt shpenzojnë afërsisht 146 minuta në ditë. Duke ju referuar numrit mesatar të individëve të anketuar vërejmë se numri më i lartë i të anketuarve i përket gjinisë femërore. Por edhe pse janë anketuar më shumë femra sesa meshkuj rezultatet tregojnë se ata shpenzojnë më shumë kohë, gjatë një dite, se sa meshkujt duke përdorur mjetet e komunikimit.

Tabela 7: Independent Samples Test

Koha shpenzuar ne rrjete	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
								Lower	Upper
Equal assumed	1.910	.185	-3.169	113	.005	.2900	.2439	-.2867	.5078
Equal variances not assumed			-3.169	104.6	.007	.2900	.2439	-.2845	.5053

Testi Levene përdoret për të testuar në k grupe në mostër kanë variance të njëjta ose homogjenitet variance. Meqë disa teste statistikore psh. analiza e variancës marrin supozimin që variancat midis grupeve të mostrës janë të njëjta, testi Leven pëdoret për të verifikuar këtë supozim. Rregulli i testit Levene është nëse $p<0.5$, variancat janë signifikative, në këtë rast $0.185<0.05$ dmth. varianca njëjta janë signifikative midis grupeve. Duke parë testin e Levene analizohet vlera e rreshtit lart: $t= -3.169$ me nivel signifikance $p=0.005$. Meqë $p<0.05$, testi është signifikativ që do të thotë se mesatarja e kohës së harxhuar ndëmjet dy gjinive femrave dhe meshkujve ndryshon në mënyrë signifikative.

4.1 MULTIKOLINEARITETI

Tek tabela e koeficentëve tek regresioni i shumëfishtë shikohet vlera e tolerances VIF për të bërë një vlerësim nëse kemi prani të multikolinearitetit në modelin tone, pra nëse kemi lidhje midis variablave shpjegues. Kur tolerenca është afër vlerës 1 ose e barabartë me 1 nuk kemi prani multikolinariteti ndersa kur toleranca është afër vleres 0 ose e barabartë me 0 kemi prani multikolinariteti. Vlerat e VIF tregojnë nëse variablat duhet të mbahen në model apo duhet të përjashtohen. Që variabli të mbahet në model VIF duhet të jetë më e vogel se 10 në të kundërt do të përjashtohet nga modeli.

Tabela 8: Multikolinariteti

Model	Collinearity Statistics	
	Tolerance	VIF
(Constant)		
Mesatarja vjetore	.575	1.738
Gjinia	.767	1.303

Programi studimit	.781	1.281
Statusi aktual martesor	.313	3.196
Mosha	.115	8.708
Abonimi ne rrjete të ndryshme	.084	11.742
Punesimi	.706	1.426
Viti studimit	.925	1.083

Për variablat e vitit të studimit dhe punesimit nuk kemi shumë presence multikolinearitet sepse vlerat e tolerances janë 0.706 dhe 0.925 afër vlerës 1 dhe vlera e VIF~1 (1.083). Për variablin abonimi i studenteve në rrjete sociale dhe mosha kemi prezencë të madhe të multikolinearitetit T=0.084 dhe T=0.115. Variabli abonimi i studenteve në rrjete sociale duhet të hiqet nga modeli sepse ka vlerë të VIF>10, ndërsa variabli mosha ka një vlerë të lartë të VIF=8.708 por jo aq sa vlera e kërkuar për tu hequr nga modeli, por nëse do të hiqej ndonjë variabël tjetër nga modeli ky do të ishte i radhës.

Për variablat e tjerë si mesatarja, program i studimit, gjinia kemi prani relativisht të mesme multikolineariteti, ndërsa variabli i statusit martesor prani më të madhe multikolineariteti. Si përfundim mund të themi se kemi lidhje midis variablave shpjegues edhe pse në disa variabla kjo lidhje nuk është e madhe.

5. KONKLUZIONE

Analiza tregon se shumica e studentëve janë përdorues të disa rrjeteve sociale.

Shumica e studentëve shpenzojnë më shumë se 3 orë në rrjete sociale të ndryshme.

Ndër rrjetet më të përdorura nga studentët është rrjeti Facebook.

Përdorimi i rrjeteve sociale nga studentët ka bëre që të reduktojnë kohën dedikuar studimit.

Rrjetet sociale kanë ndikim negativ në rezultatet e tyre, shpërqëndrim dhe rënie të interesit për të studiuar.

Ka diferencë në aspektin gjinor ku sipas të dhënave femrat janë ato që shpenzojnë më shumë kohë në rrjete sociale në krahasim me meshkujt.

Koha e shpenzuar në rrjete sociale nga studentët ndikon në reduktimin e komunikimit ballë-për-ballë.

6.LIMITET E PUNIMIT

Për të studiuar ndikimin e rrjeteve sociale tek studentët kërkohet:

- më shumë hapësirë kohore,
-rritje e numrit të mostrës,
-përfshirje e studentëve të universitetve të tjera në vend,
- analize më e thellë statistikore ndërmjet variablave.

do te ishin vlerë e shtuar për studime të mëtejshme.

BibliograFIA

Ahn, J. (2011). The Effect of Social Network Sites on Adolescents' Social and Academic Development. *Journal of the American Society for Information Science and Technology*, , 1435–1445.

Akhtar, N. (2013). Relationship between internet addiction and academic performance among university undergraduates. *Educational Research and Reviews,* , 8(19), 1793-1796.

Asemah, E. S., Okpanachi, R. A., & Edegoh, L. O. (2013). Influence of social media on the academic performance of the undergraduate students of Kogi State University, Anyigba, Nigeria. *Research on Humanities and Social Sciences,* , 90-96.

Banquil, K., Chuna, N., Leano, G., Rivero, M., & Burce, C. (2009). *"Social networking sites affect one's academic performance.* Retrieved August 12, 2011, from at: http://www.ust.edu.ph.

Barkhuus, L., & Tashiro, J. (2010). Student socialization in the age of Facebook. *Proceedings of the 28th International Conference on Human Factors in Computing Systems* , 133-142.

Boyd, D. M., & Ellison, N. B. (2008). Social Network Sites: Definition, History and Scholarship,. *Journal of Computer-Mediated Communication,* , 13, 210-230.

Boyd, D., & Ellison, N. (2007). 'Social Network Sites: Definition, History, and Scholarship'. *Journal of Computer-Mediated Communication,* .

Bryman, A., & Bell, E. (2007). The nature of qualitative research. In: Business Research Methods. . *Oxford University* (pp. 402-437). New York: Press. P. .

Coyle, C. (2008). Social Networking/; Communication revolution or evolution? *Bell Labs Technical Journal* , , 13-18.

Deng, L., & Tavares, N. J. (2013). From Moodle to Facebook. *Exploring Students' Motivation and Experiences in Online Communities. Computers and Education* , 167-176.

Dwyer, C., Passerini, K., & Hiltz, S. R. (2007). Trust and privacy concern within social networking sites. *Conference on Information Systems,* (pp. 1-12). Keystone: 09.12.2007.

Iorliam, A., & Ode, E. (2014). The impact of social network usage on university students academic performance: a case study of Benue State University Makurdi, Nigeria. *International Journal on Computer Science and Engineering,* , 6(7), 2757-279.

Joinson, N. A. (2008). Looking at 'Looking up' or 'Keeping up with' People? Motives and uses of Facebook., (pp. 1027-1036.).

Joinson, N. A. (2008). Looking at', 'Looking up' or 'Keeping up with' People? Motives and uses of Facebook. *CHI 2008 Proceedings:* , 1027-1036.

Karpinski, A. (2009). A description of Facebook use and academic performance among undergraduate and graduate students. *Annual Meeting of the American Educational Research Association,* . San Diego, Calif.

Kirschner, P. A., & Karpinski, A. C. (2010). Facebook and academic performance. In *Computers in Human Behavior* (pp. 1237–1245). Netherlands: University of the Netherlands.

Kraut, R., Patterson, M., Lundmark, V., Kiesler, V., & Kiesler, S. M. (1998). Internet paradox: A social technology that reduces social involvement and psychological well-being? *American Psychologist,* , 53, 1017–1031.

Kuppuswamy, S., & Shankar, N. (2010). The Impact of Social Networking Websites on the Education of Youth. *International Journal of Virtual Communities and Social Networking* , 13.

Lampe, C., Ellison, N., & Steinfield, C. (2007). The benefits of Facebook ‘‘Friends:’’ social capital and college students’ use of online social network sites. *Journal of Computer-Mediated Communication.* , 1143–1168.

Lenhart, M. (2009). *Adults and social network websites. Pew Internet & American Life Project Report.* Retrieved from Available from http://www.pewinternet.org/pdfs/PIP_Adult_social_networking_data_memo_FINAL.pdf

Lenhart, M., & Madden, M. (2007). *Teens, Privacy and Online Social Networks. How teens manage their online identities and personal information in the age of MySpace. Pew Internet & American Life Project Report.*

Lewis, K. (2008). The Taste for Privacy: An Analysis of College Student Privacy Settings in an Online Social Network.

Malaney, G. D. (2005). Student Use of the Internet. *Journal of Educational Technology Systems* , 53-66.

McLoughlin, C., & Lee, M. J. (2007). Social software and participatory learning: Pedagogical choices with technology affordances in the Web 2.0 era. *Paper presented at the ASCILITE,* , 664-675.

Moon, A. (2011). The impact of Facebook on undergraduate academic performance: Implications for educational leaders.

Mugenda, O. M., & Mugenda, A. G. (2003). Research methods: Quantitative and qualitative . *Science and Education* .

Nie, N., Hillygus, D., & Erbring, L. (2002). Internet use, interpersonal relations, and sociability. *The Internet in everyday* .

Nie, N., Hillygus, D., & Erbring, L. (2002). Internet use, interpersonal relations, and sociability. In B. Wellman & C. Haythornthwaite (Eds.). *The Internet in everyday* .

Oberst, L. (2010). The 6S Social Network. *American Journal of Educational* , 961-969.

Paul, J. A., Baker, H. M., & Cochran, J. D. (2012). Effect of online social networking on student academic performance. *Computers in Human Behavior,* , 28(6), 2117-2127.

Stutzman, F. (2006). *An evaluation of identity-sharing behavior in social network communities. Paper presented at the iDMAa and IMS Code Conference,*. Oxford, Ohio.

Wang, Q., Chen, W., & Liang, Y. (2011). The Effects of social media on college students. *Johnson Wales* .

Wiley, C., & Sisson, M. (2006). Ethics, accuracy and assumption: The use of Facebook by students and employers. *Paper presented at the Southwestern Ohio Council for Higher Education Special Topics Forum,*. Dayton,.

Yunus, M., Nordin, N., Salehi, H., Embi, M. A., & Salehi, Z. (2013). *The Use of Information and Communication Technology in Teaching ESL Writing Skills.* Retrieved 01 12, 2015, from English Language Teaching,: http://www.ccsenet.org/journal/index.php/elt/article/viewFile/27998/16886

AneksE

A: GRAFIKE SHTESE

Grafiku 1:Përqindja e kampionit të studentëve sipas moshës.



Grafiku2:Përqindja e kampionit të studentëve sipas gjinisë



Grafiku 3: Shpërndarja sipas fakulteteve.



Grafiku 4: Shpërndarja sipas programit të studimeve.



Grafiku 5: Shpërndarja sipas viteve të studimit



Grafiku 6: Përqindja e përdorimit të rrjeteve sociale tek studentët.



Grafiku 7: Perqindjet e studenteve sipas abonimit ne disa rrjete sociale



Grafiku 8: Rrjetet sociale të përdorura më shumë nga studentët.



Grafiku 9: Qëllimi i perdorimit të rrjeteve.



Grafiku 10: Ndikimi i rrjeteve.



Grafiku 11: Ndikimi i rrjeteve në reduktimin e komunikimit përballë.

Grafiku 12: Koha e shpenzuar në rrjete sociale.



Grafiku 13: Koha shpenzuar për qëllime studimi.



3.2.4 Koha shpenzuar nga studentët në rrjete sociale në raport me gjininë.

Tabela 1: Koha shpenzuar në rrjete sipas gjinisë.

Koha shpenzuar ne rrjete	Gjinia		Totali
	Femër	Mashkull	
Asnje ore	2	2	4
	50%	50%	100%
1 ore	9	7	16
	56%	44%	100%
1-2 ore	12	9	21
	57%	43%	100%
2-3 ore	18	12	30
	60%	40%	100%
Më shume se 3 ore	26	18	44
	50%	41%	100%
Totali	67	48	115
	58%	42%	100%

B. PYETSOR

1. Gjinia juaj është:*

☐ Femër ☐ Mashkull

2. Mosha juaj është:*

_____

3. Statusi juaj civil:

☐ Beqar

☐ I martuar

4. Nga cili fakultet jeni?

☐ Ekonomik

☐ Juridik

☐ Shkencave Sociale

☐ Shkencave të Natyres

☐ Shkencave të Edukimit

☐ Shkencave Shoqerore

5. Në cilin program studimi jeni frekuentues?

☐ Bachelor

☐ Master Profesonal

☐ Master Shkencor

6. Në cilin vit jeni?

☐ 1

☐ 2

☐ 3

7. Cila është mesatarja juaj?

☐ 5 – 6

☐ 6 – 7

☐ 7 - 8

☐ Me shume se 8

8. A jeni aktualisht i punësuar?

☐ I papunë

☐ I punësuar part-time

☐ I punësuar full-time

9. A jeni përdorues i rrjeteve sociale?

☐ Po ☐ Jo

10. Në sa rrjete sociale komunikimi jeni pjestar/e?

☐ 1

☐ 2

☐ 3

☐ Me shumë se 3

11. Cili është rrjeti juaj i preferuar?

☐ Facebook

☐ Tëitter

☐ Linkedin

☐ Instagram

12. Si mund hyni në llogarine tuaj në rrjete sociale?

☐ PC

☐ Smartphone

☐ Laptop

13. Sa kohë keni qe jeni perdorues i rrjeteve sociale?

☐ 1 muaj

☐ 1 – 5 muaj

☐ 6 – 10 muaj

☐ Më shumë se 1 vit

14. Mesatarisht sa kohë shpenzoni në ditë në këto rrjete sociale?
☐ Asnjë orë
☐ 1 orë
☐ 1 – 2 orë
☐ 2 – 3 orë
☐ Me shume se 3 orë
15. Në çfare vendi i vizitoni zakonisht këto rrjete sociale?
☐ Shkollë
☐ Shtepi
☐ Punë
16. Përse i përdorni këto rrjete sociale?
☐ Për te gjetur informacione te ndryshme
☐ Për të qenë në dijeni të lajmeve të reja
☐ Për të qenë i informuar rreth ngjarjeve sociale
☐ Për të zgjeruar kontaktet profesionale
17. Cilin rrjet social përdorni më shumë?
☐ Facebook
☐ Instagram
☐ Twitter
☐ Linkedin
☐ Ëhatsapp

18. Pjesën më të madhe të kohës së shpenzuar në këto rrjete sociale e shpenzoni për:
☐ Informacione
☐ Krijimi i kontakteve të reja
☐ Lajme
☐ Foto
19. Sa kohë shpenzoni në rrjete për të gjetur informacione në lidhje me studimet tuaja?
☐ 1 orë
☐ 1 – 2 orë
☐ 2 – 3 orë
20. Sa kanë ndikuar rrjetet sociale në reduktimin e komunikimit ballë për ballë?
☐ Aspak
☐ Pak
☐ Mesatarisht
☐ Shumë

21. Sa ndikon perdorimi i rrjeteve sociale në reduktimin e kohës suaj dedikuar studimit:
☐ Aspak
☐ Pak
☐ Mesatarisht
☐ Shumë

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

GJENDJA E SHQIPTARËVE NË ZONAT E PUSHTIMIT GJERMAN

PhD.c. Jeton Idrizi(Historian) *-Mësimdhënës në shkollën e Mesme të Ulët "Bafti Haxhiu"-Viti*

APSTRAKT

Gjate Luftë së Dytë Botërore, nazi-fashistët pasi e pergatiten terenin më 6 prill 1941 sulmuan Jugosllavinë, e cila kapitulloi më 17 prill 1941, ku në këtë kohë ato pushtuan edhe Kosovën. Disa pjesë të Kosovës, sidomos ato verilindore ku gjindeshin Trepça, u sulmuan në tri drejtime. Në vijen Nish-Prokupe- Kushumli- Podujevë- Prishtinë sulmoi Divizioni i V i blinduar gjerman. Ndërsa, në vijën Kralevë- Rashkë- Mitrovicë- Prishtinë, për shkak të rrugës së përshtatshme dhe rëndësisë që kishte terreni, sulmoi Divizioni 60 i motorizuar gjerman, ku edhe Trepça ra përfundimisht nën pushtim më 16 prill.

Pas pushtimit të Kosovës, erdhi radha e vendosjës së pushtetit dhe ndarjës së saj ku pas shumë debateve të ashpra në mes Ribentropit dhe Qanos në mbledhjen e Vjenës, kohë më vonë me disa ndryshime më në fund ka muaji maj i vitit 1941 u vendos që Kosova të ndahet në tri zona pushtuese: në zonën gjermanë, italiane dhe bullgare. Pjesa më e madhe e territorit të Kosovës mbeti nën pushtimin Italian e cila ju aneksua Shqipërisë me dekretligj mbretëror.

Në zonën e pushtimit gjerman u krijua administrate kuisilinge e përbërë nga shqiptarë e serbë, por pushtetin faktik e kishte komanda e trupave ushtarake gjermane. Qyteti i Mitrovices ishte seli e Krajskomandanuturës 838, e cila deri në dhjetor të vitit 1941 ishte nën vartësinë e Feldkomandanturës së Nishit, ndërsa pas janarit të vitit 1942, të Feldkomandanturës në Vërnjaçka Banjë. Pushtuesit gjermanë, në ditët e para të pushtimit, krahas shtypjes me dhunë të ideve liridashëse zhvillonte edhe politikë demagogjike. Pas pushtimit, forcat gjermane mënjehere filluan edhe vendosjen e administrates civile. Në krye të çdo komune dhe prefekture u vendosen shqiptarët që i nënshtroheshin qëndrimeve gjermane. Zgjedhja e kryetarëve të tillë bëhej në të njejtën mënyrë edhe në komunat e tjera të rrethit. Shumë shpejt forcat gjermane filluan të vendosëshin edhe institucionet dhe organet e tjera të administratës pushtuese, si policinë e gjandarmërinë shqiptare të vendit, gjyqet, organet e ndryshme financiare etj. Formimin e pushtetit kuisling shqiptar e mori mbi vete Xhafer Deva me bashkëpunëtor. Prej fillimit të korrikut këtë funksion e merr "Komiteti Nacional i Shqiptarëve" edhe në LLap. Xhafer Deva erdhi në rrethet e afërta së bashku me oficerët gjermanë, të cilët organizuan mbledhje në përmasa rrethi, si dhe i emëroi nënprefektët e rretheve.

Përmes këti apstrakti do të tentojmë të shtjellojmë aspekte të rëndësishme që kanë karakterizuar këtë periudh të popullit shqiptar. Referenc e këti apstrakti janë burime te shkruara si dhe dokumente të asaj kohe. Ky apstrakt ka për qëllim të ndriçoj këto çështje kryesore:

1. **Vëndosjen e administartës gjermane në Kosovë**
2. **Gjendjen e shqiptarëve në këto zonë dhe**
3. **Kapitullimin e Gjermanisë në fund të luftës.**

1. Vendosja e pushtimit dhe pozita e shqiptarëve

Pozita e shqiptarëve, para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, përbën një veçori, që duhet marrë domosdoshmërisht në konsideratë, për trajtimin objektiv të qëndrimit të tyre ndaj saj. Lufta i gjeti shqiptarët në një situatë, kur nuk e kishin zgjidhur detyrën e çlirimit dhe bashkimit të tyre kombëtar.[119] Kjo luftë tregoi se në kushtet e pushtimit nga Fuqitë e Boshtit, shtetet e rinj kombëtarë të Europës Juglindore ishin sërish më të rrezikuarit.[120] Mandej vështirësitë që i pati Shqipëria në tallazet e Luftës së Dytë Botërore, e bënë tepër komplekse dilemën për Pavarësinë e saj pas lufte.[121] Shqipëria ishte i pari vend ballkanik që u sulmua nga Italia fashiste dhe që në fillim ishte i pari që përqafoi lëvizjen e rezistencës së armatosur kundër fashizmit, duke hedhur në luftë të gjitha forcat e tij material dhe morale.[122] Në anen tjetër, pushtimi i Shqipërisë nga Italia Fashiste shënoi fundin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar.[123] Problematika e kombit tonë gjatë Luftës së Dytë Botërore është shumë e gjërë. Në këtë trajtim synimi i zgjidhjes së problemit kufizohet tek qëndrimi i shqiptarëve ndaj konfliktit botëror dhe, brenda këtij kuadri, të përcaktimit se sa ishin realist shqiptarët në pozicionimin e tyre si dhe i forcave që e nxitën atë.[124] Lufta e Dytë Botërore krijoi kushte krejtësisht të reja gjeoploitike në Ballkan dhe në trojet etnike shqiptare. Gjatë kësaj lufte Kosova dhe trojet e tjera etnike u pushtuan nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria dhe u ndanë ndërmjet tyre. Edhe pse në bisedimet rreth ndarjes së territoreve të pushtuara u theksua kriteri themelor përkatësia kombëtare e popullsisë, ky kriter u shkel nga Fuqitë e Mëdha në mënyrën më të vrazhdë të mundëshme.[125] Me fillimin e Luftës Botërore, lufta e shqiptarëve, pavarësisht se ku banonin në Shqipëri apo në trevat etnike jashtë saj, mori karakterin e luftës çlirimtare mbarëkombëtare shqiptare.[126] Detyra e çlirimit kombëtar i vuri shqiptarët në një emërues të përbashkët, pavarësisht nëse pushuesit dhe sunduesit ishin italianë, serbë apo grekë. Pra, ata ishin vënë përballë rrezikut të asgjësimit të shtetit kombëtar në Shqipëri te i cili kishin shpresën që ta

---

[119]Muharrem Dezhgiu, Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugusllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 39.

[120] Ana Lalaj, Projektet për Federatën Ballkanike dhe e ardhmja e Shqipërisë (1943-1945), Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi I Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.190.

[121] Muharrem Dezhgiu, Dilemat për Pavarësinë shqiptarennë vitet e Luftës së Dytë Botërore, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.158.

[122] Esilda Luku, Aspekte të çështjes shqiptare në Traktatin e Paqës me Italinë pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjurmime Albanologjije Seria e shkencave albanologjike, nr. 39/2009, Prishtinë, 2010, f.156.

[123] Hamit Kaba, Projektet e Aletaëve të Mëdhenj mbi të ardhmen e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.173.

[124] Marenglen Verli, Antifashizmi, alternative e perspektivës për kombin shqiptar, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f.81.

[125] Muhamet Shatri, Çlirim apo ripushtim jugosllav I Kosovës dhe trojeve të tjera etnike më 1944, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 217.

[126] Fejzulla Shabani, Roli i Shqipërisë në mbrojtje të identitetit kombëtar të shqiptarëve në trevat lindore 1941-1944, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti I Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.213.

kishin si shtet unik të tyre. [127] Lufta e Dytë Botërore, riaktualizoi çështjen e Kosovës, si një çështje e cila kërkonte zgjidhje të ngutshme. Kosova u bë një çështje e rëndësishme, rreth së cilës do të bëheshin diferencime e polararizime forcash, madje u shndërrua në një problem që do të përcaktonte orientimin e shtresave të ndryshme politike duke ndikuar edhe në zgjerimin apo ngushtimin e koalicioneve antifashist, apo fashist.[128]

Marrëdhëniet e shqiptarëve me gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin të shkelqyera. Mirëpo, nëse iu hedhim një sy këtyre raporteve para luftës, ato ishin mjaft të kufizuara. Arsyeja e raporteve jo të mira ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Gjermanisë, padyshim ishte ndikimi Italian në Shqipëri. Politika gjermane ishte krejtësisht e painteresuar ndaj Shqipërisë, duke marrë në konsideratë xhelozinë italiane ndaj çdo shteti që shfaqte interesa për marrëdhënie preferenciale ndaj Shqipërisë, të cilën, Italia, e konsideronte si "domenin" e saj.[129]

Këtë situatë të marrëdhënieve të Shqipërisë së paraluftës me Italinë dhe Gjermaninë e kanë vënë në dukje edhe studius të ndryshëm. Kështu, duke iu referuar kësaj situate të marrëdhënieve të Shqipërisë me pushtuesit e ardhshëm, studiusit kanë pohuar: "Ministria e Jashtme Gjermane ishte e lëkundur, veçanarisht pasi italian1ët u bënë thuajse histerikë, kur morën vesh përçapjet e Mehdi Frashërit për bisedime me gjermanët.[130] Zhgënjimin e tij, lidhur me shkallën e ulët të ndikimit gjerman në Shqipëri, dhe raporteve jo aqë të mira në mes këtyre shteteve, e shprehte edhe përfaqësuesi gjerman në Shqipëri, Eberhard von Pannëitz, posaçërisht lidhur me dështimin e një marrëveshje tregtare të vitit 1938 midis këtyre dy shteteve.[131]

Nëse bëjmë një vlersim më të përgjithshëm në bazë të dokumentave të kohës, konsatojm se Shqipëria e para Luftës së Dytë Botërore nuk zinte ndonjë vend shumë të rëndësishëm në planet ekspansive të Gjermanisë Hitleriane. Pas kapitullimit të Italisë më 3 shtator 1943 si dhe daljes së saj përfundimtare nga Boshti Qendror më 8 shtator 1943, interesi i Gjermanisë ndaj Shqipërisë filloi të rritej. Ky interes pa mëdyshje ishte edhe si rezultat i pozitës së mirë gjeografike të Shqipërisë.[132] Shkalla e ulët e raporteve shqiptaro-gjermane, para Luftës së Dytë Botërore, do të shprehej edhe në përgjigjen negative të Hitlerit ndaj kërkesës së Mbretit shqiptar, në mars të vitit 1939, për ta mbrojtur atë nga Musolini. Megjithatë, Zogu nuk shihte ndonjë optimizëm në ndihmën gjermane për mbrojtjen e tij nga italianët, vetëm gjatë Luftës, në rrethanat e zhvillimit të ngjarjeve në Ballkan dhe në Shqipëri, intersi gjerman për Shqipërinë u shpreh me një vëmendje të veçantë.[133]

Plani për ndarjen e territoreve të Jugosllavisë u konkretizua në mbledhjen e Vjenës, më 21-22 prill të atij viti, në bisedimet mdërmjet ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, F. Ribentrop dhe atij të

---

[127] Muharrem Dezhgiu, Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugusllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 40.

[128] Sabit Syla, Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 111.

[129] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.

[130] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.

[131] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.

[132] Marenglen Kasmi, Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944, Tiranë, 2003, f.53.

[133] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61-62.

Italisë, G. Çiano. Në kuadër të këtyre ndarjeve, copëtimin e përjetuan edhe viset shqiptare të cilat bënin pjesë në mbretërinë ish-jugusllave, të cilat u ndanë midis pushtuesve gjermanë, italianë dhe bullgarë.[134] Ky pushtim, objektivisht solli ndryshime për pozitën e mëparshme të shqiptarëve. Bashkimi me Shqipërinë i Kosovës dhe dhe i trevave të tjera, në kuadrin e ndarjes së zonave të pushtimit të Ballkanit, ndryshoi pozitën sociale, ekonomike e politike të shqiptarëve.[135]

3. Head teachers are critically important to this Endeavour. They emphasize teaching and learning in their management.
4. Research studies show the following in well-performing schools: Well structured, visible and transparent school management involving all staff; Regular monitoring of student performance and teaching practice combined with support for professional

5. One major emphasis in the educational arena in the early 21st century has been the continuing demand for greater accountability to increase student performance.
6. National and state expectations require schools to ensure that all students achieve mastery of curriculum objectives, and local schools focus on implementing those requirements to the best of their ability. As a result, leading instructional efforts in a school has evolved into a primary role for school principals. The operating expenses in education is managed by the local government. It is important that the school continuously plays an active role in the use of this part of the budget. *Bentler, P.& Bonett, D. (1980).*

- Actually the school should take part in the planning of its expenses for the items mentioned above and introduce to the commune or municipality in the draft budget of the school for the coming year.
- The education institution should be directly involved to manage and follow the expenses all the time, in compliance with the concrete plan approved by the commune or municipality.
- Another element of school financing is the space of the educational institutions to ensure additional resources through the contribution of the community, parents, business and particular sponsors, as well. *Source: (Manasse, 1985; Zmuda, Kuklis, & Kline, 2004).*

3.3 BUILDING AND SUSTAINING A SCHOOL VISION

If you are not sure of where you want to go, how will you ever get there?

All schools need principals to exercise their roles as instructional leaders who ensure the quality of instruction (*Portin et al.*, 2003). Thus, there is a need to spend time in classrooms observing the process of teaching and learning while also balancing other needs such as student safety and parent relationships. Fulfilling these multiple responsibilities well requires principals to possess an inner compass that consistently points them toward the future interests of the school, never losing sight of their schools' visions, missions, and goals.

Principals of high-achieving schools are confident that they will accomplish their vision and goals despite challenges and setbacks and, thus, serve as role models for staff and students (Cotton, 2003). And when milestone achievements are reached, those successful results are celebrated.

.

A series of counseling organs about different aspects of education operate in the Ministry of Education and Science.

Institute of Curricula and Standards ICS has been operating as a national public institution depending on the Ministry of Education and Science since 2003. Its mission is the development of the curricula and achievement standards for different school levels. Training and Qualifications Center for Education

TQCE has started to operate since 2005. The Center's mission is to assess the needs for the teacher and school principal trainings as well as develop national training programs.

The experience of the recent years has shown that there is no coordination and harmonization of the activities among these three institutions so as to fulfill the national education objectives formulated in the national strategy. Their management is of a low level because collegial managing and decision making organisms lack. The change of the status and of the statute of these three institutions is now a primary need of the Ministry of Education and Science which is also involved in the Education Excellence and Equity Program (EEE-P)

CONCLUSIONS

1. Advancing, creating and disseminating knowledge through research and providing as part of its service to the community, relevant expertise to assist societies in cultural, social and economic development;
2. Helping to protect and enhance societal values by training students in the values that form the basis of democratic citizenship and enhance critical and forward-looking function. While organizing the follow-up of the World Declaration, quality appeared as one of the most constant criteria adopted by all regional strategies throughout the world.
3. It is universally acknowledged that to implement the mission of higher education, quality is among the most important conditions to fulfill.
4. Quality in Higher Education is a multidimensional concept which should embrace all its functions and activities: academic programmers, research and scholarship, staffing, students, building facilities, equipment, service to the community and the academic environment.
5. Quality is important because it sets the standards that defy ne a University' s intellectual standard which conditions the vision and capacity of graduates and of a nation to manage its own affairs. (Saint, 1992)

But this is not enough. Because the demand for teachers varies across subjects, the planning team must also determine critical district needs for more teachers in specific subject areas. In recent years, for example, teachers of mathematics, science, bilingual education, and special education have been in high demand. Similarly, school districts sometimes seek teachers with particular characteristics.

Most of the National Quality Assurance bodies are highly dependent on government. In terms of mandate and activities, they all have the authority to assess higher education institutions and/or programmers, to approve new programmers and to approve or refuse the creation of new private tertiary institutions. Most of the Agencies now cover both public and private institutions.

While emergency-certified teachers usually receive better benefits and higher salaries than substitute teachers, their employment status is conditional on satisfying requirements for full certification within a grace period, typically three years. This pool is another good source of permanent teachers for districts with teacher shortages. Because substitute and emergency-certified teachers have teaching experience in the partner district, they know the student population well. Many are of racial/ethnic minority backgrounds and are knowledgeable about the cultures of students of color. Because most possess bachelor's degrees, they can complete the coursework required for certification within a relatively brief period, even if they are taking courses part-time

- Partnerships with a history of collaboration and a system of open communication are more apt to succeed in solving implementation difficulties than partnerships with no previous collaborations or with poor communication.

REFERENCES

1) UNESCO (2005). EFA Global Monitoring Report - The Quality Imperative, 477 p.
2) UNESCO (2005). Education Pour Tous en Afrique: EPT, Repres pour l'Action, 300 pp.
3) UNESCO (1998). Higher Education in the Twenty-First Century: Vision and Action - Final Report, 134p.
4) UNESCO (2009). EFA Global Monitoring Report: Overcoming Inequality - Why Governance Matters, 463p.
5) UNU (2009). Innovating to Revitalize Education in Sub-Saharan Africa: The Role of Innovating Centres, 113p.First and foremost, principals need to have a clear vision for their schools Source: (Manasse, 1985; Zmuda, Kuklis, & Kline, 2004).
6) Schools need principals who strive to ensure the quality of instruction in their schools (Harris, 2007; Marzano et al., 2005; Portin et al., 2003).
7) Principals of high-achieving schools expect teachers and students to meet the schools' goals (Leithwood & Riehl, 2003).
8) Principals of high-achieving schools are confident that their schools can meet their goals (Cotton, 2003).
9) Principals who focus on school improvement have more effective schools (Shen & Hsieh, 1999).

- Principals of high-achieving schools communicate to all stakeholders that learning is the school's most important mission (Cotton, 2003; Marzano et al., 2005)
- Chandler, Alfred D., Jr. *Strategy and Structure*. Cambridge, Mass.: M.I.T. Press, 1962. Chandler, Alfred D., Jr., and Salisbury, Stephen. *Pierre S. Du Pont and the Making of the Modern Corporation*. New York: Harper & Row, 1971. Drucker, Peter F. *The Future of Industrial Man.* New York: John Day, 1942. Drucker, Peter F. *Concept of the Corporation*. New York: John Day, 1946; revised edition, 1972. Title of British edition: Big Business. London: Heinemann, 1946. Drucker, Peter F. *The New Society*. New York: Harper & Row, 1950. Eells, R.S.F. and Walton, C.C. *Conceptual Foundations of Business*. Homewood, Ill.: Irwin, 1961. Emmett, Boris, and Jeuck, John C. *Catalogues and Counters*; *A History of Sears, Roebuck & Co*. Chicago: University of Chicago, 1950.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

GJUHA E PAKICAVE KOMBËTARE VLERË APO RREZIK

PhD Melihate ZEQIRI-Mësimdhënëse e lëndës Gjuha shqipe, Prishtinë

Abstrakt

Në këtë kumtesë, ne do të trajtojmë çështjen e vlerës kombëtare të gjuhës amtare dhe rrezikun që mund të ketë gjuha e pakicave. Gjuha quhet e nënës, sepse rrjedh nga ajo që na jep qumësht, që së bashku me qumështin na jep edhe afërsinë e të folurit. E gjuha e nënës, e të gjithëve është shumë e bukur. Vlerë e gjuhës amtare është hapja e katedrës, e cila mund të zhvilloj punë kërkimore shkencore dhe mësimdhënien. Përgatitja e planprogrameve mësimore në gjuhën e pakicave. Roli i mësimdhënies për mësimin e gjuhës amtare. Strukturimi i aktiviteteve me rol të rëndësishëm kombëtar. E drejta dhe ruajtja e gjuhës së nënës me ligj. Për ruajtjen e vlerës kombëtare të gjuhës nevojitet bashkëpunim i madh me shoqatat, veprimtarit me studiuesit dhe aktivistëve. Mirëpo, interesat e përbashkëta ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kombëtar. Rrezik është emigracioni, i cili bëhet për shkaqe ekonomike, prandaj zhdukja e njerëzve rrezikon zhdukjen e gjuhës. Për t'i shpetuar rrezikut të gjuhës duhet të përgatiten projekte për promovimin e kulturës e të gjuhës së pakicave.

Fjalët kyçe: gjuha, pakica, vlera, rreziku, ligji, planprograme, projekte.

Gjuha e pakicave kombëtare vlerë apo rrezik

"*Ajo që në gjuhë është e përhershme, janë ndryshime!t*" – Egon Fekete

Respektimi i të drejtave të pakicave dhe personave, të cilët u përkasin atyre është faktor me rëndësi për paqe, stabilitet dhe demokraci. Ndersa, përdorimi i gjuhës dhe kulturës së pakicës është shënjë e pasurisë dhe e vitalitetit të qytetërimit evropian. E drejta për përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare në esencë bënë pjesë në një seri të së drejtave të kultivimit të kulturës dhe traditës së vet. Mirëpo, rëndësia e ruajtjes dhe përdorimit të lirë të gjuhës është e tillë që duhet të ndahet dhe veçenarisht të shqyrtohet.

Në Republikën e Kosovës gjuhë zyrtare janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe, kurse gjuhë zyrtare që kanë status në nivel komune janë gjuha Turke, Boshnjake dhe Rome, përdorimi i të cilave është në pajtim me ligjin(Kushtetuta RK, neni5,f.2). Mirëpo, gjuhë zyrtare në nivel vendi e treta me rend është gjuha angleze. Pra, përdorim të dendur kanë Gjuha shqipe, serbe dhe angleze, të cilat janë pjesë e çdo dokumenti zyrtar. Por, gjuha shqipe në Kosovë ka qenë dhe ende mbetet e ndikuar nga termet e anglishtes dhe të serbishtes.

Në Kosovë gjuha serbe ka zënë vend të rëndësishem në përdorim të saj, pasiqë këtu jeton një numër i madhë i qytetarëve serbë, të cilët në nivel vendi udhëheqin dhjetë komuna. Ata kanë të drejtë ligjore për udhëheqjen komunale në gjuhën e tyre, edhe shkollimi i tyre bëhet me planprograme të Serbisë.

Njëherit kemi përdorim të madhë të toponimeve sllave në Kosovë, të cilat do t'i mbledhimpër t'i prezentuar në konferencat e ardhshme. Edhe boshnjakët kanë të drejtë të përdorimit të gjuhës sipas Kushtetutës së Kosovës, por që arsimimi i tyre dhe Romëve bëhet me planprogram të arsimimit kosovar. Kurse gjuha turke gëzon të drejta të njëjta me këto minoritete, përveç se ky komunitet ka arritë të ketë Katedrën e Gjuhës Turke për të studiuar në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë, me planprograme të miratuara nga Universiteti dhe Agjensia e Akreditimit.

Sipas *Kushtetutës së Kosovës*, neni 47- *E Drejta për Arsimin*, pika 1. (Kushtetuta, 2008:14) Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.

2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Ligji për përdorimin e gjuhëve në procesin e arsimit u garanton të drejtën pakicave në Kosovë që të arsimohen në gjuhën e tyre amtare, duke filluar nga institucionet parashkollore deri në ato universitare.

Fondi për të Drejtën Humanitare vlerëson se ky ligj, në mënyrë të përgjithshme respektohet sa u përket turqve dhe boshnjakëve, pasi nxënësit e këtyre komuniteteve mësimet i ndjekin në gjuhën e tyre amtare dhe me planprograme të shkruara në gjuhën turke dhe boshnjake. Edhe nxënësit tjerë, përveç komunitetit serb, mësimet i ndjekin sipas planprogramit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por nuk mësojnë në gjuhën e tyre amtare. *"Turqit, boshnjakët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe një pjesë e goranëve që shkollohen në gjuhën boshnjake, mësimin e ndjekin në shkollat që janë kompetencë e Ministrisë së Arsimit në Kosovë. Ndërsa, serbët, goranët që shkollohen në gjuhën serbe, mësimin e ndjekin sipas planprogrameve të Qeverisë së Serbisë".* [154]

Sipas *Kushtetutës së Kosovës*, (neni 59, faqe 19); Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: 1. të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre; 2. të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës se Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre; 3. të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore; 4. të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; 5. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike; 6. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente; 7. të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; 8. të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë; 9. të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse; 10. të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; 11. të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e

[154]Nadie Ahmetihttps://www.evropaelire.org/ Shikuar për herë të fundit më, 22.1.2018

shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë Republikën e Kosovës; 12. të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare; 13. të gëzojnë kontakte të papenguara me dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare; 14. të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Sipas këtyre pikave, këto komunitete tani gëzojnë pjesën dërrmuese. Rëndësia e përdorimit të lirë të gjuhës amtare është shumë me rëdësi. Andaj, ajo është e garantuar me dokumente të shumta ndërkombëtare, dhe ajo si në rrafshin ndërkombëtar dhe atë rajonal. Ndër dokumentat univerzale gjithsesi duhet të përmenden burimet juridike më të rëndësishme ndërkombëtare – *Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike* (neni 27), si dhe *Deklarata e Kombëve të Bashkuara për të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore* (nenet 2,4). Në rrafshi rajonal duhet thekësuar *Konventa për mbrojtjen e pakicave kombëtre të Këshillit Europian (*1995.).

Kontributi i shqiptarëve të Zarës së Kroacis dhe arbëreshëve të Italisë

Në Zarë të Kroacisë zyrtarisht u hap gjimnazi në gjuhën shqipe. Rasti i shqiptarëve në Zarë është pothuajse i pari në botë, ku një pakicë gëzon të drejtën e hapjes së një gjimnazi në gjuhën e saj. Drejtori i gjimnazit "Vlladimir Nazor", Rade Shimiçeviq u uroi mirëseardhjen nxënësve me mësim në gjuhën shqipe në këtë shkollë.[155]

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kroaci, Ilir Melo theksoi: "Kjo është një ngjarje e shënuar dhe me rëndësi të veçantë dhe është ngjarje historike, sepse para 300 vjetëve këtu kanë ardhur një gjeneratë e shqiptarëve nga veriu i Shqipërisë, por edhe një gjeneratë tjetër që kanë ardhur në 100 vitet e fundit. Është rast që edhe arbëneshët e Zarës të mësojnë gjuhën shqipe. Është moment i rëndësishëm historik se në këtë ditë ka filluar mësimi në gjuhën shqipe për ta ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditën shqipe. Ambasada e Shqipërisë, do të japë gjithë ndihmesën e duhur".

Përfaqsuesi i Ambasadës së Kosovës, Uliks Emra, në fjalën e tij të rastit mes tjerash theksoi: "Krenaria dhe pasuria më e madhe e shqiptarëve është gjuha shqipe, dhe kjo është ngjarje jo vetëm historike por edhe e veçantë. Ambasada e Kosovës do të mbështesë gjithë aktivitetet e këtilla. Populli shqiptar është popull që nuk harron dhe kurrë nuk do ta harrojë miqësinë që ka historikisht me popullin kroat".

Vlen të theksohet se një numër i konsideruar i njerëzve janë edhe të habitur me mbështetjen që i jep populli dhe shteti, popull dhe shtet mjaft i civilizuar në këtë drejtim, për dallim nga popuj dhe shtet që pengojnë dhe cungojnë arsimimin në gjuhën amtare shqipe. Agjencioni për arsim dhe edukim, ka dhënë mendim pozitiv për kurikulën e lëndës gjuha shqipe dhe kultura sipas "Modelit C" për shkollat e mesme, që nënkupton që sipas kurikulës së përmendur, nga viti shkollor 2016/2017, mësimi i gjuhës shqipe dhe kulturës (Modeli C), mundë të mbahet- zhvillohet për nxënësit e interesuar pranë shkollës tuaj "Vlladimir Nazor". Në kuadër të këtij plan-programi, të miratuar nga Ministria e arsimit të R. së

[155] 16 Tetor 2016 http://shqiptarja.com/mobile/

Kroacisë, sipas Standardeve Shtetërore Pedagogjike të edukimit dhe arsimimit, sipas gazetës Zyrtare (Narodne Novine 63/2008, cl.43, stav 3, alinea 3), nxënësit shqiptar të shkollës së mesme do të njihen krahas lëndëve tjera të përgjithshme shkollore, edhe me lëndët: gjuhë e letërsi amtare-shqipe, histori, gjeografi, art figurativ dhe artin muzikor.

Për seminarin me titull "*Gjuha e pakicat gjuhësore: shqipja dhe arbërishtja*", që u zhvillua në Romë, më 22 shkurt 2016, mund të thuhen vetëm fjalë të mira, si nga pikëpamja e temës së gjetur, ashtu edhe për nga cilësia e panelit të folësve[156], organizuar nga Ambasada pranë njësisë numër një të bashkisë së Romës. Arsyeja e lindjes e konceptimit të kësaj veprimtarie ishte përkujtimi i Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, shpallur nga UNESCO në vitin 1999.

Seminari përfshiu disa ekspertë të temës: ish-ministrin italian të Arsimit, Luigi Berlinguer; profesorin e Pontificia Università Urbaniana, Ardian Ndreca; prof. Domenico Morelli, ish drejtues i ministrisë së Arsimit e veprimtarë i kulturës arbëreshe dhe prof. Edmond Çali, lektor i gjuhës shqipe pranë Universitetit Lindor të Napolit. Krahas tyre, morën fjalën për përshëndetjet institucionale, E Ngarkuara me Punë a.i. Vera Cara dhe përgjegjësi për integracionin e njësisë numër një, Emiliano Monteverde.

Në fjalën e tij, prof. Berlinguer vlerësoi lart kontributin e arbëreshëve, si për ruajtjen e përcjelljen e gjuhës amë ashtu edhe për kontributin e rëndësishëm dhënë Italisë, formimit të shtetit italian, e më parë ndërgjegjësimit për nevojën e ndërtimit të këtij shteti. Prof. Berlinguer njoftoi se pas pak ditësh do të jetë në Kalabri për të takuar kryebashkiakët arbëreshë por edhe mësuesit arbëreshë të shkollave fillore. Angazhimi ka si synim shtrirjen e rrjetit institucional e të shoqërisë civile që nisi të ndërtohet në San Paolo Albanese në muajin tetor të vitit të kaluar. Rrjeti synon përfshirjen e këtyre subjekteve për të promovuar kulturën e përcjellë gjuhën arbëreshe te gjeneratat e reja, ku kjo po trashëgohet me vështirësi, të diktuara edhe nga mungesa e fondeve për mësimdhënien në shkollat përkatëse. Ky fakt u vu në dukje nga fjala e prof. Morelli, i cili theksoi si Ligji 482 i vitit 1999 parashikonte një mbulim financiar domethënës për zbatimin e tij.

Gjatë diskutimit u përmendën edhe shifrat e lidhura me gjeneratat e dyta të shqiptarëve të Italisë, që kanë nevojë për mbështetje për të mësuar gjuhën amë. Janë më shumë se 138 mijë të miturit shqiptarë që jetojnë në Itali (27% e tërë komunitetit), ndër të cilët 108mijë frekuentojnë shkollat italiane. Këto qendra të merren model për ruajtjen e gjuhës së pakicave kombëtare.

Në esencë çdo e drejtë e ka dimensionin kolektiv. Sikurse një njeri e përdorë gjuhën për të komunikuar me të tjerët, të cilët atë gjuhë e njohin, ashtu si shprehje e lirë, bashkimi, shoqërimi etj., nuk mund të paramendohen pa të tjerët. Dhe më në fund, njeriu nuk mund të shijojë në të drejtat individuale, a njëkosisht të jetë anëtar i grupit etnik të shtypur apo të privuar nga të drejtat ligjore, ose të pakicës nacionale të rrezikuar.

Juristi i njohur amerikan, Adis vjen madje deri të përfundimi, *"se mënyra e vetme për t'u kuptuar koncepti i të drejtave të pakicave është që ato të të trajtohen si të drejta të grupit!"*

Përfundime

[156] Shikuar për herë të fundit 27.2.2018www.shqiptariitalise.com

Thelbi i zgjidhjes së drejtë të çështjes së pakicave, qëndron në atë, që kurrkush mos të ndiej presion nga më i madhi dhe më i forti, por çdo popull pavarësisht nga madhësia e tij numerike ta ndiej veten të barabartë dhe të lirë. Sepse, sikurse do të thoshte Gandi: "*qytetërimit tonë do ti gjykohet sipas asaj se çfarë trajtimi u ofronë pakicave".* Vlerë gjuhësore përveç mbrojtjes apo ruajtjes së gjuhëve me ligj kemi edhe hapjen e Instituteve kërkimore-shkencore, përgatitjen e planprogrameve në gjuhën amtare, roli dhe cilësia e mësimdhënies profesionale, strukturimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i projekteve me vlerë kombëtare.Rrezik për gjuhën e pakicave paraqet, pikërisht mosmbrojtja apo ruajtja e gjuhës së pakicave me ligj. Mungesa apo ndalimi i instituteve kërkimore-shkencore, mungesa e planprogrameve dhe mësimdhënia. Emigrimi i qytetarëve rrezikon përdorimin e gjuhës së pakicave. Poashtu zhdukja e njerëzve rrezikon zhdukjen e gjuhës. Pakicat kombëtare pa arsimimin në gjuhën amtare ndeshen me procesin e asimilimit dhe të humbjes të identitetit kombëtar.

Literaturë

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Ligji Nr. 96/2017 Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë
- Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrotjen nga Diskriminimi, Tiranë, 2013
- *Pakicat dhe standardet nderkombëtare*, nga revista Malësia, më 16/ 9/ 2017, nga Nikë Gashaj
- http://www.albanianlanguage.net/
- https://www.evropaelire.org/
- http://www.shqiptariitalise.com/
- http://www.ambasadat.gov.al/italy/sq
- http://shqiptarja.com/mobile/

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

VENDBANIMI DHE ZHVILLIMI KULTUROR,PARA HISTORIK I QYTETIT TE CAKRANIT.

TEUTA SHANAJ.-Mësuese në shkollën: "Liri Gero ", Fier.

Abstrakt

Vjetersia e vendbanimeve dhe vendndodhja e tyre dëshmohet me një varg qendrash të banuara, të njohura që në antikitet, të cilat e vazhdojnë jetën e tyre edhe në mesjetë.Edhe regjistrimet osmane te shek. XV-XVI flasin për një numër të madh fshatrash vendin ku ndodheshin dhe madhesite e përafërta të secilit. Shumica e vendbanimeve gjendeshin në zonat kodrinore, në shpatet e maleve a rrëzë tyre dhe përgjatë luginave të lumenjve. Ka zona në Shqiperi,ku mjaft fshatra janë shtrirë me kohë në dy ose tri nivele banimi, gjithnjë brenda kufijve të fshatit të tyre ose të malit a të vrrinit që u përkiste, p.sh. Bresti i Epërm e Bresti i Poshtëm (Dibër), Domja e malit e Domja e Poshtme (Shëngjergji-Tiranë), Gojani i Epërm e Gojani i Poshtëm (Mirditë), Lufaj i Epërm e Lufaj i Poshtëm (Mat), Preçi i Poshtëm e Preçi i Sipërm (Elbasan), etj.

Në mesjetë këto fshatra kishin vetëm një nivel banimi, që ishte zakonisht atje ku ka pasur një kishë ose atje ku janë ose kanë qenë varret, ose atje ku ka një toponim "katund plak" a "katund i vjetër", etj. Me moshë nga mesjeta e hershme, në mos edhe më përpara, duhen konsideruar fshatrat që mbajnë emrin e një shenjti, si Shëngjergj, Shëmri, Shënjak, Shënkoll, etj., ose thjesht një emër të krishterë, si Damian, Dedaj, Gjonomadh, Kolgecaj, Lekas, Lukan, Lleshan, Marinë, Marjan, Markaj, Martanesh, Matogjini, Mërtin, Mërtur, Nënmavriq, Nikas, Petran, Petrelë, Simon, Sotirë, etj.

Fjalët kyçe: *Zhvillimi kulturor***,** *Cakran, neolit, zbulimet arkeologjike, stacion, studime, vegla, qeramikë, ngjyrë, kulturë, punime, enë, ngjashmëri, karakteristika, objekte.*

***Veshtrimi i Pergjithshem*:** Përveç vendbanimeve të hapura, në mesjetë ka pasur edhe vendbanime të fortifikuara ose kështjella. Sipas arkeologëve të kësaj periudhe, në Shqipëri njihen rreth 70 kështjella që nga mesjeta e hershme deri në pushtimin osman. Ato gjenden kryesisht nëpër luginat e lumenjve kryesorë, si Drini, Shkumbini, Osumi, Devolli, Vjosa etj., dhe lehtësonin lidhjet e viseve të brendshme me vijat e mëdha të komunikacionit, pra edhe lidhjet ekonomike e shoqërore të kohës. Disa prej tyre kanë qenë kështjella të trashëguara nga antikiteti, të ngritura kryesisht në vende kodrinore, në bregdet ose afër tij, me sipërfaqe disi të mëdha, brenda mureve të tyre të trasha. Të tjerat ishin kështjella të

lindura rishtas në afërsi të burimeve të ujit ose buzë lumenjve në pika zotëruese prej ku mund të kontrollohej i gjithë territori.

Rrethi i Fierit, ka qenëi banuar qysh në kohët prehistorike nga popullsia ilire, pasardhësit e pellazgëve. Autorë të vjetër i kanë quajtur pellazgët me origjinë hyjnore, - thotë Homeri, - ose të mbirë nga dheu, ndërsa helenët i quanin të ardhur, - siç thotë Hesiodi. Ata kishin si mbret hyun e njohur, Zeusin, - shkruan Homeri tek " Iiada ".

Materialet arkeologjike të zbuluara në fshatrat e Fierit dëshmojnë se, duke filluar nga vendbanimi i kohës së gurit të ri (neoliti) të zbuluar në Cakran, deri te monumentet e mesjetës, treva e Mallakastrës dhe e Myzeqesë, ka qenë e populluar intensivisht. Gjetjet arkeologjike krijojnë njëdiapazon të gjerë si në kohë dhe në hapësirë, duke e bërë rrethin e Fierit një nga zonat më të pasura në vendin tonë.

Ndër vendbanimet e lashta që janë zbuluar nga zbulimet arkeologjike është vendbanimi i neolitit të Cakraniti i cili, në bazë të studimeve krahasuese dhe analizave të thella tipologjike, dëshmon se ka patur një zhvillim ekonomik e kulturor, që i përgjigjej rendit shoqëror të bashkësisë primitive që sundonte në atë kohë.

Fjalët kyçe: Cakran, neolit, zbulimet arkeologjike, stacion, studime, vegla, qeramikë, ngjyrë, kulturë, punime, enë, ngjashmëri, karakteristika, objekte.

Kultura vendore dhe zhvillimi historik i saj

Mesjeta ishte një periudhë shumë e turbullt në Ballkan e në Evropë, me luftëra dhe me grindje të shumta midis zotërve feudalë, që kërkonin të zgjeronin zotërimet e tyre, me dyndje popujsh të ardhur nga larg, me lëvizjet e kryqtarëve, që përshkuan territorin e vendit, të nisur nga disa drejtime, për të shkuar në vendet e shenjta ose në Kostandinopojë. Pra jeta ishte e pasigurt dhe njerëzit parapëlqenin të banonin brenda mureve të kështjellave, megjithëse në kushte jo fort të përshtatshme. Në trojet brenda kështjellave ka pasur edhe shumë ndërtesa banimi, me mure të ndërtuara me gurë mesatarë, të mbuluara me tjegulla ose me lëndë druri. Rrënojat e Shurdhahut (shek. XII-XIV) tregojnë se ato ishin shtëpi me dy ose me më shumë të ndara. Për shkak të sipërfaqes së kufizuar që ndodhej brenda mureve rrethues të kështjellave, njerëzit banonin të ngjeshur në një hapësirë të vogël. Shtëpitë ishin të vogla, të ulëta, të errëta e me lagështi, ku duhej shfrytëzuar mirë çdo pëllëmbë e sipërfaqes. Rrugët ishin të ngushta e dredhuese, që dukeshin edhe më të ngushta, kur katet e sipërme dilnin mbi rrugë pak përtej mureve, për të shtuar sipërfaqen e banimit, duke penguar ajrosjen e mirë të rrugëve. E kështu jeta rridhte brenda një horizonti të ngushtë për sa kohë banorët detyroheshin të qëndronin në kështjellë, ngaqë nuk ishin të sigurt jashtë saj. Dendësia e popullsisë, lagështia por edhe vështirësia për të mbajtur pastërti, krijonin kushte të dëmshme për shëndetin ; epidemitë e shpeshta e rëndonin edhe më tej gjendjen. Përmirësimi erdhi me ndërtimin e lagjeve të banuara jashtë mureve të kështjellave.Shtëpitë e fisnikëve dalloheshin nga përmasat e mëdha, nga cilësia e materialit të përdorur e nga mjeshtëria e ndërtimit, si dhe nga pajisjet luksoze të tyre. Kështjellat monumentale dhe kishat e hijshme që u ngritën me shpenzimet e fisnikëve shqiptarë dhe që kanë arritur deri në ditët tona, dëshmojnë për mundësitë materiale të fisnikëve shqiptarë gjatë shekujve të mesjetës për të pasur kushte jetese sa më optimale.

Guri i latuar dhe druri i gdhendur kanë qenë materialet kryesore që hijeshonin pamjen e jashtme e të brendshme të banesave të familjeve fisnike, krahas përdorimit të tullës së pjekur si dhe të tjegullës si mbulojë për çatitë. Banesa, oborri, magazinat dhe stallat e kafshëve (që ngriheshin larg banesës), madje edhe kopshti bashkë me gropën e gëlqeres, zakonisht ishin të qarkuara me një mur të përbashkët e të

lartë guri. Kur burimet e ujit të pijshëm ishin larg vendbanimeve, në oborrin e banesës hapej një pus. Paretet e tij visheshin me gurë cilësorë dhe puset lartësoheshin nga niveli i tokës me një grykë guri, që mbulohej me kapakë druri. Në mjediset e banesës ose në oborrin e saj ishte edhe furra familjare për pjekjen e bukës, të mishrave etj. Në oborrin e banesës kultivoheshin trëndafila dhe lule të tjera.

Muret e brendshme të banesës ishin të suvatuara. Krahas lyerjes së shpeshtë të tyre me gëlqere, që përdorej gjerësisht edhe si material kryesor dezinfektimi, muret e dhomave të veçanta ishin të zbukuruara me afreske dhe ishin të pajisura me vatra të mëdha me oxhakë shumë të gjerë, të ngjashëm me ato që shihen në kuzhinat e manastireve të vjetra të vendit tonë. Natën ato ndriçoheshin me qirinj dylli, të vendosur në shandanë argjendi, me dy, tri ose me më shumë llambadha. Shandanët ishin të zbukuruar me gdhendje artistike.

Kultura e Cakranit, që ka ngjashmëri e lidhje me grupet kulturore Brenda vendit, sidomos me atë të zonës së Korçës, dëshmon se treva që shtrihej nga pjesa bregdetare e Adriatikut e deri në Lindje " krahina e Korçës ", banohej nga një popullsi me kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë.Enjëjta popullsi me një ekonomi e kulturë unikeduhet të ketë përfshirë edhe treva të tjëra të vendit tonë.Lidhje dhe afërsi, kultura e Cakranit, ka pasur edhe me grupet jashtë vendit si me ato të Greqisë, Italisë, Dalmacisë, Bosnjës etj.

Sipas objekteve të gjetura, dëshmohet se edhe lidhjet ekonomike me botën e jashtme në stacionin neolitik të Cakranit nuk kanë munguar. Këto dhënie e marrje me botën e jashtme tregojnë se banorët e këtij stacioni nuk kanë qëndruar të mbyllur në vetvete. Siç e vërtetojnë zbulimet arkeologjike për këtë zonë, jeta njerëzore në rrethin e Fierit ka filluar qysh nga periudha prehistorike e neolitit.

Një vështrim i përgjithshëm prehistorik mbi vendbanimin antik të Cakranit.

Stacioni neolitik I Cakranit ndoshet në vendin e quajtur Thikëzë. Qysh në kohët prehistorike, Cakrani ka qenë krahinë e përshtatshme për banim; falë kushteve të përshtatshme gjeografike e klimatike, të cilat kanë qenë të përshtatshme për zhvillimin ekonomik e kulturor. Banesat fshatare ndërtoheshin me gurë të lidhur ose jo me llaç dhe nuk kishin dritare por vetëm frëngji. Në shtëpitë përdhese dyshemeja përbëhej nga trualli i ngjeshur mirë ; ato nuk kishin ende tavanë dhe mbuloheshin ose me tjegulla, ose me rrasa guri ose me fluga pishe, atje ku kishte lëndë të mjaftueshme drusore. Shumica e fshatrave ishin të ndërtuara në terren të thyer, kështu që pjesa përdhese përdorej për kafshë dhe në katin e sipërm banonte familja. Muret ishin të pasuvatuara, dritaret të ngushta si frëngji nga jashtë, por të gjera nga brenda. Në mure nuk kishte dollapë me flegra, por kishte kamare si në antikitet (p.sh. në Kamenicë). Vatra e zjarrit nuk ishte krejt në mes, por disi më pranë njërit mur. Banesa e vjetër e Tiranës, në format e saj më fshatarake, duket se ruante mjaft tipare nga banesa mesjetare.

Në banesat e zakonshme tymtarët ishin të rrallë, por ata nuk mungonin në banesat e zotërve feudalë, madje atje edhe vatrat ishin të mëdha e me oxhakë shumë të gjerë. Në të dyja anët e vatrës kishte, përveç shkambeve të thjeshtë, karrige ose frona druri, me forma mjaft të zhvilluara, me mbështetëse për shpinën e për parakrahët. Format e tyre shihen në disa skena afreskesh dhe si një fazë e thjeshtuar e tyre mund të konsiderohen disa nga format më origjinale të karrigeve prej druri të përdorura në rrethet Pukë, Mirditë etj. deri në shek. XIX. Në përdorim të fisnikëve të kohës përmenden edhe frona ose poltrona të dërguar nga Venediku. Dhe kështu Noli, jo rastësisht thotë për Vojsavë Kastriotin : "rrinte pranë zjarrit mbi një poltron venecian..." (në prozën e shkurtër "Kthimi i Skënderbeut në Krujë"). Edhe bujari Gjon Muzaka, në kujtimet e tij, përmend "një poltronë despotale", të zbukuruar me një stem gurësh të çmuar të Andre Muzakës, rreth vitit 1372. Shembuj të tjerë luksozë të këtyre poltronave janë fronat e

dhespotëve në disa nga kishat ortodokse të vendit, në të cilat shumë pajisje janë ruajtur me konservatorizëm të madh.

Fusha e Cakranit e rrethuar në Lindje e Veri me kodra dhe në Jugperëndim me bregore (ajo e Selishtës dhe e Gjonçës pranë të cilave kalon lumi Vjosa), plotësonte kushtet material e kulturore të popullsisë së atëhershme.Orendi të përhershme ishin arkat ose sëndyqet e vogla prej druri për sendet e imta e të mëdha dhe për rrobat e trupit. Ato punoheshin prej zdrukthtarëve dhe marangozëve vendës, por, për bujarinë e lartë, silleshin edhe nga jashtë, sidomos nga Venediku. Arkat e punuara më mirë ishin arkat e pajës. Në zonat me pyje shumë, kishte fshatarë vendës që i punonin vetë orenditë shtëpiake prej druri, duke përdorur teknika tradicionale, pa përdorur gozhda metalike. Ndër këto orendi mund të përmenden fronat e gjatë e të thjeshtë pa mbështetëse, tryezat masive me dhoga të trasha, govata e magje, shtretër etj.

Për t'u çlodhur, malësori mund të ulej thjesht mbi një postiqe pranë zjarrit, kurse banori i fushës, për një pushim të shkurtër ulej gjysmë i shtrirë mbi një rrogoz, shtruar në një qoshe të freskët brenda shtëpisë ose në hije në oborr. Sidoqoftë, përsa u përket pajisjeve të fjetjes, në dokumente, sidomos në testamente, përmenden shtretërit prej druri, e në disa raste ata shihen edhe në skena ikonash. Krerët e shtretërve mund të ishin të zbukuruar edhe me gdhendje të thjeshta. Pajisjet e tjera të fjetjes ishin dyshekët ose më mirë shtresat dhe jastëkët a përkresat, që bëheshin me pëlhurë liri ose leshi, në formën e një këllëfi që mbushej me lesh ose kashtë. Për fisnikërinë e lartë dyshekët, sidomos jastëkët, duket se ishin të mbushur me pupla

Kodrat rrethuese dhe një pjesë e fushës kanë qenë të mbuluara me pyje të dendura, të pasura me lloje të ndryshme drurësh dhe kafshësh të egra. Në popullimin e hershëm të kësaj zone ka ndikuar ndjeshëm klima e butë dhe me shira, ecila favorizonte zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë.Në Cakran janë zbuluar materiale të shumta në numër e në lloj qëi përkasin periudhave të ndryshme, duke filluar nga neoliti e duke vazhduar deri në mesjetë, përfshirë këtu dhe objekte të kulturës helenistike.Krahina e Cakranit ka qenë intensivisht e populluar dhe e banuar nga popullsi prej së cilës, më vonë, aludohet të jetë formuar popullli i stërlashtë, pellazgët, pasardhësit e të cilëve qenë ilirët – stërgjyshërit e shqiptarëve që banojnë sot. Materialet arkeologjike të zbuluara
në Cakran i përkasin kulturës së periudhës së neolitit të mesëm, që nuk njihej më parë në vendin tonë dhe, si e tillë formon një kulturë më vete qëështë quajtur me të drejtë kultura e Cakranit.

Materialet arkeologjike të zbuluara në stacionin neolitk të Cakranit janë të shumta e të larmishme, të tilla si: veglat e punës prej guri, kocka e briri, punimet e qeramikës dhe poçerisë, si edhe banesat e ndërtuara sipas arkitektonikës së neolitit.Objektet e qeramikës, poçerisë, si edhe enët e kultit të gjetura me shumicë, për nga forma, teknika e punimit dhe nga motivet e zhvillimet e tyre kanë ngjashmëri dhe pika kontakti me materialet kulturore të zbuluara në stacionet neolitike brenda dhe jashtë vendit.Ky stacion ka pasur lidhje shkëmbimi edhe me botën e jashtme, për të cilën dëshmojnë objektet e importuara të qeramikës.

Shkëmbimetdhe monumentet e lashta kulturore

Shumica e veglave të gjetura janë të përgatitura prej stralli. Për këtë dëshmojnë gjetjet me shumicë të ashklave të strallit (veçori kjo për periudhën e neolitit). Për punimin e tyre ka pasur punishte të posaçme

të ngritura pranë banesave.Numri i vogël dhe lloji i kufizuar i veglave të përgatitura nga kocka e brirë, dëshmon se ato janë përdorur rrallë si lëndë e parë për bërjen e veglave të punës.

Tipar dallues i kulturës neolitike të Cakranit është edhe punimi dhe përdorimi në shkallë të gjerë qeramikës dhe i poçerisë. E gjithë qeramika është e punuar me dorë me njëcilësi më të mirë se qeramika e punuar trashë, e cila është e pranishme në këtë vend. Krahas qeramikës së neolitit të mesëm, në stacionin e Cakranit janë zbuluar objekte qeramike që i përkasin neolitit të hershëm. Punimet me qeramikë të neolitit të mesëm për nga forma, teknika e punimit, materialet dhe zbukurimet me ngjyra, si edhe nga funksionet e përdorimit të enëve prej banorëve qëndrojnë cilësisht më lart se objektet e qeramikës së neolitit të hershëm. Krahas formës dhe teknikës së punimit, objektet e qeramikës të zbuluara në Cakran janë zbukuruar me motive e ngjyra të shumëllojshme, gjë që dëshmon se banorët kanë pasur një botë të pasur kulturore e shpirtërore.

Objektet dhe sidomos fragmented e shumëllojshme të qeramikës e të poçerive të gjetura në stacionin neolitik të Cakranit kanë ngjashmëri dhe karakteristika të përbashkëta me me punimet qeramike të zbukurauara në stacionet neolitike brenda vendit. Në këtë stacion janë gjetura më shumicë fragmente enësh kuzhine, si: kupa, tasa,pjata, enë të mëdha etj. Të cilat për nga forma dhe punimi teknik, zgjedhja e lëndës së parë, dheut për përgatitjen e tyre etj. ngjajnë dhe kanë karakteristika të përbashkëta me enët e zbuluara në stacionin e Maliqit.Punimet e qeramikës dhe të poçerisë së kulturës neolitike të stacionit të Cakranit, që përbëjnë enët e ndryshme shtëpiake dhe objektet e kultit, kanë ngjashmëri e lidhje me kulturat neolitike të Greqisë Qëndrore e Jugore, me ato të neolitit të mesëm të Italisë të zbuluara në pjesën Jugore të saj: analogji, afërsi dhe paralelizma takohen edhe me kulturat neolitike të Dalmacisë dhe Bosnjës.

Njëaspekt tjetër ku objektet e qearmikës së kulturës së Cakranit ngjajnë dhe kanë pika të përbashkëta me grupët kulturore jashtë vendit janë zbukurimet, ornamentet, motivet dhe ngjyrat. Zbukurimet me gërvishtje të enëve tëkuzhinës apo objekte të tjera të kulturës së Cakranit kanë ngjashmëri me objektet e grupit kulturor të Bosnjës, Dalmacisë dhe Greqisë. Zbukurimi me incizim e ngulitje është karakteristike për kulturën e Cakranit. Motivi është kryer me kujdes e mjeshtëri, zbukurimi dallohet për një kompozicion të goditur, në të cilin është përdorur boja e bardhë që ruhet shumë mirë dhe sot në shumë fragmente. Enët e kuzhinës, sidomos fragmentet e tyre, të cilat janë të shumta dhe kanë pika takimi me grupet kulturore të vendeve fqinje.

Kupat në variantet e tyre të shumta si nga forma dhe teknika e punimit, kanë ngjashmëri me grupin kulturor tëzonës së Adriatikut, Egjeut, Dalmacisë, Italisë, Greqisë së Mesme e Jugore.Kupat konike me profil S-je si nga forma, ashtu edhe nga madhësia janë identike me ato të zbuluara në grupin kulturor të Dalmacisë. Po kështu edhe variant tjetër I kupave me segment ku ngjajnë me ato të grupit kulturor të Adriatikut në Itali, si dhe me qeramikën e Korintit në Greqi. Enët e tjera: tase, pjatat dhe enët e mëdha, nga ana tipologjike kanë ngjashmëri me ato të grupit kulturor të neolitit të mesëm të Dalmacisë e të Greqisë.

Enët me këmbë të larta, që janë të njëjta me ato të zbuluara në vendet fqinje, I përbëjnë frutierat, kupat dhe gotat të zbuluara në vendin tonë. Thellësia e rombeve që zbukurojnë sipërfaqen e enëve janë të mbushura me bojë të kuqe, e cila, siç dëshmojnë gjurmët e saj, ruhet ende. Ndërtimi I banesave nga ana arkitektonike është bërë më dy faza. Faza më e hershme është ajo kur banesa futej e gjitha në dhe`, ndërsa çatia dilte mbi sipërfaqe. Më vonë, për shkak të rritjes së depozitimit të dheut, është ngritur niveli i gropës. Në këtë fazë, banorët kanë qenë të detyruar që banesat t'i ndërtojnë pjesërisht të futura në tokë e pjesërisht mbi sipërfaqe. Dyshemetë kanë qenë të shtruara me

baltë. Shpërndarja ka qenë në distanca të caktuara nga njëra-tjetra me një oborr nëmes. Ushqimi e rregullat e të ngrënit njihen më mirë, sepse shumë artikuj ushqimorë shfaqen në mallrat tregtare të kohës. Për pjesën më të madhe të vendit, artikulli kryesor ishte buka prej gruri, sidomos në zonat ku toka punohej mirë, siç ishte rrethi i Tiranës, por edhe pllajat e kultivuara me grurë, thekër, mel etj. Drithi, si artikull i rëndësishëm eksporti, duket se i plotësonte mirë kërkesat e kultivuesve, por padyshim, kishte edhe zona në luginat e thella ku nuk mjaftonte gruri dhe kështu hahej edhe meli, megjithëse prej tij dilte një bukë shumë e qullët. Në disa dokumente, krahas artikujve të tjerë për eksport, përmendet edhe buka. Këtu është fjala për bukë të thekur (peksimadhe), artikull shumë i nevojshëm për detarët sa kohë ishin në lundrim, sepse i qëndronte më mirë lagështirës, dhe ky ishte një zakon i përhapur gjithandej në brigjet e Mesdheut.

Drithi bluhej në mullinj, që punonin tashmë me forcën e ujit, megjithatë mokrat prej guri vazhduan të bëjnë pjesë në orenditë shtëpiake, duke bluar në to edhe grurin për trahan etj. Të tjera orendi për të grimcuar ose shtypur sende ushqimore ishin shtypësat e ndryshëm prej druri ose prej guri. Gruri i bluar trashë e i zier është padyshim një nga gatimet e hershme, që i paraprin bukës. Me kohë ai mbeti në përdorim jo si ushqim i përditshëm, por si ushqim ritual për të kremtet e motmotit e sidomos për rastet e përkujtimit të të vdekurve. Krahas bukës e gatimeve të tjera me bazë mielli (si qulli, mëmëliga, përsheshi, pitet, petullat, etj.) në shekujt e mesjetës vinte përdorimi i bulmetit dhe i yndyrave. Në dokumentacionin e kohës, krahas djathit përmendet në eksportet edhe qumështi. Në gjellëtarinë e kohës është i pranishëm shpesh vaji i ullirit e kokrrat e tij, artikuj ushqimorë tipikë mesjetarë por që njiheshin që në antikitet. Mullinj vaji kishte tashmë jo vetëm pranë banesave të zotërve feudalë, por edhe pranë manastireve që kishin ullishte.

Mishi konsumohej më shumë në dimër se në verë. Në qytet ai konsumohej veçanërisht në tryezat e fisnikëve e të kështjellarëve të kohës. Baza ishte mishi i pjekur, për të ftuarit më të nderuar edhe mish shpendësh e zogjsh gjahu. Përdorej shumë edhe vera. Në kushtet e kohës mishi ose konsumohej pas therjes ose ruhej i kripur shumë, prandaj para gatimit duhej lënë në ujë që t'i dilte kripa. Edhe peshku konsumohej mjaft sidomos në qytetet e bregdetit, i freskët ose i tharë. Në dokumente të kohës përmenden ngjalat, krapi e putargat e Shkodrës por dëshmon edhe ekzistenca e dajlaneve, përveç mënyrave të tjera të peshkimit. Pak a shumë këto ishin ushqimet që konsumoheshin edhe në tavernat e qyteteve kryesore, si Durrësi, Vlora, Shkodra. Llojet më të përdorura të perimeve ishin qepët, preshët, hudhrat, specat djegës, të freskëta dhe të regjura (turshi). Gjithashtu gjerësisht përdoreshin fruta të freskëta, të thata dhe shurupe, si kumbullat, mollët, dardhat, qershitë, fiqtë etj. Në gjellët e ndryshme të kësaj kohe përdorej shumë edhe uthulla, për të shtuar shijen, gjë që vazhdon edhe në shekujt e mëvonshëm.

Në stacionin neolitik të Cakranit stolitë, si objekte zbukurimi, janë të pakta. Ato janë të punuara me kockë, guaskë dhe gurë. Punimet janë bërë me kujdes, cilësi të lartë dhe të lëmuara mirë, gjë që u jep objekteve bukuri të veçantë.

Së fundi, mund të kujtojmë se nga shek. XV deri në shek. XVIII, në shtresa të ndryshme të shoqërisë është mbajtur një lloj kapele mjaft e lartë dhe me strehë rreth e qark, që cilësohet në Francë si kapelë shqiptare ("chapeau albanois" ose thjesht "albanois", nga F. Rabelais).

Krahas rrobaqepësve e gëzoftarëve, si zeje më vete, përmenden në qytetet e Shqipërisë edhe këpucarët, çizmarët e papuçinjtë. Deri nga fundi i shek. XV veshja e fisnikëve vazhdoi të zhvillohet jo vetëm nën ndikimin e qytetërimit bizantin, por edhe nën ndikimin perëndimor, që hynte te ne kryesisht nëpërmjet

marrëdhënieve me qytetet më të zhvilluara italiane të kohës. Këtu nuk duhet harruar se shumë nga familjet bujare të kohës, si Balshajt, Topiajt, Dukagjinët, Gropajt, Muzakët, Zahariajt, Arianitët, Kastriotët, Jonimajt etj. ishin të përzier midis tyre me lidhje të shumëfishta gjaku e krushqie. Madje disa prej tyre kishin të tilla lidhje edhe me dinastitë e mëdha të kohës si paleologët, asienët, anzhuinët, si edhe me aristokracinë kroate, serbe e boshnjake, pra e mbanin veten të barabartë me ta, madje edhe me fisnikët e Italisë së Jugut.

Këto familje fisnikësh kishin secila oborrin e vet, ku vinin rrotull një varg zotërinjsh e fisnikësh, kancelarësh, qefalinjsh e vojvodësh të rangjeve të ndryshme, si edhe një mori kalorësish, kasnecësh e shërbëtorësh, si edhe të ftuar të shumtë.

Kjo fisnikëri nga kontaktet me fisnikët e Perëndimit, synonte të jetonte e të zbavitej si ata. "Për një kohë shumë të gjatë, - thotë Shuflai, - fisnikët dhe zotërinjtë e hinterlandit, kishin zakon të shkonin në Durrës shumë herë në vit, për punët e veta dhe për dëfrim ("pro suis factis, vel pro placere"). Në një marrëveshje midis anzhuinëve dhe despotit shqiptar Andre Muzaka, në vitin 1336, u jepej liri anëtarëve të kësaj familjeje që të vinin në Durrës sa herë dëshironin dhe ata mbetën, deri në shpërnguljen e tyre në Itali më 1476, në raporte miqësore me familjet fisnike të Durrësit. Këto lidhje miqësie, që favorizonin shtrirjen e modës veneciane në gjithë mënyrën e jetesës, duket se vazhduan edhe në shek. XVI.

Nën ndikimin perëndimor, sidomos të anzhuinëve, fisnikët e vendit tonë fillojnë të përdorin edhe stemat e vulat, duke zgjedhur secili shenja e simbole të veçanta. Stema e gdhendur në gur vendosej, zakonisht, në hyrjen kryesore të kështjellës. U bë zakon gjithashtu që familjet fisnike të hartonin edhe gjenealogjitë e tyre, më fort për të konsakruar prejardhjen e tyre, por edhe për t'u treguar pinjollëve pasardhës ku shtriheshin pronat e zotërimet e tyre.

Një shembull i mirë për këtë është Gjon Muzaka, i cili në vitin 1510 hartoi gjenealogjinë e familjes së vet, duke na dhënë kështu një dokument shumë të vlefshëm për kohën. Gjithashtu, qëndresa e ngjyrave ndaj agjentëve atmosferikë deri në ditët tona, tregon se këta banorë kanë qenë mjeshtër të aftë dhe unik për përgatitjen teknologjke të bojërave. Këta banorë, krahas mjeshtërisë teknologjike, kanë ditur të zgjedhin nga mjedisi lëndën e parë për gatimin e kombinimin e bojërave.

Perfundimet:

Zhvillimi ekonomiko-shoqëror e politik që karakterizon shek. XII-XIV krijoi kushte për përdorimin më të gjerë të shkrimit. Konsolidimi i formacioneve shtetërore vendase shtruan nevojën e redaktimit të akteve me karakter juridik e politik. Kësaj nevoje i shërbenin tani jo më rastësisht njerëz të ditur si klerikë e murgj të manastireve, por profesionistë të specializuar. Këta formonin kancelaritë pranë oborreve feudale dhe në qytetet kryesore të vendit. Rrethi i njerëzve të kulturës u shtua edhe me banorë të komunave qytetare. Në shek. XIV e në fillim të shek. XV numri i intelektualëve klerikë shqiptarë me origjinë qytetare ishte mjaft i madh; ata gjenden të përhapur edhe jashtë Shqipërisë, në shumë qytete dalmatine ku kryenin funksione kancelarësh, mësuesish, famulltarësh etj.

Nuk munguan edhe vepra të shkëputura deri-diku nga përmbajtja kishtare. Të tilla janë, p.sh., kronika e peshkopit Mihail nga Devolli (shek. XI-XII), e cila trajton ngjarje të luftës së bizantinëve kundër mbretërisë bullgare në Maqedoni e pjesërisht në tokat shqiptare, letërkëmbimi i peshkopit Teofilakt të Ohrit, me disa të dhëna interesante mbi jetën e banorëve të peshkopatës së tij në fillim të shek. XII, disa jetëshkrime shenjtorësh që zhvilluan veprimtarinë e tyre edhe në tokat shqiptare, si ato të Klementit e Naumit hartuar në shek. XIII etj.

Ndryshe nga këto vepra të shkruara greqisht, është shkruar latinisht kronika e një prifti nga Dioklea, e cila përshkruan ngjarjet që u zhvilluan në Shqipërinë e Epërme në kapërcim të shek. X-XI. Në territor të banuar prej shqiptarësh në Epir, janë hartuar në fund të shek. XIV e në fillim të shek. XV dy kronika greke që japin të dhëna me interes për historinë e Principatës shqiptare të Artës. Shënime historike për shek. XIV gjenden edhe në disa nga dorëshkrimet e Beratit.

Megjithëse nuk shkëputen nga fryma teologjike, këto prodhime përbëjnë hapat e para të historiografisë në vendin tonë, sepse një pjesë e këtyre është hartuar pa dyshim nga autorë vendas dhe i përket historisë së tokave shqiptare. Shkëputjen nga ndikimi kishtar dhe kalimi në historiografinë laike, këtë hap në historinë e kulturës shqiptare, e bënë humanistët shqiptarë në fund të shek. XV e në fillim të shek. XVI, por tanimë në kushtet e pushtimit osman të vendit, jashtë Shqipërisë

1) Sipas përcaktimit që kanë bërë arkeologët, rëndësia e kësaj kulture qëndron në faktin se:
   1- Në vendbanim u vërtetua plotësisht ekzistenca e një grupi të ri kulturor për të cilin më parë nuk ka pasur asnjë të dhënë materiale.
   2- Ky grup kulturor përbën një pikë të rëndësishme ndërlidhjeje midis grupeve neolitike veriore e jugore të kompleksit Adriatik-Egjean.
   3- Studimi dhe analizat e hollësishme të grupit kulturor neolitik të Cakranit krijojnë mundësinë për formimin e një ideje të saktë mbi jetën kulturore dhe ekonomike të shoqërisë së atëhershme (Neolitit të mesëm) në vendin tonë.

REFERENCAT

“ Fieri Almanak 1976 .”-Rregjistri kadastror i qytetit të Fierit.

Muzeu i Fierit.-“ Pronësia feudale në tokat shqiptare ” Selami Pulaha.

“ Renta feudale dhe evoluimi i saj në viset shqiptare ” Petrika Thengjilli.

Mayo, Elton. *The Human Problems of an Industrial Civilization*. Boston: Harvard Business School, 1946. McGregor, Douglas. *The Human Side of Enterprise*. New York: McGraw-Hill, 1960. Taylor, F.W. *The Principles of Scientific Management*. New York: Harper’s, 1912, and many editions since. Wiener, Norbert. *The Human Use of Human Beings*. Boston: Houghton Mifflin, 1950. Woodward, Joan. *Industrial Organization; Theory and Practice*. Oxford University Press, 1965.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

SFIDAT E EDUKATOREVE NË NGRITJEN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL NË KOSOVË

Mevlude Aliu-Gashi, -Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Bazuar në rëndësinë që ka edukimi në fëmijërinë e hershme dhe në gjendjen aktuale, në të cilën ndodhet ky nivel i edukimit në Kosovë, është e domosdoshme që edukimi parashkollor të ketë një vend meritor në sistemin tonë të arsimit. Nevojat për institucione parashkollore janë të mëdha, ndërsa mundësitë për të përfshirë më shumë fëmijë në institucione parashkollore publike janë të vogla.
Edukatoret që realizojnë punën me fëmijët e grup-moshave nga 0-6vjeç, duhet të kenë përgatitje adekuate dhe të kenë përkushtim për punën me fëmijët edhe pse shpesh gjatë punës së tyre shfaqen sfida dhe pengesa të ndryshme.
Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë vështirësitë që kanë hasur edukatoret në zhvillimin e tyre profesional dhe mundësitë që u janë ofruar për zhvillimin e tyre, si me rikualifikim në programet e akredituara pa shkëputje nga puna, poashtu edhe përmes trajnimeve, për ngritjen e cilësisë në punën e tyre.
Hulumtimi është vlerësues dhe karakterizohet nga qasja kuantitative dhe kualitative. Është realizuar në 5 komuna. Respondentët pjesëmarrës në hulumtim ishin 53 edukatore të institucioneve parashkollore publike.
Rezultatet tregojnë se qëndron hipoteza ,,Edukatoret kanë kaluar me sukses sfidat gjatë ngritjes dhe zhvillimit profesional të tyre", ku sipas rezultateve 70% e edukatoreve kanë kaluar sfida, gjatë rikualifikimit i tyre duke qenë njëkohësisht në punë dhe duke vazhduar studimet dhe se 66% janë të kënaqur me punën e tyre. Ka edhe sfida tjera që edukatoret kalojnë për t'u zhvilluar profesionalisht dhe në realizim të punës së tyre, siç janë ofrimi i trajnimeve të shpeshta pa i vlerësuar nevojat e secilës edukatore, nevojat për trajnime specifike, numri i madh i fëmijëve në grupe, ndryshimi i shpeshtë i dokumenteve zyrtare, etj.

Ekzistojnë programet në Fakultetin e Edukimit që përgatisin edukatore për të punuar me fëmijë të grupmoshave 0-3 vjeç dhe edukatore për të punuar me grup-moshat 3-6vjeç. Për edukatoret që kanë qenë në shërbim dhe që kualifikimi i tyre ishte Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare, u është mundësuar të ndjekin edhe dy vite programin pa shkëputje nga puna, për t'u rikualifikuar. Gjatë një rrugëtimi në karrierë, për të realizuar punën e tyre, edukatoret kanë kaluar vështirësi të ndryshme edhe pse u është ofruar mundësia të kualifikohen dhe të zhvillohen profesionalisht. Poashtu, edhe tani po kalojnë sfida profesionale, organizative e teknike në punën e tyre.

Fjalë kyçe: Edukatore, edukim, institucion, fëmijë, parashkollor.

SHKURTESAT

ISCED (SNKA) - Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit

KShLM - Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve

MAShT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

PSAK - Plani Strategjik për Arsim në Kosovë

QBK – Qendrat me Bazë në Komunitet

SMIA - Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim

UA – Udhëzim Administrativ

Përkufizimi i termave kryesorë:

Edukimi parashkollor -i referohet edukimit të hershëm nga edukatorët e njohur për fëmijët e moshës parashkollore.

Edukatore – Punonjëse në kopshtet e fëmijëve, që merret me edukimin e parashkollorëve, punonjëse e arsimit parashkollor.

Institucione parashkollore - mund të definohen objektet apo shtëpitë e konventuara të cilat janë të ndërtuara në mënyrë speciale për të ofruar programe parashkollore dhe të cilat plotësojnë nevojat edukative dhe zhvillojnë nevojat e fëmijëve deri në regjistrimin e tyre në shkollë fillore. Këto institucione ofrojnë shërbime të cilat janë me orar të plotë, gjysmë orari dhe mund të zgjatet orari edhe gjatë shërbimit të mbrëmjes.

Institucione tjera parashkollore- këtu hyjnë të gjitha institucionet tjera parashkollore, pos atyre publike d.m.th institucionet parashkollore private, Qendrat me Bazë në Komunitet - QBK,etj. ***Kualifikim*** - njohje zyrtare e të arriturave të shkollimit apo të aftësimit ose suksesi i kënaqshëm në test apo në provim.

Akreditim- procesi përmes të cilit Autoriteti Shtetëror i Kualifikimeve (ASHK), në bazë të ligjit në fuqi, përcakton, monitoron dhe auditon institucionet (organet vlerësuese), të cilat i vlerësojnë kandidatët dhe lëshojnë certifikata e diploma, si dhe çdo organ tjetër që kryen funksione në emër të ASHK-së.

Hyrje

Edukimit parashkollor në Kosovë për vite me radhë, nuk i është kushtuar rëndësi e madhe, as nga niveli qendror as nga niveli lokal. Rëndësia e edukimit në fëmijërinë e hershme është e padiskutueshme, prandaj, edhe përgatitja profesionale e edukatoreve që punojnë me fëmijë, ka rëndësi të veçantë në qasjen e tyre ndaj fëmijëve, e poashtu edhe zhvillimi profesional i tyre, përmes trajnimeve të ndryshme që i freskojnë njohuritë teorike dhe anën praktike të edukatoreve me fëmijë.

Funksionimi i edukimit parashkollor në Kosovë, është i rregulluar me Ligjin për Edukim Parashkollor, si dhe Udhëzimet Adminsitrative. Sa i përket përgatitjes profesionale të edukatoreve, ekziston Udhëzimi Administrativ Nr.06/2016-Për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, sipas të cilit janë të përcaktuara kriteret që duhet t'i plotësojnë edukatoret për të punuar me fëmijët e moshës 0-3 vjeç dhe poashtu cilat kritere edukatoret që punojnë me fëmijët e moshës 3-6vjeç.

Duke e parë rëndësinë e kualifikimit dhe zhvillimit profesional të edukatoreve, Fakulteti i Edukimit, në vitin 2004, hapet Drejtimi për Parashkollor, që zgjatë 4 vite studime, e që edukatoret për të punuar me fëmijët e moshës 3-6 vjeç duhet të përfundojnë këtë fakultet. Ndërsa, për edukatoret që ishin në proces dhe punonin me përgatitje profesionale 2 vjeçare, iu dha mundësia që nga viti 2010 të ndjekin programin e akredituar nga MASHT, për studime 2 vjeçare, pa shkëputje nga puna. Kështu, edukatoret gjeneratë pas gjenerate, përfunduan këtë program dhe tani janë me përgatitje profesionale 4 vjeçare.

Trajnimet e realizuara për edukatoret kanë rëndësi të madhe në procesin e realizimit të edukimit në fëmijërinë hershme. Ky proces i kalimit të edukatoreve në përgatitje profesionale përmes studimeve dhe përmes trajnimeve ka qenë një sfidë e edukatoreve për t'u tejkaluar dhe shpesh e paraqitur si shumë e vështirë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka hartuar dokumente zyrtare e profesionale për zbatim në institucione parashkollore në Kosovë dhe për disa nga edukatoret, përdorimi i këtyre dokumenteve në praktikë, ishte një risi dhe ishte sfidë, si në planifikimin e punës, poashtu edhe në punën me fëmijë. Me mbështetjen që iu ofrohet edukatoreve me trajnime, me materiale, me mentorime dhe monitorime, këto sfida po tejkalohen dhe po arrihen rezultatet në punën e tyre me fëmijë, duke përgatitur fëmijët për shkollë dhe për jetë.

Qasja teorike

Idetë për organizimin e sistemit të edukimit janë shfaqur që moti dhe në mënyrë të sistemuar e kanë paraqitur filozofët e vjetër. Në veprimtarinë e tyre këta mendimtar e kanë shtruar rëndësinë e zhvillimit të edukimit institucional dhe integrimin e tij në sistem. Edukimi dhe kujdesi ndaj fëmijës ka ekzistuar në çdo shoqëri dhe është ndryshuar krahas me zhvillimin në shoqëri.

Për rëndësinë e edukimit parashkollor kanë dhënë mendimet e tyre edhe filozof, psikolog e pedagog të kohës, duke theksuar rolin dhe rëndësinë e edukimit parashkollor. Edhe sot e kësaj dite janë të

rëndësishme dhe aktuale mendimet e tyre, të cilat e kanë pasuruar praktikën e edukimit parashkollor.

Nga autorët shqiptar dallohet Aleksandër Xhuvani, i cili dha kontribut në zhvillimin e edukimit parashkollor. „Ai analizon cilësitë anatomiko-fiziologjike në moshën parashkollore, nevojën e zhvillimit të shqisave, parafytyrimeve, të imagjinatës, të folurit në këtë moshë, thekson rolin e lojës, të kushteve natyrore dhe të ushqimit për edukimin fizik të fëmijës. Sado që më shumë përshkruan, edukatën parashkollore në familje, ai nuk mohoj as rolin e kopshteve fëmijërore dhe propozoi themelimin e tyre." (Rexhepagiq, 2002) .

Teoritë e zhvillimit të fëmijëve, paraqesin rëndësinë e edukimit në moshën e fëmijërisë së hershme, duke kushtuar rëndësi stadeve të zhvillimit, fushave të zhvillimit dhe të mësuarit tek fëmijët, mjedisit ku zhvillohet fëmija, etj. Është vërtetuar se periudha parashkollore ka rëndësi të jashtëzakonshme në zhvillimin e mëvonshëm të njeriut ngase kjo moshë ka pasuri të mëdha mendore, të cilat po qe se nuk zhvillohen në këtë moshë mund edhe të humbin.

Sipas Robert Fulghum „Gjithçka që unë me të vërtetë duhet të dijë i kam mësuar në kopshtin e fëmijëve". Ai rëndësinë e edukimit parashkollor në institucion e paraqet kështu: „ Nuk i mësova në shkollën e mesme por në kopshtin e fëmijëve": ndani gjithçka me të tjerët; luaj drejtë; mos t'i goditni njerëzit; vendosni gjërat atje ku i keni gjetur; pastroni rrëmujën tuaj; mos merrni gjërat që nuk janë tuajat; thoni se ju vjen keq kur lëndoni dikë; lani duart para se të hani; ushqimi i ngrohtë dhe qumështi të ftohtë janë të mira për ju; jetoni një jetë të ekuilibruar - disa mësoni, disa vizatoni, pikturoni, këndoni, kërceni dhe luani dhe disa punoni, çdo ditë; merrni një sy gjumë çdo pasdite; jeni të vetëdijshëm që mund të ndodhin çudi...." (Jacobs & Crowley, 2010).

„Gjatë viteve, hulumtuesit kanë vazhduar të konfirmojnë rëndësinë e edukimit dhe lojës si një nga mënyrat më të mira për fëmijët e kopshteve për të mësuar dhe për të përmbushur standardet. Shumë nga teoricienët tanë të lartë të arsimit kanë theksuar fuqinë e lojës për mësimin e fëmijëve, duke përfshirë: Piaget, Dewey, Brunner dhe Vygotsky që lojën e quajtën "veprimtarinë edukative preeminente (më të shquar)" për fëmijët tanë" (Berk&Winsler,1995).

„Kopshti shpesh shihet si fillimi i viteve të shkollës dhe mund të vendosë tonin për të ardhmen arsimore të fëmijëve". (Jacobs & Crovelly, 2010).

Edukimi parashkollor në Kosovë krahasuar me nivele tjera të arsimit pothuajse çdo herë është lënë pas dore, domethënë në përgjithësi ka munguar një qasje serioze ndaj këtij niveli. Si rezultat i kësaj edukimi parashkollor po ballafaqohet me një varg problemesh relativisht të mëdha. Pra, edukimi parashkollor në Kosovë për shkak të një numri të madh arsye shoqëroro-ekonomike e politike asnjëherë nuk është trajtuar si duhet.

Deri në periudhën e pasluftës në Kosovë, pra, deri në përfundim të viti 1999, në Kosovë ekzistonin institucionet parashkollore publike, ku vijonin fëmijët prej moshës 1 vjeç deri në moshën 7 vjeç, kur edhe fillonin klasën e parë, por, pas vitit 1999, filloi reformimi në edukimin parashkollor, dhe kur u rregullua sistemi i arsimit në Kosovë sipas ISCED,u vendos që klasën e parë fëmijët të fillojnë nga mosha 6 vjeç.

MAShT duke e kuptuar rolin dhe rëndësinë e edukimit parashkollor të institucionalizuar dhe në pamundësi të hapjes së shpejtë të institucioneve parashkollore publike, lejoj që të hapen institucione parashkollore private, e poashtu edhe qendra me bazë në komunitet, për të mundësuar përfshirje më e madhe e fëmijëve në edukim parashkollor.

Përkundër përpjekjeve që të ketë përfshirje më të madhe të fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor ende nuk është ngritur në nivelin e duhur.

Përveç përpjekjeve për të përfshirë më shumë fëmijë në edukim parashkollor, domosdoshmëri është edhe përgatitja dhe zhvillimi profesional i edukatoreve që punojnë me fëmijët parashkollor.

Gjatë dekadës së kaluar ka pasur një ndryshim radikal, për të kuptuar se çfarë përbën zhvillimin efektiv profesional për mësimdhënësit, se çfarë duhet të përfshijë, çfarë duhet të përmbajë dhe si duhet të sigurohet zhvillimi profesional i mësimdhënësve, si dhe të analizohen nevojat se çfarë zhvillimi profesional duhet të kenë mësimdhënësit për të plotësuar nevojat e gjeneratave të reja.

Zhvillimit profesional të mësimdhënësve i është dhënë rëndësi e veçantë edhe në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 - PSAK. Një nga objektivat e tij ishte „Ngritja e cilësisë së mësimdhënësve përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve”. Nevoja për zhvillimin profesional të mësimdhënësve është paraparë edhe në objektivat e PSAK 2017-2021. Prandaj, zhvillimi profesional i mësimdhënësve do të kontribuojë në zbatimin e reformës në institucione edukative.

Që nga viti 2004-2005, MAShT ka hartuar konceptet për krijimin e sistemit të cilat u pasuan me udhëzime administrative për licencimin e mësimdhënësve, në bazë të të cilëve mësimdhënësit/edukatoret u pajisën me licencën e karrierës.

Në vitin 2009, MAShT themeloi Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KShLM), për ta udhëhequr procesin e licencimit përmes Udhëzimit Administrativ UA 01/2009. Poashtu, MAShT ka realizuar edhe hartimin e udhëzimeve administrative, akreditimin e programeve trajnuese, hartimin e katalogut të trajnimeve, etj.

Në vitin 2017 u hartua Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë, përmes të cilës përcaktohen standardet e profesionit të mësimdhënësit përgjatë karrierës. Sipas kornizës, janë dy faza që zbërthejnë kompetencat e mësimdhënësit:

-Faza e parë - përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit dhe hyrjen në profesionin e mësimdhënësit, dhe

- Faza e dytë – përfshinë periudhën në shërbim, e cila përfshinë katër nivele të zhvillimit të mësimdhënësve në shërbim, përkatësisht kompetenca të veçanta për secilën shkallë të karrierës gjatë shërbimit, siç janë: Mësimdhënës i karrierës; Mësimdhënës i avancuar; Mësimdhënës mentor; Mësimdhënës i merituar.

Për edukimin parashkollor janë hartuar edhe kompetencat e edukatores. Përgjegjësia për shkollat publike (institucionet parashkollore, fillore, shkollat e mesme të ulëta dhe të larta dhe arsimi i lartë) është e MAShT-it e cila është përgjegjëse për planifikimin, mbështetjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve arsimore në nivel të përgjithshëm, ndërsa mbështetja për funksionimin e shkollave/ institucioneve parashkollor, është përgjegjësi e komunave.

Organizimi i Edukimit Parashkollor në Kosovë

Edukimi Parashkollor në Kosovë organizohet:

- Në institucione parashkollore publike
- Në institucione parashkollore private
- Në institucione parashkollore publiko-private
- Në qendrat me bazë në komunitet – QBK
- Në klasë parafillore për fëmijët e moshë 5-6vjeç, në kuadër të shkollave fillore.

Edukimi parashkollor në Kosovë është edukim vullnetar dhe përkundër përpjekjeve që edukimi i fëmijëve të moshës 5-6vjeç të bëhet edukim i obliguar, ende kjo nuk është arritur të realizohet.

Qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojë vështirësitë që kanë hasur edukatoret në zhvillimin e tyre profesional krahas shfrytëzimit të mundësive që u janë ofruar për zhvillimin e tyre si me programet e akredituara pa shkëputje nga puna, poashtu edhe përmes trajnimeve për ngritjen e cilësisë në punën e tyre.

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të jenë tregues të nevojshëm për opinionin, për hartuesit e politikave të edukimit parashkollor, për planifikimin e trajnimeve, për ngritjen e cilësisë në edukim parashkollor që janë bazë për cilësinë në nivelet e tjera të shkollimit. Nevoja për aftësim gjatë gjithë jetës është e madhe, prandaj ky hulumtim do të nxjerrë në pah mënyrat e tejkalimit të sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive që u ofrohen edukatoreve, për të qenë në hap me zhvillimet edukative dhe shoqërore për të edukuar fëmijët në fëmijërinë e hershme.

Pyetjet e hulumtimit

1. Cilat janë sfidat e edukatoreve për ngritjen dhe zhvillimin profesional të tyre?

3. Sa i kanë shfrytëzuar edukatoret mundësitë që u janë ofruar për t'u ngritur dhe zhvilluar profesionalisht?

4. Sau ka ndihmuar edukatoreve rikualifikimi dhe trajnimet që u janë ofruar, për efektivitet në punë?

. ***Hipoteza***

Edukatoret kanë kaluar me sukses sfidat që i janë paraqitur gjatë ngritjes dhe zhvillimit profesional.

Metodologjia

Modeli i hulumtimit

Hulumtimi është vlerësues dhe karakterizohet nga qasja kuantitative dhe kualitative.

Popullacioni dhe mostra

Në Kosovë janë gjithsej 43 institucione parashkollore publike. Për këtë hulumtim janë përzgjedh 5 institucione parashkollore publike, në katër komuna. Sipas Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim -SMIA 2016, janë 528 edukatore të institucioneve parashkollore publike, që në këtë rast e përbëjnë popullacionin, ndërsa mostër e këtij hulumtimi janë 53 edukatore të këtyre institucioneve.

Instrumenti: Pyetësor me edukatore

Pyetësori u realizua me qëllim që të grumbullohen të dhëna nga edukatorët, për mendimin e tyre lidhur me sfidat dhe mundësitë e ngritjes dhe zhvillimit të tyre profesional.

Procedurat e hulumtimit

Hulumtimit në terren i ka paraprijë një analizë kabinetike e literaturës lidhur me edukimin parashkollor në përgjithësi e poashtu edhe për punën e edukatores, ku janë hulumtuar edhe përvojat e shteteve tjera lidhur me realizimin e edukimit parashkollor. Pastaj, janë përgatitur pyetësorët për të mbledhur të dhëna në terren. Respondentët janë njoftuar me kohë për qëllimin e hulumtimit dhe është realizuar hulumtimi. Ndërsa, për përpunimin e të dhënave, është hartuar një platformë për futjen e të dhënave. Pastaj është bërë filtrimi i tyre dhe është bërë përpunimi i të dhënave.

Rezultatet dhe interpretimi i tyre

Sipas rezultateve të hulumtimit, sfidat e edukatoreve gjatë ngritjes dhe zhvillimit profesional kanë qenë: Rikualifikimi për edukatoret që punojnë me fëmijët e moshës 3-6vjeç , pas një pauze të gjatë duke qenë me vite të tëra punëtore me kualifikim shkollë e lartë pedagogjike dhe të vazhdojnë studimet edhe për dy vite tjera. Sfidë është edhe kualifikimi i edukatoreve që punojnë me fëmijët 0-3 vjeç, sepse ato kanë qenë në shërbim me përgatitje profesionale me shkollë të mesme, tani kërkohet kualifikim universitar. Sfidë është kualifikimi i pedagogeve që kanë punuar si edukatore për vite me radhë, e që tani ju duhet

të rikualifikohen, (janë në proces të rikualifikimit) për të realizuar të njëjtën punë që e kanë bërë deri më tani. Sfidë janë edhe trajnimet e shpeshta dhe pa e vlerësuar nevojën e edukatoreve, se çfarë përmbajtje kanë nevojë edukatoret të përfitojnë në trajnime.

- Nga edukatoret që kanë ndjekur programin e rikualifikimit pa shkëputje nga puna, 70% e edukatoreve janë përgjigjur se vazhdimi i studimeve pa shkëputje nga puna ka qenë sfidë, 20% janë përgjigjur se ka qenë mundësi e mirë, ndërsa 10% janë përgjigjur që ka qenë mundësi e mirë dhe sfidë. Ky rezultat tregon që për shumicën e edukatoreve rikulaifikimi ishte një sfidë, të cilën e kanë tejkaluar, sepse tani ato i kanë përfunduar studimet.
- Sa i përket efektit të rikualifikimit në punën e edukatoreve, 33% e edukatoreve shprehen se programi i rikualifikimit u ka ndihmuar në teori, 7% që i ka ndihmuar në anën praktike, 47% i ka ndihmuar në teori dhe praktikë, ndërsa 13% janë deklaruar që ky program nuk i ka ndihmuar fare. Duke marrë parasysh që ky program, do të duhej të kishte ndikim në zhvillimin teorik dhe praktik të edukatoreve, këto rezultate nuk janë tregues i kënaqshëm për ngritjen profesionale të edukatoreve.
- Ndërsa për shfrytëzimin i mundësive për trajnim nga edukatoret, 84 % kanë deklaruar që kanë marrë pjesë çdoherë kur kanë qenë të ftuara për trajnim, ndërsa 16% kanë deklaruar që edhe pse kanë qenë të ftuara, vetëm ndonjëherë kanë marrë pjesë, jo çdoherë.
- Lidhur me efekti i trajnimeve në punën e edukatoreve, 80% kanë dhënë përgjigje që shumë i kanë ndihmuar trajnimet, ndërsa 20 % kanë dhënë përgjigje që trajnimet pak i kanë ndihmuar në punën e tyre.
- Zbatimi në praktikë i përvojave të fituara në trajnime, 84% kanë deklaruar se përvojat e fituara do t'i zbatojnë në punën e tyre, 4% është përvojë e mirë por nuk do ta zbatojnë në punën e tyre, ndërsa 12% kanë deklaruar që është vështirë për t'i zbatuar gjërat e reja që i mësojnë në trajnime.
- Nevojat e edukatoreve për trajnime, 32% kanë deklaruar që kanë nevojë për trajnime, për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta- FNV, 20% për qasje ndaj fëmijës, 19% për planifikim të punës edukative, 16% për lojëra kreative, 13% për bashkëpunimin me prindër.
- Cilat janë nevojat më të ngutshme për ndryshim, 40% kanë deklaruar, të kenë më pak fëmijë në grup dhe edukatore speciale për FNV, 25% të ketë hapësirë më të madhe, materiale dhe mjete për punë, 25% të ketë programe adekuate dhe më pak dokumente të reja zyrtare, 10% ambienti i jashtëm të jetë më i përshtatshëm për fëmijët.

Rekomandimet

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kanë dalë këto rekomandime:

- Edukatoret kanë nevojë për trajnime që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së punës së tyre, sepse janë rikualifikuar, kanë ndjekur trajnime, por kanë si nevojë të domosdoshme trajnimet sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta, për qasje ndaj fëmijës, etj.

- Të monitorohen edukatoret dhe të vlerësohen se për cilat trajnime ka nevojë secila edukatore, e jo të ofrohen trajnime për të gjitha edukatoret pa ekzistuar një vlerësim paraprak i nevojave të tyre për trajnim.
- Të respektohen kriteret infrastrukturore për fëmijët në institucione parashkollore, sepse është numri i madh i fëmijëve në grupe, e hapësira është e vogël, kjo ndikon në mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve dhe është sfidë për edukatoret që t'i realizojnë aktivitetet në kushte të tilla.
- Të punësohen edukatore speciale për fëmijë me nevoja të veçanta.
- Të ofrohen udhëzime të qarta për realizimin e programeve të trajnimit, sidomos për dokumentet zyrtare dhe profesionale që ofrohen nga MAShT.

Literatura dhe burimet

Aliu-Gashi, M & Plakolli, Z, (2016), Sfidat dhe gatishmëria e nivelit lokal për realizimin e edukimit parafillor si edukim i obliguar, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.

Berk, L., & Winsler, A. (1995). Schaffolding Children's Learning: Vygotsky and Early Childhood Education. Washington DC: Naeyc.

Copple, C, Bredekamp, S,(2009), Developmentaly Appropriate Practice, Washington, National Asssociation for the Education of Young Children.

Crowley, K. & Jacobs,G.(2010), Reaching Standards and beyond in Kindergarten, USA, Naeyc.

Rexhepagiq, Jashar, (2002), Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike,Libri shkollor, Prishtinë.

Shatri, Bajram, (2010), Arsimi shqip në Kosovë 1990-1999, Libri shkollor, Prishtinë.

Vadahi, Fatmir, (2002)Pedagogjia Parashkollore, Shkodër

Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2017), Kërkime Pedagogjike 2, Gjendja e përgjithshme në institucione parashkollore private, Prishtinë.

MAShT, (2006). Ligji mbi edukimin parashkollor.

MAShT, (2008). Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

MAShT, (2011). Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

MAShT, (2011). Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6vjet

MAShT, (2006). Standarde të përgjithshme të edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç.

MAShT, (2006). Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç.

MAShT, (2017), Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë.

MAShT, (2016),Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016, (PSAK)

MAShT, (2016), Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar në Kosovë 2016-2020.

MAShT - Udhëzimi Administrativ - Për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore
MAShT - Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve MAShT - Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve

MAShT - Udhëzimi Administrativ për Licencimin e Mësimdhënësve

MAShT – Udhëzimi Administrativ, Sistemi i licencimit dhe zhvillimi i mësimdhënësve në Karrierë.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

RRETH DISA ASPEKTEVE TË "GJUHËS SË GRAVE" NË TË FOLMEN E QYTETIT TË PRIZRENIT ME RRETHINË

Prof. ass. dr. Muharrem Gashi-Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë

Abstrakt:

Gjinia dhe mosha ndikojnë në ndarjen shoqërore nga dalin edhe grupime të të folurit. Shkalla e edukimit reflekton sjelljen gjuhësore shquan mendimi i U. Labovit, jo vetëm për të folurit e gjuhës femërore.

Niveli i edukatës së femrës të së folmes së qytetit të Prizrenit me rrethinë është i përafërt me atë të femrës kosovare. Rëndësi ka se ku lind e rritet njeriu, natyrisht se aty nis të flasë, sepse pa mjedisin shoqëror nuk do të flisnim. Në këtë trevë një dukuri që e ndan gjininë femërore është mos arsimimi i mirëfilltë. Pra kemi mjedise ku mungon zhvillimi i duhur, nga femra merret me punë të shtëpisë. Këtu sidomos veçohet të folurit e grave të reja e nuseve. Ato i zbatojnë *rregullat* e të folurit me zë të ulët, qëndrim të urtë e zemër të çiltër. Kjo sjellje hetohet në gazmende, si: në *kanë, përgim, kanagjeq* e *dasma*, ku nuset rrinë në këmbë e përshëndesin me *temena*. Kjo i bën të veçohen në sy të pranishmëve, por në mënyrë të veçantë nga vajzat që i këndojnë: */E ka Afërdita o: një pikë n`ball`Ani nuk na la o: shoqe n`mahall`!/* (Kushtrim, Prizren). Kështu ato e bëjnë nusërinë, atyre nuk u takon të flasin, se *me ia çit nuses gojën* do të kritikohet, *se si nusjafoli*, dhe këndohet: */Nusja Ali agës dimijat me topa N` ren`in e nuseve po duket si shota!/* (Vlashnjë, Prizren) etj.

Kjo etnografi e të folurit shquan vlera leksikore të këtyre trevave duke vënë në pah të dhëna të veçanta komunikimi me dallime specifike të këtyre dukurive përfaqësuese sociodialektore e sociolinguistike.

Fjalë kyçe: *femër, kanë, përgim, dasmë, i çiltër* etj.

Hyrje

Dialektet dhe të folmet a ligjërimet vendore të shqipes në të gjitha krahinat e trojet e sajjanë të pasura me fjalë dhe shprehje të larmishme, me koncepte e forma që kanë vlera të mëdha në planin dialektor dhe leksikor e më gjerë. Prandaj mbledhja e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga goja e popullit është detyrë e dorës së parë dhe burimi kryesor prej nga mund të vilet kjo lëndë, sepse lidhet me jetën dhe veprimtarinë e njerëzve, me punën e tyre, me mënyrën e jetesës, me doket, zakonet, traditën, psikologjinë dhe mjedisin ku ata jetojnë.

Gjurmimi dhe mbledhja e lëndëstë qyteteve e krahinavetë pastudiuara plotësisht ngërthen vetë procesin e pandërprerë të studimeve të gjuhës shqipe. E tillë dhe me shumë interes si për nga hapësira e truallit, ashtu edhe për nga qëmtimi shterues është edhe lënda e së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinave të tij.

Metodologjia

Shikuar në këtë këndvështrim kam bërë përpjekje që nëpërmjet të metodës së krahasimit dhe asaj të përndarjes së elementeve përbërëse të jap një qasje sa më të plotë rreth disa segmenteve të përdorimit të "gjuhës së grave", në kuadër të përkufizimit të të folmeve tëqytetit të Prizrenit dhe rrethinës.Në radhë të parë, jo për t'i analizuar në detaje, por për të pasur një pasqyrë të larmisë së këtij varianti të përdorimit gjuhësor. Në punën kërkimore më është dashur takonsultoj literaturënsi dhe subjekt të veçantë dialektologjikë. Në këtë kontekst kryesisht kam përfshirë ritet e këngëve më të ndjeshme jetësoree të gazmendeve, si të dasmave, knagjeqeve etj.

Ndryshethënë duke i pasur parasysh këto të dhëna të vlershme për arealin e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës që dalin nga këto vëzhgime dialektore dëshmohet bindshëm struktura e pasur e formave të fjalëve, përmbajtjevetë tyre që vijojnë të shquajnë funksionepërplot me nuanca kuptimore,emocionuese e mjaft *therëse* e kritike.Niveli arsimor dhe kulturor i femrës sëarealit të së folmes së Prizrenit me rrethinë është i përafërt me nivelin arsimor e kulturor të femrës kosovare në përgjithësi. Për ndonjë pozitë më të mirë, mund vetëm t`i veçojmë qendrat më të mëdha, si: Prishtina, Peja, Mitrovica, Gjilani, e ndonjë tjetër, të cilat përveç edukimit nëpër çerdhe të fëmijëve kanë shkollimin e rregullt parafillor, pastaj fillor, gjithashtukanë numër relativisht të përgjegjshëm të shkollave të mesme, të mesme profesionale, për nivele më të larta kolegje të ndryshmedhe arsimim universitar. Megjithatë ka rëndësi të madhe se ku lind dhe rritet njeriu, djepi ku ai mëson të flasë, sepse po të mos ishte një mjedis i tillë shoqëror, atëherë mund të kishim njerëz që nuk dinë të flasin siç është tëholluar rasti i eksperimentimit të fëmijëve që janë rritur në mjedisin e ujqërve.[157]

Në këtë hulli mendojmë se kemi mangësi në trajtimin e "gjuhës së grave", derisa në mese të tjera të studimit shprehen për trajtime më të përimtuara. Kështu shquhet nevoja që t`i shqyrtojmë e t`i evidentojmësë paku disa aspekteedhe në arealet e së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës.

[157]Shkurtaj, Gj.:"Sociolinguistika", f. 160.

,,Gjinia bashkë me moshën janë faktorë natyrorë, porse ato pleksen edhe me ndarjet shoqërore e etnokulturore të ndryshme të bashkësive shoqërore duke dhënë dorë edhe për diferencime e grupime të të folurit"[158].

Ndonëse dallimi i arsimit të femrës kosovare nuk është fort i madh, megjithatë krahas kushteve të jetës në qytetin e Prizrenit ka lehtësi edhe për një arsimim më të rregullt, sepse përveç institucioneve parafillore, fillore të mësimit ka edhe qendra të arsimit të mesëm e të lartë shkollor e edukativ. Përveç këtij dallimi të mjedisit shoqëror që është ndryshimi vet zhvillimit të rrethanave të mjedisitkulturor,[159] që gjithsesi se nuk është vetëm i bashkësisë shoqërore kosovare,rol jo pak të rëndësishëm shquan edhe vetë konservatorizmi shoqërisë kosovare. Kjo dukuri që prej kohësh e ka ndarë gjininë femërore, jo vetëm në gjini, por edhe në vetë punët e jetës:

Grania janë në detyrë me punue për shpi: po e teproi koha, si të lirohen prej punve të shpis, munden me ba pun doret të vetat[160].

Nga ky paragraf i ndërtimit të rendit familjar shihet fare qartë roli i femrës shqiptare që e ka përcjellë për një kohë të gjatë ndër periudha të ndryshme të kaluarën e trashëgiminë tonë. Madje, në treva të malësisë më të largët,ka edhe qëndrime të cilat i respektojnë rregullat e *kanunit* po në këtë masë.

Konsideroj se ky përkufizim shoqëror nuk është dëshira e vet entitetit, por padyshim se këtë e bëri edhe më të zymtë okupimi i pandërprerë[161] që përball pushtimeveqë nuk reshten as programet për denigrim e tjetërsim të kësaj etnie nëpërmjet marrëveshjeveqë kishin për qëllim shpërnguljen , si "*neçertanja e vitit 1884*"-(lexo:projekti) [162]nga këto troje, madje, siç qemë vetë dëshmitarë edhe në rastin e Luftës së fundit.

Kur kësaj të dhëne i shtojmë edhe anën e karakterit të traditës sonë, ku femra ka kryer kryesisht *detyrat e shtëpisë* e më pak ka qenë faktor në zhvillimin e proceseve shoqërore, shpërfaqja del edhe më e errët, del edhe më konservator të folurit e këtij grupimi, pra gjithsesi edhe i kësaj ane. Në këtë aspekt tashmë është e njohur, por edhe e dëshmuar se shkalla e edukimit si dhe e aftësimit intelektual të njeriut reflekton në masë të konsiderueshme edhe formën e sjelljes gjuhësore. Sa më i lartë të jetë niveli arsimor e edukativ aq më i shprehur do të jetëniveli i pasqyrimit gjuhësor të individit. Këtu është fare me vend për tu parë me kujdes edhe mendimi i Uljam Labovit, i cili shprehet për rolin përtëritës si dhe atëtë ndjeshmërisë më të theksuar të të folurit të *gjuhës femërore*[163].

Gjinia femërore ka veçanti, sidomos për dukuriintime të jetës, por edhe në përgjithësi në të folurit e tyre të përditshëm, qoftë në raportet bashkëshortore e familjare, por edhe në marrëdhënie të situatave të ndryshme që shquan. Gjegjësisht ato shprehin një përulje më të qartë ndaj ndryshimeve, gjegjësisht mbajnë një qëndrim më të pranueshëm nga frika se mos pësojnë sanksionin e rrethit shoqëror, përkatësisht humbjen e besimit a privilegjin e gjinisë së kundërt. Gratë duke qenë më të ndjeshme se burrat dëshmojnë kësisoj një përthyerje më të qartë ndaj ndryshimeve, nga edhe përimtojnë

---

[158]Shkurtaj, Gj. :"Etnografi e të folurit të shqipes", Tiranë, 2004 f .246

[159]Çabej, E.:"Studime gjuhësore", f. 19, IV, Prishtinë, 1978
[160]Gjeçovi, Sh.:"Kanuni i Lekë Dukagjinit", Nye 49, f.7, 8, 9.
[161]Beci, B.:"Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre", f.79, "Dituria", Tiranë, 2002.
[162]Pedersen, H.:"Studime për gjuhën shqipe", f.29, Prishtinë, 2003.
[163] Labov, U.: "The intersection of sex and social in the Course of Linguistic Chenge", Chicago, 1990.

sociolinguistët; Fisher e Labov.[164]Në këto marrëdhënie veçanërisht vjen në shprehje ,,lidhja e seksit si dhe e tregueseve të standardizimit të thënies"[165].

Posaçërisht duhet theksuar të folurit e grave të reja, sidomos të nuseve të sapomartuara deri sa bëhen gra me fëmijë. Gjatë tërë kohës së nusërisë ajo është, e detyruar të zbatojë rregullat e të folurit, pra të të folurit me zë të ulët, me qëndrim të urtë e të butë, me takt sa më elegant e të respektuar, t'i kryejë të gjitha vetëm duke i lëvizur buzët e *me zemër të hapur* me qëndrim joshës e të dashur, në mënyrë që të fitojë gjithë *simpatinë* e adhurimin e rrethit.Në arealin e të folmeve të Prizrenit, kjo sjellje zbatohet e njihet mirë, madje në këtë drejtim bëhet edhe konkurrencë.

Në gazmende të ndryshme, si: përgim, kanagjeq e veçanërisht në dasma, ceremonia e të cilave zgjat më shumë, nuset e reja renditen të mbështetura përanë, apo në ndonjë vend të dukshëm dhe qëndrojnë *të paluara* apo të rregulluara dhe fare pa bë zë përshëndesin vetëm me lëvizje tejet intime e të pëlqyeshme, në mënyrë që të mos i zgjojnë askujt ndjenjën e padashjes. Ato marrin, *temena*, rit i lëvizjeve me duar, me kokë e me trup, apo më mirë, rit i mirëkuptimit, i përshëndetjes si dhe njëherazi edhe i përuljes në shenjë nderimi e respekti në momentetë ndryshme, por edhe kur dikush u afrohet nga të afërmit për t`i përshëndetur.

Të gjitha këto nusja mundohet t`i bëjë në mënyrë sa më të përkryer që të bëjë *emër* e *zë* qëtë dallohet nga të tjerat. Këto hetohen edhe nga të pranishmit që marrin pjesë në këto gazmende e në mënyrë të veçantë nga vajzat të cilat janë më të ndjeshme në këtë aspekt, të cilat mblidhen si dhe i këndojnë këngë që kapin anë të ndryshme si të mirëkuptimit, pra të lëvdimit të po këtyre sjelljeve, qoftë edhe vetëm të ndonjërës e cila shquhet. Nga këndej ato edhe këndojnë:

/Unaza e dukatit sillet nëpër o: u:jë

Lumja nana, shka ka çit o: n`der  t`hu:j!/

(Atmaxhë, Prizren)

Po në këtë kontekst kur ka nuse më shumë që janë të rrethit, përkatësisht kur nuk dihet se për kë shkojnë këto lëvdata ato që këndojnëdinë mirë edhe t`i dallojnë me emra, por më rrallë me emra të nuseve, gjegjësisht, kryesisht në emra të burrave, përkatësisht të djalit, nipit apo edhe të djalit të dajës, ngase një vend të veçantë kanë edhe nuset e nipave në këto gëzime familjare:

/Dimijat e nuses filxhana filxhana,

zgjohu pak më herët se s'je te nana!/

(Zojz, Anadri, Prizren)

[164]Shkurtaj, Gj.:"Sociolinguistika", f. 156.
[165]Labov, U. : Vepër e cituar, f. 210.

/Nusja Ali agës dimijat me topa

N` ren`in e nuseve po duket si shota!/

(Vlashnjë, Prizren)

Këngët, pra*gjuha e grave*, në këtë rast jo vetë e vajzave, por edhe e të tjerave shquajnë rrethanat në të cilat ato e bëjnë *nusërinë*.

Gjatë kësaj kohe asaj nuk i takon të flasë, madje edhe kur ndonjëri edhe *e ngacmon*me fjalëajo përsëri nuk bën të flasë, ngase shumë sosh dëshirojnë që me qëllim *me ia çit nuses gojën*, pra që ta bëjë të flasë nusja e më pas ta këndojnë se si nusja *foli*etj.Kur ndonjëra nga nuset *mbahet* në mënyrë të veçantë i pasojnë edhe këngët në mënyrë të veçantë, ngase ajo përcillet si dhe për çdo sjellje kritikohet:

/Oj Lulije, o moj zeshkane

Shka po rrin kaq azgane!/

(Landovicë, Prizren)

Madje kur nusja herë-herë,me qëllim nuk i përfillkritikat e para asaj do t`i pasojnë këngë me kritika edhe më shumë:

/Shka e ke rrit men`en oj magjupe

Që vet`m i ke vu dy pika t`kuqe!/

/Ka ardh baba i nuses dathën nëpër loq,

I ka hi katundit e po lyp kallamoq!/

(Medvec, Prizren)

Korri i vajzave vazhdimisht e përcjell si dhe kur ajo vazhdon të jetë mospërfillëse ato i drejtojnë akuza të rrepta:

/Nusja jonë vetllat si drapen

Sot po shihet se asht gjarpen!/

(Billushë, Prizren)

Kritikat nuk do të ndalen duke akuzuar edhe personalitetin e saj e edhe të afërmit edhe burrin si dhe gjithë të tjerët që janë të afërmit e nuses, si: burrin, babanë, vëllain etj:

/Vllavi i nuses me dy diploma

Nja për speca nja për patlixhana/

Të gjitha këto kritika do të tolerohen, ndonëse ka edhe që në mesin e të tjerave që kërkojnë të respektohen nuset, kërkojnë që të mos kritikohen, madje kërkojnë nga të afërmit si dhe nga më të moshuari, pra që kanë autoritet të mesit familjar të ndërhyjnë te vajzat, në atë mënyrë që këndojnë, por të jenë më të kujdesshme, të mos i fyejnë nuset, burrat e tyre, të afërmit e tyre gjegjësisht t`i lënë nuset që ta bëjnë nusërinë e tyre etj.

Për këto raste nusja zakonisht parapërgatitet ngase është e vetëdijshme se edhe do të ketë edhe *fyerje* e edhe *nënçmime* nga më të ndryshmet, jo vetëm nga vajzat, por edhe nga të tjerët.Që të mos ketë ngecje, *telashe***,** ajo paraprakisht *nreqet* [rregullohet], pra që të dalë sa më mirë e veshur, sa më bukur dhe sa më *e pagojë*si dhe të jetë sa më dëftuese. Ajo,jo vetëm se duhet t'u përmbahet këtyre rregullave të sjelljes, e më së shumti rregullave të mirësjelljes, apo sjelljes së pranueshme e të këndshme. Madje,ajo duhet të ketë kujdes edhe me fëmijë të vegjël kur ndonjëherë edhe e nxisin duke e prekur që nusja *të flet* ose ndoshta edhe ta shpotisin me ndonjë fjalë që s`i përket asaj.

Kur këto kushte do t`i përballojnë nuset, tek atëherë, pra më pas do të vijnë edhe urimet,fjalët që e vlerësojnë sjelljen dhe taktin *nusërisë*, pra të nuseve që janë *të renditura (palueme)*.Kur nuset janë *të mbështetura* përanë a përball grupeve të vajzave, por edhe të grave që e kanë kaluar *nusërinë* i këndojnë me këngë të ndryshme madje herë-herë edhe therëse, pra edhe duke i akuzuar, por herë-herë edhe duke i lëvduar për ndonjë sjellje të mirë, sjellje e qëndrim elegant e fisnik, në mënyrë që nusja të ndjehet me ndonjë sjellje që shquan simpati,kësisoj duke *e futur në lojë*, nga më pas do ta përqeshin me shumë këngë të tjera që arritën nusen ta *mashtrojnë* me pak fjalë që e kanë përgëzuar.

Nga një numër tejet i madh si dhe i larmishëm që dëgjohen e këndohen në të folmen e arealit të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij ne po i veçojmë disa nga sosh.

/Nusja e Zeçës e ka ngre kryt hava

sikur kali kur del n`vrap me nga!/

/ Shpija jonë e ham`  bukën me mjalt`

ori nuse, men`en e madhe ta ulin kadal!/

(Zhur, Prizren)

Nga e kaluara, por edhe sot në mjaft vende e veçanërisht në malësi të këtyre trevave të të folmes së Prizrenit në rrethinë, e në mënyrë të veçantë në trevën e Hasit, zakonisht kur jepet *fjala e nuses*, pra kur fejohet çifti i ri, në pritjen e familjes së të fejuarit, kur **e** *çojnë maramën e nuses*, përveç *misitit* shkon edhe vëllai i nuses.

Nëse nusja ka vëlla, po nëse nuk ka vëlla, shkon djali i vëllait të babait të nuses, apo edhe ndonjë tjetër i afërm i familjes. *Miqtë e ri*, por në mënyrë më të ndjeshme vëllai i nuses, duhet të ketë qëndrime shumë të matura, të mos flasë me zë të lartë, të dëgjojë më shumë e të flasë me zë normal, pra pa bërtitur, sado që mikpritësit dëshirojnë të e dëgjojnë dhe ta pyesin, ai duhet të marrë pjesë në kuvend, por pa e tepruar. Sjellje të këtillë duhet të tregojë edhe kur hanë e kur pinë, pra fare pa e tepruar.

/Kn`oni ori vajza kno`ni, se *na ka ardh vllavi i nuses*

Oni e kish krevin ooo:, si lakna e Billushëeeees! /

/Vërri, Prizrenit/

Ngase përveç miqësisë që shquan në këto sjellje ai është edhe vetë pasqyrë e motrës, pra nuses. Në vëllain e nuses miqtë e shohin *nusen* që nesër do ta marrin, apo do ta kenë në *derë të shtëpisë*. Prandaj për këtë edhe këndojnë këngë edhe për ta uruar, por edhe për ta *nënçmuar*. Nëse eventualisht kanë hetuar se miqtë apo edhe vëllai i nuses ka ngrënë shumë, apo ka pirë shumë, poashtu, nëse ai është i veshur keq, apo ka edhe ndonjë të metë ose është mbathur jo mirë këndohet që nga ardhja e deri sa të largohen miqtë nga dera e shtëpisë.

Në kuadër të këtyre gëzimeve më të shprehura në këtë aspekt janë ritet e dasmës që shquajnë traditat më të ruajtura, sidomos ato në malësi të këtyre trevave, si në Has, Vërri e në Rreth të Bjeshkës së Kabashit tëPrizrenit.Të gjitha këto fillojnë që nga *marrja e penit* të nuses e deri te kryerja e martesës së djalit me nusen.

/*Ori nuse dil e lidhe qenin*

Se po vim` me ta marr penin!/

(Piranë, Prizren)

Me këso këngësh nis në mënyrë të mirëfilltë edhe riti i dasmës në këtë anë. Po me këtë rast përveç marrëveshjes së kohës së dasmës, përkatësisht datës së saj, bëhet edhe dërgimi i *teshave të nuses,* që aty-këtu dëgjohet edhe *petkat e nuses:*

/Priti baba i nuses kutijat e kuqe

mas do dite, ti pa çik e na me nuse!/

(Gjonaj, Has, Prizren)

Po në këtë kohë, pra me rastin e *marrjes së penit* dhe dërgimit të teshave të nuses nis edhe mbledhja e bijave të shtëpisë, së pari duke filluar nga motrat, hallat e të tjerat që vinë me radhë në kuadër të afërsisë së gjinisë së familjes që bën dasmë:

/ Shkrepi di`lli n`penxheree,

ori halla Gjyl a mun` erdhe!/

(Romajë, Has, Prizren)

Në kuadër të këtij gëzimi familjar të dasmës në këto anë shquhet edhe riti i gatimit *të kulaçit të nuses* që përcillet edhe me një numër këngësh e thëniesh që janë të veçanta me këtë rast.

Sipas traditës djali duhet të jetë i pranishëm në këtë rit, ai duhet ta nisë këtë rit, por të mos flasë fare. Është traditë se me rastin e gatimit të kulaçit futen monedha, pra monedha të metalta, të cilat do t`i gjejë nusja ose dhëndri në natën e dhëndërisë:

/Kush e gatoi kulaqin me sheqer

mos past idhnim kurrë asniher`!/

Zakonisht riti i dasmës në shtëpi të dhëndrit nis të mërkurën mbrëma, kur vijnë farefisi i gjerë, bijat edhe ndonjë mik i veçantë. Miqtë e tjerë të shtunën priten *me dajre***,** lodra e def, në kohë të fundit edhe me muzikë.Ceremonia merr karakterin e veçantë kur shkohet të merret nusja ditën e diel:

/Babai i nuses, a ki livadhe

me na i prit krushqit me dajre!/

(Vërmicë, Prizren)

Ndërsa në shtëpi të nuses gjithashtu këndohet madje edhe aty në mënyrë shumë të ndjeshme duke iu kundërvënë edhe këngëve që këndojnë vajzat, nuset si dhe gratë e tjera që këndojnë kur vinë ta marrin nusen. Varësisht prej rrethanave grupet *kundërshtare*, janë shumë të zëshme, në momentet kur e përfundon grupi i atyre që kanë ardhur ta marrin nusen, nis grupi i atyre që e përcjellin nusen. Herë-herë kur merr përmasa më të ashpra ky rivalitet dhe i tejkalon edhe këto *rregulla*të respektit të dy anshëm, grupet nën tensionet kundërvënies më nuk mund ta dëgjojnë njëri tjetrin, por vazhdojnë deri sa shkojnë dasmorët me nusen.

/A e din besën që na ke dhanë

Nanës huj nan`, mos me i thanë!/

(Kobaj, Prizren)

Në këto rrethana këngët motivohen me atakime të ndryshme për dhëndrin si dhe familjen e tij që vinë ta marrin, si:

/*Kaj oj mot`r, kaj e kup`sh*

Se po t`çojmë nuse për magjup!/

(Gurrë, Prizren)

Përgjatë tërë ditës vajzat, nuset, gratë, por edhe plakat ato më të afërtat të shtëpisë që e bëjnë dasmën, luajnë e këndojnë këngë të ndryshme, madje kur një grup e përfundon këngën ia nis grupi i tjetër. Herë-herë edhe të gjithë së bashku ose edhe ndaras në grupe më të vogla.

Këngët dhe lojërat janë nga më të ndryshmet edhe për nusen edhe për dhëndrin, edhe për shtëpinë e nuses e farefisin e saj edhe për shtëpinë e dhëndrit dhe krenarinë e familjes së tij që bën dasmë. I këtillë është edhe momenti kur e marrin nusen në shtëpi të babait të nuses si dhe gjatë largimit.

/Hade-hajde gratë e sh`pisë

Shihne sorrën që ka hyp n`lis!/

(Landovicë, Prizren)

Herë këto këngë shënojnë edhe teprime që janë shumë dëftuese edhe për fyerje që mund të çojnë në ngatërrime të ndryshme, megjithatë kjo tolerohet për hir të vetë dasmës dhe rëndësisë së saj që ajo shquan si ceremoni e veçantë. Por ka edhe këngë që e mirëkuptojnë nusen si dhe vetë dasmorët.

/Çka ju hini uji perfuni

nusja e mire ju perzuni!/

/Vërri, Has /

Dasma në këtë areal të këtyre të folmeve është e pasur edhe me rite të tjera e këngë nga më të ndryshmet që kryesisht e shquajnë jo vetëm këtë anë, *si këngët e natës së dhëndrit:*

/Ti te burri je me çit plehin,

kur t`idhnohen t`zan e t`rrehin! /

(Shkozë, Prizren)

Ndërsa dita e hënë është dita kur nusja e shpërndan çejzin që e ka sjellë për dhurata të shtëpisë. Në shumë mese të këtyre arealeve dita e hënë njihet edhe si dita e grave. Ato mblidhen dhe e këndojnë nusen me këngë të ndryshme:

/Oj lulije pash çat v`lla,

a po na merr ni temena!/

(Therandë, Prizren)

Repertuari i këngëve të këtilla është edhe i pasur, por edhe i larmishëm që shquhet nga treva në trevë. Në mesin e këtyre këngëve ka edhe shumë këngë të tjera si, këngët e çejzit të nuses etj.

Përfundim

Lënda që mblidhet nga gurra popullore është bazë e pasurisë leksikore për fjalorë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë i shquajnë prurjet leksikore e frazeologjike në gjithë pasurinë e leksikut e të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Në këtë hulli padyshim se pasqyrohet edhe e folmja e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Tutje në këtë aspekt, zotërimi i shprehjeve në kuptimin e plotë do të thotë njohje e përdorim i të gjitha vlerave të saj. Kjo vlen për të gjithë, aq më tepër për krijuesit, gazetarët, mësuesit e të gjitha kategorive, që me gjuhën e tyre e të teksteve mësimore janë përzgjedhje interpretimi për nxënësit. Njohja e shfrytëzimi i këtyre vlerave është pasqyrimi gjuhës së pasur, të bukur e me plotstil, por edhe mundësi për ta zhvilluar e për ta çuar atë më tej në të gjitha drejtimet,gjithandej në sfondin e trashëgimisë sonë kulturore kombëtare.

Literatura:

Ajeti, I. “Studime Gjuhësore në Fushën të Shqipes”, I, Prishtinë, Rilindja, 1982, 1982; II, Rilindja, Prishtinë, 1985; III, Rilindja, Prishtinë, 1985; IV, Rilindja, Prishtinë 1989.

Beci, B. ”Dialektet eshqipes dhe historia e formimit të tyre”, “Dituria”, Tiranë, 2002.
Badallaj, I. “Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit” GJASSHF, V-1975, Prishtinë. 1976.
Badallaj, I. “E folmja e Hasit”, Prishtinë, 2004.
Halimi, M. “Kërkime dialektologjike”, Prishtinë, 1985.

Shkurtaj, GJ. “Sociolinguistika”, SHBLU, SHBLSH, Tiranë, 2003

Shkurtaj, GJ. “Etnografi e të folurit të shqipes”, LSH, Tiranë, 2004.

Çabej, E. ”Zakone dhe doke të shqiptarëve”, “Studime gjuhësore”,V, Prishtinë, 1982.
Çabej, E.”Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1978.
Gjeçovi, Sh. ”Kanuni i Lekë Dukagjinit”, New York, SHBA, 1984.
Labov, U. “The intersection of sex and social in the Course of Linguistic Change”, Chicago, USA, 1990.
Pajaziti, N. “Disa tipare të së folmes katundit Randobravë”, GJASSHF, 24-1994, Prishtinë, 1995.

Topalli, M. “ Fjalë e shprehje të rralla të shqipes“, “Jehona“, Shkup, XVI, 6/1978.
Topçiu, V.“Veçoritë fonetike të së folmes së elementit katolik të qytetit të Prizrenit“, UP në DGJSH, Prishtinë, 1988.

Shatri, M. “Shkolla dhe arsimi në Prefekturën e Prizrenit, 1889-1994, “Koha”, Prishtinë, 2017.

Gosturani, Xh.“Veçori gjuhësore të gegërishtes verilindore”, SF, 4, Tiranë, 1984
Zymberi, A. “Disa eufemizma dhe shprehje eufemistike popullore shqipe”, Prishtinë, 1982.
Zymberi, A. “Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhje të Malësisë së Prizrenit, ”SNGJLKSH, 2. Prishtinë, 1978.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

PERSONALITETI I VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE SHABAN IDRIZI DHE KONTRIBUTI I TIJ NË FUSHËN E ARSIMIT SHQIP NË MITROVICE ME RRETHINË

PHD.Mustafe Haziri Kordinator i Qendres per studim dhe Hulumtim në Mitrovicë

Abstrakt:

Duke u nisur nga fakti se ne historianët bartim barren kryesore, për ndriçimin e shumë çështjeve që kanë të bëjnë jo vetëm me historinë, por edhe me arsimin, kulturen etj, na del të kuptojmë se arsimi është segmenti më i rëndësishemnë zhvillimin e vetëdijes së një populli. Asipiratave për shkollim në gjuhën shqipe i kanë paraprirë shumë ngjarje të rëndësishme të asaj kohe.

Arsimi është kategori historike, dhe sistem shumë kompleks që është zhvilluar vazhdimisht në kuadër të rrjedhave të qytetrimit të popullit shqiptarë në tërësi.

Roli i Shban Idrizit, në arsimin shqip ishte i madh, ai ishte i vetëdijshem se pa arsimimin e masës dhe rritjen e ndërgjegjjes kombëtare, nuk ka perparim dhe ardhmeri të një vendi dhe pupullit të tij. Kujtimet për Shaban Idrizin i gjejmë jo vetëm në burimet arkivore dhe historiografike por edhe në atë të revistave shkencore të shtypit të kohës si dhe kujtimet dhe deshmit e bashkëkohanikëve të tij. Qëllimi im në këtë kumtesë është që t'i vë në pahë disa aspekte të rëndësishme historike të arsimit shqip, dhe kontributit të veprimtarit të devotëshem të çështjes kombëtare të mësuesit Shaban Idrizi

---

Autori është Doktorrant në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë dhe autorë i dy librave, "Greva e Minatorëve të Trepçës në Stan-Tërg, 20-28 shkurt, 1989", dhe monografisë për mësuesin dhe veprimtarin e çështjes kombëtare "Shaban Idrizi", si dhe referues dhe organizatorë i shumë simpoziumeve shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Nje vështrim i shkurtër biografik për mësuesit Shaban Idrizi

Shaban Idrizi u lind me 20 tetor të vitit 1892, në fshatin Zhabar i Poshtëm të Mitrovicës. Rrjedh nga një familje e dalluar dhe përparimtare e njohur për bujari e trimëri. Shabani u lind, u rrit dhe u edukua në këtë familje me tradita patriotike, bujare e liridashëse. Qysh në fëmijëri u shqua nga moshatarët e tij për zgjuarësi. Mësimet e para i mori nga hoxha i fshatit, Mullah Selimi, të cilin e kishte sjellë në fshatin Zhabar babai i tij për t'i edukuar dhe mësuar jo vetëm fëmijët e vet, por edhe fëmijët tjerë të fshatit. Në odën e tij hoxha ua jepte mësimet e para të fesë. Numri i nxënësve arrinte deri në tridhjetë[166].

Shaban Idrizi, së bashku me Mulla Rexhepin, Mulla Osmanin, Mulla Januzin dhe Mulla Shaban Bellën, pasi mbaruan iptidainë, mësimin fillestar fetar, vazhduan arsimin e mesëm në gjimnazin i quajtur idadije në gjuhen turke (legalisht), kurse në ndiqnin edhe mësimet në gjuhen shqipe ilegalisht. Populli shqiptar në atë kohë bënte luftë të pandërprerë kunder sundimit osman. Shaban Idrizi qysh në atë kohë, si nxënës i gjimnazit turk propagandonte idetë kombëtare, përhapte mesimin në gjuhën shqipe me alfabetin latin, përkrahte kryengritjet e armatosura në krye me Isa Boletinin dhe demaskonte autoritetet turke. Për shkak të veprimtarisë patriotike, organet e shkollës e përjashtuan për një kohë nga shkolla e Mitrovicës[167].

Sipas kujtimit të bashkëkohasve dhe nxënësve të tij, si Veli Osmani, Ali Beqiri, Jetish Sadikut, Tafil Osmanit etj., Shaban Idrizi ishte një burrë i mençur dhe ushqente dashuri të pakufishëm për arsimimin në gjuhën shqipe. Ai pati fatin të rritej e të burrërohej në gjirin e një familje fisnike, kulla e së cilës mbante gjithherë derën çelur dhe ishte bërë një shkollë e madhe për edukimin patriotik. Kullat dikur kanë shërbyer jo vetëm për banim, por edhe për mbrojtje, siguri, organizim të kuvendeve të ndryshme etj. Ato janë ndërtuar kryesisht prej guri, por edhe prej tullave të pjekura. Kulla më e njohur në Zhabar ka qenë ajo e Idriz Poterës. Disa elemente tradicionale të arkitekturës popullore janë ruajtur deri vonë. Kështu, edhe sot ekzistojnë dhoma pritjeje *("soba të burrave", "soba të mysafirëve")*, ku janë imituar odat tradicionale të burrave me oxhak në ballë, me tavane e dollapë prej druri të zbukuruar.

Duke qenë se popullsia e Zhabarit është marrë vazhdimisht me disa veprimtari kryesore ekonomike, me bujqësi, me blegtori, pemëtari etj. banorët e Zhabarit në të kaluarën e kanë kompensuar mungesën e shkollimit nëpërmjet *"odës së burrave"*.

---

[166]Mulla Asllan Murati, imam në xhamin e Zallit në Mitrovicë, intervista me të u realizua me 8 shtator 2012 në Mitrovicë.

[167] FazliHajrizi, Mitrovica dhe Shala e Bajgorës në fokusin e historisë, Shtëpia Botuese "Libri shkollor", Prishtinë, 2011, f. 280.

Oda e Zhabarit, si ajo e Drenicës, e Dukagjinit, e Shalës etj. ka qenë shkollë, universitet, ku përpara mblidheshin burrat e fisit, të krahinës e më gjerë dhe debatonin për çështje nga më të ndryshmet. Në odë, e cila në kuptimin juridik popullor ishte baza institucionale e jetës shoqërore private, mbizotëronte gjithmonë rendi, bujaria, drejtësia, burrëria, mikpritja, besa, fryma e tolerancës dhe e atdhedashurisë etj. Njerëzit që mblidheshin nëpër kuvende për të biseduar, për t'u marrë vesh për shumë çështje, ishin të zgjedhur, të ditur, të drejtë në gjykimet e mendimet e tyre. Këta njerëz me të ditur e më të mençur, më të drejtë e më me autoritet, populli i quante pleqnarë, jo duke pasur parasysh moshën, por diturinë, sepse ata gjykonin a pleqëronin me urtësi e mendjemprehtësi, duke zgjidhur konflikte të ndryshme, ngatërresa e mosmarrëveshje midis palëve, pajtonin gjaqe etj. Në odën e Zhabarit fjalën kryesore dikur e kanë pasur njerëzit më të ditur, të cilëve u bëhej vend në krye të oxhakut. Në tubimet e rëndësishme, pos hoxhës, merrnin pjesë edhe pleqnarë, personalitete të njohura, si: Isa Boletini, Ali Draga, Hasan Prishtina, Ibrahim Deva, Zejnullah Begu etj.[168]

Shaban Idrizi u martua me Ajeten, bijë e Shabanit nga Shupkofci. Ajo rridhte nga një familje e njohur që merrej me bujqësi po edhe me veprimtari atdhetare. Për shkak të presionit, dhunës e terrorit të vazhdueshëm serb, kjo familje e njohur në këtë mjedis e më gjerë, u detyrua që të shpërngulet në Turqi. Miku i Shaban Idrizit kishte vdekur në moshën 90 vjeçare në Turqi me mallin e madh për vendlindjen dhe të afërmit e vet.

Shaban Idrizi ka pasur pesë fëmijë, tre djem (Jakupi, Ademi dhe Idrizi) dhe dy vajza (Miradija dhe Eminja).

Trungu i familjes Idrizi

Smajli pati dy djem: Idrizi dhe Emini

Idrizi ka pasur dy djem: Shabani dhe Lami

Shaban Idrizi ka pasur tre djem dhe dy vajza: Jakupi, Ademi, Idrizi, Miradija dhe Eminja.

Jakup Shaban Idrizi ka lënë një djalë dhe një vajzë: Agimi dhe Merita

Ademi ka lënë tre djem dhe tri vajza: Naimi, Besimi, Veliu, Qamilja, Shqipja dhe Merita

Idrizi ka lënë një djalë dhe një vajzë: Albioni dhe Arta

[168] FazliHajrizi, Jeta dhe vepra e mësuesit Shaban Idrizi, revista "Shkëndija, 14 prill 1998, Prishtinë.

Miradija ka lënë dy vajza dhe tre djem: Lirija, Eminja, Musaja, Jahjaja dhe Bashkimi

Eminja ka lënë katër djem dhe një vajzë: Afrimi, Vetoni, Bedriu, Kujtimi dhe Hamidja.

SMAJLI

IDRIZI EMINI

SHABNI LAMI

Jakupi---------- Agimi, Merita

Ademi ----------Naimi, Besimi, Veliu, Qamilja, Shqipja, Merita

Idrizi---------- Albioni, Arta

Miradija ---------Lirija, Eminja, Musaja, Jahjaha, Bashkimi

Eminja----------Afrimi, Vetoni, Bedriu, Kujtimi, Hamidja

2. Veprimtaria atdhetare e mësuesit Shaban Idrizi

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kur Shaban Idrizi ishte në moshën madhore, u pa qartë se ai kishte pikëpamje të jashtëzakonshme e të avansuara. Ai ishte njeri largpamës. Shihej se nga kjo familje po hapej një dritare e shpresës së mirë për fshatin, dhe më gjerë, për gjeneratat e ardhshme, një dritë e bardhë për arsimin shqip në Zhabar dhe rrethinë.

Në kuadër të komunës së formuar në qendër të fshatit, Shaban Idrizi ishte inkuadruar si nëpunës i komunës, ku qysh atëherë i lindi ideja për hapjen e një shkolle në gjuhën shqipe. Kështu, pas shumë përpjekjeve, në vitin 1916, arriti ta realizojë këtë dëshirë e synim të tij, dihet, në bashkëpunim me ideologët e Lëvizjes Kombëtare, pra të hapë shkollën në fshatin e vet të lindjes, në Zhabar.

Në vjeshtë të vitit 1915, nisi një periudhë e re në veprimtarinë e dendur atdhetare. Shaban Idrizi u angazhua me tërë qenien në lëmin e arsimit, I vetëdijshëm se pa arsimimin e masës dhe rritjen e ndërgjegjes kombëtare nuk as përparim dhe ardhmëri të vendit dhe popullit të tij[169]. Hapja e shkollës shqipe në Zhabar në fillim të vitit 1916, ishte me rëndësi të posaçme historike, sepse për herë të parë

[169] Fazli Hajrizi, Shaban Idrizi – jeta dhe vepra e tij, "Shkëndija, 14 prill 1998, Prishtinë.

fëmijët shqiptarë të këtij mjedisi e mësonin alfabetine e gjuhes amtare. Vijimi i nxënësve ishte i rregullt dhe interesimi i tyre për mësim ishte i jashtëzakonshëm.

Lajmi për vrasjen e udhëheqësit më të çmuar e më të dalluar të lëvizjes sonë kombëtare, Isa Boletini në Potgoricë më 23 janar 1916, jehoi dhemshëm në gjithë trojet shqiptare, sidomos në Boletin, Mitrovicë e rrethinë. Ky lajm e pikëlloi shumë edhe Shaban Idrizin, i cili e kishte mik shtëpie. Për këtë tragjedi që përjetoi populli ynë ai u kishte folur nxënësve të tij, duke ngritur lart figurën e Isa Boletinit dhe duke ndriçuar rrugën jetësore të tij.Atë vit bëri thatësi e madhe. Shumë familjeve në Zhabar u mungonte kafshata e gojës. Mesuesi Shaban, i cili gjithmonë mbante hapur dyert e zemrës, për t'u ardhur në ndihmë bashkëfashatarëve të tij, i hapi dyrt e hambarit me drithë.

Mesuesi Shaban Idrizi ishte i zgjuar. Kishte trup të gjatë e të drejtë, sy të zez e depërtues. Ishte i respektuar jo vetëm në rrethin ku jetonte, por edhe më gjerë.

Pushtimi i viseve shqiptare nga forcat ushtarake serbe (1912) ai e kishte përjetuar shumë rëndë. Nga fundi i ivitit 1913 dhe fillimi i viti 1914, qindra familje shqiptare nga Zhabri, Shipoli, Vaganica, Vërrnica, Lushta, Suhodolli etj., u detyruan t'i lëshojnë trojet e veta stërgjyshore, duke u shpërngulur në Turqi, në Shqipëri e vende tjera. Tokat e këtyre familjeve fatkeqe pushtuesi ua ndau kolonistëve serbo-malazezë. Lumi i të shpërngulurve u ndërpre në saje të angazhimit të Shaban Idrizit. Në nëntor të vitit 1914, në Mitrovicë hyri ushtria austro-hungareze, e cila e mbajti pjesën veriore të Kosovës nën sundimin e vet deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore (1918). Popullata shqiptare e përjetoi këtë kohë si çlirim dhe emancipim kulturor, arsimor, ekonomik etj. Pos në qytet, shkolla shqipe u hapën edhe në disa fshatra, si: në Zhabar, Koshtovë etj., ku ishin mësues Shaban Idrizi, Hajrë Haxhija e Jusuf Rexha.

2.1.Kontributi i mësuesit Shaban Idrizi në hapjen e shkolles shqipe

Përpjekjet e para për shkollim në Mitrovicë e rrethinë, pra edhe në fshatin Zhabar, kanë filluar në fillim të shek. XX, rreth vitit 1906. Këtu i kemi nismat e para të shkrim-leximit shqip. Mësimi deri atëherë zhvillohej në gjuhën arabe. Në Zhabar në këtë kohë hoxha i fshatit, i cili ishte imami Mulla Selimi, shkonte nga një shtëpi në shtëpinë tjetër dhe zhvillonte mësimin, dihet, në frymën fetare islame. Kjo formë e mësimit vazhdoi deri në vitin 1910.

Gjatë vitit 1909, ***Hasan Prishtina, Nexhip Draga e Isa Boletini*** dolën në mbrojtje të shkollave të hapura, duke shtruar nevojën për hapjen edhe të shkollave tjera në Vilajetin e Kosovës. Për mbrojtjen e shkollës shqipe në Mitrovicë ishte ngitur *"Këshilli Administrativ"* me kryetar të parë Nexhip Draga.

Në emër të shqiptarëve të Mitrovicës, edhe komiteti shqiptar i Kosovës *"Kombi"*, me 28 mars 1910, në krye me Ibrahim Agë Devën dhe Hasan Agën, kërkoi me ngulmë hapjen e shkollave shqipe. Në vitin 1910, fshatarët e Zhabarit, me iniciativën dhe ndihmën e Idriz Poterës e të afërmve të tij, organizuan

ndërtimin e shkollës në këtë vend. Edhe pse shkolla u ndërtua për këtë qëllim, ajo nuk u përdor për mësim, por mbeti për nevojat e pushtetit të atëhershëm. Në vitin 1915, ndërtohet për herë të dytë, ku një vit më vonë, pra në vitin 1916, në kohën e pushtetit austro-hungarez filloi punën shkolla e parë shqipe në Zhabar.

Mësuesi i parë i kësaj shkolle u emërua Shaban Idrizi. Në këtë shkollë fillim i ndiqnin mësimet 37 nxënës (të gjithë meshkuj), ndërsa në vitin 1917 në klasën e parë u regjistruan gjithsej 38 nxënës. Kështu, numri i përgjithshëm i nxënësve arriti në 75. Në vitin 1917, si ndihmës i mësuesit Shaban Idrizi erdhi Hajrë Haxhija nga fshati Vaganicë. Nxënësit ishin të moshës 10-15 vjeçare dhe vinin nga dy Zhabaret, Shipoli, Vaganica, Lushta etj. Mësimi nuk zhvillohej gjatë tërë vitit sepse ishte gjendje lufte dhe pasigurie. Deri në vitin 1918, kur përfundoi Lufta e Parë Botërore dhe u ripushtua Kosova, për mirëmbajtjen e shkollës, financimin dhe mbarëvajtjen e punëve tjera u angazhuan vetë fshatarët.

Mësuesi Shaban Idrizi dhe Hajrë Haxhija në vitin 1916, e kishin kryer kursin pedagogjik, i cili zgjati dy muaj, dhe u kualifikuan si mësues, Në fillim u rikualifikuan rreth 40 mësues. Kursin e udhëhoqën kryesisht mësuesit nga Shqipëria.

Rol të rëndësishëm në hapjen e shkollave shqipe gjatë Luftës së Pare Botëore kishte luajtur organizata arsimore *"Bashkimi"*, të cilin e kishin themeluar Hasan Prishtina dhe Nexhip Draga në prag të vitit 1916.

Në vitin 1920, ndërtesa e shkollës u shkatërrua për shkak të materialit të dobët. Po këtë vit u hap shkolla në ndërtesën, që ishte ngritur në vitin 1910. Mbretëria SKS e ndaloi mësimin në gjuhën shqipe, prandaj mësimi në shkollën e Zhabarit, sikurse në mbarë Kosovën, mbahej vetëm në gjuhën serbe. Në fillim kjo shkollë kishte 40 nxënës (meshkuj dhe femra) me kombësi shqiptare, serbe e malazeze. Mësues i shkollës ishte emëruar Llazo Lekoviqi. Në vitin 1925, u ngrit ndëtesa e re shkollore, ku, pos Llazo Lekoviqit, u angazhuan edhe dy mësues të tjerë, ***Asim Salihamixhiqi*** dhe Milka Berberiani. Kjo shkollë serbe në Zhabar, ku i vijonin mësimet kryesisht nxënësit shqiptarë, ka punuar deri në vitin 1941, kur kapitulloi Mbretëria jugosllave dhe Mitrovica u shpall prefekturë, dihet, nën administrimin gjerman.

Në vitin 1941, pos shkollave fillore në Mitrovicë, në Suhaodoll, në Koshtovë, në Broboniq, në Boletin, në Vllahi, në Zasellë, në Melenicë etj., u hap edhe në fshatin Zhabar. Shkolla u pagëzua me emrin ***"Naim Frashëri"***, ndërsa mësues u emëruan *Reshid Damati dhe Musa Kalaja*.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe ripushtimit të Kosovës në Mitrovicë u hapën dy shkolla fillore: shkolla fillore serbe dhe shkolla fillore shqipe. Në fillim të vitit 1945, pos në Mitriovicë, u hapën edhe gjashtë shkolla fillore në gjuhën shqipe në fshatrat përreth, si: në Zhabar, në Koshtovë, në Broboniq, në Tunel të Parë, në Suhodoll dhe në Broboniq. Mësues të parë në shkollën katërvjeçare në Zhabar pas LDB-së kanë qenë Sejdi Sulejmani e Isak Buçinca. Në vitin shkollor 1945/46, në shkollën

e Zhabarit kanë dhënë mësim këta mësues: Ibrahim Koka, Melihate Sadiku – Hoti dhe Bedri Hamza. Deri në shtator të vitit 1975, shkolla e Zhabarit ka qenë e pavaruar. Në fillim të vitit shkollor 1975/76, ajo iu bashkëngjit shkollës së Shipolit. Kështu, prej atëherë e deri në gusht të vitit 2008, shkolla e Zhabarit ka qenë paralele e ndarë e shkollës fillore të Shipolit. Duke qenë se objekti i vjetër shkollor, i cili është ngritur qysh në vitin 1925, ishte shkatërruar shumë dhe nuk i plotësonte as nevojat minimale për zhvillimin e mësimit, në vitin 1974, kishte filluar ndërtimi i shkollës së re.

Në vitin shkollor 1963-64 kjo shkollë fillore ka startuar si shkollë e plotë tetëvjeçare. Kështu, doli brezi i parë i nxënësve në mësim në gjuhën shqipe.

Shkolla e Zhabarit hyri në kuadër të drejtorisë së shkollës së Shipolit që nga viti 1975. Në vitin shkollor 1991-92, kjo paralele e ndarë e Zhabarit ka pasur katër dhoma të mësimit. Mësimi, për shkak të numrit të madh të nxënësve është zhvilluar në tri ndërresa. Vlen të theksojmë se deri në vitin 1992, shkolla amë e Shipolit, në kuadër të saj edhe kjo e Zhabarit, është quajtur *"29 Nëntori"*.

Ish drejtori i shkollës fillore në Shipol, Xhemajl Uka, tregon se si në vitin 1986, kishte kërkuar nga Komiteti Komunal I LKJ-së në Mitrovicë që të shënohet 70 vjetori i hapjes së shkollës fillore shqipe në Zhabar. Organet udhëheqëse komunale ishin njoftuar se ishin bërë përgatitjet për shënimin e këtij përvjetori, por ato kundërshtuan këtë nismë me pretekstin se shkollë në Zhabar na qenkësh hapur në periudhën e okupimit Austro-Hungarez. Në mbledhjen e jashtëzakonshme që e thirri Komiteti, në mesin e shumë tjerëve, diskutoi edhe publicisti serb, Marko Vaviq, i cili tha se duhet kundërshtuar çfarëdo lloj iniciative për organizimin e manifestimit kulturor me rastin e 70 vjetorit të hapjes së shkollës shqipe në Zhabar. Disa diskutues tjerë serbë kërkuan madje që të dënohen edhe iniciatorët e këtij shënimi të përvjetorit të shkollës shqipe. Drejtori Xhemaj Uka iu kundërvua me gjakftohtësi e në mënyrë të argumentuar këtyre akuzave, duke ua përkujtuar një manifestim të ngjashëm që ishte mbajtur ato ditë në Kolashin në 100 vjetorin e shkollës serbe, e cila ishte hapur gjatë sundimit osman. "Edhe Perandoria Osmane në kohën kur është hapur shkolla serbe, edhe Perandoria Austro-Hungareze, kur është hapur shkolla shqipe në Zhabar, kanë qenë pushtues, prandaj ky qëndrim juaji nuk është parimor dhe I sinqertë. Ne, megjithatë, kemi përgatitur një program modest dhe do ta shënojmë këtë moment të rëndësishëm të shkollës shqipe! – ishte shprehur Xhemajl Uka. Dhe vërtet, pas pak ditësh në shkollën e Shipolit ishte shënuar përvjetori I shkollës shqipe në Zhabar.

Propozimin e kolektivit të shkollës që ajo të riemërtohet me emrin e mësuesit atdhetar "Fazli Greiçevci", u miratua nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës. Në këtë kohë paralelja e ndarë në Zhabar ka pasur 12 paralele me gjithsej 491 nxënës.

3.Kujtime për mësuesin Shaban Idrizi

Thonë se vetëm për mësuesin flitet një shekull e më gjatë. Për mësuesin e parë të shkollës shqipe të parë në Zhabar, Shaban Idrizin, flasin të gjithë brezat, sidomos brezi më i vjetër, ata më të moshuarit, të cilët e kanë njohur më për së afërmi. Unë kam biseduar me disa prej tyre, si: Sejdi Sulejmanin, Mulla Abdullahin, Mulla Asllanin, Bedri Dërvarin, Lirie Pacën e të tjerë, dhe kam marrë opinionet e tyre. Të gjithë thonë se Shaban Idrizi ishte një njeri i mirë, një atdhetar i kulluar, një njeri i ditur, një mësues i devotshëm e arsimdashës i flaktë. Duke qenë se kontributi i tij ka qenë shumë i madh jo vetëm në arsimimin dhe edukimin e brezit të ri, por edhe në rritjen e vetëdijes kombëtare në këtë mjedis, në emancipimin e përgjithshëm shoqëror etj., shumë më herët është dashur që shkolla e Zhabarit ose ndonjë institucion tjetër arsimor e kulturor të mbajë emrin e tij.

3.1.Kujtimet e Sejdi Sulejmanit, mësues veteran

Mësuesi Sejdi Sylejmani, i cili tash është në pension, nuk pritoi fare, edhe pse në moshë të shtyrë, të na rrëfejë për veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare, Shaban Idrizi. Ai jep portretin e tij fizik e moral të këtij njeriu. “Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kam punuar mësues në fshatin Zhabar. Duke qenë se ky fshat ka pasur një traditë të mirë të shkollimit, nuk e kemi pasur shumë vështirë sikurse mësuesit tjerë në mjediset tjera. Në këtë fshat më herët se në mjediset tjera janë mbjellë idetë përparimtare. Këtu më herët është zhvilluar mësimi në gjuhën turke – arabe. Pra, nxënësit që i ndiqnin mësimet fetare, mësonin kryesisht në gjuhën e huaj, kurse gjatë periudhës së LDB-së mësimi është zhvilluar kryesisht në gjuhën amtare. Dhe kjo ishte shumë më e lehtë.

Në kohën e Perandorisë Osmane këtu kanë punuar vetëm shkollat fetare, kurse nga viti 1912-1914, si dhe pas vitit 1918, kanë punuar vetëm shkollat në gjuhen serbe. Duket se këto rrethana Shaban Idrizi qysh në moshë të re tregoi një interesim të veçantë për shkollat dhe arsimin shqip. Ai u rrit me ndjenja kombëtare dhe që në fillim mori pjesë në lëvizjen kombëtare për çlirim nga sundimi osman.

Ai mori pjesë në një tubim (kuvend) popullor në Zhabar të Epërm, i cili u mbajtë në vitin 1910. Në atë tubim ishte i pranishëm edhe ideologu i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Hasan Prishtina. Aty u bë fjalë edhe për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe shkollimin e fëmijëve shqiptarë në gjuhën amtare. Hasan Prishtina kishte shtruar nevojën e dërgimit të disa të rinjve në Normalen e Elbasanit për t’u shkolluar e për t’u përgatitur si mësues.

Shaban Idrizi ishte njëri ndër të parët që ndihmoi shkollën në forma të ndryshme. Ai qe njëri ndër të parët që i dërgoi fëmijet e vet në shkollën fillore, të mesme e pastaj edhe në fakulte të ndryshme. Ai ishte iniciator kryesor për dërgimin e femrave shqiptare në shkollën shqipe gjatë viteve 1945-50, ishte organizatori kryesor për meremetimin e shkollës në vitin 1946, kurse një kohë ishte edhe kryetar i këshillit.

Në vitin 1948, kjo shkollë është shpallur si shkolla më e mirë në nivel të Kosovës, në bazë të një vizite që i kishin bërë inspekëtorët e asaj kohe, në krye me inspektorin e njohur Mehmet Gjevori.

Gjatë viteve 1945-48, me rastin e 28 Nëntorit -Ditës së Flamurit, Shaban Idrizi vishej me rroba kombëtare dhe i printe grupit të rinisë dhe folklorit nga fshati Zhabar e deri në Mitrovicë, duke manifestuar këtë ngjarje të rëndësishme të historisë sonë"[170].

3.2. Thërmija kujtimesh të Mulla Asllan Muratit

Biseda me Mulla Asllanin ishte mjaft e shkurtër, por shumë përmbajtësore. Ai, që në fillim shprehu gatishmërinë dhe kënaqësinë se mund të thotë diçka për Shaban Idrizin. Filloi të na rrëfejë për të parët, të cilit, si thotë ai, kanë arrdhur nga fshati Shllak i Malçsisë së Madhe të Shkodrës dhe se të afërm me fisin tonë janë edhe shokët tanë nga Bibaj, Jezerc, Llapashticë e Podujevës. Jemi të afërt e të një fisi gash edhe me banorët e fshatit Broboniq dhe Lubovec.

I pari i familjes që ishte vendosur në Zhabar, ishte Smajli, i cili kishte dy djem, Idrizin dhe Eminin. Idrizi, babai i mësuesit Shaban, kishte dy djem: Shabanini dhe Lamin. Shaban kishte pesë fëmijë, tre djem dhe dy vajza. Djemtë e tij kanë qenë: Jakupi, Ademi dhe Idrizi, kurse vajzat: Miradija dhe Eminja.

Idrizi, babai i mësuesit dhe veprimtarit të çështjes kombëtare, Shaban Idrizit, ishte njeri i mirë, i devotëshëm dhe i pasur. Familja e tyre ishin të njohur si dashamirëse e diturisë, solidare e bukëdhënëse. Qysh në atë kohë baca Idriz odën e vet e kishte shndërruar në shkollë, për edukim dhe mësim fetar, për të filluar më vonë edhe më shkollat shqipe, të cilat do të hapen, falë klubeve, shoqatave dhe aktiviteteve të ideologëve të lëvizjes kombëtare, si: Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Nexhip Dragës dhe Rexhep Mitrovicës etj.

Në oden e bacë Idrizit edhe pse mësimi zhvillohej për fenë, numri i nxënsëve arriti në tridhjetë. Ka rëndësi të veçantë të theksojmë për vetë faktin se në këtë lokalitet për herë të parë filloi mësimi të zhvillohej në odë ku, hoxha Mulla Selimi, ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim. Mullah Selimi jetonte në odën e bacës Idriz dhe merrte rrogën mujore. Këtu mësimet e para i mori Shaban Idrizi, i cili me ftesen e babait të tij Idrizit numri i nxënësve rritej gjithnjë e më shumë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore (1915-1918) Shaban Idrizi me vetëkontribut ka ndërtuar shkollën në oborrin ku sot gjendet shkolla e re. Derisa e ndiqte Kursin Pedagogjik, ai me mjetet e veta fillloi të ndërtojë shkollën në Zhabar. Në këtë drejtim e kanë ndihmuar edhe bashkëfshatarët e vet me punë vullnetare. Në atë kohë u ndërtua rruga prej Zhabarit në shkollë dhe nga shkolla për në Shipol në

[170]Sejdi Sylejmani, mësues veteran në pension, tetor 2011, Mitrovicë.

mënyrë që nxënësit ta kanë më lehtë të udhëtojnë. Më vonë kjo rrugë u qujat *"Kalldremi i Shaban Idrizit"*. Për ndërtimin e kësaj rruge ai pagoi 500 metra gurë dhe shtroi rrugën nga Zhabari i Poshtëm deri në Shipol[171]. Mullah Asllan Murati rrëfen se si ka pasur fatin të takohet me ish nxënësit e shkollës së Zhabarit, të cilët kishin vijuar mësimin gjatë viteve 1916-18 dhe që të gjithë dinin shkrim dhe lexim me alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe. Vlen të theksohet se kontributi që në atë kohë kishte dhënë Shaban Bella, pastaj mësusesi Asim Salihamixhiqi e të tjerë, ishte shumë i rëndësishëm.

Më kujtohet një rastë kur isha duke shkuar rrugës për në qytet. Ai shpesh rrinte para shtëpisë së tij që gjendet edhe sot afër shkollës fillore "Migjeni". Më ndali në rrugë dhe më pyeti se a e di a mos ka rënë, pra është zvogëluar numri i gazetës "Rilindja" dhe numri i lexuesve. Kërkoj nga ju, më tha, që si njeri komunikues, të bisedosh me njerëz në mënyrë që numri i parapagusve të gazetës "Rilindja" të rritet!"[172].

Pas vdekjes së Shaban Idrizit në vitin 1973, shkrimtari ynë i njohur, Nebil Duraku, së bashku me djalin e mësuesit Shaban, Jakup Idrizin, kishin kërkuar që shkolla e Shipolit që mbante emrin "23 Nëntori" – "dita e çlirimit të Mitrovicës", të pagëzohet me emrin e Shaban Idrizit, por komiteti i atëhershëm nuk lejoi, me arsyetimin se gjoja gjatë Luftës së Dytë Botërore, serbët e Shipolit e Zhabarit, paskan kërkuar ndihmën e Shaban Idrizit, i cili ua paska ofruar, pra u qenka përgjigjur se nuk mund t'u sigurojë asgjë për shkak se është gjendje lufte. Prandaj, ky qëndrim "oportunist" i tij është marrë si proteks që shkolla mos ta marrë emrin Shaban Idrizi[173].

3.3.Kujtime te dhembshme e krenare të mbesës së Shaban Idrzi, Lirie Pacës

Lirie Paci lindi më 11 korrik1943, në Prishtinë. Është e bija e dëshmorit Murat Paci, i cili u vra në vitin 1943, në kohën kur Liria kishte mbushur vetëm tre muaj. Vajza më e madhe e Shaban Idrizit, Miradia, ishte e martuar me Murat Pacën, i cili ishte sektretar i Tafil Boletinit. "Pas vrasjes së babait tim, gjyshi, i cili na ka dashur shumë, na ka marrë në mbrojtje. Ai më ka dashur shumë. Edhe unë pastaj jam lidhur shumë emocionalisht me gjyshin Shaban, sepse jam rritur te dajat! Gjyshi im, rrëfen më tej Liria, ishte shumë vigjilent, ishte reformator dhe shtylla e fshatit. Ai lexonte shumë. Ishte elegant, i gjatë, në kokë mbante safin, kurse rrobat i kishte kangar (shtof i vjetër). Ka pasur shtëpi në Mitrovicë dhe në Zhabar. Ai shoqërohej me intelektualë, tregtarë dhe esnafë. Është karakteristikë se ai kishte karrocë dhe kalë të bardhë, karroca quhej "qeze" dhe kishte formën e pajtanit. Gjyshi ka qenë njeri i ditur, prandaj shpeshherë ulej dhe më tregonte shumëçka. Ai ishte kundër botëkuptimeve patriarkale të së kaluarës,

[171] Fazli Hajrizi, Shaban Idrizi – jeta dhe vepra e tij, "Shkëndija, 14 prill 1998, Prishtinë.

[172]Mulla Asllan Murati nga Zhabari, imam në xhaminë e Zallit në Mitrovicë, marrë më 8 shtator 2012, Mitrovicë.

[173]Mulla Asllan Murati nga Zhabari, imam në xhaminë e Zallit në Mitrovicë, marrë më 8 shtator 2012, Mitrovicë.

Duke punuar e krijoi një autoritet, i cili më vonë u bë udhëheqës shpirtëror dhe njeri shumë i besueshëm. Ai e donte muzikën. Kënga më e preferuar e tij ishte *"Elbasan qytet i bukur"*.

Gjyshi gëzohej kur i lindnin nipat dhe mbesat. Shpeshherë ai i pagëzonte me emrat: Lirie, Naim, Shpresë, Besim, Drita, etj.

Ai më rrëfente se si veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare dhe i arsimit shqip në kohëra të liga kishte shkuar në Shqipëri për të sjellë Abetaret në gjuhën shqipe. Njëherë, duke kaluar lumin Valbona, iu kishin mërdhirë këmbët nga të ftohtit. Ai një kohë ishte burgosur për shkak të aktiviteteve kombëtare dhe si njeri i papërshtatshëm.

Gjyshi ishte shumë human. Ai ndihmonte të varfërit dhe të sëmurët. Jepte këshilla edukuese. Gjyshi që nga viti 1970, filloi të lodhej nga pleqëria, prandaj ne mbesat dhe nipat jemi kujdesur për të me ndërrime.

Ai kishe ide përparimtare dhe kjo shihej në emancipimin e familjes së tij. Kishte ndikuar, të gjitha vajzat e kishin të kryer shkollën fillore në gjuhën serbokroate dhe qysh në atë kohë vajzat i ka martuar pa ferexhe. Falënderoj të gjithë ata që kanë hedhur dritë dhe bëjnë përpjekje që të ndriçojnë jetën dhe veprimtarinë e gjyshit tim, i cili ka qenë shpirt njeriu dhe, me të drejtë, çmohet si mësuesi i pare në Zhabar e më gjerë. Sot me plot të drejtë shkolla e fshatit Zhabar mban emrin e tij[174].

[174] Bisedë me Lirie Pacën, mbesë e mësuesit Shaban Idrizi, gusht 2012, Prishtinë.



Një letër e mësuesit Shaban Idrizi dërguar mbesës së tij, Lirie Paca

3.4.Kujtime të mulla Avdullahit për mësuesin Shaban Idrizi

Duke qenë se është në interes të kësaj monografie që të dalë sa më e formësuar, intervistuam edhe bashkëfshatarë, njerëz të moshave të ndryshme, bashkëkohanikë të mësuesit e veprimtarit Shaban Idrizi. Biseduam edhe me Mulla Avdullahin, i cili, edhe pse në moshë të shtyer, na priti ngrohtësisht në shtëpinë e tij. Ai filloi të na rrëfejë se si Shaban Idrizi ishte rritur me babain e tij, mulla Rexhepin. “Babai i Shaban Idrizit e kishe marrë një hoxhë nga medreseja e Shkupit për të mësuar djalin e vet, por ai kishte ftuar edhe fëmijë të tjerët të fshatit për të mësuar për fenë.

Ndër të parët që shkoi për të mësuar te hoxha nga Shkupi, ishte babai im, Rexhepi. Babai im ia ka parë hajrin sepse më vonë shkoi në medrese në Mitovicë dhe më vonë u bë hoxhë. Shaban Idrizi shoqërohej gjithnjë me babain tim dhe shpeshherë, si në mahi, i thoshte, pse ti mulla Rexhep, u bëre hoxhë, kurse unë ende jo.

Kur ne filluam ta ndërtojmë shtëpinë, shpesh vinte për të na shtuar moralin. Na thoshte se për të na ndihmuar nuk mundet, sepse është plak, mirëpo vinte për t'u kënaqur sepse i vinte mirë se po e zgjidhnim çështjen e banimit.

Shabani ka qenë punëtor dhe i dhënë pas shkollës. Ai kënaqej kur shihte e dëgjonte gjëra të mira. Njëherë disa veta nga fshati u përgaditëm për të shkuar në haxh. "A po vjen me ne axha Shaban?" – i thamë si me shaka. "Unë vij vetëm me një kusht që, kur të kthehemi, askush të mos të më thërrasë haxhi!"

Kur shkonim nëpër oda, mua më merrte babai me vete. Më kujtohet mirë kur Shabani i bënte babës shumë iqram (e respektonte). Shpeshëherë, kur i thoshin Shabanit të flasë diçka, ai përgjigjej shkurt: *"Si të flas unë kur këtu është mulla Rexhepi!"*

Shabani dhe baba im u kushtonin shumë rëndësi miqve, shokëve dhe vëllazërisë. Çdo mosmarrëveshje apo ngatërresë që bëhej, këta të dy ndërmjetësonin dhe i pajtonin. Unë shpesh kam shkuar nëpër mevlude dhe kemi kënduar bashkë me Shabanin. Ai ka pasur zë të mirë dhe e dinte nakamin.

Unë sot jam plak me mjekër të bardhë, prandaj e mbështes këtë iniciativë tuajën për të ndriçuar jetën dhe veprën e Shaban Idrizit dhe të gjithë atyre që kanë kontribuar për popull, atdhe e fe. E kemi për detyrë që t'u jepet haku të gjithë atyre që kanë dhënë shumë për këtë vend.[175]

[175] Bised me Mulla Avdullahu Imam ne xhaminë e Zhabarit, Qershor, 2012

P Ë R F U N D I M I

Arsimi është një nga segmentet më të rëndësishme të shoqërisë. Është një kategori kombëtare me karakter universal. Arsimi në gjuhën shqipe në Mitrovicë ka zënë fill në agom të shek XX. Deri në këtë kohë kanë ekzistuar vetëm disa shkolla të ulëta në gjuhën turke, ku i ndiqnin mësimet edhe të rinjtë shqiptarë. Në to jepnin mësim edhe disa mësues shqiptarë, të cilët ishin shkolluar në Stamboll, në Shkup, në Prishtinë, në Manastir e vende tjera. Kërkesat e popullatës shqiptare të këtij mjedisi për të hapur shkolla edhe në gjuhën shqipe, si ato që u hapën në Korçë, Elbasan, Tiranë, Shkodër, Shkup, Manastir, Prizren, Janjevë etj., kanë qenë të vazhdueshme. Shkolla e parë shqipe që u hap për herë të parë në Mitrovicë në kohën e Revolucionit Xhonturk (1908), fatkeqësisht nuk pati jetë të gjatë për shkak se atë e mbyllën organet qeveritare turke.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, kur pjesa më e madhe e Kosovës u pushtua nga Austro-Hungaria, popullatës shqiptare të këtij mjedisi iu mundësua që të hapin shkollat në gjuhën e tyre amtare. Kështu, pos në Mitrovicë dhe në disa fshatra përreth, u hap shkolla shqipe edhe në Zhabar (1916). Mësues i parë i kësaj shkolle ishte Shaban Idrizi, i cili ka pasur si ndihmës edhe mësuesin e fesë Hajrullah (Hajrë) Haxhinë nga Vaganica. Në këtë shkollë, e cila ka pasur karakter të përgjithshëm popullor, i vijonin mësimet nxënësit e këtyre fshatrave: Zhabar i Poshtëm, Zhabar i Epërm, Shipol, Lushtë, Vaganicë, Vinarc etj.

Pas përfundimit të LPB dhe ripushtimit të Kosovës nga forcat ushtarake serbe, Mbretëria SKS i mbylli të gjitha shkollat në Kosovë, pra edhe atë të Zhabarit. Në disa mjedise, sidomos ku kishte popullatë serbe e malazeze Mbretëria Jugosllave hapi shkolla në gjuhën serbe, ku i ndiqnin mësimet një numër simbolik i nxënësve shqiptarë. shqiptarët ishin jo vetëm të pabarabartë, por ata diskriminoheshin në forma të ndryshme.Pushteti ndalonte çdo aktivitet arsimor e kulturor në gjuhën amtare shqipe.Çdonjëri që dispononte ndonjë libër shqip, ndiqej e burgosej pa mëshirë. Kjo gjendje dhune e terrori shtetëror zgjati deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, kur Gjermania sulmoi Jugosllavinë dhe e detyroi që të kapitullojë. Pushtuesi i ri u dha të drejtë shqiptarëve që të vetëqeverisin, të organizojnë administratën, të hapin shkolla në gjuhën amtare etj. Kështu, në Mitrovicë dhe në disa fshatra përreth, si: në Suhodoll, në Zasellë, në Boletin, në Koshtovë, në Zhabar, në Broboniq, në Vllahi, në Melenicë etj., u hapën shkolla në gjuhën shqipe, të cilat kanë luajtur një rol shumë të madh në arsimimin e edukimin e brezit të ri, në rritjen e vetëdijes kombëtare etj. Shkolla fillore katërklasëshe, e cila u hap në Zhabar, u pagëzua "Naim Frashëri", emri i poetit tonë më të shquar të Rilindjes Kombëtare. Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore në shkollën e Zhabarit kanë punuar dy mësues: ***Reshat Damati*** dhe ***Musa Kalaja***.

Pas ripushtimit të Kosovës (nëntor 1944) dhe instalimit të regjimit komunist jugosllav, u rihapën shkollat ekzistuese dhe të tjera, madje edhe në zonat më të thella. Kjo ishte kërkesë e popullatës shqiptare, e cila përspektivën e vet e shihte vetëm në dritën e arsimimit të përgjithshëm. Duke qenë se në Zhabar ekzistonte objekti shkollor dhe ky mjedis kishte një traditë të mirë të arsimimit në gjuhën

amtare, në fund të vitit 1944, u hap shkolla në gjuhën shqipe, ku jepnin mësim këta mësues: ***Sejdi Sulejmani*** dhe ***Isak Buçinca***. Në vitet e pasluftës deri në fillim të viteve gjashtëdhjetë kanë punuar mësuesit, si: ***Ibrahim Koka, Melihate Sadiku – Hoti, Bedri Hamza, Sofije Fetahu, Qelebije Peja, Igballe Çuni etj.***

Deri në shtator të vitit 1975, shkolla e Zhabarit ka funksionuar si e pavaruar. Në fillim të vitit shkollor 1975/76, ajo iu bashkëngjit shkollës së Shipolit. Kështu, prej atëherë e deri në gusht të vitit 2008, shkolla e Zhabarit ka punuar si paralele e ndarë e shkollës fillore "Fazli Greiçevci" (ish "29 Nëntori") të Shipolit.

Në vitin shkollor 2007/08 filluan punimet për ngritjen e objektit të ri shkollor në Zhabar. Më 29 gusht 2008, kjo shkollë, e cila deri në këtë kohë ishte pasralele e ndarë e shkollës së Shipolit, u pavarësua dhe u pagëzua me emrin Shaban Idrizi, mësuesit të parë të saj e veprimtarit për çështje kombëtare

Literatura

1.Arkivi i shtetit në Tiranë

2.Arkivi ndërkomunal në Mitrovicë

3.Haziri, Mustafë, monografi për "Shaban Idrizin", Prishtinë, 2012

4.Haziri, Mustafë, "Greva e minatorëve të Trepçës në Stan-Tërg" Prishtinë, 2011

5.Fazli Hajrizi, Mitrovica dhe Shala e Bajgorës në fokusin e historisë, Shtëpia Botuese "Libri shkollor", Prishtinë, 2011

6.Hajrizi, Fazli, "Jeta dhe vepra e mësuesit Shaban Idrizi", revista "Shkëndija, 14 prill 1998, Prishtinë

7.Shatri, Bajram, "Arsimi fillorë në Kosovë", Prishtinë, 2006

Kujtime dhe dëshmi

8Intervista me Sejdi Sylejmani, mësues veteran në pension, tetor 2011, Mitrovicë.

9.Intervista me Lirie Pacën, mbesë e mësuesit Shaban Idrizi, gusht 2012, Prishtinë.

10.Intervista me Mulla Avdullahu Imam ne xhaminë e Zhabarit, Qershor, 20

11.Mulla Asllan Murati, imam në xhamin e Zallit në Mitrovicë, intervista me të u realizua më 8 shtator 2012 në Mitrovicë.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

NJË KËNDVËSHTRIM PËR ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE KULTURËS

MBA. Olda Çiço,-Sh.L.U.P. "Universiteti Metropolitan Tirana",

Msc. Iris Çiço-A.R.S Legal & Financial Services, , Qëndra Sun Toër,Tiranë, Shqipëri

PËRMBLEDHJE

Bazuar në teoritë e komunikimit dhe përparimet në shkencën e menaxhimit kulturor, ky punim synon të tregojë parimet e komunikimit, të cilat prekin në të gjitha format e mënyrat individët në marrëdhënie të përditshme e saktësisht në ato të punës. Të përcaktosh komunikimin dhe të tregosh si mund të bëhet efektiv, është një sfidë. Komunikimi përcaktohet sipas kanaleve të përcaktuara të komandim-drejtimit. Çdo lloj linje në organigramën përkatëse perfaqëson linjën e autoritetit dhe marrëdhëniet e raportimit.

Përmenden dhe shpjegohen disa nga mangësitë e këtij procesi, të cilat e bëjnë zinxhirin e komandimit joefektiv. Kufiri, në të cilin menaxherët dhe punonjësit bien dakord rreth çështjeve të punës, të cilat janë të ndjeshme për pikëpamjen e secilit, tregon komunikim të mirë. Në përgjithësi, menaxherët dhe punonjësit, ndryshojnë në perceptimet e tyre për çështje të ndryshme.

Komunikimi joverbal i referohet komunikimit të një mesazhi jo përmes të folurit e të shkruarit, por me mjete të tjera. Ai mund të japë idenë e vërtetë të mesazhit, atë për të cilin fjalët nuk mjaftojnë.E rëndësishme është të merret parasysh efekti i kulturës nga vijnë individët të cilët janë pjesë e bashkëbisedimit.

Ka dallime gjuhësore që vihen re të parat në komunikimin midis individëve apo grupeve që janë pjesë e kulturave të ndryshme. Një komunikim i mirë ndihmon në marrëdhëniet e punës dhe shumëfishon aftësitë e tjera në raport me të tjerët.

Fjalët kyç: Komunikim, Joverbale, Kulturë, Përmirësim

ABSTRACT

Based on communication theories and the science of cultural management, this paper aims to show the principles of communication, which affect in all forms and ways individuals in everyday relationships and exactly in the workplace. Determining communication and showing how it can be effective is a challenge. Communication is defined according to defined command-line channels. Each line in the relevant organizational chart represents the line of authority and reporting relationships.

Some of the shortcomings of this process are mentioned and explained, which lead to the ineffectiveness of command-line. The boundary in which managers and employees agree on work issues, which are sensitive to each other's point of view, leads to the good communication. Generally, managers and employees differ in their perceptions of different issues.

Nonverbal communication refers to the communication of a message not through speech and writing, but by other means. He can give the true idea of the message, the one for which the words are

not enough. It is inevitable to take into account the effect of culture on coming individuals who are part of the conversation.

There are linguistic differences that are seen as the first matter in communication between individuals or groups that are part of different cultures. Good communication helps work relationships and multiplies skills in relation to the others.

Keywords: Communication, Nonverbal, Culture, Improvement

HYRJE

Të përcaktosh komunikimin dhe të tregosh si mund të bëhet efektiv, është një sfidë, pavarësisht nga studimet që janë bërë deri më tani. Me përkufizim, komunikimi është procesi përmes të cilit informacioni shkëmbehet midis dërguesit dhe marrësit. Lloji i komunikimit për të cilin flet ky punim është ai ndërpersonal. Lloji i tij më i thjeshtëështë komunikimi mes dy individëve në ambjentin e punës. Dërguesi duhet të kodojë mendimin e tij në disa forma, në mënyrë që t'i transmetohet marrësit. Format mund të jenë: i drejtpërdrejtë apo me gojë, me e-mail, me takime zyrtare ku prezantohen fjalime apo çdo formë tjetër që kodi i etikës përmban në komunikimin zyrtar. Marrësi i mesazhit i dekodon ato sipas mënyrës apo perceptimit të tij. Edhe pse duket e thjeshtë, në këtë proces, ekzistojnë gjithnjë të ashtuquajturat "zhurma".

Bazuar në rastin e mësipërm që shpjegon procesin e komunikimit, këto zhurma mund të jenë: linjë interneti e dobët, e cila bën që e-mail-i të mos mbërrijë në kohën e duhur, duke vështirësuar kthimin e përgjigjes apo më keq, mosrealizimin e detyrës; mospjesëmarrje në takim për të dëgjuar me zë e figurë komunikimin zyrtar; moskuptimi i termave teknikë apo shkurtimeve të ndryshme; një paraqitje emocionale e mendimit që ka lidhje me punën; çdo faktor tjetër që prek procesin e kodimit apo dekodimit të mesazhit. Pavarësisht nga arsyet, masa e 'zhurmës" përbën masën e shmangies nga ideja fillestare.

Në një botëtë përkryer, kodimi e dekodimi do të ishin dy anë të së njëjtës medalje, por të gjithë jëmi të ndërgjegjshëm që kjo nuk mund të ndodhë. Sfida është që kjo përshtatje t'i afrohet njëqind për qindëshit sa më shumë të mundet.

1. A. BAZAT E KOMUNIKIMIT NË ORGANIZATË

Komunikimi përcaktohet sipas kanaleve tëpërcaktuara të komandim-drejtimit. Çdo lloj linje në organigramën përkatëse perfaqëson linjën e autoritetit dhe marrëdhëniet e raportimit. Kështu, me kanal komandimi do të kuptojmë linjat e autoritetit dhe marrëdhëniet formale të raportimit. Teorikisht, komunikimi në organizatë duhet të ndjekë kanalet e përcaktuara të komandimit dhe realizohet përmes tre formave:

a. Komunikimi nga lart-poshtëështë qarkullimi i informacionit nga menaxheri i nivelit të lartë drejt punonjësve sipas shkallëve hirearkike. Përshembull, në një kompani prodhimi, zëvendëspresidenti për prodhimin instrukton menaxherin e fabrikës, i cili i jep detyra menaxherittë planifikimit. Ky i fundit përcakton specifikat për supervizorët, të cilat ua transmetojnë ato punonjësve.
b. Komunikimi nga poshtë-lart është qarkullimi i informacionit nga punonjësit drejt menaxherëve të nivelit të lartë sipas shkallëve hirearkike. Nëse i qëndrojmë shembullit të mësipërm, kahu i kundërt i komunikimit do të ishte shembulli mëi mirë si përgjigje ndaj specifikimeve të kërkuara. Mund të japim shembullin e një komunikimi të tillë si përshembull një inxhinier kimist i cili ka krijuar një formulë të re dhe ia dërgon e shpjegon këtë menaxherit të

departamentit të kërkim-zhvillimit dhe ky i fundit informon zëvendëspresidentin apo presidentin e kompanisë.

c. Komunikimi horizontal është qarkullimi i informacionit midis departamenteve apo njësive funksionale, e thënë ndryshe koordinimi i përpjekjeve të këtyre njësive, të cilat janë ojesë e të njëjtit trup.

Realiteti i komunikimit në organizatë tregon se zinxhiri formal i komandimit nuk është një rrugë e plotë në funksion të komunikimit efektiv. Vetë menaxherët e pranojnë se ndjekja strikte e zinxhirit të komandimit është shpesh joefektive.

1. B. MANGËSITË E KOMUNIKIMIT NË ORGANIZATË

Më poshtë përmenden dhe shpjegohen disa nga mangësitë e komunikimit, të cilat e bëjnë zinxhirin e komandimit joefektiv.

a. Komunikimi informal, i cili është pashmangshëm për sa kohë individët komunikojnë me njëri-tjetrin. Komunikimi informal mund të shpërndajë pasiguri, thashetheme dhe të dëmtojë kryerjen e punëve në organizatë.

b. Filtrimi, i cili është prirja që një mesazh të përcillet i ekzagjeruar ose të mos jepet një pjesë e tij gjatë transmetimit. Rezultati është dëmtim i organizatës në sasi e cilësi dhe arritjen e objektivave. Kështu, një drejtues mund të kërkojë të vendosë autoritet duke "fryrë" urdhërat e drejtuesve të tij në momentin që ua përcjell vartësve. Ose, vartësit mund të lenë mënjanë një pjesë të informacionit që duhet dërguar në nivele më të larta. Në zgjidhje është gjetur në disa kompani, duke ndjekur "politikën e dyerve të hapura", ku çdo punonjës ka të drejtë të shkojë tek menaxheri i një niveli më lart, nëse ndjen se ka probleme komunikimi menaxherin e linjës së vet.

c. Ngadalësimi. Edhe kur nuk ka probleme filtrash apo komunikimi informal, informacion, edhe pse i përçuar besnikërisht, mund të vonohet. Kjo është dukuri më e qartë tek komunikimi horizontal.

Në përgjithësi, komunikimi informal, njohja e filtrimit, vështirësive dhe pengesave të kohës, sigurojnë që organizata do të zhvillojë kanalet e komunikimit përtej zinxhirtit strikt të komandimit.

2. SA I MIRËËSHTË KOMUNIKIMI MENAXHER-PUNONJËS ?

Kufiri në të cilin menaxherët dhe punonjësit bien dakord rreth çështjeve të punës , të cilat janë të ndjeshme për pikëpamjen e secilit, tregon komunikim të mirë. Në përgjithësi, menaxherët dhe punonjësit, ndryshojnë në perceptimet e tyre në lidhje këto çështje :

- Si e shpenzojnë kohën punonjësit ?
- Sa kohë merr mësimi i një procesi pune ?
- Si është lidhja punë-pagesë ?
- Çfarë autoriteti ka vetë punonjësi?
- Cilat janë aftësitë dhe mundësitë që kanë vetë punonjësit?
- Si dhe sa është performanca e punonjësve ?
- Cili është modeli i lidershipit që zbatojnë menaxherët e që duan të ndjekin punonjësit ?

Barrierat në komunikimin menaxher-punonjës materializohen në tre drejtime të ndryshme :

a. Konflikti i kërkesave të rolit. Roli i lidershipit kërkon menaxherë që të ndjekin të dy drejtimet, funksionin e detyrës dhe atë social-emocional. Shumë menaxherë e kanë të vështirë të gjejnë ekuilibrin mes këtyre dy roleve.

b. Efekti i heshtjes i referohet prirjes për shmangien e komunikimeve të panevojshme për të tjerët. Shpesh, njerëzit pranojnë si zgjidhje më të mirë heshtjen se sa dhënien e informacioneve të

këqia që mund të provokojnë reaksione negative. Menaxherët evidentohen si shmangës të komunikimeve të këqia, duek filluar nga momenti i vlerësimit të performancës së punonjësve. Por, shpesh, menaxherët dhe punonjësit e tyre kanë perceptime të ndryshme lidhur me performancën e punonjësve.

c. Komunikimi informal (thashethemet-fjalëpërhapja). Zakonisht mendohet që thashethemet janë vetëm fjala e gojës, por si të tilla mund të shërbejnë edhe shënimet e mbajtura keq, dërgimi i informacionit nëpërmjet "korrierit" të gabuar apo vendosje fizike jo e drejtë sipas detyrave. Por, rrjeti i thashethemeve mund të menaxhohet nga organizata në dy mënyra: e para, mund të përdoret për të transmetuar një informacion për të parë reagimin e punonjësve, para se te bëhet zyrtare; e dyta: kur kërkohet përhapësi i thashethemeve dhe për këtë jepet një informacion jo i vërtetë për të parë se kush e qarkullon.

Një çështje për t'u diskutuar është "zhargoni", që do të thotë gjuhë e specializuar, e veçantë, që përdoret nga punëdhënësit, nga pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme apo nga organizatat. Problemi i vetëm i zhargonit është se mund të mos kuptohet nga të tjerët jashtë grupit, ndërkohë që brenda komunitetit është normal. Dikush duhet ta verë në dukje këtë për t'u korrigjuar sa janë në kohë dhe për të shmangur konfuzionin.

3. KOMUNIKIMI JOVERBAL

Komunikimi joverbal i referohet komunikimi të një mesazhi jo përmes të folurit e të shkruarit, por me mjete të tjera. Mundet që ai të japë idenë e vërtetë të mesazhit, atë për të cilin fjalët mund të krijojnë mjegullnajë. Ka disa shembuj për të treguar llojet e komunikimit joverbal.

a. Gjuha e trupit është komunikim joverabl dhe përfshin lëvizjet e trupit, shprehjet e fytyrës dhe vendndodhjen fizike të dërguesit. Në përgjithësi, dërguesit komunikojnë pëlqimin dhe interesin kur :

- Pozicionojnë veten e tyre fizikisht para marrësit
- Prekin marrësin gjatë ndërveprimit
- Mbajnë kontaktin me sy me marrësin
- Mbështeten para dhe gjatë ndërveprimit
- Drejtojnë gjoksin drejt marrësit
- Vendosin rastësisht duart dhe këmbët në një pozicion të caktuar
- Qëndrojnë gjysëm shtrirë apo nuk ngrihen nag pozicioni ulur
- Tregojnë ose aktivitet nervoz

b. Zbukurimet, artifaktet dhe veshja

- Dekori i zyrës dhe zbukurimet e vendosura aty janë një tregues i komunikimit joverbal. Ato tentojnë të tregojnë statusin e personit apo personave që punojnë aty, pozicionin që ata kanë, imazhin që ka kompania në përgjithësi. Nëse në një zyrë punon më shumë se një person, mënyra e vendosjes së mjeteve të punës tregon statusin e secilit prej tyre. Një problem që mund të ndodhëështë kur individët vendosin zbukurime mbi tavolinat e punës, për të cilat ekziston një parim i mirëpranuar që të jenë të natyrës familjare serioze, në të kundërt do të krijonin situata jo të mira. Kjo vlen nëse ata mbajnë sende personale aty. Ndërkohë, nëse zbukurimet janë pjesë e inventarit të kompanisë, ka persona përgjegjës për çdo send që vendoset aty.
- Veshjet ose "garderoba" e individit që punon në një vend pune, janë një element i dukshëm parësor për të treguar pozicionin e punës dhe krijimin e imazhit personal. E rëndësishme është që kjo paraqitje vlen që nga momenti i intervistës për punë.

c. Ndryshimet gjinore në komunikim janë një element i komunikimit joverbal. Studimet kanë gjetur se femrat dhe meshkujt kanë ndryshime në komunikim që vijnë që nga fëmijëria. Në përgjithësi, vajzat e shikojnë komunikiminsi mënyrë për të krijuar marrëdhënie, rrjet dhe

intimitet, ndërsa djemtë si mënyrë për të arritur status. Ndryshimet gjinore në komunikim rrotullohen rreth asaj qëDeborah Tannen perifrazon "kush do mbijetojë, kush do mbetet pas".Bazuar në kërkimet e Deborah Tannen, ndryshimet kyçe në komunikim mes femrave e meshkujve dhe ritualet që i vendosin femrat në pozita inferioriteti, janë:

- Besimi dhe mburrja, më e dukshme tëk meshkujt
- Kërkimi i llogarisë, nga vetë natyra e meshkujve
- Kërkimi i ndjesës që femrat e shprehin më lehtë se meshkujt
- Dhënia e feedback-ut, e cila nga ana e femrave përdoret më shumë për të amortizuar kritikën, ndërsa nga meshkujt e kundërta
- Komplimentet për punën
- Kundërshtime të vazhdueshme
- Menaxhimi në nivele të ndryshme
- Komunikimi indirekt

Meqënëse komunikimi edhe në jetën e përditshsme është i ndërthurrur me kulturën, për studiues të shumtë bëhet i pandashëm prej saj. Shpeshherë, mund të kuptosh më shumë nga sjellja e një individi, e cila është rrjedhojë e kulturës së vet të origjinës, se sa nga fjalët e tij. Mesazhet e dhëna nëpërmjet sjelljeve janë të ndërlikuara nëse nuk njihet kultura përkatëse. Ato marrin kuptim sipas kontekstit ku e kur ndodhin. Nëse do të krahasonim rëndësinë e mesazheve verbal me ato joverbale, individët tentojnë më shumë nga kjo e dyta. Për referencë, ashtu si në shkrimin e shifrave me numra dhe fjalë, ku merret parsysh saktësimi me fjalë, në komunikimin verbal kundrejt atij joverbal, merret parasysh saktësimi me këtë të fundit, sepse ai është saktësisht përfaqësues i kulturës përkatëse.

4. KOMUNIKIMI MIDIS KULTURAVE

Ka dallime gjuhësore që vihen re të parat në komunikimin midis individëve apo grupeve që janë pjesë e kulturave të ndryshme. Kjo nuk do të përbënte problem për një shembull siç është komunikimi mes grupeve të interesit amerikane me ato britanike, por sigurisht do të kishte probleme mes grupeve të interesit japonezë dhe norvegjezë. Pra, është i rëndësishëm konteksti kulturor. Me kontekst kulturor kuptohet informacioni kulturor që rrethon një episod komunikimi. Ai prek kodimin dhe dekodimin e mesazhit. Një ndarje e njohur në literaturëështë ajo që përcakton kulturat me nivel të lartë dhe ato me nivel të ulët të kontekstit kulturor.

Njerëzit nga kultura me kontekst të lartë, duan të marrin më shumë informacion për punonjësin vetë dhe për organizatën, në mënyrë që të krijojnë kontekstin e bisedës dhe të përparojnë në negociata.në këto kushte, nuk është modeli i komunikimit që favorizon njerëzit në kontekstin e kulturës së lartë, por prezantimet dhe takimet ku njerëzit njihen me njëri-tjetrin, duke siguruar propozime biznesi.Gjithashtu në këto lloj kulturash, ka rëndësi mosha dhe pozicioni në shoqëri i komunikuesit.

Njerëzit nga kultura me kontekst të ulët, priren të favorizojnë kontrrata biznesi shumë të detajuara, duke e zhvlerësuar kontekstin kulturor. Kuptimi për ta është mesazhi në vetvete. Kulturat me kontekst të lartë vendosin më pak theksin tek kontratat e gjata, sepse konteksti ku ato nënshkruhen është kritik.

Komunikimi joverbal midis kulturave është një element tjetër që duhet marrë parasyshdhe kjo mund të ilustrohet me disa elementë :

a. Shprehjet e fytyrës : amerikanët përshembull mund të shprehin lehtësisht inatin, surprizt, frikën, dëshpërimin përmes shprehjeve të fytyrës. Ndërkohë, në Japoni, rrudhja e vetyllave jep mesazhin e « të pakuptueshmes ».
b. Gjestet : amerikanët përshembull tregojnë me gishtin e madh miratimin për një procedurë apo fakt, por në Afganistan, tregon mosmiratim deri në kuptimin si sulm. Ose, amerikanët përdorin gishtin e madh në formën e rrethit si « OK", ndërsa në Francë, kjo ka kuptimin e zeros ose

diçkaje pa vlerë. Një rast tjetër është ai tundjes së kokës që në SHBA ka kuptimin e miratimit, ndërsa në në vende si Greqia, Italia, Shqipëria, shpesh do të thotë « jo ».

c. Vështrimi : ka ndryshim të madh kulturor kur përdoret vështrimi. Shmangia e tij nënkupton mungesën e respektit në vende si Amerika e Veriut apo Arabia,ndërkohë qëështë tregim i respektit të mos vështrosh në sy në vendet e Azisë Lindore.

d. Prekja : është normale që të prekësh bashkëbiseduesin në vende si Europa e Jugut, Amerika Latine apo vendet arabe. Ndërkohë qëështë normale mbajtja e distancës në vendet e Amerikës së Veriut apo Europës Perëndimore. Kjo përfshin edhe pozicionet e të ulurit.

Marrëveshjet sociale mes kulturave të ndryshme janë marrëveshje të nënkuptuara e të mirëpranuara nga palët në momentin që kemi të bëjmë me marrëveshje të natyrës së biznesit apo diplomatike mes përfaqësuesve të vendeve të ndryshme. Për ta ilustruar, po japim në tabelë kuptimin e përshëndetjes « tungjatjeta » në vende të ndryshme të botës :

Tabela 1: Të thuash « tungjatjeta » në vende të ndryshme të botës

Vendi	**Mënyra si thuhet « tungjatjeta »**
Japoni	Përkulje deri në ulje në pozicion 90 gradë
Indi	Vendosje e duarve në gjoks në pozicion lutjeje me pak hark
Lindje e Mesme	Selam : dora e djathtë lëviz pak, prek në fillim zemrën, pastaj ballin, pastaj lëviz paksa në ajër
Rusi	Fillohet me shtrëngim duarsh e pastaj përqafim

Është interesante si prek komunikimi marrjen e vendimeve. Për këtë, literatura përfshin disa mënyra për të klasifikuar llojet e vendim-marrësve. Për shembull, tiparet e personalitetit të Jung-ut sollën si rezultat testin e Treguesit të Tipit Myers-Briggs. Rowe dhe Boulgarides (1983) propozouan një model të stileve të vendimit, i cili njeh ndikimin e vlerave dhe perceptimeve. Modeli është paraqitur në figurën 2 dhe tregon se vendim-marrësit janë të nxitur nga katër forca.

Tabela2. Modeli Rowe dhe Boulgarides

I lartë

ANALITIK Nevojë e fortë për arritje (në formën e sfidave)	KONCEPTUAL Nevojë e fortë për arritje (në formën e mirënjohjes)
DREJTUES Nevojë e fortë për pushtet	I SJELLJES Nevojë e fortë për përkatësi

I ulët

I orientuar nga detyra I orientuar nga njerëzit

Katër forcat : drejtuese, analitike, konceptuale dhe të sjelljes, mund të jenë të lidhura me Tipologjinë e Nevojave të zhvilluar nga McClelland (1962). McClelland fillimisht propozoi që sjellja është e motivuar nga nevoja për pushtet, arritje dhe përkatësi. Më pas, ai pranoi se nevoja për arritje shfaqet në dy mënyra të ndryshme : nëmënyrë të brendshme, duke ndërmarrë sfida të reja ose në mënyrë të jashtme, duke marrë lëvdata dhe mirënjohje. Sipas tipologjisë së dhënë nga Rowe dhe Boulgarides, nevoja kryesore e drejtuesve vendimmarrës është ajo për pushtet. Ata janë të orientuar nga rezultati, por gjithashtu duan

të dominojnë të tjerët. Ata kanë tolerancë të ulët për dykuptimshmërinë dhe preferojnë nivele të ulëta të kompleksitetit të njohjes. Kjo preferencë kufizon sasinë e informacionit që ata mbledhin dhe numrin e alternativave që marrin parasysh.

Vendim-marrësit analitikë kanë një nevojë të fortë për arritjen, në formën e sfidave të reja. Ata kanë tolerancë më të madhe për dykuptimshmërinë se sa homologët e tyre të drejtimit. Ata marrin vendime ngadalë, sepse duan të shqyrtojnë situatën në tërësi dhe të konsiderojnë alternativat shumë sistematikisht.

Vendimmarrësit konceptualë janë të orientuar nga arritja si homologët e tyre analitikë, por vdesin për shpërblime jokarakteristike, të tilla si falënderime, mirënjohje dhe pavarësi. Ata janë të kënaqur me një shkallë të lartë të kompleksitetit të njohjes dhe gjithashtu kanë një orientim të fortë ndaj njerëzve.

Vendim-marrësit konceptualë zakonisht mbledhin informacione nga burime të shumta dhe marrin parasysh shumë alternativa. Janë të nxitur kryesisht nga nevoja për përkatësi. Ky lloj drejtuesi ka të ulët kompleksitetin e njohjes, por të fortë orientimin nga njerëzit.

Si "një programim kolektiv i mendjes që e dallon një kategori njerëzish nga një tjetër"(Hofstede, 1980), vlerat kulturore në nivel kombëtar ose shoqëror ka të ngjarë të ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve.

Komunikimi ndërkulturor është bërë sfidues për shkak të teknologjisë. Sot shumë takime zhvillohen online, me ndërmjetësimin e teknologjisë dhe për këtë arsye, koha e përshtatjes me individë të kulturave të ndryshme është shkurtuar shumë. Çështja shtrohet a ka sjellë përmirësim në vendimmarrje përdorimi i teknologjisë për shitjet, prodhimin, të ardhurat, investimet apo ka shtuar problemet. Në të vërtetë, ky lloj komunikimi kërkon njohuri më të gjëra edhe në fushën e shkrimit për t'iu përshtatur kulturave të ndryshme. Edhe një e-mail i thjeshtë mund të shkaktojë problem nëse nuk është formalizuar si duhet dhe nëse nuk dërgohet në kohën e duhur. Kjo e fundit, duke marrë parasysh fashat orare të botës dhe rregullat etike të dërgimit të mesazheve të biznesit.

5. PËRQASJE PËR PËRMIRËSIMIN E KOMUNIKIMIT

Shumë njerëz janë duke mësuar se zhvillimi i aftësive të tyre komunikueseështë po aq i ndjeshëm dhe i rëndësishëm sa aftësitë për teknike, kompjuterike apo menaxheriale. Një komunikim i mirë ndihmon në marrëdhëniet e punës dhe shumëfishon aftësitë e tjera në raport me të tjerët. Gjithashtu, bën të mundur përparimin në karrierë. Më poshtë listohen disa parime bazë të komunikimit efektiv:

a. Kushtojini kohën e duhur! Në veçanti, menaxherët, një pjesë të mirë të kohës së punës e zënë me komunikimin. Për këtë arsye, duhet që kjo kohë të jetë efektive. Ky aspekt përfshsin edhe formën e komunikimit, e cila do të jetë në varësi të qëllimit që do të përmbushë komunikimi. Për më tepër, pritja e feedback-ut kërkon kohën e vet, duke shtuar vlerën e komunikimit dhe rikomunikimit.
b. Pranoni bashkëbiseduesin ashtu siç është! Të veprosh si arrogant apo të shfaqesh si superior është një gabim infantil, i cili ka pasoja për njësinë ku punohet.
c. Mos ngatërroni personin me problemin! Edhe pse fytyra e dikujt mund të mos pëlqejë, nëse puna kërkon bashkëpunim, ky duhet bërë patjetër. Pra, fokusi ëhstë tek puna dhe objektivat për t'u përmbushur, jo tek pëlqimet apo mospëlqimet personale.
d. Thoni atë që mendoni! Mendimi se mbajtja fshehur e diçkaje me shpresën se do ta thotë dikush tjetër, është diçka e gabuar. Për më tepër, përputhshmëria e asaj që flitet apo shkruhet me atë që bëhet, është integritet dhe vlerësohet shumë.
e. Dëgjoni me vëmendje ! Është cilësuar si problemi më i madh në komunikimin gojor, i cili përbën zhurmë në komunikim dhe prish zinxhirin e punës. Mund të ndodhë nga të dy bashkëbiseduesit.

f. Kujdesuni për gjuhën e trupit ! Gjithçka në paraqitje e lëvizje flet për atë që ju bëni në punë. Prandaj është kaq e rëndësishme. Menaxherët e niveleve të larta kanë ekipe konsulence për gjuhën e trupit, si pjesë e marrëdhënieve publike.
g. Tregoni mirëkuptim ! Të qënit asertiv ndihmon në dhënien e së drejtës bashkëbiseduesit atëherë kur e meriton dhe dëgjimi i nformacionit shtesëështë në përputhshmëri të plotë me këtë aspekt
h. Bëni pyetje ! Nuk është turp të kërkosh informacion shtesë, sigurisht pasi merret leje nëse mund të bëhen pyetje, kjo në takime zyrtare. Në takime më të thjeshta, kjo duhet të jetë pjesë normale e bashkëbisedimit.
i. Jepni feedback për atë që ju është adresuar! Përgjigjja apo interpretimi i saj duhet të jetë në përputhje me atë çka është kërkuar. Kjo lehtëson komunikimin dhe bën të mundur përparimin e tij.

PËRFUNDIME

Parimet e komunikimit, të cilat prekin në të gjitha format e mënyrat individët në marrëdhënie të përditshme e saktësisht në ato të punëskanë të njëjtën bazë : Dërguesi duhet të kodojë mendimin e tij në disa forma, në mënyrë që t'i transmetohet marrësit. Pavarësisht nës është i drejtpërdrejtë apo me gojë, me e-mail, me takime zyrtare, marrësi i mesazhit i dekodon ato sipas mënyrës apo perceptimit të tij. Në këtë proces, ekzistojnë gjithnjë të ashtuquajturat "zhurma".

Disa nga mangësitë e komunikimit, të cilat e bejnë zinxhirin e komandimit joefektiv janë : komunikimi informal, filtrimi dhe ngadalësimi.

Barrierat në komunikimin menaxher-punonjës materializohen në tre drejtime të ndryshme : konflikti i kërkesave të rolit, efekti i heshtjes dhe zinxhiri i thashethemeve.

Komunikimi joverbal mund të japë idenë e vërtetë të mesazhit, atë për të cilin fjalët nuk mjaftojnë. E rëndësishme është të merret parasysh efekti i kulturës nga vijnë individët të cilët janë pjesë e bashkëbisedimit. Marrëveshjet sociale mes kulturave të ndryshme janë marrëveshje të nënkuptuara e të mirëpranuara nga palët në momentin që kemi të bëjmë me marrëveshje të natyrës së biznesit mes përfaqësuesve të vendeve të ndryshme.

Disa parime bazë të komunikimit efektiv janë: Kushtojini kohën e duhur komunikimit ; Pranoni bashkëbiseduesin ashtu siç është ; Mos ngatërroni personin me problemin ; Thoni atë që mendoni ; Dëgjoni me vëmendje ;Kujdesuni për gjuhën e trupit ;Tregoni mirëkuptim ; Bëni pyetje dhe Jepni feedback për atë që ju është adresuar.

REFERENCA

Hofstede, G., *Culture's Consequences: Comparing values, behaviors, institutions, and organizations across nations*, London: SAGE Publications 2001.

Charles, M., & Marschan-Piekkari, R. (2002). Language training for enhanced horizontal communication: a challenge for MNCs. *Business Communication Quarterly*.

Dhir, K.S., & Goke-Pariola, A. (2002). The case for language policies in multinational corporations. *Corporate Communications: an International Journal*.

Feely, A.J., & Harzing, A.W.K. (2003). Language management in multinational companies. *Cross-Cultural Management*, 10(2).

Griffith, D.A. (2002). The role of communication competencies in international business relationship development. *Journal of World Business*.

Harzing, A.W.K., Maznevski, M.L., Fischlmayr, I., Yaconi Liberman, L., Wittenberg, K., Myloni, B., Low, J.C.K., Castro, F.B., Zander, L., Karlsson, C., Romani, L., & Feely, A. (2002). The interaction between language and culture: A test of the cultural accommodation hypothesis in seven countries. *Language and Intercultural Communication*.

House, R.J., Hanges, P.J., Javidan, M., Dorfman, P.W., & Gupta, V. (2004). *Culture, Leadership and Organizations: The GLOBE study of 62 societies.* Thousand Oaks, CA: Sage.

Maclean, D. (2006). Beyond English: transnational corporations and the strategic management of language in a complex multilingual business environment. *Management Decision*.

Marschan-Piekkari, R., Welch, L., &Welch, D. (1997). Language the forgotten factor in multinational management. *European Management Journal*.

Marschan-Piekkari, R., Welch, D., &Welch, L. (1999b). In the shadow: the impact of language on structure, power and communication in the multinational. *International Business Review*.

Hofstede, G., Culture's Consequences: International differences in work-related values, London: SAGE Publications 1980.

Hofstede, G., *Masculinity and Femininity: The Taboo Dimension of National Cultures*, London: SAGE Publications 1998.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

RAPORTET RRJEDHIMORE NË GJUHËN SHQIPE

Aida Kurani

Abstrakt

Raportet rrjedhimore janë pjesë e raporteve sintaksore që vendosen mes njësive të ndryshme sintaksore ashtu si ato vendore, kohore, lejore etj. Tradicionalisht në sintaksën shqiptare ato janë trajtuar në kuadrin e sintaksës së periudhës dhe, në veçanti të periudhave me fjali të nënrenditura rrethanore.
Por, periudha me fjali të nënrenditur nuk është e vetmja mënyrë e shprehjes së raporteve rrjedhimore. Përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ato mund të shprehen edhe me ***fjali të thjeshta***, *periudha me fjali të bashkërenditura*, *periudha me fjali asindetike*, si edhe përtej periudhës, ***në nivel teksti***. Ngjyrime rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.
Në këtë punim jemi ndalur në shprehjen e raporteve *shkak-pasojë*, duke mos u kufizuar vetëm në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore, por duke vështruar edhe ndërtime të tjera që shprehin marrëdhënie të këtij lloji. Kjo mënyrë e së vështruari na jep mundësinë që këto raporte të shihen më gjerë, dhe të vihen në dukje jo vetëm ndërtimet tipike që shprehin këto lloj marrëdhëniesh, por edhe ndërtime të tjera ndër to edhe ndërtime me gërshetime raportesh ose me nuanca të veçanta kuptimore.

1. Raportet rrjedhimore në periudhën me fjali të nënrenditur rrjedhimore

Trajtimi i formave të shprehjes së raporteve rrjedhimore ka qenë në vëmendje të studimeve të gjuhëtarëve tanë ku përmendim, A. Xhuvani (Xhuvani 1922, 1938, 1942 : 41), A. J. Rrota (Rrota, 1943: 88-89), K. Cipo (Cipo, 1952*:* 97), M. Domi (Domi, 1955: 192, 1971: 109), S. Floqi, (Floqi, 1965: 55), S. Prifti (Prifti, 1971: 417), *Gramatika e gjuhës shqipe II*, *Sintaksa (Gramatika*, 1997: 493), M. Totoni (Totoni, 2012: 199-215) etj. Këta studiues, në punimet e tyre, kanë bërë objekt diku më shkurt a më gjerë, çështje që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të shprehjes së raporteve rrjedhimore.
Ajo ç'kavërejmë në studimet e tyre është se raportet rrjedhimore janë trajtuar në kuadrin e periudhës dhe, në veçanti, të periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore.
A. Xhuvani[176] (i cili mendohet se është i pari ndër studiuesit shqiptarë që i ka vendosur emrin këtyre fjalive të nënrenditura) në tekstin e tij jep këtë përkufizim për fjalinë rrjedhimore: "*Fjalitë rrjedhore kallëzojnë nji përfundim, nji rrjedhje të punës që tregohet në fjalinë e parë*". Ai vë në dukje përdorimin e lidhëzave që lidhin fjalinë kryesore me fjalinë e nënrenditur e konkretisht lidhëzën *saqë*, e cila vjen pas ndajfoljeve *kaq*, *aqë* dhe nëse në fjalinë kryesore mungon ndajfolja *kaq*, në fjalinë *rrjedhore* përdoret vetëm lidhëza *sa*. Këtu ai jep shembullin: Fiton ***sa me jetue.***
Duke e vështruar në rend kronologjik trajtimin e kësaj njësie sintaksore në gramatikat dhe studimet për gjuhën shqipe[177]vërejmë se përkufizimi, tiparet e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore jepen

[176]A. Xhuvani, *Njohunit`e para të sintaksës shqipe, pjes` e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922; *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores e për t`ultat e Shkollavet të Mesme*, Tiranë, 1938; *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses,* Tiranë, 1942.

[177]A. Xhuvani, *Njohunit`e para të sintaksës shqipe, pjes` e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922; *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores e për t`ultat e Shkollavet të Mesme*, Tiranë, 1938; *Libri i gjuhës shqipe, pj. II për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses,* Tiranë, 1942.

pak a shumë njësoj, pa shumë ndryshime.Në vija të trasha, periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore shpreh marrëdhënien ndërmjet një shkaku dhe pasojës a rrjedhimit të tij.Studimi i saj në gjuhën shqipe ka ecur duke hyrë më thellë në kuptimin e marrëdhënieve rrjedhimore dhe të mjeteve shprehëse të tyre. Nga ana tjetër, mund të themi se ndonjëherë janë lënë jashtë përfshirjes në periudhat me fjali të nënrenditura rrjedhimore edhe disa tipa periudhash ku, për mendimin tonë, marrëdhënia rrjedhimore është kryesorja. E kemi fjalën, para së gjithash, për periudhat me fjali që bashkohen me lidhëzat **sa, derisa** etj. Në disa gramatika të shqipes, si për shembull tek ajo e Martin Camajt (1984), këto fjali klasifikohen si rrjedhimore, por në të tjera, si për shembull te *Gramatika II (Sintaksa)* e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, cilësohen si periudha me fjali të nënrenditur *kohore* me ngjyrime rrjedhimore. Mendojmë se për interpretimin e tyre duhet mbajtur parasysh deri diku vërejtja që bëhet po në *Gramatikën II* [178]sipas së cilës, nëse në këto fjali mbizotëron kuptimi kohor apo ai rrjedhimor, kjo varet nga konteksti a situata.

Kështu, periudha "Qeshi **sa i dolën lot nga sytë**" duhet të merret si rrjedhimore (mund ta perifrazojmë me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore si: *Qeshi **aq shumë, sa i dolën lot nga sytë***, por jo me një kohore që tregon kohëzgjatje si: **Qeshi **për aq kohë sa i dolën lot***), por tek *E skuqim qepën **sa të marrë ngjyrë të verdhë*** është e vështirë të thuash nëse kryesor është kuptimi kohor apo kuptimi rrjedhimor (si parafraza *E skuqim qepën **për aq kohë sa të marrë ngjyrë të verdhë***, ashtu edhe *E skuqim qepën **aq sa të marrë ngjyrë të verdhë*** janë njësoj të përshtatshme).

Sidoqoftë, mund të thuhet me siguri se këtij tipi periudhe mund t'i bëhet gjithherë një interpretim *rrjedhimor*, gjë që s'mund të thuhet edhe për atë *kohor*, ndaj kjo përligj, sipas gjykimit tonë,klasifikimin e tyre përkrah fjalivetë tjera rrjedhimore.Kështu, për ne janë rrjedhimore edhe periudhat me fjali të nënrenditur si: *Ishte **aq i fuqishëm, sa të tërë ia kishin frikën***, ashtu edhe të bashkërenditurat e jolidhëzoret *Ishte i fuqishëm **dhe (si rrjedhim)të tërë ia kishin frikën**; Ishte i fuqishëm, **ndajtë tërë ia kishin frikën;** Ishte i fuqishëm, **(si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën***.

Pavarësisht nga struktura e tyre sintaksore, për sa i përket kuptimit, këto periudha janë sinonime me njëra-tjetrën.

Po, përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ndërtimet rrjedhimore mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta, periudha me fjali të bashkërenditura, periudha me fjali asidentike*, si edhe përtej periudhës, *në nivel teksti*. Ngjyrime rrjedhimore ngërthejnë edhe një numër periudhash të tjera me fjali të nënrenditura.

2. Shprehja e raporteve rrjedhimore në fjali të thjeshtë

Tradicionalisht në sintaksën shqiptare nuk ka qenë i përhapur emërtimi ***"fjali (e thjeshtë) rrjedhimore"***. Kjo me gjasë ka ndodhur jo vetëm ngaqë nuk është bërë ndonjë klasifikim sistemor i fjalive të thjeshta sipas raporteve funksionale-kuptimore (ose qoftë edhe formale) ndërmjet gjymtyrëve të tyre, por edhe sepse është menduar, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 493), se në këto fjali nuk ka raporte rrjedhimi, gjë që, sipas autorëve të kësaj vepre, dëshmohet nga mungesa e plotësve (rrethanorëve) të rrjedhimit, përkundër qenies së fjalive të nënrenditura rrjedhimore.

Por ne jemi të mendimit se edhe në shqip ka njësi sintaksore që mund të thuhet se kryejnë funksionin e rrethanorëve të rrjedhimit. E tillë, sipas gjykimit tonë, është për shembull fraza *për vdekje* në "rrah

---

J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe,* botimi i dytë, Shkodër, 1943; *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.

K. Cipo, *Sintaksa*. Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1952.

M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare,*Tiranë, 1955; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa*, Tiranë, 1964; *Sintaksa e gjuhës shqipe II*, dispensë, Tiranë, 1969; M. Domi, *"Gramatika e gjuhës shqipe", Sintaksa për shkollat e mesme,* Prishtinë, 1969 dhe 1971.

S. Floqi, *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2.

S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.

Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, *Sintaksa*, Tiranë, 1997, 2002.

M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Tiranë, 2000.

[178] Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, Sintaksa, Malaka, Tiranë,2002, f. 574.

(godas, qëlloj) **për vdekje***(dikë)*", frazë e cila është sinonime me fjalinë e varur rrjedhimore *(aq)sa e vdes.*[179]
Sidoqoftë, për mendimin tonë marrëdhëniet rrjedhimore ekzistojnë edhe në ndërtimet ku ato nuk janë të shprehura posaçërisht nga ana leksikore, domethënë ku ka fraza - kryesisht në rolin e rrethanorëve - që mendohet se shprehin në fjali raporte të tjera, sipas të cilave edhe emërtohen. Kështu, për shembull, kuptim rrjedhimor mund të themi se kemi edhe në ato fjali ku si gjymtyrë e dytë del një rrethanor shkaku, ndonëse në to sigurisht raportet rrjedhimore ndërthuren me raportet shkakore. Në këtë mënyrë, ndërtimet me rrethanorë të shprehur me emër me parafjalë, me emër në rrjedhore a me folje në përcjellore si: *U mek **nga të qeshurit (së qeshuri;duke qeshur)***mund të perifrazohen qoftë me një periudhë me fjali të nënrenditur shkakore konstatuese (*U mek **ngaqë qeshi***), qoftë edhe - duke tingëlluar mbase më natyrshëm - me një periudhë me fjali të nënrenditur rrjedhimore (*Qeshi **sa u mek.***).
Po kështu, edhe ndajfolja *copash* e lokucioni i barasvlershëm me të *copa-copa* në *E thyej xhamin **copash (copa-copa)***, që tradicionalisht do të interpretoheshin si rrethanorë mënyre, mund të themi se janë rrethanorë rrjedhimi dhe këtë sërish e provon perifrazimi me periudha rrjedhimore: *E thyej xhamin **aqshumë (aq keq),sae bëj copash (copa-copa)*** ose *E thyej xhamin **sae bëj copash (copa-copa)***. Perifrazimi mund të shërbejë shumë mirë si një letër lakmusi për të përcaktuar së ç'lloj raportesh shprehen në fjali ose të paktën llojin e rrethanorit që përmban ajo.
Kështu, ndonëse fjalia *E bëj xhamin **copash(copë-copë)*** është sinonime me *E thyej xhamin **copash (copë-copë)***, ajo nuk mund të perifrazohet me periudha rrjedhimore: s'mund të themi, për shembull, **E bëj xhamin **aqshumë (aq keq), sa e thyej copash (copa-copa)*** ose **E bëj xhamin **sae thyej copash (copa-copa)***.
Ndaj mund të arrijmë në përfundimin se *copash(copë-copë)*tek *E bëj xhamin **copash(copë-copë)*** tregon shkallëne ndryshimit të gjendjes së realies që shënon emri në funksionin e kundrinës (*xhamin*), prandaj mund të cilësohet si rrethanor mënyre.

3. Shprehja e raporteve rrjedhimore në periudha me bashkërenditje

Një formë e veçantë e shprehjes së raporteve rrjedhimore janë disa ndërtime me fjali të bashkërenditura. Nga pikëpamja pragmatiste, kodifikimi i rrjedhojës me anë të nënrenditjes ndryshon nga bashkërendimi prej llojit të veprimit gjuhësor që përmbushet prej folësit.
Periudha me nënrenditje rrjedhimore shpreh një marrëdhënie rrjedhimore mes dy fakteve të një pohimi të vetëm. Në të kundërt, duke përdorur dy fjali që nuk janë të renditura në mënyrë hierarkike, folësi realizon dy pohime, i dyti prej të cilëve vendoset si përfundim kundrejt të parit.
Periudhat me fjali të bashkërenditur që shprehin *marrëdhënie rrjedhimore* janë zakonisht ato përmbyllëset. Te këto periudha me fjali të bashkërenditura me strukturë detyrimisht dykryegjymtyrëshe, fjalia e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, përmbyllje e fjalisë së parë dhe lidhet me fjalinë e parë me anë të lidhëzave të specializuara: *andaj, ndaj, pra, pa.*

Tha se ishte i sëmurë, prandaj atë ditë nuk mund të shkonte në shkollë.

Ka bërë shumë ftohtë, ndaj rruga është e ngrirë.

Lidhja rrjedhimore mes këtyre dy fjalive mund të jetë e vlefshme edhe në mungesë të lidhëzave të posaçme rrjedhimore: *Ishte i fuqishëm dhe të tërë ia kishin frikën*

4. Shprehja e raporteve rrjedhimore në periudha me fjali asindetike

Lidhja rrjedhimore mes dy fjalive mund të jetë e vlefshme edhe në mungesë të mjeteve të specializuara lidhëse (fjalitë asindetike):*Ishte i fuqishëm, **(si rrjedhim) të tërë ia kishin frikën***.

[179]Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për ndërtimet e tipit "mërzis (bezdis) *(dikë) për vdekje*", ku *për vdekje* përdoret në kuptim jo të drejtpërdrejtë dhe luan rolin e një rrethanori sasie a mënyre.

Kësisoj në fjalinë "*Ka bërë shumë ftohtë, rruga ka ngrirë"*interpretimi rrjedhimor bëhet nëpërmjet faktorëve enciklopedikë.
Dihet se për nga ana e raporteve kuptimore midis fjalive në bashkimet asindetike mund të shprehen si *raportet e barazisë*, pra të bashkërenditjes, ashtu edhe *raportet e varësisë*, pra të nënrenditjes. Në periudhat me fjali asindetike me marrëdhënie rrjedhimore fjalia e parë përmban *shkakun*, ndërsa e dyta rrjedhimin a pasojën e këtij shkaku.
Siç vërehet në Gramatikën e Akademisë,[180] ka periudha asindetike që për nga kuptimi dhe për nga intonacioni mund të vihen në lidhje edhe me periudha me fjali të bashkërenditura lidhëzore, edhe me periudha me fjali të nënrenditura lidhëzore, si p.sh. disa raste periudhash me marrëdhënie rrjedhimore ose përmbyllëse: *U shtriva që u shtriva, po bëj një sy gjumë.*

5. Ngjyrime rrjedhimore në periudha me fjali të tjera të nënrenditura

Ngjyrim rrjedhimor ngërthejnë edhe fjali të tjera të nënrenditura, si periudha me fjali të nënrenditur përcaktore, kohore e qëllimore. Kështu, siç vërehet në *Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)* të Akademisë së Shkencave (f. 534), bashkëlidhja e brendive reale konkrete të fjalive të periudhës mund t'i japë fjalisë së nënrenditur përcaktore ngjyrim rrjedhimor. Për këtë ka edhe disa tregues formalë gramatikorë në fjalinë kryesore.
Paraprijës është një togfjalësh emëror, i përbërë prej një emri të përgjithshëm të shoqëruar nga përemra dëftorë të cilësisë, si kësi, ai, i (a) tillë. Prania e përemrit dëftor shkakton një lidhje shumë të ngushtë midis fjalive; fjalia e nënrenditur është pjesë e domosdoshme e fjalisë kryesore nga pikëpamja gramatikore dhe kuptimore.
Përemrat dëftorë i japin emrit një cilësim në mënyrë më të përgjithshme, por gjithmonë pa e emërtuar atë cilësi. Kjo cilësi e pashprehur zbulohet vetëm nëpërmjet asaj që thuhet në fjalinë e nënrenditur, d.m.th. zbulohet nëpërmjet *rrjedhimit, pasojës*:*Fytyra i mori një pamje të tillë që e gëzoi vajzën.*
Paraprijës mund të jetë një emër i vetëm, i pashoqëruar nga ndonjë përemër dëftor, por semantika dhe trajta e këtyre kërkojnë doemos një karakteristikë, të cilën në të vërtetë e jep fjalia e nënrenditur nëpërmjet diçkaje që është rrjedhim i saj. Paraprijësi emër është rëndom një emër i vetëm në trajtë të pashquar, i shoqëruar nga fjalët një a disa (ca):*Kishte ca piktura që ta prishnin mendjen.*
Marrëdhëniet rrjedhimore mund t'u mbishtohen fjalive qëllimore me lidhëzat *që* dhe lokucionin lidhëzor *në mënyrë që*, sidomos kur fjalia drejtuese pas foljes kallëzues ka ndonjë gjymtyrë të shprehur me ndajfolje mënyre, ndajfolje sasie ose me mbiemër:*Shuplakat më të rënda do ti japim atyre, gjersa të gjithë të largohen nga ky vend.*

6. Raportet rrjedhimore në nivel teksti

Në gjuhësinë bashkëkohore flitet edhe për një njësi gjuhësore që qëndron mbi fjalinë. Kjo njësi është teksti. Kur vendoset përtej kufijve të fjalisë a periudhës, marrëdhënia e rrjedhojës siguron një lëvizje teksti që lejon të organizohet ligjërimi në bazë të nevojave të veçanta arsyetuese:

Dadaizmi nuk mëtonte t'i jepte pikënisje një rryme artistike me rregulla të kodifikuara, sikurse në fakt ishte, për shembull, rasti i fotodonamizmit futuristë të Balës e të Boçionit. Dadaizmi që provokim i pastër. Kështu, futurizmi dhe dadaizmi mund të kenë pika lidhjeje.

[180]Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, *Sintaksa*, Malaka, Tiranë, 2002, f. 624.

Përfundime

Si përfundim mund të themi se, interesi i treguar për ndërtimet rrjedhimore nuk ka munguar nëpër gramatika apo studimet sintaksore të gjuhëtarëve tanë, por trajtimi i temës në fjalë ka qenë i paplotë. Ndërtimet rrjedhimore nuk ishin parë në tërësinë e tyre, por ishin kufizuar në trajtimin e periudhës me fjali të nënrenditur rrjedhimore. Po, siç u trajtua edhe më sipër, përveç periudhave me fjali të nënrenditura rrjedhimore, ato mund të shprehen edhe me *fjali të thjeshta*, si edhe përtej periudhës, *në nivel teksti*.

Bibliografia

Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.

Cipo, K., *Gramatika e gjuhës shqipe për klasat e V-ta, VI-ta, VII-ta të shkollave 7-vjeçare*, Tiranë, 1949.

Cipo, K., *Sintaksë* (Tekst për Institutin Pedagogjik), Tiranë, 1951.

Cipo, K., *Sintaksa shqipe*, Tiranë, 1952.

Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1968.

Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa për shkollat e mesme, Prishtinë, 1969 dhe 1971.

Floqi, S., *Periudha me fjali të nënrenditur rrjedhimore në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1965/2.

Mansaku, S., *Prirje të strukturës sintaksore të shqipes së sotme standarde*, Seminari XX ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën Shqiptare 20/1, Prishtinë 2002.

Mikeli, G., *Gramatika e giûhës shqype*, Shtypshkronja "Nikaj", Shkodër, 1916.

Prifti, S., *Sintaksa e shqipes*, Tiranë, 1962, ribotuar në Prishtinë, 1971.

Rrota, J., *Syntaksa e gjuhës shqipe (ose Sintaksi i shqipes, 1942*) *për klasën II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, shtypshkronja At Gj. Fishta, Shkodër, 1943Rrota, J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, AShSh IGjL Botimi I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.

Xhuvani, A., *Libri i gjuhës shqipe*, pjesë e dytë për klasat e nalta të fillores dhe të parat e Qytetses, Tiranë, 1942

Xhuvani, A., *Njohunit` e para të sintaksës shqipe, pjes` e parë për klasët e nalta të fillores*, Vlorë, 1922.

Xhuvani, A., *Njohunit e para të sintaksës shqipe për klasët e nalta të Fillores*, Tiranë, 1938.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

NAIM VEQILHARXHI-NJË RILINDAS PROMOTER I GJUHËS SË SHKRUAR SHQIPE

. Rovena VATA-Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Abstrakt:

Fjalë kyçe: ***Gjuhë, atdhe, komb, qytetërim, albafet, identitet***

Eshtrat i ka thërrmuar koha. Sjhkrijnë si plisi. Bëhen baltë, pluhur, dhe. Si ishim? Ku jemi? Ç'farë jemi, ku përfundojmë në realitet! A ndërtojnë eshtrat një profil njerëzor me të gjithë përbërësit?...[181].

Naumi Veqilharxhi, ishte vetëm 27 vjeçar, kur nisi punën për përpilimin e alfabetit të veçantë, që nuk do të ishte as arab, as grek, as latin, as edhe cirilik, duke vijuar me pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, me gramatikën, me afrimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe dhe së fundmi me hartimin e abetareve dhe materialeve të tjera didaktike. Si iluminist, Naum Veqilharxhi mendonte se mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës, mund ta vinin atdheun në radhën e vendeve të qytetëruara. Për Naum Veqilharxhin, çlirimi kulturor ishte një factor, pa të cilin nuk mund të arrihej çlirimi politik. Në këto kushte ai ishte i pari që ndjeu nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit, në gjuhën amtare edhe për të penguar helenizimin e vendit. Shkollat shqipe do të shërbenin gjithashtu si një mjet të dorës së parë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, bashkimin dhe emancipimin e popullit, si dhe propagandimin e ideve patriotike.

Punën e tij si atdhetariluminist e nisi me krijimin e një albafeti origjinal të gjuhës shqipe, të përbërë 33 shkronjash. Me këtëalfabet hartoi dhe libra për mësimin e gjuhës shqipe. Të parin libër, që është e para abetare për mësimin e gjuhës shqipe, Veqilharxhi e botoi më 1844 me titullin "Evëtar". Një komb sipas tij mund të dalë nga mjerimi dhe prapambetja, kur të fillojë të lëvrojë gjuhën kombëtare. Gjuhën tonë ne duhet ta shkruajmë me "shkronja të veçanta kombëtare".

Naum Veqilharxhi është nismëtari për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme dhe pasurimin e saj me fjalë të gurrës popullore ose të formuara rishtas. Duke theksuar gjuhën si faktor themelor të mëvetësisë kombëtare, ai vlerësonte vetëm gjuhën e pastër të popullit, pa fjalë të huaja.

Naum Panajot Bredhi, i mbiquajtur Veqilharxhi, është pionieri i lëvizjes sonë kulturore patriotike të shekullit XIX. Ai është ideologu i parëi Rilindjes në Shqipëri, ku nuk mund të lëmë pa përmendur edhe kontributin e tij në hapjen e udhës së ideve të reja politike e kulturore kombëtare.

Naum Veqilharxhi lindi më 1797 nëVithkuq tëKorçës. Si shumë shqiptarë të tjerë edhe ai emigroi në Rumani.

[181] Gëzim Llojdia, në gazetën "Ndryshe", e enjte, 26 korrik 2007.

Veprat e Naumit që kanë arritur deri në ditët tona, të rreshtuara kronologjikisht, janë: *Ëvetari* i vitit 1844 dhe i vitit 1845, që ishte edhe një libër leximi, *Qarkorja*, si *dhe Letra e hapur dërguar nipit të tij*, student në Vjenë më 1846.

Naumi, nuk ishte më shumë se 27 vjeç, kur nisi menjëherë punën për përpilimin e alfabetit të veçantë që nuk do të ishte as arab, as grek, as latin, as edhe cirilik, duke vijuar me pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, me gramatikën, me afrimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe dhe së fundmi me hartimin e abetareve dhe materialeve të tjera didaktike.

Nga shkrimtarët e Shqipërisë, një brez para atyre të Rilindjes, Naum Veqilharxhi është një ndër të parët që u përpoqën të pasuronin gjuhën e shkrimit e ta spastronin nga fjalët e huaja, me fjalë si: *fletore, kamës, mësim, padije, shënim, shumicë, thelloj* e ndonjë tjetër[182].

Si iluminist, Naum Veqilharxhi mendonte se mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës, mund ta vinin atdheun në radhën e vendeve të qytetëruara.

Gjuha si faktor i shquar veprues, shprehës, ruajtës i identitetit etnik, bartës i lëvizjeve shoqërore, politike e mendore, është një argument i mirë se ajo nuk është kod i sigurtë shoqëror e kulturor, dhe se çdo përpjekje për ta bërë të tillë ka dështuar dhe do të dështojë[183].

Për Naum Veqilharxhin, çlirimi kulturor ishte një faktor pa të cilin nuk mund të arrihej çlirimi politik. Në këto kushte ai ishte i pari që ndjeu nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit në gjuhën amtare edhe për të penguar helenizimin e vendit. Shkollat shqipe do të shërbenin gjithashtu si një mjet të dorës së parë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, bashkimin dhe emancipimin e popullit, si dhe propagandimin e ideve patriotike.

Në periudhën e veprimtarisë së Naum Veqilharxhit, iluminizmi, lëvizja kulturore dhe filozofike, që lindi dhe u zhvillua në Europën Perëndimore të shekullit 18-të, kishte depërtuar edhe në Ballkan. Nëpërmjet tri veprave të tij, jo të gjata, portë ngjeshura, ai kërkon të ndihmojë kombin shqiptar, duke ndriçuar mendjet e njerëzve të errësuara nga padija dhe besëtytnitë. Ai do ta kryejë këtë detyrë nëpërmjet përhapjes së dritës së arsimit dhe të kulturës me anë të alfabetit të veçantë të gjuhës amtare dhe të shkollës shqipe, të cilat do të jenë të pavarura nga të huajt dhe për të gjithë fëmijët e shqiptarëve.

Alfabeti i veçantë i gjuhës shqipe, i filluar nga Naum Veqilharxhi në vitin 1824, u bë armë në duart e shqiptarëve me botimin e dyËvetarëve 20 vjet më vonë. Ata zgjuan vetëdijen e popullit shqiptar, ndezën dëshirën për liri, si dhe zjarrin e luftës për rilindjen e Shqipërisë.

Ndërsa *Qarkorja* (1846) ishte një manifest, në të cilin Naum Veqilharxhi paraqet me ton luftarak kërkesat kulturore të lëvizjes tonë kombëtare. Në*Qarkore*është përdorur një gjuhë ezopike e fshehtë kundër Turqisë, ndërkohë që sulmohen plot urrejtje planet djallëzore të Greqisë dhe synimet shoviniste të qarqeve greke.

Letra dërguar të nipit të tij Jani Calit, student në Vjenë, më 7 prill të vitit 1846, ishte një akuzë e fortë për të gjithë ata shqiptarë, që kishin vënë në shërbim të të huajve dijet, energjinë dhe pasuritë intelektuale, duke mohuar kështu kombin dhe të qenurit shqiptarë.

---

[182] Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në revistën:"Gjuha Shqipe", 2/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prsihtinë, 2008, f. 8.
[183] Shefkije Islamaj, *Kultura e shkrimit sot dhe nesër*, në revistën:"Gjuha shqipe", 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 1.

Historiani rumun Viktor Papakostea në revistën *Balkania* e botuar në Bukuresht të vitit 1945 shkruan se: "Veqilharxhi me shokë, që formonin grupin politik, ishin të parët në shekullin e lëvizjeve nacionale, që u angazhuan dhe luftuan për kauzën shqiptare. I shqetësuar për fatet e atdheut të vet, tashmë më përvojën e luftës kundër pushtuesit osman, i vendosur dhe i vetëdijshëm, ai duket se nxori përfundimet e duhura, të cilat, pasi i përpunoi, i paraqiti të përmbledhura në*Qarkoren*, që u drejtoi shqiptarëve, në*Letrën dërguar Jani Calit* më 1846 dhe në Parathënien e *Ëvetarit* të vitit 1845".

Veqilharxhi i ndikuar padyshim nga idetë e lëvizjes kombëtare të popujve të Ballkanit, mori pjesë në revolucionin, që pati karakter, jo vetëm, çlirimin antiosman, por edhe antifeudal. Me formimin illuminist, Veqilharxhi e drejtoi vëmendjen tek atdheu i tij. Ai e kuptonte se gjendja e Shqipërisënë ato çaste historike shtronte para popullit të tij kërkesa të reja. Në vitit 40 të shekullit XIX lëvizjet çlirimtare në Shqipëri kishin marr hov, por atyre u mungonte një program kombëtar dhe një platform ideologjike e përpunuar.

Veqilharxhi ka kontribut të veçantë në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, pasi formuloi i pari kërkesat themelore të Rilindjes. Punën e tij si atdhetar iluminist e nisi me krijimin e një alfabeti origjinal të gjuhës shqipe, të përbërë prej 33 shkronjash. Të parin libër, qëështë e para abetare për mësimin e gjuhës shqipe, Veqilharxhi e botoi më 1844 me titullin *Evëtar*. Një vit më vonë, më 1845, e botoi të përpunuar e të zgjeruar, me titullin *Fare i ri evëtar shqip për djem nismëtar*, të shoqëruar me një parathënie për djemtë e rinj shqiptarë.

Idetë dhe konceptet e tij kanë burimin te realiteti shqiptar dhe në atmosferën e përgjithshme, që sundonte atëkohë në Ballkan. Ai dalloi nevojën e shkrimit të gjuhës shqipe, të krijimit të alfabetit të saj të veçantë, të ngritjes së arsimit shqiptar, të njohjes së historisë kombëtare si kusht idomosdoshëm për njësimin kombëtar mbi bazën e vetëdijes kombëtare, gjë që do të përshpejtonte afirmimin e mëvetësisë së kombit shqiptar.

"Ndër fqinjët ballkanikë të Shqipërisë, feja dhe kombësia përputheshin. Përderisa kjo nuk ndodhte me shqiptarët, rilindësit u përpoqën të zhvillonin ato aspekte të kulturës shqiptare që ishin të një natyre jofetare, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të kryhej bashkimi. Për rrjedhojë, theksi u vu te gjuha e përbashkët, e cila mund të shërbente si një hallkë ndërlidhëse ndërmjet grupeve të ndryshme krahinore dhe fetare"[184].

Për Naum Veqilharxhin gjuha shqipe, vendosja e një alfabeti të njëjtë për të gjithë shqiptarët, lëvrimi i saj në letërsinë e shkruar dhe përhapja e shkrimit shqip me anë të shkollave amtare, nuk duheshin trajtuar vetëm si çështje kulture, por edhe në rrafshin politik, si veprime patriotike që do të ndihmonin në njësimin e kombit shqiptar.

Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua si pjesë e pandarë e lëvizjes politiko-shoqërore e kulturore për çlirimin e vendit nga zgjedha e huaj kjo lëvizje, që nis nga mesi i shekullit XIX dhe arrin deri në vitin 1912, quhet Rilindje Kombëtare, prandaj edhe letërsia e kësaj periudhe quhet letërsi e Rilindjes Kombëtare.

Jo rastësisht, kërkesat kulturore kombëtare, midis të cilave një vend të veçantë zinte edhe liria e gjuhës dhe e shkollës shqipe, që nga koha e veprimtarisë së Naum Veqilharxhit, u bënë pjesë e pandarë e programeve politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

[184] Stavro Skendi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Tiranë, 2000, f. 111.

Në*Qarkoren* e vitit 1846 Naum Veqilharxhi theksonte rëndësinë e gjuhës amtare dhe të arsimit: "Lënia pas dore e lëvrimit të gjuhës sonë kombëtare dhe zëvendësimi i saj me një gjuhë të uaj na sollën në gjendjen më të ulët të turpit, sepse kështu u ngul përgjithmonë padituria e kombit, u përhap me të shpejtë barbaria dhe, pa kuptuar, vargonjtë e robërisë u bënë edhe më çeliktë. Kultura, vijon ai, mund të fitohet vetëm në gjuhën amtare"[185].

Ideja e Naumit në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla, ishte edhe fakti që gjuha shqipe duhej patjetër tëpërdorej edhe në shërbesat fetare, ku në parathënien e *Ëvetarit* të tij në vitin 1845 shkruan se: "shqiptarët, jo vetëm nuk kanë mundur t'i shkruajnë njëri-tjetrit në gjunë e vet, por as t'i fallen e t'i luten Perëndisë me gjuhën, që secili e mësoi duke pirë qumështin e nënës, si gjithë bota tjetër (Parathënia e Ëvetarit 1845). Kurse në *Qarkore* përdor koncepte të reja për kohën në fushën ekonomike-shoqërore, si për shembull termat: shkencë, arte të bukura dhe politike, dhe jep porosinë që të ruhen me kujdes dhe të zhvillohen më tej nga shqiptarët.

Gjuha shqipe është thesari më i shtrejtë që trashëguam nga të parët tanë. Këtë pasuri të paçmueshme, armiqtë e kombit tonë kanë dashur të na e dhunojnë, me qëllim që të na robëronin më lehtë. Por populli shqiptar u bëri ballë burrërisht orvatjeve të pareshtura të armiqve dinakë, dhe në këtë përpjekje gjigante mësuesit e gjuhës shqipe kanë qëndruar ballë të luftës. Abetaren shqipe ata e shkruan me gjak, kurse shkollën shqipe e ndërtuan me kockat e tyre të shenjta. Veçoria që ka dalluar shkollën tonë nga të gjitha shkollat e vendeve fqinje është se mësonjëtorja shqipe ka qenë laike që në fillimet e saj dhe e lirë nga çdo paragjykim fetar e shoqëror.

Naum Veqilharxhi ishte i pari dhe i vetmi që kuptoi se shqiptarët, të ndarë dhe të paditur, rrezikonin të zhdukeshin si komb. Naumi u përpoq të zhvillonte ato aspekte të kulturës kombëtare, që ishin të një natyre jo fetare, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të bëhej bashkimi kombëtar.

Si rrjedhim, theksin e vuri te kezistenca e kombit shqiptar, te raportet e kombit me fetë dhe te gjuha shqipe, e cila mund të shërbente si një hallkë e qëndrueshme bashkuese ndërmjet grupeve të ndryshme krahinore dhe fetare[186].

Naum Veqilharxhi e kishte të qartë se theksimi i identitetit kombëtar shqiptar do të minimizonte identitetet fetare dhe dukurinë e mbylljes së identiteteve fetare ndaj njëri-tjetrit. Në letrën drejtuar Jani Calit më 7 prill 1846, ai shkruan se kombi shqiptar është një trup homogjen, është esenca, kurse fetë veçori të fituara më vonë të esencës. Ai del i pari që shtroi problemin e përparësisë së kombësisë mbi fetë, duke i ideuar në këtë mënyrë rikonstruksionin ose rilindjen e kombit shqiptar, që përfshinte myslimanët, ortodoksët dhe katolikët.

Për Naumin gjuha shqipe nuk duhej trajtuar vetëm si çështje kulture, por edhe në rrafshin politik. Jo rastësisht, kërkesat kulturore kombëtare, midis të cilave një vend të veçantë zinte edhe liria e gjuhës dhe e shkollës shqipe, që nga koha e veprimtarisë së Naum Veqilharxhit, u bënë pjesë e pandarë e programeve politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Naumi e kishte të qartë se theksimi i identitetit kombëtar shqiptar do të zbehte dallimet fetare, si dhe mbylljen e identiteteve fetare midis tyre. Për Naumin Kombi shqiptar i krijuar në të njëjtën kohë me

[185]Po aty,f. 116.
[186] Fedhon Meksi, *Naum Bredhi Veqilharxhi, Dimensionet e vërteta të ideologut të Rilindjes*, Argeta-LMG, Tiranë, 2012, f. 30.

kombet e tjerë, i përbërë nga myslimanë, ortodoksë dhe katolikë si pjesë të kombit, ka përparësi mbi fetë, të cilat janë veçori të fituara më vonë dhe si të tilla të ndryshueshme.

Naumi ishte i pari që shtroi problemin e përparësisë së kombësisë mbi fetë, si një element specifik të kombit shqiptar, që qëndron në themel të harmonisë fetare ose bashkëjetesës shqiptare, shprehje e karakterit homogjen të kahershëm dhe kohezionit të brendshëm kombëtar.

Kurse prindërit i këshillon që fëmijët e tyre të kryejnë shkollën fillore në gjuhën amtare që do t'i ndihmojë edhe për të mësuar me lehtësi gjuhët e huaja.

Naum Veqilharxhi është nismëtari për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme dhe pasurimin e saj me fjalë të gurrës popullore os etë formuara rishtas. Duke theksuar gjuhën si faktor themelor të mëvetësisë kombëtare, ai vlerësonte vetëm gjuhën e pastër të popullit, pa fjalë të huaja.

Duke vlerësuar gjuhën si faktor themelor të mëvetësisë kombëtare, ai vlerësonte vetëm gjuhën e pastër të popullit, pa fjalë të huaja. Në faqet e *Ëvetareve* të Naumit kanë parë dritë për herë të parë fjalët si: *fatkeq, fatkeqësi, fatmir, fletore, lesim për lehtësim, nismëtor, i paçmuar, detyrë, vendlermi për vendlindje* etj. Naumi gjithashtu krijoi një varg temash gjuhësore, si:*zëtore për zanore, e zëshme dhe e pazëshme*. Ai përdori i pari termat: *fjalë e huaj, gjuhë e huaj*. Ai gjen rastin t'u këshillojë lexuesve të tij toskë që në vend të fjalëve të huaja *pishmanosem turqisht ose metanoi greqisht, të përdoren fjalën penohem (pendohem)*, të cilën e konsideron fjalë gegërisht dhe kjo fjalë nuk është i vetmi gegizëm në veprën e tij. Në këtë mënyrë duke kërkuar afrimin e dy dialekteve kryesore të shqipes, ai promovon idenë e njëismit të saj.

Naumi duke qenë i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm se pastrami dhe pasurimi i gjuhës sonë kërkon një punë të gjatë dhe të pandërprerë, u drejtohet djemëve të rinj shqiptarë:

Gjuha jonë ka marrë shumë fjalë dhe shprehje të huaja të cilat duhet të zëvendësohen me fjalë dhe shprehje shqipe, që fillimisht mund të mos tingëllojnëëmbël, por, kam shpresë që me kohë do tëëmbëlsohen. Unë hoqa disa fjalë të huaja dhe i zëvendësova, aq sa munda me fjalë që i ndërton vetë. Disa prej tyre që s'ua gjeta sesinë (mënyrën për të zëvendësuar), i lashë ashtu, me shpresë që ju, o djem, do të mundohi ta përfundoni punën që kam nisur, do të vihi jo vetëm ta qëroni, por dhe satë mundni ta shtoni.

Dhe në fakt është kryer një punë e gjithanshme sistematike dhe me afat të gjatë për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, që sigurisht duhet të vijojë pareshtur.

Ëvetari i Naumit është abetarja e njësisë kombëtare, abetarja që na mëson se gjithë ai popull që flet gjuhën shqipe, është popull shqiptar, një dhe i pandarë, se ai vend ku jeton ky popull është vendlermi (atdheu) i shqiptarëve, Shqipëria një dhe e pandarë.

Abetaret e tij ishin lajmëtaret e para të arsimit kombëtar shqiptar dhe nxitën qytetarët e Korçës që të hapin një fushatë ndihmash për të ngritur një tipografi edhe shkolla, në mënyrë që mësimi që mësimi të shtrihet në gjithë atdheun tonë dhe në gjithë kombin tonë.

Përkrahje të jashtëzakonshme Naum Veqilharxhi pati nga personalitetet më të shquara të kulturës rumune dhe bullgare, të cilët shkruan artikujt të shumtë, me ngrohtësi për popullin shqiptar dhe për veprën e Naum Veqilharxhit, duke theksuar se: "Përpjekjet e Naumit mund të konsiderohen si një simbol kombësie rreth të cilit mund të mblidhen të gjitha pjesët e shpërndara prej aq shekujsh".

Naum Veqilharxhi e kuptoi rrezikun e madh që paraqisnin shkollat e huaja për bashkimin e popullit shqiptar dhe çlirimin kombëtar. Pas krijimit të shtetit grek dhe forcimit të tij ekonomik, me miratimin e autoriteteve turke, në Shqipërinë e Jugut filloi një fushatë e dendur për ngritjen e shkollave greke, që kishte për qëllim përhapjen e gjuhës dhe të kulturës greke në hullinë e synimeve helenizuese.

Naum Veqilharxhi e kishte të qartë se "shkollat greke janë të organizuara për të ndriçuar rininë greke dhe jo vetëm ndricimin e popullit shqiptar. Në*Qarkoren* 1846 që u dërgonte bashkëkombësve, Naum Veqilharxhi shkruan se: vetëm kombet që kanë një gjuhë të shkruar, mund të hyjnë në rangun e kombeve të qytetëruara, ndërsa të tjerët do të jenë në injorancë, mbasi për t'u shkolluar, shqiptarët detyrohen të shkojnë në mërgim. Në këtë mënyrë largohen nga të afërmit e tyre, humbin gjuhën amtare dhe nuk punojnë për vendin e tyre, por për lulëzimin e kombeve të tjera".

Si iluminist, Naum Veqilharxhi mendonte se mëismi i shqipes dhe ngritja e kulturës mund ta vinin atdheun në radhën e vendeve të qytetëruara. Çlirimi kulturor, për Naum Veqilharxhin, ishte një faktor pa të cilin nuk mund të arrihej çlirimi politik. Në këto kushte Naum Veqilharxhi ishte i pari që ndjeu nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit në gjuhën amtare për të penguar helenizimin e vendit.

Në parathënen e *Ëvetarit* të dytë në vitin 1845 Naumi shprehet se: është për t'u çuditur që ne shqiptarët jemi kaq të ndryshëm nga popujt e tjerë, që nuk mund ta shkruajmë as edhe ta lexojmë gjuhën tonë.

Naumi në parathënien e dytë të vitit 1845 shkruan:

Gjatë mësimit të gjuhës shqipe, fëmijët do të kenë vështirësi vetëm për të njohur shkronjat, mbasi gjuhën e kanë të mësuar nga nënat e tyre dhe çdo libër që do të marrin në dorë, do ta lexojnë dhe do ta kuptojnë.

Gjuha shqipe do t'i ndihmojnë ata edhe kur të kalojnë në klasat e larta, ose edhe për të mësuar gjuhët e huaja.

Kudo në botë dihet se është gjuha e vendit që preferohet. Gjuhët e huaja shërbejnë vetëm për disa që kanë të bëjnë me të huaj. Por edhe të huajt mund ta mësojnë gjuhën shqipe, në qoftë se e kanë të nevojshme. Si demokrat që ishte, Naumi kërkonte një arsimim për gjithë popullin, me shkolla laike, ku vendin kryesor në tërësinë e njohurive do ta zinin lëndët shkencore.

Gjuha amtare, shkruante ai-është faktor i rëndësishëm për zhvillimin mendor të fëmijës dhe për përvetësimin e shpejtë të njohurive të dhëna në shkolla.

BIBLIOGRAFIA:

Çabej, Eqrem, *Për pastërtinë e gjuhës*, në revistën: "Gjuha Shqipe", 2/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prsihtinë, 2008.
Islamaj, Shefkije, *Kultura e shkrimit sot dhe nesër*, në revistën: "Gjuha shqipe", 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998.
Llojdia, Gwzim, në gazetën "Ndryshe", e enjte, 26 korrik 2007.
Meksi, *Fedhon, Naum Bredhi Veqilharxhi, Dimensionet e vërteta të ideologut të Rilindjes*, Argeta-LMG, Tiranë, 2012.
Skendi, Stavro, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Tiranë, 2000.

E- ISSN 2337-0521 *ISSN 1800-9794*

ORIENTIMI PROFESIONAL I NXËNËSVE TË KLASËS SË 9-të NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

M.Sc. Safete Statovci-Shala-Instituti Pedagogjik i Kosovës
Skender Mekolli-Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstrakt

Ky publikim është rezultat i punës hulumtuese për përvojat dhe qëndrimet e nxënësve të klasave të 9-ta rreth informimit, përcaktimit për profesionin e ardhshëm, këshillimit dhe mbështetjes nga shkolla dhe prindërit për orientimin profesional të tyre për shkollim të mëtejmë.

Qëllimi i hulumtimit është gjetja e përgjigjeve në pyetjet: Çka paraqet një orientim profesional dhe i drejtë në shkollimin e ardhshëm për zgjedhjen e profesionit? Cilat janë profesionet më të preferuara të nxënësve? Cili është orientimi profesional i nxënësve? Çfarë është mbështetja e shkollës dhe prindërve për orientim profesional? A duhet të aplikohet si lëndë mësimore "orientimi në karrierë"?

Popullacionin e përbëjnë nxënësit e klasave të nënta nga i cili është përzgjedhur mostra e hulumtimit. Kjo mostër përfshinë 1817 nxënës të 87 shkollave nga 30 komuna të shtatë regjioneve të Kosovës.

Të dhënat e këtij hulumtimi paraqesin informimin dhe këshillimin e nxënësve të klasave të nënta për orientim në karrierë, preferencat e tyre, përzgjedhjen e profesionit të ardhshëm, mbështetjen nga mësimdhënësit dhe prindërit e tyre si dhe qëndrimet e këtyre të fundit ndaj përcaktimit të profesionit të arshëm të fëmijëve të tyre.

Sipas këtyre të dhënave, profesionet më të pëlqyera janë: mjekësia, mësimdhënia, arkitektura, aktrimi, dizajnimi, profesioni i policit, informatika (IT), psikologjia, inxhinieria, profesioni i sportistit, etj.

Profesione që pëlqehen më shumë nga vajzat janë mjekësia, mësimdhënia, dizajni, psikologjia, edukimi etj., kurse djemtë kanë preferenca për disa profesione të tjera, si për sport, polici, inxhinieri, për profesionin e pilotit etj.

Bazuar në ndikimin e madh që ka informimi me kohë në zgjedhjen e drejtë të profesionit të ardhshëm, është e nevojshme futja e një lënde të veçantë shkollore si "orientimi në karrierë", nëpërmjet së cilës nxënësit do të merrnin informacione të drejtpërdrejta për profesionet e ardhshme.

Rezultate e dala nga ky hulumtim, synojnë të kontribuojnë në politikat arsimore për informim, këshillim dhe udhëzime në përzgjedhjen e profesionit.

HYRJE

Nxënësit në shkollat e mesme të ulëta, sa i përket karrierës, thuajse janë të papërcaktuar se çfarë është karriera dhe se çfarë rëndësie ka ajo.

Orientimi profesional për karrierën është një proces për të cilin çdo individ, jo vetëm nxënësit e klasës së 9-të, por edhe çdo i ri që kërkon të kualifikohet ose të rikualifikohet, e ka të domosdoshme të gjejë zgjidhjen optimale të drejtimit që do të marrë gjatë jetës së tij. Ai luan një rol vendimtar për të ardhmen e nxënësve dhe kërkon që nxënësi dhe familja e tij të mendojnë për këtë shumë seriozisht.

Në marrjen e një vendimi për profesionin e ardhshëm ose drejtimin e zhvillimit të mëtejshëm të karrierës, nxënësit mund gabohen. Zgjedhja e gabuar e profesionit mund të shkaktojë zhgënjim dhe pakënaqësi më vonë. Nxënësit e shkollave fillore nuk janë shumë të pjekur për të marrë vendime për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm. Ata nuk janë shumë të vetëdijshëm për veten, mundësitë dhe aftësitë e tyre dhe nuk e njohin mirë situatën në tregun e punës, llojet e vendeve të punës dhe numrin e profileve arsimore që ofrohen pasi që ka shumë profesione dhe numri i tyre është vazhdimisht në rritje. Ato po shfaqen çdo ditë e më shumë e që nuk ekzistonin më parë ose të paktën nuk ekzistonin në formën aktuale.

Orientimi profesional është mjaft kompleks. Ai ka të bëjë së pari me vetë nxënësin, pastaj edhe me prindërit e tij dhe mësimdhënësit. Roli i prindërve është kryesisht për të informuar fëmijët rreth llojeve të ndryshme të profesioneve, për t'i këshilluar dhe ndihmuar ata në zgjedhjen e profesionit të tyre duke marrë parasysh preferencat e tyre, por ata nuk duhet të japin ndonjë vendim përfundimtar. Këtë funksion më së miri mund ta kryej mdonjë këshill për orientim në karrierë apo shërbim profesional.

Nga ky hulumtim del se orientimi profesional është me rëndësi të veçantë pasi që në Kosovë nxënësit pas përfundimit të shkollës së mesme të ulët, fillojnë vetë orientimin në karrierë në shkollat e mesme të larta të cilat kanë profile dhe drejtime të ndryshme.

Kësaj çështjeje nuk i është kushtuar rëndësi në të kaluarën. Duke marrë për bazë sistemin e sotëm shkollor dhe dominimin e gjimnazeve me numrin e nxënësve të regjistruar, del sikur profesionet e tjera nuk kanë qenë aq joshëse për nxënës dhe kësaj, ndoshta, i ka kontribuar edhe sensibilizimi i pamjaftueshëm shoqëror dhe institucional për rëndësinë e profesioneve të tjera.

KONTEKSTI TEORIK

Në kuadër të kësaj teme, janë publikuar hulumtime të ndryshme, megjithatë nuk mund të thuhet se nuk ka ç'të hulumtohet e ç'të shkruhet edhe në të ardhmen rreth saj.

Sipas Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë, 2017-2021, Objektivi strategjik 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimi i të rriturve, këshillimi dhe orientimi në karrierë është një shërbim i domosdoshëm për një sistem funksional të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në vend. Ky shërbim, përmes këshilltarëve të karrierës, do të sigurohet për të gjitha shkollat e Arsimit dhe Aftësimit Profesional. Këshillimi dhe orientimi në karrierë është funksional në sistemin e shkollimit për nxënësit dhe të rriturit, (Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, pika 6.6 Prishtinë 2016).

Rreth informimit të nxënësve në orientimin e drejtë profesional një kontribut e ka dhënë Januz Dërvodeli me tekstin hulumtues "Informimi dhe orientimi profesional". Autori ka një qasje gjithëpërfshirëse, duke e trajtuar nevojën që ka njeriu për ndihmë, e në këtë kontekst veçanërisht nxënësit në një pikë të caktuar të moshës së tyre. Ai trajton edhe aspekte të tjera që janë në funksion të një informimi sa më të plotë të kësaj kategorie nxënësish në orientimin e tyre profesional, duke filluar nga roli i familjes, pra i prindërve, pastaj roli i shkollës me procesin e rregullt mësimor, por edhe me aktivitetet jashtëmësimore. (Dërvodeli, 1997).

Dr.Vaxhid Nuredini, (Prishtinë 1999), e trajton në mënyrë të kompletuar dhe gjithëpërfshirëse këtë temë, duke shprehur edhe referenca të shumta nga autorë të ndryshëm që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë fushë.

Në literaturën rreth kësaj teme gjejmë definicione të ndryshme dhe një terminologji adekuate, e cila termin "orientim profesional" e përshkruan si një veprimtari shumë të rëndësishme që ndikon në mënyrë të drejtë në orientimin profesional të nxënësve. Ka definicione të shumta rreth kësaj teme edhe pse pranohet fakti se një definicion i plotë e i përmbyllur është vështirë të arrihet, duke e pasur parasysh karakterin e vetë aktivitetit të orientimit profesional të nxënësve.

Draft Strategjia për udhëzime në karrierë përcakton qartë definicionet për *edukimin në karrierë*, *informimin në karrierë* dhe *udhëzimin në karrierë*.

Edukimi në karrierë - aktivitet në shkolla, kolegje etj për t'iu ndihmuar studentve të qartësojn synimet e tyre në karrierë, kuptojnë botën e mësimit dhe zhvillojnë shkathtësitë e menaxhimit të karrierës

Informimi në karrierë - të shtypura,*të bazuara në kompjuter* ose shërbime direkte për të përgatitur dhe shpërndarë informata për punët dhe karrierën, kurset e studimit dhe trajnimet profesionale për t'iu ndihmuar individëve që të bëjnë zgjedhjen në karrierë.

Udhëzimi në Karrierë - këshillime personale, përkrahje dhe këshillim për të ndihmuar me vendimet rreth kurseve fillestare të studimit, kurset e trajnimit profesional, arsimim dhe trajnim, zgjedhjen fillestare të punës, ndërrimin e punës ose ri-hyrjen në fuqinë punëtore.(Draft Strategjia, 2015-2017).

,,Edukimi për karrierën nuk mund të jetë efektiv, nëse kryhet vetëm në raportin mësues-nxënës. Edukimi për karrierën duhet të jetë i hapur për bashkëpunim me ofruesit e edukimit" (Niklaniviç, Nikshiqi, 2011).

Informimi i plotë dhe me kohë i nxënësve për orientim profesional, është i një rëndësie të veçantë. ,,Hulumtimi dhe shfrytëzimi i informatave për mundësitë e shkollimit dhe profesioneve të ndryshme, i mundëson të rinjve të arrijnë qëndrime të reja në lidhje me kompetencat personale dhe kërkesat e shkollës dhe profesioneve" (Kaemmerer, 2013).

,,Qëllimi kryesor i programit është zhvillimi i aftësive të rinjve që të marrin dhe zbatojnë vendim të paramenduar, të vlefshëm dhe të pavarur lidhur me zgjedhjen e shkollës dhe profesionit, si dhe të planifikojnë karrierën dhe të kyçen në botën e punës" (Stevenson, 2014).

Orientimi profesional definohet si "ndihmë individit para zgjedhjes së profesionit në atë mënyrë që t'u përgjigjet prirjeve dhe aftësive psiko-fizike të tij. Sipas Stevenson, orientimi profesional është veprimtari profesionale shoqërore sistematike, e organizuar dhe komplekse në ofrimin e ndihmës së individit para zgjedhjes së drejtimit të zhvillimit profesional.

Pra, në këtë mënyrë përfshihen disa kërkesa dhe cilësi që duhet të kihen parasysh në orientimin profesional të nxënësve, si nga prindërit apo shkolla, e këto janë: "harmonizimi i dëshirave të nxënësve me interesat e shoqërisë", që këshillat rreth orientimit të jenë menduar vetëm si mundësi "për zgjedhjen e rrugës më të mirë", dhe që gjithsesi të jenë në përputhje me talentin që kanë nxënësit për profesione të caktuara.

Në këtë aspekt gjithmonë duhet të merren parasysh karakteristikat e nxënësve dhe zhvillimi i tyre profesional.

Rëndësi i është kushtuar edhe informimit të drejtë e të gjithanshëm, duke ua bërë të ditur nxënësve se janë prirjet e tyre, aftësitë dhe preferencat e tjera, si shëndeti, kushtet ekonomike a rrethana të tjera sociale që

duhet të dominojnë në raport me dëshirat e tyre, të cilat edhe mund të mos jenë reale e objektive, gjithmonë duke i përfshirë këto karakteristika. ,,Orientimi në karrierë është një sërë procesesh të hartuara për t'ua mundësuar individëve që të bëjnë zgjedhje dhe tranzicione të informuara për arsimim dhe punë". (EYE-Enhanncing Youth, 2014).

Ky proces zhvillohet në disa faza, prej përcaktimit të problemit, përmes pranimit dhe përpunimit të informacioneve, deri te vendimi dhe realizimi. Zgjedhja e profesionit si proces mësimi, qasja në teorinë e mësimit, e cila shpjegon zgjedhjen e profesionit, vështron ,,Konceptin personal, tërësinë e përshtypjeve nga fushat e jetës (familja, shkolla etj.) dhe metodat e mësuara për zgjedhjen e problemeve, si dhe përvojat e të mësuarit, të cilat ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe çojnë deri te zgjedhja e vetëdijshme e profesionit" (Niklaniviç, Nikshiqi, 2011).

Orientimit profesional i nxënësve është kontribut i rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e personalitetit të tyre, dëshirës, aftësive për vendim-marrje, orientim, zellshmëri, gatishmëri, qëndrueshmëri dhe aftësi për të krijuar lidhje për komunikim me tregun e punës.

PYETJET E HULUMIMIT

- Çka paraqet një orientim profesional dhe i drejtë në shkollimin e ardhshëm për zgjedhjen e profesionit?
- Cilat janë profesionet më të preferuara të nxënësve?
- Cili është orientimi profesional i nxënësve?
- Çfarë është mbështetja e shkollës dhe prindërve për orientim profesional?
- A duhet të aplikohet si lëndë mësimore "orientimi në karrierë"?

METODOLOGJIA

Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është analiza e gjendjes aktuale në shkollat e mesme të ulëta rreth informimit, këshillimit dhe mbështetjes nga shkolla dhe prindërit për orientimin profesional të nxënësve të klasës se 9-të, në Kosovë.

Objektivat e studimit lidhen me qëllimin që synohet të arrihet me këto objektiva specifike të orientuara në evidentimin e:

- Nivelit të informimit të nxënësve për orientimin në karrierë;
- Qëndrimit dhe qasjes së shkollës ndaj kësaj çështjeje;
- Praktikave të shkollave në orientimin e drejtë profesional;
- Qëndrimit dhe mbështetjes së fëmijëve nga prindërit;
- Orientimit në karrierë si lëndë mësimore

Metodat

Për të arritur qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore. Metoda sasiore është përdorur për marrjen e perceptimeve dhe informacioneve nga nxënësit rreth informimit, këshillimit dhe mbështetjes nga shkolla dhe prindërit për orientimin profesional të tyre. Të dhënat cilësore për dhunën në shkollë janë marrë nga pyetjet e hapura të pyetësorëve. Varësisht nga fazat e zhvillimit të hulumtimit, janë përdorur edhe këto metoda: Është përdorur metoda e analizës së dokumenteve ligjore, dokumente dhe vendime tjera të miratuara nga MASHT. Përmes metodës së analizës kemi analizuar literaturën përkatëse që lidhet me objektin e hulumtimit dhe përgjigjet e dhëna në pyetësor i kemi përmbledhur përmes metodës së sintezës. Me anë të metodës statistikore kemi paraqit të dhëna statistikore dhe në fund përmes metodës deskriptive kemi përshkruar rezultatet e hulumtimit.

Me metodën krahasuese është bërë krahasimi i rezultateve të fituara nga qasjet sasiore dhe cilësore të hulumtimit.

Instrumentet

Hulumtimi për orientimin profesional të nxënësve të klasës së 9, është realizuar përmes anketimit. Anketimi është realizuar me pyetësorët për anketim.

Pyetjet janë të tipit të mbyllur, por ka edhe të tipit të hapur. Shumica e pyetjeve të tipit të mbyllur kanë vetëm nga një alternativë, kurse të tjerat janë me shumë alternativa. Pyetësorët kanë të dhënat e përgjithshme si mosha, gjinia, klasa etj. dhe pyetjet që lidhen me hulumtimin si informimi i nxënësve rreth orientimit profesional nga shkolla apo nga prindërit, profesionet e preferuara dhe profesionet për të cilat janë përcaktuar, mbështetjen për orientim në karrierë si dhe qëndrimin e prindërve në orientimin dhe zgjedhjen e profesionit.

Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i hulumtimit përbëhet nga nxënësi e klasave të nënta të shkollave të Kosovës. Nga ky popullacion i gjerë është zgjedhur mostra e hulumtimit nga 30 komuna të Kosovës, më saktësisht 87 shkolla të mesme të ulëta. Mostra e nxënësve të përfshirë në hulumtim përbëhet nga 1817 nxënës. Përzgjedhja e nxënësve për anketim është bërë në mënyrë rastësore. Janë anketuar nxënësit e një paraleleje të nëntë që ka qenë e pranishme në momentin e vizitës në shkollë.

Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

Në fazën e parë janë mbledhur të dhënat përmes hulumtimit kabinetik të cilat janë shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar. Në fazën e dytë, janë përgatitur instrumentet e hulumtimit, është bërë pilotimi i tyre në një shkollë dhe pas disa ndryshimeve dhe plotësimeve të vogla, hulumtimi është realizuar në terren me mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve nga mostra e zgjedhur paraprakisht. Plotësimi i pyetësorëve për nxënës është bërë gjatë një ore mësimore në prani të anketuesit pas sqarimeve të nevojshme për arsyet dhe qëllimin e realizimit të këtij hulumtim duke iu përkujtuar atyre se pyetësori është anonim dhe shërben vetëm për qëllim studimi.

Të dhënat sasiore janë analizuar me metodën statistikore përmes Excel-it dhe janë paraqitur në mënyrë grafike e tabelare. Të dhënat cilësore të mbledhura nga pyetjet e hapura të pyetësorëve, janë analizuar duke përdorur analizën e interpretimit dhe duke grupuar përgjigjet për çdo pyetje të cilat pastaj janë interpretuar në mënyrë përshkruese.

REZULTATET

Rezultatet nga pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim, janë paraqitur të sistemuara në pjesë të cilat paraqesin në fillim të dhënat e përgjithshme, pastaj profesionet e preferuara dhe të zgjedhura, informimin e nxënësve për orientimin në karrierë nga ana e mësimdhënësve dhe prindërve, qëndrimet e prindërve për orientimin e fëmijëve të tyre si dhe aplikimin e orientimit ne karrierë si lëndë mësimore.

Si hap i parë, ne do të përqendrohemi te të anketuarit që iu përgjigjën këtij hulumtimi sipas kritereve të gjinisë, moshës, gjendjes familjare dhe përgatitjes profesionale të prindërve të tyre.

Kështu shikuar sipas strukturës së nxënësve të intervistuar, 49 % e tyre kanë qenë meshkuj dhe 51 % femra.

Sa i përket kriterit gjeografik të përfshirjes së shkollave në anketë, afro 60 % e tyre (saktësisht 59.84), kanë qenë shkolla në vendbanime urbane, kurse pak më shumë se 40 % (saktësisht 40.16 %), nga vendbanimet rurale. Nga hulumtimi rezulton se 63.74% të baballarëve, të nxënësve të anketuar kanë kualifikim të mesëm, 6.79 % e tyre kualifikim të lartë, respektivisht një diplomë Bachelori, 19.36 % e tyre kanë pasur diplomë fakulteti, kurse 10.11 % e tyre kanë diplomuar në Master. 71.19 % nga nënat e nxënësve kanë kualifikim të mesëm, 5.35 % kualifikim të nivelit Bachelor, 17.49 % diplomë fakulteti, kurse 5.97 % kanë pasur diplomë të nivelit Master. Nga prindërit e nxënësve të anketuar, të punësuar të gj. mashkullore janë 88.3 %, kurse vetëm 27.82 % janë të gjinisë femërore.

Tabela 1. Punësimi i prindërve

Punësimi	Po	Jo
Babai	88.34	11.66
Nëna	27.82	72.18

.

Tabela 2. Niveli i shkollimit të prindërve

Niveli i shkollimit	I mesëm	bachelor	fakultet	master
Babai	63.74	6.79	19.36	10.11
Nëna	71.19	5.35	17.49	5.97

1. **Profesionet e preferuara**

Nga nxënësit e anketuar ka dalë një listë e gjatë profesionesh të preferuara, megjithatë dominojnë disa prej tyre. Në krye të kësaj liste janë: mjekësia, mësimdhënia, arkitektura, aktrimi, dizajnimi, profesioni i policit, informatika (IT), psikologjia, inxhinieria, profesioni i sportistit, këngëtarit etj. Siç shihet, mjekësia dhe arsimi, pra mësimdhënia, kanë rezultuar si profesionet më tërheqëse.



Grafiku 1. Profesionet e preferuara

Nga të gjithë nxënësit e anketuar, 29.02 % janë shprehur se e pëlqejnë profesionin e mjekësisë, kurse profesionin e mësimdhënies 24.17 %. Arkitekturën si profesion e pëlqejnë 13.66 % e nxënësve, kurse aktrimin 10.33 % prej tyre. Profesione tjera me një përqindje më të vogël janë dizajni me 8.63 %, informatika me 8.54 %, për të vazhduar pastaj me psikologjinë, inxhinierinë, sportin, avokaturën, profesionin e policit, ushtarit, farmacistit, ekonomistit etj.

Një numër i madh i profesioneve (mbi 40), përfaqësohen me një përqindje rreth 1 % apo më pak. Mund të përmenden disa nga këto profesione siç janë jurist/e, fizioterapeut/e, gjykatës/e, gazetar/e, futbollist/e, artist (art figurativ), dentist/e, pedagog/e, shkrimtar/e, regjisor/e, modele, matematicient/e, prokuror/e, kuzhinier/e, elektricist, pediatre, sociolog/e, gjeodet/e, historian/e, arkeolog/e, xhamaprerës, fotograf/e, tregtar/e, farkatar/e, mishshitës, vozitës/e, argjentar, dekorator/e, instruktore e komunikacionit, etj.

Sipas preferencave gjinore, mjekësinë si profesion e pëlqejnë 76.47 % të vajzave, kurse 23.53 % të djemve. Edhe profesioni i mësimdhënies nga të gjithë të anketuarit, pëlqehet nga vajzat, madje edhe më shumë se ai i mjekësisë, që shprehur në përqindje, ky raport është 79.55 % me 20.45 % në favor vajzave. Pra preferencat për profesione të caktuara dallojnë në mes të djemve dhe vajzave. Për profesione të caktuara, siç janë mjekësia, mësimdhënia, dizajni, psikologjia, edukimi etj., vajzat shprehin preferenca shumë më të theksuara se djemtë, derisa, për shembull, për disa profesione të tjera, si për sport, polici, inxhinieri dhe veçanërisht për profesionin e pilotit, djemtë janë shumë më të interesuar se sa vajzat.



Grafiku 2. Preferencat e profesioneve sipas gjinisë

2. Zgjedhja e profesionit

Për dallim nga preferencat për profesione të caktuara, me rastin e përcaktimit të profesionit, pra zgjedhjes së profesionit, nxënësit në përgjigjet e tyre kanë qenë më të arsyeshëm dhe më real në zgjedhjen e profesionit, duke qenë të vetëdijshëm se megjithatë pavarësisht dëshirës për profesionin e pëlqyer, ata zgjedhin një profesion tjetër sepse paraprakisht e dinë se mundësitë për regjistrim janë minimale qoftë për arsye të kriterit të suksesit apo numrit të kufizuar të nxënësve për pranim. Profesionet e zgjedhura nuk dallojnë shumë nga ato të pëlqyerat. Vlerat e tyre në përqindje janë më të ulëta. Edhe këtu prin mjekësia me 28.61 % me përfaqësim gjinor 68.58 % me 31.42 % në favor të vajzave. Pason mësimdhënia me përqindje po thuajse të njëjtë. Profesionin e dizajnit e kanë zgjedhur 90 % të vajzave për dallim nga djemtë me 10 %, të gazetarisë 92.31 % të vajzave nga 7.69 % të djemve. Me të njëjtat përqindje në favor të vajzave përfaqësohen edhe profesionet e farmacistes, psikologes e përafërsisht edhe ai i stomatologes dhe këngëtares. Profesionet që kanë zgjedhur të anketuarit e gjinisë mashkullore, janë informatika (IT), ekonomia, inxhinieria, futbolli, dhe policia, përqindjet e të cilave sillen nga 80 deri në 95 %. Grafiku në vazhdim paraqet profesionet e zgjedhura dhe raportin gjinor të kësaj zgjedhjeje.



Grafiku 3. Zgjedhja e profesioneve sipas strukturës gjinore

Lidhur me atë se ç'mendojnë të arrijnë me përcaktimin për një profesion të caktuar, ata kanë specifikuar disa nga opsionet. Shumica prej tyre, më saktësisht 59.64 % shprehen se duan ta kenë këtë profesion. 57.32 % nga të anketuarit kanë bërë këtë zgjedhje sepse ata duan të zhvillohen profesionalisht, kurse një numër i konsiderueshëm, që të bëhen të pavarur materialisht. Disa të tjerë e kanë bërë këtë zgjedhje vetëm sa të kenë një diplomë.

3. Informimi i nxënësve nga mësimdhënësit dhe prindërit me kohë për zgjedhjen e drejtimit në shkollën e mesme të lartë

Lidhur me atë se sa nxënësit kanë pasur informacion nga shkolla, respektivisht nga mësimdhënësit apo edhe nga literatura tjetër plotësuese për orientimin e tyre profesional, për rëndësinë dhe profesionet e mundshme ku ata mund të orientohen në shkollimin e tyre të mëtejmë, nga hulumtimi, kanë dalë këto rezultate: 43.27 % e nxënësve janë shprehur se kanë pasur informacion për mundësinë e përcaktimit të tyre në ndonjë profesion të ardhshëm, 47.76 % e nxënësve janë shprehur se kanë pasur informacion vetëm "deri diku", derisa 8.97 % e nxënësve janë shprehur se nuk kanë pasur kurrfarë informacioni rreth kësaj çështjeje. Informimin më të plotë për orientimin në karrierë, nxënësit e kanë nga prindërit e tyre. Kështu 83.75 % e nxënësve të anketuar, kanë deklaruar se ata janë të informuar nga prindërit e tyre, 13.91 % deri diku, kurse vetëm 2.34 % janë përgjigjur negativisht, pra se nuk janë informuar dhe se prindërit fare nuk interesohen për orientimin e tyre profesional.



Grafiku 4. Informimi i nxënësve nga mësimdhënësit dhe nga prindërit

Rreth përcaktimit të tyre për profesionin e ardhshëm, pjesa dërmuese e nxënësve këshillohen në radhë të parë me prindërit e tyre. Kështu 92.73 % e nxënësve, janë përgjigjur se këshillohen me prindër, 61.04 % me mësimdhënësit, 36 % e nxënësve janë përgjigjur se marrin mendimet e të afërmve, kurse 17.06 % e tyre janë përgjigjur se këshillohen me nxënës të tjerë të shkollave të mesme rreth profesioneve të mundshme orientuese. 16.07 % e nxënësve janë përgjigjur se këshillohen me pedagogun e shkollës rreth kësaj çështjeje.



Grafiku 5. Këshillimi i nxënësve për profesionin e ardhshëm

Pavarësisht se vetëm 8.97 % e nxënësve në pyetjen për informimin janë përgjigjur se nuk kanë qenë të informuar për orientimin e tyre profesional në të ardhmen, nga këta nxënës shumica prej tyre janë shprehur se arsyet e këtij mosinformimi qëndrojnë në mungesën e qendrave këshillimore për informim, jo gatishmëria e mësimdhënësve për t'i informimur nxënësit si dhe mosfunksionimi i shërbimit të pedagogut dhe psikologut të shkollës.

4. Mbështetja për orientim në karrierë

Lidhur me mbështetjen për orientim në karrierë, shumica dërmuese e nxënësve, apo 84.51 % e tyre janë shprehur se orientimi i duhur profesional duhet të mbështetet në rezultatet e arritshmërisë së individit, pastaj 55.68 % e tyre janë përgjigjur se ky orientim duhet të jetë i përcaktuar nga zgjedhja që bën vetë nxënësi, e tek pastaj vijnë përgjigje, në përqindje shumë më të pakëta, se janë prindërit (22.38 %) dhe mësimdhënësit (21.22 %) ata që duhet të merren parasysh në orientimin e drejtë profesional të nxënësve. Ndërsa dukshëm më pak nxënës janë përgjigjur se në orientimin e tyre profesional duhet merren në konsiderim edhe rrethana të tjera, siç janë afërsia e shkollës (16.47 %) dhe kostoja e shkollimit (6.54 %).

Gjithsesi edhe këto shifra tregojnë se nxënësit megjithatë kanë gjykime të drejta për peshën e orientimit të tyre në shkollimin e mëtejmë, duke u mbështetur në radhë të parë në aftësitë e tyre, si dhe në vlerat e tjera që duhet t'i posedojnë.



Grafiku 6. Mbështetja për orientim në karrierë

5. Qëndrimi i prindërve në orientimin dhe zgjedhjen e profesionit

Nga hulumtimi rezulton se 60.41 % e nxënësve janë përgjigjur se prindërit i mbështesin në zgjedhjen e orientimit të tyre profesional, 31.96 % janë shprehur se prindërit u propozojnë zgjidhje konkrete në orientimin e tyre shkollor, derisa 12.03 % e nxënësve janë përgjigjur se prindërit nuk përzihen fare në këtë çështje. Sipas përgjigjeve të nxënësve 6.82 % e prindërve ua imponojnë fëmijëve të tyre orientimin profesional.



Grafiku 7. Qëndrimi i prindërve në orientimin dhe zgjedhjen e profesionit

6. Ndikimi i informimit të pamjaftueshëm në zgjedhjen e drejtë të profesionit

Rezultatet nga hulumtimi tregojnë se informimi i pamjaftueshëm mund të ndikojë në zgjedhjen e gabuar të profesionit. Shumica e nxënësve e pohojnë këtë pa i specifikuar më tej shkaqet e mosinformimit apo rrethana të tjera që kushtëzojnë mosinformimin e duhur.

Jo pak përgjigje kanë qenë se ende nuk kanë "informimin e duhur" për t'u përcaktuar për profesionin e tyre të ardhshëm.

Duke i analizuar rezultatet e përgjigjeve të dala nga nxënësit, vërehen "vështirësitë" që u paraqet momenti i përcaktimit për një profesion të caktuar. Kjo nuk është e lehtë, kështu që ndihma e të tjerëve është e nevojshme, e në raste të caktuara, edhe e domosdoshme. "Na duhet ndihma e prindërve, këshillat e mësimdhënësve, udhëzimet e shkollës", kanë deklaruar shumë nxënës.

Duke u bazuar në ndikimin e madh që ka informimi me kohë në zgjedhjen e drejtë të profesionit të ardhshëm, shumica e nxënësve kanë paraqit nevojën e ekzistimit të një lënde të veçantë shkollore, të cilën disa e kanë quajtur saktësisht "orientimi në karrierë", nëpërmjet së cilës do të merrnin informacione të drejtpërdrejta për profesionet e ardhshme, si dhe për karakteristikat e tjera të këtyre profesioneve, që pastaj ata të përcaktohen për ndonjërin prej tyre.

PËRFUNDIM

Orientimi profesional është një kërkesë e rëndësishme për një karrierë të suksesshme në të ardhmen. Ky orientim profesional ndihmon në zgjedhjen e një profesioni ideal apo të një karriere. Një karrierë e suksesshme është e lidhur ngushtë me një profesion të zgjedhur mirë.

Të dhënat e këtij hulumtimi paraqesin informimin dhe këshillimin e nxënësve të klasave të nënta për orientim në karrierë, preferencat e tyre, përzgjedhjen e profesionit të ardhshëm, informimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësit dhe prindërit e tyre si dhe qëndrimet e këtyre të fundit ndaj përcaktimit të profesionit të ardhshëm të fëmijëve të tyre.

Nga këto të dhëna rezulton se profesionet më të pëlqyera janë: mjekësia, mësimdhënia, arkitektura, aktrimi, dizajnimi, profesioni i policit, informatika (IT), psikologjia, inxhinieria, profesioni i sportistit etj.

Preferencat për profesione të caktuara dallojnë në mes të djemve dhe vajzave. Për profesione të caktuara, siç janë mjekësia, mësimdhënia, dizajni, psikologjia, edukimi etj., vajzat shprehin preferenca shumë më të theksuara se djemtë, derisa, për shembull, për disa profesione të tjera, si për sport, polici, inxhinieri dhe veçanërisht për profesionin e pilotit, djemtë janë shumë më të interesuar se sa vajzat.

Rreth përcaktimit të tyre për profesionin e ardhshëm, pjesa dërmuese e nxënësve këshillohen në radhë të parë me prindërit e tyre dhe me mësimdhënësit. Një numër më i vogël prej tyre janë përgjigjur se marrin mendimet e të afërmve, e disa të tjerë rreth profesioneve të mundshme orientuese, këshillohen me pedagogun e shkollës rreth kësaj çështjeje.

Shumicë dërmuese e nxënësve, janë shprehur se orientimi i duhur profesional duhet të bazohet në rezultatet e arritshmërisë së individit, pastaj në zgjedhjen që bën vetë nxënësi, e tek në fund, në zgjedhjen e prindërve apo opinionin e mësimdhënësve.

Numri më i madh i nxënësve janë përgjigjur se prindërit i mbështesin në zgjedhjen e orientimit të tyre profesional. Në pjesë e tyre kanë deklaruar se prindërit nuk përzihen fare në këtë çështje, kurse 6.82 % e prindërve ua imponojnë fëmijëve të tyre orientimin profesional.

Bazuar në ndikimin e madh që ka informimi me kohë në zgjedhjen e drejtë të profesionit të ardhshëm, është e nevojshme futja e një lënde të veçantë shkollore si "orientimi në karrierë", nëpërmjet së cilës do të merrnin informacione të drejtpërdrejta për profesionet e ardhshme.

REFERENCAT

- Dërvodeli Januz(1997): "Informimi dhe orientimi profesional", Prishtinë
- Erwin Kaemmerer, Paedagogische Hochschule des Bundes in Steiermark (2013) përkthyer: nga Ana Drgutijeviq "Orientimi profesional pesë hapat derite vendimi për shkollimin dhe profesionin"Beograd.
- EYE-Enhanncing Youth, 2014).
- MASHT,(2007): "Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007 -2017", Prishtinë
- Niklaniviç Sasha, Nikshiqi Eralda (Konsulentë) 2011 ,,Edukimi për karrierën",Tiranë
- Nuredini Vaxhid, (1999): "Orientimi profesional i nxënësve", Prishtinë
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, 2017-2021
- Stevenson Linda (2014): ,,Edukimi në karrierë-Doracaku i mësimdhënësve" Prishtinë

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

SHQIPTARËT NË MAL TË ZI NDËR VITE, NGA RËNJA NËN PUSHTETIN E MALIT TË ZI DERI NË FAKTOR TË RËNDËSISHËM PËR PAVARËSINË E TIJ

Hajro Hajdari

Abstracti

Teritorret shqiptare në Mal të Zi, shtrihen në pjesën juglindore dhe veri-lindore të tij, përgjatë kufirit me Shqipërinë. Ato në pjesën juglindore, nga Ulqini, Tivari e deri në Malësi paraqesin një tërësi territoriale homogjene, ndërsa pjesa tjetër, Plava, Gucia e Rozhaja, nuk kanë lidhje integrale territoriale, ndonëse kanë një të kaluar të hidhur historike, gjuhë e kulture të njëjtë.Territori ku banojnë shqiptarët në Mal të Zi kufizohet në të gjitha anët me shtetin amë Shqipërinë, përveç Rozhajës që kufizohet me Kosovën.

Shqiptarët në Mal të Zi për nga gjuha, raca, tradita, historia dhe nga të gjitha elementet përbërëse të indetitetit kombëtar, pa dyshim janë pjesë e pa ndarë e trungut mbarëshqiptar. Ata, deri në Kongresin e Berlinit bënin pjesë në Sanxhakun e Shkodrës, ndërsa një kohë Plava, Gucia dhe Rozhaja bënin pjesë në Sanxhakun e Kosovës. Sot, ata jetojnë të ndarë në 5 njësi administrative dhe ato në Komunën e Ulqinit – qyteti I Ulqinit dhe Ana e Malit, Tivarit-Kraja, Podgoricës-Malesia më qender Tuzin, Rozhajë-Dacaj dhe Plavë-Plave e Guci.Të gjitha këto njësi administrative kufizohen më shtetin amë Shqipërinë dhe Kosovën – Dacajt.

Krahinat shqiptare të Shqiperisë Veriore, pjesë e pandarë e trungut mbarëkombëtar, duke jetuar në kufi me Malin e Zi në vazhdimësi kanë qenë në konflikt të hapur jo vetëm me ushtrinë malazeze por edhe me banda të ndryshme malazeze të cilat kryenin krime të ndryshme ndaj populates të pambrojtur shqiptare. Në çdo konflikt të armatosur gjatë historisë, të karakterit lokal apo ndërkombëtar, janë kryer veprime jonjerzore dhe krime ndaj popullatës dhe vetë personave të armatosur. Sigurisht, viktimat me të spikatura të krimit ishinë popullata civile e pambrojtur të shprehura në forma të ndryshme të krimit, si me vrasje individuale dhe masive, maltretime fizike, plagosje, debimet me dhunë nga shtëpitë dhe trojet e veta, shkatrimi i shtëpive, monumentave kulturore,objekteve fetare si dhe konvertimi me dhunë në fe apo komb tjetër. Përmbajtja dhe forma e krimit mvaret nga qasja e këtij problemi dhe shumë herë nga interesi i hulumtimit të krimit të caktuar.

PARA KONGRESIT TË BERLINIT

Kriza Lindore e cila padyshim paraqet ngjarjen më të madhe diplomatike në shekullin XIX-të, ishte ndikuar së paku nga tri arsye të theksuara:1.Kriza e brëndshme e Përandorisë Osmane dhe dobësimi i saj; 2. Lufta e popujve të shtypur për formimin e shtetëve të tyre kombëtare;3. Kontradiktat midis fuqive të mëdha për zotërimin ekonomik e politik mbi Përandorinë Osmane e natyrishtë pyetja se kush do t'i merrte territoret Osmane pas shembjes së saj.

Mali i Zi, duke përfituar nga nga kriza e brëndshme e Perandorisë Osmane dhe përparimeve të Rusisë mbrenda territorit osman, gjithnjë e më tepër po çfaqte interesat e saja për zgjerimin territorial. Natyrisht, më e lehtë ishte të sulmonte krahinat shqiptare që kufizoheshin me Malin e Zi. Fillimisht Mali i Zi, në vitin 1857 Në vitin 1857, Mali i Zi sulmon Kuçin (shumica e popullit ishin shqiptarë) e pastaj vazhduan të

sulmojnë, pa asnjë arsye apo sa për të provuar forcat me malësor, fshatrat e Trieshit: Nikmarashin, Bucën dhe Stjepohin.Trieshnjanët më trimëri e heroizëm u mbrojtën nga sulmi malazez të cilët pësuan disfatë të rëndë

Në mengjesin e nëntorit të vitit 1861, njëkohësisht, forcat malazeze sulmuan Muriqin e Sipërm , Muriqin e Poshtëm.të cilët malazezët e quanin Krajë. Pjetri Kola (shqiptar), të cilin banorët e fashatit malazez të Krricës e kishin zgjodhur për kapetan, propozoi që të sulmohet e gjithë Kraja. " Së pari vllëzër të sulmojmë Muriqin. Nese e thejmë rezistencën e këtij vendi zëkeq, Kraja do të jetë e Malit të Zi" kishte thënë ai.Më 17 janar 1862[187] nisi luftën në Krricë ku forcat vullnetare shqipare ia dolen t'i zbrapsin forcat malazeze duke u shkaktuar humbje të mëdhaja.

Provokimet malazeze në zonat kufitare çuan në një luftë ndërmjet Malit të Zi dhe Turqisë. Malazezët, nën komanden e serdarit të Vasoviqit, Vulo Radoviqit, në shkurt të vitit 1862, sulmuan postën kufitare në Vraninë, duke bërë mizori e djegur me dhjetëra shtëpi shqiptare. Ndërkaqë në maj të vitit 1862 sulmoi Hotin dhe Grudën.

Serbia dhe Greqia se bashku tentojnë të organizojnë një kryengritje kundër Perandorisë me qëllim të rregullimit të interesave të tyre në Gadishullin Ballkanik. Lidhur më këto interesa Greqia dhe Serbia, më 26 gusht 1867, në Voeslau (Austro-Hungari) nënshkruan Traktat Aleance ndërmjet Greqisë dhe Sërbisë. Për të zbatua sa më mirë Traktatin e përmendur më 28.02.1868 në Athinë, u nënshkrua një konventë ushtarake e msheftë greko-serbe, e cila do t'i bashkangjitet Traktatit të Voslaut. Më këtë marrëveshje parashikohej që Greqia të marrë një pjesë të Maqedonisë, ndërsa Serbia të marrë Kosovën dhe Shqipërinë Veriore. Ishte ky Traktati i pare i cili parashikonte coptimin e trojeve Shqiptare.

Mali i Zi qysh më herët kishte përpiluar planet e veta ekspasioniste të shtrirjës territoriale në dëmë të tokave shqipëtare. Plani grabitës i tyre parashikonte që, përveç të tjerave, të pushtojnë tokat në mes liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe detit Adriatik, zaptimin e Tivarit dhe Ulqinit më qëllimin përfundimtar zaptimin e Shkodrës, ëndërr shekullore e tyre. Pushtimi i këtyre territorëve shqiptare për Malazezët, përveç efektit politik, kishte rëndësi të madhe ekonomike sepse sigurimi i tokave pjellore dhe dalja në det u mundësonte atyre sigurimin e kafshatës së bukës, civilizimin e tyre dhe jetë më të mirë, pasi deri atëherë jeta ekonomike në Mal të Zi ka qenë e mjerë. Më rëndësi janë tokat pjellore, ullinjtë, e mbi të gjitha ishte deshira e flaktë për të dalë në bregdet, që së fundi të kemi kontakt me botën e civilizuar" thonte Bozho Petroviqi[188]dhe se " Mali i Zi gjithmonë ka menduar që të shlirohet nga shtërngimi i malëve të veta, që të jetë në lidhje më të madhe me detin Adriatik"[189] (Vetë Knjaz Nikolla, pas suksesëve në Hercegovinë, kishte deklaruar " Kamë vetëm edhe një deshirë, ta marrim Tivarin që Mali i Zi të fitone daljen në det. [190]

Për të realizuar ekspasionizmin territorial, Malazezët, sëpari filluan përgaditjen për zaptimin e Tivarit. Malazezët bombardonin mbrenda në kala, digjëshin e plaçkitnin shtëpi edhe jashtë kalasë përveç se shtëpitë e të krishterëve i kursenin nga djegja dhe plaçkitja. Situata ishte tejet e vështirë por ushtria turke nuk dorëzohej. Nga 600 shtëpi sa kishte në kala ky qytet i vogël, asnjëra nuk shpetoi, më se gjysma e tyre u bënë shkrum e hi ndërsa të tjerat u shëndruan në gërmadha. Ushtrija turke dhe vullnetarët shqiptarë gati 2 muaj u rezistuan sulneve barbare malazeze dhe u detyruan të dorëzohe. Kjo ndodhi, më 10 janar 1878, në ora dy pasdreke ndërsa dy batalione të ushtrisë malazeze, dy orë më pas hynë në kala.

Duke u nisur nga lakmia e madhe e malazezëve për tokat shqiptare dhe ëndërra e tyre shekullore që të zaptoje sa më shumë troje shqiptare, 14 batalione të ushtrisë malazeze, nën udhëheqjen e Bozho Petroviqit, por komandant i vërtetë ishte Pllamenci, vazhduan rrugën e vet drejt Krajës, Anës së Malit qyteteve shqipëtare, Shkodrës dhe Ulqinit.

---

[187]Po aty

[188] Novak Razhnjatoviq,, Crna Gora i Sanstefanski mir, istorijski zapisi br.3-4, Titograd 1976

[189]Glas Crnogoraca nr 24, 14 qersh 1880**.**

[190]Riza Rexha, Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ulqin 1998, Simo Popoviq , Memoari Beograd 1995,

Novak Razhnjatoviq,, Crna Gora i Sanstefanski mir, istorijski zapisi br.3-4, Titograd 1976

Vullnetarët ulqinakë të cilëve u prinin Mehmet Beci, Asllan Begu Resulbegu dhe Haxhi Bet Gjyli vendosen të mos dorzohen dhe të luftojnë deri në vdekje vetëm e vetëm që shkjaut mos t'i lëshojnë asnjë pllëmbë tokë shqiptare. Vullnetarët ulqinakë të cilëve u prinin Mehmet Beci, Asllan Begu Resulbegu dhe Haxhi bet Gjyli vendosen të mos dorzohen dhe të luftojnë deri në vdekje vetëm e vetëm që shkjaut mos t'i lëshojnë asnjë pllëmbë tokë. Edhe ushtria malazeze pësoi humbje të konsideruranë ketë betejë, sipas burimeve të tyre kishte 70 ushtarë të vrarë e 110 të plagosur. Pas një mbrojtje të fortë e pas shumë viktimave Ulqini më 19 janar 1878, për herë të parë zaptohet nga ushtria malazeze.

Mali i Zi më parë pas sulmeve të njëpasnjishme kishte zaptuar Trieshin dhe Kojën e Kuçit. Kështu në kuadër të Mali i Zi, më popullsi sllave, u përfshin edhe shqiptarët, musliman e katolik, të Trieshit, Kojës, Podgoricës e Zhabjakut, Tivarit dhe një pjesë të Krajës deri në afërsi të Ostrosit, të cilët nuk i priste tjetër përveç tentimit malazezë që ato sa më parë të sllavizohen

Eksposionizmi i Malit të Zi ndaj tokave shqiptare dhe sukseset e ushtisë ruse në territorin osman e shtyu Perandorinë Osmane të hynte në bisedime me Rusinë për arritjen e paqës. Në këto rrethana Turqia, e imponuar edhe nga Rusia, ishte e detyruar që të pranoje nënshkrimin e armëpushimit i cili përfundimishtë u arritë me 31 janar 1878, në Edrene (Andrijanopojë).

Pas nënshkrimit të armëpushimit e me qëllim që tu jepet fund konflikteve të përhershme midis Turqisë dhe Malit të Zi, disa kilometra largë Stambollit, në Shën Stefan, më 3 mars 1878, u nënshkrua Marrëveshje e Paqës e cila njihet si Traktati i Shën Stefanit [191].

Fatkeqësisht Traktati i Shen Stefanit nuk e trajtoi fare çështjen shqipëtare sepse për Rusin, Shqipëria dhe çështja shqiptare në përgjithësi nuk ishin subjekt i të drejtave politike dhe as administrative ndërsa sipas këtij traktati Porta e Lartë e njeh një herë e përgjithmon pavarësin e principatës së Malit të Zi, Serbisë, Rumunusë dhe Bullgaria formohet si principatë autonome, tributare, më një qeveri të krishterë dhe më një milici kombëtare.

Megjithate, me vendimet e Traktatit të Shën Stefanit ishin të paknaqyr edhe Fuqitë e Mëdha Evropiane të cilat për këte arsye vëndosen të mbajnë një kongresë të veçantë ku do të korigjoheshin gabimet e këtij Traktati.Kongresi, nën kryesimin e Bismarkut, u mbajt në Berlin dhe zgjati nga 13 qershori deri më13 korrik të vitit 1878.

KONGRESI I BERLINIT DHE LUFTRAT BALLKANIKE

Për shqiptarët edhe vendimet e Kongresit të Berlinit ishin të padrejta dhe të papranueshme, meqenëse sipas vendimeve të tij Malit të Zi duhej t'i bashkangjiten vendet shqiptare si Tivari, Kraja përendimore Hoti, Gruda, Plava dhe Gucia, ndërkaq Ulqini i kthehej Turqisë (Shqiperisë).

Fillimisht Plava dhe Gucia e pastaj Hoti dhe Gruda e kundërshtuan me forcë aneksimin e këtyre trojeve shqiptare nga Mali i Zi kështu që Fuqitë e Mëdha se bashku me Perandorinë Osmane, me qellim të realizimit të vendimeve të Kongresit të Berlinit, u detyruan të kompenzojnë Malin e Zi, përseri, me toka shqiptare, këtë herë u flijua Ulqini i cili definivisht, pas një rezistence të fortë të vullnetarëve shqiptarë e tentative për të mbrojtur Ulqinin nga zaptimi sllav, më 26 nëntor 1880, ra nën sundimin e Malit të Zi.

Përkundër se Fuqitë e Mëdha, Malit të Zi i njohtën pavarësinë dhe zgjerimin e madh territorial, lakmija malazeze për trojet shqiptare nuk kishte të ndalur. Kështu Mali i Zi konsiderohet se i pari, më 8 tetor (26 shtator), sulmoi Turqinë (Shqipërinë) dhe kështu filloi Lufta e Parë Ballkanike dhe njëkohësisht invazioni malazez ndaj tokave shqiptare.

Në mbarim të Luftrave Ballkanike dhe me bekimin e Konferencës së Londrës (1913) e më pas Paqës së Parisit (1918) nën sundimin e Malit të Zi ranë edhe Ana e Malit, Kraja Lindore, Tuzi, Hoti, Gruda dhe Plava e Gucia.

Shqiptarë nuk u pajtuan më me okupimin e tokave të tyre nga një shtet sllav me të cilin nuk kishin asgjë të përbashkët, as historinë, asë gjuhën, as kulturë të ngjajshme madje edhe të bërit ekonomi ishin të ndryshme. Kundërshtimi i shqiptarëve, myslimanë e katolikë, kundër zaptimit të tokave shqiptare nga Mali

[191] Jusuf Buxhovi,Jusuf, Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Prishtinë, 2012

i Zi u manifestua, fillimisht, me pjesëmarrjen e tyre në luftë në anën e Turqisë kundër Malit të Zi, jo për të mbrojtur Turqinë por për të mbrojtur tokat e tyre shekullore nga agresoret e ri sllav, e më vonë edhe me proteste e peticione të ndryshme të cilat fatkeqësisht mbetën në sitaret e Fuqive të Mëdha.

Edith Durham, kjo mike e shqitarëve, duke vrejtur padrejtësitë e Kongresit të Berlinit ndaj shqiptarëve kishte cekur: " Për fat të keq Mali i Zi u shpërblye më tepër më toka shqiptare.Kjo ish një padrejtësi e madhe. Shqiptarët kishin luftuar për kombësin e tyre aq burrërisht sa edhe Malazezët dhe kurrë se kishin humbur autonomin e tyre lokale. Luftuan më rreptësi dhe i ndaluan Malazezët të pushtonin Plavën, Gucinë dhe Tuzin. Atëherë fuqitë kërkuan që ta zgjedhnin ndryshe këtë çeshtje duke bërë një vepër padrejtësie edhe më të madhe. Mr. Gladstoni, megjithëse njihte fare pak kishën Orthodokse , kish një simpati të jashtëzakonshme për te. Duke iu mbushur mëndja me iden e gabuar se çdo musliman isht turk , ay u bë i mendimit që t'i jipej Malit të Zi qyteti thjesht shqiptar i Ulqinit në vend të tre të parëve. Ky ish një vendim tepër i padrejtë dhe mizor.Ulqini, edhe në ditët e mbretërve Serbë kish patur autonomin e tij, dhe një kohë shtypte para të tija. Gjithë udhëtarët e kohëve të para shenojnë se atje flitej shqipja. Malëzezët jo vetëm që se merrnin dot por as u përkiste t'a merrnin.Vetëm një demonstratë detare e Fuqivë të mëdha i detyroi Shqiptarët t'a dorëzonin – një nga veprat kërcenonjëse nga më të shemtuarat që kanë njohur gjerë në atë kohë Fuqitë e Mëdha

Situata në trojet shqiptare tash më të okupuara nga Mali i Zi ishte e trazuar.

Gjatë luftës ballkanike, në territoret e banuara me shqiptar, ushtria dhe grupe civile të armatosura të Malit të Zi dhe Serbisë i aplikuan të gjitha mjetet e terrorit duke filluar që nga maltretimet fiziko-psiqike, vrasjet individuale dhe në grup, plaçkitjet, djegjet e shtëpiave, rrënimi i objekteve fetare deri të më e keqa konvertimi në fe dhe komb tjetër që padyshim, përveç vuajtjes fizike shkakton edhe vuajtje të rënda shpirtrore. Siç dihet më së tepërmi me të gjitha këto të këqija u përballua popullata e krahinës së Plavës dhe Gucisë.

Duke analizuar situatën në vendet e banuara me shqiptarë Komisioni Ndërkombëtar për krimet e kryera në luftrat ballkanike, kishte konstatuar: " Shtëpitë dhe fshatra të tëra u shëndrruan në hi, popullsia e pafajshme dhe e paarmatosur masovikisht janë masakruar, aktet të pabesueshme të dhunës, plaçkitje dhe brutaliteti i çdo lloji – janë mjete të cilat i ka përdorur dhe ende po i përdor ushtria serbe dhe malazeze, me qëllim të ndërrimit të plotë të karakterit etnik të rajoneve të banuara ekskluzivisht me shqiptarë. Duke kryer krimet e përmendura mbi popullin shqiptarë politika serbe e kohës mendonte që në këtë mënyre duke bërë " pastrimin etnike të tërritorëve" do të manipuloje me shënimet statistikore dhe kjo do tu ndihmoje atyre në çështjen e kërkesave serbe që do të parashtrohen në Konferencat e Paqës që po pasonin dhe do të kenë ndikim direkt në punën e Komisionit Ndërkombëtar për kufijtë. Siç ceket edhe në raportin e Komisionit Ndërkombëtar për krimet e ushtrisë serbe në luftrat ballkanike, krimet nuk janë vepër e vetëm disa përsonave, ato janë pjesë përbërse e politikës " kombëtare".

Edith Durham, kjo mike e shqitarëve, duke vrejtur padrejtësitë e Kongresit të Berlinit ndaj shqiptarëve kishte cekur: " Për fat të keq Mali i Zi u shpërblye më tepër më toka shqiptare.Kjo ish një padrejtësi e madhe. Shqiptarët kishin luftuar për kombësin e tyre aq burrërisht sa edhe Malazezët dhe kurrë se kishin humbur autonomin e tyre lokale. Luftuan më rreptësi dhe i ndaluan Malazezët të pushtonin Plavën, Gucinë dhe Tuzin. Atëherë fuqitë kërkuan që ta zgjedhnin ndryshe këtë çeshtje duke bërë një vepër padrejtësie edhe më të madhe. Mr. Gladstoni, megjithëse njihte fare pak kishën Orthodokse , kish një simpati të jashtëzakonshme për te. Duke iu mbushur mëndja me iden e gabuar se çdo musliman isht turk , ay u bë i mendimit që t'i jipej Malit të Zi qyteti thjesht shqiptar i Ulqinit në vend të tre të parëve. Ky ish një vendim tepër i padrejtë dhe mizor.Ulqini, edhe në ditët e mbretërve Serbë kish patur autonomin e tij, dhe një kohë shtypte para të tija. Gjithë udhëtarët e kohëve të para shenojnë se atje flitej shqipja. Malëzezët jo vetëm që se merrnin dot por as u përkiste t'a merrnin.Vetëm një demonstratë detare e Fuqivë të mëdha i detyroi Shqiptarët t'a dorëzonin – një nga veprat kërcenonjëse nga më të shemtuarat që kanë njohur gjerë në atë kohë Fuqitë e Mëdha

Krajl Nikolla , menjëherë pas përfundimit të Luftrave Ballkanike,më 8 nëntor 1913, iu drejtua popullit të vetë, me ç'rast proklamon bashkimin e të gjitha krahinave të okupuara në kufijtë që janë caktuar

me Mbretërin e Serbisë, sipas kontratës të nënshkuar në Beograd, me Shqipërinë sipas Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe me Bosnën dhe Hercegovinën sipas kufijëve të deritanishëm.

Kështu, më Proklamatën për aneksimin e vendeve të okupuara, të banuara krejtësisht me shqiptarë formalisht shqiptarët u bënë nënshtetas malazez. Po themi në mënyrë formale, pasi Proklamata për aneksimin e trojeve shqiptare nuk u zyrtarizua asnjë herë sipas kushtetutës në fuqi të Malit të Zi, e cila në nenin 73 të sajë parashikon:" As një Ligj nuk mund të nxiret, të abrogohet, të përshtatet ose në mënyrë obligative të interpretohet pa pëlqimin e Kuvendit Popullor" çka do thotë se Krajli nuk e dërgoi Proklamatën për aneksimin e trojëve shqiptare për marrjen e pëlqimit në Kuvendin Popullor. Thënë thjeshtë Kuvendi Popullor nuk pruri asnjë vendim apo akt me të cilin edhe juridikisht territoret shqiptare do të bëhën pjesë e territorit dhe jurisdikcionit malazezë. Edhe zgjedhjet parlamentare në Mbretërinë e Malit të Zi të mbajtura më 29 dhjetor 1913 (11 janar 1914), pra atëherë kur kishin përfunduar luftrat ballkanike dhe pas shpalljes së Proklamatës, u mbajtën dhe deputetët u zgjodhën vetëm në pjesën e vjetër të Malit të Zi, sigurisht, pasi nuk kishte bazë juridike .

Shqiptarët vazhdonin të kundërshtonin aneksimin e trojeve të tyre etnike nga Mali i Zi. Banorët e Krajës dhe Anës së Malit iu drejtuan konsullatave të Fuqive të Mëdha në Shkodër me peticion me të cilin protestonin për okupimin e këtyre territorëve nga Mali i Zi dhe kërkonin që t'i bashkangjiten Shqipërisë. Në memorandumin e bërë në emër të 23 katundeve të Anës së Malit, derguar autoritetëve të Europës dhe Austro-Hungarisë,[192] ndër të tjera thuhej:

" këto vende i kanë kënë të shenjueme Malit të Zi. Mbasi katundet t'ona janë të gjitha krejt shqyptare, pa asnji malazias, lutëna që këta 23 copë katunde mos të keputen prej te dashtunit atdheut t'on Shqypnies prej se ciles nuk duem kurrsesi të ndahem"

Dy muaj para mbajtjes së Konferencës së Paqës në Paris, më 18 nëntor 1918, u mblodhën në Shkodër, burrat e fiseve të Hotit e Grudës, iu drejtuam Mbretërisë së Bashkuar, Francës e Italisë, me kërkesë që të iu mundësohet bashkimi me Shqipërinë, ku ishin edhe më parë.

MBRETËRIJA SKS DHE E JUGOSLLAVISË

Fundi i Luftës së Parë Botërore, Malin e Zi e gjeti të okupuar nga forcat aleate të Francës, Anglisë, Italisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Serbisë. Në vendet ku jetonin shqiptarët në Mal të Zi, trupat italiane ishin vendosur në Ulqin e Tivar, ku kishte edhe trupa franceze, trupat amerikane në Podgoricë, ndërsa trupat serbe ishin vëndosur në mbrendi të Malit të Zi (edhe në Plavë e Guci) dhe për nga numri ishin forcat më të shumta okupuese.Trupat okupuese aleate qendruan në territorin e Malit të Zi deri në qershor të vitit 1920 (Italijanet).

Tani më Serbija kishte proklamuar idenë për një shtet të përbashkët të sllloveneve të jugut. Qeveria e Serbisë, në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 1918, formoi Këshillin për çështje politike në Mal të Zi, i cili, pasi trupat serbe hynë në Mal të Zi, mënjëherë filloi punën për bashkimin e këtyre dy shtetëve.

Në lidhje me bashkimin e këtyre dy shteteve çdo gjë përfundoi me Konstituimin e Kuvendit të Madh të Podgoricës më 26 nëntor 1918, I cili me votim me thirje, ndër të tjera vëndosi që Mali i Zi të bashkohet me vllezërit serb në një shtet të vetëm nën dinastinë e Karagjorgjeviqit, dhe në një bashkim i tillë të hyjë në atdheun e përbashkët të popullit tonë treemëror, Serb, Kroat e Sllovenë

Duhet theksuar se në vendet e banuara me shqiptarë, në kapetaninë e Ulqinit, Krajës dhe Bunës (Katërkollë) mbledhjet dhe zgjedhjet për Kuvendin e Podgoricës nuk janë mbajtur, ndërsa komisioneret e zgjedhur në rrethin e Plavës dhe Gucisë nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e përgjithshme të komisionerëve të mbajtur në Andrijevicë.

Sipas këtij vendimi shtetësija, ndërkombtarisht e pranuar e Malit të Zi, anulohet dhe territori i tij, me veprim unitarist, u bashkue territorit të n jë shteti tjetër – Serbisë dhe populli malazez u inkorporua në popullin serb Duhet theksuar se me krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate–Sllovene, gati gjysma e popullsisë shqiptare mbeti në këte Mbretëri.

---

[192] Eqrem Zenelaj, Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, rivalitetet e brendshme në Shqipëri dhe rruga e pavarësisë 1912-1913

Sidoqoftë, okupuesi i ri i tokave shqiptare, Mali i Zi,sipas dispozitave të vendimeve të Kongresit të Berlinit u detyrua nga Fuqitë e Mëdha, që të rrespektoje liritë dhe të drejtat civile dhe politike të të gjithë qytetarëve dhe se përkatësia kombëtare dhe fetare nuk mund të ishte pengesë e realizimit të tyre. Nisur nga ky fakt Mali i Zi ka qenë i obliguar që të rrespektoj të drejtat dhe liritë civile dhe politike të qytetarëve si individ dhe kolektivitet, por fatkeqësisht Kontrata e Berlinit nuk parashikonte sanksione në rast të mosrealizimit të tyre, çka do thotë se nuk u përcaktua mekanizmi i realizimit, nivelit dhe kualitetit të drejtave dhe lirive të qytetareve për qytetaret e aneksuar, konkretisht për shqiptarët.

Ndaj kombësisë shqiptare në përgjithësi e shqiptarëve në Mal të Zi në veçanti, në Mbretërinë Jugosllave terrori ndaj tyre ishte i përditësuar i cili shprehej përmes burgosjeve, maltretimeve psikologjike dhe fizike madje edhe vrasjeve. Ajo ishte burg i vërtetë jo vetëm për shqiptarët por edhe për pakicat tjera kombëtare. Shqiptarët nuk gëzonin as të drejtat minimale kombëtare si të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare, të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike, të drejtën e zhvillimit të kulturës kombëtare e të individualitetit kombëtar, veprimtarisë botuese në gjuhën e vet, përdorimin e simboleve kombëtare etj., mungesa e të cilave i çoj shqiptarët drejt rrugës së asimilimit.

Në të gjitha periudhat te sundimit të të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene ose Jugosllave pozita kushtetuese juridike e shqiptarëve në Mal të Zi ishte e njëjtë me pozitën e shqiptarëve në trojet tjera shqiptare. Kjo periudhë karakterizohet me shkeljen e të drejtave dhe lirive qytetare civile dhe politike, me qëllimin përfundimtar të pushtetit: shkombtarizimi dhe asimilimi i shqiptarëve në tërësi.

Në Mbretërinë Serbe, Kroate dhe Sllovene, viset e banuara me shqiptarë në Mal të Zi,si edhe në Mbretërinë e Malit të Zi, edhe përkundër resurseve natyrore dhe mundësisë për zhvillim më të shpejtë ekonomik, si pasojë e politikës së padrejtë të qeverisë shtetërore, bënin pjesë në viset më të prapambetura të vendit nga pikëpamja ekonomike. Në të vërtetë në situate të ngjajshme ishin edhe të gjitha viset tjera të banuara me shumicë shqiptare si në Kosovë, Maqedonin Perëndimore, dhe Luginën e Preshevës. Në qytetet e trojeve shqiptare, në kohën e Mbretërisë SKS, forma kryesore e ekonomizimit ishte tregëtija dhe zejtarija, madje një pjesë e mirë e popullsisë qytetare merrej me bujqësi, industria ishte në zanafillën e saj kështu që mbizotëronte tipi i ekonomisë natyrale, ndonëse kishte kushte të favorshme natyrale e demografike, për 705

Duke analizuar pozitën e shqiptarëve në Mal të Zi, qoftë në Mbretërinë e Malit të Zi apo të Mbretërisë Serbo-kroate-sllovene dhe asaj të Jugosllavisë mund të konstatojmë disa veçori.

Pushtimet e para të trojeve shqiptare nga malazezët u bënë në mënyrë të dhunshme pa pëlqimin e tyre, duke përdorur format më brutale të okupimit: vrasjet individuale dhe kolektive, djegjen e shtëpijave dhe fshatrave të tëra, me arsyetim para opinionit ndërkombëtar se po kryenin çlirimin e tyre , kështu vendet e okupuara i pagëzonin ― vendet e reja të çliruara‖ (novooslobogjeni krajevi). Duhet përmendur se në disa raste, historiografia malazeze , vendet e okupuara i konsideronte si ― vende e reja të bashkangjitura‖ (novo pripojeni krajevi) ose ― vende të reja të fituara‖ (novo dobijeni krajevi), por në asnjë rast nuk konstatohet se të gjitha ato veprime ishin kryer me dhunë e pa asnjë bazë historiko-juridike.

Menjëherë pas okupimit të vendeve shqiptare përdorimi i gjuhës së popullatës së bashkangjitur‖ në vendet publike (administratë, gjyqësi, shkolla) jo vetëm që nuk u lejua por edhe u ndalua, veprime të cilat bënë që shqiptarët t‘i lëshojnë trojet dhe shtëpitë e tyre stërgjyshore.

Në kryengritjen e shqiptarëve të Malësisë të vitit 1910-1911, Mali i Zi synonte të jetë i paanshëm dhe sa më objektiv. Mirëpo, të gjitha veprimet e më vonshme tregojnë se planet dhe qëllimi kryesor i Malit të Zi ishte zaptimi i Shkodrës dhe fushave pjellore rreth liqenit të lumit Buna.

Gjatë luftrave ballkanike, përveç aktit të okupimimit me force e pa pëlqimin e tyre shqiptarët u ballafaquan me keqperdorimet dhe torturat të papara deri atëherë. Çarmatimi dhe kryqëzimi i shqiptarëve u vu në shërbim të krimeve dhe shpërnguljes së tyre me qëllimin përfundimtar pastrimin e trojeve etnike shqiptare e në formën më të butë asimilimin e tyre. Çarmatimi i shqiptarëve në Mal të Zi, si në kohën e Mbretërisë së Malit të Zi (pas përfundimit të Luftrave Ballkanika) e po ashtu edhe gjatë Mbretërisë Serbo-Kroate dhe Sllovene, nën preteksin se ―i tërë populli ishte i armatosur‖ paraqet formën më të mire për arsyetimin e dhunës ndaj tyre, por ―kryqëzimi‖ nuk kishte preteks e as arsyetim përveç tentimit të çthurjes së shqiptarëve nga ndjenjat kombëtare e fetare. Reagimi i mundshëm i shqiptarëve ishte: shpërngulja ose dalja në mal. Në të vërtetë Krajl Nikolla për të hulumtuar ―keqpërdorimet‖ formoi komisione të ndryshme,

por pasi pasojat ishin të rënda. Nuk qëndron fakti se Krajli nuk dinte për keqpërdorimet dhe masakrat ndaj shqiptarëve, dhe se për këtë arsye ngriti komisionet e hetimit, por është e qartë se veprimet jo njërzore ndaj shqiptarëve kishin mbërritë në veshin e ndërkombëtarëve dhe nga frika e komprimentimit të ― emrit malazez‖ ngriti komision e hetimeve, por si do të shihet më vonë rrezulltatet e hetimit nuk ndikuan në ndërrimin e politikës malazeze ndaj shqiptarëve dhe as përmirësimit të gjëndjes politiko-juridike të tyre.

Mendimi se okupimi i vendeve të Shqipërisë Veriore gjatë Luftës së Parë Ballkanike është në funkcion të çlirimit të atyre territoreve nga Perandoria Osmane, okupues shumëvjeçar i tokave shqiptare, dhe zhvillimit më të shpejt ekonomik dhe politik të tyre është i pabazuar në fakte, i pa arsyshëm dhe i papranueshëm. Nëse do të ishte në të mire të shqiptarëve, atëherë lind pyetja përse ushtria malazeze edhe pas okupimit të viseve shqiptare vazhdoi me terror të paparë, deri atëherë bile edhe në mënyrë më arragante se gjatë diteve të luftës. Djegja e fshatrave të tëra, çarmatimi dhe kryqëzimi apo konvertimi në fenë pravosllave, duke iu ndërruar dhe emrat, nën masat e dhunës, nga njëra anë, dhe si pasojë shpërngulja e shqiptarëve dhe boshatisja e fshatrave, arratisja në mal me qëllim shpetimi nga dhunimet malazeze, nga ana tjetër, tregojnë qartë synimet dhe qëllimet e Malit të Zi. Nëse Mali i Zi i okupoi dhe i aneksoi për të mirën e tyre, atëherë shtrohet pyetja pse në asnjë periudhë kohore të qenies së territoreve shqiptare nën sundimin e malazezëve nuk u trajtuan realisht të drejtat qytetaro-civile dhe politike të tyre.Pse nuk hapi shkolla në gjuhën shqipe, pse nuk u përfaqësuan realisht në organet administrative, ligjëvënse, gjyqësore e ekzekutive, pse trojet shqiptare mbetën ekonomikisht më të pazhvilluarat përkundër pozitës dhe kushteve më të favorshme natyrore për zhvillim më të mirë ekonomik. Përgjigja është e thjeshtë dhe nëpër mes të këtij punimi është arsyetuar: ― Mbaji në vuajtje për t‘i sunduar më lehtë‖.

Për këto fakte histografija malazeze deri me ditët e sotme ka heshtur madje ka tëntuar që të gjitha veprimet malazeze ndaj shqiptare t‘i arsyetojë si qëllim mire e në favor të çlirimit të shqiptarëve nga kthetrat e zaptuesit shumëvjeçar, Turqisë, ani se i futën nën kthetrat e veta, por gjendja, as politike e as socialo-ekonomike e shqiptarëve në Mal të Zi, për periudhën e përmendurr – afër 65 vite, nuk ndryshoi në të mirën e tyre, përkundrazi ajo përkeqësohej nga viti në vit.

Nisur nga të gjitha të dhënat dhe faktet historike me të cilat disponojmë mund të thuhet lirishtë se zaptimi i territoreve të Shqipërisë Veriore, gjegjësisht vendbanimeve ku sot jetojnë shqiptarët në Mal të Zi, s‘kishte elemente të luftës së drejtë çlirimtare që do të arsyetonte aneksimin nga ana e Malit të Zi, përkundrazi në mënyrë të faktuar mund të thuhet se qëllimi i vetëm i Malit të Zi ishte okupimi dhe aneksimi e jo çlirimit.

Bazuar në të gjitha dokumentat dhe korospondencën e kohës, historiografinë malazeze dhe shqiptare, në mënyrë retrospektive po ceki vetëm disa nga veprimet dhe mosveprimet e shtetit malazez (duke lënë pa numruar veprimet individuale) që patën pasoja në realizimin e të drejtave dhe lirive personale, civilo-politike dhe socialo ekonomike e të cilat patën ndikim serioz në jetën dhe pozitën kushtetuese juridike të shqiptarëve në Mal të Zi.

- Ndalimi i mësimit në gjuhën shqipe,si e drejtë themelore e se cilit për arsimin, pati si pasojë ngecjen në zhvillimin e të gjitha sferave të jetës dhe si rrjedhojë ato mbetën populli më i pa arsimuar dhe i vendosi ata në pozita jo të barabarta juridike me shtetasit tjerë malazez;
- Mosmundësimi i shprehjes së lirë me gojë, shkrim dhe shtyp në gjuhën amtare pa pasur frikën e një dënimi, si e drejtë themelore të shprehjes se mendimit të lirë, është atak themelor në ndjenjat kombëtare të sëcilës pakicë kombëtare, në rastin konkret shqiptare;
- Princi i Malit të Zi i ngarkoi shqiptarët me tatimet për shkollat, edhe pse nxënësit shqiptarë nuk i ndiqnin shkollat serbe, pra shqiptarët në krahasim me malazezët paguanin taksën e shkollës dy herë, edhe për mejtepet e tyre edhe për shkollat serbe. Kjo i përkeqësonte edhe më shumë kushtet ekonomike edhe ashtu shumë të rënduara. Barrë më e rëndë ekonomike ishte vendosja e pagesës së shërbimit ushtarak e njuhur si “ nizamija” pra shqiptarët u detyruan të blejnë shërbimin ushtarak nga Princi.Ishte kjo edhe një barrë fiskale më shumë për shqiptarët të cilët edhe në sferën e obligimeve financiare ndaj shtetit i bëri të pabarabartë me malazezët:

-Ndërhyrja në jetën private ishte e shpeshtë, kërcenuese dhe dënuese. Me ligj të veçantë pushteti malazez ndaloi varrosjen e qytetarëve të vdekur pa kaluar 24 orë, ndalim i cili ishte në kundërshtim të plotë me normat fetare dhe tradicionale të popullsisë myslimane. Kjo normë e pazakontë fyese i iritoi dhe brengosi shumë shqiptarët mysliman dhe ndikoi që një numër i tyre të shpërngulën në mesin e të cilëve ishte edhe prijsi fetar Myftiu, i cili i ofenduar iku nga Mali i Zi në Stambollë dhe nuk u kthye kurr më. Myslimanet në Ulqin u detyruan nga shteti të ngriten në këmbë me rastin e kalimit të përcjellsëve të kufomës malazeze dhe t'i mbyllnin dyert e dyqaneve (për xhenazet myslimane shteti nuk i detyronte). Ulqinaket e kishin patur zakon në varreza të jepnin ushqim, sidomos për fukarenjtë, por shteti me urdhëresë të veçantë e ndaloi këtë adet tradicioanal, madje dënoheshin ato qe e thyenin urdhëresën. (DACG, MUD 1898, dok. 1242, MUD 1902, dok. 27) Fillimisht, shteti i ndaloi të punonin puntorit private të myslimanëve të dieleve, veprim i cili i bëri të pabarabartë me malazeztë, pasi myslimanët nuk punonin as të premteve dhe kështu u përkeqësua gjendja e tyre ekonomike. Këto veprime përveç se shqiptarët i vunë në pozita juridike të pabarabarta me shtetasit tjerë, ndikuan edhe në shpërnguljen e tyre nga trojet e veta stërgjyshore;
- Detyrimi i myslimanëve dhe katolikëve shqiptarë për bartjen e kapicave malazeze, si në Ulqin, Tivar (DACG, MUD 1879, dok. 188, 189, 866) , Plavë e Guci, e cenon rënd denjitetin njerzor dhe nuk ishte tjetër veçse mënyrë për t'i bërë shqiptarët të shpërngulën e t'i lirojnë tokat për ardhacakët malazez;
- Çarmatimi dhe kryqëzimi i shqiptarëve në fenë pravosllave, për ka qëllimi dy veprime të pandara nga njëri tjetri, paraqet aktin më të ultë shtetëror, nënçmimin dhe nënvlerësimin më flagrant të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit. Këto veprime, të cilat më vonë u ndaluan nga Krajl Nikolla, u bënë me dijenin e plotë të shtetit dhe ishin në funkcion të projektit shtetëror për shpërnguljen e shqiptareve për qëllimin përfundimtar asimilimin e tyre. Edhe pse ndërhyri dhe i ndaloi veprimet e mëtejshme Krajl Nikolla nuk mund të lirohet nga përgjegjësija për këto veprime, pasi Cetinja zyrtare rregullisht njoftohej për çdo rast të "kërkesës vullnetare" për të kaluar në fenë pravosllave, madje shteti paguante edhe shpenzimet e nevojshme për konvertim. Se fundi si është e mundur që shteti mos të ketë përgjegjësi për veprimet e organeve shtetërore si atyre administrative ashtu edhe policore, ushtarake dhe gjyqësore;
- Plaçkitjet, vrasjet personale dhe në grupe e qindra e mijëra pleqëve, grave e fëmijëve shqiptarë, shpesh edhe pa gjyq, për arsye të shprehjes së mendimit të tyre ose mosbindjeve të urdhëresave të paligjshme të pushtetarëve jo profesional e të koruptuar, për ka përmasat dhe kohëzgjatja, përmbajnë në vehte elementet e gjenocidit ndaj popullit shqiptarë sidomos në periudhën e luftrave ballkanike dhe në fazë e parë të Mbretërisë SKS – 1918-1927;

- Punësimi i shumë pak ose aspak i shqiptarëve në administratën shtetërore dhe punët tjera publike (shqiptarët nuk u punësuan as si korijera dhe as puntor fizik as në organet e administratës publike dhe as të institucioneve si posta, banka, porte etj) ngadalsoi integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe është shprehje e mosbesimit ndaj shqiptarëve nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër është veprim i shkeljes së të drejtave për punësim të secilit qytetar, mosveprim ky i cili i vuri në pozita të pabarabarta juridike me shtetasit tjerë dhe nxitës i shpërnguljeve të shqiptarëve;
- Në vitet e para të okupimit, princi i Malit të Zi, në Krajë, Shestan dhe Trieshë për kapetan , si bartës i pushtetit lokal, emëroi shqiptarë vendas, ndërsa në vendet tjera si në Podgoricë, Tivar dhe Ulqin, i banuar 100 % me shqiptarë, e pastaj në Plavë e Guci për kapetan emëroi vetëm malazezët. Edhe në Krajë e Shestan, në vitin 1910, kur Mali i Zi po përgaditej të okupoje territore të reja shqiptare, i hoqi shqiptarët dhe në vend të tyre emëroi malazezët, mbase ato ishin të besueshmit e tyre. Ky veprim ishte hap mbrapa dhe mohim i të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në punësim në organet dhe institucionet publike nga njëra anë dhe nga ana tjetër shprehje e mosmirënjohjes, mosbesimit, rrespektit dhe denjitetit njerëzor të shqiptarëve që i bënë ato, po ashtu, të mos kenë besim të shteti dhe vet Mbreti;
- Ndërrimi i mbiemrave duke u shtuar mbrapashtesën sllave "iq" apo " viq" dhe ndërrimi i emërtimeve të vendbanimeve paraqet shkelje flagrante të drejtës personale të së cilit për tu deklaruar ashtu si e ndien vehten dhe sulm mbi integritetin e njeriut të lirë. Në të vërtetë pushtetit malazez ndërrimi i mbiemrave dhe vendbanimeve nuk u shërbeu tjetër veçse me veprim të tillë deshtën të fusin frikën të shqiptarët për të pasur më lehtë t'i ç'thurnin ato nga çdo gjë që ishte shqiptare;
- Përfaqësimi i shqiptarëve në Kuvendin e Pincipatës malazeze në zgjedhjet e para, në Krajë e Shestan i përgjigjej strukturës së popullsisë, ndërsa në vendet tjera, veçanarisht në Ulqin kjo nuk ndodhi. Në zgjedhjet e më vonshme gjendja në këtë sferë u keqësua edhe më shumë. Sidomos në Mbretërinë SKS dhe ate Jugosllave, përkundër se shteti kishte nënshkruar një "Kontratë për Mbrojtjen e Pakicave", shqiptarëve në Mal të Zi nuk iu mundësua bile as pjesëmarrja në zgjedhje e jo më të kenë mundësi të zgjedhin përfaqësuesin e vet (për të pasur të drejtë të bëhesh subjekt zgjedhor është dashur të keshë përkrahjen e më së paku 80.000 zgjedhsëve në mbarë territorin e Jugosllavisë). Liritë politike janë shprehje dhe garanci e ekzistencës aktive të njeriut në shoqëri për të jetuar në lartësinë e potencialit dhe kontributit të vet dhe kur të shëndrohen në të drejta kolektive këto të drejta krijojnë besimin që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe të lirë të shprehin pa frikë nga dënimi përkatësinë e etnicitetit të tyre me qëllim të zhvillimit arsimor-kulturor dhe ekonomiko-social të të gjithë qytetarëve. Me ligjet diskriminuese dhe veprimet e pushtetarëve në asnjë periudhë të sundimit serbo-malazez shqiptarëve nuk iu mundësua përfaqësimi adekuat i interesave të tyre as ekonomike dhe as politike. Të drejtat politike shpeshherë nuk mund të ndahen nga të drejtat civile, prandaj mund të thuhet se roli i shqiptarëve në këtë sferë të interesit ishte inferior dhe i parëndësishëm çka e bëri poziten e tyre juridike të palakmueshme e të pabarabartë me shtetasit tjerë malazeze;
- Vendet e banuara me shqiptarë ishin vende me resurse natyrore më të pasura të cilat mundësonin një zhvillim ekonomik më të shpejtë dhe mirëqenie sociale më të mirë. Ekspertet e vendit dhe të huaj kishin konstatuar përparësit e Ulqinit dhe vendeve tjera shqiptare për mundësitë e zhvillimit ekonomik, veçanarisht të turizmit. Në të njëjtën kohë ato kishin konstatuar se neglizhenca e shtetit dhe mos marrja e masave për krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik të këtyre trojeve kishte karakter politik, pasi arsyena tjerë nuk kishte. Sidoqoftë, përkundër pasurive natyrore të mëdhaja dhe përparësive ndaj territoreve tjera, vendet e banuara me shqiptar në Mal të Zi mbetën vendet më të pazhvilluara ekonomikisht;
- Aneksimi i territoreve shqiptare nga Mali i Zi, sidomos në vitin 1912-1913, asnjëherë nuk u sanksionua juridikisht dhe si i tillë nuk mund të ketë veprim juridik. Ç'është e vërteta Krajl Nikolla shpalli aneksimin e trojeve shqiptare por atë nuk e çoi kurr në Parlament për tu zyrtarizuar edhe pse Kushtetuta e shtetit në fuqi e obligonte. Në favor të këtij konstatimi shkon edhe fakti se zgjedhjet parlamentare që u mbajtën pas shpalljes se aneksimit nuk u mbajtën në territoret e aneksuara me arsyetim se Ligji zgjedhor nuk i kishte përfshirë ato territore, me fjalë të tjera pushteti malazez në krahinat shqiptare të Plavës e Gucisë, Hotit dhe Grudës, Anës së Malit dhe Krajës nuk u legjitimua asnjëherë, çka do thotë se këto vende mbetën vetëm të okupuara e të aneksuara në mënyrë joligjore, çka e bënë të qartë pozitën politiko-juridike të shqiptarëve në Mal të Zi. Nëse këtij konstatimi i shtohet edhe fakti i vendimeve të padrejta dhe joligjore të Kuvendit të

Podgaricës, atëherë është krejtësisht e qartë se hyrja e shqiptarëve në Mbretërinë e tre vllëzërve sllav është aqë i pa drejtë dhe i paligjshëm sa edhe humbja e subjektivitetit shtetëror malazez dhe bashkimi i tyre me Serbinë në shtetin e përbashkët SKS.
- Përkundër se Kushtetutat e vitit 1905, 1921 dhe 1931, përmbanin kapituj të vëçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, çka në kushte normale do të nënkuptonte se realizimi i tyre është i mbrojtur dhe i garantuar nga shteti, shqiptarët në Mal të Zi kurr nuk i realzuan ato së paku në nivelin dhe kualitetin e përcaktuar me kushtetutë dhe akte ndërkombëtare që kishin filluar të kenë ndikim, çka le të kuptojmë se shëndrrimi i normës kushtutuese imperative në ato deklarative ka qenë në funksion të politikës afatgjate hegjemoniste serbe me qëllim përfundimtar asimilimin e shqiptarëve.
Përfundimisht, është e qartë se shqiptarët në asnjë periudhë të sundimit serbo-malazez nuk i kanë gëzuar të drejta civilo-politike të parapara me aktet e mbrendshme të shtetit e aq më pak konform standardeve ndërkombëtare
Nga vështrimin im retrospektiv i të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në Mal të Zi në kuadër të legjislacionit pozitiv shtetëror të kohës del qartë se pozita kushtetuese juridike e tyre ka qenë neglizhuese, e pabarabartë dhe diskriminuese në krahasim me shtetasit tjerë në Mal të Zi.

PERIUDHE E JUGOSLLAVISË 1945 -1990

Shumica e shqiptarët në Mal të Zi, si edhe të gjithë shqiptarët në Mbretrinë e Jugosllavisë, në luftën Nacionalçlirimtare u radhiten në krahë të aleancës fituese, e udhëhequr në këto troje, nga Partia Komuniste e Jugosllavisë. Pa përfunduar mirë lufta e dytë botërore. Partia Komuniste e Jugosllavisë e muar kontrollin mbi të gjitha segmentet e jetës shoqëroro-politike duke filluar procesin e indokrinimit të popullatës . Ajo deshironte që vlerat e veta ideollogjike t'i paraqesë në atë mënyrë që ato të bëhën të pranishme për krejtë popullatën e duke afirmuar " **dëshirën ndaj popullit, Luftës Nacionalçlirimtare, bashkim-vllaznimit dhe luftën e sllaveve të jugut për liri**" me qellim që të popullata në përgjithësi e të rinjët në veçanti të mbjellë edukimin e të rinjëve në frymën e patriotizmit socialist, traditës të revolucionit popullor për ndertimin e shtetit ku të gjithë do të ishin të barabartë pa dallim feje dhe kombësije.

Kjo doktrinë komuniste, nga njëra anë jepte shpresë se gjëndja e shqiptarëve do të përmirësohej, nga ana tjetër që më ndarjet e para teritorijale dhe organizimin e pushtetit popullor,
Shqiptarët e patën të qartë se edhe në shtetin e ri me rregullim shtetëror komunist pozita e tyre politiko-juridike nuk do të përmirësohej dukshëm.

Mali i Zi, sipas kushtetutës të vitit 1946,në një mënyrë e kthen shtetësinë, e humbur në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, në kuadër të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Në bazë të ndahejes territoriale-administrative Mali i Zi (Kushtetuta e 1946) përbëhej prej 14 Qarqeve e 180 Këshillave Popullore Vëndore të cilët në vitin 1947 zvoglohen në 145. Sipas kësaj ndarje, vendet shqiptare në Mal të Zi, në shumicën e rastëve, kishin formuar Këshillat e veta Popllore dhe jepte shpresë se vetë ato do të qeverisin pushtetin vëndor.Në vitin 1949 zvoglohet numri i KPV dhe formohen, përveç Cetinjës, Nikshiqit dhe Podgoricës edhe 8 qytetem të tjera në mes të cilave edhe Ulqini. Ndërkaq në vitin 1955, me Ligjin mbi territorin e qarqeve dhe komunave në Republikën Popullore të Malit të Zi, ndahet në 5 rrethe dhe 36 komuna në kuadër të atyre qarqeve.
Vlen të theksohet se Ulqini, si vendbanim më kompakt dhe më i madh me shumicë të popullsisë shqiptare dhe një ndër qytetet më të mëdhaja në Mal të Zi, nuk u caktua si qëndër e qarkut por hyri në qarkun e Tivarit. Kjo ndarje territoriale ishte e dhimbshme për shqiptaret pasi së shpejti u abraguan komunat shqiptare si komuna e Katërkollës, e Krajës, e Tuzit, e Vuthajve,e pak më vonë edhe e Gucisë, pra shqiptarët më as sa i përket qeverisjes lokale nuk vëndoseshin për administrimin e të mirave lokale dhe mbeten pandikim në pushtetet e bashkangjitura lokalal së paku për arsye të mumrit të popullsisë.Nga viti 1958 hiqen qarqet nderësa nga viti 1960 deri në vitin 1990 numri i komunave në Mal të Zi mbetet në 20. Në këtë periudhë shqiptarët në Mal të Zi u ndanë në 5 njësi administrative – komuna dhe përveç në Ulqini ku shqiptarët janë në shumicë,shqiptarët në komunat tjera janë pakicë dhe me ndikim të vogël në vëndosje

qoftë polkitike apo zhvillimore. Duhet përmendur faktin se nga 20 komunat në Mal të Zi sëpaku 5 komuna kanë numër më të vogël banoresh se lokaliteti i Malësisë të cilës iu mohua e drejta e themelimit të komunës.

Në përfundim të Luftës Nacional Çlirimtare Mali i Zi ekonomikisht ishte në një nivel të ultë të zhvillimit ekonomik, prandaj detyrë themelore ishte mëkëmbje e ekonomisë në tërësi, ndërtimi i infrastruktures, shkollave, ndërtimi i fabrikave, zhvillimi i turizmit etj. Parrulla e bashkim – vllazërimit duke predikuar barazi në çdo lëmi të jetës shoqërore e politike, pa marrë parasysh përkatësit fetare e kombëtare,kishte ngjallur shpresën e shqiptarëve për një zhvillim ekonomiko-kulturor më të shpejt edhe për vetë faktin se vendet e banuara me shqiptarë kishin kushte dhe pozitë të mirë, ose më të mire, në krahasim me viset tjera malore të Malit të Zi.

Një ndër segmented kryesore për realizimin e doktrines komuniste padyshim ishte ngritja e një sistemi arsimor i cili nëpër mes planëve mësimore, librave dhe vetë punojsëve arsimorë do të ketë ndikim në edukimin e brezit të ri në frymën e platforms komuniste. Dhe vertetë hapja e shkollave në gjuhën shqipe (këte e mundësonte Kushtetuta e 1946) është fitorja më e madhe shqiptarëve në këtë periudhë. Po thuaj në çdo fshat u hapen shkollat fillore shqipe dhe shqiptarët kishin nisur rrugën e mbarë të arsimimit. Tekstet shkollore në shqip mungonin por ato siguroheshin fillimisht nga Shqipërija e pastaj nga Kosova. Ky gëzim dhe benefit i shqiptarëve për arsimim në gjuhën e tyre amtare nuk zgjati shumë pasi, sigurisht, atyre qe në fillim e kishin proklamuar ideollogjinë arsimore si "**dëshirë ndaj popullit, Luftës Nacionalçlirimtare, bashkim-vllaznimit dhe luftën e sllaveve të jugut për liri "** u pengonte arsimimi i popullit jo sllav dhe inegrimi i plotë i tyre në shoqëri. Kështu Qeveria e Malit të Zi në fillim të vitit 1956 kishte formuar komisione të veçanta për arsimin në gjuhën shqipe në përbërjen e të cileve nuk kishte përfaqësues shqiptarë dhe si pasojë në vendet e banuara me shqiptarë hapen paralelet në gjuhën serbe edhe pse fëmijët nuk dinin po thuaj asnjë fjalë të kësaj gjuhe. Përveç se nxënësit u detyruan të mësonin në gjuhën jo amtare sllave, po si në Mbretërinë Jugosllave, edhe shumë mesimdhënës në gjuhën shqipe mbetën pa punë. Rrezulltatet e dobëta që po arrinin fëmijët, sidomos nëpër shkollat e fshatrave, e shtynë pushtetin që përseri të rikthejnë mësimin në gjuhën amtare shqipe. Të theksojmë se shkolla e parë e mesme në gjuhën shqipe u hapë në vitin 1965 në Ulqin.

Pushteti i atëhershëm nuk ishte i interesuar për zhvillimin ekonomik të trojeve shqiptare, përkunder resurseve e mundësive zhvillimore shumë të mëdhaja. Ulqini me bukurit e veta natyrore, plazhet rënore ndër më të gjatat në Evropë, fushat pjellore, lumejt e liqejt në afërsi të tij kishin tërhjekur vëmendjen e të huajve. Një program i Kombëve të Bashkuara për zhvillim i kishte ofruar në vitin 1968 Jugosllavisë ndërtimin e komplekseve turistike në Plazhin e Madh të Ulqinit me kapacitet prej 40.000 shtretërve, por për shumë arsye, për shqiptarët të pa justifikuara, kjo ofertë, e cila do e kishte transformuar jo vetëm Ulqinin, u refuza. Qëndra e zhvillimit të turizmit u bë Budva e cila për nga resurset dhe mundësit as për së afërmi nuk i ka kapacitetet e Ulqinit. Duhet përmendur se qysh në kohën e Mbretërisë SKS Ulqini ishte përcaktuar si qëndër e zhvillimit të turizmit shëndetësor, pasi shkenctarisht, ujrat sulfurike dhe përmbajtja e rërës ishin përcaktuar më cilësi sheruese. Për fat të keq ajo qeveri e la punën pa e përfunduar , ndërkaq as sot e kësaj dite këto të mira natyrore mbetën të pashfrytëzuara. Përveç kriporës së Ulqinit, e cila ishte ngritur në kohen e Mbretërisë Jugosllave, në vëndet e banuara me shqiptarë, nuk u ngrit ndonjë objekt i rëndësishën ekonomik.

Zhvillimin ekonomik në trojet shqiptare në Mal të Zi madje nuk e ndihmoi as ekzistimi i një fondi federativ për vendet më pak të zhvilluar dhe vendet kufitare të pazhvilluara që funksionoi në Mal të Zi, por nuk funksionoi në Ulqin, Krajë, Malsia e as Plavë e Guci, ato mbeten dhe nga sistemi monist dolen si vendet më të pazhvilluare në Mal të Zi, përkundër resurseve dhe kushteve natyrore dhe favoret që mundësonin ato e të cilat më lartë i përmendem.

Në aspektin e të drejtave civile dhe politike, në krahasim me malazezët dhe popujt tjerë shumicë, pa folur për standardet ndërkombëtare, shqiptarët në Mal të Zi ishin në pozitë inferiore. Kushdo që haptas shprehte apo kërkonte avansimin e të drejtave kombëtare, si kudo tjetër në Jugosllavi, përdorimin e lirë të gjuhës shqipe dhe simbolëve kombëtare shpallej armik, shovenist apo irendentist. Të gjithë ato që e shprehnin një gjë të tillë denoheshin me burg, anatemoheshin e nuk mund as të punësoheshin ose e humbnin punësimin , si kemi rastet e vitit 1972 në Kraje, në 1983 ne Ulqin e vënde të tjera. Megjithatë, sa u përket

të drejtave civilo-politike fitorja më e madhe shqiptarëve në përgjithësi në Jugosllavi, pra edhe atyre në Mal të Zi, është e drejta e ngritjes së flamurit Kombëtar e 6 tetorit 1968. Por kjo fatkeqësisht zgjati vetëm deri më 1982, kur pas ngjarjeve në Kosovë, përdorimi i tij me ligj u ndalua.

Edhe në këtë periudhë në vendet e banuara me shqiptarë në punësim në aparatin shtetëroro-administrativ e dhe në përfaqësim politik në cilin do nivel qoftë, dominonin malazezët, pra shqiptarët ishin në pakicë dhe nuk bëhej fjalë për përfaqësimin propocional ashtu si ideollogjia komuniste dhe politika shtetërore e predikonte. Kështu në Ulqin, komunë me mbi 75 % shqiptarë, kryetari i parë i komunës nga komuniteti shqiptar u zgjodh në vitin 1968 dhe pastaj deri në shumëpartiaksi në vitin 1990, nuk pati më kryetar shqiptarë. Ndërkaq, sa i përket punësimit të shqiptarëve në organet e administratës shtetërore as që mund të bëhët fjalë, dominonin jo shqiptarët.

Sa i përket përfaqësimit në Kuvendin e Malit të Zi lirisht mund të themi se ishte diskriminues dhe mospërfillës i ideollogjisë komuniste e cila predikonte barazi për të gjithë në çdo aspekt të jetës shoqëroro-politike. Mund të thuhet se përfaqësimi mi i mirë i shqiptarëve në këtë periudhë në Kuvendin e Malit të Zi ishte pikërisht në zgjedhjete para për Ansamblenë Kushtetuese (1946), deputetet e të cilës vazhduan mandatin 4 vjeçar (1946-1950) si deputet të Kuvendit Popullor, kur nga 107 deputet, shqiptarët ishin përfaqësuar nga 5 deputet (njësia zgjedhore Shtoj-Braticë 1, Katërkollë 1, Ostros 1, Tuz 1 dhe Hot-Grudë 1) .Në zgjedhjet e vitit 1950 nga 161 deputet sa kishte Kuvendi 6 prej tyre ishin shqiptarë (Njësija zgjedhore Katërkollë 1, Zogaj 1, Shestan 1, Ostros 1, Tuz 1 dhe Triseh 1). Në zgjedhjet të tjera, deri në vitin 1990, si rrjedhojë e ndryshimit të përbërjes së Kuvendit, kur kuvendi përbëhej nga disa dhoma, duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të deputetëve, përfaqësimi i shqiptarëve u keqësua. Kështu nga gjithësejt 122 deputet në zgjedhjet e vitit 1953, u zgjodhën vetëm 3 shqiptarë, në vitin 1958 nga 150 deputet u zgjodhën po ashtu 3 shqiptarëm, në vitin 1963 nga 254 deputet vetëm 8 ishin shqiptarë, në zgjedhjet e vitit 1969 nga
Po ashtu 254 deputet po ashtu 8 ishin shqiptarë. Në zgjedhjet e vitit 1974, mbas Kushtetutës së re nga e cila shqiptarët kishin pritshmëri të mëdhaja, struktura e kuvendit të Malit të Zi ndryshoi dhe tani ajo përmbahej nga 3 dhoma me gjithlsejtë 135 deputet nga të cilët vetëm 6 ishin shqiptarë.Në vitin 1978 numri i deputetëve shqiptar u zvoglua në 3 po aq sa u zgjodhën edhe në zgjedhjet e vitit 1982, Në këtë mandat, 1982-1986 nënkryetari i Kuvendit të Malit të Zi u emërua 1 shqiptarë, (Fadil Taipi) dhe një shqiptarë si antërë i Kshillit Ekzekutiv Republikan (Nikollë Gjonaj).Në zgjedhjet e viti 1986 në Kuvendin e Malit të Zi u ulën 5 shqiptarë nderësa në zgjedhjet e fundit komuniste në vitin 1989, pas të ashtaquajtuirt " jogurt revolucion" në të cilin shqiptarët muarën pjesë aktive dhe pritej që ato të përfaqësohen më denjësisht në parlamntin e dalë nga këto zgjedhje nga gjithlsejt 165 deputet vetëm 3 ishin shqiptarë dhe ato 1 në dhomën e Punës së Bashkuar e 2 në dhomën e Komunave ndërsa në dhomën shoqëroro-politike nuk u zgjodh asnjë shqiptarë.

Edhe kjo periudhë karakterizohet me emigrimin e pandalur të shqiptarëve, që faktikisht sishte ndalur asnjë herë, por për arsye të papunsisë së madhe, si pasojë e pakujdesisë së shtetit ndaj zhvillimit ekonomik të trojeve shqiptare,, emigrimet e shumta dhe boshatisja e shumë shtepive dhe fshatrave ndodhën në vitin 1969- 1970 e kështu në pafundësi deri në vitin 1990

PLURALIZMI POLITIK – SHUMËPARTIAKSIA

Instalimi i pluralizmit politik ngjalli tek shqiptarët shpresën se më në fund do të vinin ditë më të mira si në aspektin e të drejtave dhe lirive qytetare me theks të veçantë në të drejtat kombëtare dhe në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe krijimit të kushteve për një zhvillim më të shpejtë konformë resurseve natyrore dhe njerëzore për një mirëqenje më të mirë e të qendrueshme.

Forcat progresive të Malit të Zi, nëpër mes të ashtaquajturit Jogurt revolucion" arrijten që të shembin, në një farë mënyre, ideollogjin komuniste duke krijuar kushtet e nevejshme për një pluralizëm politik, pra u promovua shumëpartiaksia dhe kshtu u krijuan kushtet qe edhe shqiptarët, me përfaqësuesit e tyre ligjitim, të inkuadrohen në jetën politike dhe të vëndosin vetë për fatin e vet, natyrisht aq sa rrethanat e kohës dhe infrastruktura ligjore e lejonte.

Vendet apo territoret shqiptare në Mal të Zi nga komunizmi kishin dalë si vende ekonomikisht më pak të zhvilluara, përkundër resurseve të bollshme natyrore, niveli i arsimit i shqiptareve akoma ishte në nivel të ultë, nuk kishte shkollim të lartë në gjuhën shqipe, plan-programet mesimore ishin të ngarkuara jo

vetm me ideollogji komuniste, shumë pak mësohej historia e kultura shqiptare, përfaqësimi i shqiptareve në organet shtetërore, ligjvënse, gjyqësore e ekzekutive ishte i ultë në disproporcion me mjesëmarrjen në numrin e përgjithshëm të popullsisë, shpërnguljet dhe boshatisja e trojeve shqiptare po vazhdonte.

Në shtator të vitit 1990 u shpallen zgjedhjet e para shumpartiake. Shqiptarët, tani më, e kishin kuptuar nevojën e organizimit politik sepse vetëm në atë mënyrë mund të ndikojnë në përmirësimin e pozitës së tyre politike dhe ekonomike. Kështi lindi partia e parë politike – Lidhja Demokratike në Mal të Zi e cila në zgjedhjet e para në shumpartiaksi, të mbajtura me 5 dhjetor 1990, grumbulloi pranë vehtës shumicën dërmuese të shqiptarëve dhe doli fituese apsulute në të gjitha vendvotimet me shumicë shqiptare. Kështu LD në MZ –ja siguroi 4 mandate në parlamentin e Malit të Zi dhe për herë të parë në historinë e tyre interesat e tyre do të përfaqësohen e ruhen nga përfaqësuesit e tyre legjitim. Në zgjedhjet lokale në Ulqin 2/3 e kshilltarëve ishin të kësaj partie e kështilltarë shqiptarët fituan kudo si në Tivar, Podgoricë, Rozhajë e Plavë.

Përkundër fitores brilante të shqiptarëve si në nivelin qendror ashtu edhe në ato lokal, pushteti qëndror, akoma i ngarkuar me të kaluarën dhe sindromin shqiptar, në vend që të bashkpunojë ngusht me te dhe të krijoj kushtet për avancimin e të drejtave dhe lirive civilo- politike dhe kombëtare konform trendit dhe akteve ndërkombëtare për këto çështje, ato as që donin të degjonin për problemet e shqiptarëve. Ishte kjo periudha e nisjes së shpërbërjes se ish Jugosllavisë, kur Armata Popullore e Jugosllavisë, në mënyrë të organizuar po sulmonte fillimisht popullin slloven e pastaj ato kroat, boshnjak e veçanarisht popullin shqiptarë në Kosovë, po thuaj u bë shkatrrimi i ekonomisë dhe sistemit monetar, u bë centralizimi i pushtetit vëndor pothuaj edhe më i theksuar se në komunizëm, filloi privatizimi i padrejtë i pasurisë dhe u shkatrrua baza e zhvillimit ekonomik, u devalvuan objektet turistike, u rrit papunësia, emigrimi i të rinjëve dhe familjeve të tëra shqiptare po vazhdont. Gjuha shqipe në administrat nuk ishte në përdorim, simbolet kombëtare ishin të ndaluara. Pra këto dhe shumë të tjera ishin sfidat e kësaj partie dhe partive të tjera shqiptare që do të formoheshin më pas.

Në fillim të vitit 1997, kur ndodhi ndarja në dysh e partisë në pushtet, Shqiptarët më saktë bartësit e politikës shqiptare LDnëMZ dhe UDSH-ja, menduan se, me qellim të përmirësimit të gjëndjes politike dhe ekonomike kjo situatë duhet shfrytëzuar dhe me këtë qellim hynë në bisedime me partinë – shtet me ç'rast nënshkruan një marrëveshje për minimumin e kushtëve për qeverisje në bazë të cilës duhej të bëhëshin ndërrimet e nevojshme të ligjit për ndarjen territoriale të Malit të Zi i cili do të mundësonte krijimin e komunës së Malësisë, pastaj me ligjin për informim shqiptarëve duhej t'u mundësohej informimi adekuat në gjuhën shqipe i cili do të përkrahej financiarisht nga qeveria, të përmirësohen plan-programet shkollore si dhe të përmirësohet kuadri ligjor i cili do të mundësojë përfaësimin proporcional të shqiptarëve në parlament, punësimi proporcional i shqiptarëve në organet shtetërore, legjislative dhe gjyqësore, të sillet ligji për përdorimin e simboleve nacionale si dhe të fillojë decentralizimi i pushtetit vëndor me qellim të krijimit të kushteve për një zhvillim më të shpejt ekonomik. Ishte ky një hap i qitur i faktorit shqiptarë për të nisur rrugën e cila do të mundësonte avancimin e të drejtave politike deri atëherë të mohuara dhe të inkuadrimit të popullsisë shqiptarenë, në mënyrë të barabartë me të tjerët, në jetën politiko-shoqërore në shtetin e Malit të Zi.

Megjithate, shumë pak nga këto premtime u jetësuan. Injorimi i të drejtave shqiptare vazhdonte.

Fillimisht u aprovua infrastruktur zgjedhore, ku muarën pjesë edhe përfaqësuesit e partive, në bazë të cilës u përcaktuan vendet zgjedhore shqiptare dhe u krijua një nënzonë zgjedhore e cila u mundësonte shqiptare të fitonin 5 mandate në Kuvendin e Malit të Zi, që përafërsisht është përfaqësim proporcional me pjesëmarrjen në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Sidoqoftë, me këtë ligj shqiptarët arrijtën të fitonin 4 mandate në Kuvend.

Pas zgjedhjeve të vitit 1998, kinëse për të përmirësuar e realizuar të drejtat e popujve pakicë, qeveria e Malit të Zi themeloi Ministrin për pakica të cilën iu ofroi partive shqiptare. LD në MZ –ja, si partia më e madhe shqiptare, mendonte se çështja e popujve pakicë, pra edhe shqiptarëve, nuk mund të rregullohen me këtë ministri pasi fillimisht ato duhen të rregullohen me aktin themelor shtetëror, me Kushtetutë, Sidoqoftë,

kjo Ministri u themelua dhe Minister u emrua nga radhët e UDSH-së. Ska dyshim se edhe koha në vijim do të tregojë të arriturat dhe arsyeshmërinë e sajë.

Në fund të vitit 2000 Kuvendi i Malit të Zi aprovoi Ligjin për përdorimin e simbolëve kombëtare pra edhe flamurit shqiptarë. Ky ligj, edhe pse ishte më shumë restriktiv se sa lejonte përdorimin e simbolëve kombëtare, kthen pas afro 20 viteve të drejten e përdorimit të flamurit dhe simbolëve kombëtare dhe paraqet avancimin e parë në korpusin e lirive dhe të drejtave politike të pakicave kombëtare në Mal të Zi.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë Mali i Zi së bashku me Serbinë kishin krijuar shtetin e përbashkët ku natyrisht serbet ishin në shumicë. Elementi serb gjithnjë e më tepër bëhej mbisundues dhe kërkonte hapsirë për tu bërë dominues në të gjitha segmentet e jetës shoqëroro-politike. Kështu lindi ideja e popullit malazez për krijimin e shtetit të pavarur të Malit të Zi, lindi deshira e kthimit të shtetësisë së humbur 9 dekada më parë. Kjo nuk ishte e lehtë pasi elementi serb po fuqizohej gjithnjë e më shumë. Përkrahësit e pavarsisë së Malit të Zi e dinin se pa pakicat jo sllave në Mal të Zi kjo ide nuk mund të realizohej.

Për realizimin e idesë së pavarësisë, natyrisht, së pari duhej të përmirësohej infrastruktura ligjore dhe të aprovohek Kushtetuta e re e Malit të Zi.

Pavarësija e Malit të Zi u konvenonte shqiptarëve për shumë arsye. Së pari Kosova ishte në rrugë të mbarë për shpalljen e pavarësisë kështu që me mbetja në shtetin e përbashkët Serbi-Mali i Zi, shqiptarët do të mbetëshin edhe në minorancë më të madhe, do të kishin më pak ndikim në vendim marrje e në një shtet hemogjenist serb mundësia e avancimit dhe plotësimit e të drejtave legjitime të indentitetit të tyre kombëtar dhe lirive e të drejtave ekonomiko-politike, praktikisht do të vështirësohej, në të kundërtën ndarja nga Serbia do thonte mundësi më e madhe e realizimit të synimeve të përmendura.

Ndikim në përkrahjen e pavarësisë së Malit të Zi, nga ana e popullit shqiptarë paten orijentimet politike të partive përkrahëse të pavarsisë e në veçanti partisë në pushtet të cilat në kampanjln për referendum, të cilat përafërsisht shpreheshin: " **Republika e Malit të Zi, shtet i pavarur me subjektivitet të plotë juridiko-ndërkombëtarë, do të ndërtohet si shtet i qytetarëve, si shoqëri multietnike, multikulturore dhe shumëkonfensionale e bazuar në rrespektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtave të veçanta të pakicave,bazuar në principet e demokracisë parlamentare, sundimit të drejtës, pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe ekonomisë së tregut" . (më vonë kjo u bë deklaratë zyrtare e Kuvendit të Malit të Zi).**

Për këtë arsye partitë politike dhe populli shqiptarë në përgjithësi u rreshtuan në krahë të atyre partive politike dhe asaj pjese të popullsisë së Malit të Zi që përkraheshin pavarësin e Malit të Zi dhe shkëputjen nga Serbija. Por as kësaj rradhe partitë politike shqiptare nuk ishin unike ne qendrime për këtë çështje edhe pse ishin rreshtuar në të njëjtin krah.

Unioni Demokratik i Shqiptarëve se bashku me partitë tjera malazeze të cilat përkraheshin pavarësin e Malit të Zi, më 28 mars 2006, nënshkruan Marrëveshjen për pjesëmarrjen e përbashkët në kampanjën në referendumin për statusin shtetëroro-juridik të Malit të Zi, sipas të cilës të gjithë nënshkruesit do të krijojn një pol të përbashkët mediatik për senzibilizimin e popullatës dhe përgaditjen e referendumit, pa asnj kusht plotësues. Ndërkaq Lidhja Demokratike në Malit të Zi u çfaqë si subjekt në vehte pro pavarësisë të Malit të Zi, e cila në kampanjën para mbajtjes së referendumit promovonte kërkesat e shqiptarëve për realizimin e aspiratave të tyre: plotësimin e e të drejtave legjitime të indetitetit kombëtar, lirive dhe të drejtave të pakicave, shfrytëzimin e resurseve natyrore në trojet shqiptare dhe krijimin e kushteve për zhvillim adekuat ekonomik dhe mirëqenje sociale. Pra edhe në këtë rast, si edhe në rastin e krinimit të Ministrisë për popujt pakicë, partitë shqiptare nuk patën qëndrim të përbashkët.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se 10 ditë para mbajtjes së referendumit për pavarësinë e malit të Zi. Kuvendi i Malit të Zi aprovoi Ligjin mbi të drejtat dhe liritë e pakicave i cili më përafërsisht i indentifikonte të drejtat e përmendura. Ky ligj, përkundër mangësive në përmbajtje, sadokudo paraqet një hapë para në plotësimin e kërkesave të shqiptarëve.

Referendumi, përkundër praktikës 50 % + 1, kishte përcaktuar norma të forta për arijtjen e qellimit të pavarsisë pasi ishte caktuar se vetëm në rastin se 55 % të votueseve voton pro pavarsisë Mali i zi do të fitojë pavarësinë.

Përfundimisht më 21 maj 2006, krahu i pavarësisë së Malit të Zi në të cilin bënin pjesë edhe shqiptarët, fitoi minimalisht me 55,5 % dhe kështu Mali i Zi, u shkëput nga Srbija, shpalli pavarësinë duke këthyer kështu shtetësin e humbur m[1918.

Siç shihet nga rrezulltati shqiptarët luajtën rrol të rëndësishëm dhe patën rrol vendimtar në krijimin e shtetit të pavarur të Malit të Zi duke shpresuar se në shtetin e pavarur do t'i arrinin më lehtë e më shpejt synimet e tyre për avansimin e të drejtave dhe lireve civilo-politike dhe ruajtjes së indentitetit kombëtar.

Pas pavarësisë, natyrisht, Mali i Zi kishte obligim të aprovonte Kushtetuten e re të shtetit të pavarur.në të cilën do të inkorporoheshin të gjitha principet e deklaruara.

Në grupin punues për hartimin e Kushtetutës morën pjesë edhe deputetet të partive shqiptare, të cilët në mënyrë konstruktive ndihmuan punën e tij, e po ashtu në kuvend gjatë debatimit për Kushtetutën me amandamente e diskutime u munduan të përmirësojnë tekstin dhe instituan që në Kushtetutë, për sa u përket shqiptarëve, duhet të futën të gjitha ato dispozita të deklaruara në referendum për barazinë e të gjithë popujve e pakicave kombëtare që jetojnë në Mal të Zi.

Shqiptarët e kishin të qartë se është kjo Kushtetuta e parë pas pavarësisë dhe se implementimi i saj, në të ardhshmen do të ketë ndikim edhe për shqiptarët, ndaj duke u bazuar në kontributin e dukshëm të tyre për pavarsi të shtetit dhe në faktin se shteti i ri është deklaruar se sa u përket popujve pakicë do të aplikojë të gjitha aktet e standartet ndërkombëtare për përmirësimin e statusit të tyre, shqiptarët artikuluan në mënyrë të qartë kërkesat e tyre.

Një ndër kërkesat e shqiptarëve ishte që në preambullën e kushtetutës, duke marrë parasysh të kaluarën faktike historike të tyre si popull auteknon në këto troje, shqiptarët duhen të jenë element konstituiv i shetit të Malit të Zi, pasi nga trajtimi i një populli apo entititeti do të mvarej edhe realizimi i të drejtave të tyre në të ardhmën.

Kërkesë tjetër më rëndësi ishte normativizimi i përdorimit të lirë të gjuhës shqipe dhe simbolëve kombëtare në ato territore ku ato janë shumicë, jo vetëm në shkollë por edhe në organet e administratës dhe gjykatave të instancave të ndryshme konform dispozitave të Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare pastaj mësimi i historisë kombëtare, pa dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë të pajustifikueshme konform dispozitave të Kartës Europiane të gjuhëve rajonale dhe të pakicave. Lidhur më këto dhe kërkesa të tjera duhet të përcaktohet instrumenti i implementimit dhe përgjegjësija për mos realizim të drejtave dhe lirive politiko-civile duke u shëndrruar norma deklarative në normë imperative, e cila do të sigurone realizim dhe jetëgjatësi të gjitha normave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e popujve pakicë konkretisht shqiptarëve.

Duhet theksuar, në fund, se nga të gjitha kërkesat të parashtruar me shkrim në formë të amandamenteve shumë pak prej tyre kanë zënë vendë në Kushtetutë e parë të shtetit të pavarur, në të cilin shqiptarët, duke marrë parasysh kontributin e tyre në pavarësin e shtetit të Malit të Zi, pritnin shumë më tepër.

Sidoqoftë, edhe sot e kësaj ditë, 10 vjet pas, gjuha shqipe nuk përdoret as në procedurat administratë e as to gjyqësore, plan-programet mësimore janë të mangta dhe në nivelin e parapavarësisë, përfaqësimi në Kuvendin e Malit të Zi, me normen ligjore të ndryshuar, është më pak se të drejtat e arritura më parë dhe është në kundërshtim flagrant më dispozitat e Ligjit mbi të drejtat e popujve pakicë.

Plaga e vjetër e shqiptarëve në Mal të Zi, boshatisja e trojeve etnike shqiptare, nuk u shërua as në pluralizëm.

Përfundimisht, është e qartë se shqiptarët në asnjë periudhë të sundimit serbo-malazez nuk i kanë gëzuar të drejta civilo-politike të parapara me aktet e mbrendshme të shtetit e aq më pak konform standardeve ndërkombëtare.

Nga vështrimin im retrospektiv i të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në Mal të Zi në kuadër të legjislacionit pozitiv shtetëror të kohës del qartë se pozita kushtetuese juridike e tyre ka qenë neglizhuese, e pabarabartë dhe diskriminuese në krahasim me shtetasit tjerë në Mal të Zi.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

GJENDJA E SHQIPTARËVE NË ZONAT E PUSHTIMIT GJERMAN

PhD.c. Jeton Idrizi*(Historian)* - Shkolla e Mesme të Ulët "Bafti Haxhiu"-Viti

1. Vendosja e pushtimit dhe pozita e shqiptarëve

Pozita e shqiptarëve, para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, përbën një veçori, që duhet marrë domosdoshmërisht në konsideratë, për trajtimin objektiv të qëndrimit të tyre ndaj saj. Lufta i gjeti shqiptarët në një situatë, kur nuk e kishin zgjidhur detyrën e çlirimit dhe bashkimit të tyre kombëtar.[193] Kjo luftë tregoi se në kushtet e pushtimit nga Fuqitë e Boshtit, shtetet e rinj kombëtarë të Europës Juglindore ishin sërish më të rrezikuarit.[194] Mandej vështirësitë që i pati Shqipëria në tallazet e Luftës së Dytë Botërore, e bënë tepër komplekse dilemën për Pavarësinë e saj pas lufte.[195] Shqipëria ishte i pari vend ballkanik që u sulmua nga Italia fashiste dhe që në fillim ishte i pari që përqafoi lëvizjen e rezistencës së armatosur kundër fashizmit, duke hedhur në luftë të gjitha forcat e tij material dhe morale.[196] Në anen tjetër, pushtimi i Shqipërisë nga Italia Fashiste shënoi fundin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar.[197] Problematika e kombit tonë gjatë Luftës së Dytë Botërore është shumë e gjërë. Në këtë trajtim synimi i zgjidhjes së problemit kufizohet tek qëndrimi i shqiptarëve ndaj konfliktit botëror dhe, brenda këtij kuadri, të

[193]Muharrem Dezhgiu, Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugusllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 39.

[194] Ana Lalaj, Projektet për Federatën Ballkanike dhe e ardhmja e Shqipërisë (1943-1945), Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi I Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.190.

[195] Muharrem Dezhgiu, Dilemat për Pavarësinë shqiptarennë vitet e Luftës së Dytë Botërore, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.158.

[196] Esilda Luku, Aspekte të çështjes shqiptare në Traktatin e Paqës me Italinë pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjurmime Albanologjije Seria e shkencave albanologjike, nr. 39/2009, Prishtinë, 2010, f.156.

[197] Hamit Kaba, Projektet e Aletaëve të Mëdhenj mbi të ardhmen e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.173.

përcaktimit se sa ishin realist shqiptarët në pozicionimin e tyre si dhe i forcave që e nxitën atë.[198] Lufta e Dytë Botërore krijoi kushte krejtësisht të reja gjeoploitike në Ballkan dhe në trojet etnike shqiptare. Gjatë kësaj lufte Kosova dhe trojet e tjera etnike u pushtuan nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria dhe u ndanë ndërmjet tyre. Edhe pse në bisedimet rreth ndarjes së territoreve të pushtuara u theksua kriteri themelor përkatësia kombëtare e popullsisë, ky kriter u shkel nga Fuqitë e Mëdha në mënyrën më të vrazhdë të mundëshme.[199] Me fillimin e Luftës Botërore, lufta e shqiptarëve, pavarësisht se ku banonin në Shqipëri apo në trevat etnike jashtë saj, mori karakterin e luftës çlirimtare mbarëkombëtare shqiptare.[200] Detyra e çlirimit kombëtar i vuri shqiptarët në një emërues të përbashkët, pavarësisht nëse pushuesit dhe sunduesit ishin italianë, serbë apo grekë. Pra, ata ishin vënë përballë rrezikut të asgjësimit të shtetit kombëtar në Shqipëri te i cili kishin shpresën që ta kishin si shtet unik të tyre. [201] Lufta e Dytë Botërore, riaktualizoi çështjen e Kosovës, si një çështje e cila kërkonte zgjidhje të ngutshme. Kosova u bë një çështje e rëndësishme, rreth së cilës do të bëheshin diferencime e polararizime forcash, madje u shndërrua në një problem që do të përcaktonte orientimin e shtresave të ndryshme politike duke ndikuar edhe në zgjerimin apo ngushtimin e koalicioneve antifashist, apo fashist.[202]

Marrëdhëniet e shqiptarëve me gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin të shkelqyera. Mirëpo, nëse iu hedhim një sy këtyre raporteve para luftës, ato ishin mjaft të kufizuara. Arsyeja e raporteve jo të mira ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Gjermanisë, padyshim ishte ndikimi Italian në Shqipëri. Politika gjermane ishte krejtësisht e painteresuar ndaj Shqipërisë, duke marrë në konsideratë xhelozinë italiane ndaj çdo shteti që shfaqte interesa për marrëdhënie preferenciale ndaj Shqipërisë, të cilën, Italia, e konsideronte si "domenin" e saj.[203]

---

[198] Marenglen Verli, Antifashizmi, alternative e perspektivës për kombin shqiptar, Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f.81.

[199] Muhamet Shatri, Çlirim apo ripushtim jugosllav I Kosovës dhe trojeve të tjera etnike më 1944, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 217.

[200] Fejzulla Shabani, Roli i Shqipërisë në mbrojtje të identitetit kombëtar të shqiptarëve në trevat lindore 1941-1944, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti I Historisë, 100 vjet Pavarësi, Akte e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, Vëllimi i Dytë, Tiranë, më 26-27 nëntor 2012, f.213.

[201] Muharrem Dezhgiu, Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugusllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 40.

[202] Sabit Syla, Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 111.

[203] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.

Këtë situatë të marrëdhënieve të Shqipërisë së paraluftës me Italinë dhe Gjermaninë e kanë vënë në dukje edhe studius të ndryshëm. Kështu, duke iu referuar kësaj situate të marrëdhënieve të Shqipërisë me pushtuesit e ardhshëm, studiusit kanë pohuar: "Ministria e Jashtme Gjermane ishte e lëkundur, veçanarisht pasi italian1ët u bënë thuajse histerikë, kur morën vesh përçapjet e Mehdi Frashërit për bisedime me gjermanët.[204] Zhgënjimin e tij, lidhur me shkallën e ulët të ndikimit gjerman në Shqipëri, dhe raporteve jo aqë të mira në mes këtyre shteteve, e shprehte edhe përfaqësuesi gjerman në Shqipëri, Eberhard von Pannëitz, posaçërisht lidhur me dështimin e një marrëveshje tregtare të vitit 1938 midis këtyre dy shteteve.[205]

Nëse bëjmë një vlersim më të përgjithshëm në bazë të dokumentave të kohës, konsatojm se Shqipëria e para Luftës së Dytë Botërore nuk zinte ndonjë vend shumë të rëndësishëm në planet ekspansive të Gjermanisë Hitleriane. Pas kapitullimit të Italisë më 3 shtator 1943 si dhe daljes së saj përfundimtare nga Boshti Qendror më 8 shtator 1943, interesi i Gjermanisë ndaj Shqipërisë filloi të rritej. Ky interes pa mëdyshje ishte edhe si rezultat i pozitës së mirë gjeografike të Shqipërisë.[206] Shkalla e ulët e raporteve shqiptaro-gjermane, para Luftës së Dytë Botërore, do të shprehej edhe në përgjigjen negative të Hitlerit ndaj kërkesës së Mbretit shqiptar, në mars të vitit 1939, për ta mbrojtur atë nga Musolini. Megjithatë, Zogu nuk shihte ndonjë optimizëm në ndihmën gjermane për mbrojtjen e tij nga italianët, vetëm gjatë Luftës, në rrethanat e zhvillimit të ngjarjeve në Ballkan dhe në Shqipëri, intersi gjerman për Shqipërinë u shpreh me një vëmendje të veçantë.[207]

Plani për ndarjen e territoreve të Jugosllavisë u konkretizua në mbledhjen e Vjenës, më 21-22 prill të atij viti, në bisedimet mdërmjet ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, F. Ribentrop dhe atij të Italisë, G. Çiano. Në kuadër të këtyre ndarjeve, copëtimin e përjetuan edhe viset shqiptare të cilat bënin pjesë në mbretërinë ish-jugusllave, të cilat u ndanë midis pushtuesve gjermanë, italianë dhe bullgarë.[208] Ky pushtim, objektivisht solli ndryshime për pozitën e mëparshme të shqiptarëve. Bashkimi me Shqipërinë i

[204] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.
[205] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61.
[206] Marenglen Kasmi, Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944, Tiranë, 2003, f.53.
[207] Muharrem Dezhgiu, Gjermanët në Shqipëri (verë-vjeshtë 1943), në Studime Historike, nr. 3-4/ 2010, Tiranë, Instituti i Historisë, 2011, f. 61-62.
[208] Lafter Nasi, Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943, në Studime Historike, nr. 3-4/2006, Tiranë, Instituti i Historisë, 2006, f.87, shih edhe: Ledia Dushku, Situata politike dhe shoqërore në Kosovë sipas raportit të Mazar Sopotit (12 nëntor -9 dhjetor 1941), Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 191.

Kosovës dhe dhe i trevave të tjera, në kuadrin e ndarjes së zonave të pushtimit të Ballkanit, ndryshoi pozitën sociale, ekonomike e politike të shqiptarëve.[209]

Me shpërbërjen e Jugosllavisë më 1941,[210] trojet shqiptare e coptuan në mënyrën më të dhimbëshme, si rezultat i Marrëveshjes së Vjenës, kur ministart e Punëve të Jashtme të dy shteteve Gjermanisë dhe Italisë hartuan edhe politikat e tyre në territorinë e Jugosllavisë, ku natyrishtë këtu përfshiheshin edhe viset e banuara me shqiptarë. Pas shumë polemikave të këtyre shteteve të kësaj marrëveshje, në maj të vitit 1941 Kosova dhe disa vise të tjera shqiptare që gjindeshin në ish Jugosllavi u coptuan në tri shtete: Italisë, Bullgarisë dhe Gjermanisë.[211] Mirëpo, nuk duhet harruar fakti, se objektivisht gjermanët me shpërbërjen e Jugosllavisë e çliruan Kosovën nga pushtimi i egër serb, madje, e bashkuan atë me Shqipërinë. Sigurisht, që ata e bënë për interesat e tyre gjeopolitike, por këto interesa përkonin me interest madhore të shqiptarëve. U realizua ëndrra e kombit shqiptar-bashkimi kombëtar dhe funksionimi i shtetit të pavarur shqiptar në ksuhtet e luftës botërore.[212]

Duke pasur parasysh që Kosova ishte pjesë e planit gjerman, në bisedimet e 21 dhe 22 prillit 1941, në Vjenë ishin takuar ministry Italian Konti çiano dhe Rybentropit-ky i fundit kishte deklaruar, se: "Hitleri dëshiron zvogëlimin sa më të madh të Serbisë, për arsye se territoret e saj do t'u epen Shtetit të Pavarur Kroat dhe Shqipërisë. Gjithashtu para kapitullimit të Italisë fashiste më 9 shtator 1943, në bisedimet e zhvilluara në Beograd më 5 shtator, ndërmjet Xhafer Devës dhe dr. Herman Neubahuer u precizua që Kosova dhe viset e tjera shqiptare të bashkoheshin me shtetin amë. Marrëveshja u arrit në bazë të analizës së Shtabit të Vermahtit ku thuhej se: " shqiptarët kërkojnë pavarësi shtetërore dhe për ta ai shtet, që do t'u sillte pavarësinë, do të ishte miku i tyre.[213] Pra, pjesën më të madhe të Kosovës, e ksihte pushtuar Gjermania, mirëpo në një takim të lartcekur në mes të Italisë dhe Gjermanisë, ishte arritur marrëveshja që pjesa më e madhe e këtij territory të banuar me shqiptarë të vihej nën pushtetin Italian dhe të bashkohej me

---

[209] Muharrem Dezhgiu, Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugusllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 40.

[210] Nuridin Ahmeti, Qëndrimi Italian ndaj reformës agrare në Kosovë më 1942, Instituti Albanologjik, Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike, nr. 41/42. 2011/2, Prishtinë, 2012, f.30, shih edhe : Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore 1939-1943, Tiranë, 2014, f.154.

[211]Fehmi Rexhepi, Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 136, shih edhe Hakif Bajrami, Programet serbe për likuidimin e shqiptarëve 1941-1945, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh), Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë dhe Qendra e Studimeve Albanologjike-Tiranë, Prishtinë, 2014, f.27.

[212] Muharrem Dezhgiu, Qëndrimi politik i Lef Nasit gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Studime Historike, nr. 3-4/ 2013, Tiranë, Instituti i Historisë, 2014, f.239.

[213] Sabit Syla, Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2012, f. 31, shih edhe Muhamet Shatri, Kosoa në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f.36.

Shqipërinë, më qëllim që në të ardhmen të parandalohej shndërrimi i shqiptarëve në irredentista të lëvizjeve antigjermane.[214]

Më 27 mars 1941 Hitleri shpalli planin e tij orientus, i cili u konkretizua më 12 prill në ndarjen e përkohshme të Jugosllavisë sipas të cilave territory i "Serbisë së vjetër" u vë nën administratën ushtarake gjermane, kurse Italisë iu përcaktuan kufij taktikë. Gjatë negociatave të Vjenës u mor vendimi lidhur me caktimin e kufijve ndërmjet pushtuesve në Maqedoni dhe në Kosovë. Që në ditët e para pas shkatrrimit të ushtrisë së Jugosllavisë forcat pushtuese gjermane, në bashkëpunim më ato italiane, u vendosën në Kosovë dhe pushtuan gjithë territorin e saj. Gjermania si shteti më i fuqishëm i koalicioni luftarak, lejoi që të plotësoheshin kërkesat territorial të Italisë, Bullgarisë dhe Hungarisë në territoret shqiptare. Megjithatë, ajo mbajti nën kontrollin e vetë pjesën më të madhe të Kosovës.[215] Në kuadër të zonës pushtuese gjermane hynin rrethi i Mitrovicës, i Vuçitërnës, i Pudujevës (Llapit) dhe i Pazarit të Ri. Administrate pushtuese gjermane që u vendos në këto treva ndoqi një politikë të dyfishtë përsa i përket Kosovës. Nga njëra anë paraqitej si mbrojtëse e bashkësisë shtetërore serbe ku nxiste qarqet serbe perreth M. Nediqit dhe Millan Açimoviqit që të kërkonin bashkimin e Kosovës me Serbinë, ndërsa nga ana tjeter, Ministria e Punëve të Jashtme i rekomandoi administratës ushtarake gjermane që të merrte parasysh edhe interest e shqiptarëve.[216] Menjëherë pas vendosjes së pushtimit gjerman në Shqipëri, u krijua Komiteti Egzekutiv provizor, të cilin e udhëhiqte Ibrahim Biçaku. Komiteti i formuar më 11 shtator 1943, rishpalli Pavarësinë e Shqipërisë, kurse më 14 shtator ai i drejtoi një thirrje popullit shqiptar e cila përfundonte, "Rroft Shqipëria e Lirë". Më 16 tetor u mblodh në Tiranë Kuvendi Kombëtar i cili shpalli "Këshillin e Lartë të Regjencës. Ky kuvend përbëhej nga 243 delegatë, të cilët përfaqësonin të gjitha prefekturat e Shqipërisë, ku 163 prej tyre ishin nga Kosova dhe nga trevat e tjera shqiptare jasht kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913.[217]

Gjatë muajit prill dhe maj të vitit 1941 vazhdoi vëndosja e administratës, organeve shtetëore dhe trupave ushtarake gjermane në rajonin e Mitrovicës dhe Vuçitërnës.[218] Sistemi pushtues gjerman dhe instacat e tij komandat dhe fuqitë e ndryshme qysh prej fillimit të pushtimit përfshinin në sistemin e vet të gjitha fuqitë kolaboracioniste dhe formacionet e tyre dhe bashk me to përbënin një aparat të përbashkët pushtues. Qyteti i Vuçitërnës ishte qendër rrethi, ku gjindeshin të gjitha formacionet e fuqive ushtarake dhe policore gjermane dhe kusilinge. Në fillim, kryetar i qarkut të Mitrovicës ishte Xhafer Deva,

[214] Neol Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 1998, f. 303.
[215] Fehmi Rexhepi, Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945), Prishtinë, 1998, f.60.
[216] Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f. 21.
[217] Sabit Syla, Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Instituti i Historisë "Ali Hadri" -Prishtinë dhe Instituti i Historisë -Tiranë, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore(Përmbledhje studimesh), Prishtinë, 2014, f. 130-131.
[218] Islam Dobra, Sistemi pushtues në Drenicë më 1941-1944, në Kosova, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 463.

ndërsakomandant i xhandarmërisë ishte Pajazit Boletini. Kryetar i rrethit të Vuçitërnës ishte Mustafa Alijeviqi e më vonë Jahja Kmeti, Asllan Boletini etj.[219]

Në zonën e pushtimit gjerman u krijua administrate kuisilinge e përbërë nga shqiptarë e serbë, por pushtetin faktik e kishte komanda e trupave ushtarake gjermane. Qyteti i Mitrovices ishte seli e Krajskomandanuturës 838, e cila deri në dhjetor të vitit 1941 ishte nën vartësinë e Feldkomandanturës së Nishit, ndërsa pas janarit të vitit 1942, të Feldkomandanturës në Vërnjaçka Banjë.[220] Pushtuesit gjermanë, në ditët e para të pushtimit, krahas shtypjes me dhunë të ideve liridashëse zhvillonte edhe politikë demagogjike. Pas pushtimit, forcat gjermane mënjehere filluan edhe vendosjen e administrates civile. Në krye të çdo komune dhe prefekture u vendosen shqiptarët që i nënshtroheshin qëndrimeve gjermane. Zgjedhja e kryetarëve të tillë bëhej në të njejtën mënyrë edhe në komunat e tjera të rrethit. Shumë shpejt forcat gjermane filluan të vendosëshin edhe institucionet dhe organet e tjera të administratës pushtuese, si policinë e gjandarmërinë shqiptare të vendit, gjyqet, organet e ndryshme financiare etj.[221] Formimin e pushtetit kuisling shqiptar e mori mbi vete Xhafer Deva me bashkëpunëtor. Prej fillimit të korrikut këtë funksion e merr "Komiteti Nacional i Shqiptarëve" edhe në LLap. Xhafer Deva erdhi në rrethet e afërta së bashku me oficerët gjermanë, të cilët organizuan mbledhje në përmasa rrethi, si dhe i emëroi nënprefektët e rretheve. Gjithashtu bëri ndërimin e nënpunësve, marrjen e gjyqeve, postës etj. Nëper komunat u emëruan kryetarët e rinj dhe këshilltarët, ndërsa nëper fshatra kryepleqtë.[222] Në maj të vitit 1941 gjermanët themeluan të ashtuquajturën qeveri komisare të Millan Aqimoviqit, e cila kishte për detyrë ti përtërijë organet e banovinave dhe ato locale të administratës shtetërore në Serbi. Këshilli i komisarëve më 6 gusht të vitit 1941 nxori një dekretligj për rregullimin dhe administratën në Kosovë, i cili hyri ne fuqi dy ditë më vonë. Sipas këti dekretligji parashihej që qarku i Kosovës, me qendër në Mitrovicë, të përbëhet nga këto rrethe: Novi Pazari, Mitrovica, Vushtrria dhe Pudujeva. Sipas këti dekretligji, kombësia shqiptare e ksihte përfaqësuesin e vet në rang të ndihmësit të banit, i cili kishte të drejtë të merrte pjesë në shqyrtimin e të gjithave çështjeve, që kishin të bënin me qarkun e Kosovës.[223]

Pushtuesi gjerman, qysh në marrëveshjen e 21 prillit të vitit 1941 propozoi edhe formimin e institucioneve tjera administrative në territorin e Kosovës si: xhandarmërinë, financat, gjyqet etj. Xhandërmeria u përbë nga shqiptarët e cila u vu nën kontrollen e kapitenit Pajazit Boletini, ki siapas rregullimit administrative, të gjitha njesitë e xhandarmërisë ishin të detyruara të vepronin nën komandën e

[219] Emin Pllana, Vuçiterna me rrethinë në kuadrin e sistemit pushtues fashist 1941-1945, në Kosova, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 297-298.
[220] Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f. 26.
[221] Izber Hoti, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinëndhe rrethinë, Prishtinë, 1986, f.38.
[222] Hakif Bajrami, Sistemi i pushtimit në Podujevë dhe rrethinë 1941-1944, në Kosova, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 314.
[223] Ali Hadri, Sistemi i Pushtimit fashist në Kosovë (1941-1944), në revisten Kosova, nr. 7, Prishtinë, 1978, f.37.

tij. Ndërsa sa u përket financave, në fillim për to duheshin të kujdeshein komunat. Organi kryesor administrative për financa u vendos në Mitrovicë. Sipas marrëveshjes së 21 prillit 1941 shqiptarët duhet t'i marrin në rregull organet financiare. Edhe për gjyqet në Kosovë, sipas po të njejtës marrëveshje u vendos që pushteti gjyqësor në fillim të funksionoj në komunë. Udhëheqja më e lart gjyqsore u vendos në Mitrovicë. E cila merrej me shqyrtimin e ankesave dhe harmonizimin e kryerjes së punëve gjyqsore nëpër rrethe dhe komuna. Kjo edhe ishte arsyeja, që në raportin e 21 prillit thuhej se pushtuesit duhet njoftuar për formimin e gjyqeve e pastaj të njoftohet edhe I tërë populli.[224] Në territorin e Qarkut të Kosovës, egzistonte një gjyq i qarkut, i cili ishte nën juridiksionin e Gjyqit të Apelacionit në Nish. Me rastin e emërimeve të personelit të gjyqeve përfillej proporcioni i numrit të banorëve të kombësisë serbe dhe shqiptare.[225]

Një ndër problemet e rëndësishme me të cilin u ballafaquan shqiptarët në Zonën gjermane të psuhtimit ishte ai i statusit të qarkut të Kosovës në kuadrin e shtetit kusiling serb. Prijesit shqiptarë të asaj kohe i kishin filluar bisedimet me komanden gjermane qysh në muajin maj të vitit 1941. Pas këtyre bisedimeve, komandanti i kombsorisë gjermane Eberhard, nënshkroi një marrëveshje me prijësit shqiptar të Mitrovicës, Senicës, Pazarit të Ri, Vushtrrisë, Prishtinës, Podujevës, Drenicës, të Istogut dhe të Pejës, sipas së cilës u sigurohej shqiptarëve pushteti i plotë në këto treva.[226] Njëri nga protagonistët kryesorë të shqiptarëve gjatë këti takimi ishte Xhafer Deva, për të cili flitej se ksihte punuar për shërbimin e fshehtë gjerman edhe para pushtimit gjerman, ku edhe më vonë bëhet kryeshef i administratës locale në Mitrovicë. Gjatë këti takimi u arrit marrëveshjan që shqiptarët ta ksihin pushtetinlokal në rajonet e banuara me shqiptar, mandej ata të ksihin të drejtë të hapnin shkolla etj. Duhet përmendur, se një ndër temat kryesore që u shqyrtua në këtë takim në mes gjeneralit Eberhard dhe parisë së shqiptarëve, ishte dëbimi i kolonistëve serbë dhe malazes nga Kosova. Sipas të dhënave të kohës, gjenerali Eberhard u premtoi ndihmë shqipatrëve për largimin e serbëve, por insistoi që nuk duhët marrur masa të sjpejta për largimin e tyre, por duhet pritur ndonjë moment te volitshëm. Mirëpo, për fat të keq këto premtime ishin vetëm iluzione.

[224] Hakif Bajrami, Sistemi i pushtimit në Podujevë dhe rrethinë 1941-1944, në Kosova, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 320.
[225] Hakif Bajrami, Sistemi i pushtimit në Podujevë dhe rrethinë 1941-1944, në Kosova, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 320.
[226] Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f. 30.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

KRAHASIM I FJALIVE TË PËRBËRA NË DISA SINTAKSA TË SHQIPES

Petrit Duraj-Fakulteti i Edukimit – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Dimë që fjalia e përbërë formohet prej dy a më shumë njësish kallëzuesore dhe përbën një unitet kumtesor, gramatikor dhe intonacionor. Megjithatë, për të ardhur deri në një përkufizim të tillë, ka pasur mendime të ndryshme nga gjuhëtarë dhe studiues (sintaksologë) të ndryshëm. Punimi ynë, ka për qëllim të japë një krahasim mes përkufizimeve të fjalive të përbëra nga sintaksa e K. Cipos, I. D. Sheperit dhe sintaksa e Akademisë së Shkencave. Do të merremi me mjetet gjuhësore të ndërtimit të tyre (mjetet e lidhjes), si dhe veçoritë e ndërtimit sintaksor të pjesëve në fjalinë e përbërë. Do të krahasohen nocione dhe përkufizime nga sintaksat e sipërpërmendura, qoftë për fjalitë e përbëra me bashkërenditje, qoftë dhe, për ato me nënrenditje. Fjalia e përbërë me bashkërenditje përbëhet nga dy a më shumë pjesë homogjene të bashkuara me anë të lidhëzave bashkërenditëse. Por, një përkufizim dhe një pikëpamje të njejtë nuk na e japin të gjithë gjuhëtarët. Fjalia e përbërë me nënrenditje është tërësia sintaksore e ndërlidhur organikisht për nga ana kuptimore e gramatikore, e përbërë prej dy a më shumë njësive kallëzuesore, me raporte nënrenditjeje, varësie ndërmjet tyre. Sipas Sheperit, fjalia që plotësohet prej një fjalie të varme quhet fjali e parë e saj dhe mund të jetë fjali kryesore ose e pavarme, ose fjali e varme prej një tjetre. Do të krahasohen dhe llojet e nënllojet e fjalive me bashkërenditje dhe nënrenditje.

Për t'i dhënë sa më qartë dhe përmbledhtazi dallimet se si janë trajtuar fjalitë e përbëra, do të përdorim metodën përshkruese dhe krahasuese.

Fjalë kyçe: fjali e përbërë, mjete të lidhjes, bashkërenditje, nënrenditje, krahasim.

Fjalia e përbërë formohet prej dy a më shumë njësish kallëzuesore dhe përbën një unitet kumtesor, gramatikor dhe intonacionor. Këtë përkufizim na e jep Akademia e Shkencave. Ndërsa I. D. Sheperi thotë se për t'u shfaqur plotësisht një mendim, shumë herë bashkohen dy ose më shumë fjali kryesore të thjeshta ose të plotësuara, të cilat përbëjnë kështu një periudhë. Intonacioni i plotë dhe i përfunduar është mjet i shprehjes së raporteve ndërmjet pjesëve të fjalisë së përbërë. Fjalia asindetike e shqiptuar me intonacione të ndryshme, merr kuptime të ndryshme.

Mjetet e lidhjes

Sipas Cipos dy a më shumë fjali mund të lidhen duke ruajtur secila pavarësinë e saj dhe fjali të tilla quhen ***të renditura bashkë***, p.sh.: *Shtëpia është e vogël, po ka brenda një zemër të madhe, zemrën e nënës.* Renditja bëhet: **a**) me anë lidhëzash, **b**) pa lidhëza fare, po duke i ndarë ato me anë të presjes. Fjalitë që renditen me

anë të lidhëzave këpujore quhen ***të renditura polisindetisht***. Kur renditen pa ndihmën e lidhëzave quhen ***të renditura asindetisht***. Mjetet e lidhjes – *lidhëzat, përemrat lidhorë, ndajfoljet lidhore, fjalët korrelative*.

a) *Lidhëzat bashkërenditëse e nënrenditëse* – elemente të domosdoshme në fjalinë e përbërë lidhëzore. *Lidhëzat semantike* – kanë kuptim të tyren (p.sh. *e, dhe* shprehin idenë e bashkimit, *po*(*r*) të kundërvënies, *sepse* të shkakut etj).

b) *Përemrat e ndajfoljet lidhore* – mjete që lidhin pjesët në fjalinë e përbërë, ndaj quhen **fjalë lidhëse**, si: *që, i cili, e cila, ku, kur, tek, nga*. Përemrat funksion të dyfishtë – lidhin fjalinë dhe janë gjymtyrë fjalie. Lidhëzat nuk janë gjymtyrë.

c) *Fjalët korrelative* – përdoren brenda pjesës kryesore dhe paralajmërojnë se brendia e tyre konkrete do të sqarohet në pjesën e varur. Si fjalë korrelative shërbejnë: ndajfoljet *aq, kaq, ashtu, kështu, atëherë* etj., përemrat dëftorë: *ai, ky, i tillë*; ndonjë përemër i pacaktuar: *gjithë, kushdo, cilido. (Gramatika e Akademisë)*

Veçoritë e ndërtimit sintaksor të pjesëve në fjalinë e përbërë

Mes pjesëve të fjalisë ka përshtatje sintaksore – shprehet: me mungesën e një gjymtyre të domosdoshme te njëra pjesë dhe pjesa e nënrenditur kryen pikërisht funksionin e kësaj gjymtyre. P.sh.: *Trajnerit i ra menjëherë në sy (çfarë?) se skuadra ishte mjaft optimiste.* Paralelizëm sintaksor – kur dy pjesë të një fjalie të përbërë kanë gjymtyrë të njëjta (si lloj), rend të njëjtë të tyre dhe intonacion të njëjtë. Lidhja e tyre bëhet me lidhëzat *por, kurse, ndërsa,* p.sh.: *Artani merrej me basketboll, kurse i vëllai stërvitej për atletikë.*

Rendi i pjesëve në fjalinë e përbërë

Sipas Sheperit *në fjali të pavarme,* kryefjala ka vendin e parë; këtë e pason folja dhe pas kësaj vjen kundrina ose atributi. Plotësit e kanë secili vendin pranë fjalës që plotësojnë, p.sh.: *Djemtë e mirë u binden kurdoherë të mëdhenjëvet.*

Fjalitë e varme, si plotës të fjalive kryesore ose të ndonjë fjale të tyre, vihen përpara ose pas tyre si dhe plotësit e tjerë. Vetëm kryefjala e foljeve pavetore vjen rregullisht pas foljes, p.sh.: *Kush punon fiton*. Fillojnë kurdoherë nga lidhëza e tyre, në mënyrë që çdo fjalë që shkon përpara lidhëzës nuk i përket fjalisë së varme, po mund të nënkuptohet dhe në të, p.sh.: *Djalin, tek shkonja udhës, e pashë që po vente në shkollë. Në fjalitë me bashkërenditje dhe asindetike* është karakteristik rendi i ngulitur, p.sh.: *Ishte ndajnatëherë dhe frynte një veri i hollë.* Ndërsa sipas Gramatikës së Akademisë së Shkencave *në fjalitë e përbëra me nënrenditje* rendi mund të jetë i ngulitur ose i lirë. Në fjalitë me pjesë të nënrenditur përcaktore rendi është i ngulitur, pjesa e nënrenditur qëndron gjithmonë pas kryesores. Rendi i lirë – pjesa e nënrenditur mund të qëndrojë pas, para dhe në mes të kryesores. *Fjalitë e përbëra lidhëzore* – me lidhëza dhe fjalë lidhëse. *Fjalitë e përbëra jolidhëzore* – asindetike (pa lidhëza). Fjalia e përbërë me bashkërenditje përbëhet nga dy a më shumë pjesë homogjene të bashkuara me anë të lidhëzave bashkërenditëse. *Strukturë e hapur* – prej dy e më shumë pjesësh e mund të shtohen dhe të tjera (fjali shumëgjymtyrëshe). *Strukturë të mbyllur* – dygjymtyrëshe. (*Gramatika e Akademisë*)

Tipat e fjalive me bashkërenditje

Fjalitë e bashkërenditura janë **të palidhura** ose **të lidhura**. Fjalitë e bashkërenditura **të lidhura** marrin: **a**) *lidhëz shtuese*, p.sh.: *Erdhi dhe tha*; **b**) *lidhëz dalluese*, p.sh.: *Puno ose shko*; **c**) *lidhëz kundërshtore po (por, mirëpo)*, p.sh.: *Nuk e mori po e la*; **ç**) *lidhëz përmbylltore*, p.sh.: *Duhet të shkruash; merr, pra pendën*. Lidhëzat shtuese, dalluese, kundërshtorja por dhe përmbylltoret lidhin pjesë homogjene të fjalisë ose të periudhës dhe i quajmë lidhëza bashkërenditëse, për t'i dalluar nga lidhëzat e tjera, të cilat janë lidhëza të bashkëlidhjes. Sipas Sheperit kemi *fjali të palidhura:* **a**) kur shfaqet kallëzimi i gjatë, i shpejtë, p.sh.: *Djemtë thërritnin, hidheshin, qeshnin*; **b**) kur shpjegohet fjalë ose fjali e mëparshme, p.sh.: *Është i sëmurë, i dhemb koka*; **c**) kur vërtetohen të parat, p.sh.: *Ka ikur, nuk është këtu*. Dhe fjalitë e bashkëlidhura mund të renditen të palidhura për gjallëni, p.sh.: *E dënova, bëri faj*. Fjali të palidhura janë dhe fjalitë e ndërhyra. Këto shtohen në mes të fjalive të tjera pa pasur lidhje me ndonjë pjesë të tyre, dhe janë fjali kryesore prej të cilave nënkuptohen si të varura fjalitë e tjera, p.sh.: *Erdhi, më thanë, që pa gdhirë*. Lidhen me lidhëzat shtuese: *e, dhe, edhe*, ose negativisht me lidhëzën: *as...as, jo vetëm...po(e) dhe*, ose negativisht*: jo vetëm...po as*, p.sh.*: Erdhi dhe tha: as e pashë as pyeta për të*; lidhëzat dalluese: *a(ja), ase, o, ose, i, ise, se-se*, dhe në pyetje me lidhëzën *apo*, p.sh.*: Ka ardhë ose është i sëmurë*; lidhëzat kundërshtore: *por, ose, po, me gjithë që, ndonëse* etj., p.sh.: *Nuk është i madh, po i vogël*; lidhëzën përmbylltore *pra*, p.sh.: *Kemi nevojë për shumë gjëra, të cilat fitohen me punë: duhet, pra, të punojmë.*

Fjali me bashkërenditje këpujore

Përdoren lidhëzat këpujore: dhe, *e, edhe, as, as...as*. *Marrëdhënie shkak-pasojë* – lidhëza: *dhe*, p.sh.*: Ishte vonë dhe po nxitonte për në punë.* Më qartë me lidhëzën: *prandaj*. *Marrëdhënie përqasore* – p.sh.: *Nata atje është tjetër natë dhe dita tjetër ditë. Marrëdhënie mospajtimi e lejimi*, p.sh.: *Peshku në det e tigani në zjarr. Unë me bukë e ti me gurë. Marrëdhënie shkallëzimi* – lidhëzat: *jo vetëm...por edhe, le që...por edhe, jo vetëm që...por as, le që...por as*, p.sh.: *Kalorësi jo vetëm që u ndal, por i zbriti edhe kalit.*

Fjalitë e bashkërenditura me marrëdhënie kundërshtore:

Struktura dygjymtyrëshe – lidhëzat kundërshtore: *po, por, mirëpo, porse, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, me pjesëzat-lidhëza: vetëm, veç; lidhëzat: veçse, vetëm se.*

Nëntipat :

- kuptimi i përqasjes: *kurse*;
- kontrasti – veprime, ngjarje, gjendje: *por, mirëpo, përse*
- kufizuese – pjesa e dytë kufizon vlerën e pjesës së parë, p.sh.: *Supa ishte e mirë, po duhej ngrohur pak.*
- kundërshtore-lejore: *po, por, porse;* pjesa e dytë: *prapë, prapëseprapë, megjithatë, megjithëkëtë.*
- kushtore – me lidhëzën: *pa* dhe me fjalët: *ndryshe, përndryshe, veç, vetëm* etj., p.sh.: *Ai ishte dinak, veç dinakëria e ka një farë kufiri.*

Fjalia e bashkërenditur me marrëdhënie veçuese

Japin dy a më shumë fakte, dukuri etj., që përjashtojnë njëri-tjetrin; realizimi i njërit përjashton realizimin e tjetrit: *o, a, ose, ja, apo, o...o, a...a, ose...ose.*

Dy lloj marrëdhëniesh veçimi:

- përjashtim tërësor – përjashtohen të gjitha faktet e dukuritë përveç njërit, p.sh.: *Ja të vdesim, ja të rrojmë për liri.*
- përjashtim alternativ – përsëriten duke u përjashtuar këmbyerazi; lidhëza: *herë...herë*, p.sh.: *Natën herë binte shi, herë binte borë.* Në të shkruar pjesët ndahen me presje.

Fjalitë e bashkërenditura me marrëdhënie përmbyllëse

Është patjetër dygjymtyrëshe. Pjesa e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, si përfundim i pjesës së parë. Lidhëzat: *andaj, ndaj, pra, pa*; p.sh.: *Do të kalojmë në zona të ftohta, ndaj vishuni mirë.* Në të shkruar ndahen me presje.

Fjalitë e bashkërenditura me marrëdhënie shkakore-motivuese

Me lidhëzën: *pa*. Pjesa e dytë motivon kërkesën e parashtruar në pjesën e parë. Pjesa e parë e ka foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore, p.sh.: *Shko ti, pa ta mbaj unë djalin*. Në të shkruar pjesa e dytë ndahet me presje

Sa i përket fjalive me nënrenditje, në librin e Akademisë së Shkencave është përkufizuar si fjali e përbërë me nënrenditje, te Sheperi e gjejmë si fjali e bashkëlidhur, ndërsa te Cipo si fjali e varur. ASH e përkufizon: "Fjalia e përbërë me nënrenditje është tërësia sintaksore e ndërlidhur organikisht për nga ana kuptimore e gramatikore, e përbërë prej dy a më shumë njësive kallëzuesore, me raporte nënrenditjeje, varësie ndërmjet tyre." Sheperi: "Fjalia që plotësohet prej një fjalie të varme quhet fjali e parë e saj dhe mund të jetë *fjali kryesore ose e pavarme*, ose fjali e varme prej një tjetre, p.sh.: *U-habita kur i pashë që rrinin pa punë*." Dhe Cipoja:*"Fjali kryesore* quhet ajo që nuk varet nga të tjerat, po kuptim të plotë vetiu nuk ka, në mos u ndihmoftë nga fjalitë e varura, p.sh.: *Nuk kuptova se ç'deshe të më thuash." Për Gramatikën e Akademisë pjesë kryesore* quhet pjesa që shërben si bazë organizuese e fjalisë. Për Sheperin, Nga dy fjali të bashkëlidhura ajo që plotëson tjetrën merr përpara një nga lidhëzat e bashkëlidhjes, ose një nga përemrat ose ndajfoljet lidhore, dhe quhet *fjali e varme ose e dytë*. *Dhe për Cipon, fjali e varur* quhet ajo që varet ose nga kryesorja ose nga një tjetër e varur, p.sh.: *Më kanë thënë se tani nxënësit po punojnë më shumë. Pjesë e nënrenditur ose e varur* quhet ajo pjesë e fjalisë që e plotëson pjesën kryesore dhe është e varur prej saj. *Pjesë drejtuese* pjesa kryesore ose e varur prej së cilës varet një pjesë tjetër. (*Gramatika* e *Akademisë*) Fjalitë e varme, si pjesë të fjalive kryesore, shërbejnë në to: **a**) në vend të emrit, si kryefjalë, kallëzues, kundrina ose ndajshtime, p.sh.: *Duhet të punojmë;* **b**) në vend të mbiemrit, si plotës të ndonjë emri të fjalisë kryesore, p.sh.: *Njeriu që ka dëshirë për punë nuk merr parasysh lodhjen*; **c**) si plotës qëllimi (fjali qëllimi), p.sh.: *Punon që të fitojë;* **ç**) si plotës shkaku (fjali shkaku), p.sh.: *Fiton se punon;* **d**) si plotës kohe (fjali kohe), p.sh.: *Kur punojmë, fitojmë;* **dh**) si plotës kushti (fjali kushti), p.sh.: *Në punofsh do të fitosh;* **e**) si plotës që shfaq të kundërtën (fjali kundërshtore), p.sh.: *Ndonëse punon, nuk fiton*. (*Sheperi)* Fjalitë e varme lidhen me kryesoren ose me shoqet e tyre me anë të lidhëzave nënrenditëse, ose me anë përemrash lidhorë dhe me anë ndajfoljesh lidhore. Duke qenë që fjalitë e varura hyjnë në çdo farë pune, ato mund të jenë: *subjekt*, *objekt*, ose *plotës* të fjalive nga të cilat varen, andaj i gjejmë disa farësh: *subjektore*, *objektore*, *artributore*, *ndajfoljore*. Janë **subjektore** kur hyjnë në punë si subjekt të fjalisë nga ku varen, veçse kjo fjali e fundit duhet të jetë një folje pavetore ose të bëjë shërbimin e një të tille, p.sh.: *Nuk më pëlqen të sillem tërë ditën pa punë*. Janë **objektore** kur përdoren si kundrina të drejta të fjalive nga të cilat varen, p.sh.: *Më*

tha se punët venë mirë. Janë **atributore** kur bëjnë punën e plotësit atributor, p.sh.: *Kujt nuk i pëlqen një fjalë që thuhet pa sherr*? Janë **ndajfoljore** kur përdoren si plotës ndajfoljor, p.sh.: *Vetëm kur sosi tërë punët, ra e mori një sy gjumë.(K. Cipo)* Në bazë të funksioneve e raporteve sintaksore me pjesën drejtuese, pjesët e nënrenditura ndahen në: 1. pjesë të nënrenditura kryefjalore, 2. kallëzuesore, 3. kundrinore, 4. përcaktore, 5. rrethanore.

Llojet e fjalive me nënrenditje

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur kryefjalore

Fjali me pjesë të nënrenditur kryefjalore quhet ajo fjali e përbërë që ka një pjesë të varur, e cila kryen ndaj pjesës kryesore dykryegjymtyrëshe një funksion të ngjashëm me atë të kryefjalës. U përgjigjet po atyre pyetjeve të kryefjalës: *kush?, cili?, çfarë*? (*Akademia)*

Pyetje e zhdrejtë

Kur bëhet pyetje e drejtë me ndonjë përemër ose ndajfolje pyetëse, pyetja e zhdrejtë bëhet ose me po ata përemra a ndajfolje të përdorura si përemra a ndajfolje lidhore, ose merr dhe lidhëzën e caktimit: *se*, p.sh.: *Të pyes kush flet, ose të pyes se kush flet*. *(Sheperi)*

Sipas K. Cipos:

Fjalia subjektore

Quhet ajo që hyn në punë si kryefjalë e fjalisë kryesore ose e çdo fjalie tjetër nga e cila varet subjektorja. Lidhëzat që shtiem në punë në këso rasash janë këto: *që, se*. Fjalia subjektore mund të rrijë në mënyrën dëftore dhe në mënyrën lidhore, p.sh.: *Duket që nuk i pëlqen ajo fjalë*. Foljet me të cilat shkojnë fjalitë subjektore janë: **1**) *foljet pavetësore*: *duket, lipset, duhet*; **2**) *lokucionet pavetësore*: *është mirë, është keq, s'është e udhës, qenka thënë*; **3**) *foljet e vetës së tretë njëjës të diatezës pësore*, si: *flitet, thuhet, pëshpëritet* etj.

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur kallëzuesore

Kryen funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit emëror ose përcaktorit kallëzuesor. Kallëzore e tërthortë – pjesa që shtjellon brendinë e një kallëzuesi emëror ose përcaktori kallëzuesor të shprehur me ndajfolje ose përemër dëftor, p.sh.: *Jeni ashtu si ju dua unë. Ai është nga ata që nuk përulen*. *Mjetet* – lidhëzat: *se, që, sikur, kur, tek*; me përemra të pacaktuar, me përemra lidhorë dhe me ndajfolje lidhore.

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur kundrinore

Kryen një funksion të ngjashëm me atë të kundrinorit. Fjalitë kundrinore ndahen në dy grupe: **1**. *fjali jokorrelative*, **2**. *fjali korrelative*. (*Akademia*)

Fjalia objektore

Është ajo që hyn në punë si kundrinë e drejtë e fjalisë kryesore ose e një fjalie të varur. Lidhet me fjalinë kryesore me anë të lidhëzave: *që, se*, p.sh.: *Më thanë që paske shkruar një artikull të gjatë rreth poezisë*

popullore. Fjali objektore marrin sidomos ato folje që tregojnë*: të parë, të dëgjuar, të kuptuar, të thënë. P.sh.: Mora vesh se po botohen shumë libra të bukur.* (*Cipo*)

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore

Pjesa e nënrenditur ka një funksion të ngjashëm me atë të një gjymtyre përcaktore të shprehur me mbiemër, me emër, me ndajfolje ose luan rolin e një ndajshtimi. Pjesa e varur përcaktore tregon një karakteristikë të një gjymtyre që shprehet me emër ose përemër e që quhet paraprijës i saj, p.sh.: *Rilindasit punuan shumë për shkollën shqipe, e cila u ngrit e u mbajt me gjak*. (*Akademia*)

Fjalia lidhore

Mbështetet zakonisht pas një substantivi pavarësisht se ç'veprim mund të ushtrojë ky emër brenda në fjali. Lidhet me kryesoren me: **a**) përemrin lidhor: *që*, **b**) lokucionet përemërore*: i cili, e cila, të cilët, të cilave*, **c**) përemri lidhor i pacaktuar: *kush* që mund të zbërthehet: *ai që, ajo që*. p.sh.: *Puna që bëhet shkel e shko s'ka grat.* (*Cipoja*)

Fjali përmendëse (relative)

Fjalitë përemndëse ose relative lidhen me anë të përemrave lidhorë ose të ndajfoljeve lidhore dhe plotësojnë një emër ose ndajfolje që ndodhet në fjalinë kryesore, ose që nënkuptohet. Përemrat lidhorë *që* dhe *i cili* referohen: **a**) në një emër të caktuar që ndodhet në fjali kryesore, dhe përbëjnë fjali relative që shërben si një mbiemër (plotës cilësor), p.sh.*: E gjeta librin që kërkonim*; **b**) në përemrat dëftorë të tyre, me të cilët përbëjnë lokucionet: *ay që (ay i cili),* dhe fjalitë relative që bëhen me këto lokucione zënë vendin e një emri të pacaktuar, si kryefjalë ose kundrina të fjalisë kryesore, p.sh.: *Atë që kërkon, e gjen*. (*Sheperi*)

Fjali caktimi

Fjalitë e caktimit kufizojnë ose caktojnë kuptimin e gjerë të foljes kryesore, dhe lidhen me të me anë të lidhëzave: *që* dhe *se*, p.sh.: *E mësova që erdhi*. (*Sheperi*)

Fjalitë e përbëra rrethanore

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore - ajo fjali ku shprehen marrëdhënie vendore e hapësinore ndërmjet pjesës së varur dhe kryesore. Pjesa e varur mund të tregojë nuanca të ndryshme të marrëdhënieve vendore: vendin ku ndodhet një send, ku kryhet veprimi, pikënisjen e lëvizjes, drejtimin e saj, vendin që përshkon lëvizja etj., p.sh.: *Ku dhemb dhëmbi, vete gjuha*. (*Akademia*)

Fjalia vëndore

Tregon vëndin ku ka ndodhur një punë, një veprim, një ngjarje për të cilën ka bërë fjalë fjalia kryesore ose një fjali e varur. Lidhet me fjalinë kryesore me anë ndajfoljesh, kryesisht me ndajfoljen: *ku*, p.sh.: *Ku ke punën shtro dhe gunën.* Mund të lidhet me kryesoren edhe me ndajfoljen *tek*, p.sh.: *Tek nuk ka, nuk merr ai kusari*. Lidhet edhe me shprehjet vendore: *atje ku, atje tek*, p.sh.: *Vate atje ku piqnin pastërmanë. (Cipoja)*

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur kohore

Është ajo fjali ku pjesa e varur tregon kohën kur ndodh veprimi a ngjarja e pjesës kryesore, p.sh.: *Hekuri rrihet sa është i nxehtë.*

Fjali kohe

Fjalitë e kohës u përgjigjen pyetjeve: *kur*?, *që kur*?, *gjer kur*?, dhe shfaqin veprime të njëkohshme, të mëparshme a të mëpastajme nga veprimi i kryesores, ose fillimin a mbarimin e veprimit që shfaq kryesorja. **Veprimi i njëkohshëm** shfaqet: **a**) me lidhëzat: *kur, tek, sapo* etj., p.sh.: *Kur erdhi më tha*; **b**) me asjatëroren e pjesores me parafjalën: *me*, p.sh.: *Me të ardhur më tha*; **c**) me mënyrën përcjellore, p.sh.: *Duke ardhur më thoshte*. (*Sheperi*)

Fjalia kohore

Marrëdhëniet e kësaj me fjalinë kryesore janë shumë farësh, sepse çfaqin: **1**) *veprim të njëkohshëm*, **2**) *të parakohshëm*, **3**) *të paskohshëm*, **4**) *veprim përsëritës*, **5**) *fillim veprimi*, **6**) *mbarim veprimi*. Fjalitë kohore u përgjigjen këtyre pyetjeve: *kur?, që kur?, gjer kur?* (*Cipo*)

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur mënyrore

Pjesa e varur tregon mënyrën e kryerjes së një veprimi a të paraqitjes së një fakti të shprehur në pjesën drejtuese (kryen funksionin e rrethanorit të mënyrës), p.sh.: *Ti duhet të veprosh si të them unë.* (*Akademia*)

Fjalia e mënyrës

Tregon se qysh ka ndodhur një punë, një ngjarje për të cilën ka folur fjalia kryesore ose një fjali e varur nga e cila varet kjo e mënyrës. Lidhet me lidhëzat: *si, sikur, ashtu si, sikundër që, pa + particip*, p.sh.: *Puna vajti pikërisht si e kisha parashikuar unë. (Cipo)*

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur qëllimore

Tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i shprehur në pjesën drejtuese, p.sh.: *Turqit e shtrënguan rrethimin, me qëllim që kështjellarët të dorëzoheshin.* I referohet gjithë pjesës drejtuese dhe lidhet me lidhëzat e lokucionet: *që, me qëllim që, në mënyrë që* ose bashkohet pa lidhëza. *Që* është lidhëz e domosdoshme kur pjesa e varur është para drejtueses, ndërsa kur vjen pas mund të mungojë, p.sh.: *Që të arrish sukses, duhet të punosh çdo ditë.* (*Akademia*)

Fjali qëllimi

Fjalitë e qëllimit i përgjigjen pyetjes *përse*?, dhe shfaqen: **a**) me lidhëzën që dhe me mënyrën lidhore, p.sh.: *Studion, që të bëhet i ditur*; **b**) me mënyrën lidhore ose me paskajoren, p.sh.: *Vete të punojë*; **c**) me parafjalën për dhe me pjesore të nyjshme ose me paskajore, p.sh.: *Përgatitu për të shkuar*; **ç**) me lidhëzën që dhe me mënyrën dëftore ose habitore, kur shfaqet qëllimi si i mbaruar, p.sh.: *Vete që punon.* Fjali qëllimi përbën edhe lidhorja ose paskajorja vetëm, p.sh.: *Kërkon të punojë*. Lidhëza *që të* me të pakryerën e lidhores, kur plotëson fjali me kuptim të parealizuar, shfaq qëllim të parealizuar, p.sh.: *Të paskësh ikur, që të mos të gjente këtu. (Sheperi)*

Fjalia qëllimore

Tregon qëllim, d.m.th. që na thotë ç'qe qëllimi i një pune për të cilën bëri fjalë fjalia kryesore. Lidhet me anë të lidhëzës: *që*, kur është folja në mënyrë të shtjelluar, dhe me anë të lidhëzës: *për të*, kur është në particip, që është një nga mënyrat e pashtjelluara, p.sh.*: Që të lajë turpin e ritiratës dhe për të çgjakosur aishfatën e Ballaban Pashës, Sulltan Mehmeti u hoth përsëri në Shqipëri*. *(Cipo)*

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur shkakore

Pjesa e varur konstaton një fakt si shkak ose arsyeton lidhjen shkakore nëpërmjet pjesëve, p.sh.: *Ishte i gëzuar, ngaqë i sollën lajm të mirë.* (*Akademia*)

Fjali shkaku

Fjalitë e shkakut i përgjigjen pyetjes: *nga se*?, *pse*?, *përse*?, dhe shfaqen: **a**) me lidhëzën se ose me lokucionin me qenë se dhe me mënyrën dëftore, habitore ose kushtore, p.sh.: *U lodha se punova shumë;* **b**) me lidhëzën që ose me lokucionin: *me që, nga që*, dhe me po ato mënyra, p.sh.: *U-lodha që punova shumë.* Shkaku shfaqet dhe me fjali kohe, p.sh.: *Kur punojnë kështu kemi të drejtë të zemërohemi.(Sheperi)*

Fjalia shkakjore

Tregon shkakun pse ngjan një punë për të cilën bën fjalë fjalia kryesore ose çdo fjali tjetër nga e cila varet shakjkorja. Kjo fjali i përgjigjet pyetjes: *pse, përse*, ose lokucioneve shkakore: *për shkak*?, *për ç'punë*? Fjalia shkakore lidhet me fjalinë kryesore ose me një tjetër të varur me këto lidhëza: **a**) me lidhëzat: *se, pse*, dhe me lokucionet shkakore: *me qenë se, me qenë që*, duke marrë të gjitha mënyrën dëftore, p.sh.: *Me qenë që binte shi, pikniku u la për një ditë tjetër*. **b**) me lokucionet: *me që, nga që* dhe mënyrën dëftore, p.sh.: Shumë *patriotë nga që nuk e duronin dot zgjedhën fashiste, muarrën malet*. **c**) me lidhëzën: *kur*, p.sh.: *Kur nuk do të dëgjojë, s'ke se ç't'i bësh.* Fjalia shkakore mund të rrijë ose përpara ose pas fjalisë kryesore dhe është mirë të ndahet prej saj me një presë. (*Cipo*)

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore

Shpreh marrëdhënie ndërmjet një shkaku të shprehur në pjesën kryesore dhe pasojës a rrjedhimit të shprehur në pjesën e varur. Në pjesën e varur rrjedhimore tregohet përfundimi logjik i një fakti të dhënë në pjesën kryesore, p.sh.: *Rruga ishte dëmtuar mjaft, kështu që makina ecte ngadalë*. Bashkohet me pjesën drejtuese me lidhëzat: *sa, sa që, aq sa, kështu që*. (*Akademia*)

Fjalia rrjedhimore

Tregon rrjedhjen e një veprimi të shprehur nga fjalia kryesore, ose nga një fjali tjetër prej së cilës varet rrjedhorja. Ndërtohet me lidhëzën: *sa* ose me lidhëzën korrelative: *aqë...sa, kaqë...sa*, p.sh.: *Thirri aqë fort sa u ngjir nga zëri. (Cipo)*

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore

Shpreh marrëdhënie kusht-pasojë. Dy veprime a gjendje të ndërvarura mes tyre, d.m.th. realizimi ose mosrealizimi i asaj që thuhet në pjesën e varur, bën të pashmangshme, të mundur ose të pamundur atë që thuhet në pjesën kryesore, p.sh.: *Nuk do të nisej, në rast se dëbora do të vazhdonte ende. (Akademia)*

Fjali kushtore

Fjalitë kushtore shfaqen: **a**) me lidhëzat: *në, po* ose me lokucionet: *nëse, në është se, në qoftë se*, dhe me mënyrën dëftore ose habitore, kur vihet kushti si i vërtetë dhe i mbaruar, p.sh.: *Po ike, nuk kthehesh më*; **b**) me lidhëzën: *në* dhe me mënyrën dëshirore, kur vihet kushti si i pritshëm ose i mundshëm, p.sh.: *Në punofsh, je i fituar*; **c**) me lokucionet: *po të, sikur të* dhe me mënyrën lidhore, kur shfaqet kushti pas gjykimit të atij që e flet si i pritshëm ose i mundshëm, p.sh.: *Po të punosh je i fituar*; **ç**) me lidhëzën: *të*, ose me lokucionet: *po të, sikur të* dhe me të pakryerën e lidhores ose të habitores, kur shfaqet kushti si i parealizuar. (*Sheperi*)

Fjalia kushtore (perioda hipotetike)

Tregon kusht në rrjedhim të së cilës mund të ndodhë e mund të mos ndodhë ç'është thënë në fjalinë kryesore ose në çdo fjali tjetër nga e cila varet kushtorja dhe lidhet me anë të këtyre lidhëzave kushtore: *në qoftë se + i tanishmi* ose *i pritshmi, në rast se + i tanishmi* ose *i pritshmi, po qe se + i tanishmi, po + aoristi, po të + mënyra lidhore, në + i tanishmi* etj. Fjalia e varur që tregon kushtin: në qoftë se e di kushtin quhet **protasë**; kryesorja që përmban rrjedhimin: shkruajmë quhet **apodasë**. Protasa me gjithë apodasën formon periudhën hipotetike. (Cipo)

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur lejore

Tregon një veprim a gjendje që pritej ta pengonte realizimin e veprimit të pjesës drejtuese, por që nuk arrin ta ndalojë. (Akademia)

Fjali kundërshtore

Fjalitë kundërshtore plotësojnë fjali kryesore që shfaqin përfundim të kundërt me shkakun ose me kushtin që shfaqin kundërshtoret, p.sh.: *Me gjithë që punon, nuk fiton. (Sheperi)*

Fjalia lejore

Tregon një veprim, një ngjarje e cila kërkon sikur ta pengojë veprimin e çfaqur nga ana e fjalisë kryesore, po, jo vetëm nuk e pengon, po e lejon. Lidhet me kryesoren me anë të lokucioneve: *sadoqë, ndonëse, megjithëqë, sidoqë, dhe në*, p.sh.: *Sadoqë frynte e binte, shëtitjen e zakonshme e bëra. (Cipo)*

Fjalia e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore

Shërben për të krahasuar nga një pikëpamje e caktuar një dukuri me një tjetër. Pjesa e varur krahasore lidhet me drejtuesen me këto lidhëza a lokucione lidhëzore: *si, siç, sikur, sikurse, ashtu si, ashtu siç, se, seç, sesa,*

me ndajfoljen *sa*, me përemrin *sa* të prirë nga parafjala *nga* (*nga ç'*)., p.sh.: *Ajo tablo më shumë e brengosi sesa i ngjalli kënaqësi.* (*Akademia*)

Fjalia krahasore

Përdoret për të bërë një krahasim midis dy gjendjeve, dy ngjarjeve, dy veprimeve. Lidhet me fjalinë nga e cila varet me lidhëzat korelative: **1**) *si...ashtu*, ose vetëm me lidhëzën *siç*, p.sh.: *Siç mbolli, korri*. **2**) *sa më...aq më*, p.sh.: *Sa më ta marrçë me të mirë, më i egër bëhet*. **3**) *sikundër që...ashtu*, p.sh.*: Sikundër që thashë ashtu edhe veprova.* **4**) *ashtu si...ashtu edhe*, ose *ashtu sikundër ...ashtu edhe*, p.sh.: *Ashtu si kundër the, ashtu edhe të veprosh.* **5**) *më...se sa*, p.sh.: *Është më afër fqinjësia se sa mund të jetë fisi dhe gjëria. (Cipo)*

Fjalia kufizore

Është fjalia që shtiem në punë kur duam të kufizojmë a të ngushtojmë një mendim që e kemi çfaqur ne fjalinë kryesore ose në një fjali të varur. Përdoren këto lidhëza: *me sa..., me ç'...*, p.sh.: *Me sa marr vesh unë, gjendja ekonomike e vendit tonë është përmirësuar qint për qint.(Cipo)*

Literatura:

Akademia e shkencave e Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002,

Cipo, K., "Gramatika", Instituti i Shkencave, 1949.

Cipo, K., "Sintaksa" Instituti i Shkencave, 1952.

Sheper, I. D., Gramatika, 1927, Vlorë.

INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM - ULQIN, Mali i Zi, 6-7 Prill 2018

Konferenca e X-të:

" *Novacioni, arsimi. Kërkimi dhe shkenca në funksion të zhvillimeve globale* "

E- ISSN 2337-0521 **ISSN 1800-9794**

AFTËSITË KOMUNIKUESE TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETET SHQIPTARE

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Prof. Dr. Diana Shehu[1]

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Prof. Dr. Myslym Osmani

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Dr. Ylvie Kraja

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Prof.Dr. Elez Osmani[4]

Abstrakt

Aftësitë e komunikimit janë një nga elementet e aftësive të përgjithshme, të cilat janë thelbësore mes studentëve të universitetit. Gjatë viteve të tyre në universitet, studentët do të jenë të ekspozuar ndaj situatave, brenda dhe jashtë auditoreve të leksioneve. Brenda auditoreve, ata duhet të përdorin aftësitë e tyre të komunikimit, për shembull në projektet e kursit që ata përgatisin si dhe në prezantimet në klasë. E rëndësishme është jo vetëm komunikimi me njëri tjetrin, por dhe me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në senat. Jashtë auditorve atyre ju duhet të rrisin komunikimin për punësimin. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është të evidentojë nivelin e shkathtësive të komunikimit midis studentëve të universitetit me njëri tjetrin dhe me përfaqësuesit e tyre në senat. Aftësitë e komunikimit u matën nëpërmjet një pyetësori të organizuar me 5 universitete publike të vendit. Për përpunimin e të dhënave u përdor metoda deskriptive. Nga analiza e studimit rezultoi se komunikimi midis studentëve dhe me përfaqësuesit e tyre në senat nuk ëhstë në nivelin e duhur. Në fund do të jepen konkluzione dhe rekomandime, se si mund të punojnë më mirë drejtuesit e universiteteve, por dhe vetë studentët për të përmirësuar këto aftësi komunikuese në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Aftësi komunikuese, studentë të universitetit, senator, komunikim social.

Hyrje

Roli i universitetit në përgatitjen e studentëve në fusha të ndryshme për të plotësuar nevojat e tregut nuk fokusohet vetëm në arritjet akademike, por edhe në aftësitë e përgjithshme të tyre për tju përshtatur dhe konkurruar në ekonominë globale. " Në botën e globalizuar, studentët e universitetit është e nevojshme të perfeksionojnë aftësitë komunikuese në kontekstet e ndryshme kulturore". (Penbek, Yurdakul, & Cerit, 2009).

Nisur nga realiteti që po jetojmë është e nevojshme që studentët të kenë:

1. Aftësi të mira komunikuese,
2. Të njohin teknologjinë, pra të njohin të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë
3. Të përvetësojnë një apo dy gjuhë bazë ndërkombëtare që ju nevojiten atyre për një komunikim cilësor në ekonominë globale.

Aftësitë komunikuese të mira ju nevojiten studentëve në tregun e punës, sepse punëdhënësit sot ju kushtojnë një rëndësi të madhe këtyre aftësive si dhe personalitetit në zgjedhjen e punonjësve të tyre të ardhshëm. "Studentët është e nevojshme që të përpiqen për të zhvilluar aftësitë e tyre komunikuese që të jenë të aftë për të arritur sukes në profesionin e tyre të zgjedhur". (Ihmeideh, et al. 2010). Komunikimi realizohet në të dy format e tij, komunikim gojor dhe ai me shkrim. Studimet e bëra në fushën e komunikimit kanë treguar se nëse mjediset ku jetojnë dhe punojnë studentët janë pozitive për komunikim, ato ofrojnë mundësi për studentët që të praktikojnë aftësitë e tyre të komunikimit dhe të marrin pjesë në të mësuarit aktiv.

Ky ambjent përfshin dhe komunikimin e pedagogëve me studentët si dhe komunikimin e pedagogëve me njëri tjetrin. Studentët duhet t'i zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit përmes diskutimeve dhe prezantimeve në klasë, por edhe të njohin situatat e komunikimit në botën reale.

Universitet duhet të organizojnë shumë aktivitete për të rritur efektivitetitin e komunikimit me qëllim që të përballojnë sfidat e botës se globalizuar.

Metodologjia

U përgatitën pyetësorët dhe u shpërndanë në 5 universitetet, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në Universitetin e Tiranës, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, në Universitetin "Aleksandër Mojsiu" të Elbasanit, në Universitetin "Fan Noli" të Korçës. Numri total i studentëve të anketuar ishte 854. Përpunimi i të dhënave u bë me anë të metodës deskriptive që nënkupton grupime të ndryshme strukturore, tabela, grafiqe, dhe madhësi mesatare.

Rezultatet dhe diskutimi

Ekzistojnë katër elementë për komunikimin shoqëror, të cilat janë negocimi, gjuhë, kulturë dhe të jenë të mirësjellshëm (Iksana, et al. 2012). Për të rritur efektivitetin e komunikimit është e domosdoshme fryma e bashkëpunimit të studentëve me njëri tjetrin që shprehet në faktin që studentët duhet të diskutojnë dhe negociojnë për një kurs projekti ku të gjithë të jenë dakort me hapat që do të ndiqen dhe rezultatet që do të arrihen, etj. Çdonjëri prej anëtarëve të grupit duhet të jetë i aftë për të filluar një diskutim, të jetë i aftë për të kritikuar dhe për tu kritikuar, të jetë në gjendje të bëjë konkluzione të sakta mbi diskutimet

Në anketimin e organizuar në pyetjen "A jeni të kënaqur me numrin e studentëve në grup", siç vërehet dhe nga tabela e mëposhtëme 48% e studentëve kanë dhënë përgjigjen se janë të kënaqur shumë, 42% pak dhe 10% aspak.

Kënaqësia me numrin studentëve në grup	Nr
Aspak	78
Pak	359
Shumë	417
Total	**854**

Tabela 1: Kënaqësia me numrin studentëve në grup

Në pyetjen nr 29, "A diskutoni probleme të ndryshme në grup"? grafiku tregon se alternativës "asnjëherë" i janë përgjigjur 6% e tyre, 45% i janë përgjigjur "ndonjëherë", 39% "shpesh", 10 % gjithmonë.

Në pyetjen nr 30, "A ka frymë bashkëpunimi në grupin tuaj?" alternativës "asnjëherë" i janë përgjigjur 6% e tyre, 46% i janë përgjigjur "ndonjëherë", 33% "shpesh", 15 % gjithmonë.

Në pyetjen nr 31, "A jeni të hapur të pranoni mendimet që nuk përputhen me mendimet tuaja?"

alternativës "asnjëherë" i janë përgjigjur 2% e tyre, 27% i janë përgjigjur "ndonjëherë", 35% "shpesh", 34 % gjithmonë.

Si konkluzion mund të themi që komunikimi dhe fryma e bashkëpunimit mes studentëve nuk janë në nivelin e duhur.



Grafiku 1: Bashkëpunimi në grup

Në pyetësor u trajtua dhe problemi i marrëdhënieve të studentëve me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në senat.

Senati i universitetit zgjidhet një herë në 4 vjet. Studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në senat në varësi të numrit të studentëve të universitetit. Ndër funksionet kryesore të senatit janë:

1. Garanton autonominë e universitetit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve.

2. Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UBT.

3. SENATI përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit, duke programuar, bashkërenduar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Nisur nga funksionet e senatit, detyra e përfaqësuesve të studentëve në senat është:

a. Para së gjithash që të luftojnë për të siguruar të drejtat e studentëve,

b. Që të paraqesin problemet e ndryshme të studentëve që lidhen me procesin mësimor dhe cilësinë e tij,

c. Që të paraqesin problemet e komunikimit të studentëve me stafin akademik, me njëri tjetrin, me përfaqësuesit e tyre në senat.

E rëndësishme është që në senat të zgjidhen studentët më të mirë, të cilët janë model për studentët e tjerë në të gjitha drejtimet dhe jo thjesht vetëm pse kanë një mesatare shumë të mirë. Në anketimin e organizuar në pyetjen "A mendoni se personat që janë zgjedhur nga ju në senat janë të duhurit"? përgjigja e mbi 55 % e studentëve ishte "Jo".

Nga anketimet rezultoi se më shumë se 55 % e studentëve në të gjitha universitet ku u krye anketimi deklarojnë se nuk i njohin fare të zgjedhurit e tyre. Nga grafiku i mëposhtëm rezulton se në pyetjen "A i shprehni ju problemet tuaja tek studentët e zgjedhur në senat nga 854 studentë të anketuar rezulton:

534 studentë shprehen "asnjëherë",

203 studentë shprehen "ndonjëherë",

89 studentë shprehen "shpesh",

28 studentë shprehen "gjithmonë".

Mbi 62% e studentëve që dhanë alternativën "asnjëherë", shprehen se nuk i njihnin përfaqësuesit e tyre në senat, 30% e tyre se nuk ishin të interesuar dhe 8 % se nuk kishin besim tek ata.



Grafiku 2: Problemet e studentëve të shprehura tek të zgjedhurit në senat

Përfaqësuesit e studentëve në senat duhet të organizojnë herë pas here anketime, takime me studentët në lidhje me problemet, shqetësimet që ata kanë gjatë procesit mësimor dhe t'i ngrenë këto shqetësime në senat.

Nga grafiku i mëposhtëm rezulton se në pyetjen ". A bëjnë studentët e zgjedhur takime me ju për të marrë mendimet? nga 854 studentë të anketuar rezulton:

571 studentë shprehen "asnjëherë",

207 studentë shprehen "ndonjëherë",

60 studentë shprehen "shpesh",

16 studentë shprehen "gjithmonë".

Mbi 66% e studentëve shprehen se përfaqësuesit e tyre në senat nuk organizojnë takime me ta, 24% se organizojnë ndonjëherë, 7% shpesh dhe 3% gjithmonë. Sipas studentëve disa nga arsyet për këtë situatë janë se përfaqësuesit e tyre janë indiferentë, se nuk duan t'i dëgjojnë dhe se kanë frikë nga problemet që mund të ngrenë studentët.



Grafiku 3: Alternativat e shprehura për takimet me studentët.

Nisur nga anketimi, por dhe nga komentet që kanë bërë studentët ky rezultat mund të shpjegohet për disa arsye:

1. Nuk është bërë një prezantim shumë i mirë nga vetë kandidatët për senat, gjatë fushatës për zgjedhjen e tyre.

2. Rreth 30 % e të anketuarve në të gjitha universitet ku u krye anketimi, thanë se përfaqësuesit e tyre janë zgjedhur nën ndikimin e rektorit.

3. Studentët vetë nuk interesohen për përfaqësuesit e tyre në senat gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Në një pjesë të universiteteve dhe pse studentët i njihnin përfaqësuesirt e tyre në senat, ata shprehën opninonin se senatorët merreshin më shumë me organizimin e festave dhe mbrëmjeve, se sa zgjidhnin problemet që kishin studentët.

Shefat e departamenteve, dekani, por dhe pedagogët duhet tju shpjegojnë studentëve që kur vijnë në vit të parë procedurat që duhet të ndjekin ata, nëse ata kanë probleme të ndryshme, ankesa dhe cilat janë shkallët hierarkike që ata duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Shefat dhe pedagogët duhet të jenë të çiltër e të sinqertë me studentët që ata të mos ndihen të frikësuar nga ndëshkimi me notë apo mënyra të tjera, për problemet që mund të ngrinin. Efektiviteteti i komunikimit rritet nëse shtohet fryma e bashkëpunimit, solidaritetit dhe pranimit të mendimeve të tjerëve edhe pse ato mund të jenë ndryshe, ose madje dhe të kundërta.

Konkluzione dhe rekomandime

1. Studentët e zgjedhur në senat duhet të organizojnë më shumë takime dhe anketime me studentët lidhur me problemet e tyre dhe t'i paraqesin ato në senat për zgjidhjen e tyre.

2. Drejtuesit duhet të organizojnë më shumë anketime në lidhje me komunikimin e studentëve me stafin akademik, por dhe me njëri tjetrin dhe përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në senat.

3. Universitetet duhet të organizojnë më shumë aktivitete për studentët që të rrisin frymën e bashkëpunimit midis tyre, që të zhvillojnë dhe të krijojnë aftësitë e tyre të komunikimit, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e karrierës së tyre në të ardhmen.

Literatura

1. Ihmeideh, F. M., Ahmad, A., & Al-Dababneh, K. A. (2010). Attitude toward communication skills among students' teachers' in Jordanian Public Universities. Australian Journal of Teacher Education, 35, 1-11.

2. Penbek, S., Yurdakul, & D., Cerit, A. G. (2009). Intercultural communication competence: A study about the intercultural sensitivity of university students based on their education and international experiences. Kertas kerja ini telah dibentangkan di European and Meditteranean Conference on Information System 2009.

3. Zanaton Haji Iksana, Effendi Zakariaa, Tamby Subahan Mohd Meeraha, Kamisah Osmana, Denise Koh Choon Liana, Siti Nur Diyana Mahmuda & Pramela Krishb

(2012), Procedia - Social and Behavioral Sciences, 59, p 75.

E- ISSN 2337-0521 ISSN 1800-9794

VEPRA LETRARE E MUSINE KOKALARIT NË 100 VJETORIN E LINDJES

PhD cand. Meliza Krasniqi-Instituti Albanologjik i Prishtinës

Musine Kokalarit, tashmë në bazë të studimeve, pohohet se është shkrimtarja e parë në letrat shqipe. Vepra e Musine Kokalarit është representative, sidomos për kohën kur është shkruar, është shembull i guximit krijues dhe mjeshtërisë artistike të autores, ajo zgjedh për temë zërin femërorë, tematikat dhe problematikat femërore si dhe gjuhën tipizuese të femrës, konkretisht asaj qytetare gjirokastrite.

Musine Kokalari ka shkruar disa vepra, mes të cilave më së shumti njihen "Siç më thotë nënua plakë" në vitin 1939, "Rreth vatrës" dhe "….Sa u tunt jeta" në vitet 1944-45 etj.

Në këtë shkrim do të përpiqemi të përcaktojmë temën që del prej strukturës së krijimtarisë së tregimeve të saja të para.

Në verën e vitit 1939 Musine Kokalari u kthye për pushime nga Roma dhe shkroi përmbledhjen "Siç më thotë nënua plakë" të cilën e botoi në shtator të po atij viti në shtypshkronjën "Gutenberg" Tiranë. Kjo vepër, mjaftë modeste në dukje (80 f.), ndërtohet nga dhjetë proza të cilat janë klasifikuar si *rrëfime rinore*[227], *novela*[228], *skica letrare*[229] (siç janë quajtur atë kohë) apo tregime.

Musine Kokalari shfaqet si fenomen letrar në gjininë e prozës[230] duke sjellë risi tematike, teknike e stilistike në letërsinë shqipe pra sjell krijime origjinale. Ajo duke qenë e guximshme edhe në jetë vjen si shkrimtare e eksperimenteve letrare në kohën kur letërsia shqipe spikatej me emra të mëdhenj prozatorësh, Koliqi, Kuteli, Migjeni, Spasse, Stërmilli, etj.

Kjo kohë e shkrimit të letërsisë e cila më vonë do të quhet "letërsia e periudhës pavarësi-pushtim 1912 (1924) – 1939 (1944)[231]" ose "letërsia e viteve '40-'45[232]"prodhon autoren/subjektin që shkruan tekste që kanë për objekt botën e femrës shqiptare e cila e bën gruan kryetemë të gjithë veprimtarisë së saj shkrimore. Vepra e Kokalarit i kushtohet botës dhe shpirtit të femrës. Nëpërmjet rrëfimit ajo ndërton identitetin, ligjërimin, psikologjinë, fatin e fatkeqësinë femërore.

---

[227] Robert Elsie *Historia e letërsisë shqiptare,* Shtëpia botuese "Dukagjini", Tiranë-Pejë 1997, f. 241.

[228] Musine Kokalari *Jeta ime universitare,* Geer, Tiranë, 2009, f. 354.

[229] Lasgush Poradeci *Siç më thotë nënua plakë,* "Bota e re" nr. 1/30 Korik 1940, Korçë

[230] Sabri Hamiti *Letërsia moderne shqipe,* UET/Press Tiranë 2009 f. 428.

[231] Arshi Pipa *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Botime Princi, Tiranë, dhjetor 2013, f. 187-188.

[232] Sabri Hamiti *Letërsia moderne shqipe,* UET/Press Tiranë 2009 f. 425.

Tema dhe fokusi është femra. Personazhet dhe narratori janë femra. Këto dhjetë tekste janë të lidhura me njëra-tjetrën tematikisht, strukturalisht e formalisht.

Siç më thotë nënua plakë - Tema

Nëse tema merret si lëndë atëherë temë e rrëfimeve të Kokalarit *Siç më thotë nënua plakë* del të jetë universale dhe ajo është: jeta e përditshme. Ndërsa nëse tema merret si përbërës strukturor atëherë tema e rrëfimeve të Kokalarit është: konflikti.

Konflikti duke qenë element letrar, që për gjininë e dramës është esencë, këtu shfaqet si motiv i përsëritur. Motivi është përmbajtje e fjalisë që përfshin një konflikt i cili kur shprehet në mënyrë të veçantë zhvillohet në temë. Motivet e identifikuara te *Siç më thotë nënua plakë* janë: kundërshtimi, grindja, përleshja, mosmarrëveshja, përplasja, etj.

Pra karakteri polivalent i temës, si strukturë e si lëndë, në planin e përgjithshëm te këto rrëfime determinohet si: konflikt në jetën e përditshme. E konfliktet e jetës së përditshme te kjo vepër, në fillim e në fund, variojnë në të brendshme (me vetveten) e të jashtme (njeriu me njeriun, njeriu me shoqërinë, njeriu me natyrën).

Siç më thotë nënua plakë është tekst që i prin veprës për nga ndërtimi teorik, shfaqja formale e diskursi. Monologu i dendur i nënos plakë ngritet në nivel shkrimi dhe nis e mbyll tërë përmbajtjen që ka bërë edhe të marr titullin e saj. Karakteristikë e rrëfimeve është numri i personazheve që të shumtën e herëve nuk i kalon më shumë se tre ndërsa këtu i kemi vetëm dy, për të mos thënë një.

Nëno plakë nuk pajtohet me të renë, sipas saj jeta është trazuar dhe ajo nuk mëton ta perceptoj dot ndryshimin. Zëri i saj shpreh pakënaqësi me mënyrën e sjelljes së vajzave që dalin rrugëve, e nuseve që nuk rrinë në këmbë por u është *hapur faqja*. Objekt trajtimi bëhet, sidomos, mospajtimi dhe kundërthënia jetësore në marrëdhënien midis moshave/brezave gjyshe-mbesë. Nëno, si gjeneratë e vjetër, me anë të monologut lakonik shpreh pikëpamjet e veta për këtë botë të re të mbesës. Monologu naiv i protagonistes na kujton vjehrrën e tipit të *Hanko Hallës* (poemë e Ali Asllanit) e cila shpreh emocionet dhe qëndrimet e saj për mjedisin që e rrethon dhe për kohën e shkuar. Humbja e autoritetit dhe e ndikimit e ka vënë plakën në një situatë ku ajo më nuk ka kontroll andaj zemërimi i saj arrin deri në mallkim:

U thafçin e mos u bëfçin më mirë...të mos u skuqet faqe faqja kështu, të mos mblidhen çikë në shtëpi, mbetën udhëve dhe s'i sheh kurrë me një zanat në dorë. (f. 206).
Ikë vajzë së s'të shoh dot përpara, më ngjethet mishtë, kur më del me kërcinj hapur, me llërë zbuluar.

Personazhi i nënos na del si personazh kolektiv i të gjitha kohërave ajo shëmbëllen revoltën e të gjitha motrave, nënave, gjysheve të një ideali të familjeve tradicionale. Temë është konflikti midis brezave.

Sintagma poetike e vënë si titull ***Për mustaqet e Çelos*** është rrëfim që trajton gjëra të kota dhe grindjen midis dy personazheve gra, *Merushes e Havës.* Për dallim prej tekstit të parë këtu personazhet emërtohen dhe tregohet relacioni i tyre, ato janë fqinje. Ngatërresa e tyre për hiçgjë (siç thotë edhe titulli: Për mustaqet e Çelos) shpalon peshën dhe gjendjen e rëndë të jetës në disa aspekte. Duke u nisur nga mos emancipimi i grave që zihen në rrugë për një keqkuptim të kotë

tregon nivelin e ngjashmërisë së tyre si personazhe, ato nuk dallojnë. Shtjellimi i ngjarjes përvijohet në harmoni me veprimin e personazheve dhe shpaloset mentaliteti i tyre primitiv. Ato kërcënojnë, ofendojnë e gati se nuk rrahen krejt spontanisht dhe kjo del si element komik në rrëfim përmes dialogut e situatave groteske:

- *More në dalça jashtë, dhe në të zënça dot, pa më sheh mua se ç'do të bëj, të kam për të marë shpirtin, more zabërhan. Ti, ti të më vëç dorë përmbi djalin q'e kam të vetëm. More vesh, dëgjon? Dëgjova t'më thuaç.*
Ti, ti ishe ajo që më zure pulkën. Në darkë ishte në avllinë t'ënde dhe në mëngjes s'u duk më. E hangre, që si s'të ndesi në grikë, që si s'tu bë helm dhe të të helmonte?

Kokalari ishte mjaft e talentuar në skicimin e rolit të personazheve duke përdorur intriga të vogla. Zëri i personazhit të parë e pret përgjigja e të dytës që ndez grindjen dhe ato shpërthejnë në mallkime nga më të çuditshmet që mund të lexohen si tallje me mendësinë dhe aktualitetin e asaj kohe dhe të atij vendi. Aspekt tjetër mund të jetë edhe vërejtja ndaj shtypjes së grave në atë shoqëri patriarkale sepse në rrëfim paraqitet edhe situata e martesës së kunatës me kunatin pas vdekjes së burrit. Në këtë kuptim nuk ka barazi gjinore dhe gratë e vuajnë pozicionin e tyre inferior duke mos mundur të zgjedhin largimin por detyrohen të kthehen e të martohen për së dyti, pa dëshirë. *Temë është grindja/konflikti midis njerëzve.*

Pas *përqeshjes* së bërë në rrëfimin e dytë, Kokalari zgjedh të shkruaj për një çështje tjetër që mund të lexohet si zgjatim i nëntemës së tekstit *Për mustaqet e Çelos,* atë të martesës. Te ky rrëfim burri martohet fill pas vdekjes së gruas së parë. ***Burri shoku i qenit*** si titull i rrëfimit është krahasimi që i bëhet burrave me qenët ose më saktë burrat quhen shokë qenësh! Rrëfimi shtjellohet përmes dialogut midis kunatave të cilat janë të tronditura me të dëgjuar se Beqiri "që kish shahtisur pas asaj" ishte martuar ende pa i "shkuar ditët" (pa i bërë dyzet ditë) së ndjerës.

Ai burrë q'e donte atë Mukades aqë shumë, që ja bënte qejfet lloi-lloi, që e shpuri nga të katër anët e botës kur qe sëmurë, që gjë s'i la pa bërë, dhe sa mbilli sitë e harroi.

Ato dënojnë Beqirin të cilin e identifikojnë me të gjithë burrat tjerë. Përvoja e tij e hidhur shihet nga perspektiva e grave ku vend të rëndësishëm zë fati i femrës si qenie e si gjini e parëndësishme. Jo vetëm Mukadesi e vdekur, por edhe fati i ardhshëm i fëmijëve të lënë kujtohen nga shoqet e saj që përveç halleve ditore përballen edhe me konfliktin grua-shoqëri. Këtu raporti i burrit me gruan simulohet si problem ekzistencial.

Rrëfimi i radhës ***Është e thellë*** trajton konfliktin *njeri me njeri (*nusja me kunatë, nusja me burrë dhe nusja me djalin e saj) si temë e jetës së përditshme. Rrëfimi është i thurur në dialogun midis dy personazheve (Bedosë dhe Aishes). Ky dialog është karakterizues dhe eksplicit ku njëra nga personazhet i ankohen shoqes për hallet e përditshme, i cili nis kështu:

Ti, ja ke hipur kalit, prandaj më flet kështu moj Aishe. Je me burrë vetëm dhe e bën si të duaç, pastaj e ke të mbledhur, nuk është i prishur.
Ç'e do, ma prishin ato fëmërat e sidmos Nebua, kunata e madhe. Ç'është ajo e ç'është, të ha si qeni fshehura...

E shohim se që me fjalinë e parë hyhet në objektin që trajtohet. Gjithë teksti shtjellohet përmes dialogut, ku shprehjet vijnë breshër, dhe nuk përdoret asnjë koment narrativ. Kjo nxjerr në pah rolin e rëndësishëm që luan dialogu i cili është i ngjeshur e pa degëzime. *Është e thellë* flet për mosmarrëveshjen e nuses me kunatë, relacion i cili lidh edhe konfliktin e nuses me burrë dhe me djalin e vet që në tërësi shfaqin një rrjet drame familjare. Komunikimi i personazheve zbulon imtësi jetësore të cilat i jeton Bedo për çdo ditë, ajo është e *trazuar* nga kunata e cila e kallëzon te i vëllai se gjoja kishte *vu dorë mbi djalin* gjë që e nxit burrin ta sulmoj fizikisht gruan.

Te ***Paç fatin e së ligavet*** trajtohet tema e konfliktit shpirtëror (të brendshëm) të personazhit të një plake. Personazhi i paemëruar i gjyshes nëpërmjet rrëfimit që ndërtohet si monolog jep përjetimin e saj në formë të komunikimit të brendshëm. Teksti me anë të planit të diskursit monologjik transmeton portretin shpirtëror të plakës xheloze. Si strukture ky tekst është mjaftë i shkurtër dhe megjithëse i nisur që në titull me një aforizëm *Paç fatin e së ligavet* ai shtrihet edhe më gjerë. Personaliteti smirëzi i gjyshes zhvillohet në përsëritjen e fjalës *ligë* në variante:

Xhuxhmaxhuxhe, di grushte një mbi një pastaj një e tharë, e vdekur e pa kallur, na shkon duket si do të thihet në mes. Lere, së parit më keq akoma, e shëmtuar.
Të liga si ato, të prapa jashtë udhës, golë-shporta, gjuhën sa një lopatë, maruka të grisura nga mënt e kokës, fëllega që kur hin në shtëpin' e tire të zëq hundët.

Kjo copë e monologut shpalon botën dhe psikologjinë e shpirtit të femrës që duke i folur vetes në fakt i drejtohet mbesës. Motivet që lakohen në rrëfim janë pamundësia dhe *prishja e punës* së vajzës që të martohet me një djalë dhe fati i mirë i tjetrës/*të ligës.*

Udhën e mbarë pastë shtrihet jashtë skemës së temave të përditshmërisë së botës së femrës. Ky rrëfim identifikohet me tema të mëdha universale, është një tekst që takon dhe gjen temën nacionale, atë të kurbetit. Këtu rrëfehet për ndarjet e gjata të familjarëve, personazhi, Serveti, do të niset për udhë të largët i shtrënguar nga skamja. Tema shfaqet si konflikt i njeriut me një varg problemesh sociale, ekonomike, po edhe psikologjike.

Leximi i tekstit bëhet nëpërmjet dialogut të vjehrrës me nuse, ku e para ndërton rrëfimin me anë të diskursit personal, pra emocional. Vjehrra tregon hap pas hapi, në mënyrë të detajuar si kishte kaluar një natë të tërë në shtëpinë e zonjës Huzo e cila e përcillte djalin në kurbet. Diskursi përqendrohet në përshkrimet që bëhen për darkën e shtruar, në rendin e ushqimeve, pastaj ilustrohen këngët e kënduara të kurbetit dhe vallet e kërcyera. Rrëfimi i vjehrrës mbyllet me rrëfimin për nënën e gjorë e cila pas përcjelljes së djalit:

...nuk i u mbajt më nënës, një t'iu shkrepur të qartët dhe qajti sa plasi, vu-vu i venin lotët. Tek kthehesh, mori ca gurë të vegjël dhe kur i vuri në kamaren e odës së dimrit tha me ngadalë: atje ku më shkeli këmba e djalit për ikëlë, atje më shkeltë sa më shpejtë dhe për të ardhëlë.

Në esencë përfundimi tematik është ndarja e hidhur ku burri le prindërit, gruan dhe fëmijët por kjo pamje shpërthen në një perspektivë të tretë me anë të proverbes: *atje ku më shkeli këmba e djalit për ikëlë, atje më shkeltë sa më shpejtë dhe për të ardhëlë.*

Kulloi odaja është rrëfimi më i trishtuar i cili ka për temë vdekjen, konfliktin e njeriut me natyrën, duke sjellë fatin e një vdekjeje të hidhur. Me gjuhën e tekstit të vet Kokalari vë çdo shenjë

aty ku e ka vendin. Dëshpërimin e jetës së një familjeje e përshkruan si ngjarje të vuajtshme dhe të thekshme. Në një vend të tillë të varfër, njerëzit i paraqet shumë të lidhur me njeri-tjetrin të cilët ndajnë gëzimin dhe mërzinë së bashku. Këtë rrëfim e cilëson atmosfera mortore e ngjeshur dhe e rëndë e cila dialogon dhe përforcohet edhe me vargje:

Ç'u këput ili nga hëna,
Djali se ç'u nda nga nëna,
Djalë nënës kë e le,
Bit për kë të bëj be,
Djalë shkove, m'u largove,
Bir nënën s'e mendove

Në këtë tekst, ndryshe nga ai përpara tij, veprohet në mënyrë të kundërt e bija, Mediha i rrëfen nënës, teto Hanuas për ato që kishte parë e kishte dëgjuar me rastin e vdekjes së Hamdiut, vëllaut të vetëm të gjashtë motrave i cili ishte shuar brenda tri ditësh.
Kokalari përjetimet dhe pamjet e kësaj ngjarje tronditëse i zbulon fillimisht me anë të titullit metaforik: *Kulloi odaja.* Teksti është i ndërtuar në dikursin e pikëllimit dhe vajit goditës të shoqëruar me shumë derdhje lotësh. Metafora *Kulloi odaja* shpreh krahasimin e ngjashmërisë që i bëhet lagështisë së mureve të dhomës me lotët e derdhur deri në pikën e fundit, deri në zbrazje, deri në kullim.

Një qen që hamullit nuk ha shënjon satirë eksplicite përmes fjalës së urtë popullore *Qeni që leh nuk të ha* duke e identifikuar me jetë figurën e kafshës së padëmshme që leh. Përmes një dialogu, që edhe këtu luan rolin kryesor, midis shoqeve të vjetra rrëfimi trajton konfliktin e grave në përditshmëri (njeriut me njeri). Autorja jep faqen e nxirë të grave shqiptare ku vihen në pah ndjesi thellësore të shpirtit për të shpaluar psikologjinë e tyre.

Xhevrua dhe Razo zbulohen, heqin maskat, dhe vihen përballë situatës së zhveshur të thashethëmeve të ulta:

- Ësht' e marë dhe për vehten e saj! Nuk mblidhet çikë në shtëpi, po mbeti udhëve. Nuk shikon që me një i bie çatija, që do t'i zëjë brënda të gjallë. Grisi dhë këpucët, po ato para ja blen dhe fëmilës bukë që vështrojnë duart e botës. Oh! Moj Razo, një qen që hamullit nuk të ha...

Natyrshmëria e personazheve si llafazane e thashethemexhike të cilat marrin nëpër gojë një të tretë nëpërmjet të folmes së hapur dëshmon për njohjen e mirë të psikologjisë së femrës së asaj kohe dhe të atij ambienti.

Stili i shkrimit shënjon referencat e fjalëve dialektore të cilat ndihmojnë në karakterizimin e personazheve dhe veçorive shoqërore. Në ligjërimin e personazheve, ndër të tjera, përmendet: *llafositja* dhe *ferexheja*. *Llafositja* – zgjeba dhe *ferexheja* janë empiri jetsore që prekin dëshminë e konvencave të shoqërisë.

Rrëfimi tjetër ***Mos qofshin vjehrrat e zeza*** ka për bazë konfliktin e famshëm, atë më të vjetrin, antitezën vjehrrë – nuse. Teksti është i shkruar në vetën e tretë, të cilën, e preferon tregimi. Personazh kryesor është Durija, nusja, e cila i qahet motrës për vjehrrën e zezë. Tregimi përbëhet nga monologu i protagonistes që gërshetohet nga dialogu i zjarrtë e përplot të nëmura në drejtim të vjehrrës. Përshkrimet e nuses të shkruara me shumë pasion dhe ngjyra edhe pse në dukje të

zakonshme, janë më shumë se kaq. Grindja që kishte shpënë vjehrrën e zemëruar të ikë te vajza, jepet me ankime dhe mllef të fortë të mbledhur në zemër:

Shtriga, i djegtë Zoti zëmrën, ashtu si më dogji mua nusërinë. Nuk më la një herë të bënja si shoqet, të dilnja si ato. S'kam kapërxyer prakun e derës, s'kam vatus as në një dasmë, s'kam veshur një herë robat, m'u grisnë në sepet. U pupu! Ç'i bëra e pse s'rinë të zezat plaka, u kruspullofshin, e gjefçin nga Perëndija!

Kokalari e kërkon dhe e ndërton identitetin e femrës në profilin e nuses e të vjehrrës. Zgjedhja e personazheve të përmendura është karakterizuese/ilustruese dhe si e tillë e vë tekstin nën shenjën kritike e satirike.

Portretizmi i shtypjes së nuses në shumë plane është gjetje mjaft dramatike. Ajo e provon vuajtjen shumfish, e mundon vjehrra me punët e shtëpisë, e lëndon i shoqi që nuk e përkrah, e lodh fëmiu gjithnjë i sëmurë e duke qarë dhe gjendja e mjerë e familjes së babait ku nuk mund të kthehet. E gjendur në këtë situatë të pashpresë asaj i bëhet të vejë derë më derë e të *punoj me duar* sa për të mos humbur jetën, personalitetin dhe ëndrrat e nusërisë. Këtu tema e konfliktit midis njeriut me njeriun zhvillohet në konflikt të njeriut me shoqërinë.

Edhe në tregimin ***Ulurima e qenit*** që njëherit mbyll përmbledhjen me tregime, autorja sjellë temën e konfliktit të njeriut me natyrën. Ky tekst ka strukturë më komplekse në kuptimin që redukton përshkrimin dhe dominohet nga dialogu. Diskursi i personazheve është sikur edhe te tekstet tjera plot emocion dhe përjetim.

Teto Hasija kishte dëgjuar ulurimën e qenit gjatë gjithë natës dhe sipas saj kjo ndillte vdekjen. Kuptohet kjo nuk është tjetër veçse një bestytni e cila jep një atmosferë sugjestionuese dhe të rëndë. Sipas kësaj ndërgjegjeje dikush lëngon e pritet te vdes.

Gjithë natën e dëgjova të përmbisurin qen. Ulurinte e ulurinte, pastaj gërmonte baltën me thonj. E zeza unë, ah, moj Perëndi, na ruaj shëndenë e së gjithëve!

E dëgjova, i tha teto Hasijeja, qenin gjithë natën? me atë zë që më ngjethi mishtë? E! buzë-plasuri, ja ktheu teto Nefiseja, e dëgjova ndaj të gdhirë. S'kemi dëgjuar dhe njeri të sëmurë në mëhale.

Në pjesën e dytë të tregimit shenja paralajmëruese e ogurit të zi përmbushet. Djali i ri i Hasanit që kishte vjellë gjakë vdes. Dëshpërimi i kësaj ngjarjeje të hidhur përshkruhet me hollësi të tjera ku thuhet se djali ishte shtylla e shtëpisë që kishte lënë një "karvan fëmile", babain nuk e kishte si duhet, motrat e mira por të pafat dhe më e rënda një vëlla i kishte mbetur në Amerikë.

Për nga mënyra e narracionit, tregimi, sikur herëve të tjera, nuk përfundon me "happy end" përkundrazi ai mbetet i hapur duke rrëfyer për gratë që gdhinë me të vdekurin dhe pastaj ikën duke i lëshuar rend njerëzve që vijnë ta marrin "xhenazenë."

"Ulurima e qenit" ka një theks realist e përshkrues të anës zakonore e rituale që dëshmon edhe një herë se autorja ishte njohëse e saktë e mentalitetit dhe e mjedisit.